E DREJTA KUSHTETUESE

Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese"
të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj

BIBLIOTEKA **BESA**

Botues:
Jalifat Publishing
Hjuston, Teksas, SHBA

Dizajni dhe radhitja:
Plisi.org

Shtypshkronja:
Prograf
Prishtinë, Kosovë

ISBN 978-0-9970186-6-0

© 2018. Autori dhe botuesi ruajnë të gjitha të drejtat. Ata po ia dhurojnë **Shoqatës së të Verbërve të Kosovës** ekzemplarët e librit. Shoqata i merr të gjitha paratë nga shitja e tyre.

Prof. dr. Enver HASANI

E DREJTA KUSHTETUESE

Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese" të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj

Jalifat Publishing
Hjuston

Të verbërve të Kosovës

Përmbajtja

Përmbledhje xi

Summary..... xix

Hyrje xxvii

***Pjesa e parë.* TEORIA E SË DREJTËS KUSHTETUESE 1**

KAPITULLI I. KUPTIMI I SË DREJTËS KUSHTETUESE (FQ. 27–41)..... 1

KAPITULLI II. ZHVILLIMI HISTORIK I SË DREJTËS KUSHTETUESE DHE I KUSHTETUTËS (FQ. 43–66)..... 15

KAPITULLI III. BURIMET E SË DREJTËS KUSHTETUESE (FQ. 67–92) 33

KAPITULLI IV. KUPTIMI I KUSHTETUTËS DHE LLOJET E SAJ (FQ. 93–135)..... 53

KAPITULLI V. PËRMBAJTJA DHE STRUKTURA E KUSHTETUTËS (FQ. 137–153) ... 86

KAPITULLI VI. MIRATIMI DHE NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS (FQ. 155–173) 100

KAPITULLI VII. KUSHTETUTSHMËRIA, LIGJSHMËRIA DHE KONTROLLI KUSHTETUES (FQ. 175–185)..... 121

***Pjesa e dytë.* RRETH HISTORIKUT TË KUSHTETUTËS SË KOSOVËS ... 143**

KAPITULLI I. HISTORIKU KUSHTETUES I KOSOVËS NË MES TË VITEVE 1945–1999 (FQ. 189–227)..... 143

KAPITULLI II. E DREJTA KUSHTETUESE E KOSOVËS NË TRANZICION – PERIUDHA E ADMINISTRIMIT NDËRKOMBËTAR TË KOSOVËS (FQ. 229–241) 154

KAPITUJT III–IV. PROCESI I ZGJIDHJES SË STATUSIT FINAL TË KOSOVËS (PAVARËSISË SË KOSOVËS) DHE NDIKIMET NË RENDIN KUSHTETUES AKTUAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (FQ. 243–254). PROPOZIMI GJITHËPËRFSHIRËS PËR ZGJIDHJEN E STATUSIT FINAL TË KOSOVËS (PAKOJA E AHTISARIT) SI REZULTAT I BISEDIMEVE TË VJENËS (255–273). 160

KAPITUJT V–VI. PROCESI I HARTIMIT TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (2008) (FQ. 275–280). DEKLARATA E PAVARËSISË SË KOSOVËS – 17 SHKURT 2008 (PROCESI I SHPALLJES SË PAVARËSISË) (FQ. 281–297). 171

Kapitulli VII. Argumentimi i GJND-së për pavarësinë e Kosovës (fq. 289–297).....178

***Pjesa e tretë.* E DREJTA E APLIKUESHME NË KOSOVË (DISPOZITAT E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS)..... 186**

Kapitulli I. Karakteristikat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (fq. 301–314).....187

Kapitulli II. Përmbajtja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (2008): Preambula dhe parimet themelore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (fq. 315–333).....198

Kapitujt III–IV. Institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës: Kuvendi i Republikës së Kosovës (fq. 335–380). Institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës: Presidenti i Republikës së Kosovës (fq. 381–409).....211

Kapitujt V–VI. Qeveria e Republikës së Kosovës (fq. 411–426). Sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës (fq. 427–454).....239

Kapitulli VII. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (fq. 455–484).....253

Kapitulli VIII. Sektori i Sigurisë në Republikën e Kosovës (fq. 485–501).....270

Kapitujt IX–XI. Institucionet e pavarura në Republikën e Kosovës (fq. 503–514). Marrëdhëniet ekonomike sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (fq. 515–520). Qeverisja lokale dhe organizimi territorial sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (fq. 521–532).....278

Kapitujt XII–XIII. Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve pakicë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (fq. 533–561). Amendamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (fq. 565–586).....280

Përfundim..... 291

***Shtojca 1.* Reagimi i autorëve Bajrami e Muçaj**

Përgjigje një kritike jo shkencore, tendencioze dhe subjektive të prodhuar nga Enver Hasani.....295

Shtojca 2. **Përgjigjja e autorit të kritikës ndaj reagimit të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj**

KRITIKA IME NUK ËSHTË PERSONALE, POR SHKENCORE: PËRGJIGJE NDAJ REAGIMIT TË AUTORËVE ARSIM BAJRAMI DHE FLORENT MUÇAJ 343

Literatura 349

A. LIBRA 349

B. ARTIKUJ 353

C. AKTE JURIDIKE DHE DOKUMENTE TË TJERA 357

Treguesi 361

Përmbledhje

Ky material paraqet një kritikë shkencore mbi librin ***E drejta kushtetuese***, të autorëve **Arsim Bajrami** dhe **Florent Muçaj**. Libri i dedikohet studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës. Botues i librit është Fakulteti Juridik. Libri ka gjithsej 642 faqe dhe ka dalë në publik në maj të vitit 2018.

Autorëve të librit dhe vetë librit iu referohemi kryesisht si "autorët tanë". Kritika jonë shkencore ndjek strukturën e librit, që do të thotë se lexuesi ynë do të gjejë tek ne përmbajtjen e njëjtë që është në librin e autorëve tanë. Këtë e kemi bërë me qëllim që lexuesi ta ketë më të lehtë për të ndjekur natyrën dhe ashpërsinë e gabimeve dhe lëshimeve të autorëve tanë. Në këtë mënyrë, përveç kësaj si më lart, lexuesi ynë do ta ketë më të lehtë t'i gjejë pjesët që i duhen për t'i analizuar, përkatësisht pjesët që në vijim të këtij teksti i kemi veçuar si më të rëndësishmet për t'u lexuar nga çdokush.

Vëllimi pak i rritur i kësaj kritike shkencore (292 faqe) është përcaktuar nga ashpërsia dhe vëllimi i gabimeve shkencore, profesionale, didaktike dhe i lëshimeve të tjera serioze të librit të autorëve tanë. E megjithatë, këtu nuk janë përfshirë të gjitha të metat e natyrës si më sipër të librit. Kjo mospërfshirje e të gjitha gabimeve profesionale, shkencore dhe didaktike është bërë për dy arsye: e para, sepse një gjë e tillë do të çonte kritikën tonë në një vëllim shumë më të madh se ky që sot i prezantohet lexuesit; dhe e dyta, sepse do të ripërsëriste gjërat e thëna në këtë pjesë të kritikës sonë, nisur nga fakti se libri cilësohet me të njëjtat gabime përgjatë tërë tekstit. Tri janë cilësitë themelore të gabimeve të autorëve tanë që përshkojnë tërë tekstin, nga faqja e parë deri në fund të tij. Ato cilësi konsistojnë në si vijon:

- e para, autorët tanë manipulojnë në shkallë skajshmërisht të madhe literaturën e përdorur për prodhimin e tekstit të tyre, aq shumë sa e bën të pashembullt për një libër të natyrës së tillë këtu në Kosovë dhe më gjerë;
- e dyta, narracioni i librit fund e krye është kaotik dhe paraqet përmbledhje eklektike të disa mendimeve të ndryshme; aq shumë kaotik dhe i çakorduar është teksti sa të rralla janë rastet kur një para-

graf nis dhe përfundon siç duhet në lidhshmëri dhe harmoni me paragrafët e tjerë; dhe

- e treta, si pasojë e dy cilësive si më sipër, teksti shumë rrallë është i kuptueshëm për lexuesin dhe konsistent në atë që trajton; ka gabime të hapura profesionale e shkencore, dhe përçon informacion shumë të pasaktë të studenti dhe lexuesi tjetër.

Në këtë vend veçojmë vetëm disa nga gabimet e thella dhe tmerrësisht të rënda nga aspekti profesional dhe shkencor, të cilat i kanë shpërfaqur autorët tanë në këtë libër. Ato janë si vijon:

1. mosnjohja themelore e dallimit mes të drejtës kushtetuese dhe kushtetutës, si degë e sistemit pozitiv juridik dhe si teori, si dhe në kuptimin e tyre material dhe formal;
2. mosnjohja themelore e rrjedhave dhe rëndësisë së mendimit filozofik dhe juridik të proveniencës perëndimore, në të cilin bën pjesë Kosova dhe sistemi i saj juridik-kushtetues;
3. mosnjohja themelore e natyrës juridike të **Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës**, e rolit dhe pozitës së saj në procesin e krijimit të shtetit të Kosovës;
4. mosnjohja themelore e modeleve të kontrollit kushtetues dhe të vetë gjyqësisë kushtetuese; dhe
5. mosnjohja themelore e sistemit politik të cilit i takon Kosova, gjë që shihet nga keqkuptimi mbi rolin dhe pozitën e presidentit të Kosovës.

1. Në kapitullin e parë të librit të autorëve tanë, studenti dhe lexuesi tjetër krejt natyrshëm do të presin të gjejnë informacione të bollshme mbi kuptimet themelore lidhur me të drejtën kushtetuese dhe kushtetutën. Informacionet lidhur me këto kuptime nuk do t'i gjejnë. Nuk do t'i gjejnë sepse vetë autorët tanë nuk e kanë të qartë se çfarë paraqet e drejta kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik dhe çka si teori apo degë e shkencës juridike. Pikëpamjet tona gjenden në faqet 1–15 të tekstit të kësaj kritike shkencore.

2. Për idetë e para lidhur me të drejtën kushtetuese, autorët tanë flasin në mënyrë krejtësisht të përçartë dhe pa asnjë fije konsistence. Pa folur fare për **Greqinë** e lashtë, fillojnë diskutimin për **Perandorinë e Romës**, duke e quajtur madje "monarki kushtetuese"; mendojnë se kanë jetuar në të njëjtën kohë **John Locke** (Xhon Llok ose Lok) dhe **Baroni Montesquieu** (Monteskjë, Monteskjeu); nuk e kanë të qartë **Renesancën**, **Ilu-**

minizmin, **Reformacionin** dhe asnjë koncept themelor perëndimor që ka qëndruar përgjatë shekujve në themelet e konstitucionalizmit perëndimor; flasin për **Kushtetutën e Medinës** si për kushtetutën e parë në botë, pa thënë asnjë fjalë për **Instrumentin e Qeverisjes** në **Angli** (1653); as idenë më të vogël nuk e kanë se kush, pse dhe si e përdori për herë të parë termin e drejta kushtetuese, si nocion gjuhësor dhe përmbajtjesor; flasin edhe për shumë gjëra të tjera në mënyrë të gabuar. Këtë mosnjohje drastike i kemi analizuar në faqet 15–33 të kësaj kritike, në fund të së cilës lexuesi mund t'i gjejë të mbarështruara pikëpamjet tona të sakta.

3. Në kapitullin e parë të pjesës së tretë, por edhe në kapitujt e tjerë aty-këtu, autorët tanë flasin për Kushtetutën e Kosovës si për dokumentin themelues të shtetit të Kosovës. Kjo do të thotë se studentët tanë mësojnë se si **Kushtetuta e Kosovës** përbën dokumentin kyç dhe kryesor që ka themeluar Shtetin e Kosovës. Kjo, u mor vesh, nuk mund të jetë e saktë as në rastin e Kosovës e as në rastin e ndonjë shteti tjetër në rruzullin tokësor. Në të shumtën e rasteve, në veçanti këtu në Evropë përgjatë shekujve XIX dhe XX, shtetet janë themeluar përmes deklaratave të njëanshme të pavarësisë, të cilat shpesh janë shoqëruar me beteja të përgjakshme, qoftë para ose pas shpalljes së pavarësisë formale. Kështu ka ndodhur me **Greqinë**, **Rumaninë**, **Serbinë**, **Malin e Zi** (gjatë shekullit XIX) dhe njësitë federale të ish-federatave komuniste (Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia dhe Çekosllovakia). Këtë e ka konstatuar në rastin e Kosovës vetë organi më i lartë i drejtësisë ndërkombëtare, **GJND** (Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë). Në mendimin e saj këshillëdhënës të datës 22 korrik 2010, aq me rëndësi dhe aq historik për Kosovën, **GJND** ka konstatuar se **Deklarata e Pavarësisë së Kosovës** nuk ka cenuar asnjë dispozitë të së drejtës ndërkombëtare, asaj të përgjithshme dhe të posaçme. Sikundër mund të shihet në faqet 143–153 të kësaj kritike, autorët tanë mundohen t'i imponojnë studentit dhe lexuesit një pikëpamje tërësisht të gabuara dhe të paqëndrueshme, gjithnjë me shpresën se do të shitet në treg ideja e autorit të parë të librit sipas së cilës **Kushtetuta e Kosovës** ka autorësi origjinale vendore dhe se hartuesit e saj janë bartës të pushtetit të sovranit të Kosovës, apo bartës të asaj që në të drejtën kushtetuese njihet si pushteti konstituiv origjinal. Ky konstrukt nuk ka asnjë mbështetje shkencore a morale.

4. Në kapitullin VII të pjesës së parë, autorët tanë flasin për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Në mesin e gabimeve të shumta të natyrës themelore, veçohet ai i mosdijes së tyre lidhur me modelet e kontrollit të kushtetutshmërisë. Për këtë arsye ata zbulojnë modelet që fare nuk ekzi-

stojnë. Sepse, si të tilla, nuk paraqesin modele por forma të manifestimit të kontrollit kushtetues, përkatësisht ushtrim juridiksioni që ka të bëjë me kontrollin dhe interpretimin kushtetues. Autorët tanë, si të tillë cilësojnë modelin abstrakt të kontrollit dhe modelin konkret të kontrollit të kushtetutshmërisë, si dhe modelin preventiv (paraprak) dhe modelin e represiv (të mëpasshëm) të kontrollit të kushtetutshmërisë.

Në kapitullin VII të pjesës së tretë, që flet për **Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**, autorët tanë vazhdojnë me gabime të tjera të shumta. Ndër to hyn edhe zbulimi i juridiksionit të ri kësaj gjykate, juridiksion që fare nuk ekziston. Autorët tanë besojnë se në nenin 113.3 (4) të **Kushtetutës së Kosovës** gjendet juridiksioni për kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo dispozitë e këtij neni fare nuk ka të bëjë me atë që mendojnë autorët tanë, por me kontrollin e konvencionalitetit të amendamenteve të propozuara kushtetuese. Instituti i **kontrollit të konvencionalitetit** paraqet një mekanizëm të veçantë të kontrollit të kushtetutshmërisë, i cili konsiston në vlerësimin nga ana e një gjykate kushtetuese nëse një normë apo akt i brendshëm juridik (normë kushtetuese, normë ligjore apo normë tjetër e përgjithshme, një akt juridik individual apo vendim etj.) bie ndesh me dispozitat e një marrëveshjeje apo të detyrimi tjetër ndërkombëtarë që ka natyrë kontraktuale.

Në **Evropë** ekzistojnë kushtetuta që u japin këtë kompetencë gjykatave të tyre kushtetuese, apo gjykatave të barasvlefshme me gjykatën kushtetuese, të cilat ushtrojnë juridiksion kushtetues. **Kosova**, në këtë drejtim, nuk përbën një përjashtim: kjo kompetencë, në kontekstin kosovar, përfshin vetëm kontrollin e konvencionalitetit të amendamenteve të propozuara kushtetuese, duke mos përfshirë këtu normat ligjore apo normat e tjera të përgjithshme, një akt juridik individual apo vendim tjetër dhe kështu me radhë. Thënë me fjalë të tjera, në rastin e Kosovës, kontrolli i konvencionalitetit nënkupton që Gjykata Kushtetuese kontrollon vetëm nëse një amendament i propozuar kushtetues është në përputhje me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas Kushtetutës, përfshirë këtu procedurën e ndjekur për miratimin e tyre. Pikëpamjet tona të sakta dhe të detajuara lidhur me këtë, si dhe lidhur me krejt gabimet e tjera që ndërlidhen me gjyqësinë kushtetuese, lexuesi ynë mund t'i gjejë në faqet 253–270 dhe 280–291 të kësaj kritike.

5. Ndër gjërat e çuditshme dhe mjaft të shpeshta, në kuadër të gabimeve themelore të autorëve tanë hyn edhe ajo që ka të bëjë me presidentin e Kosovës, rolin dhe pozitën e tij kushtetuese. Në disa vende, autorët tanë

thonë se ajo/ai ka kompetenca dualiste dhe ekzekutive, gjë që e bën Kosovën të ketë sistem semipresidencial, në të tjerat konstatojnë se Kosova është një vend tipik me sistem parlamentar të qeverisjes, kurse në disa vende thonë që Kosova ka një sistem hibrid. Në asnjë vend nuk mund të haset shpjegimi, të cilin më së shumti e dëshiron studenti dhe lexuesi, se cilit pushtet i takon shefi i shtetit në Kosovë. Përgjigja e saktë në këtë pyetje sqaron çdo gjë lidhur me sistemin e qeverisjes në Kosovë. Këtë gjë, me sa duket, nuk e kanë të qartë as vetë autorët tanë. Se kjo është kështu shihet nga teksti i prodhuar prej tyre dhe vetë lloji i literaturës së përdorur (kryesisht në mënyrë manipulative). Gjëja më shokuese është kur studenti dhe lexuesi do të gjejnë konstatimin e autorëve tanë (fq. 381), se edhe mbreti mund të jetë president, krahas shtjellimeve të tyre përmes së cilave bëhet e qartë përtej çdo dyshimi mosnjohja nga ta e kuptimit të shefit të shtetit në një demokraci parlamentare dhe joparlamentare, si emërues i përbashkët për mbretin a mbretëreshën dhe presidentin e republikës. Pikëpamjet tona lidhur me këtë, lexuesi ynë mund t'i gjejë në fq. 211–239 të kësaj kritike. E megjithatë, në vijim në pika të shkurtra, duhet të tregojmë se çka në fakt është shefi i shtetit në një republikë parlamentare siç është Kosova. Ky shpjegim domosdo ka një histori, dhe historia e nis me **Revolucionin Francez** dhe dy ideologët e praktikuesit e tij, **Abbé Sieyès** (Abe Sjejes) dhe **Benjamin Constant** (Benzhamen Konstan).

Këta dy revolucionarë, pasi që kishin parë që vullneti i përgjithshëm i popullit po prodhonte dhunë dhe tragjedi njerëzore, gjë që u shpërfaq gjatë kohës së terrorit revolucionar të udhëhequr nga **Maximilien Robespierre** (Maksimiljen Robespjer), iu qasën punës për të ndërtuar një demokraci tjetër. Ajo demokraci u cilësua si demokraci përfaqësuese. Vetëm në kushtet e një demokracie përfaqësuese mund të flitej për ndarjen e pushteteve dhe balancimin në mes tyre, asnjëherë në kushtet e shprehjes së pakontrolluar të vullnetit të përgjithshëm, siç kishte menduar **Jean-Jacques Rousseau** (Zhan-Zhak Ruso). Pushteti duhej ndarë ashtu siç kishte thënë **Baroni Montesquieu**, apo **James Madison** (Xhejms Medison) te ***Letrat e Federalistit*** (nr. 51), por me një shtesë: duhej ndërtuar një organ të katërt, neutral dhe asnjanës, pa interes në asnjërin prej pushteteve klasike (legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit), i cili do të vishej me pushtet neutral dhe të ndërmjetëm. Modeli amerikan, ku presidenti ishte pjesë e ekzekutivit, nuk u duk i realizueshëm në kushtet franceze. Për këtë arsye, zgjidhja u gjet tek ndërtimi i një organi të katërt dhe pa pushtet ekzekutiv, të cilin e cilësuan si pushtet pasiv (apo pushtet joaktiv). Deri atëherë, pushtetin ek-

zekutiv apo aktiv e kishte pasur mbreti nga dinastia franceze e **Bourbonëve**, për qindra vite me radhë.

Revolucioni Francez e bëri të qartë se pushteti buron nga populli, jo hyjnia. Tani që pushteti buronte nga populli, jo nga fuqitë hyjnore, ngelej i pazgjidhur vetë statusi i mbretit **Bourbon**. Kjo çështje u zgjidh shumë kohë më vonë, pas rrëzimit të Napoleonit. Kjo për shkak se ardhja e tij në pushtet ndërpreu çdo debat për kontroll kushtetues dhe kornizim juridik të pushtetit dhe formës së ushtrimit të tij. Kjo është krejt normale nëse merret parasysh vetë natyra e perandorisë dhe e perandorit, ani se autorët tanë në librin e tyre besojnë se Perandoria Romake ka qenë një "mbretëri kushtetuese" (sic!). Thënë me fjalë të tjera, **Napoleoni** shtyu anash çdo debat lidhur me kontrollin kushtetues-juridik të pushtetit shtetëror, duke ndërtuar një perandori familjare që rrënoi legjitimitetet dinastike në të gjitha vendet kryesore të Evropës. Kjo rrethanë bëri që pas rrëzimit të tij dhe restaurimit të dinastisë **Bourbon** të vihet sërish në spikamë roli dhe pozita kushtetuese e mbretit francez.

Pas rikthimit të Burbonëve në pushtet më 1814, **Benjamin Constant** shtjelloi deri në detaje rolin neutral dhe të ndërmjetëm që duhet ta ketë mbreti në një monarki kushtetuese. Sipas tij, mbreti duhet të ketë të drejtën e shkarkimit të ekzekutivit në rastet kur nuk arrin të ushtrojë funksionin e vet, të drejtën e shpërbërjes së parlamentit në rastet kur paralizohej si pasojë e luftës politike ndërmjet partive dhe grupacioneve të ndryshme dhe, së fundi, të drejtën e faljes duke u nisur nga fakti se gjyqësori potencialisht mund të bëjë gabime të pakthyeshme, të cilat mund t'i përmirësonte në mënyrë diskrecionale vetëm monarku si shef i shtetit. Me falje në veçanti mendoheshin rastet e dënimeve me vdekje. Kjo qasje u cilësua si e domosdoshme për një monarki që pretendonte të jetë monarki parlamentare kushtetuese. Si e tillë, në mënyrë graduale u përqafua nëpër vendet e tjera të Evropës, përqafim që ka kulmuar në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Këtyre tri kompetencave të shefit të shtetit, si neutrale dhe të ndërmjetme, më vonë iu shtuan shumë kompetenca të tjera që e bënin vendimmarrjen e shefit të shtetit vendimmarrje zinxhirore në dobi të vetë shefit të shtetit, qoftë ai/ajo monark apo president republike. Kjo u bë me qëllim të sigurimit të ndarjes së pushtetit përmes një organi të katërt që nuk do të bënte pjesë në asnjërin prej tri pushteteve klasike (legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit). Nga kjo del se shefi i shtetit në një republikë parlamentare nuk mund të ketë asnjë pushtet aktiv apo ekzekutiv. Kjo

është arsyeja pse në të gjitha kushtetutat evropiane që kanë sistem parlamentar ekziston definimi i shefit të shtetit si garantues i funksionimit të institucioneve të shtetit dhe i unitetit të shtetit apo popullit. Kjo sepse ky definicion reflekton natyrën unifikuese të kompetencave të tij/saj që përbëjnë vendimmarrjen zinxhirore, joaktive apo joekzekutive për nga natyra.

Këtu hyn edhe Kosova: asnjë nga 30 kompetencat e shefit të shtetit në Kosovë nuk kanë natyrë aktive apo ekzekutive, por natyrë balancuese të tri pushteteve të tjera (legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit), me qëllim të sigurimit të funksionimit normal dhe stabil të tyre. Në vendet që i takojnë sistemit presidencial apo semipresidencial, presidenti përveç që definohet si kreu i shtetit, njëjtë si në sistemet parlamentare, ai/ajo definohet edhe si kreu i ekzekutivit, garantuesi i kushtetutës dhe rendit kushtetues, i sovranitetit territorial dhe nacional dhe kështu me radhë. Ky nuk është rasti me Kosovën dhe me asnjë vend tjetër ku parlamenti është hallka legjitimuese e të gjitha pushteteve të tjera, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Në vendet me sistem presidencial, parlamenti nuk është legjitimues i të gjitha organeve dhe ekzekutivi ka jetë të pavarur nga legjislativi, përkatësisht jeta e shefit të shtetit si bartës i ekzekutivit nuk varet nga legjislativi. Në sistemet semipresidenciale, ndërkaq, gjendja paraqitet pak më e nuancuar: jeta e ekzekutivit varet nga parlamenti dhe shefi i shtetit në mënyrë të kombinuar dhe të ndërlidhur e balancuese. Kjo do të thotë se në sistemet gjysmë-parlamentare, ekzekutivi varet nga besimi i parlamentit dhe i kreut të shtetit.

Në sistemin parlamentar, jeta e ekzekutivit domosdo që varet, legjitimohet dhe përligjet përmes ligjvënësit. Këto gjëra duhet t'i dinë studentët dhe lexuesit tanë, jo ashtu siç i kanë shpjeguar në libër autorët tanë. Ai shpjegim nuk ka asnjë bazë shkencore dhe profesionale dhe nuk gjendet te asnjë autor në të dy anët e Atlantikut. Këto i kemi sqaruar gjerësisht në faqet tona të kritikës (fq. 211–239), ashtu që lexuesi ynë mund të vlerësojë vetë se si duken në të vërtetë në kontekstin e gabimeve themelore të autorëve tanë të shpërfaqura në librin e tyre objekt i kritikës sonë.

Mënyra si është shkruar ky libër na mëson një gjë themelore: si nuk duhet shkruar një tekst universitar. Duke qenë kështu, ofrimi i tij për studentët, përveç se është joligjor, është edhe joetik sepse dëmton rëndë formimin e tyre profesional. Në fakt, kjo e fundit ka qenë arsyeja themelore përse unë i kam hyrë punës për të bërë këtë studim kritik. Rrethana që edhe vetë jam pjesë e edukimit profesional të studentëve tanë ka qenë një

arsye shtesë për të ndërmarrë këtë studim kritik. Sikur të bëhej fjalë për një libër që nuk u dedikohet studentëve, gjërat do të kishin qenë më ndryshe. Duke qenë kështu si janë, mbesim me shpresë se kjo kritikë do të mirëkuptohet. Në të njëjtën kohë, fuqishëm besojmë se rreshtat në vijim do të ndihmojnë studentin dhe lexuesin që të analizojnë vetë gabimet e rënda profesionale e shkencore të librit të autorëve tanë. Këtë studim kritik e kemi konceptuar si një lloj udhëzuesi për të ndihmuar studentin dhe lexuesin që të orientohen gjatë leximit të librit të autorëve tanë sepse, si i tillë, libri ka gabime shumë të thella profesionale dhe shkencore me një përmbajtje jo të saktë, ashtu që leximi i tij i pavarur dëmton rëndë çdokënd.

Summary

This text represents a critical review of ***E drejta kushtetuese*** (Constitutional Law) by Arsim Bajrami and Florent Muçaj, a university textbook. Its aim is to serve the students of all public universities in Kosovo and beyond, according to the authors. The book is published by the Faculty of Law of the University of Prishtina.

Throughout the review, I refer to the authors and the book itself as "our authors." I follow the structure of the book under review. This is done for the sake of simplicity, as it makes it easier to track our authors' errors and omissions and find the exact pages where they appear. Here, I have summarized only some of the most egregious mistakes of a professional, scientific, and didactic nature.

In line with the above, the following are the main characteristics of the book:

- First, our authors heavily manipulate each source of literature that has served to produce their text, so much as to make the book an unprecedented piece of work in Kosovo and beyond.
- Second, the book's narrative is a thoroughly chaotic and eclectic collection of different views, so much so that not even a single paragraph of the book is in harmony with the others.
- Finally—as a result—the book is seldom comprehensible. It is inconsistent and incoherent in what it says; it contains obvious professional and scientific errors and omissions, and transmits completely inaccurate information.

As to the subject matter, our authors demonstrate a lack of knowledge on the following matters:

- the key distinction between constitutional law and the constitution, in terms of positive law and theory as well as in material and formal terms;
- the trends and importance of the legal and philosophical thoughts of the Western World to which Kosovo belongs;
- the legal nature of the Declaration of Independence of Kosovo and its role and place in Kosovo's statehood process;

- elementary models of constitutional review and constitutional justice; and
- Kosovo's system of government, as revealed by our authors' misunderstanding of the role and position of the President of Kosovo as head of state.

The book is divided into three parts, each having several chapters. What follows is our analysis in brief and the summary of the key mistakes and omissions of our authors.

1. Students and other readers will expect to find sufficient information on basic concepts of constitutional law and constitution at the beginning of the book. Such information is unavailable. It is missing because the authors themselves have doubts and misunderstandings as to the meaning of constitutional law as positive law and as a theory. My views on this topic are found on pages 1–15 of the review and presented in a way that helps the reader compare them to the views of our authors.

2. Our authors discuss the early ideas on constitutional law as positive law in a very vague and inconsistent manner, so much so that it is difficult to grasp their meaning. In this sense, they write about the Roman Empire before discussing Greece, and go as far as to state that Rome was a kind of "constitutional monarchy"; they believe that **John Locke** and **Baron Montesquieu** lived during the same period of time; no distinction is made between the Renaissance, Enlightenment, Reformation, or any other Western period or concept standing behind the liberal constitutionalism as we know it today; the authors speak of the 7th-century **Constitution of Medina** (present-day Saudi Arabia) as the first modern constitution on earth, while making no mention of England's 1653 **Instrument of Government**; finally, our authors have no idea as to who was the first author to ever use the term "constitutional law," as a linguistic item and as a concept denoting positive law and its theory. In short, they speak of many things, and are thoroughly wrong in what they say. This drastic lack of knowledge is analyzed on pages 15–33 of this review, followed by an accurate overview of basic concepts and terms of constitutional law and its theory.

3. In the book, our authors depict the 2008 Constitution of Kosovo as a founding document of the state of Kosovo. This means that students will study and will be taught incorrect information, that the 2008 Constitution is the very founding document of the state. This, of course, cannot be true—not only for Kosovo, but in no case on earth. In most cases, particularly in 19th- and 20th-century Europe, states were formed through a dec-

laration of independence from their parent state. These statements declaring an entity a sovereign and independent state have usually been associated with large-scale violence and atrocities. This happened in Greece, Romania, Serbia, Montenegro (during the 19th century) and federal units of former socialist federations (during the last decade of 20th century). Former colonies also emerged as states with a declaration of independence. This was unequivocally stated in the Advisory Opinion on Kosovo of July 22, 2010, issued by the International Court of Justice.

The ICJ Opinion is one of the most important documents in the history of modern Kosovo as a sovereign and independent state. It states that the Declaration of Independence of Kosovo represents an act undertaken without violating any general or special rules of international law. As it can be seen on pages 143–153 of this review, our authors try to impose a view that is utterly wrong and unsustainable under scientific and professional terms, in an apparent hope of selling the Constitution of Kosovo as an original work codrafted by the first author of the book. In line with this premise, our authors present the drafters of the Constitutions as bearers of the original constituent power on par with the real sovereign, that is, on par with the people of Kosovo as a sovereign entity. This theory has no support on any other source on earth and does not stand the scrutiny of science or morality.

4. In the last chapter of the first part of the book, our authors talk about constitutionality and legality. Their take on constitutional review strikes out among numerous basic errors. Most unfortunately, our authors refer to models of control that do not exist at all. They do not exist as such because they are not models but forms in which constitutional review manifests itself in practice. Our authors list abstract and concrete controls of constitutionality and preventive and repressive controls of constitutionality. These are not models, but forms of manifestation.

Discussing the Constitutional Court of Kosovo, in Chapter VII of the third part of the book, our authors make yet another grave error. They invent a new power of the Constitutional Court of Kosovo: the authors believe that Article 113.3 (4) of the Constitution allows the constitutional review of international agreements by the Court. Article 113.3 (4), however, does not provide for such jurisdiction at all; it deals with the preventive control of conventionality of the proposed constitutional amendments. The institute known as the **control of conventionality** represents a particular mechanism for the control of constitutionality consisting in an

evaluation by the constitutional court as to whether a norm or an internal juridical act (ordinary legal norm or a draft constitutional amendment, a general norm or an individual legal act) runs against the provisions of an international agreement or any other contractual obligation duly undertaken on the international plane by state authorities.

Some European states grant their constitutional courts the power of conventionality control. Kosovo is among them: this power in our case means that every constitutional amendment has to be reviewed as to whether it conforms to obligations assumed by Kosovo under international agreements. Therefore, based on Article 113 (4), constitutional amendments shall be reviewed only as to their conventionality. Other legal acts of general or individual nature are not part of the control. My exact views on these matters are found on pages 253–270 and 280–291 of this review.

5. Among bizarre things repeatedly encountered in the book is the manner and content of the discussion on the President of Kosovo and its constitutional role and position. In this regard, we encounter very basic mistakes and omissions that the reader will have no difficulty understanding. In some parts, our authors say that the head of state in Kosovo has dual competences of an executive nature, rendering Kosovo's government system as semi-presidential; in other parts, they claim that Kosovo is a typical parliamentary system of liberal democracy; yet in others, they place Kosovo under the so-called hybrid system of government.

In no part of the book would students or other readers find out which power Kosovo's head of state belongs to. And this is what they need the most. The answer to this question explains everything as to Kosovo's political system. It is obvious from the book that the authors themselves have difficulties in figuring out the system of governance and the constitutional powers the head of state in Kosovo is entitled to exercise. They cannot provide an answer because they have manipulated the literature, instead of analyzing it properly.

The most shocking statement in this regard is found on page 381 of their book: they say that even a king can be the President of the Republic (sic!). This and other comments on the head of state in Kosovo reveal a profound lack of knowledge on the part of our authors about the role and constitutional position of the head of state in a parliamentary system of governance.

I have expressed my views on these and other related matters on pages 211–239 of this critical review. I have also provided a brief overview of the

role and constitutional position of the head of state in a parliamentary republic such as Kosovo. The overview begins with the historical idea and development of the parliamentary system and its head of state. The entire concept and its implementation emerged with the French Revolution and two of its revolutionaries and ideologues, **Abbé Sieyès** and **Benjamin Constant**.

The two thinkers—having seen that the general will of the people cannot be controlled, and having witnessed the violence and human tragedy it produced during the reign of terror led by **Maximilien Robespierre** (1789–1794)—contemplated a different type of democracy. It was called representative democracy. Only under the conditions of a representative democracy, can one discuss about the division and separation of powers; this may never be achieved through the general will of the people or direct democracy as proposed by **Jean-Jacques Rousseau**.

Baron Montesquieu had long held that powers should be divided. **Sieyès** and **Constant** added a third aspect: in addition to being divided and separated, powers should be balanced via a fourth body, which would serve as a neutral and impartial arbiter of the three powers in their mutual relationships. This fourth body would be vested with neutral and intermediary powers to counterbalance each of three classical powers (legislative, executive, and judiciary) in order for them to function properly and smoothly. The American model, where the head of state is part of the executive power, was not feasible in the French context of the early 19th century. For this reason, the solution was found in a fourth organ without executive powers. The monarch in the past had been an active institution, that is, the bearer of the executive. What was needed was a new body without active executive power: such an organ should have passive powers and would only balance the three existing powers. This fourth organ with passive power was proposed to be the French King devoid of active powers following the restoration of the **Bourbon** dynasty.

As noted, in the past, the King had held strong executive powers. After the French Revolution of 1789, the origins of power changed: no more would power stem from divine authority. It was to be derived from the sovereign people alone who would exercise it through their representatives and in a direct manner when necessary. After the restoration of the **Bourbon dynasty** in 1814, the fear was that the King again would have absolutist inclinations. To prevent this, **Sieyès** and **Constant** invented the concept of the passive, neutral, and intermediary powers of the King. This

was put into legal terms in a new **Bourbon Constitution**, which marks the beginning of constitutional monarchies in continental Europe.

While **Sieyès** is credited with having conceived the King's neutral and intermediary role, **Benjamin Constant** elaborated it to detail in his 1814 treatise. Constant listed as royal prerogatives the right to dismiss the executive, the right to disband the parliament, and the right to pardon. The executive would be dismissed when it did not perform its functions, while parliament would be disbanded when it lost popular legitimacy by failing to form the majority needed to pass laws. Last but not least, the judiciary would be corrected by the right to pardon. As judges could always make mistakes, the King would have the discretion to pardon those convicted of grave crimes facing the death penalty. If this were left to the judiciary, they would invent another judicial instance and reason it further. This would make things worse, and the mistakes would never be corrected. For this reason, only the King as the head of state would be able to correct the mistakes of the judiciary.

This approach was seen as necessary for a constitutional monarchy and gradually became a standard of governance in Europe. It culminated in the second half of the 20th century. The original list of the neutral and intermediate powers of the King has been complemented in the meantime with additional competences. These added powers made the head of state part of a decisionmaking chain alongside legislative and executive bodies. It was done to secure the division and separation of powers and applied equally to the republican head of state. This means that head of state in a parliamentary republic cannot have any active powers of an executive nature. This is said in constitutions of liberal, parliamentary democracies in Europe and beyond. In such constitutions, the president of the republic is defined as the head of state, representing the state both within and outside its borders as well serving as a unifying factor that guaranties the stability of institutions and their normal functioning.

This is so without exception in all constitutions belonging to parliamentary republican democracies. They all reflect the unifying role of the head of state, as maintained through the exercise of neutral and intermediary powers. These competences are reflected in the chain-like decisionmaking, whereby the head of state serves as a certifier of the proper functioning of other classical powers (legislative, executive, and judiciary). They are not executive (active) at all.

Kosovo belongs to this group of democracies: none of the thirty enu-

merated constitutional competences of the President of the Republic has an active (executive) nature. They are neutral and intermediary competences, which are executed through a chain-like decisionmaking process in which the President of the Republic only countersigns the will of other powers, thus guaranteeing the stability and normal functioning of the constitutional organs. This is the essence of the unity that the President of the Republic represents—that is, the essence of the constitutional, legal unity of the country, not the sociological or political one. Political parties and other interest groups and factors of society represent these two latter concepts.

In countries belonging to semi-presidential and presidential systems of government, the president is defined as the head of state and the head of the executive, guarantor of the constitution and the constitutional order, national sovereignty and territorial integrity, and so on and so forth. This is not the case with Kosovo or with any other state belonging to parliamentary democracy. In this kind of democracies, the parliament is the body that legitimizes all other powers, directly or indirectly. In countries with a presidential system, the parliament is not the organ legitimating other organs of power, especially the executive, which has an entirely independent and separate life from the legislature. In these systems, the president represents the executive and is not dependent on parliament to survive. In semi-presidential systems, too, the life of the executive depends on the confidence of parliament, but not only on that confidence alone: it needs the confidence of the president of the republic as well.

In parliamentary systems, the executive and its life necessarily depend on the constant legitimating confidence of the parliament. These are basic concepts that students and readers should know and understand properly, not in the manner presented by our authors in their book. The discussion of these issues by our authors is entirely unacceptable, and cannot be found in any other publication on constitutional law on either side of the Atlantic. I have clarified this topic on pages 211–239 of this critical review. In turn, readers may find proper explanations on all systems of governance and the role and constitutional position of the head of state. In particular, I have devoted more attention to the head of state in a parliamentary constitutional republic.

The manner in which the book under review is written teaches us one thing: how a university textbook should not be written. This being the case, offering it to law students at Kosovo universities is illegal and unethi-

cal as it severely affects their professional upbringing. In fact, it was this latter factor that compelled me to review the book of our authors. Had it been an ordinary book for the general public, things would have been much different, and I do not think it would have bothered me as much.

In line with the above, I strongly believe that the review will serve as a guide to students and readers alike to find their path in a jungle of errors and omissions committed by our authors. In other words, the review might well serve as a guide for students and readers to avoid the professional, scholarly, and didactic errors and omissions and to shun the trap of the quasi-knowledge presented by our authors. It would do much damage to their careers, if our students were to rely on our authors' textbook alone.

Hyrje

Në maj të këtij viti doli nga shtypi libri ***E drejta kushtetuese*** i autorëve **Arsim Bajrami** dhe **Florent Muçaj**. Botues i librit prej 642 faqesh është Fakulteti Juridik. Kjo do të thotë se libri është një tekst universitar që u dedikohet në rend të parë studentëve të drejtësisë.

Libri përbëhet nga tri pjesë: pjesa e parë i ka shtatë kapituj, pjesa e dytë e librit po ashtu ka shtatë, kurse pjesa e fundit, e treta, ka 13.

Rreshtat në vijim paraqesin studim kritik të këtij libri të autorëve si më sipër. Gjatë trajtimit tonë, sikundër konstatuam, librit dhe autorëve të tij u referohemi si "autorët tanë" apo "autorët tanë dhe libri i tyre", për t'i dalluar ata nga autorët dhe librat e tjerë.

Si çdo libër universitar, edhe ky libër mëton të jetë një referencë e pashmangshme e të gjithë atyre që duan të merren me çështje të së drejtës kushtetuese. Këtë, në fakt, e thonë vetë autorët tanë në parathënie të librit. Me një audiencë kaq të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, libri domosdo zgjon kërshërinë e lexuesit të zakonshëm dhe të studiuesve të drejtësisë. Kjo rrethanë legjitimon çdo koment, kritikë apo sugjerim që dikush mund ta ketë rreth librit dhe cilësisë së tij përmbajtjesore. Kështu thonë edhe vetë autorët tanë në parathënie të librit. Ata jo vetëm që mirëpresin sugjerime dhe kritika, por premtojnë se do t'i inkorporojnë ato në ribotimin eventual të librit. I inkurajuar nga ky premtim i autorëve tanë, që më shërbeu si një lajt-motiv i fuqishëm, diku në fillim të qershorit nisa leximin, studimin dhe analizimin me kujdes të çdo hollësi të librit me shpresë që sado pak të ndihmoj në përmirësimin e tij për botimet e ardhshme. Nisur nga fakti se edhe autorët më eminentë të fushës lëshojnë gabime dhe lënë prapa të meta, që zakonisht të tjerët më vonë i vërejnë dhe i përmirësojnë, besova se do të bëja një kontribut modest në shkencën e drejtësisë që prodhohet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kur lexova librin, megjithatë, ngela i trandur dhe i strukur në të njëjtën kohë: i tronditur sepse qartë e pashë që ky libër nuk mund të ribotohet asnjëherë, se nuk ka çfarë të ribotohet, kurse u struka në vend sepse e marr me mend si studentët që do ta lexojnë për të dhënë provimin nga lënda "E drejta kushtetuese" do të shohin në secilin prej nesh, si arsimtarë të Fakultetit Juridik, njeriun e padijshëm dhe manipuluesin e shkencës që

fshihet pas titullit fiktiv shkencor dhe akademik.

Për ta bërë të qartë dhe lehtë të përcjellshëm për lexuesin tonë, këtë kritikë shkencore e kemi sistematizuar duke ndjekur strukturën e librit të autorëve tanë. Çdo gjë që themi, e themi jo pse besojmë në strukturën e krijuar nga autorët e librit që është objekt studimi kritik, por sepse duam që lehtësisht të provojmë pasaktësitë dhe gabimet themelore profesionale të autorëve, të cilat janë të pafalshme. Kjo metodologji ndihmon studentin dhe lexuesin e librit që të kuptojë përmasat tragjike të gabimeve të tij profesionale, si në planin metodologjik ashtu dhe në planin e trajtimit profesional të koncepteve dhe instituteve themelore të së drejtës kushtetuese, të kaluarës së saj, gjendjes aktuale dhe të trendeve të saj zhvillimore.

Metoda që kemi ndjekur është kryesisht analitike dhe krahasimore: kemi analizuar dhe komentuar kryesisht ato pjesë të librit që në shikim të parë kanë të meta dhe gabime trashanike, të cilat lexuesi (juristi dhe laiku) mund t'i vërejë menjëherë. Kjo do të thotë se nuk jemi ndalur në secilën të metë dhe gabim të librit, por vetëm në ato që *prima facie* kapin syrin e lexuesit të vëmendshëm. Në fillim të analizës dhe komentimit tonë kritik për secilin kapitull japim, në një deri në tri faqe, mendimet tona paraprake dhe përshtypjet e vlerësimet e para, ashtu që lexuesi ta ketë më të lehtë për t'u fokusuar në pjesët relevante të tekstit të autorëve tanë.

Sikundër vërehet, librit dhe autorëve u referohemi gjatë tërë tekstit si "autorët tanë", për qëllimet e lehtësimit të leximit. Literatura e përdorur nga autorët tanë, që citohet në këtë libër dhe që në pjesën dërmuese është përdorur nga ta në mënyrë abuzive dhe manipulative, gjendet e qasshme në internet. Kjo do të thotë se studenti dhe lexuesi fare lehtë mund ta konstatojë çdo thënie të autorëve tanë dhe të autorit të këtyre rreshtave. Ajo pjesë që nuk gjenden në qasje të hapur në internet, gjendet tek autori i këtyre rreshtave: zotohem pa asnjë hezitim se do t'ia ofroj për lexim faqet relevante të burimeve që nuk janë të qasshme gjithë atyre që shprehin interesim.

Vëllimi i kritikës sonë shkencore është diktuar nga natyra, pesha dhe serioziteti i gabimeve të autorëve tanë. E, megjithatë, këtu nuk janë evidentuar të gjitha gabimet dhe të metat e librit të tyre por vetëm ato që në shikim të parë mund të vërehen nga secili që e lexon librin.

Literatura e dhënë në fund është po ajo që shfaqet gjatë leximit brenda tekstit dhe është e dyllojtë: lloji i parë, i cili përbën pjesën dërrmuese të literaturës, i takon literaturës së përdorur nga autorët tanë në mënyrë manipulative dhe abuzuese; lloji i dytë, ndërkaq, është literatura e jonë që

është përdorur për të dëshmuar përmbajtjet e gabuara të librit të autorëve tanë dhe pasaktësitë e tjera shkencore dhe profesionale. Literatura e llojit të dytë, si e tillë, paraqet përzgjedhjen e kujdesshme nga ana jonë të mostrës së literaturës që përfaqëson mesataren e mendimit profesional dhe shkencor mbi të drejtën kushtetuese nëpër Evropë dhe më gjerë.

Në fund, atyre që kanë kohë e durim për ta lexuar këtë studim kritik, u urojmë lexim të këndshëm.

Pjesa e parë

TEORIA E SË DREJTËS KUSHTETUESE

Nëse krahasohen shtatë kapitujt e kësaj pjese me vetë titullin e saj, qartë shihet se ka lëshim dhe shpërputhje kolosale: titulli bombastik, sikundër shumica e titujve në vijim, flet për teorinë e së drejtës kushtetuese, në ndërkohë që as 10 për qind e tekstit në këtë pjesë nuk ka të bëjë me teori por me shtjellime kaotike, si të së drejtës pozitive kushtetuese ashtu dhe të së drejtës kushtetuese si degë e shkencës juridike (teoria).

Ajo pak përqindje e së drejtës kushtetuese, të cilën autorët tanë mëtojnë se e kanë trajtuar nga aspekti teorik, i takon mendimeve konfuze të autorëve që nuk lidhen njëri me tjetrin. Si të tilla, mendimet nuk përbëjnë një tërësi nga e cila studenti dhe lexuesi mund të mësojnë diçka. Të shohim në vijim si duket kjo gjendje, duke analizuar në mënyrë kritike kapitujt dhe seksionet e librit.

KAPITULLI I.
KUPTIMI I SË DREJTËS KUSHTETUESE (FQ. 27–41)

Përgjithësisht

Ky kapitull ka gjithsej nëntë seksione. Cilësia themelore e këtij kapitulli është manipulimi në shkallë të gjerë i literaturës së përdorur, kurse për përmbajtjen e tekstit dhe natyrën e tij flasim në vijim në pjesën mbi analizën kritike.

Në fusnotën nr. 3, autorët tanë citojnë autorin **Thomas E. Baker** dhe shkrimin e tij **Constitutional Theory in a Nutshell** (*William & Mary Bill of Rights Journal*, vol. 13, no.1, 2004, fq. 57-123). Në fakt, autorët tanë manipulojnë me fq. 58-59, dy faqet e para të shkrimit, duke thënë se ky autor vërteton pohimin e tyre krejtësisht tautologjik dhe të bazuar në arsyen e shëndoshë sipas të cilit gjykim "përmes së drejtës kushtetuese si shkencë, objekti i së drejtës kushtetuese studiohet në një prizëm më të gjerë". Auto-

rët tanë provojnë të projektojnë në dobi të tyre një shkrim që fare nuk ka të bëjë me të drejtën kushtetuese kontinentale, ku kjo fushë kuptohet në mënyrë standarde dhe primare si degë e sistemit pozitiv juridik dhe si degë e shkencës (teorisë) juridike. Në SHBA dhe në sistemin e të drejtës së përgjithshme (*common law*), nuk bëhet ky dallim dhe me teori në këtë sistem nënkuptohet jo e drejta kushtetuese si degë e së drejtës (teori juridike) por si një tërësi unike e së drejtës pa dallim mes të drejtës pozitive dhe asaj teorike (si tërësi e dijes mbi të drejtën kushtetuese si degë pozitive). Në këtë sistem, thënë ndryshe, ekzistojnë teori të shumta kushtetuese, të cilat i sqaron në mënyrë të shkëlqyeshme autori **Thomas E. Baker** dhe që kanë fuqinë e të drejtës pozitive. Kjo bën që në SHBA të jetë tërësisht i pakuptimtë dallimi që autorët tanë mendojnë se ekziston mes të drejtës kushtetuese si degë pozitive dhe si degë e shkencës (apo teorisë) juridike. Fjalia e autorëve tonë, si një konstatim gjoja i mbështetur në këtë autor amerikan, nuk ka asnjë lidhje me realitetin. Shkrimi, këtë e theksojmë për lexuesin tanë, bën fjalë për interpretimin, llojet dhe teknikat e tij në sistemin gjyqësor amerikan dhe ndryshimet e shpeshta në përmbajtjen e materies të së drejtës kushtetuese amerikane.

Nuk është më i vogël manipulimi në fusnotën nr. 4, ku autorët tanë citojnë autorin e njohur serb **Jovan Gjorgjeviq** (Jovan Đorđević) dhe librin e tij të mirënjohur ***E drejta kushtetuese*** (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1967). Ata thonë se gjoja ky autor serb ka thënë në fq. 5 të librit si më sipër se dykuptimësia e së drejtës kushtetuese si degë pozitive e së drejtës dhe si degë e shkencës juridike (teori) ekziston si pasojë e lidhshmërisë mes të këtyre dy kuptimeve. Autori serb, ndërkaq, fare nuk flet për objektin e së drejtës kushtetuese si degë e së drejtës pozitive dhe dallimin e saj me të drejtën kushtetuese si degë e shkencës (teorisë) juridike, por për emërtimet themelore të këtyre dy kuptimeve dhe kufizimet gjuhësore për të specifikuar se për cilin kuptim është fjala. Në këtë pjesë, autori serb trajton dy këto kuptime: nga aspekti objektiv (si dukuri dhe procese shoqërore) dhe ai subjektiv (si ndërdije dhe tërësi njohurish), kurse arsyen kryesore për keqkuptim e gjen në varfërinë e gjuhës serbe e cila për dy kuptimet përdor të njëjtin term, përkatësisht kuptimin e drejta kushtetuese. Kjo vlen edhe për gjuhën shqipe. Sa i përket objektit të së drejtës kushtetuese në dy kuptimet si më sipër, autori serb diskuton në vend tjetër, në fq. 6-10.

Në vijim të asaj që thamë lidhur me fusnotën nr. 3 si më sipër janë edhe diskutimet tona që shoqërojnë fusnotën nr. 5. Në këtë fusnotë au-

torët tanë manipulojnë autorin e mirënjohur **David A. Strauss** dhe shkrimin e tij polemizues me profesorin tjetër të mirënjohur, **Richard H. Fallon**, përkatësisht me shkrimin e tij **How to Choose a Constitutional Theory** (*California Law Review*, vol. 87, issue 3, 1999, fq. 537-580). Shkrimi polemizues i **David A. Strauss** titullohet **What is Constitutional Theory** (*California Law Review*, vol. 87, issue 3, 1999, fq. 581-592).

Richard H. Fallon argumenton se teoria kushtetuese në të njëjtën kohë është përshkruese sa i përket gjendjes ekzistuese të normave kushtetuese (***de lege lata***), kurse përcaktuese për normat kushtetuese për të ardhmen (***de lege ferenda***). Këtu fjala është për sistemin kushtetues amerikan ku nuk bëhet dallimi si në sistemin kushtetues të së drejtës civile (kontinental), siç e theksuam më sipër. **David A. Strauss**, ndërkaq, kundërshton këtë argument dhe thekson se teoria kushtetuese bën organizimin e temave ku ka një pajtim mes autorëve dhe praktikës gjyqësore dhe jep përshkrimin e rezultateve që burojnë nga ky pajtim për temat ku ka mospajtim ekzistues. Sido që të jetë, asnjëri prej këtyre autorëve nuk e pohon atë që thuhet në fq. 28 të librit, ku autorët tanë thonë si vijon:

> [E] drejta kushtetuese si shkencë (teoria kushtetuese) nuk mund të kontestojë në asnjë mënyrë përmbajtjen e kushtetutës dhe atë çfarë ofron sistemi normativ kushtetues (e drejta kushtetuese si degë e së drejtës), mirëpo e drejta kushtetuese si shkencë (teoria kushtetuese) ndihmon në trajtimin e çështjeve të diskutueshme në praktikën kushtetuese, duke ju qasur normave kushtetuese dhe në kuptimin praktik të bazimit të tyre por edhe të çështjeve të tjera që përfshihen në objektin e studimit, përpos normave kushtetuese.

Ky konstatim si më sipër, jo vetëm që nuk i përshtatet rolit që ka teoria kushtetuese në sistemin kushtetues amerikan, një rol të jashtëzakonshëm dhe pjesë përbërëse e së drejtës pozitive, por as sistemit kontinental të vendeve evropiane, siç janë Gjermania, Çekia, Sllovenia dhe vendet e tjera, ku roli i teorisë kushtetuese ka qenë dhe ngelet vendimtar në trasimin e rrugës për shumë vendime që sot përbëjnë standard kushtetues nëpër këto vende. Të tilla janë, ta zëmë, kontributet e teorisë kushtetuese në statusin kushtetues të martesave mes gjinive të njëjta, statusi i bashkëjetesës mes çifteve të gjinisë së njëjtë, i fëmijëve të lindur jashtë martesës, të drejtat kushtetuese të komunitetit **LGBT** dhe shumë kontribute të tjera, të cilat ne sot i marrim të mirëqena por që në fakt janë rezultat i luftës së teorisë kushtetuese për jetësimin në praktikën kushtetuese të instituteve dhe kategorive që nuk kanë qenë pjesë e të drejtës kushtetuese pozitive të vendeve

demokratike evropiane. Konstatimi i autorëve tanë do të kishte pasur vlerë vetëm nëse bëhet fjalë për kohën e komunizmit, kur teoria kushtetuese ka ndjekur verbërisht praktikën dhe nuk ka kontestuar seriozisht normat ekzistuese kushtetuese.

Njëjtë si me autorin serb nga fusnota nr. 4, autorët tanë citojnë një autor tjetër; këtë herë ai është autor shqiptar. E kemi fjalën për **Kurtesh Saliun** dhe librin e tij ***E drejta kushtetuese*** (Fakulteti Juridik i UP-së: Prishtinë, 2004). Në fq. 18-19 të këtij libri nuk thuhet ajo që autorët tanë thonë në fq. 30. Në këto dy faqe, autori **Kurtesh Saliu** flet për të drejtën kushtetuese si shkencë dhe për emërtimin e së drejtës kushtetuese. D.m.th., njëjtë si autori serb, këtu nuk bëhet fjalë për diskutim të objektit të së drejtës kushtetuese, siç besojnë gabimisht autorët tanë.

Tërësisht i manipuluar është edhe burimi që citohet në fusnotën nr. 14. Autorët tanë përmendin një sërë instrumentesh ndërkombëtare dhe japin konkluzion krejtësisht të bazuar në arsyen e shëndoshë. Autori **Horst Dippel**, ndërkaq, në fq. 3-4 të shkrimit **Modern Constitutionalism: An Introduction to a History in the Need of Writing** (2002), që citohen nga autorët tanë, flet për **Deklaratën e Shtetit Virxhinia** (1776) dhe dispozitat e saj revolucionare që nisin konstitucionalizmin modern. Esenca e tyre është kjo: të drejtat dhe liritë e njeriut kanë rrënjë në të drejtën natyrore dhe shërbejnë si bazë dhe themel i qeverisjes. Tutje, ky autor flet edhe për ndikimin e madh që kjo deklaratë ka pasur në shtetet e tjera amerikane dhe në Revolucionin Francez dhe në të gjitha tekstet juridike të nxjerra pas saj në Evropë. Nuk thuhet asgjë nga ato që thonë autorët tanë (sic!).

Para se të kalojmë në analizën kritike të tekstit të prodhuar, e ofrojmë edhe një manipulim të fundit të autorëve tanë: në fusnotën nr. 16 citojnë një autor britanik, në vendin e të cilit nuk ka kushtetutë të shkruar dhe nuk ka asnjë logjikë që ky autor të flasë diku për atë që thonë autorët tanë. E autorët tanë thonë si vijon:

> Autorët e trajtojnë objektin e së drejtës kushtetuese në mënyra të ndryshme, mirëpo në shumicën e literaturës objekti i trajtimit të së drejtës kushtetuese lidhet me analizimin e akteve kushtetuese të zbatueshme, ose asaj që mund të konsiderohet e drejtë kushtetuese pozitive në një vend.

Të nisim tani analizën konkrete të tekstit të prodhuar dhe mënyrës së prodhimit të tij nga ana e autorëve tanë.

Analiza kritike

Në hyrje të këtij kapitulli (fq. 27), autorët tanë flasin për dykuptimësinë e së drejtës kushtetuese si degë e së drejtës pozitive dhe si teori (shkencë). Këtë dykuptimësi, autorët e bazojnë në dallimet në objektin dhe mënyrën e studimit. Lexuesi normal, që në fillim, këtë konfiguracion të mendimit të autorëve do ta marrë sikur diçka që thotë se e drejta kushtetuese si degë e sistemit pozitiv dhe si degë e shkencës juridike ka dykuptimësi, përkatësisht se ka kuptime që ngatërrohen ndërmjet vete. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: e drejta kushtetuese si degë e së drejtës pozitive nuk ka asnjë dykuptimësi dhe saktësisht dihet se çfarë ka kjo degë e së drejtës për objekt të studimit dhe cilat metoda i përdor, siç nuk ka asnjë dykuptimësi dhe saktësisht dihet se çfarë ka për objekt studimi dhe cilat metoda përdor e drejta kushtetuese si degë e shkencës juridike. Të gjithë autorët që janë marrë me të drejtën kushtetuese, përfshirë dhe ata që autorët tanë citojnë manipulativisht në fusnotat 1, 3, 4 dhe 5, flasin për këtë dallim të së drejtës kushtetuese. Këtë e bëjnë të gjithë autorët e së drejtës kushtetuese në sistemin kontinental (evropian), pa asnjë përjashtim. Pra, këtu fjala nuk është për dykuptimësi por për dy dallimet themelore të së drejtës kushtetuese. Kështu na kanë mësuar dikur në gjeneratën time, ata që sot nuk janë gjallë dhe që për pikë referimi kanë pasur profesorin e mirënjohur serb, studentin e **Sorbonës**, të ndjerin **Radomir Llukiq** (Radomir Lukić) dhe librin e tij monumental ***Uvod u Pravo*** (shumë herë i ribotuar).

Në tekstin në vijim të këtij seksioni, autorët tanë provojnë të dallojnë të drejtën kushtetuese si degë e së drejtës pozitive nga e drejta kushtetuese si degë e shkencës. Për të dytën flasin në kuptimin pedagogjik e didaktik, kurse për të parën në mënyrë konfuze ngatërrojnë objektin me materien duke thënë se objekt i të drejtës kushtetuese si degë e së drejtës pozitive janë normat juridiko-kushtetuese që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore. Këto norma, sipas autorëve, dallojnë nga normat juridike që rregullojnë marrëdhënie të tjera shoqërore të cilat, nga ana e tyre, përfshihen në degë të tjera të së drejtës (në të drejtën administrative, në të drejtën penale, në të drejtën civile, në të drejtën ndërkombëtare etj.). Në këtë mënyrë, autorët tanë konfondojnë objektin e së drejtës kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik me materien juridiko-kushtetuese që është objekt normimi (rregullimi, përcaktimi) i normave kushtetuese. Këto, në fakt, janë e njëjta gjë: objekt i të drejtës kushtetuese janë marrëdhëniet shoqërore dhe marrëdhëniet e tjera që supozohet se kanë natyrë juridiko-kushtetuese, gjë

që nënkupton se materia e normave juridiko-kushtetuese ngërthen dispozita pafund juridiko-kushtetuese që normojnë (rregullojnë) këto marrëdhënie të supozuara kushtetuese. Pse themi të supozuara? Sepse ka raste kur një rend juridik-kushtetues mund të përmbajë norma që nuk kanë natyrë kushtetuese, mirëpo që një shoqëri i ka ngritur në nivel të tillë kushtetues me qëllim të rregullimit të marrëdhënieve në mënyrë specifike. I tillë është, ta zëmë, rasti me **Greqinë** ku me kushtetutën para kësaj që sot është në fuqi ndalohet therja e kafshëve sipas ritit judeo-islamik: normimi (rregullimi) kushtetues i kësaj materie nuk përbën një gjë të duhur. Këtë e përmendëm vetëm sa për ilustrim, sepse ka shumë raste të tjera në të drejtën kushtetuese krahasuese që dëshmojnë për një gjë të tillë.

Në paragrafin e fundit të seksionit të parë mbi të drejtën kushtetuese si shkencë dhe si degë e së drejtës (fq. 28-29), autorët tanë arrijnë në një përfundim krejt tautologjik dhe pa asnjë kuptim: kështillojnë studentin dhe lexuesin që mos të ngatërrojnë asnjëherë kuptimin e së drejtës kushtetuese me objektin e së drejtës kushtetuese sepse, siç e thonë, këto janë dy gjëra të ndara. Jashtë çdo konteksti, po aty (fq. 29), autorët tanë konstatojnë se e drejta kushtetuese si degë e së drejtës ose si shkencë nuk do të mund të ekzistonte pa objektin e së drejtës kushtetuese. Kjo është shumë e saktë, por as unë dhe as ata që do të lexojnë rreshtat e autorëve tanë nuk do të marrin vesh se cili ishte objekti i të drejtës kushtetuese. Këtë nuk do ta kuptojnë as pasi të kenë lexuar seksionin në vijim me titull "Objekti i studimit të së drejtës kushtetuese" (fq. 29-30). Pse? Kjo sepse, në vend se të sqarojnë, siç premtojnë në paragrafin e fundit të seksionit pararendës, se çka është objekt i të drejtës kushtetuese si degë pozitive dhe si degë e shkencës juridike, autorët tanë flasin ekskluzivisht atë çfarë duan dhe si duan, jo atë që duhet ta mësojë studenti dhe lexuesi. Ky seksion thjesht beson se flet për të drejtën kushtetuese si shkencë e së drejtës, në ndërkohë që më shumë bën fjalë për të drejtën kushtetuese si degë pozitive. Kjo shihet qartë në faktin se kryesisht flitet për aspekte historike të zhvillimeve të ndryshme kushtetuese, ndarjet e pushteteve dhe dallimet në rregullimin kushtetues mes shteteve të ndryshme.

Ajo çka është shokuese dhe që bie në sy është zhytja e tyre më thellë në konfuzitet vetanak: në fq. 30 konstatojnë, *inter alia*, se "ky argument forcon edhe më shumë bindjen se objekti i të drejtës kushtetuese i përket më shumë trajtimit të së drejtës kushtetuese si shkencë, ku autorët i trajtojnë çështjet e objektit të së drejtës kushtetuese duke përdorur argumente të ndryshme". Nuk besoj që ka student apo lexues që mund të marrë vesh

diçka nga ky konstatim, lëre më të kuptojë se cili në të vërtetë është objekti i të drejtës kushtetuese, si degë pozitive dhe si shkencë (sic!).

Në seksionin e tretë, autorët tanë kërcejnë pa pritur në "sqarimin" e objektit të së drejtës kushtetuese sipas pikëpamjeve klasike, pa definuar se çka nënkuptohet me klasike dhe kush janë autorët klasikë dhe cilët parametra përdoren për një dallim të tillë. Kjo gjë bëhet në tekstet universitare të **Evropës**, përfshirë këtu autorët shqiptarë: për këta të fundit, mjafton të shihet përciptazi libri ***E drejta kushtetuese*** i autorëve **Luan Omari** & **Aurela Anastasi**, apo teksti universitar me të njëjtin titull i profesorit tanimë të ndjerë **Kurtesh Saliu**. Te autorët tanë, ndërkaq, seksioni për pikëpamjet klasike përbën një përzierje tërësisht anarkike të disa tezave të paqena të autorëve të paqenë, të cilët gjoja thonë se objekt studimi i të drejtës kushtetuese çdoherë kanë qenë liritë dhe të drejtat e njeriut, gjë që nënkupton çdoherë dhe në secilën kohë të zhvillimit kushtetues evropian. Në fakt, përveç këtyre dy autorëve, asnjë autor tjetër nuk thotë se ndonjëherë para Revolucionit Francez liritë dhe të drejtat e njeriut kanë qenë objekt studimi i së drejtës kushtetuese. Në fakt, e drejta kushtetuese, si degë pozitive e së drejtës dhe si degë e shkencës juridike, as që ka ekzistuar para **Revolucionit Francez**. Kanë ekzistuar institute e institucione relevante me natyrë kushtetuese, dokumente e karta, një kushtetutë, ajo e SHBA-së, por asnjëherë e drejta kushtetuese si degë e së drejtës pozitive apo si degë e shkencës juridike. Seksionin e pikëpamjeve klasike (fq. 31), autorët tanë e mbyllin me një paragraf tjetër tautologjik që thotë se "kushtetuta përveçse sanksionon shtetin ajo rregullon edhe të drejtat e njeriut", frazë që e rrotullojnë disa herë në një paragraf duke thënë gjëra që vërtet s'kanë kuptim.

Edhe më skandaloz është seksioni në vijim (fq. 32-34), që pretendon se flet për objektin e së drejtës kushtetuese sipas pikëpamjeve të sotme. Autorët tanë nuk definojnë dhe asnjëherë nuk saktësojnë se për cilin objekt është fjala, për objektin e së drejtës kushtetuese si shkencë apo për objektin e së drejtës kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik. Kjo përbën një arsye të fortë për ngatërrim të studentit dhe lexuesit. Kjo, qartë shihet, vjen si pasojë e manipulimit të literaturës së përdorur me qëllim të argumentimit të asgjësë: në fusnotat nr. 15 dhe 16 respektivisht manipulohen një autor shqiptar dhe një anglez, për të arritur te konstatimet që nuk janë veçse deklarata notore (botërisht të ditura) mbi atë se e drejta kushtetuese ka një objekt dhe një metodë studimi që ndryshon nga vendi në vend, nga autori në autor. Si dhe ku ndryshon ky objekt dhe kjo metodë nga vendi në vend dhe nga autori në autor, këtë nuk na e thonë autorët tanë. Kjo ka

qenë dhe akoma është detyra e një teksti universitar, pra t'iu tregojë studentëve dhe lexuesve objektin dhe metodën e studimit, si dhe divergjencat mes autorëve. Këtë e bëjnë të gjithë librat universitarë për të drejtën kushtetuese, përfshirë dhe autorët shqiptarë që zura në gojë më sipër dhe të cilët autorët tanë i manipulojnë gjerësisht.

Duke folur për parimin e ndarjes së pushteteve, tërësisht jashtë kontekstit të këtij seksioni, autorët tanë i mbështesin argumentet e tyre në veprat e **Baronit Montesquieu** dhe **John Locke**-ut. Për këtë, si dëshmi të tyre, autorët tanë citojnë fq. 1-23 të librit ***Constitutionalism and the Separation of Powers*** të autorit **M.J.C. Vile** (Liberty Fund: Indianapolis, 1998). Autorët tanë, në fakt, e manipulojnë këtë autor të respektuar dhe prestigjioz amerikan: në fq. 1-24 të librit bëhet fjalë për "The Doctrine of Separation of Powers and Institutional Theory", ku gjerësisht shpalosen rrënjët historike dhe evolucioni i doktrinës mbi ndarjen dhe balancimin e pushteteve, ku qeveria e balancuar dhe e kufizuar në **Angli** paraqet pikën nisëse, deri në institucionalizimin e këtij parimi në dy anët e Atlantikut. Ne vijim të kësaj, autori **M.J.C. Vile** në kapitullin e katërt flet për **Baronin Montesquieu**, kurse kapitulli i tretë, i titulluar "Theory of Balanced Constitution", në tërësi i dedikohet **John Locke**-ut dhe ideve të tij mbi ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Shtjellimet e këtij autori amerikan bazohen ne veprat kryesore të këtyre dy dijetarëve: ***Traktati i dytë mbi qeverisjen*** i **J. Locke**-ut dhe ***Fryma e ligjeve*** e **Baronit Montesquieu**. Në fillim diskutohet **John Locke**, si apologjet i Revolucionit të Lavdishëm në Angli (1688) dhe studiues i ngjarjeve pas vitit 1640 e tutje, kurse më pas autori flet për **Montesquieu** dhe veprën ***Fryma e ligjeve***. Kjo është e kuptueshme sepse **John Locke** ka lindur përpara **Baronit Montesquieu**, ashtu që dhe veprat e tyre në pikëpamje kohore kanë një shekull ndërmjet. Këtë rrethanë autorët tanë nuk e kanë të qartë (sic!). Kjo paqartësi e tyre ka bërë që ata të flasin në mënyrë të përçartë për njërin dhe për autorin tjetër në fq. 33, gjithnjë me besimin se këta dy autorë të mëdhenj mbështesin tezat tërësisht konfuze të autorëve tanë mbi "objektin e së drejtës kushtetuese sipas pikëpamjeve të sotme".

Seksioni në vijim, që flet për rëndësinë e së drejtës kushtetuese (fq. 34-35), sërish përmban gjëra që nuk e kanë vendin aty. Edhe sikur ta kishin, studenti dhe lexuesi do ta kishin shumë të vështirë për të kuptuar diçka prej atyre rreshtave. Nëse autorët tanë kanë pasur për qëllim trajtimin e së drejtës kushtetuese si lëndë mësimore për studentët e drejtësisë, si dhe aspektet e tjera didaktike, atëherë kanë dështuar sepse asnjëri prej rreshtave

të shkruar aty nuk plotëson asnjë standard minimal didaktik. Më këtë rast, për të fshehur lëshimet serioze profesionale, autorët tanë sërish kanë manipuluar tre autorë, një shqiptar dhe dy të huaj. Profesorin **K. Saliu** dhe librin e tij të sipërcekur e manipulojnë në tërësi: seksioni i tij me të njëjtin emër, në fq. 28-29, paraqet një shtjellim të shkëlqyer të rëndësisë së kësaj dege të së drejtës dhe teorisë së saj, duke e kontekstualizuar këtë rëndësi në aspektin teorik dhe pedagogjiko-edukativ (fq. 29). **K. Saliu** jep shkaqet dhe arsyet pse kjo është kështu dhe lexuesi shqip nuk do të ketë asnjë problem për të dalluar të drejtën kushtetuese si teori dhe si degë të sistemit pozitiv juridik, si dhe arsyet pse kjo lëndë mësohet nëpër universitete dhe më gjerë. Këtë nuk arrijnë ta bëjnë autorët tanë, të cilët duke u munduar të riprodukojnë seksionin homonim të profesorit **K. Saliu**, në fakt, përziejnë të gjitha kuptimet e së drejtës kushtetuese pa thënë asgjë siç duhet. Në favor të kësaj, autorët tanë citojnë dhe manipulojnë dy autorët e huaj, për t'i ikur idesë origjinale të autorit **K. Saliu**. Në njërin rast, autorët tanë citojnë një autor lidhur me ekzistimin e së drejtës për t'u harruar, e drejtë të cilën në jetën time nuk e kisha dëgjuar apo lexuar, dhe tjetrin në kontekstin e kufizimit kushtetues të të drejtave. Në fusnotën nr. 24, manipulojnë autoret **Patricia Sanchez Abri** & **Jacqueline D. Lipton** dhe shkrimin e tyre "The Right to be Forgotten: Who Decides What the World Forgets?" (*Kentucky Law Journal*, vol. 103, issue 3, 2014-2015, fq. 363-389). Këta autorë, në këtë shkrim, flasin për mbrojtjen e së drejtës së privatësisë në dritën e një vendimi të **Gjykatës Evropiane të Drejtësisë**, të vitit 2014, që kishte gjetur se **Google** është përgjegjës për ruajtjen e privatësisë së të dhënave në planin global dhe se shtetet duhej të kujdeseshin për implementimin e kësaj qasjeje. Kjo sepse, gjithnjë sipas këtij vendimi, ruajtja e të dhënave pakufi mund të dëmtonte privatësinë, siç kishte ndodhur, për shkak të abuzimit me to nga individët dhe bizneset që kanë interes konkret. Faqet 364-365 të këtij shkrimi interesant, të cilat i citojnë autorët tanë, nuk kanë asnjë relevancë për seksionin në fjalë dhe as për kontekstin e librit të autorëve tanë marrë si tërësi, përveç për pjesën që flet për të drejtat e njeriut dhe ardhmërinë e tyre. Kështu siç kanë vepruar autorët tanë, qartë shihet, përbën një manipulim të literaturës për argumentim të asgjësë: faqet që citojnë kanë të bëjnë me hyrjen e shkrimit në fjalë të dy autorëve të huaj, në ndërkohë që mbi gjysma e shkrimit bën fjalë për historikun e lindjes së vendimit si më sipër lidhur me të drejtën e privatësisë në planin global.

Asgjë më mirë nuk qëndron gjendja me librin tjetër të cilin autorët

tanë e manipulojnë në fusnotën nr. 25. E kemi fjalën për librin me përmbledhje të punimeve me titull ***Global Perspectives on Constitutional Law*** (Oxford UP: 2009), të autorëve të njohur amerikanë **Vikram David Amar** & **Mark V. Tushnet**. Autorët tanë manipulojnë fq. 5 të këtij libri: sipas ndërtimit të argumentit në fq. 35, autorët tanë sikur duan të thonë se edhe autorët amerikanë mendojnë si ta, pra se as ata nuk thonë asgjë, njëjtë si autorët tanë. Por në fq. 4-7 të librit të autorëve **Vikram David Amar** & **Mark V. Tushnet** jepen pjesë nga një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Polonisë lidhur me hyrjen e Polonisë në Bashkimin Evropian (Aktgjykimi i datës 11 maj 2005). Kjo, sikundër vërehet, nuk ka fare të bëjë me atë që thonë autorët tanë në faqen e tyre 35: kjo, pra, përbën manipulim brutal të literaturës.

Seksioni në vijim, që flet për marrëdhëniet e së drejtës kushtetuese me degët e tjera të së drejtës (fq. 36-38), mund të quhet i pranueshëm sepse ka disa konstatime që kanë logjikë kushtetuese dhe janë të kuptueshme për studentin dhe lexuesin, gjë që nuk është rasti me seksion në vijim të tij, që flet për materien (përmbajtjen) e së drejtës kushtetuese dhe emërtimin e saj (fq. 38-39): nuk besoj që ka student dhe lexues që do të mund të kuptojë dy fjalitë e para të këtij seksioni (sic!). Menjëherë pas këtyre dy fjalive, autorët tanë vazhdojnë me avazin e vjetër të narracionit të përçartë, pa asnjë kuptim, të shoqëruar me mbështetje në literaturë të manipuluar. E nisin me **Carl Schmitt** dhe **Hans Kelsen**, për të cituar autorë të huaj pafund, si dhe autorët shqiptarë. Ndërkohë që autorët e huaj i citojnë me emër e mbiemër, autorët shqiptarë fare nuk i tregojnë. Ata që i zumë në gojë më sipër, profesorët **Luan Omari** e **Aurela Anastasi** (Shqipëri) dhe prof. **Kurtesh Saliu** (Kosovë), megjithatë, nuk kanë asnjë lidhje me këtë që autorët tanë thonë në këtë seksion. Nuk kanë asnjë lidhje as **Carl Schmitt** e **Hans Kelsen**. Autorët tanë manipulojnë me dy këta autorë, qartë pa i lexuar asnjëherë. Po t'i kishin lexuar, do ta kishin parë se **Carl Schmitt** ka qenë një apologjet i diktaturës dhe shtetit joliberal, kurse **Hans Kelsen** e kundërta e tij. **Carl Schmitt** në veprën e tij ***Constitutional Theory*** (Duke UP: USA 2008), asnjëherë nuk flet për liberalizmin siç mendojnë autorët tanë, por për të kundërtën e tij. Në këtë vepër në tërësi bëhet fjalë kundër parimit demokratik dhe ndarjes së pushteteve, federalizmit dhe vlerave kushtetuese, kurse me kushtetutë **Carl Schmitt** nënkupton aktin konkret historik të një populli për definimin e formës së ekzistencës së tij, kurse me të drejtën kushtetuese atë që ne sot e quajmë kushtetutë në kuptimin formal. Sikundër shihet, **Carl Schmitt** i takon një bote tjetër prej

asaj që pretendojnë autorët tanë, një bote joliberale ku kushtetuta është akt politik i vullnetit konkret historik, parlamentarizmi degjenerim i vullnetit politik dhe e drejta kushtetuese vetëm si formë që mund të ndryshohet sipas një akti politik pa ndjekur asnjë procedurë. Tërë libri i tij si më sipër, në fakt, paraqet goditje të drejtpërdrejtë ndaj rendit liberal të ndërtuar me Kushtetutën e Vajmarit. Rrënimit të këtij rendi liberal i kushtohet ky libër i **Carl Schmitt**-it, jo diskutimit për anët e mira dhe pozitive të liberalizmit.

Për **Hans Kelsen**, autorët tanë flasin në kontekstin e debatit të tij me **Carl Schmitt**-in, pa treguar se në çka konsiston ai debat dhe nëse e ka vendin diskutimi i tij në këtë seksion që flet krejtësisht për diçka tjetër (sic!). Shumë më e qëlluar do të kishte qenë sikur autorët tanë mos të kishin manipuluar me literaturën në fusnotat nr. 33-35, por t'i kishin lexuar vetë ato dhe më pastaj t'i kishin inkorporuar në pjesën që ka të bëjë me kuptimet bazike që lidhen me rolin dhe pozitën e shefit të shtetit, ndarjen e pushteteve dhe parlamentarizmin, gjithnjë në kontekstin historik të zhvillimit të kushtetutshmërisë në kohën e Gjermanisë së Vajmarit. Kësaj kohe i takon ky debat dhe relevanca e tij sot qëndron vetëm sa i përket rolit dhe pozitës së shefit të shtetit dhe gardianit të kushtetutës. Krejt normal është që këtë nuk kanë mundur ta bëjnë autorët tanë sepse, fare qartë shihet, nuk i kanë lexuar dhe, për pasojë, nuk e kanë të qartë përmbajtjen e librave që ua citojnë të autorëve **Carl Schmitt** e **Hans Kelsen.**

Në seksionin e parafundit që flet për degët që kanë lindur nga e drejta kushtetuese (faqe 39-40), autorët tanë sërish bëjnë çudira: flasin për të drejtën kushtetuese në kohën e **Aristotelit**. Sipas tyre, "çështjet kushtetuese u trajtuan edhe gjatë shekullit XVII, nga Monteskjeu, Machiavelli, John Stuart Mill etj." Kësaj radhe, për të dëshmuar këtë si argument kryesor citojnë konstitucionalistët **Tom Ginsburg** & **Rosalind Dixon** dhe librin e tyre të njohur ***Comparative Constitutional Law*** (Univ. of Chicago Law School: Chicago, 2001), një libër me përmbledhje punimesh. Pak mund të besohet që këta dy autorë eminentë të së drejtës kushtetuese dhe filozofisë të së drejtës të kenë thënë se **Baroni Montesquieu** ka lindur dhe ka botuar para **Niccolò Machiavellit**, apo se **Baroni Montesquieu** e **John Stuart Mill** (Xhon Stjuart Mill) kanë punuar dhe jetuar në shekullin XVII (sic!). Autorët tanë për këtë citojnë fq. 1-2 të librit si më sipër. Në këto dy faqe hyrëse të librit, ndërkaq, autorët **Tom Ginsburg** & **Rosalind Dixon** flasin për historinë e zhvillimit të së drejtës kushtetuese krahasimore që nga lashtësia e deri te **Machiavelli**, **Montesquieu** dhe **John Stuart Mill** dhe për

studimin e aspekteve kushtetuese me metoda krahasimore. Në këtë hyrje autorët flasin për traditën intelektuale perëndimore në studimin krahasimor të materies kushtetuese përgjatë historisë, diçka që autorët tanë nuk e kanë marrë parasysh.

Në secilën përpjekje intelektuale ekziston një metodë, një metodologji, apo disa syresh të kombinuara që kanë për qëllim ndjekjen e një qëllimi dhe arritjen e një rezultati. Këtë rrethanë notore autorët tanë e kanë prekur në seksionin e fundit që flet për metodat e së drejtës kushtetuese (fq. 40-41). Ky seksion nuk është veçse një plagjiat brutal i materies së njëjtë të autorit të ndjerë **Kurtesh Saliu**, përkatësisht i faqeve 32-33 të librit të tij të sipër cekur, pa e cituar fare. Në fakt, autorët tanë e kanë cituar në fusnotën 41, vetëm një herë, dhe atë krejtësisht me qëllim të manipulimit. Studenti dhe lexuesi fare lehtë mund të vërejë se autorët tanë citojnë vetëm fq. 32 të autorit **K. Saliu** (krahas autorit tjetër kosovar, **Osman Ismajli**), në ndërkohë që plagjiati i autorëve tanë buron nga fq. 32-33 të librit të autorit **K. Saliu**.

Nga sa thamë më sipër, vërehet se titulli bombastik i këtij kapitulli fare nuk reflekton përmbajtjen e tij. Zakonisht, në librat e autorëve të huaj dhe vendorë, ky kapitull i rezervohet kuptimeve themelore, ideve, subjekteve dhe metodave të studimit të lëndës (materies) kushtetuese. Këtë e gjejmë kështu të thënë edhe në librat e autorëve të sipër cekur nga Shqipëria (**Luan Omari** & **Aurela Anastasi**) dhe Kosova (**Kurtesh Saliu**). Këtu, thënë ndryshe, studenti dhe lexuesi presin që autorët tanë të flasin për të drejtën kushtetuese si degë pozitive dhe si teori, subjektet dhe objektin e saj, si dhe për metodat e studimit. Të shohim si duket kjo në vijim çdokund nëpër sistemin kontinental, të cilit i takon Kosova.

Shprehja **E drejta kushtetuese** nënkupton shumë gjëra, si për laikun dhe ashtu edhe për jolaikun. Në lëmin juridik, ndërkaq, me këtë shprehje asociohen dy kuptime themelore: si degë juridiko-pozitive e një sistemi juridik-kushtetues dhe si dije mbi lindjen, zhvillimin dhe kahet e zhvillimit, si dhe mbi vetë përmbajtjen e kësaj dege të së drejtës. Cilësori "juridik" në këto fjali ka për qëllim themelor të bëjë dallimin mes sistemeve normative që nuk janë manifestim dhe rezultat i një vullneti politik, siç është religjioni, morali apo sistemet e tjera normative, dhe sistemeve normative që kanë një cilësi të tillë, pra që shprehin vullnetin politik të një shoqërie konkrete të organizuar në shtet. Përveç kësaj, **E drejta kushtetuese**, si e drejtë pozitive dhe si teori, duhet të dallohet nga shprehja "Kushtetuta": kjo e fundit tregon vendin, llojin, natyrën dhe fuqinë juridike të

normave kushtetuese dhe rregullave të organizimit politik në një shoqëri.

Dy shprehjet si më sipër, ndërkaq, kanë kuptimin e tyre material dhe formal. Ky kuptim, megjithatë, dallon kur bëhet fjalë për shprehjen "E drejta kushtetuese" dhe krahasimin e saj me shprehjen **Kushtetutë**: në rastin e parë, **E drejta kushtetuese** në kuptimin material na tregon se kush i solli në jetë normat kushtetuese, pa marrë parasysh se ku gjenden ato në aspektin formal, cili vullnet apo manifestim i vullnetit i ka sjellë në jetë normat konkrete kushtetuese, kurse në rastin e dytë fjala është për përcaktimin e saktë të objektit të së drejtës kushtetuese si degë pozitive. Sa i përket kuptimit formal, dallimi konsiston në atë se në rastin e së drejtës kushtetuese si degë pozitive bëhet fjalë për një pjesë të sistemit juridik që ka një tërësi normash të dallueshme nga të tjerat dhe që kanë një cilësi dalluese nga normat e tjera dhe, për pasojë, një vend të caktuar në hierarkinë e normave të sistemit juridik, kurse fjala **Kushtetutë** çdoherë nënkupton tërësinë e rregullave të caktuara juridike që gjenden në një akt apo traditë (praktikë) të llojit caktuar.

Edhe termi **Kushtetutë** definohet në kuptimin material dhe atë formal. Në kuptimin material, kushtetuta definohet sipas përmbajtjes së normave. Fjala është për tërësinë e rregullave, të shkruara apo të pashkruara, që kanë të bëjnë me bartjen dhe ushtrimin e pushtetit politik si dhe me liritë dhe të drejtat e njeriut. Në kuptimin formal, ndërkaq, me kushtetutë nënkuptohet tërësia e rregullave juridike prodhimi dhe ndryshimi i të cilave i nënshtrohen një procedure speciale dhe të cilat qëndrojnë mbi rregullat e tjera juridike dhe kjo përbën karakteristikën e tyre themelore. Kështu na thotë autori **Dominique Chagnollaud** në librin e tij ***Droit constitutionnel contemporain 1 : Théorie générale – Les régimes étrangers***, 7e éd. (Dalloz: Paris, 2013, fq. 32-36). Njëjtë thonë të gjithë autorët evropianë pa asnjë përjashtim.

Çka nënkuptohet atëherë, me të drejtën kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik dhe si teori, të cilin kuptim autorët tanë e lënë të paqartë për studentin dhe lexuesin, përveç që lënë të paqartë kuptimet si më sipër të së drejtës kushtetuese dhe të kushtetutës?

Më të drejtën kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik në kuptimin material nënkuptohet tërësia e normave që për objekt rregullimi kanë marrëdhëniet juridiko-kushtetuese. Këto marrëdhënie juridiko-kushtetuese që normohen nga e drejta kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik në kuptimin material kenë natyrë horizontale atëherë kur kanë të bëjnë me rregullimin e organizimin të pushtetit, kurse vertikale atëherë kur i re-

ferohen mbrojtjes dhe promovimit të lirive dhe të drejtave njerëzore. Një kohë të gjatë, kjo degë e së drejtës pozitive është cilësuar si **E drejtë shtetërore**. Kjo sepse që nga fundi i shekullit XVI (Revolucioni i Lavdishëm në Angli, më 1688) e deri në fund të shekullit XVIII (revolucionet amerikane dhe franceze), kohë kur në mënyrë graduale u krijua shteti modern, asnjëherë nuk është diskutuar mundësia që objekt i rregullimit kushtetues të jenë liritë dhe të drejtat njerëzore. Vetëm nga shekulli XVIII nis evoluimi i konsiderueshëm i të drejtës kushtetuese, në atë mënyrë që objekt rregullimi fillojnë të bëhen edhe liritë dhe të drejtat njerëzore, pra jo vetëm organizimi i shtetit dhe ndarja e kompetencave mes organeve shtetërore (sistemi politik). Kjo fazë, e cila nis me revolucionet në Amerikë dhe në Francë respektivisht, njihet ndryshe edhe si faza e shtetit kushtetues, për dallim nga faza pararendëse e shtetit absolut.

Në kuptimin formal, ndërkaq, e drejta kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik përcakton cilësinë formale të tërësisë së normave juridikokushtetues dhe vendin e tyre në hierarkinë e përgjithshme të rendit juridik. Në këtë kuptim, e drejta kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik manifeston tri cilësi: e para, vlera juridike e normave të saj është më e lartë se vlera juridike e çdo normë tjetër juridike, kurse vetë normat e saj nuk kanë një normë tjetër më të lartë se ajo; e dyta, normat juridike të kësaj dege të së drejtës përcaktojnë objektin dhe subjektin, formën dhe përmbajtjen e normave të tjera që duhet të prodhohen; dhe, e treta, normat e kësaj dege të së drejtës janë themeli përfundimtar i normave të prodhuara sipas përcaktimeve të vetë normave të saj, pozicion i njohur ndryshe edhe si prezumimi i kushtetutshmërisë së normave juridike pozitive.

Si degë e shkencës juridike (teori), ndërkaq, **E drejta kushtetuese** nënkupton një disiplinë shkencore që studion tërësinë e rregullave dhe praktikave që cilësohen si kushtetuese. Natyra dhe metodat (qasjet) e teorisë kushtetuese, ***grosso modo***, mund të përmblidhen në dy grupime: në teoritë mbi të drejtën natyrore kushtetuese dhe në teoritë mbi të drejtën pozitive kushtetuese. Të parat konsistojnë në atë se studimi i të drejtës kushtetuese duhet të niset nga e drejta natyrore. Me të drejtë natyrore nënkuptohet krijuesi apo vetë natyra njerëzore, arsyeja humane dhe kështu me radhë. Kjo qasje teorike në veçanti ka dhënë kontribut në lëmin e lirive dhe të drejtave njerëzore sepse marrin parasysh konsideratat e drejtësisë të cilat duhet të mbizotërojnë kur vjen puna të respektimi dhe promovimi i lirive dhe i të drejtave njerëzore, pa marrë parasysh nëse të njëjtat janë të shkruara në kushtetutë. Kjo qasje, përveç në këtë lëmë, ka dhënë kontribut të

çmuar edhe në lëmin e legjitimitetit të pushtetit politik. Teoritë e dyta, ndërkaq, nisen nga presupozimi se teoria e së drejtës kushtetuese nuk mund të ketë për objekt studimi të drejtën natyrore por vetëm të drejtën pozitive, atë që manifeston një vullnet konkret. Si e tillë, e drejta pozitive mund të verifikohet empirikisht me metoda të shkencave natyrore dhe të njëjtën gjë duhet ta bëjnë edhe juristët kushtetues, pra të merren me studimin vetëm të atyre normave që janë pozitive dhe që ekzistojnë. Çdo qasje tjetër, sipas tyre, përbën moral dhe subjektivizëm. Kjo ndryshe njihet edhe si qasje dogmatike juridike, për dallim nga qasja sociologjike. Këtë e mësojmë nga fq. 40-47 të librit ***Droit constitutionnel***, 37e ed. (LGDJ: Paris, 2016) të autorëve **Francis Hamon** e **Michel Trope**. Kjo mësohet çdo kund në Evropë dhe në sistemin kontinental të së drejtës nëpër demokracitë kushtetuese të proveniencës liberale.

KAPITULLI II.

ZHVILLIMI HISTORIK I SË DREJTËS KUSHTETUESE DHE I KUSHTETUTËS (FQ. 43–66)

Përgjithësisht

Në tetë seksionet e këtij kapitulli, autorët tanë në pjesën dërrmuese ndjekin rrugën e kapitullit pararendës: manipulojnë literaturën e thurin narracion sipas tekeve dhe dëshirës së momentit, pa asnjë vlerë profesionale. Kjo shihet nga shpërputhjet e mëdha mes titujve të seksioneve dhe përmbajtjes së tyre. Në të shumtën e rasteve, përmbajtja e seksioneve është kaotike. Ky kaotizëm buron nga fakti se seksionet janë krijuar si pasojë e përmbledhjeve eklektike, metodës që autorët tanë kanë ndjekur në shumicën e tekstit, të lloj-lloj teksteve të autorëve të ndryshëm që kanë shkruar për të njëjtën gjë apo fenomen por që te autorët tanë dalin si tekste distopike me narracion tërësisht jorelevant për titullin e seksionit dhe të kapitullit marrë si tërësi. Ka vende që autorët tanë flasin për zhvillimet historike në të drejtën kushtetuese të sistemeve të cilave nuk u takon vendi ynë, siç janë vendet islamike, pa denjuar që të flasin sado pak për zhvillimet kushtetuese nëpër dy fetë e tjera të traditës abrahamike (judaizmi dhe krishterimi). Kjo qasje paraqet indoktrinim të studentëve dhe të lexuesit dhe bie ndesh me parimin kushtetues të laicitetit dhe të qëndrimit neutral

të shtetit dhe institucioneve publike, siç është Fakulteti Juridik, ndaj çështjeve fetare dhe doktrinave të tyre.

Edhe këtu manipulimi i literaturës del në syprinë. Sipas vlerësimit tonë, në këtë kapitull më së shumti manipulohen autorët shqiptar, përkatësisht autorët **Luan Omari**, **Aurela Anastasi** dhe **Kurtesh Saliu**. Kjo nuk do të thotë se autorët e huaj janë "mëshiruar"; sa i përket atyre, manipulimi del të jetë edhe më brutal sepse në asnjë rast nuk ekziston një faqe konkrete e një autori të huaj që mbështet (vërteton) shtjellimet apo deklarimet (konstatimet) e autorëve tanë. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, se çdoherë citohen vetëm titujt që kanë dhjetëra e qindra faqe, mirëpo në esencë nuk kanë fare të bëjnë me atë për çka citohen.

Të shohim në rreshtat në vijim si duket kjo gjendje e përshkruar si më sipër.

Analiza kritike

Në seksionin e parë, **Paraqitja e së drejtës kushtetuese** (fq. 43-45), autorët tanë flasin në mënyrë zigzage për shekujt XVIII dhe XIX, si shekuj të lindjes të së drejtës kushtetuese së bashku me të drejtën administrative dhe degët e tjera të së drejtës publike. Sipas tyre, e drejta kushtetuese paska lindur së bashku me të drejtën administrative dhe degët e tjera të së drejtës publike. Kjo thuhet kështu qysh në paragrafin e parë. Paragrafi i dytë del tmerrësisht i pakuptueshëm, kurse i treti me radhë saktëson se e drejta publike dhe e drejta kushtetuese kanë objekt të njëjtë të studimit (sic!). Për më tepër, autorët tanë në këtë vend konstatojnë se ky objekt i studimit është i njëjtë si për të drejtën kushtetuese si degë e shkencës juridike ashtu dhe për të drejtën kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik. Kjo mund të thuhet që është relativisht e saktë dhe vlen vetëm për sistemet e së drejtës së përgjithshme kushtetuese (*common law*), por asnjëherë në sistemet e së drejtës civile (kontinentale), ku hyn Kosova.

Menjëherë pas kësaj, autorët tanë thurin në mënyrë ekskursive një narracion tërësisht kaotik, të cilin mendojnë ta paketojnë dhe shesin te studenti e lexuesi si një diskurs të mirëfilltë intelektual, me citime fiktive dhe manipulative të literaturës (kryesisht të huaj). Në fillim flasin për **Perandorinë Romake** e më pastaj për **Greqinë** (sic!). Këtë e bëjnë deri në fund të këtij seksioni. Në një vend, në fq. 43, shkojnë aq larg sa thonë se "Roma e Vjetër ka pasur akte të zbatueshme që kanë pasur fuqinë më të lartë dhe të cilat në disa raste kanë bërë Perandorinë Romake të duket si një **mo-**

narki kushtetuese". Për të mbështetur këtë konstatim absurd citohen fq. 256-388 të librit kolosal ***The Roman Empire: Essays on the Constitutional History from the Accession of Domitian (81 A.D.) to the Retirement of Nicephorus III (1081 A.D.)***, vols. I-II (London and New York: Longmans, Green, and Company, 1910), të autorit të mirënjohur **F.W. Bussell**. Libri i tretë dhe i katërt i këtij libri voluminoz mbi Perandorinë Romake ka të bëjë, siç e thotë vetë autori, me analizimin e historisë kushtetuese të kësaj perandorie, përfshirë dy shekujt e fundit të ekzistencës së saj. Kjo do të thotë se bëhet fjalë për kohën e dyndjeve barbare në Perandori, si dhe për kohën e krijimit të **Romës së Lindjes** apo **Bizantit**. Marrë si tërësi, libri flet për historinë kushtetuese të **Romës Perandorake** nga perandori **Domician** (ka sunduar në vitet 81-96 të e.s.) deri te perandori bizantin Nicefori III (i pensionuar në vitin 1081 të e.s.). Në asnjë rresht autori nuk flet për Perandorinë Romake si **monarki kushtetuese**: krejt esenca e këtij libri voluminoz është që të sqarojë, duke ndjekur mësimet e **Hegel**-it mbi Perandorinë Romake, arsyet e qëndrueshmërisë dhe të zhdukjes së saj, arsyet e rimëkëmbjes së sistemit kushtetues romak në Evropë pas ardhjes së fiseve germane dhe, krejt në fund, arsyet e vazhdimit të Perandorisë Romake në Lindje, në Bizant. Autori thekson se libri ka të bëjë me studimin e sundimit imperial me fokus të veçantë këtë perandori. Sipas tij, perandorët romakë kanë sunduar me pëlqimin e heshtur të popullit dhe i kanë shërbyer kauzës dhe mirëqenies së përgjithshme. Përmes këtij libri, krejt në kundërshtim më atë që thonë autorët tanë, ky autor thekson se absolutizmi perandorak ka qenë i ngjashëm me absolutizmin modern, nga i cili duhet të mësojnë të gjithë. Kaq! Asnjë fjalë apo asociim me **monarkinë kushtetuese romake**. Po të kishte qenë ndryshe, një gjë e tillë do të përbënte një absurd të llojit të vetë: monarkitë kushtetuese nuk kanë ekzistuar në asnjë periudhë të zhvillimit të Evropës para modernitetit (fundi i zgjerimit kolonial, përkatësisht koha mes shekujve XVIII dhe XIX). Këtë që e themi ne e thotë edhe një recensues tjetër i librit si më sipër, i vetmi recension, i botuar në vitin tanimë të largët 1911, pra një vit pas botimit të librit. E kam fjalën për recensionin e autorit **George Willis Botsford** të botuar në numrin 3 të vëllimit 16 të revistës akademike *The American Historical Review* (1 April 1911, fq. 592-594).

Për fjalën kushtetutë, autorët tanë supozohet se kanë folur në kapitullin pararendës, gjë të cilën nuk e kanë bërë. Këtu u detyruam ta bëjmë ne në vend të tyre. Këtu vetëm do të tregojmë se sqarimi që autorët tanë i bëjnë nocionit gjuhësor të fjalës "kushtetutë" është i gabuar dhe përbën

një keqinterpretim të sqarimit të shkëlqyer që e japin autorët **Luan Omari** & **Aurela Anastasi** në librin e tyre ***E drejta kushtetuese*** (Shtëpia Botuese ABC: Tiranë, 2010), të cilin autorët tanë e citojnë në fusnotën nr. 1 të fq. 9. Në këtë libër, autorët shqiptarë sqarojnë nocionin gjuhësor të fjalës "kushtetutë" dhe dallimin e tij nga nocioni homonim përmbajtjesor, që paraqet një rend juridik superior në krahasim me rendet e tjera inferiore që i takojnë sferës së ***lex***-it të zakonshëm. Ky dallim, me të drejtë vërejnë autorët shqiptarë, nuk ka ekzistuar në kohën e Romës dhe nis të paraqitet në mënyrë graduale diku në Mesjetë. Kjo nënkupton se këta autorë flasin vetëm për fjalën "kushtetutë" në kuptimin përmbajtjesor, jo në kuptimin etimologjik të fjalës. Po të kishin dashur autorët tanë të dinë saktësisht gjendjen kuptimore të nocionit "kushtetutë", një gjë të tillë kanë pasur mundësi ta bëjnë. Këtë nuk e kanë bërë, dhe kjo ka qenë detyrë e tyre primare.

Sikundër dihet, në kuptimin përmbajtjesor, fjala "kushtetutë" paraqet një rend superior dhe një dukuri objektive shoqërore në të njëjtën kohë. Si e tillë, pra si nocion përmbajtjesor, fjala "kushtetutë" ka ekzistuar vetëm në Greqinë e lashtë, jo edhe në Romë. Nuk është për t'u habitur që autorët tanë nuk e kanë kuptuar këtë rrethanë, nëse merret parasysh fakti se në mënyrë arbitrare flasin për Greqinë pas diskutimit të tyre për Romën, ani se kjo e dyta i ka pasrendur civilizimit grek (sic!). Ai rend grek superior, i njohur si ***nomos***, ka qenë pika e referimit për identitetin kushtetues grek, të cilin **Aristoteli** e ka përshkruar shumë bukur kur ka thënë te vepra e tij ***Politika*** se "nuk janë muret e kështjellave dhe qyteteve ata që përbëjnë identitetin tonë, por mënyra e qeverisjes dhe asaj se si sundohemi". Këtë histori të ***nomos***-it grek e sqaron shumë bukur **Michel Rosenfeld** në shkrimin e tij të thellë **Constitutional Identity**, botuar në Michel Rosenfeld & András Sajó (eds.), ***The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*** (Oxford UP: Oxford, 2012, fq. 757-776).

Në mënyrë të njëjtë, autorët tanë kanë pasur mundësi të gjerë për të sqaruar dallimin etimologjik të fjalës ***constitutio*** dhe përdorimin e saj në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera, përkatësisht të sqarojnë kuptimin jopërmbajtjesor të fjalës "kushtetutë". Po ta kishin bërë këtë, autorët tanë do të kishin zbuluar se poeti romak **Virgjili** në veprën e tij ***Eneida*** e përdor këtë term me kuptimin e një "akt ndërtimi", kurse te grekët e vjetër kjo është shprehur përmes fjalës *politeia*, që ka një kuptim tjetër me botën romake. Sidoqoftë, autorët e huaj pajtohen që fjala "kushtetutë", të cilën autorët tanë mendojnë se e kanë sqaruar për studentin dhe lexuesin duke

folur në mënyrë të përçartë për kohën e antikitetit e deri më sot, asnjëherë nuk ka pasur kuptim normativ që ka sot dhe në çdo periudhë tjetër para Revolucionit Amerikan dhe Francez. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, se në të kaluarën është bërë dallimi mes fjalës *constitutio* dhe rendit eventual superior juridik që nuk ka qenë i përcaktuar nga *constitutio*, përkatësisht që ka qenë tërësisht i ndarë dhe i ndryshëm nga rendi tillë. Mjafton për këtë të citojmë autorët **Yasuo Hasebe** & **Cesare Pinelli** dhe shkrimin e tyre **Constitutions** (fq. 9-19), botuar në librin me përmbledhje të **Mark Tushnet**, **Thomas Fleiner** & **Cheryl Saunders** me titull ***The Routledge Handbook of Constitutional Law*** (Routledge: London/New York, 2013). Në konstatim të ngjashëm arrin edhe **Aurela Anastasi** në veprën e saj ***Historia e Institucioneve*** (Pegi: Tiranë, 2006), në pjesët që flet për historinë e Antikës, Mesjetës dhe lindjen e Modernitetit.

Edhe për të drejtën shtetërore, autorët tanë e kanë shumë gabim: kjo ka lindur, si degë e së drejtës dhe si dije e sistematizuar mbi të drejtën publike, në gjysmën e parë të shekullit XVIII, dhe vetëm në fund të atij shekulli e drejta kushtetuese është diferencuar nga e drejta shtetërore në dy kuptimet si më sipër. Po ashtu, e drejta publike asnjëherë nuk mund të thuhet se ka për objekt të njëjtë të rregullimit dhe të studimit me të drejtën kushtetuese, qoftë si një drejtë pozitive apo si teori mbi të drejtën publike, siç e thonë autorët tanë. Në të dyja rastet, objekti rregullimit, përkatësisht i studimit janë institucionet shtetërore dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, kurse në rastin e së drejtës kushtetuese objekt rregullimi nuk janë vetëm institucionet dhe marrëdhëniet në mes tyre, por edhe liritë dhe të drejtat njerëzore dhe pozita dhe roli i individëve në shtet dhe marrëdhëniet e tyre me pushtetin politik dhe anasjelltas. Për më tepër, në disa vende, si në **Francë** dhe në vendet e tjera evropiane, e drejta kushtetuese (si degë e sistemit pozitiv juridik dhe si teori) titullohet si **E drejta kushtetuese dhe institucionet politike**. Atëherë kur e drejta publike ka pasur për objekt rregullimi institucionet shtetërore dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, nuk ka pasur të drejtë kushtetuese por vetëm të drejtë publike, përkatësisht të drejtë shtetërore (siç është quajtur në disa shtete, si **Gjermania, Austro-Hungaria** etj.). Autori i parë që ka lëruar lëmin e së drejtës kushtetuese, në mënyrë sistematike dhe shkencore sipas standardeve që sot i njohëm, ka qenë francezi **Adhémar Esmein**. Ai ka shkruar mbi të drejtën kushtetuese në fillet e **Republikës së Tretë**. E kemi fjalën për librin e tij themeltar të së drejtës kushtetuese moderne ***Eléments de droit constitutionnel français et comparé*** (Paris, 1896). Një liberal deri në fund, **A. Es-**

mein u angazhua për ndarjen e së drejtës kushtetuese nga e drejta shtetërore dhe për trajtim më ndryshe të institucioneve të Francës pas rënies së perandorisë së **Napoleonit III** dhe instalimit të një rendi më liberal me njohje të së drejtës së përgjithshme të votës dhe shumë lirive e të drejtave të tjera individuale. Ky libër paraqet një trajtimin sistematik të së drejtës kushtetuese, të cilin trajtim ky autor e ka bërë duke analizuar institucionet liberale të Republikës së Tretë në dritën e diskursit mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe duke e lidhur këtë materie me të drejtën kushtetuese. Që në fillim të librit, **A. Eismein** konstaton se, për dallim nga të gjitha degët e tjera të së drejtës pozitive, e drejta kushtetuese presupozohet. Libri në fjalë përbën një trajtim krahasimor të së drejtës kushtetuese, pra jo vetëm të së drejtës franceze.

Në doktoratën e tij ***Adhémar Esmein et le droit constitutionnel de la liberté*** (l'Université de Reims Champagne-Ardenne, 2012), **Antoine Chopplet** e ka cilësuar librin e **A. Esmein** si qasje intelektuale që ka autonomizuar të drejtën kushtetuese, me kuptim ndarjen e saj nga e drejta shtetërore, administrative dhe degët e tjera të së drejtës me të cilat e drejta kushtetuese është asociuar deri në atë kohë. Një tjetër autor, duke folur për historinë intelektuale dhe faktike të së drejtës shtetërore në Evropë, e radhit **A. Esmein**-in në krah të njëjtë me kolosët e tjerë të së drejtës si **Léon Duguit**, **Maurice Hauriou**, **Raymond Carré de Malberg** etj. E kemi fjalën për recensionin mbi veprën **A. Chopplet,** ***Adhémar Esmein et le droit constitutionnel de la liberté*** (Mare & Martin, 2016), të autorit **Arthur Braun**, botuar në ***Civitas Europa*** (2016/2, n° 37, fq. 407-411).

Qasja liberale e **A. Eismein**-it nuk reflektohet vetëm në analizën e tij të hollë lidhur me origjinën e pushtetit por edhe tek format e manifestimit të tij. Kështu, ai e bën ndarjen e pushtetit në ndarjen e butë dhe në ndarjen e rreptë, duke iu referuar teorisë dhe praktikës së traditës amerikane dhe evropiane mbi ndarjen e pushtetit, krahas trajtimit të rolit dhe pozitës së individit në **Republikën e Tretë**. Kjo qasje e bën **A. Eismein** të dallueshëm nga autorët e tjerë të mëdhenj evropianë. Këtu e kemi fjalën për autorin e mirënjohur gjerman **Paul Laband** dhe librin e tij të mëhershëm ***Public Law of the German Empire*** (1888). Laband në këtë libër nuk flet për të drejtën kushtetuese në kuptimin e sotëm të fjalës, por për të drejtën gjermane, të drejtën shtetërore të **Rajhut Gjerman** pas unifikimit, duke mos i kushtuar ndonjë vëmendje të madhe ndarjes së pushteteve dhe rolit dhe pozitës së individit në shoqërinë gjermane. Vetë titulli i librit në gjuhën gjermane në origjinal i autorit **P. Laband** është ***E Drejta Shtetërore e Pe-***

randorisë Gjermane. Se ky libër është kryekëput analizë e së drejtës shtetërore gjermane pa ndonjë shije dhe ndjeshmëri të veçantë për të drejtën kushtetuese e ka sqaruar autori **John W. Burgess** në një recension të tij të botuar po atë vit kur është botuar edhe libri i **P. Laband**. E kemi fjalën për recensionin me titull ***Laband's Public Law of the German Empire*** (*Political Science Quarterly*, vol. 3, no. 1, March 1888, fq. 123-135).

Kjo si më sipër nuk dallon në esencë me pikëpamjet e autorëve të tjerë evropianë që i takojnë proveniencës së njëjtë. Vetëm më vonë, aty nga fundi i shekullit XIX, në mënyrë graduale fillon të kristalizohet ideja dhe konsensusi mbi ekzistimin e së drejtës kushtetuese si degë e veçantë e së drejtës dhe si teori e ndarë nga degët e tjera të shkencës juridike. Të kuptuarit e kësaj çdoherë nënkupton njohjen e thellë, jo vetëm bazike, të historisë intelektuale të mendimit evropian, me fillim në veçanti nga historia e Renesancës, Reformacionit, Kundërreformacionit dhe Iluminizmit. Kjo, si duket, përbën të metën kryesore të autorëve të librit që e recensojmë. Kjo rrethanë objektive, përkatësisht ky kufizim i autorëve tanë, do të shihet edhe më shumë në seksionet që vijnë, në këtë dhe në kapitujt e tjerë. Të shohim si duket kjo mosnjohje themelore në seksionin e dytë të këtij kapitulli.

Seksioni i dytë titullohet "Periodizimi i zhvillimit të së drejtës kushtetuese dhe të Kushtetutës" (fq. 45-46). Studenti e lexuesi presin nga vetë titulli, dhe atë me plot të drejtë, të mësojnë diçka më shumë për periudhat e zhvillimit të së drejtës kushtetuese, si degë e së drejtë pozitive dhe si teori, si dhe për vetë kushtetutën si koncept themelor. Në faqen 45 bëhet periodizimi më i shfytyruar që mund të hasë njeriu: fillon me parahistori për të dalë në Mesjetë, duke u pasuar nga humbja e dy shekujve në vijim, në mënyrë që më pastaj të kapërcehet në shekujt XVIII dhe XIX. Krejt kjo bëhet me qëllim që në fund të duket sikur kalimi në shekullin XX në mënyrë të natyrshme pason periodizimin e tillë të shfytyruar. Për të qenë e keqja edhe më e madhe, ky periodizim nuk ndiqet nga autorët tanë në fq. në vijim; d.m.th. vetë ata nuk i rrinë mbrapa periodizimit të tyre, të zbuluar nga ata vetë. Si periudhë parahistorike, për autorët tanë janë koha e **Romës** dhe **Greqisë**. Merreni me mend: autorët tanë flasin së pari për Romën pastaj për Greqinë dhe atë në kontekstin parahistorik (sic!). Këtë e bëjnë në fq. 46. Mos pyet!

Studenti e lexuesi mbase presin që seksioni në vijim do të flasë për parahistorinë, apo së paku për kohën antike, **Greqinë** dhe **Romën.** Mirëpo, do të zhgënjehen, siç është zhgënjyer autori i këtyre rreshtave, sepse

autorët tanë menjëherë kalojnë në Mesjetë dhe flasin për ***Magna Carta Libertatum*** (1215), si për një dokument që ka garantuar barazinë e të gjithëve, në vend se t'i shpjegojnë studentit e lexuesit se të gjitha dokumentet mesjetare mbi liritë dhe të drejtat njerëzore kanë qenë dokumente të aristokracisë për mbrojtjen e privilegjeve të tyre. Kjo ka qenë kështu kur janë prodhuar ato dhe të tilla cilësohen sot e gjithë ditën, pra si dokumente të aristokracisë mesjetare të fituara në luftën e tyre kundër pushtetit mbretëror dhe me qëllim të ruajtjes së privilegjeve të tyre. Shumë më vonë këto dokumente kanë fituar universalitetin e tyre. Përveç këtij lëshimi, autorët tanë është dashur t'i shpjegojnë format e qeverisjes së ndarë angleze, jo të mashtrojnë studentin e lexuesin me teza fiktive se ***Magna Carta*** paska pas qenë udhërrëfyes për hartuesit e Kushtetutës së SHBA-së (1787) dhe të Deklaratës së Francës mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit (1789). Sot nuk ka asnjë dilemë se **John Locke** ka qenë udhërrëfyesi kryesor ideologjik i baballarëve të kombit amerikan, kurse **J.J. Rousseau** inspiruesi kryesor i Deklaratës së vitit 1789 të **Revolucionit Francez.** Këto dy fakte i kanë bërë të dallueshme diametralisht, sot e kësaj dite, Revolucioni Amerikan, respektivisht Francez.

Absurdi i autorëve tanë është edhe më skandaloz kur në këtë seksion, pas ***Magna Carta Libertatum***, të cilën me të drejtë e cilësojnë si dokumentin e parë me rëndësi kushtetuese në Mesjetë, befas konstatojnë të kundërtën lidhur me *Magna Carta*: në fq. 47 të librit të tyre thonë se kushtetuta e parë konsiderohet **Kushtetuta e Medinës**, e përpiluar nga profeti mysliman **Muhamed**. Kësaj kushtetute autorët tanë i japin një cilësi të një kushtete moderne, duke na thënë se është e përbërë nga pjesa e organizimit të pushtetit dhe nga pjesa mbi të drejtat dhe liritë njerëzore, njëjtë sikur sot që ndahen kushtetutat e vendeve liberale demokratike (sic!). Përveç kësaj, autorët tanë e lavdërojnë këtë kushtetutë sepse paska pas pasur një preambulë që ka filluar me "emrin e Allahut, mëshiruesit dhe mëshirëbërësit". Për këtë si referencë citojnë autorët vendorë, **Hilmi Ismaili** & **Fatmir Sejdiu** dhe fq. 124-125 të librit të tyre ***Historia e shtetit dhe së drejtës (I)*** (Fakulteti Juridik i UP-së: Prishtinë, 2005). Këta autorë, megjithatë, nuk e thonë një gjë të tillë. Këtë nuk e thonë as në fq. e njëjta të botimit të tyre më të fundit, esencialisht të njëjtë, me titull ***Historia e institucioneve shtetërore dhe juridike*** (Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik: Prishtinë, 2017). Autorët **Hilmi Ismaili** & **Fatmir Sejdiu** "Kartën e Medinës" e trajtojnë në kuadër të shtjellimeve mbi Kalifatin Arab, që është pjesë e trajtimeve mbi institucionet shtetërore e

juridike në periudhën e feudalizmit. Ky nuk është rasti me autorët tanë. Ku janë trajtimet për Kodin e Hamurabit, Ligjin e 12 Tabelave, Kodin e Justinianit dhe shumë e shumë kode e dokumente të tjera shumë para dhe gjatë Mesjetës? Askund. Ku është trajtimi i aspektit kushtetues të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re, meqë autorët tanë kanë vendosur që studentit e lexuesit t'i thonë se "Karta e Medinës" na qenka kushtetuta e parë? Askund. Autorët **H. Ismaili** & **F. Sejdiu** konstatimin e tyre rreth "Kartës së Medinës" e bazojnë tek autorët e tjerë, duke mos e dhënë si një mendim të tyrin. Ky trajtim i njëanshëm dhe tërësisht ahistorik i historisë kushtetuese nga ana e autorëve tanë, duke e paraqitur Islamin si pararendësin e konstitucionalizmit modern, nuk është veçse një qasje joshkencore me qëllim të indoktrinimit të studentit dhe lexuesit. Autorët **H. Ismaili** & **F. Sejdiu**, ndërkaq, në veprën e tyre si më sipër flasin ndryshe: me radhë dhe një nga një i trajtojnë dokumentet dhe momentet kyçe në historinë e institucioneve shtetërore e juridike, duke filluar prej Dhiatës së Vjetër, Kodit të Hamurabit, periudhës greke e romake, Dhiatës së Re, Mesjetës, Kushtetutës së Medinës e deri te kushtetutat dhe aktet e tjera me rëndësi për historinë kushtetuese dhe historinë tjetër të civilizimit njerëzor. Mbi të gjitha, autorët **H. Ismaili** & **F. Sejdiu** flasin për tekstin më me ndikim në kushtetutat e nxjerra më pastaj pas revolucioneve amerikane e franceze të fundshekullit XVIII. E kam fjalën për "Instrumentin e Qeverisjes" së **Oliver Cromwell** (1653), i nxjerrë pas Luftës Civile në Angli (1642-1651), me të cilin u themelua republika jetëshkurtër (1653-1657). Instrumenti parashikonte për herë të parë ndarjen e pushtetit, bikameralizmin, kushtetutën e shkruar, kontrollin gjyqësor dhe kategoritë e tjera kushtetuese të qeverisjes që më vonë do të bëhen objekte trajtimi e diskutimi në dy anët e Atlantikut.

Në asnjë pjesë të librit të tyre mbi të drejtën kushtetuese, autorët tanë nuk e thonë një fjalë për këtë si më sipër (sic!): në paragrafin e parë të fq. 48, autorët tanë flasin për fitoren e Revolucionit në Angli (1688), duke kaluar nga *Magna Carta* e vitit 1215, në vitin 1688, për të konstatuar se këtu në këtë kohë janë nxjerrë edhe dy dokumente me rëndësi. Trajtim eklektik dhe kaotik, pa asnjë përmbajtje, pa treguar në mënyrë vërtet shkencore dhe me përmbajtje se cila ka qenë historia e Revolucionit të Anglisë (1688) dhe pse aty u proklamua epërsia e parlamentit dhe e qeverisjes së kufizuar (*limited governement*), jo e pushteteve të ndara dhe e kontrollit gjyqësor. Kjo nuk mund të bëhet pa përmend Oliver Cromwellin dhe rolin e tij historik në proceset para ngjarjeve që çuan në **Revolucionin e**

Lavdishëm (1688).

Dy shekujt që autorët tanë i harrojnë gjatë periodizimit të përshkruar si më sipër, i rikthejnë në seksionin e tretë me titull "Zhvillimi i kushtetutave gjatë shekullit XVII, XVIII, XIX dhe fillimet e shekullit XX". Në këtë seksion e rikthejnë edhe tezën reale sipas së cilës kushtetutë e parë në botë nuk është ajo e Medinës por Kushtetuta e SHBA-së. Mirëpo, kur flasin për historinë intelektuale të konstitucionalizmit perëndimor, autorët tanë janë konfuzë në tërësi sepse flasin për Montesquieu-në, Rousseau-në dhe Locke-un para Machiavelli-t, dhe flasin për J.S. Mill-in vetëm kalimthi ani se ndikimi i tij ka qenë vendimtar në historinë kushtetuese perëndimore, në veçanti në SHBA. Renditja e diskutimit në këtë seksion është aq kaotike sa studenti dhe lexuesi do ta kenë të pamundur ta kuptojnë se kur nis historia moderne kushtetuese e kur koha e Mesjetës dhe cili është raporti në mes këtyre epokave historike të zhvillimit të teorisë dhe praktikës kushtetuese. Në fq. 50 autorët tanë konstatojnë me të drejtë se Kushtetuta e SHBA-së është kushtetuta e parë në botë, kurse ajo franceze e dyta, mirëpo gabimisht mendojnë se kushtetutat e tjera evropiane, si ajo bullgare, polake, ruse dhe të tjerat e shekullit XIX kanë qenë njëjtë si ajo amerikane dhe kanë garantuar ndarjen e pushteteve dhe liritë e të drejtat njerëzore. Këtë e thonë në fq. 50. E vërteta është se koncepti i mbrojtës së lirive dhe të drejtave të njeriut, ashtu siç e njohim sot, në truallin evropian ka nisur me **Kushtetutën e Vajmarit** (1919), kurse formalisht me **Kushtetutën e Frankfurtit** (1849), që kurrë nuk u vu në jetë, kanë ekzistuar dispozita të rralla mbi liritë dhe të drejtat e njeriut.

Seksioni i katërt ripërsërit dy shekuj nga seksioni paraprak, dhe mëton të diskutojë vetëm disa kushtetuta që sipas autorëve përbëjnë gurthemelin e konstitucionalizmit modern perëndimor: në këtë thes i fusin edhe kushtetutën ruse e bullgare, polake, rumune e zvicerane, me një fjalë krejt kushtetutat e njohura të kohës. Seksioni titullohet "Disa kushtetuta të periudhës së shekullit XVIII dhe fillim-shekullit XX". Në dy fq. e para të këtij seksioni, fq. 51-52, autorët tanë me një saktësi relative flasin për historikun e nxjerrjes së Kushtetutës së SHBA-së (1787) dhe të Kushtetutës së Francës (1791). Mirëpo, këtu sërish nis të vërehet manipulimi i literaturës nga autorët tanë: në fusnotën 91 autorët tanë në vend të neneve të Kushtetutës së SHBA-së, citojnë librin ***American Constitutional Law: Essays, Cases, and Comparative Notes*** (Rowman & Littlefield Publishers: USA 2009) të autorëve **Donald P Kommers**, **Gary J. Jacobsohn** e **John E. Finn,** jashtë çdo konteksti. Fq. e këtij libri që citohen fare nuk kanë të bëjnë me

tre nenet e Kushtetutës së SHBA-së, por me tekstin integral të saj, që jepet si aneks "B" në fq. 745-754, të cilat i citojnë autorët tanë krejt me qëllim manipulimi. Thënë me fjalë të tjera, autorët tanë, në vend se të citojnë nenet konkrete të Kushtetutës së SHBA-së dhe t'i përshkruajnë ato, citojnë librin dhe autorët si më sipër.

Libri si më sipër ka dy vëllime. Vetëm vëllimi i parë i kushtohet ndarjes së pushteteve, gjë që shihet nga vetë titulli "Governmental Powers and Democracy". Vëllimi i dytë, ndërkaq, flet për liritë dhe të drejtat e njeriut e jetën në komunitet. Në ndërkohë që autorët **Donald P Kommers, Gary J. Jacobsohn** dhe **John E. Finn**, në librin si më sipër, në dy vëllime, japin një analizë të shkëlqyer të ndarjes së pushteteve në SHBA, të teorisë dhe praktikës së saj, që domosdo nis me **John Locke** dhe me ***Letrat e Federalistit***, autorët tanë përmendin vetëm aneksin "B" të vëllimit të parë, që përmban tekstin *ad literam* të Kushtetutës së SHBA-së, tekst që gjendet çdokund nëpër internet, bile edhe në gjuhën shqipe (sic!).

Manipulimi me literaturën del edhe më i dukshëm e më brutal pas diskutimit që autorët tanë e bëjnë lidhur me kushtetutat zvicerane e belge. Pas këtij diskutimi fillon "analiza shkencore", përmes manipulimit të hapur të literaturës, për kushtetutat si vijon: **Polonisë** (1791), **Rumanisë** (1866) **Bullgarisë** (1879), **Spanjës** (1812) dhe **Rusisë** (1906). Sikundër shihet, autorët tanë flasin për kushtetutat e këtyre vendeve, jo sipas kohës së nxjerrjes së tyre por sipas dëshirës së vetë autorëve për t'i renditur ato në një mënyrë të caktuar (sic!). Kjo këtu nuk ka aq shumë rëndësi sa gabimet përmbajtjesore që autorët i bëjnë lidhur me këto kushtetuta dhe zhvillimet historike të vendeve si si më sipër. Të shohim si bëhet kjo nga autorët tanë.

Kushtetutën e Polonisë të vitit 1791 autorët tanë e trajtojnë tërësisht në mënyrë të gabuar si pjesë të kushtetutave të "iluminizmit kushtetues". Për të provuar këtë konstatim, në fusnotën nr. 97 citojnë librin, përkatësisht disertacionin e doktoratës së autorit të mirënjohur turk **Levent Gönenç** me titull ***Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries*** (Martinus Nijhoff Publishers, 2002). Autorët tanë thonë se në fq. 53 të këtij libri, autori paska shkruar se Kushtetuta e Polonisë e vitit 1791, i takon proveniencës së kushtetutave të tilla. Këtë konstatim, megjithatë studenti dhe lexuesi nuk do ta gjejnë. Në fakt, në atë fq. gjendet një përmbajtje krejtësisht tjetër prej asaj që thonë autorët tanë: aty nuk është thënë asnjë fjalë për "iluminizmin kushtetues". Jo vetëm kaq. Autorët tanë e paraqesin këtë kushtetutë si një fitore të aristokracisë konservatore po-

lake kundër pushtetit absolut të mbretit. E vërteta, ndërkaq, është krejt ndryshe. Këtë e sqaron shumë bukur autori turk, në të cilin gjoja mbështeten autorët tanë: në fq. 53-55 të librit të autorit turk sqarohet se Kushtetuta e Polonisë, e 3 majit të vitit 1791, paraqet fitore të mbretit polak, i cili në bashkëpunim me inteligjencien mundi aristokratët konservatorë dhe nxori këtë kushtetutë mjaft liberale për kohën e vet sepse futi ndarjen e pushtetit, të drejtat e njeriut dhe sovranitetin popullor. Thënë më fjalë të tjera, mbreti ka kufizuar pushtetin e vet me ndihmën e inteligjencies vendore duke kundërshtuar aristokracinë konservative, jo anasjelltas siç pohojnë autorët tanë. Ka qenë pikërisht kjo aristokraci, jo mbreti polak, ajo që ka pasur nevojë të reformohet dhe të frenohet.

Edhe për **Rumaninë**, autorët tanë flasin në mënyrë të përçartë: mendojnë se ka ekzistuar vetëm një kushtetutë rumune në periudhën pas Traktatit të Paqes së vitit 1858. E vërteta është, ndërkaq, se kanë ekzistuar dy sosh: e para ka qenë Kushtetuta e vitit 1864 dhe e dyta Kushtetuta e vitit 1866. Ka qenë kushtetuta e parë e vitit 1864, ajo që është miratuar me referendum dhe që i ka dhënë princit rumun **Alexander Cuza** një pushtet ekzekutiv absolut, rrethanë që ka paraqitur pengesë për reformat e thella në vend. Në ndërkohë formohet një koalicion liberalo-konservativ, i cili e detyron këtë princ autoritar të abdikonte, dhe pason ardhja në fron e princit gjerman Charles nga familja Hohenzollern dhe nxjerrja e Kushtetutës së vitit 1866. Këtë kushtetutë, autorët tanë në mënyrë të gabuar e ngatërrojnë me kushtetutën e parë të vitit 1864. Ky aktivitet kushtetutëbërës i rumunëve, tërësisht elitik, krijon një monarki kushtetuese. Kjo ka ardhur si rezultat i Traktatit të Paqes së vitit 1858 dhe i autorizimeve të dhëna princit gjerman nga fuqitë e mëdha të kohës. Kjo sqarohet shumë bukur nga autori turk **Levent Gönenç**, të cilin autorët tanë si duket nuk e kanë kuptuar si duhet. Kështu si autori turk thotë edhe autorja tjetër, të cilin autorët tanë e manipulojnë në fusnotën nr. 101. E kam fjalën për shkrimin **The Romanian Constitutional Discourse between Modernization and Europeanization** nga **Gabriela Goudenhooft**, botuar në *Europolity* (vol. 9, no. 1, 2015, fq. 65-87). Në fq. 67-68, të cilat i citojnë autorët tanë, autorja **Gabriela Goudenhooft** flet për zhvillimin kushtetues të Rumanisë mbretërore deri në rënien e këtij vendi nën komunizëm. Pjesa e shkrimit që ka të bëjë me detyrimet nga Traktati i Paqes së Parisit, në tërësi përputhet me autorin turk, përkatësisht shpërputhen në tërësi me atë që thonë autorët tanë. Në fakt, autorët tanë citojnë **Gabriela Goudenhooft**, në ndërkohë që teksti që flet për Rumaninë në fq. 54-55 të librit të

autorëve tanë, në tërësi është transportuar, në mënyrë të shtrembëruar, nga autori turk **Levent Gönenç**. Fundi i fundit, trajtimi i autores **Gabriela Goudenhooft,** ka të bëjë më një kontekst modern dhe shumë shkurt flet për historinë kushtetuese monarkike të këtij vendi: ajo flet krejt në mënyrë të kondensuar, ashtu që autorët tanë pak kanë mundur të kuptojnë lidhur me historinë kushtetuese rumune e kohës pas pavarësimit nga otomanët.

Aspak më mirë nuk paraqitet gjendja me historinë kushtetuese të **Bullgarisë**, pas fitimit të pavarësisë. Në fillim, në fq. 55, autorët tanë konstatojnë krejt në mënyrë të gabuar se Kushtetua e vitit 1879 e këtij vendi është, krahas asaj ruse (ani se nuk tregojnë se për cilën kushtetutë ruse është fjala), e fundit kushtetutë e ndikuar nga idetë përparimtare të Iluminizmit. Kushtetutën e Bullgarisë të vitit 1879, autorët tanë e cilësojnë si kushtetutë konservatore, ani se në përshkrim të saj në tërësi dominojnë elementet e një kushtetute liberale të një monarkie kushtetuese, çfarë në fakt edhe ka qenë. Kjo kushtetutë mishëron triumfin e elitës liberale bullgare ndaj rrymave konservatore të kohës, gjë që përbën esencën e kulturës iluministe. Autorët tanë si duket me kulturë iluministe dhe me iluminizëm kushtetues nënkuptojnë sundimin e shumicës dhe jo projektet dhe veprat racionale elitike të mbretërve, intelektualeve dhe shtresave të tjera të shoqërisë më qëllim të kufizimit të pushtetit. Kjo konstatohet në fq. 64-65 të librit të autorit turk, konstatim tërësisht i ndryshëm nga autorët tanë, të cilët këtë kushtetutë bullgare e fusin në kategorinë e kushtetutave konservatore.

Tri kushtetutat si më sipër, sipas autorit, hyjnë në kategorinë e njëjtë me **Kushtetutën e Spanjës** të vitit 1812. Autorët tanë as idenë më të vogël nuk e kanë se çfarë paraqet Kushtetuta e Spanjës e vitit 1812, e njohur si **Kushtetuta e Kadizit**, dhe ndikimi që kjo kushtetutë ka pasur në Norvegji (Kushtetuta e vitit 1814), Portugali (Kushtetuta e vitit 1822) dhe Meksikë (Kushtetuta e vitit 1824). Kushtetuta, e cila i takon proveniencës së kushtetutave të liberalizmit klasik apo liberalizmit fillestar, ka lindur në luftën e këtij vendi për pavarësi nga sundimi napoleonik dhe në tërësi dallohet nga tri kushtetutat e sipërcekura. Në fakt, gabimi themelor që autorët tanë e bëjnë në këtë seksion është se pas trajtimit të ndikimit të ideve iluministe në kushtetutat e Evropës juglindore të fundshekullit XIX, i kthehen vendeve perëndimore dhe zhvillimit të tyre kushtetues në fillim të atij shekulli. Një trajtim ky tërësisht kaotik dhe eklektik për nga natyra e vet. Këtu, me këtë rast, autorët tanë në mënyrë eklektike shkojnë më tutje dhe thonë

se kjo kushtetutë spanjolle ka pasur ndikim në kushtetutat e vendeve si Gran-Kolumbia, Granada e Re, Venezuela, Peruja, Uruguaji, Kili etj. Për këtë, në fusnotën nr. 105 citojnë fq. 2 të librit ***Comparative Constitutional Law: Introducion*** të autorëve **Tom Ginsberg** & **Rosalind Dixon**. Kjo paraqet gabim në dy drejtime: e para, hyrja e këtyre dy autorëve është botuar në librin e redaktuar nga vetë ata me titull ***Comparative Constitutional Law*** (Edward Elgar, USA & GB, fq. 1-15), pra jo siç citohet; e dyta, në fq. 2 që citohet nga autorët tanë, autorët **T. Ginsburg** dhe **R. Dixon** flasin për ndikimin që ka pasur përmbajtja klasike liberale e **Kushtetutës së Kadizit**, jo idetë e kulturës iluministe. Fundja, idetë iluministe jo domosdo janë liberale: ato mund të vijnë edhe nga sunduesit absolutë. Në fakt, për të qenë të saktë, shënojmë se krejt historia e promovimit të iluminizmit dhe besimit në kushtetutat e shkruara si projekte të qëllimshme institucionale ka nisur dhe është realizuar kryesisht nga sundimtarë absolutë. Prandaj shpesh herë ata janë cilësuar si "sundimtarë të përndritur", sepse u kanë dhënë qytetarëve kushtetuta dhe sundime me fytyrë të theksuar humane.

Në renditjen arbitrare të historisë kushtetuese, e fundit në këtë seksion vjen Kushtetuta e Rusisë e vitit 1906. Vetëm tani lexuesi e kupton se për cilën kushtetutë ruse autorët tanë flasin më herët në fillim të fq. 55. Autorët tanë në mënyrë të gabuar mendojnë se Kushtetuta e vitit 1906 përbën një kushtetutë që ka sanksionuar ndarjen e pushteteve dhe, si e tillë, mund të radhitet në kushtetutat liberale të nxjerra sipas frymës iluministe të shekujve XVII-XVIII dhe XIX. Ky është konstatim absurd. Për këtë konstatim ahistorik, kaotik dhe jo të saktë citojnë sërish fq. 67-72 të librit të sipërcekur të autorit turk **Levent Gönenç**. Në fq. 67-71, **L. Gönenç** në mënyrë të shkëlqyer diskuton sfondin e ngjarjeve që i kanë paraprirë nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1906, lindjes së proletariatit rus si dhe pakënaqësisë së të gjitha shtresave sociale ruse para vitit 1906 (fshatarëve, proletarëve, borgjezisë dhe intelektualëve) me regjimin autokratik të perandorit rus Nikolla II, pakënaqësi që ka qenë shumë prezente para vitit 1906. Në këtë mes, Manifesti i 17 tetorit 1905, përbën pikën e vlimit në nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1906: mbi bazën e këtij manifesti u bë draftimi i saj dhe ndërtimi i një sistemi kushtetues në të cilin **Cari i Rusisë** konsiderohej i shenjtë, i paprekshëm dhe të cilit i takonte tërë pushteti. Këtu as që mund të behej fjalë për ndarje të pushtetit. Autori turk e theksон se Kushtetuta e vitit 1906 ka qenë elitike dhe shumë larg pritjeve të inteligjencies liberale ruse, e cila kishte bërë hartimin e saj dhe që përqa-

fonte vlerat liberale të Evropës së asaj kohe. Këto janë konstatime krejt të ndryshme nga ato të autorëve tanë, që e shohin Kushtetutën e vitit 1906, si vazhdim të vënies në jetë të ideve iluministe në truallin rus, në ndërkohë që e vërteta është se pikërisht këto ide iluministe në fund dështojnë si pasojë e mungesës së kulturës politike iluministe të shoqërisë ruse të kohës. Ky konstatim i autorit turk vjen në fund të trajtimit të tij të kësaj kushtetuese, përkatësisht në fq. 71 të librit të sipërcekur. Autorët tanë, me sa duket, nuk e kanë lexuar siç duhet shtjellimin e autorit turk për Rusinë e shekullit XIX dhe idetë liberale të fillimit të shekullit XX, të cilat kanë dështuar pikërisht si pasojë e mungesës së kulturës politike iluministe në shoqërinë ruse të kohës. Pikërisht kjo mungesë e kulturës politike iluministe dhe shtresëzimi i ashpër i shoqërisë ruse, si pasojë e industrializimit të shpejtë (që në fund të shekullit XX u nis në Rusi, nga carët rusë, me qëllim të konkurrimit dhe ecjes në hap me Evropën) kanë bërë që të shpërthejë Revolucioni i Dytë Rus, ai i tetorit të vitit 1917: edhe ai pak konstitucionalizëm rus që kishte ekzistuar u fut në rrugën e abisit komunist gati për një shekull.

I pesti seksion me radhë, "Zhvillimi i kushtetutave në mes të Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore" (fq. 56-59), vazhdon tutje me manipulimin e literaturës dhe trajtimin kaotik të zhvillimit të kushtetutshmërisë në truallin evropian. Që në fillim, në paragrafin e tretë, sërish duke cituar autorin turk **Levent Gönenç**, autorët tanë në mënyrë të gabuar konstatojnë se Revolucioni i Tetorit (1917) ka filluar ndarjen mes Lindjes dhe Perëndimit. Autori turk, ndërkaq, nuk e thotë një gjë të tillë: ai në fq. 35-43, si pjesë e analizës së tij të saktë mbi kulturën politike dhe konstitucionalizmin para-komunist, flet për periudhën e Mesjetës, që nënkupton kohën nga shkatërrimi i Perandorisë Romake, në vitin 395, e deri nisjen e Renesancës. Në fakt, autori flet për Mesjetën e vonë, ku diskutohen faktorët kyçë për ndarjen e Evropës, në Lindje dhe në Perëndim, përkatësisht ndarjen e krishterimit në vitin 1054, në Kishën e Lindjes dhe në Kishën e Perëndimit. Vetëm ky faktor përbën pikën e referimit që i ka dalluar dhe i dallon akoma shoqëritë evropiane në juglindjen dhe në veriperëndimin e tyre (përfshirë këtu ardhjen e Islamit në Ballkan në gjysmën e dytë të shekullit XIV, duke shtuar kështu edhe një ndarje tjetër në anën lindore të Evropës, në kuptim të ndryshimit të kulturave politike). Autori turk shpjegon se ky dallim, paradoksalisht, ka pasur shumë pika të përbashkëta: në kohën para përqafimit masiv të kristianizmit krejt Evropa ka pasur sisteme të decentralizuara fisnore të qeverisjes, kurse pas kësaj kohe nis

faza e përbashkët e qeverisjeve politike teokratike. Kjo zgjat deri në Paqen e Vestfalisë (1648), kur në Perëndim ndahet kisha nga shteti dhe nis ndërtimi gradual i shtetit modern. Kjo fazë ka lindur në djepin e Renesancës dhe Reformacionit, të cilat së bashku i kanë shtruar rrugën Iluminizmit dhe revolucioneve borgjeze të fundit të shekullit XVIII. Kështu thotë edhe autori turk që autorët tanë e manipulojnë në vazhdimësi; kështu thonë krejt autorët seriozë që janë marrë më historinë politike dhe kushtetuese të Evropës.

Menjëherë pas kësaj, autorët tanë kalojnë në konkluzione eklektike absurde, duke futur në një thes **Kushtetutën e Vajmarit** (1919) dhe Kushtetutën e Mbretërisë SKS (Serbo-Kroato-Sllovene), e njohur si **Kushtetuta e Vidovdanit** (1921). Trajtimi i Kushtetutës së Vidovdanit nga autorët tanë është i mirë dhe i kuptueshëm, standard që gjenden në secilin tekst evropian mbi të drejtën kushtetuese. Ajo që nuk shkon dhe që është shumë gabim është se autorët tanë thonë se Kushtetuta e Vajmarit, ka qenë modeli për Kushtetutën e Vidovdanit, **Kushtetutën e Austrisë** (1920) dhe për **Kushtetutën e Polonisë** (1923). Kjo nuk është fare e vërtetë: me Kushtetutën e Vidovdanit dhe me Kushtetutën e Polonisë, Kushtetuta e Vajmarit nuk ka mund të ketë të përbashkët sepse, në rastin e fundit bëhet fjalë për një kushtetutë liberale që ka normuar një rend republikan me ndarje të pushteteve. Këtë nuk e kanë bërë Kushtetuta e Vidovdanit dhe Kushtetuta Polonisë. Këto dy kushtetuta kanë normuar një rend morarkik parlamentar kushtetues, ku nuk ka pasur ndarje të pushtetit, as në praktikë e as në teori. Ngjashmëria e Kushtetutës së Vajmarit me Kushtetutën e Austrisë është e madhe sepse në dy rastet bëhet fjalë për sistem liberal demokratik, ku ndarja e pushteteve bën pjesë në postulatet kryesore të sistemit qeverisës. E vërteta është pra se Kushtetuta e Vajmarit nuk ka qenë model për kushtetutat si më sipër: vendet në të cilat ka shërbyer si model Kushtetuta e Vajmarit janë vendet baltike, kurse sistemi republikan i Spanjës së vitit 1931 ka qenë në tërësi i bazuar në modelin sovjetik. Në tërësinë e tyre, kushtetutat e Evropës mes dy luftërave kanë reflektuar kombinimin e ideologjive liberale dhe nacionaliste me vetëvendosjen mbretërore si dominante. Këto gjëra është dashur autorët tanë t'ia prezantojnë studentit dhe lexuesit, siç bën autori turk **Levent Gönenç** dhe të gjithë autorët e tjerë seriozë të së drejtës kushtetuese dhe të historisë së saj. E kam fjalën për fq. 72-76 të librit të sipërcituar të autorit turk, ku bëhet fjalë për të gjitha vendet kryesore të Evropës mes dy luftërave botërore. Pse atëherë, autorët tanë bëjnë gabime të tilla?

Përgjigjen në pyetjen e tillë e gjejmë në llojin e literaturës që autorët tanë kanë konsultuar për trajtimin e zhvillimit të konstitucionalizmit evropian në periudhën mes dy luftërave botërore. Këtu nuk e kemi fjalën për literaturën e cituar, për qëllime tërësisht manipulative, në fusnotat nr. 109, 112, 112 dhe 114 të librit të autorëve tanë; fjala është për literaturën e cituar në fusnotën 110 dhe 116, përkatësisht për librin ***E drejta kushtetuese*** (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të KSAK: Prishtinë, 1967) të autorit të mirënjohur serb **Jovan Gjorgjeviq**. U mor vesh, këtu nuk bëhet fjalë për vërejtjet rreth mënyrës së gabuar të citimit: autorët tanë në këto dy fusnota citojnë të njëjtin autor dhe të njëjtin libër në mënyrë të plotë. Kjo metodologji citimi është papranueshme profesionalisht për çdo nivel studimi e hulumtimi shkencor, arkaike dhe cenuese e secilës metodologji shkencore. Para se të kalojmë në sqarimin për lexuesin tonë të qasjes së autorit serb si më sipër, t'i kthehemi pak këtu manipulimit të literaturës nga autorët tanë në këtë seksion të këtij kapitulli.

Fusnota nr. 109 tek autorët tanë nuk ka autor, as vend e shtëpi botimi. Mbi të gjitha nuk ka as datë dhe uebfaqe apo ndonjë shenjë se ku mund të gjendet. Një hulumtim i përciptë me fjalët kyçe për burimin e kësaj fusnote, në makinën e kërkimit Google, menjëherë del se fjala është për një platformë për ligjërim të temës që ka të bëjë me Gjermaninë e Vajmarit dhe krejt çka lidhet me demokracinë e asaj kohe, pa ndonjë përmbajtje të veçantë. Kjo do të thotë, pra, se fjala është për burim të qasshëm për çdokënd pa ndonjë përmbajtje pos me qëllim që të shërbejë si një udhëzues për Gjermaninë e Vajmarit dhe mënyrën e sundimit të saj.

Manipulimi i radhës, qesharak, brutal dhe arkaik deri në fund kryhet në fusnotën nr. 112 të autorëve tanë: fjala është për një temë të një kandidati për nivelin BA, **Daniel Hefflebower**, me titull ***The* Präsidialregierung*, 1930–1933: The Executive Branch of the Weimar Government and the Dismantling of the Republic***, e mbrojtur më datën 20 prill të vitit 2010, në Universitetin Miçigan të SHBA-së, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, nën mbikëqyrjen e **Johannes von Moltke**-s. Autorët tanë në fusnotën 112 e citojnë fq. 2 të këtij burimi për të dëshmuar rolin e fortë të presidentit sipas Kushtetutës së Vajmarit, në ndërkohë që fq. 2 nuk bën fjalë për asgjë tjetër pos për hyrjen në temë dhe paraqitjen fillestare lexuesit të materies që pason. Autorët tanë më mirë do kishin bërë ta kishin studiuar si duhet këtë temë jo edhe aq voluminoze (61 fq. gjithsej), sepse do të kishin kuptuar si duhet sfondin historik të zhvillimit të konstitucionalizmit gjerman dhe vendin e tij në truallin evropian.

Manipulimi i literaturës në këtë seksion mbaron me burimin e cituar në fusnotën nr. 114 dhe nuk ka ndonjë arsye pse lexuesi ynë duhet të dijë më shumë për të sepse fare lehtë mund ta vërejë që ka shpërputhje të mëdha mes titullit të burimit të cituar dhe fjalisë së prodhuar të cilën burimi i fusnotës mëton ta arsyetojë (sic!). Për të qenë e keqja edhe më e madhe, autorët tanë citojnë fq. e burimit, në ndërkohë që ai në internet gjendet i pasistematizuar në fq. dhe mund të citohet vetëm si vegëz, asnjëherë si faqe. Kjo metodologji nuk besoj se njihet në ndonjë vend tjetër, por këtu te autorët tanë: të citosh sipas dëshirës dhe tekeve burimet e caktuara, të cilat më pastaj mund t'i dish vetëm ti dhe askush tjetër se ku gjenden ato. T'i kthehemi tani rastit të autorit serb.

Në vijim të diskutimit tonë si më sipër, vlen të thuhet se **Jovan Gjorgjeviq**, ka qenë ndër kolosët e teorisë dhe praktikës kushtetuese në truallin ish-jugosllav. Trajtimi që i ka bërë zhvillimit të konstitucionalizmit evropian në mes dy luftërave botërore është një trajtim tipik ideologjik nga këndi i metodologjisë së a.q. materializmi dialektik dhe historik, i cili ka qenë cilësi që ka dalluar vendet ish-komuniste nga vendet jokomuniste të Evropës dhe më gjerë. Kjo metodologji komuniste, e përdorur nga autori serb, përbën arsyen që barazon kushtetutat evropiane mes dy luftërave botërore me kushtetutat borgjeze dhe liberale që kultivojnë ndarjen e pushtetit. Ndarja e pushtetit, ndërkaq, për kohën komuniste është konsideruar si një dukuri e shëmtuar dhe e kundërt me pikëpamjet materialiste-dialektike mbi botën. Kjo, megjithatë, nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë e vërtetë. Kështu ta zëmë, Kushtetuta e Vidovdanit në kapitullin IV ["Pushtetet Shtetërore"] ka rregulluar natyrën, formën dhe mënyrën e ushtrimit të pushtetit në shtetin e fundit të sllavëve të jugut (përveç Bullgarisë). Nenet e saj 46 & 47 në mënyrë të qartë e thonë se pushteti legjislativ dhe ekzekutiv i ka takuar mbretit dhe është ushtruar nga ana e tij përmes parlamentit përkatësisht ministrave përgjegjës. Pushteti gjyqësor ka qenë i vetmi që është proklamuar me kushtetutë si i pavarur dhe është ushtruar në emër të mbretit. Afërsisht dispozita të njëjta kanë pasur edhe në kushtetutat e vendeve si Polonia, Çekosllovakia, Rumania, Shqipëria dhe kështu me radhë. Këtu nuk hyjnë kushtetutat e Austrisë dhe të vendeve baltike, të cilat janë modeluar apo ndikuar fuqishëm nga Kushtetuta e Vajmarit. Me fjalë të tjera, pikëpamja e autorit serb **Jovan Gjorgjeviq**, që barazon kushtetutat borgjeze me demokracinë kushtetuese, liberalizmin, sundimin e ligjit dhe me ndarjen e pushtetit është tërësisht e gabuar. Këtë mund ta konstatojë lexuesi ynë fare lehtë: në internet gjenden të gjitha kushtetutat

e vendeve evropiane si më sipër. Nëse autorit serb edhe mund t'i falet një gabim i tillë, pra që barazon kushtetutat borgjeze me shtetin liberal ku sundon ndarja dhe balancimi i pushteteve, një gabim i tillë nuk mund t'u falet autorëve tanë dhe askujt tjetër që jeton dhe punon në kohën tonë; qasja në burime të dijës sot është e pafund dhe e pakufizuar. Kjo përbën një privilegj të gjeneratës sonë dhe kohës në të cilën jetojmë. Mëkat për ata që nuk e shfrytëzojnë si duhet.

KAPITULLI III.
BURIMET E SË DREJTËS KUSHTETUESE (FQ. 67–92)

Përgjithësisht

Ky kapitull ka gjithsej 11 seksione. Në secilën prej tyre vërehet qasja e njëjtë si në kapituj pararendës: manipulim literature dhe përmbledhje eklektike e teksteve të autorëve të tjerë, pa përpunim adekuat të tyre duke i futur në përdorim në mënyrë arbitrare dhe në vende që fare nuk kanë të bëjnë me titullin e seksionit respektiv. Kjo qasje metodologjike ka rezultuar në ndërtimin e një narracioni tërësisht kaotik në të shumtën e tekstit, ashtu që vetëm autorët tanë mund ta dinë se çfarë kanë pasur parasysh. Jo vetëm kaq, për të qenë e keqja më e madhe, disa koncepte e tema, tradicionalisht standarde në përmbajtjen e tyre, të autorët tanë paraqiten si të paqarta dhe tërësisht konfuze. E kemi fjalë këtu për kuptimin e burimeve dhe kategoritë e burimeve të së drejtës, përfshirë të drejtën kushtetuese.

Manipulimi i literaturës këtu ndjek rrugën e njëjtë: citim i autorëve vendorë dhe të huaj në tekste dhe vende që nuk kanë asnjë lidhje organike dhe strukturore me tekstin apo tematikën që autorët tanë kanë marrë përsipër për ta trajtuar në seksionet relevante. Jo rrallë, ky manipulim konsiston në përdorimin e teksteve të autorëve të tjerë, ashtu siç janë cituar nga tjerët, jashtë kontekstit të temës së cilës i takojnë apo, që është edhe më keq, përdorim i fusnotave të cituara nga autorët e tjerë (kryesisht shqiptarë, si **Luan Omari** e **Aurela Anastasi**) vend e pa vend.

Të shohim në rreshtat në vijim si duket kjo gjendje e përshkruar si më sipër, përkatësisht kjo teknologji e shëmtuar e manipulimit me literaturë profesionale dhe narrativi fiktiv dhe i pakuptimtë që i qëndron mbrapa.

Analiza kritike

Në seksionin e parë, "Kuptimi i burimeve të së drejtës kushtetuese", studenti e lexuesi natyrshëm presin që të kuptojnë se çfarë nënkuptohet me burime të kësaj dege të së drejtës pozitive dhe cilat janë ato. Tre paragrafët e parë janë aq jologjike saqë nuk ka njeri që mund të kuptojë së çfarë në të vërtetë kanë dashur të thonë autorët tanë. As autori i këtyre rreshtave nuk e ka pasur të qartë, as kur e ka lexuar dhe as aktualisht. Për të gjetur një dalje, ky autor ka marrë në analizë tekstet e autorëve që autorët tanë i citojnë në mënyrë manipulative në fusnotat nr. 151 dhe 152 të tekstit që analizojmë: në fusnotën e parë citohen fq. 3-6 të librit "Parime dhe institucione të së drejtës publike" (Elena Gjika: Tiranë, 2007) të autorit **Luan Omari**, kurse në të dytën citohen faqja 36 e librit ***E drejta kushtetuese*** (Fakulteti Juridik i UP: Prishtinë, 2004) të autorit të ndjerë **Kurtesh Saliu**. As njëri dhe as tjetri nuk flasin për gjëra që autorët tanë i citojnë si mbështetje të tekstit të tyre të pakuptimtë. Pas këtyre tre paragrafëve, studenti e lexuesi do të nisin të ndihen komodë nga definicioni i saktë i autorëve tanë për kuptimin e burimeve të së drejtës, i dhënë në paragrafin e fundit të fq. 66, të cilat definohen si "elemente, fakte ose akte, pavarësisht nga forma, që përmban rregulla të detyrueshme për një shoqëri të caktuar". Ky definicion, megjithatë, nuk është i autorëve tanë, por i autorëve shqiptarë **L. Omari** dhe **A. Anastasi**, i dhënë në librin e tyre ***E drejta kushtetuese*** (Shtëpia Botuese ABC: Tiranë, 2010). Menjëherë pas këtij definicioni të huazuar, por me shumë përmbajtje të përmbledhur, pason manipulimi brutal i literaturës dhe konstatimi i pavend dhe i paqenë i autorëve tanë: me kalimin e kohës, thonë autorët tanë, burimet e së drejtës kanë marrë formën e caktuar dhe, sipas tyre, në këtë proces natyrisht rol të rëndësishëm ka luajtur fuqia e shtetit për të bërë të drejtën. Në ndërkohë që pjesa e dytë e kësaj fjalie përbën një gjë të ditur që mendja e shëndoshë e absorbon pa pasur nevojë për sqarim shtesë, pjesa e parë e fjalisë ngelet kontestuese deri në fund: më kalimin e kohës, siç u pa, e thonë autorët tanë, burimet kanë marrë një formë të caktuar (por nuk tregojnë se për çfarë forme bëhet fjalë). Për këtë konstatim të çuditshëm citojnë fq. 42 të librit ***E drejta kushtetuese*** të autorit italian **Temistocle Martines** (UET Press: Tiranë, 2011). Faqet 41-44 të këtij libri flasin krejt për diçka tjetër: duke ndjekur traditën franceze, autori italian flet për llojet e burimeve primare, që njihen si burimet e prodhimit të normave dhe akteve të tjera juridike. Mirëpo, ky autor flet për burimet e së drejtës kushtetuese italiane

dhe asgjë tjetër. Autori nuk jep asnjë krahasim me të drejtat e tjera. Jo vetëm kaq: në këtë seksion, të cilin autorët tanë e citojnë gjoja si fq.42, autori italian flet për burimet mbi prodhimin (e së drejtës) në sistemin italian (sic!). Lexuesit dhe studentit nuk besoj që u intereson diskutimi ynë më tutje rreth këtij kategorizimi. Mjafton të thuhet këtu se "burime prodhimi" të së drejtës është shprehja që shënojnë mjetet teknike që krijohen apo njihen nga sistemi për prodhimin e së drejtës objektive (sistemit normativ), kurse "burime mbi prodhimin" e së drejtës është shprehja që përcakton burimin e normave mbi organet dhe procedurat e formimit të së drejtës. Më gjysmën e dytë të shekullit XX, kushtetutat, si pasojë e dominimit të parimit të kushtetutshmërisë, shërbejnë si burim i burimeve, kurse ligji dhe parimi i legalitetit vetëm si burim mbi prodhimin e sistemit normativ inferior. Këto dallime dhe këtë qasje e gjejmë te autori francez **Louis Favoreu**, më me renome nga të gjithë autorët evropianë, i cili së bashku me një grup autorësh të tjerë (P. Gaia, R. Ghevontian, Jean-Loise Mestre, O. Pfersmann, A. Roux & G. Scoffoni) i ka shprehur në librin monumental ***Droit constitutionnel***, botimi i 19-të (Dalloz: Paris, 2017, fq. 159-170).

T'i kthehemi tani paragrafëve të tjerë të autorëve tanë, të shkruar në këtë seksion. Në dy paragrafët e tyre të fundit, autorët tanë japin vetëm një gjë të saktë: dallimin mes burimeve formale dhe materiale të së drejtës kushtetuese. Pas këtij dallimi të saktë, autorët tanë sërish rrëshqasin në gabim skandaloz, duke manipuluar një autor tjetër. E kemi fjalën për fq. 15 të librit të sipërcekur të autorëve shqiptarë **L. Omari** & **A. Anastasi**. Skandali i autorëve tanë konsiston në moskuptimin e tërësishëm të përmbajtjes së nocionit "burime materiale" të së drejtës kushtetuese, duke abuzuar me autorët e sipërcekur shqiptarë. Autorët tanë thonë kështu në fq. 68: "Në anën tjetër burimet materiale janë burime fakte, dhe identifikohen si fakte ose sjellje të caktuara që kanë krijuar rregulla të sjelljes si pasojë e përsëritjes për një kohë të gjatë". Ky definicion, në tërësi i pakuptueshëm për çdokënd, sipas autorëve tanë gjendet në fq. 15 të librit si më sipër të autorëve **L. Omari** & **A. Anastasi**. Kjo, megjithatë, fare nuk është kështu. Autorët shqiptarë në fq. 14-15, japin një pasqyrë të shkurtër kuptimore për kuptimin dhe llojet e burimeve të së drejtës, përfshirë këtu edhe burimet e së drejtës kushtetuese. Pasi japin definicionin e shkëlqyer të burimeve të së drejtës, që e cekëm më sipër, autorët shqiptarë konstatojnë se dallimi kryesor i burimeve të së drejtës është në burime në kuptimin formal dhe burime në kuptimin material. Burimet në kuptimin formal ndryshe njihen

edhe si burime-akte, kurse burimet në kuptimin material ndryshe njihen edhe si burime-fakte. Burimet formale janë aktet juridike në fuqi, me rëndësi të përgjithshme, të cilat paraqiten në formë të shkruar dhe shërbejnë për të rregulluar marrëdhëniet në fushën kushtetuese (**L. Omari** & **A. Anastasi**, fq. 15), kurse burime materiale të së drejtës kushtetuese konsistojnë në sjellje e faktorë objektivë, të cilët kushtëzojnë prodhimin e normave të së drejtës kushtetuese (**L. Omari** & **A. Anastasi**, fq. 17). Nga ajo që u pa, autorët tanë ngatërrojnë krijimin e normave kushtetuese përmes sjelljes së përsëritur për një kohë të gjatë, e që quhet zakon kushtetues, me burimet formale të së drejtës kushtetuese. Thënë me fjalë të tjera, autorët tanë ngatërrojnë burimet e prodhimit të normave dhe akteve të tjera juridike me burimet mbi prodhimin e normave dhe akteve të tjera të ***Droit constitutionnel***. Në ndërkohë që burimet mbi prodhimin e normave mund të jenë formale (akte) dhe joformale (fakte apo rrethana objektive), burimet e prodhimi të normave janë çdoherë vetëm akte që kanë një formë (p.sh. akti mbi shpalljen e pavarësisë, kushtetuta, ligji dhe kështu me radhë). Objekti material i të drejtës kushtetuese, që mund të gjendet edhe jashtë akteve juridike formale, përbën një gjë tjetër nga burimet materiale të së drejtës kushtetuese si degë pozitive. Në rastin e fundit flitet për sjellje a faktorë objektivë që kushtëzojnë lindjen e normave të së drejtës, kurse në aspektin formal një akt mund të jetë kushtetutë, por të ketë për objekt rregullimin e materies jokushtetuese; i tillë është rasti, ta zëmë, me dispozitat kushtetuese nëpër kushtetutat moderne që normojnë çështje që nuk kanë natyrë kushtetuese (si p.sh. pjesët e caktuara të heraldikës së një vendi, ndalimi i konvertimit të dhunshëm, mbajtja e armëve etj.), apo me disa kushtetuta të cilat, në të kaluarën, kanë pasur dispozita që kanë ndaluar therjen e kafshëve sipas traditës hebraike (me ritual). I tillë ka qenë rasti me **Kushtetutën e Zvicrës** të vitit 1893, e cila ka ndryshuar këtë rregull në vitin 1973, apo me **Kushtetutën e Greqisë** deri në vitin 1978, kur ka ndryshuar kjo rregull. Apo anasjelltas: ka raste kur kushtetutat nuk kanë rregulla që normojnë materien kushtetuese, siç janë zgjedhjet për deputet, duke lënë këtë materie për rregullim me një ligj të veçantë organik (**Franca**).

Në vijim të gabimeve si më sipër, seksioni i dytë me titull "Burimet formale" përmban manipulime të literaturës dhe lëshime serioze profesionale. Në fillim, në paragrafin e parë, në fjalinë e mesit, japin definicionin e burimeve formale: në mënyrë të përçartë flasin për definimin e burimeve formale, duke shfytyruar në tërësi definicionin elokuent të autorëve

shqiptarë **L. Omari** e **A. Anastasi**, të dhënë në fq. 15-16 të librit të sipërcekur. Autorët tanë, këtë burim shqiptar e citojnë në fusnotën nr. 155, mirëpo në realitet fjala është për dallime substanciale. Pse? Sepse definicioni i autorëve shqiptarë është i plotë dhe në linjë me definicionet që i bëjnë autorët e sipërcekur francezë e italianë, por edhe çdo autor tjetër serioz i së drejtës. Studenti e lexuesi ynë do ta ketë problem serioz për të kuptuar se çfarë, në të vërtetë, përbën burim formal të së drejtës kushtetuese. Për ta kuptuar këtë, studenti e lexuesi ynë më mirë të konsultojë burimet origjinale të cilat i citojnë autorët tanë, në mënyrë të deformuar, në fusnotat 155 dhe 156. Nga këto burime shqiptare, si dhe nga çdo burim tjetër nga teoria kushtetuese, lexuesi mund të gjejë se burimi formal ka të bëjë me përcaktimin e vendit të proceseve formale që ngërthejnë përbërjet (strukturat) e caktuara normative kurse burimi material lidhet me proceset shoqërore që shkaktojnë lindjen e përbërjeve (strukturave) të tilla të caktuara normative.

Menjëherë pas kësaj, autorët tanë nisin klasifikimin e burimeve formale sipas karakteristikave të tyre, siç janë forma e shkruar e tyre, miratimi sipas një procedure të caktuar, normimi i materies kushtetuese dhe fuqia më e lartë e tyre. Autorët tanë e harrojnë në këtë kategorizim një cilësi themelore të burimeve formale, e që konsistojnë në atë se kushtetuta si burim prodhimi dhe burim mbi prodhimin, përkatësisht si burim i burimeve (**Louis Favoreu** et al., fq, 159) përcakton jo vetëm procedurën, subjektin dhe objektin e burimit kushtetues por edhe vetë përmbajtjen e burimit. Këtë e bën, ta zëmë, përmes ndalimit të diskriminimit apo duke vënë parametrat e dispozitave mbi liritë dhe të drejtat e njeriut si bazë për kushtetutshmërinë e ligjit (**L. Favoreu** et al, fq. 161).

Ky kategorizim i autorëve tanë përfundon në një gabim tjetër trashanik të listimit në kuadër të burimeve formale kategorinë tautologjike dhe emëruesin e përbashkët të burimeve formale si dhe materiale të së drejtës kushtetuese. E kemi fjalën për të a.q. aktet kushtetuese: në fq. 69, autorët tanë i definojnë aktet kushtetuese si "ato akte që kanë fuqinë më të lartë juridike dhe janë miratuar nga një organ më i lartë". Kjo fjali tërësisht tautologjike, e cila nuk gjendet si definicion te asnjë autor tjetër serioz mbi të drejtën kushtetuese, mëton të krijon një burim formal të së drejtës nga diçka që përbën emëruesin e përbashkët të të gjitha burimeve formale të së drejtës kushtetuese. Çdo akt që normon materien kushtetuese paraqet një akt kushtetues, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Mbi këtë bazë mund të bëhet, dhe zakonisht bëhet, kategorizimi burimeve for-

male të së drejtës kushtetuese, pra si burime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të së drejtës kushtetuese. Paralel me këtë kategorizim vlen kategorizimi tjetër klasik i burimeve, përkatësisht kategorizimi në burime primare dhe sekondare të së drejtës kushtetuese.

Çka kanë pasur parasysh autorët tanë kur kanë futur në kategorinë e parë të burimeve formale të a.q. aktet kushtetuese? Këtë vështirë se mund ta dijë autori i këtyre rreshtave dhe, besoj shumë, as studentët e lexuesit e librit. Autorët tanë në fusnotën nr. 157 si burime të këtij prioritizimi të a.q. akteve kushtetuese në vend të parë dhe si kategori e veçantë përmendin librat e sipërcekur të autorëve **L. Omari** & **A. Anastasi**, **K. Saliu**, **Temistocle Martines** dhe **Louis Favoreu**. Asnjëri nga këta autorët në librat e sipërcekura nuk përmend aktet kushtetuese si burime të veçanta të së drejtës kushtetuese, e aq më pak t'iu akordojë të a.q. akte kushtetuese vendin e parë në kuadër të burimeve formale (sic!). Jo vetëm kaq: autorët tanë, gënjejnë dhe thonë, në fusnotën nr. 158 dhe tekstin e prodhuar që e shoqëron këtë fusnotë, se i njëjti burim dhe kategorizim ekziston edhe në sistemin amerikan. Në mbështetje të këtij konstatimi absurd, autorët tanë citojnë, në po atë fusnotë, librin ***American Constitutional Law***, vol. I, të autorëve Otis H. Stephen, Jr., John M. Scheb II & Colin Glennon, botuar nga Cengage Learning (SHBA) në vitet 2015, 2012 dhe 2008. Autorët tanë i referohen botimit të katërt të këtij libri, fq. 19-30. Kur shikohen fq. në fjalë, qartë shihet se fjala është për manipulim brutal të literaturës sepse në ato fq. autorët e respektuar amerikanë flasin për krejt diçka tjetër: në seksionin me titull "Enduring Constitution", fq. 20, si pjesë e kapitullit të parë me titull "An Introduction to the U.S. Constitution", bëhet fjalë për demokracinë kushtetuese amerikane, për artin e interpretimit kushtetues, për marrëdhënien mes kushtetutës dhe pushtetit dhe, në fund, për ***Letrat e Federalistit*** nr. 10, 47 dhe 51. Pra, asnjë fjalë për burimet e së drejtës kushtetuese në **SHBA**. Kjo është krejt e kuptueshme nëse kihet parasysh se vëllimi I i këtij libri titullohet "Sources of Power and Restraint".

Manipulimi i fundit i literaturës nga autorët tanë, gjithnjë në kontekst të a.q. akte kushtetuese si burime të së drejtës, haset në fusnotën nr. 159, ku përmendet **Traktati i Lisbonës,** si pjesë e këtij lloji të çuditshëm të burimeve formale të së drejtës kushtetuese me fuqi superiore të pakontestueshme. Në këtë fusnotë thuhet se një mendim të njëjtë me autorët tanë e ka shprehur edhe autori italian **Temistocle Martines** në librin e tij të sipërcekur, të përkthyer në shqip, mbi të drejtën kushtetuese. Në fq. 99-103 të librit ***E drejta kushtetuese***, të cilat autorët tani i citojnë, megjithatë, qartë

del se autori italian as që ka bërë fjalë për **Traktatin e Lisbonës**, e as për ndonjë aspekt tjetër që ngjason me trajtimin e autorëve tanë.

Pas këtij akrobacioni, autorët ndërtojnë një narracion të pranueshëm sa i përket kushtetutës, ligjeve kushtetuese, amendamentit kushtetues dhe burimeve të tjera formale të së drejtës kushtetuese. Manipulimi i literaturës vërehet sërish në fusnotat nr. 161 dhe 162, për çka këtu nuk ka shumë rëndësi të ndalemi. Më me vend e shohim të ndalemi në gabimet thelbësore në këtë pjesë, ku autorët tanë konstatojnë në fq. 70-71 të librit të tyre se Mali i Zi paska pasur ligj kushtetues pas shpalljes së pavarësisë, se **Ligji Themelor i Gjermanisë** qenka për nga forma dhe emërtimi një ligj kushtetues dhe, në fund, se Kosova gjatë kohës së administrimit të **UNMIK**-ut paska pasur një ligj kushtetues. Nga historia kushtetuese e Malit të Zi nuk del një gjë e tillë, përkatësisht se ky vend ka pasur çdoherë kushtetutë të plotë që nga koha e ish-Jugosllavisë e deri më sot. Këtë e sqaron shumë bukur doajeni i të drejtës kushtetuese malazeze, **Mijat Suković**, në një shkrim të tij me titull "Tri različita ustavna uređenja Crne Gore: Od razbijanja šestočlane jugoslovenske federacije (1992.) do sada (2009.)", botuar në *Revus: Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava* (nr. 11/2009, Lublanë, fq. 9-43). Për çudi, në fq. 72, vetë autorët e librit flasin për **Kushtetutën e Malit të Zi**, duke harruar se çfarë kanë thënë më herët (sic!). Këtë herë, në fakt, si mbështetje për konstatimin e tyre të kundërt me të parin përdorin një mendim të Komisionit të Venecias. Këtë e bëjnë në fusnotën nr. 167, u mor vesh, krejtësisht në mënyrë manipulative. Këtu manipulimi është si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Në formë, mendimi i cituar i **Komisionit të Venecias** nuk është i datës 24 maj 2011, me nr. 626/2011, CDL-REF (2011) 033, siç e thonë autorët tanë, por i datës 17 qershor 2011 dhe me nr. 626/2011, CDL-AD (2011) 010. Për më tepër, autorët tanë udhëzojnë lexuesin që të konsultojnë teknikat e inkorporimit të amendamenteve kushtetuese në Malin e Zi, përmes shfletimit në internet të mendimit si më sipër, i cili mban një titull krejt tjetër nga ai që citohet në fusnotën nr. 167, dhe është si vijon: "**Opinion on the Draft Amendments to the Constitution of Montenegro, as well as on the Draft Amendments to the Law on Courts, the Law on the State Prosecutor's Office and the Law on the Judicial Council of Montenegro**". Ajo çka ka rëndësi, megjithatë, nuk lidhet me formën e gabuar por me përmbajtjen e këtij mendimi: në asnjë paragraf të tij nuk flitet për teknikat e inkorporimit të amendamenteve kushtetuese në **Mal të Zi**, siç e udhëzojnë autorët tanë lexuesin e tyre. Kjo, shihet qartë, përbën një manipulim të literaturës

dhe mashtrim të lexuesit.

Sa i përket natyrës juridike të **Ligjit Themelor të Gjermanisë**, pas unifikimit të saj, besoj se pakkush, veç autorëve tanë, ka ndonjë dyshim për atë nëse ky instrument përbën kushtetutën e këtij vendi. Sa i përket Kosovës, autorët konstatojnë se "Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme" e vitit 2001 (më tej shkurt: "Korniza Kushtetuese" ose vetëm "Korniza") "ka qenë një akt (ligj i përkohshëm) kushtetuese, por që për arsye politike ky emërtim nuk është përdorur". Këtë mendim të lirë, të cilin nuk mund ta përdorin asnjëherë ata që pretendojnë prodhimin e një libri profesional e me standarde shkencore, autorët e bazojnë në përvojën personale të autorit të parë të librit, Arsim Bajrami, si pjesëmarrës në grupin hartues të këtij instrumenti juridik (të cilin autorët e cilësojnë në fusnotën nr. 163 si një akt kushtetues). Kjo në tërësi është gabim, por edhe gabim i pafalshëm, dhe atë për disa arsye.

Në rend të parë, duhet pasur parasysh se nuk mund të flitet për dokumente të natyrës kushtetuese në kushtet e administrimit ndërkombëtar; çdo dokument juridik i nxjerrë në kuadër të këtij administrimi, në vijim të zbatimit të **Rezolutës 1244** të KS të OKB-së (1999), ka pasur natyrën e rregullores. Kjo vlen edhe për Kornizën Kushtetuese. Vetë esenca e administrimit i përket sferës së kundërt me qeverisjen: deri sa njerëzit qeverisen, sendet janë ato që administrohen. Kjo ka qenë situata me Kosovën gjatë administrimit ndërkombëtar: në aspektin juridik, me fjalë të tjera, Kosova ka qenë territor nën administrim ndërkombëtar ku banorët e saj nuk kanë pasur asnjë ndikim dhe rol në këtë administrim. Ky autoritet i administratës ndërkombëtare reflektohej, në aspektin formal, edhe në aktivitetin juridik të përfaqësuesit kryesor të këtij autoriteti, PSSP (Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm), në duart e të cilit ishin aktiviteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në tërësinë e tyre. Përveç kësaj, e dyta, kur studentit dhe lexuesit i ofrohet një tekst në emrin e shkencës dhe profesionit nuk guxon dhe nuk mund të përdoren hamendësimet e natyrës ekstra-profesionale dhe ekstra-shkencore, siç bëjnë autorët tanë kur konstatojnë, në fusnotën nr. 163, se për shkak të presionit dhe ndikimit ndërkombëtar Korniza Kushtetuese nuk është cilësuar si ligj kushtetues. Çdoherë rregullat e shkencës dhe profesionit kërkojnë qartësi e rreptësi të pamëshirshme në përshkrimin e objektit të studimit dhe trajtimit profesional. Me të njëjtën gjuhë dhe qasje të gabuar, autorët tanë flasin për anekset kushtetuese në kontekstin e vendeve si **Bosnjë-Hercegovina**, **Qiproja** dhe **Malajzia** (fq. 73), në ndërkohë që konstatimi i tyre për **Indinë**,

në të njëjtin vend, paraqitet i saktë.

Në rastin e **Bosnjë-Hercegovinës**, pa sqaruar se vetë kushtetuta e këtij vendi është aneks i Marrëveshjes së Dejtonit (1995), konstatojnë që anekset e kësaj kushtetuese kanë pasur natyrë të përkohshme. E vërteta është se nga dy anekset vetëm aneksi i dytë ka pasur natyrë të tillë, kurse aneksi i parë që ka të bëjë me instrumentet shtesë ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut që akoma zbatohen në tërë territorin e Bosnjë-Hercegovinës.

Në rastin e **Qipros**, marrëveshjet ndërkombëtare që përbëjnë aneks kushtetues kanë natyrë të përhershme, jo siç e thonë autorët tanë. Në rastin e Qipros, Marrëveshjet e **Londrës-Cyrihut** të gushtit 1959, kanë një ngjashmëri të jashtëzakonshme me rastin e **Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës,** të datës 2 shkurt 2007 (më tej shkurt **Plani Ahtisaari**): në aneksin e parë të këtyre marrëveshjeve, i titulluar "Struktura bazike e Republikës së Qipros", parashikohej nxjerrja e një kushtetute mbi bazën e parimeve dhe normave të këtij aneksi. Marrëveshjet, së bashku me **Kushtetutën e Qipros**, kanë hyrë në fuqi më 16 gusht 1960 dhe akoma kanë statusin e njëjtë. U mor vesh, Kushtetuta e Qipros është nxjerrë më vonë, si pjesë e detyrimit për vënien të Marrëveshjeve të Londrës–Cyrihut, pra, nuk ka qenë aneks i tyre, dhe është draftuar duke marrë parasysh në tërësi aneksin e parë si më sipër. Pra njëjtë si në rastin e Kosovës dhe aneksin e parë ("Dispozitat Kushtetuese") të **Planit Ahtisaari**. Ndryshe, **Kushtetuta e Qipros,** i ka 13 pjesë dhe 199 nene, me tri anekse që kanë fuqi kushtetuese dhe që përfshijnë në rend të parë Marrëveshjet e **Cyrihut** si dhe **Marrëveshjen mbi Garancitë** të vitit 1960. Statusi i tyre definohet në pjesën mbi dispozitat përfundimtare (pra jo në pjesën mbi dispozitat kalimtare, të cilat nuk ekzistojnë në këtë kushtetutë). Autori i këtyre rreshtave kështu e ka lexuar nenin 179 të Kushtetutës, përkatësisht pjesën mbi dispozitat kalimtare, për dallim nga autorët tanë. Kështu si autori i këtyre rreshtave mendon edhe njëri ndër autorët më të njohur për konstitucionalizmin qipriot dhe historinë e tij, **Georghios M. Pikis**, në librin e tij *Constitutionalism – Human Rights – Separation of Powers* (Marinus Nijhoff: Leiden/London, 2006).

Në rastin e **Malajzisë**, gabimet janë edhe më të dukshme: Kushtetuta e Malajzisë ka hyrë në fuqi me 27 gusht 1957, mirëpo, fitimi i pavarësisë të këtij vendi ka ndodhur vetëm më 31 gusht të po atij viti. Viti paraprak ka qenë vit i përgatitjeve për fitimin e pavarësisë nga britanikët, mbretëresha e të cilëve ua kishte premtuar. Për këtë qëllim u sajua një makineri kushte-

tuese për ta sjellë në fuqi kushtetutën e vendit, pra jo anasjelltas siç pohojnë autorët tanë kur thonë se Kushtetuta e këtij vendi ka pasur anekse. Ajo makineri përbëhej nga aktet dhe veprimet si vijon:

1. Në Britaninë e Madhe, **Ligji mbi Federatën e Malajas** i vitit 1957, së bashku me dekretet qeveritare të nxjerra në vijim të implementimit të tij – Ky ligj, i nxjerrë nga Parlamenti i Britanisë, i jepte dritën e gjelbër Mbretëreshës **Elizabeta II**, të drejtën për të ndërprerë sovranitetin dhe juridiksionin britanik ndaj provincave dhe shteteve që më vonë do të përbënin Federatën e Malajzisë.
2. **Marrëveshja për Federatën e Malajas** e vitit 1957, e bërë më datën 5 gusht 1957, në mestë Komisionerit të Lartë të Britanisë (në emër dhe për dobi të Mbretëreshës **Elizabeta II**) dhe Sundimtarëve të Malajit – Kjo marrëveshje ka përmbajtur **Kushtetutën e Federatës së Malajas** dhe kushtetutat e njësive të reja kryesore federative Penang dhe Melaka. Kjo teknikë juridike, sikundër shihet, është e kundërt me atë që thonë autorët tanë, pra fjala është për modelin e ngjashëm me atë të përdorur dekada më vonë në **Dejton** (nëntor 1995) për rregullimin kushtetues të Bosnjë-Hercegovinës;
3. Në nivel Federate, **Urdhri për Kushtetutën Federale** i vitit 1957, i nxjerrë më 27 gusht 1957, nga ana e Këshillit Legjislativ Federal të Federatës së Malajës – Ky organ është formuar sipas Marrëveshjes për Federatën e Malajës të vitit 1948 (pra, sipas marrëveshjes së parë ndërkombëtare për këtë vend). Kushtetutave të reja të njësive të reja federale Penang dhe Melkaka, si dhe Kushtetutës së Federatës iu njoh fuqia e ligjit suprem në tërë territorin e shtetit që sot njihet si Malajzi, pikërisht sipas këtij urdhri legjislativ, që më pastaj u sanksionua më akte juridike dhe rezoluta të njësive federale. **Kushtetuta e Malajzisë** së sotme, në vitin 1963, ka pësuar ndryshime të mëdha pas hyrjes në Federatë të disa vendeve, përfshirë **Singaporin**, por që këtu nuk çon peshë trajtimi i kësaj teme sepse tejkalon dukshëm caqet e analizës sonë të prodhimit të autorëve tanë.

Në vazhdën e diskutimit të tyre të burimeve formale të së drejtës, para se të rrëshqasin në terrenin e marrëveshjeve ndërkombëtare si burime dhe trajtimin e tyre krejtësisht me lajthitje, autorët tanë flasin për **ligjet organike** si burime të së drejtë kushtetuese. Për to përdorin njëkohësisht edhe shprehjen "ligje sistemike", si sinonim i ligjeve organike. Këtu bëjnë disa gabime themelore: së pari, sepse barazojnë ligjin organik me ligjin sistemik; së dyti, sepse nuk e kanë të qartë se çka kuptohet me ligj organik;

dhe, së fundi, sepse i cilësojnë si ligje organike në kontekstin kosovar ligjet nga neni 81.1 ["Legjislacioni me Interes Vital"] Kushtetutës.

Me ligje kushtetuese nënkuptohet lloji i veçantë i ligjeve me të cilat normohet në mënyrë të drejtpërdrejtë materia kushtetuese, kurse me ligje organike jo domosdo normohet materia kushtetuese: disa ligje kushtetuese janë edhe ligje organike, mirëpo, anasjelltas ky çdoherë nuk është rasti sepse mund të ketë ligje që janë kushtetuese e që nuk cilësohen si ligje organike. Në rastet kur ligjet kushtetuese kanë për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e kushtetutës ekzistuese, atëherë ato janë pjesë përbërëse e saj. Kur ky nuk është rasti, atëherë ligjet e tilla nuk mund të jenë kushtetuese, ani se mund të kenë një cilësim të tillë. Këtë e ka konstatuar me shumë të drejtë **Gjykata Kushtetuese e Kroacisë**, në një vendim të vetin që thotë se ligjet që rregullojnë mbrojtjen e komuniteteve nacionale, bashkëpunimin e Kroacisë me Gjykatën e Hagës për ish-Jugosllavi si dhe ligji për situatat kur presidenti nuk mund të veprojë për arsye objektive janë ligje organike, jo ligje kushtetuese siç thuhet në emërtimet e tyre. Këtë vendim e ka analizuar shumë bukur autori i njohur kroat **Smiljko Sokol** në veprën e tij *Ustavno pravo* (Narodne novine: Zagreb, 2009, fq. 17-18; në veçanti pjesa me titull "Ustavni pravo kao grana prava i njegovi izvori" diskuton këto çështje dhe këto dallime në sistemin kushtetues kroat, duke iu referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese). Me këtë vendim, kjo gjykatë e ka bërë të qartë se në rastin e ligjeve kushtetuese, materia kushtetuese është përcaktues parësor: me ligje kushtetuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ndryshohet dhe plotësohet kushtetuta ekzistuese, kurse me ligje organike nënkuptohet lloji i veçantë i ligjeve të cilat përmbajnë rregullat fundamentale kushtetuese mbi organizimin e pushtetit shtetëror dhe mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Me këto ligje, thënë ndryshe, nuk ndryshohet dhe plotësohet kushtetuta por caktohen rregullat fundamentale kushtetuese mbi organizimin e pushtetit shtetëror dhe mbi vendin dhe pozitën e komuniteteve pakicë në sistemin kushtetues. Në fakt, historikisht shikuar, ligjet organike kanë lindur për të vënë në jetë normat kushtetuese mbi organizimin e organeve të pushtetit, prandaj edhe quhen ligje organike sepse kanë normuar jetën dhe punën e organeve kryesore të pushtetit duke marrë parasysh kushtetutën si akt suprem. Në këtë kuptim, vetë kushtetuta, në esencë, paraqet një lloj të ligjit organik sepse ka të bëjë me rregullimin e shtetit si një strukturë organike (me subjektivitet të ndarë nga ata që punojnë në të dhe për të, siç e ka konstatuar dijetari gjerman **Rudolf von Jhering**).

Kategoria e ligjeve organike për herë të parë janë përmendur në **Francë** në **Republikën e Dytë** (1848), për t'u bërë standard me **Kushtetutën e Republikës së Katërt** (1946-1958). Më vonë, liritë dhe të drejtat e njeriut, kryesisht ato që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë u bënë pjesë normative e kushtetutave nacionale, krahas normave mbi rregullimin e shtetit si një strukturë organike me subjektivitet të ndarë nga ata që punojnë në të dhe për të. Pas kësaj kohe ka nisur historia e kushtetutave që kanë futur ligjet organike për të normuar në mënyrë fundamentale edhe liritë dhe të drejtat e njeriut, krahas organizimit të pushtetit publik. I tillë është rasti me **Spanjën** dhe **Kroacinë**. Ky autorizim për nxjerrjen e këtij lloji të ligjeve, me një shumicë të kualifikuar dhe më një procedurë të posaçme, buron nga kushtetuta dhe atë në mënyrë shprehimore. Pa pasur dispozita kushtetuese që në mënyrë shprehimore përcaktojnë materien që duhet të mbulohet me ligje organike nuk mund të ketë ligje të tilla, pa marrë parasysh se disa nga to mund të nxirren me shumicë të kualifikuar dhe me procedurë të posaçme dhe të vështirësuar. Është kushtetuta nacionale, me fjalë të tjera, ajo që autorizon nxjerrjen e ligjeve organike dhe definon materien të cilën e mbulojnë ligjet e tilla. Kështu është në **Francë**, **Kroaci**, **Spanjë, SHBA** dhe në shumë vende të tjera të botës (në veçanti ato që modelohen sipas sistemit francez, ku edhe ka lindur koncepti i ligjeve organike). Në **Shqipëri** nuk ka ligje organike, as në **Maqedoni**, siç pohojnë gabimisht autorët tanë. **Kosova** nuk bën përjashtim në këtë drejtim. Ligjet nga neni 81.1 i Kushtetutës si më sipër nuk janë ligje organike sepse si të tilla nuk autorizohen nga kushtetuta jonë, ani se materia që normohet me ligjet në fjalë është e natyrës së ligjeve organike. E njëjta vlen edhe për Ligjin nr. 03/L-21 për Gjykatën Kushtetuese, Ligjin nr. 03/L-199 për Gjykatat, Ligjin nr. 03/094 për Presidentin, ligjin (eventual) për qeverinë, për aktet normative, ushtrinë dhe kështu me radhë. Këto të fundit nuk janë të tilla, jo vetëm sepse nuk kanë autorizim e definim kushtetues por edhe për shkak se janë miratuar me një shumicë të thjeshtë, pra me procedurë të rregullt për miratimin e ligjeve. Këto ligje, eventualisht mund të quhen "ligje sistemike", të cilën shprehjen e përdorin autorët tanë si sinonim për ligjet organike, gjë që nuk është ashtu: emërtimi "ligje sistemike" i takon sistemit komunist dhe ka shënuar ato ligje që në mënyrë sistemike (gjithë përfshirëse) kanë rregulluar një materie, e cila zakonisht ka qenë kushtetuese vetëm tërthorazi. Kjo shprehje nuk përdoret aktualisht në sistemet kushtetuese të vendeve perëndimore.

Kjo që u tha më sipër thuhet nga autorët e huaj, jo nga unë, pra se ek-

ziston një histori e veçantë e lindjes së ligjeve organike në vendet si **Franca**, **Spanja**, **Kroacia** etj., se ato kanë natyrë që i dallon nga ligjet e tjera të zakonshme, dallim që bazohet ekskluzivisht në llojin e materies dhe procedurës kushtetuese për prodhimin e tyre dhe, mbi të gjitha, në kriterin që nxjerrja e tyre duhet të ketë një autorizim (përcaktim) shprehimor kushtetues. Si ilustrim japim vetëm disa nga autorët më të njohur, të cilët vendevende citohen edhe nga autorët tanë me qëllim manipulimi. E kemi fjalën për autorët si vijon: **Louis Favoreu** et. al, *Droit constitutionnel* (Dalloz: Paris, 2017, fq. 160-161); **Philippe Ardant** & **Bertrand Mathieu**, *Droit constitutionnel et institutions politiques* (LGDJ: Paris, 2016, fq. 72-73); **Olivier Duhamel** & **Guillaume Tusseau**, *Droit constitutionnel et institutions politique* (Seuil: Paris, 2013, fq. 293-294, 302-303 etj.); **Oliver Gohin**, *Droit constitutionnel* (Lexis Nexis: Paris, 2013, fq. 638-639, 980-981).

Rrëshqitja kah abisi i gabimeve themelore profesionale i autorëve tanë bëhet më akut në pjesën ku flasin për marrëveshjet ndërkombëtare si burim i së drejtë kushtetuese (fq. 75-76). Kjo pjesë ndahet në trajtimin mbi "aktet ndërkombëtare (instrumentet ndërkombëtare)" dhe "marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (traktatet ndërkombëtare)". Që në fillim, në mënyrë absurde, autorët tanë konstatojnë se "aktet ndërkombëtare (instrumentet ndërkombëtare) janë aktet të cilat garantojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe të cilat janë miratuar nga organizatat ndërkombëtare". Pasi listojnë një nga një por me hamendje, me fillim që nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, një sërë dokumentesh ndërkombëtare, autorët konstatojnë në mënyrë absurde se këto zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shumica e vendeve demokratike dhe se, këto akte, si të tilla, "nuk janë marrëveshje të ratifikuara por konventa të miratuara nga organizata e mekanizma ndërkombëtare, të cilat bëhen pjesë e një rendi juridik, në një shtet të caktuar sipas procedurave të ratifikimit dhe zakonisht i obligojnë të gjitha shtetet në mënyrë kolektive". Nuk duhet të jetë njeriu jurist për të kuptuar absurdin dhe pakuptimësinë e kësaj fjalie dhe këtij konstatimi: konventat e marrëveshjet e miratuara nga organizatat ndërkombëtare, të cilat i obligojnë shtetet kolektivisht, herë ratifikohen e herë nuk ratifikohen (sic!). Nëntitulli në vijim "marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (traktatet ndërkombëtare)" sikur do të ndahet nga pararendësi, duke e cilësuar këtë nëntitull si trajtim i statusit të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në rendin kushtetues nacional, përfshirë këtu Kosovën. Në paragrafin e parafundit (fq. 75), autorët mendojnë se **Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve** (1969), nor-

mon statusin e traktateve në rendin e brendshëm, pra, jo kushtetuta nacionale (sic!).

Lidhur me statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërkaq, autorët tanë japin një pasqyrë krahasuese dhe konstatojnë vetëm dy sisteme: ai i vendeve si Holanda, ku marrëveshjet ndërkombëtare kanë epërsi absolute dhe vendet e tjera (të pacaktuara nga autorët tanë) ku marrëveshjet ndërkombëtare kanë statusin e ligjit të zakonshëm. Kjo, në fakt, nuk është e saktë sepse ekziston edhe një grup i madh i vendeve, ku hyn edhe Kosova, në të cilat marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare kanë fuqinë më të madhe se ligji i zakonshëm e më të ulët se kushtetuta nacionale. Kështu thotë neni 19.1 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës. Kategorizimin si më sipër të statusit të marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm, autorët tanë e bazojnë në fq. 50-53 të librit *E drejta kushtetuese* (Shtëpia Botuese ABC: Tiranë, 2010) të autorëve shqiptar **L. Omari** & **A. Anastasi**. Në fq. në fjalë, lexuesi mund të gjejë krejt diçka tjetër. Seksioni nr. 4 flet në aspektin krahasimor për kushtetuta dhe të drejtën ndërkombëtare, dhe pasohet me seksionet nr. 5-8 që flasin për statusin e së drejtës ndërkombëtare në sistemin kushtetues shqiptar. Sikur autorët tanë të kishin lexuar me kujdes fq. 50-53, do të kishin gjetur një trajtim të hollë të statusit të së drejtës ndërkombëtare, të marrëveshjeve ndërkombëtare në veçanti, në vendet ish-komuniste dhe dallimin e tyre me vendet perëndimore. Aty do të gjenin se **Kosova**, së bashku me krejt vendet ish-komuniste, përfshirë **Shqipërinë**, i japin një status mbi ligjin e zakonshëm dhe nën kushtetutën secilit traktat të ratifikuar ndërkombëtar. Përveç kësaj, do të zbulonin edhe shumë gjëra që kanë të bëjnë me statusin e së drejtës ndërkombëtare juridikisht të detyrueshme në vendet e ndryshme të botës, përfshirë **Shqipërinë** dhe kështu me radhë.

Para se të kalojmë të pjesa mbi burimet materiale të së drejtës kushtetuese (fq. 79-82), vlen të theksohet se trajtimet e autorëve tanë të burimeve të tjera të së drejtës kushtetuese (rregulloret e organeve përfaqësuese, dekretet e presidentit) shoqërohet me trajtime e definicione themelore në mënyrë të përsëritur të burimeve formale të së drejtës kushtetuese, kurse për vendimet dhe interpretimet e gjykatave kushtetuese konstatojnë, pa cituar asnjë burim, se hyjnë në fuqi menjëherë dhe vlejnë në tërë territorin e një vendi si burime formale. Autorët bëjnë gabim sepse hyrja në fuqi e vendimeve të gjykatave kushtetuese ka modalitete e forma nga më të nduarnduartat. Ka raste kur vërtet vendimi hyn në fuqi menjëherë, dhe për këtë vendos vetë gjykata, siç ndodh në Kosovë dhe për këtë ka autorizim ligjor

shprehimor; ka vende ku vendimet hyjnë në fuqi një kohë të caktuar pas nxjerrjes së tyre dhe pritet derisa organi i dhënë të vendos sipas udhëzimeve të gjykatës, dhe kështu me radhë. Ajo çka këtu bie në sy është konstatimi tjetër, që edhe më shumë reflekton mosnjohjen themelore të autorëve tanë të koncepteve siç janë efekti ***erga omnes*** i vendimeve të gjykatave kushtetuese dhe precedentëve të tyre. Për këtë citojnë fq. 283 të autorit **Visari Morina** dhe shkrimin e tij "Aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës – roli i precedentit dhe fushëveprimi i nenit 116.1 të Kushtetutës së Kosovës" (revista ***E drejta/Law***, nr. 1/2013, fq. 283-296, Fakulteti Juridik i UP-së). Ky citim fiktiv, manipulues deri në fund, vetëm sa tregon për mosnjohjen dhe ngatërrimin e konceptit ***erga omnes*** të vendimeve me rolin dhe rëndësinë e precedentit në gjyqësinë kushtetuese: autori V. Morina në mënyrë thuajse shteruese flet për dallimet mes efekteve ***inter partes***, efekteve ***erga omnes*** dhe efekteve të tjera të vendimeve. Vlen të theksohet se aktualisht ekziston një standard sipas të cilit në sistemin kontinental precedenti mund të ndryshojë me një vendim tjetër të gjykatës kushtetuese apo me amendament kushtetues, përkatësisht se vetë gjykata kushtetuese jo domosdo është e lidhur me vendimin e vet pararendës në vendimmarrjen tjetër të ngjashme në të ardhmen. E njëjta vlen edhe për përfaqësuesin e sovranit: ai çdoherë mund ta ndryshojë me amendament kushtetues një vendim të gjykatës kushtetuese, gjithnjë me supozim që vendimi i përfaqësuesit të sovranit nuk rrënon parimet themelore kushtetuese. Kjo ndryshe njihet edhe teoria dhe praktika mbi **amendamentet kushtetuese jokushtetuese**, të cilën autorët tanë e diskutojnë në tekstin me fusnotën nr. 168. Në këtë vend, autorët tanë flasin për këtë fenomen, pra për teorinë dhe praktikën sipas së cilës në disa vende nuk lejohet ndryshimi i parimeve themelore kushtetuese të cilat prekin themelet e sistemit kushtetues dhe identitetin nacional. Në kontekstin kosovar, sipas autorëve tanë, **Gjykata Kushtetuese e Kosovës** e paska krijuar këtë standard, i cili, gjithnjë sipas tyre, ka status ndërkombëtar (sic!). Për këtë, autorët citojnë autorin **Ahron Barak**, përkatësisht shkrimin e tij "Unconstitutional Constitutional Amendments", botuar në *Israel Law Review* (vol. 44, issue 3. 2011, fq. 321-341). Në fakt, autorët tanë manipulojnë me këtë burim: në fusnotën e tyre nr. 168, autorët tanë citojnë vetëm fq. 327-328, në të cilat **Ahron Barak** flet për teorinë dhe praktikën austriake mbi amendamentet jokushtetuese kushtetuese ("C. Unconstitutional Constitutional Amendments in Austria"), pra jo për amendamentet jokushtetuese në përgjithësi. Me këtë koncept nënkup-

tohet, siç e thotë vetë **Ahron Barak**, rastet kur një amendament kushtetues është draftuar në pajtim me kushtet formale të kërkuara me kushtetutë, mirëpo që si i tillë devijon nga struktura bazike (themelore) kushtetuese.

Sa i përket konstatimit se këtë standard ndërkombëtar e paska pas ndërtuar Gjykata Kushtetuese e Kosovës, një gjë e tillë aspak nuk është e vërtetë: ky juridiksion i takon Gjykatës sipas nenit 113.9 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] lidhur me nenin 144.3 ["Amendamentimi"] të Kushtetutës dhe është në harmoni të plotë me nenin e saj 112.1, që përcakton fizionominë e mekanizmit të gjyqësisë kushtetuese ndër ne. Kësaj çështje i kthehemi sërish më vonë, kur të analizojmë pjesët e librit që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ku autorët edhe më shumë gabojnë dhe vënë në lajthitje lexuesin për gjërat më themelore të gjyqësisë kushtetuese kosovare.

Përveç kësaj si më sipër, autori **Visar Morina** sqaron me shumë kompetencë se efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese varen në mënyrë të konsideruar nga disa faktorë siç janë tipi ose llojet e procedurave kushtetuese, natyra e kontestit kushtetues, i cili është objekt shqyrtimi para një gjykate kushtetuese, llojet e subjekteve që marrin pjesë në procesin e kontrollit kushtetues, natyra e normave juridike të cilat kundërshtohen në pikëpamje kushtetuese si dhe vetë përmbajtja e vendimit të gjykatës kushtetuese. Mbi bazën e këtyre kritereve, efektet e vendimeve mund të jenë të ndryshme, përfshirë këtu edhe efektin e një ligji. Këtu më tutje nuk do shtjellojmë këtë çështje. Besojmë se mjafton për të parë lexuesi se është i pafalshëm ngatërrimi i këtyre nocioneve themelore nga ana e autorëve tanë, i bërë kryesisht si pasojë e manipulimit me literaturën. Sikur ta kishin analizuar shkrimin e sipërcekur të autorit **Visar Morina**, do të kishin pasur mundësi të jepnin një pasqyrë të thukët të kuptimit të efektit ***erga omnes*** dhe të efekteve të tjera të vendimeve, në vartësi të llojit të tyre, subjekteve në procedurë dhe objektit të vendosur nga një gjykatë kushtetuese. Kjo është kështu sepse shkrimi i sipërcekur paraqet një studim krahasimor të kësaj çështje, duke përfshirë edhe trajtimin e nenit 116 ["Efekti Juridik i Vendimeve"] të Kushtetutës së Kosovës, në të gjitha dimensionet e tij.

Në seksionin mbi burimet materiale (fq. 79-82), fitohet përshtypja që autorët tanë e kanë të qartë se për çfarë do të flasin. Lexuesi, megjithatë, zhgënjehet që në fillim. Në ndërkohë që me të drejtë konstatojnë, në paragrafin e parë (fq. 79), se "burimet materiale janë të pashkruara dhe.... zakonisht nuk kanë ndonjë formë të shkruar ose të kodifikuar", menjëherë

rrëshqasin në skandal profesional kur konstatojnë se në **Itali** "regjimi parlamentar kishte ardhur në një rrugë zakonore, përmes një numri sjelljesh të vazhdueshme të organeve shtetërore, në kundërshtim me rregullat kushtetuese në fuqi" (fq. 79). Për këtë konstatim absurd, autorët tanë citojnë fq. 57 të autorit italian **Temistocle Martines** dhe librin e tij të sipërcekur mbi të drejtën kushtetuese. Në fq. 57 të librit të tij, ndërkaq, autori italian sqaron natyrën e zakonit kushtetues në kontekstin italian duke marrë si shembull **Statutin Albertino** të vitit 1848, me të cilin është qeverisur Italia deri në rënien e fashizmit, përkatësisht deri me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1948. Autorët tanë, me sa duket, nuk e kanë të qartë se regjimi parlamentar nuk është i papajtueshëm me monarkinë kushtetuese, gjë që dëshmojnë rastet e **Britanisë së Madhe**, mbretërive skandinave dhe **Holandës**, si dhe rastet e disa ish-kolonive britanike që janë monarki kushtetuese.

Në ndërkohë që pjesa tjetër deri në fillim të kapitullit të katërt, si tekst, mund të cilësohet e pranueshme sepse në shumicën e kohës lexuesi mund të ndjekë diçka që ka logjikë, literatura e përdorur kryesisht është e manipuluar, dhe ne vetëm në një rast të tillë do të ndalemi për t'i ikur vëllimit dhe për të mos shkaktuar kakofoni profesionale që mërzit lexuesin tonë. Do të ndalemi, gjithashtu, në një konstatim jo me vend dhe profesionalisht të gabuar të autorëve tanë sa për ilustrim të narracionit që, ani se i pranueshëm, nuk i shkon për shtati një libri që mëton të mësojë studentët dhe lexuesin për gjërat themelore të së drejtës kushtetuese. Trajtimi i burimeve të së drejtës kushtetuese materiale, në Kosovë dhe në disa vende, kryesisht paraqet riprodhim jo kritik të pjesëve të librave të sipërcekur të **K. Saliu**, autorëve shqiptar **L. Omari** & **A. Anastasi** si dhe pjesëve të caktuara të librit ***E drejta kushtetuese*** (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972) të autorit serb **J. Gjorgjeviq**.

Lidhur me manipulimin e literaturës, në fusnotën 228, autorët tanë citojnë disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, në rastet si vijon: rasti KO 98/11, rasti KI 47/10 dhe rasti KO 103/14. Këto vendime, sipas tyre, kanë ndryshuar përmbajtjen e tekstit të Kushtetutës së Kosovës. Ky konstatim është jo i saktë. Secili nga këto vendime paraqet interpretim të kushtetutës, jo ndryshim i përmbajtje së normave kushtetuese, siç pohojnë autorët tanë në fusnotën e tyre nr. 228. Të shohim se për çfarë bëhet fjalë këtu, para se të konstatojmë gabimet përmbajtjesore të autorëve tanë në këto pjesë të fundit të kapitullit të tyre të tretë të pjesës së parë të librit.

Në rastin KO 103/14 bëhet fjalë për vendim meritor të Gjykatës. Ky vendim ka pasur të bëjë me kërkesën e Presidentes A. Jahjaga për sqarim

lidhur me raportin reciprok mes neneve 84 (14) ["Kompetencat e Presidentit"] dhe 95 ["Zgjedhja e Qeverisë"] të Kushtetutës. Në pikën e parë të këtij vendimi, nën pikën "b", Gjykata ka konstatuar se nenet 84 (14) dhe 95 të Kushtetutës janë në përputhshmëri me njëri-tjetrin. Në pikat në vijim ka sqaruar deri në fund se cila është domethënia e saktë e kuptimeve "parti politike" ose në kontekstin e fituesit dhe humbësit relativ të zgjedhjeve në kushtet kosovare të ekzistencës së një sistemi proporcional zgjedhor me premisa të theksuara të balancimit administrativ të rezultatit zgjedhur ku 20 për qind e numrit të përgjithshëm të deputetëve nuk llogariten në përqindjen e tërësishme të votave për numrin prej 100 për qind deputetëve. Më këtë, Gjykata ka kryer detyrën e vet kushtetuese të interpretimit të normës kushtetuese me qëllim të sigurimit të epërsisë së kushtetutës, siç e bëjnë të gjitha gjykatat kushtetuese që modelohen sipas sistemit evropian/kelsenian.

Në rastin KO 47/10, bëhet fjalë për rastin e ish-Presidentit të Kosovës, F. Sejdiu: në pikën e dytë të aktgjykimit, Gjykata Kushtetuese, ka gjetur se ka pasur shkelje serioze te Kushtetutës së Kosovës, respektivisht të nenit 88.2 të Kushtetutës nga ish-**Presidenti Sejdiu**, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës së Kosovës si dhe postin e Kryetarit te Partisë Politike – Lidhja Demokratike e Kosovës (**LDK**). Asnjë argument nuk ekziston që thotë se në këtë rast ka ardhur deri te ndryshimi i Kushtetutës sepse në një vend si Kosova, ku ka demokraci kushtetuese parlamentare, shefi i shtetit nuk mund të mbajë postin e liderit të partisë politike. Kjo është e qartë në Kushtetutën e Kosovës, të cilën vetëm e ka interpretuar Gjykata Kushtetuese, dhe e tillë është çdokund në vendet që janë demokraci parlamentare. Autorët tanë nuk kanë dhënë ndonjë argument për atë se si ka ndodhur ndryshimi i Kushtetutës, në çfarë drejtimi, por vetëm kanë përdorur në fusnotën nr. 228 këtë vendim, krahas dy vendimeve të tjera, si argument se ka ardhur deri te një ndryshim (i panjohur për lexuesin). Kjo logjikë, që është e rrugës, nuk guxon të shprehet në një libër që mëton të jetë profesional e shkencor.

Në rastin e fundit nga fusnota nr. 228, që përdoret si argument se ka ardhur deri te ndryshimi i Kushtetutës me vendim të Gjykatës Kushtetuese, fjala është për rastin KO 98/11 lidhur me imunitetin e funksionarëve të lartë publikë kosovarë, përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të gjithë funksionarët e lartë shtetërorë. As këtu Gjykata nuk ka ndryshuar Kushtetutën, por e ka interpretuar atë. Në pikën e dytë të aktgjykimit në këtë rast, Gjykata interpretoi Kushtetutën duke konstatuar se, në për-

puthje me nenin 75 (1), nenin 89 dhe nenin 98 të Kushtetutës, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet funksional për veprimet dhe vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre përkatëse. Prandaj, deputetët e Kuvendit, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë lirohen nga përgjegjësia në procedura gjyqësore të çfarëdo natyre mbi pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Ky lloj i imunitetit ka kohëzgjatje të pakufizuar, pati thënë Gjykata. Cili qenka ndryshimi i Kushtetutës këtu? Përveç Italisë, në Evropë ky është standardi: nuk ka imunitet tjetër pos atij funksional. Cili kuptim tjetër mund të derivohet nga leximi i neneve 75 (1) dhe 89 e 98 të Kushtetutës, pos këtij që garanton vetëm një imunitetit, atë funksional, pra jo imunitetin absolut, siç e bën Italia?

Nga tërë kjo si më sipër, si dhe nga vendimet e sipërcekura të analizuara, qartë shihet se autorët tanë nuk e kanë të qartë se **Kushtetuta e Kosovës** nuk bën dallim mes interpretimit kushtetues (***constitutional interpretation***) dhe kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë (***judicial review***). Këtë nuk e bëjnë as kushtetutat tjera; këtë dallim e bën praktika kushtetuese. Me interpretim kushtetues nënkuptohet procesi i ndërtimit apo krijimit të kuptimit dhe i sqarimit të kushtetutës nacionale (nëse ekziston si tekst i shkruar), i teksteve të tjera kushtetuese dhe i normave e parimeve të tjera të pashkruara që kanë veçori kushtetuese; kontrolli kushtetues apo kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë, ndërkaq, quhet procesi në të cilin vlerësohet nëse sjellja e një akteri kushtetues është në pajtim me kushtetutën, me tekstet e tjera apo parimet që kanë cilësi kushtetuese. Kështu thotë autori **Maartje de Visser** në fq. 2 të librit të tij të njohur ***Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*** (Hart Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2015). Në këtë kuptim, interpretim kushtetues paraqet vetëm ai operacion mendor që kryhet si interpretim abstrakt nga neni 113 i Kushtetutës, paragrafët si vijon: 2 (pikat 1 & 2), 3 (pika 4), 4, 5, 8 & 9. Juridiksioni shtesë nga paragrafi 10 i nenit 113 të Kushtetutës nuk ka asnjë mundësi që të jetë juridiksion i kontrollit abstrakt të një norme të përgjithshme juridike sepse një situatë e tillë do të binte ndesh me vetë fizionominë e gjyqësisë kushtetuese të tipit **evropian/kelsenian**, ku juridiksioni i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme nënkupton në rend të parë autorizimin e gjykatës kushtetuese për shfuqizim/anulimin të normës së përgjithshme apo të dispozitave të caktuara të saj (**gjykata si ligjvënës negativ**). Pa këtë nuk ka gjyqësi kushtetuese të tipit **evropi-**

an/kelsenian. Kohëve të fundit, brenda këtij modeli gjykatat kushtetuese kanë marrë (uzurpuar) funksione të theksuara të **ligjvënësit pozitiv.** Kjo nuk ndryshon asgjë në këtë që thamë më sipër. Gjërat do të ishin krejt ndryshe sikur gjykatat kushtetuese të tipit **evropian/kelsenian** të mos kishin për detyrë të tyre primare shfuqizimin/anulimin e ligjeve dhe normave të tjera të përgjithshme (**gjykata si ligjvënës negativ**), krahas kompetencave të tjera.

Siç u pa më sipër, autorët tanë nuk e kanë të qartë kuptimin e kategorisë dhe të konceptit **interpretim i kushtetutës**, si një aktivitet i vetëm dhe themelor. Edhe në jurisprudencën e Gjykatës përdoret terminologjia e njëjtë për dy operacionet mendore si më sipër, përkatësisht termi "interpretimi kushtetues" dhe "kontrolli gjyqësor", për të shënuar tërë aktivitetin që kryhet në sferën e gjykimit kushtetues. Si bazë për këtë jurisprudencë, e cila nuk bën dallimin mes **interpretimit kushtetues** dhe **kontrollit gjyqësor** si më sipër, shërben keqkuptimi dhe keqinterpretimi i domethënies së nenit 112.1 të Kushtetutës, nen që definon fizionominë e Gjykatës. Një definim i tillë i këtij funksioni gjendet, pa asnjë përjashtim, në të gjitha kushtetutat e vendeve që modelohen sipas modelit **evropian/kelsenian.** Mirëpo, kjo nuk do të thotë asgjë sa i përket juridiksionit specifik të gjykatës kushtetuese brenda këtij modeli të gjyqësisë kushtetuese: kompetencat e gjykatave kushtetuese brenda modelit juridiksional **evropian/kelsenian** nuk dallojnë shumë nga një vend në tjetrin. Si juridiksioni ashtu dhe kompetencat konkrete veç e veç nuk i referohen asnjëherë krijimit të normës kushtetuese, por interpretimit të saj. Këtë nuk e kanë të qartë autorët tanë kur konstatojnë se Gjykata Kushtetuese ka ndryshuar përmbajtjen e Kushtetutës me vendimet që ata i citojnë në fusnotën 228 si më sipër, të cilat deri këtu ishin objekt i analizës sonë.

Në vijim të diskutimit tonë si më sipër, t'i kthehemi tani gabimeve përmbajtjesore të autorëve tanë. Në këtë aspekt, në mesin e gabimeve themelore në këtë pjesë janë konstatimet nga paragrafi i dytë në fq. 90, ku thuhet se "[b]urim tjetër formal dhe i zbatueshëm i së drejtës kushtetuese në Republikën e Kosovës janë instrumentet ndërkombëtare të cilat gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë si dhe kanë epërsi ndaj dispozitave ligjore, por jo ndaj kushtetutës". Në vijim të këtij konstatimi, autorët citojnë një nga një marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare nga neni 22 i Kushtetutës së Kosovës. Gabimi themelor në këtë rast është se nuk kuptohet që ky nen i Kushtetutës përmban dispozita kushtetuese që janë mbi çdo ligj tjetër. Kjo përbën thelbin e parimit kushtetues mbi epërsinë e ku-

shtetutës, pra çdo normë e saj ka epërsi ndaj secilës normë tjetër ligjore. Ajo çfarë autorët kanë pasur parasysh, por që nuk e kanë kuptuar, ka të bëjë me ngatërrimin e tyre të këtij neni me nenin tjetër të Kushtetutës së Kosovës, nenin 19, që flet për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare. Ky nen, për dallim nga neni 22, rregullon statusin e së drejtës ndërkombëtare në rendin kushtetues kosovar jashtë regjimit kushtetues të nenit 22. Këtë e treguam më sipër në këtë pjesë të analizës sonë dhe nuk do t'i kthehemi sërish, përveç që ripërsërisim edhe njëherë se Kosova dhe qasja e saj ndaj të drejtës ndërkombëtare bën pjesë në qasjet standarde të ish-vendeve komuniste të Evropës.

KAPITULLI IV.
KUPTIMI I KUSHTETUTËS DHE LLOJET E SAJ (FQ. 93–135)

Përgjithësisht

Ky kapitull ka gjithsej 13 seksione. Njëjtë si në kapitullin pararendës, seksionet karakterizohen me narrativ kaotik, i thurur me zigzage dhe me përmbajtje eklektike, duke manipuluar literaturën e autorëve të tjerë. Këtu, për dallim nga kapitulli paraprak, gabimet profesionale janë edhe më të theksuara dhe më dramatike, gjë që e bën librin edhe më të dyshimtë në aspektin shkencor, profesional dhe didaktik.

Të shohim si duket kjo në pjesët kryesore, të cilat i kemi analizuar kryesisht duke veçuar gabimet profesionale që duken në shikim të parë, *prima facie*, njëjtë siç kemi bërë më herët dhe siç do të bëjmë përgjatë tërë tekstit tonë.

Analiza kritike

Pas dy paragrafëve të parë të seksionit "Rëndësia dhe kuptimi i kushtetutës" (fq. 92-96), ku autorët ngatërrojnë të drejtën kushtetuese si degë pozitive e sistemit juridik dhe si teori, duke konstatuar se e drejta kushtetuese si shkencë nuk ka ekzistuar para se të paraqiten kushtetutat e para të shkruara, pason konstatimi i tyre që thotë se kushtetutat e shkruara kanë ndikuar tej mase në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm qeverisës. Si shembull për këtë konstatim "epokal", që mendja e shëndoshë nuk mund

ta refuzojë, merret **Franca**. Për këtë si burim citojnë autorin **Andrew Beale** dhe fq. 3 në librin e tij *Essential Constitutional Law* (Second Edition, Cavendish Publishing Limited: London & Sidney, 1997). Ky autor, ndërkaq, fare nuk mendon si autorët tanë. Fq. 1-13 të librit të tij kanë të bëjnë me kapitullin e parë që titullohet "The citizen and the constitution" dhe nuk kanë asnjë lidhje me konstatimet dhe diskutimet e autorëve tanë. Jo vetëm kaq. Në fq. 3, të cilën autorët tanë e citojnë, **Andrew Beale** fare nuk përmend **Francën**: asnjë rresht i kapitullit nuk flet për këtë vend evropian. Në seksionin e parë, në fq. 2-3, autori në fjalë diskuton dilemën britanike lidhur me atë nëse **Britania** duhet të ketë kushtetutë të shkruar dhe tregon se Parlamenti dhe Mbretëresha, balanci mes tyre dhe ekzekutivit, si dhe gjykatat mbretërore, përbëjnë shtyllën kurrizore të sundimit të ligjit në këtë vend. Kjo pjesë e librit pasohet nga seksioni që flet për cilësitë e kushtetutës britanike (fq. 4-6), ku flet për epërsinë e parlamentit, ndarjen e pushteteve dhe kontrollin gjyqësor në Britani dhe kështu me radhë. Me një fjalë, ky libër ka të bëjë me sistemin kushtetues në **Britaninë e Madhe**, fund e krye dhe fare nuk ka të bëjë me **Francën**. Kjo tregon se autorët tanë kanë manipuluar literaturën, duke përdorur një fjali dhe konstatim të përgjithshëm dhe duke venë si fusnotë një autor dhe një libër që nuk ka asnjë relevancë me diskutimin në krejt këtë seksion.

Në dy paragrafët e parë të asaj faqeje, autorët tanë në mënyrë dukshëm kaotike flasin për kuptimet e kushtetutës, përkatësisht për kuptimin e gjerë dhe të ngushtë, të cilat i kanë huazuar nga autorët shqiptarë **L. Omari** & **A. Anastasi**, përkatësisht fq. 23 nga libri i tyre ***E drejta kushtetuese*** (Shtëpia Botuese ABC, 2010). Këta autorë, ndërkaq, në fq. 23-24 në mënyrë të shkëlqyer trajtojnë kuptimin dhe rëndësinë e kushtetutës. Ky nuk është rasti me autorët tanë, të cilët përdorin definicionin e tyre duke cituar një autorë tjetër gjerman, filozofin nazist të së drejtës dhe teoricienin e diktaturës, **Carl Schmitt**, dhe fq. 112 të librit të tij ***Constitutional Theory*** (Duke UP: Durham and London, 2008). Jo vetëm kjo faqe, por edhe fq. 113 që citohet në fusnotën nr. 238 të librit të autorëve tanë bën fjalë për të kundërtën e kontratës sociale: **Carl Schmitt**, në këtë libër, pra jo vetëm në këtë kapitull që flet për kushtetutën si kontratë sociale, mëton të tregojë teorinë e tij monumentale sipas së cilës kushtetute është akt konkret me të cilin populli definon unitetin e vet total politik. Në fq. 112-113, krejt kundër asaj që mendojnë autorët tanë, flet për **Rousseau**-n si për mendimtarin që ka folur për kontratën sociale si për aktin themelues të shtetit, që dallon nga kushtetuta si ligj politik apo fundamental me të cilin rregu-

llohet mënyra e ushtrimit të pushtetit shtetëror. Ky autor gjerman ndryshe njihet si mbështetës i teorisë së diktaturës dhe për të cilin kushtetuta përbën vendim total lidhur me natyrën dhe formën e unitetit politik, kurse krejt autorët e kontratës sociale, nga **Th. Hobbes**, **Rousseau** dhe **I. Kant**, përfshirë vetveten, i fut në një thes. Kjo sikundër vërehet, bie ndesh me bindjen e autorëve tanë që besojnë se **Rousseau** dhe **Carl Schmitt** e shohin kontratën si bartje të vullnetit me dëshirë te sovrani (populli). E vërteta është krejt e kundërta, sipas **Carl Schmitt**-it, kjo kontratë çdoherë imponohet dhe këtë e bazon në teorinë e **Th. Hobbes**, **Rousseau** dhe autorëve të tjerë të diktaturës popullore.

Në fq. 95 autorët vazhdojnë me diskutimet kaotike për kontratën sociale, për të kërcyer papritur në kuptimet kryesore të kushtetutës, gjëja për të cilën më së shumti ka nevojë studenti dhe lexuesi. Këtu duke cituar fq. 46-48 të librit ***E drejta kushtetuese*** (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1984) të autorit **Kurtesh Saliu**. Këtë autor e citojnë edhe autorët e sipërcekur shqiptarë. Në fq. e sipërcekura të librit të tyre, ata sqarojnë për lexuesin se çka është kuptimi formal i kushtetutës, kuptimi material dhe kuptimi politik dhe tjetër. Këtë nuk e bëjnë autorët tanë këtu, siç e bëjnë autorët shqiptarë dhe **K. Saliu,** por e lënë për më vonë. Në vend të kësaj, fq. 95 e mbyllin me diskutime të turbullta dhe të pakuptueshme për misionin e kushtetutave të shkruara, për liritë dhe të drejtat e njeriut, për pushtetin dhe kështu me radhë. Këtu citojnë, në fusnotën nr. 240, fq. 2-3 të librit ***Constitutional and Administrative Law*** (Oxford U: Oxford, 2012) të autorit **Neil Parpworth**. Edhe këtë autor, njëjtë si **C. Schmitt**, e keqinterpretojnë dhe thonë gjëra që ai nuk i ka thënë dhe që fare nuk mbështesin konstatimin e autorëve tanë. Këta të fundit, duke cituar këtë autor kanë konstatuar në fq. 95 si vijon: "Profesor King në lidhje me përkufizimin e kushtetutës pohon se ajo është një tërësi rregullash të rëndësishme, që rregullon marrëdhëniet midis pjesëve të ndryshme të qeverisjes (institucioneve kushtetuese) si dhe marrëdhëniet midis institucioneve kushtetuese dhe shtetasve të shtetit, normalisht gjithnjë duke pasur parasysh karakteristikat e saj si një akt suprem dhe më i lartë". E vërteta ndërkaq është krejt ndryshe. Autori **Neil Parpworth** në seksionin "What is a constitution?" citon disa autorë dhe mendimet e tyre lidhur me kuptimin e kushtetutës, ndër ta edhe prof. King-un, gjithnjë duke provuar që këtë kuptim t'ua përshtatë nevojave dhe botëkuptimeve të shoqërisë britanike. Këtë e thotë shprehimisht në fillim të këtij kapitulli. Në këtë kontekst, ai bën dallimin mes kushtetutave të shkruara dhe të

pashkruara. Definicioni që autorët tanë japin, gjoja se e ka thënë prof. K-ing, në fakt ka të bëjë me definimin e tij të kushtetutave në kuptimin e gjerë të fjalës (pra si rregulla të lojës, pa marrë parasysh a janë të shkruara apo jo). Në kuptimin e ngushtë, ndërkaq, ky autor britanik thekson se ka dy kushtetuta: ato që nisin me germën e madhe "K" dhe ato që nisin me germën e vogël "k". Të parat janë tekste të shkruara kurse të dytat gjenden gjithandej të shkapërderdhura. Ky klasifikim përputhet deri dikund me kuptimin e kushtetutave në kuptimin material dhe në kuptimin formal të sistemit kontinental. Vetëm në këtë të fundit, ku bën pjesë edhe Kosova, prof. King thekson ka kuptim parimi i epërsisë së kushtetutës. Në vendet ku kushtetuta nis me germën e vogël "k", që është **Britania e Madhe** dhe disa prej ish-kolonive të saj, ajo dallohet dhe definohet sipas karakteristikave të rregullave të saj të marra si tërësi dhe që nuk janë të kodifikuara në një tekst të vetëm. Besoj se lexuesi ynë do ta kuptojë se edhe këtu flitet për manipulim brutal të literaturës dhe trajtim konfuz të kuptimit themelor të termit kushtetutë.

Në fq. 96-100, në dy seksionet më kryesore për të drejtën kushtetuese, ku flitet për kuptimet formale, materiale dhe kuptimet e tjera të kushtetutës, autorët bëjnë gabimet më trashanike, të cilat për autorin e këtyre rreshtave ngelen të pabesueshme. Në dy këto seksione, "Kuptimi formal i kushtetutës" dhe "Kuptimi material dhe kuptimet tjera të kushtetutës", autorët ndërtojnë një narracion tërësisht kaotik që në tërësi bazohet në parafrazimin e gabuar, jo kritik dhe me përzgjedhje arbitrare të thënieve e mendimeve të autorëve të tjerë të së drejtës kushtetuese. E kemi fjalën për autorët dhe mendimet e tyre të dhëna në burimet në fusnotat 248, 255-257, 259-263 të librit, ku citohet këta autorë dhe librat e tyre: **Neil Parpworth** (vep. e cit. si më sipër); **Kurtesh Saliu** (vep. e cit. si më sipër); Hilaire Barnett, *Constitutional and Administrative Law* (4th ed., Cavendish: London, 2002); **Karl Loewenstein**, *History, Methodology and Tipology* (sic), libër që nuk ekziston fare nga ky autor gjerman, por të cilin autorët tanë në mënyrë të gabuar na udhëzojnë në fusnotën nr. 259 ta lexojmë si "Chapter 4. Types of Constitutions, fq. 115-117", që në fakt ka të bëjë me një punim krejtësisht tjetër të autorit **Diter Grimm**, përkatësisht me punimin e tij "Types of Constitutions", botuar në fq. 98-132 të libri të librit ***Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*** (Oxford UP: Oxford, 2012) të autorëve **Michel Rosenfeld** & **András Sajó** (eds.); dhe **Carl Schmitt** (vep. e cit. si më sipër); Jovan Gjorgjeviq, ***E Drejta Kushtetuese*** (Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të KSAK: Prishtinë, 1967).

Të shohim tani gabimet trashanike të autorëve tanë në fq. 96-100.

Në dy paragrafët e parë të fq. 96, autorët në mënyrë konfuze flasin për segmente të caktuara të kushtetutës në kuptimin formal, për të dhënë definicionin e tyre "origjinal" në paragrafin vijues. Në fakt, në vend të këtij definicioni lexuesi gjen një parafrazim arbitrar dhe të gabuar të definicioneve të profesorëve **L. Omari** & **Aurela Anastasi** dhe **K. Saliu**. Ky i fundit, në fq. 46 të librit të sipërcekur, më së afërmi i ngjason këtij definicioni të gabuar të dhënë në fq. 96: në thelb është një ripërsëritje e asaj që ka thënë **K. Saliu** në fq. 46 të librit të tij, por pa e cituar. Kjo ka bërë që autorët tanë ta ripërsërisin gabimin e të ndjerit K. Saliu: duke dhënë definicionin formal të kushtetutës, dy palët e cilësojnë miratuesin e kushtetutës, kuvendin (parlamentin), si organin më të lartë. Ky koncept është i gabuar për dy arsye: e para, sepse jo domosdo dhe jo gjithnjë kuvendi (parlamenti) paraqitet si miratues i kushtetutës, në veçanti pas luftërave e revolucioneve; dhe e dyta, kuvendi (parlamenti) ka qenë organi më i lartë në sistemin ish-komunist, kurse tani, në Kosovë dhe gjetiu, kuvendi (parlamenti) nuk është veçse njëri prej tri pushteteve të ndara – pushteti legjislativ. Kur nxjerr kushtetutë, apo kur amendamenton atë, kuvendi luan rolin e pushtetit kushtetutëbërës (origjiner dhe derivativ respektivisht).

Në faqen përballë, përkatësisht në faqen 97, pason gabimi i sërishëm, tani në definimin e kushtetutës në kuptimin material. Këtu si cilësi të këtij definicioni e marrin epërsinë e normave kushtetuese kundrejt normave të tjera, pa marrë parasysh se ku gjenden ato. Kjo është gabim sepse kjo epërsi nuk ekziston në vendet që nuk kanë një kushtetutë të shkruar dhe të kodifikuar. Për më tepër, edhe në vendet ku ka një kushtetutë të shkruar dhe të kodifikuar, normat kushtetuese në aspektin material që gjenden jashtë tekstit të shkruar dhe kodifikuar nuk kanë epërsi ndaj normave të tjera të shkruara. Ky kuptim i autorëve tanë i nocionit material të kushtetutës nuk gjendet as te autorët shqiptarë, e as te **K. Saliu**, të cilin e citojnë gabimisht në fusnotën nr. 255: mendimi i dhënë nga autorët tanë për kuptimin material të kushtetutës, që mëton të paraqitet si mendim përfundimtar, nuk është i K. Saliu por i një autori tjetër, francezit. Mjafton që lexuesi të lexojë fq. 48 të librit të K. Saliu dhe e gjen këtë që themi këtu. Vlen të theksohet këtu se ky mendim i francezit F. Lasalle daton që nga ligjërata e tij të vitit 1862 dhe njihet si definimi i kushtetutës materiale si "raport i forcave" në një shoqëri. Konstatimin si më sipër autorët tanë e "trashin" duke e ripërsëritur sërish në fq. 99, ku thonë se "kuptimi material i kushtetutës nënkupton përmbajtjen e këtij akti dhe materies që

ndërlidhet me të, por që ka fuqi supreme në kuadër të rendit juridik". Sipas kuptimit material të kushtetutës, ndërkaq, nuk është e rëndësishme forma e normave kushtetuese (a është kushtetuta e shkruar dhe e kodifikuar, apo jo e shkruar dhe jo e kodifikuar), as fuqia e tyre juridike. Kështu thotë **K. Saliu** në fq. 47, autorët shqiptarë **L. Omari** & **A. Anastasi** në fq. 25. Kështu thonë edhe autorët e tjerë serbë, kroatë, francezë dhe kështu me radhë, të cilët i citojnë dhe i kanë shfrytëzuar me ndërgjegje e pastërti profesionale. Për këtë arsye ne nuk i ripërsërisim në këtë vend, meqë kuptimi i kushtetutës në aspektin formal dhe material përbën një standard të njohur për çdo jurist mesatar.

Manipulimi i literaturës vazhdon me intensitet të njëjtë në fq. si më sipër të autorëve tanë: duke e marrë në mënyrë të shtrembëruar definicionin e **Karl Loewenstein**-it nga fq. 48 e librit të K. Saliu, autorët tanë në fusnotën 259 citojnë në mënyrë fiktive një titull libri që nuk ekziston dhe që kurrë nuk e ka shkruar dijetari gjerman si më sipër. Këtë definicion të kuptimit politik nga K. Saliu e kanë marrë edhe autorët shqiptarë por e kanë cituar në mënyrë besnike. Autori **Diter Grimm**, për të cilin nuk janë të vetëdijshëm autorët tanë, ani se e citojnë, në shkrimin e tij të sipërcekur flet për gjermanin Karl Loewenstein, i cili njihet si personi që ka bërë tipologjinë e kushtetutave sipas shkallës së efektivitetit dhe mënyrës së krijimit të tyre. Në shkrimin si më sipër, **Diter Grimm** askund nuk flet për kuptimin politik të kushtetutës, të cilin autorët tanë ia atribuojnë **Karl Loewenstein**: i vetmi vend që e zënë në gojë në kuptim të tipologjisë konkrete ka të bëjë me fq. 107 ku autori **Diter Grimm**, duke iu referuar tipologjisë së **K. Loewenstein**, e citon tipologjinë e tij të kushtetutave normative, nominale dhe semantike. Kjo e bën të pakuptimtë definimin politik të kushtetutës të dhënë nga autorët tanë në fund të paragrafit të dytë të fq. 99, sikur gjoja derivon nga analiza e tyre e **K. Loewenstein** dhe autorëve të tjerë. Këtu kemi të bëjmë me manipulim literature dhe me definime tërësisht të pakuptimta për çdo lexues.

Kjo pakuptimësi përfshin moskuptimin nga ana e tyre të definimit të kushtetutës sipas **C. Schmitt**, të cilin e manipulojnë në fusnotën nr. 260. Ky autor gjerman, në fq. 75 nis diskutimin mbi dallimin mes kushtetutës dhe të drejtës kushtetuese. Mirëpo, ai me kushtetutë nuk nënkupton atë që thonë autorët tanë, por një akt të vetëm me të cilin kryhet definimi i unitetit politik lidhur me formën e caktuar të ekzistimit. Ky kuptim, sipas **C. Schmitt**, dallon nga e drejta kushtetuese. Më aktin e parë definues, **C. Schmitt** nënkupton ushtrimin e pushtetin kushtetutëbërës origjinal, kurse

me të drejtë kushtetuese nënkupton atë që sot nënkuptohet me të drejtën kushtetuese si degë e së drejtës pozitive. Kjo besoj është qartë krejt e ndryshme nga ajo që kanë thënë autorët tanë dhe këtë mund ta gjejmë në fq. 75-88 ("Positive Concept of the Constitution") të librit të sipërcekur të **C. Schmitt**.

Para se të kalojnë në gabimet doktrinare të fq. 100, autorët tanë, japin një kuptim teorik të kushtetutës. Për këtë ata citojnë në mënyrë të gabuar në fusnotën nr. 262 autorin serb **Jovan Gjorgjeviq**. Kur krahasohet autori **K. Saliu**, që po ashtu e citon autorin e njëjtë serb, qartë del se kuptimi teorik te autorët tanë paraqitet i shfytyruar dhe i pakuptimtë në ndërkohë që kuptimi origjinal i kuptimit teorik të kushtetutës del si më domethënës dhe më i saktë. Kjo tregon se autorët tanë në mënyrë arbitrare kanë cituar dhe parafrazuar mendimet e këtyre dy autorëve.

Në paragrafin e parë të fq. 100, autorët përdorin fjalët "teori" dhe "doktrinë" si të ndryshme dhe ndërtojnë një paragraf përmbledhës por që nuk mund të kuptohet në asnjë lexim sepse nuk ka lidhje as me paragrafët pararendës apo pasrendës. Menjëherë pas këtij ngatërrimi kalojnë në definicioni që ata e quajnë social, duke cituar autorin serb Jovan Gjoergjeviq. Autorët tanë e definojnë në kuptimin social duke thënë se "kushtetuta, përveç se është një akt juridik, është edhe një tërësi e marrëdhënieve dhe rrethanave reale shoqërore, ekonomike, politike, juridike, ndërkombëtare etj.". Ky definicion, sikundër edhe të tjerët, është krejt i ndryshëm nga origjinali, i dhënë nga autori serb Jovan Gjorgjeviq, sipas të cilit përkundër:

> mendimit formalo-juridik të kushtetutës paraqitet ai sociologjik, i cili insiston në esencën shoqërore të kushtetutës. Kuptimi sociologjik niset nga ajo se kushtetuta e një vendi nuk është dokument juridik, por sërë e marrëdhënieve dhe e rrethanave reale, mes të cilave mbizotërojnë: raportet e forcave shoqërore, struktura ekonomike, rrethanat gjeografike e politike, marrëdhëniet ndërkombëtare etj. [**J. Gjorgjeviq**, vep. cit. fq. 21.]

Ajo që te librat standardë mbi të drejtën kushtetuese në sistemin civil (kontinental) figuron si seksion mbi "rëndësinë dhe vetitë e kushtetutës", përfshirë dhe autorët e sipërpërmendur shqiptarë, te autorët tanë është riformuluar dhe paraqitet si "Pse duhet të kemi një kushtetutë?" dhe "Funksionet e kushtetutës" (fq. 110-111), kurse seksioni që supozohet se do të duhej të trajtonte cilësitë e kushtetutës, te autorët tanë titullohet si "Vetitë dhe atributet e kushtetutës" (fq. 112-115). Në tri këto seksione ripërsëriten në mënyrë absurde konstatimet e thëna më herët, përfshirë këtu konstati-

met dhe fjalitë e pakuptimta brenda vetë këtyre seksioneve. Kjo kulmon me seksionin tjetër në vijim, seksionin "Supremacia si një atribut absolut i kushtetutës dhe sfida nga e drejta ndërkombëtare" (fq. 116-119).

Në paragrafin e parë të seksionit "Pse duhet të kemi një kushtetutë", autorët tanë cekin një version të dhënë nga një autor tjetër, **Nick Howard,** në librin e tij *Beginning Constitutional Law* (Routledge and New York, 2013). Ky libër, ani që nuk është një tekst universitar, përmban në mënyrë të kondensuar sqarimet themelore rreth mbi të drejtën kushtetuese. Si i tillë, libri është shkruar për audiencën e sistemit të së drejtës së përgjitshme (anglo-sakson). Megjithatë, trajtimet mbi të drejtën kushtetuese janë të sakta. Në rastin konkret ku autorët tanë e citojnë, libri jep sqarime për kontekstin e lindjes së një kushtetute, kurse autorët tanë e kthejnë në pyetje që tejkalon atë çfarë thotë ky libër. Në grupin e parë të arsyeve për lindjen e një kushtetute hyjnë arsyet kataklizmike, thotë **Nick Howard** në fq.15, në ndërkohë që autorët tanë rastin tragjik të kaosit dhe shthurjes së Shtetit shqiptar në vitin 1997 e cilësojnë si "konflikt të armatosur" që ka rezultuar në lindjen e Kushtetutës së Shqipërisë (sic!). Për këtë citojnë autorin **Luan Omari** dhe fq. 219 të librit të tij ***Sistemi parlamentar*** (Botimet "Elena Gjika": Tiranë, 2004), i cili asnjë fjalë të vetme nuk e thotë për një gjë të tillë e aq më pak të konstatojë se në Shqipëri ka pasur konflikt të armatosur në vitin 1997, që më pas ka rezultuar në nxjerrjen e kushtetutës së sotme shqiptare (sic!). Thënë me fjalë të tjera, **Luan Omari** as nuk e cilëson gjendjen kaotike të shthurjes së shtetit shqiptar si "konflikt i armatosur" e as që konstaton se kushtetuta u nxor si pasojë e saj. Këtu ne i referohemi edhe botimit të katërt të vitit 2010 të këtij libri, përkatësisht tërë kapitullit 12 ("Rilindja e parlamentarizmit", fq. 210-235).

Autorët tanë këtë konstatim si më sipër e japin para se të kalojnë në fq. tjetër, fq. 102, ku japin në mënyrë kaotike arsyet nevojës së ekzistimit të kushtetutave, të cilat arsye në fakt janë funksionet e një kushtetute. Kur flasin për funksionet e kushtetutës, ndërkaq, i ripërsërisin në mënyrë të pakuptueshme të njëjtat gjëra që i thonë në pjesën për arsyet e ekzistimit të një kushtetute. Këtë herë, megjithatë, funksionet e kushtetutës trajtohet duke u huazuar nga një projekt/libër, të autorit **Elliot Bullmer**, të cilin fare nuk e citojnë. E kemi fjalën për librin e tij me titull *What is a Constitution: Principles and Concepts* (IDEA: Stockholm, 2017), që i dedikohet laikëve për të mësuar gjërat themelore mbi kushtetutën. Ajo që te autorët tanë gjendet në fq. 102-112 është huazuar në tërësi si strukturë nga fq. 3-4 të librit të **Elliot Bullmer**, por më një dallim. Autorët tanë, në mënyrë

krejt jologjike dhe profesionalisht të paqëndrueshme, e fusnin si funksion të parë të një kushtetute mbrojtjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Jo vetëm kaq, autorët tanë tërë kohën flasin për arsyet e ekzistimit të një kushtetute, për formën dhe përmbajtjen e saj sipas këndit liberal, sikur tërë bota të kishte qenë e qeverisur nga kushtetuta e dokumente të natyrës liberale. Përkundër tërë këtij gabimi themelor në qasje, gabimi i tyre nuk qëndron këtu. As në aspektin historik e as në atë aktual, kushtetutat nuk kanë si funksion primar garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut për përcaktimin e mënyrës së ushtrimit të pushtetit dhe organizimin e tij institucional, kurse vetëm më pas vijnë dispozitat kushtetuese për rolin dhe pozitën e individit në shoqëri. Thënë me fjalë të tjera, në çdo kushtetutë, si të vendeve demokratike ashtu dhe të atyre jodemokratike, dispozitat e para i kushtohen sovranitetit shtetëror, definimit të origjinës dhe mënyrës së ushtrimit të tij, kurse më pastaj pasohen nga dispozitat që përcaktojnë rolin që individi ka në një shoqëri. Në vendet që nuk janë demokraci kushtetuese liberale, kjo qasje vërehet edhe më shumë sepse për individin flitet nën hijen që shteti joliberal hedh mbi individin duke e eklipsuar në tërësi. Këtë rrethanë e ka trajtuar jashtëzakonisht me kompetencë autori **Nathan J. Brown** në librin *Constitutions in a Nonconstitutional World* (State University of New York Press: New York, 2002), ku autori flet për konstitucionalizmin dhe përvojat kushtetuese në kontekst të vendeve islame arabe (në veçanti fq. 91-94, apo "Conclusions to Part One" dhe fq. 192-200 apo "Conclusion" dhe "Conclusion: Lessons from Arab Constitutional Experience").

Përmbajtja e secilit nënseksion të huazuar nga **Elliot Bullmer** është e mbushur me shqyrtime të pakuptueshme dhe jokonsistente. Kështu, ta zëmë, në fq. 104, autorët tanë thonë se "[z]akonisht institucioni kushtetues kompetent për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut është Gjykata Kushtetuese". Në grupin e shteteve që kanë gjykatë kushtetuese, krahas **Kosovës** dhe **Maqedonisë**, **Malit të Zi** dhe **Spanjës**, fusin edhe **SHBA**-në (sic!). Lëshimet serioze profesionale vazhdojnë edhe në nënseksionin në vijim, në fq. 105, ku autorët e transformojnë gabimin e tyre të mëhershëm të bërë në fq. 79 të librit, të cilin e kemi diskutuar në pjesën e kritikës sonë për kapitullin e tretë. Aty, rikujtojmë lexuesin, autorët tanë, konstatojnë se në Itali "regjimi parlamentar kishte ardhur në një rrugë zakonore, përmes një numri sjelljesh të vazhdueshme të organeve shtetërore, në kundërshtim me rregullat kushtetuese në fuqi" (fq. 79). Tani ata bëjnë një transformim të thellë joprofesional, duke thënë se "[n]jë ndër vlerat kush-

tetuese në Itali është forma republikane e qeverisjes e cila, siç u tha më lartë sipas autorëve italianë kishte ardhur natyrshëm në formën e një zakoni kushtetues dhe që nuk mund të ndryshohet" (fq. 105). Gjykuar sipas fusnotës nr. 295, me autorë italianë kanë parasysh autorin **Temistocle Martines** dhe fq. 40 të libri të tij *E drejta kushtetuese* (UET Press: Tiranë, 2011). Kur njeriu shikon këtë faqe, gjen se autori italian as që bën fjalë për një gjë të tillë sepse, thjesht, nuk mund të mendojë diçka që nuk ka logjikë profesionale. Organizimi republikan i shtetit italian në vitin 1946, ka ardhur si pasojë e një referendumi popullor, i organizuar sipas një detyrimi që me një dekret mbretëror kishte marrë mbreti i ri (i fundit) italian **Umberto II** në qershor 1944. Në këtë vit, të gjitha forcat politike dhe ushtarake, së bashku me mbretin, patën rënë dakord që pas luftës të organizohet një referendum për dy çështje: e para, për fatin e mëtejmë të monarkisë, e cila ishte kompromet uar duke mbajtur anën fashizmit të **Benito Mussolinit**; dhe e dyta, për krijimin e një asambleje kushtetuese që do të nxirrte një kushtetutë të re për vendosjen e një sistemi tëri të organizimit të shtetit dhe pushtetit në këtë vend. Referendumi u cilësua si **referendumi institucional** (ital. *referendum istituzionale*) apo **referendumi për formën institucionale të shtetit** (ital. *referendum sulla forma istituzionale dello Stato*), përmes së cilit italianët duhej të vendosnin nëse kreu i shtetit do të ishte nga familja mbretërore e dinastisë së **Savojës** apo një president i ri i një republike të re. Ky referendum, i mbajtur më 2 dhe 3 qershor të vitit 1946, i dha fund mbretërisë, krijoi Asamblenë Kushtetuese që punoi deri në vitin 1948, kur u nxor **Kushtetuta e Italisë**, e vitit 1948, përmes së cilës mbreti u depushtetizua në tërësi dhe iu ndalua qëndrimi në vend. Kjo do të thotë se republikanizmi italian nuk ka ardhur si rezultat i zakonit kushtetues por si shprehje plebishitare e vullnetit të popullit italian. Për këtë, pra për **Asamblenë Kushtetuese të Italisë**, e ka fjalën autori italian **Temistocle Martines** në fq. 40 të librit si më sipër, dhe asnjëherë për atë që thonë autorët tanë. Përveç kësaj, përmendja e Asamblesë Kushtetuese në këtë fq. ka të bëjë me burimet e së drejtës kushtetuese, pra në një kontekst krejtësisht të ndryshëm. Autorët tanë, për të konstatuar diçka rreth lindjes së republikanizmit italian, është dashur të konsultojnë pjesët tjera të këtij autori dhe të autorëve të tjerë italianë, ndër të tjerët doajenin e së drejtës kushtetuese italiane **Franco Pierandrei** dhe librin e tij trevëllimesh ***Scritti di Diritto Costituzionale*** (G. Giappichelli Editore, Torino, 1964). Ky autor, në kapitullin "La nostra costituzione" (fq. 423-454) të vëllimit të dytë, jep historikun e referendumit për reformën institucionale dhe themelimin

e Asamblesë Kushtetuese, nxjerrjen e Kushtetutës dhe hyrjen e saj në fuqi më 1 janar 1848, plot një shekull pas **Statutit Albertino**, strukturën e saj dhe dilemat fillestare të italianëve për republikën e re.

Nuk është vetëm ky gabim në këtë nënseksion të autorëve tanë që bën fjalë për identitetin kushtetues: në fq. 106-108 provojnë të thonë diçka për identitetin kushtetues. Për këtë gjoja mbështeten, me shumë të drejtë, në një autor amerikan. E kemi fjalën për autorin **Gary Jeffrey Jacobsohn** dhe shkrimin e tij "Constitutional Identity", botuar në *The Review of Politics* (vol. 68, no. 3, 2006, fq. 361-397). Ky shkrim, më vonë u bë libër dhe sot paraqet burimin e pashmangshëm të krejt atyre autorëve seriozë që shkruajnë për identitetin kushtetues kudo në botë. E kemi fjalën për librin me të njëjtin titull, ***Constitutional Identity***, botuar në vitin 2010 nga "Harvard UP". Citimi i tyre, megjithatë, është në tërësi fiktiv sepse, po ta kishin lexuar dhe ta kishin asimiluar teorinë e këtij autori të shkëlqyer, do ta kishin pasur të qartë se çka është identiteti kushtetues dhe cilët janë parametrat e tij, pa marrë parasysh nëse flitet për një vend demokratik apo një diktaturë. Se kjo është kështu, shihet qartë nga forma dhe përmbajta e diskutimit të tyre mbi identitetin kushtetues. Në vend se të diskutojnë për definimin, për vendin dhe për rolin e identitetit kushtetues, autorët përçartë dhe përmes manipulimit të literaturës, konstatojnë krejt jashtë kontekstit, se **Franca** "procesin e krijimit të identitetit e ka përmbyllur me Kushtetutën e vitit 1958. Për këtë si burim marrin autorin **Olivier Duhamel** dhe librin e tij *Droit constitutionnel* (Seuil: Paris, 1993), të përkthyer në shqip, siç e thonë autorët në fusnotën nr. 307. E vërteta është se ky autor, as në këtë botim dhe as në botimin koautorial nuk e ka thënë një gjë të tillë. E kemi fjalën këtu për ***Droit constitutionnel et institutions politiques*** (Seuil: Paris 2013) të autorëve **Olivier Duhamel** & **Guillaume Tusseau**. Fq. që autorët tanë i citojnë në fusnotën e tyre si më sipër kanë të bëjnë me kapitullin e parë të pjesës së parë të librit në fjalë, që mban këtë titull: "La construction de la democratie en France (historie constitutionnelle"). As dhe një rresht i vetëm nuk flet për diçka të tillë që do të çonte në përfundimin se, identiteti i **Francës** është përmbyllur me Kushtetutën e vitit 1958". Ky konstatim është krejt normal dhe pasojë e moskuptimit nga ana e autorëve tanë të origjinës dhe konceptit të identitetit kushtetues, përkatësisht duke e barazuar atë me tekstin kushtetues dhe duke e paramenduar si një diçka që shkon dorë për dore me kushtetutën si një akt i shkruar. Në këtë kontekst, autorët tanë, në fq. 106-107 konstatojnë, duke cituar në mënyrë krejtësisht abuzive dhe manipulative fq. 361 me të cilin fillon shkrimi i sipërcekur i

vitit 2006 i **Gary Jeffrey Jacobsohn**, si vijon: "Kushtetutat e vendeve të ndryshme të botës mishërojnë identitetet e veçanta, kështu, kushtetuta është një trashëgimi e rëndësishme andaj identiteti nuk mund të shkatërrohet". Në këtë fq., ndërkaq, **Gary Jeffrey Jacobsohn** citon rastin e njohur të Gjykatës Supreme të Indisë, i cili vlen për një materie tjetër, atë të dispozitave kushtetuese të pandryshueshme (e njohur si ***unconstitutional constitutional amendments doctrine***), dhe atë në mënyrë të gabuar. Ky autor citon një pjesë të këtij vendimi që thotë se identiteti kushtetues nuk mund të ndryshohet, pra jo identiteti në përgjithësi siç mendojnë autorët tanë. Kjo tregon se ka një identitet kushtetues dhe një identitet apo disa identitete të tjera që nuk janë identitete kushtetuese. Kushtetutat nuk krijojnë identitete vetëpërvete, siç mendojnë autorët tanë. Identitetet e dyta formohen ndryshe, mund të ndodhë paralel dhe në kundërshtim me tekstin kushtetues apo konform tij, dhe këtë e shpjegon në mënyrë të shkëlqyer **Gary Jeffrey Jacobsohn** dhe autorët e tjerë që ai citon, si në librin e tij të sipërcekur të vitit 2010, ashtu dhe në artikullin e vitit 2006.

Çfarë, atëherë, nuk kanë kuptuar autorët tanë? Ata nuk kanë kuptuar gjërat bazike mbi atë se si dhe kur u paraqit identiteti kushtetues, si ka lindur dhe cilat janë llojet dhe cilësitë e tij themelore dhe ku ankorohet një identitet kushtetues? Përgjigja në këto pyetje përfshin, në rend të parë, diskutimin tonë për iluminizmin, si pikë kthyese që "lindi" identitetin kushtetues modern. Nga iluminizmi u krijua ideja e tekstit kushtetues, si pikë themelore e dallimit ndërmjet njëjtësisë dhe të ndryshmes, pa marrë parasysh kontekstin social në të cilin ka operuar ky tekst kushtetues në kohën e lindjes së iluminizmit. Pas mbarimit të ciklit të iluminizmit, u themeluan një sërë praktikash e teorish kushtetuese, të cilat unë paraprinë modeleve të ndryshme kushtetuese të bazuara kryesisht në tekstin kushtetues nacional. Këtu e kemi fjalën në veçanti për kristalizimet dhe për zhvillimet e këtyre modeleve gjatë shekujve XIX dhe XX, siç janë modeli amerikan, francez, gjerman, postkolonial dhe kështu me radhë.

Identiteti kushtetues, njësoj si ai nacional, ka të bëjë me komunitetet imagjinare ashtu siç i ka definuar **Benedict Anderson**, pra si një bashkësi ku përkatësia kolektive përcaktohet mbi bazën e disa cilësive imagjinare të secilit anëtar (Benedict Anderson, ***Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism*** (Verso: New York, 2006), në veçanti kapitullin 3: "Origins of National Consciousness", fq. 39-48). Si i tillë, identiteti kushtetues primar përcaktohet jo nga cilësitë fizike të komunitetit por nga veçoritë e tij dalluese në lëmin e qeverisjes dhe të sundi-

mit të ligjit, të demokracisë dhe të respektit për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, si dhe nga veçoritë e tjera që lidhen me natyrën dhe me rolin e shtetit në shoqëri si dhe marrëdhëniet e tij me individin. Thënë shkurt, identiteti kushtetues përcaktohet pikërisht ashtu siç e ka thënë **Aristoteli**, shekuj më parë, se "nuk janë përcaktues të identitetit cilësitë fizike të shtetit por forma dhe përmbajtja e sistemit qeverisës" (Aristotle, *The Politics*, Ernest Barker, ed., transl., Oxford UP: Oxford, 1962, fq. 98-99). Autorët tanë, ndërkaq, në fq. 107, ia mveshin **Aristotelit,** sikur ai paska pas thënë se identiteti është i krijuar brenda kushtetutës. Nga kjo del se teksti kushtetues paraqet shenjën më të dukshme të identitetit kushtetues, i cili ankorohet në dispozita konkrete të këtij teksti, sikundër edhe në pjesën hyrëse (preambulë) të tij. Me tekst nënkuptohet edhe diskursi kushtetues që krijohet përgjatë shekujve në një vend ku nuk ka kushtetutë të shkruar, si p.sh. rasti i **Britanisë së Madhe.**

Identiteti kushtetues operon në një kontekst të dhënë material sociokulturor dhe ekziston një marrëdhënie ndërmjet këtij konteksti dhe identitetit kushtetues, ndaras nga vetë teksti kushtetues. Sipas disa autorëve, ajo marrëdhënie është dialektike, në kuptimin që identiteti kushtetues i përcaktuar nga teksti kushtetues dhe nga përvoja e bazuar në të nuk bëjnë asgjë tjetër vetëm se reflektojnë strukturën e dhënë materiale socio-kulturore duke i dhënë rrugë dhe formë konkrete (Cf. Robert C. Post, "Foreword: Fashioning the Legal Constitution: Culture, Courts and Law", *Yale Law School Faculty Scholarship Series*, Paper 179, 2003). Kjo pikëpamje buron nga **Hegeli** (Friedrich G.W. Hegel, cituar sipas Andrew Arato, *Civil Society, Constitution and Legitimacy*, Rowman & Littlefield Publishers: Maryland, 2000, fq. 169) dhe **Edmund Burke** (cituar sipas Gary J. Jacobsohn, "Constitutional Identity", 2006, fq. 372). Sipas autorëve të tjerë, kjo marrëdhënie është dialoguese, në kuptimin që identiteti kushtetues i bazuar në tekst dhe përvoja marrin një formë të re dhe konkrete nëpërmjet jetësimit të tyre në praktikë. Në rastin e fundit, kjo nënkupton se identiteti kushtetues nuk është i rrënjosur në strukturën materiale socio-kulturore të një shoqërie sepse teksti kushtetues dhe përvoja e bazuar në të ngërthejnë zotime dhe aspirata të cilat paraqesin manifestim të historisë së kaluar nacionale të një populli dhe janë shprehje e vendosmërisë së tij për të tejkaluar një të kaluar të tillë. Kjo pikëpamje, në literaturën moderne, fillon me **Jürgen Habermas**-in (Cf. Jürgen Habermas, "Struggles for Recognition in the Democratic Constitutional State", në Charles Taylor, ***Multiculturalism, Examining the Politics of Recognition*** (Princeton UP: New

Jersey, 1994, fq. 129-135). Si autorët e parë, ashtu dhe të dytët, kanë shumçka që pa asnjë dyshim mund të cilësohet si mendim i qëlluar i cili vlen për disa identitete kushtetuese. I pari, ta zëmë, do të ishte i qëlluar kur flitet për identitetin kushtetues amerikan apo zviceran, kurse i dyti do të ishte shumë i qëlluar për identitetet kushtetuese të tipit francez, gjerman, austriak, të ish-vendeve komuniste të **Evropës**, përfshirë këtu **Kosovën** edhe më shumë se vendet e tjera të Lindjes komuniste, pastaj Izraelin (Cf. Gary J. Jacobsohn, **Constitutional Identity**, 2010 fq. 150-168 etj.). Sa i përket Kosovës, kjo është qartë e shprehur jo vetëm në dispozitat konkrete kushtetuese, por qysh në Deklaratën e Pavarësisë dhe në preambulën e Kushtetutës së Kosovës. Në dy këto tekste shprehet qartë synimi dhe zotimi i Kosovës për të ikur nga e kaluara e hidhur me qëllim të ndërtimit të një të ardhme krejt të veçantë krahasuar me historinë tragjike të vendit. Sa u përket vendeve të tjera të ish-Jugosllavisë, lexuesin tonë e referojmë te një punim i shkëlqyer i masterit i Vedrana Baričević, ***Constitutional Identity in the Socialist Yugoslavia and the Successor States: Did the Break With the Past Really Occur?,*** mbrojtur në Departamentin e Shkencave Politike të "Central European University" (Budapest (2007). Autorja, në mënyrë interesante, shpjegon si janë krijuar gjatë ish-Jugosllavisë identitetet aktuale të ish-vendeve jugosllave duke u bazuar në analizën e nacionalizmave lokalë dhe në përgjigjen juridiko-kushtetuese që këta nacionalizma i kanë marrë gjatë kohës së ish-Jugosllavisë (Cf. në veçanti kapitullin 2: "Ambiguities of Constitutional Identity in the Socialist Yugoslavia: Foundation for Ethno-Nationalist Politics in the Post Yugoslav States", fq. 18-40).

Nga sa u tha më sipër, qartë shihet se identiteti kushtetues është një tërësi komplekse e faktorëve, ndër të cilat kushtetutat luajnë një rol të rëndësishëm për aq sa instalojnë praktika dhe institucione që formësojnë identitetin e bazuar në to dhe, anasjelltas, të njëjtat nuk kanë një rëndësi vendimtare për aq sa praktikat dhe institucionet e ndërtuara aty nuk kanë marrëdhënie dialoguese me tekstin. Nga kjo del se **Franca** nuk mund të ketë identitet sistemin semipresidencial degolist të instaluar me Kushtetutën e vitit 1958, e as **Kosova** identitet kushtetues ekskluzivisht të ankoruar në tekstin kushtetues, pa i pasur parasysh përvojat tragjike nga e kaluara e saj. Në këtë kuptim, kapitulli III i Kushtetutës, shërben si pikë referimi për një identitet të ri të Kosovës që e dallon nga ai i pritur nga popullsia shumicë, por kjo nuk shihet nga ky kapitull, por nga parimet definuese të Shtetit të Kosovës dhe formës së qeverisjes dhe institucionet që veprojnë

në emër të **Shtetit të Kosovës**. Kjo është arsyeja që **Gjykata Kushtetuese** shumë shpesh në vendime te saj përdor sintagmën "germa fryma dhe shpirti i Kushtetutës". Në këtë trinom duhet kërkuar identiteti i ri kushtetues i **Kosovës** dhe jo në tekstin e thatë kushtetues dhe dispozitat e kapitullit të tretë në mënyrë përjashtuese.

Seksioni që flet për funksionet e kushtetutës vazhdon me nënseksionin nr. 4 në fq. 108-110: këtë nënseksion, autorët tanë japin disa konstatime absurde dhe naive, gjithnjë duke cituar në mënyrë manipulative dhe abuzive autorë të tjerë (kryesisht të huaj). Si konstatim absurd është ai në faqe, 109, kur thonë si vijon: "një ndër kushtetutat e para të cilat kanë proklamuar ndarjen e pushteteve dhe kontrollin reciprok të tyre është Kushtetuta e SHBA-në, duke u bërë kështu një kushtetutë që shërbeu si udhërrëfyese për të jetësuar këtë parim, i cili është prezent në të gjitha kushtetutat e botës". Këtë konstatim e bazojnë, gjykuar sipas fusnotës së tyre nr. 314, në librin ***The Oxford Introductions to U.S. Law: Constitutional Law*** (Oxford UP: Oxford, 2010) të autorëve **Michael C. Dorf** & **Trevor W. Morrison** (fq. 95-124). Konstatimi absurd konsiston në atë se parimi i ndarjes së pushteteve nuk është prezent në të gjitha kushtetutat e botës: jo të gjitha shtetet sot janë demokraci kushtetuese liberale. Përveç kësaj, e vërteta është se Kushtetuta e SHBA-së nuk "është një ndër kushtetutat e para", por ekskluzivisht e para që ka instaluar parimin e ndarjes së pushteteve. Në librin si më sipër të autorëve **C. Dorf** & **Trevor W. Morrison**, nuk gjendet as edhe një fq e vetme, përfshirë fq. 95-124, ku të konstatohet ashtu siç pretendojnë autorët tanë. Konstatimi naiv i tyre, ndërkaq, i dhënë në fq. 109, konsiston në thënien se "përmes kushtetutës parashihen edhe kompetencat e qeverisë, të cilat zakonisht janë të natyrës ekzekutive dhe kanë për qëllim drejtimin e shtetit". Si argument për këtë konstatim kaq "shkencor" autorët tanë përdorin, as më pak e as më shumë, nenet 64, 84 dhe 93 të Kushtetutës së Kosovës. Këta harrojnë se Kushtetuta e Kosovës gjendet në internet dhe çdokush mund të ketë qasje në te për të parë se për çfarë bëjnë fjalë këto tri nene (sic!). Në vijim të këtyre konstatime "shkencore" është edhe ai në fund të fq. 109 që vazhdon në paragrafin e parë të fq. në vijim, ku thuhet:

> Siç u përmend më sipër, për shembull kushtetutat përcaktojnë dallime të qarta në kompetencat e shefit të shtetit, në sistemin presidencial, semipresidencial ose parlamentar. Kjo nënkupton se, në vendet ku Presidenti zgjidhet nga populli, kompetencat e tij në parim janë më të forta se sa presidenti i cili zgjidhet nga parlamenti.

Këtë konstatim, për fat të keq, publiku ynë e dëgjon nga disa juristë kosovarë që mendojnë se pozitën dhe rolin e presidentit në një vend e përcakton mënyra e zgjedhjes, jo kushtetuta dhe dizajni kushtetues i qeverisjes. Për dallim nga tjerët, që flasin me hamendje, autorët tanë kanë cituar një burim të tyre në fq. 318, i cili fare nuk ekziston. Krejt çka ekziston dhe që i ngjason autorit që autorët tanë e citojnë ka të bëjë me një tjetër autor çek **Miroslav Novák** dhe shkrimin e tij të njohur me titull, "Is There One Best 'Model of Democracy'?", botuar në *Czech Sociological Review* (vol. 5, no. 2, Fall 1997, fq.131-157). Ky autor, megjithatë, nuk flet për sistemin presidencial por për *efiçiencën* politike si një element i rëndësishëm më rastin e përzgjedhjes së dizajnit kushtetues apo modelit të demokracisë në një vend. Diskutimi i këtij autori është komparativ dhe teorik, duke krahasuar sistemet e ndryshme demokratike dhe teoritë e ndryshme me qëllim të konstatimit se efiçienca politike ka rëndësi kryesore në një dizajn kushtetues apo model të demokracisë.

Nënseksioni i fundit i seksionit që ka të bëjë me trajtimin e funksioneve të kushtetutës mbyllet me diskutimin lidhur me raportin e shtetit me fenë" (fq. 111). Në këtë faqe, lexuesi do të gjejë konstatimet e çuditshme që fusin në një thes **Greqinë** dhe **Egjiptin**, si pasojë e faktit që, siç e thonë autorët tanë, këto dy vende kanë të përcaktuar si fe zyrtare një fe të caktuar. Më këtë, autorët tanë e fusin Greqinë në kategorinë e të a.q. teokraci kushtetuese, përkatësisht të vendeve në të cilat feja apo besimi fetar i caktuar përbën burim primar të së drejtës. Këto dy vende, megjithatë, nuk janë të njëjta sa i përket marrëdhënies së tyre me besimin fetar. Pse atëherë autorët tanë bëjnë kësi gabimi? Këtë bëjnë si pasojë e mosnjohjes thelbësore nga ana e tyre të modeleve kushtetuese bashkëkohore lidhur me raportin mes shtetit si fesë dhe anasjelltas. Autorët tanë, mendojnë se ekzistojnë vetëm dy qasje apo, siç i quajnë, drejtime: drejtimi që përcakton një fe zyrtare në shtet dhe tjetri që nuk e bën një gjë të tillë. Në grupin e dytë, sipas tyre, hyjnë vendet si **Turqia**, **Kosova**, **Shqipëria**, **Franca**, **SHBA** etj. Kjo është kështu sepse, gjithnjë sipas autorëve, ky grup i shteteve nuk përcaktuakan një fe zyrtare, duke përqafuar kështu një koncept më liberal dhe më neutral sa i përket raportit të shtetit me fenë. Ky referim, përkatesisht thjeshtëzim i një çështje kaq me rëndësi për njerëzimin vështirë se mund të pajtohet me gjendjen reale të gjërave. E vërteta është se aktualisht ekzistojnë së paku nëntë modele që shpjegojnë raportin mes shtetit dhe fesë apo besimit të caktuar. Para se të tregojmë se cilat janë këto modele dhe cilat vende bëjnë pjesë në to, këtu vlen shumë shkurt të

sqarojmë kuptimin e shtyllës mbi të cilën qëndron secili model, përkatësisht kuptimin e asaj që njihet me emrin **laicitet**. Kjo ka rëndësi të sqarohet këtu me këtë rast sepse Kosova në mënyrë shprehimore ka një fjali në nenin 8 ["Shteti Laik"] të Kushtetutës që në dy pjesë përcakton marrëdhënien e Kosovës ndaj fesë dhe shtyrjen e fesë dhe besimit fetar dhe tjetër në sferën ekskluzivisht private të individit.

Termi "laicitet" (frëngjisht: ***laïcité***) ka lindur në **Francë,** pas vitit 1789 dhe lidhet me humbjen graduale të pushtetit dhe burimeve laike të tij nga ana e kishës (shtetëzimi i pronës së kishës, zhdukja e monopolit të kishës në edukim dhe kështu me radhë). Kjo ka pasur për pasojë zvogëlimin gradual të numrit të pjesëmarrësve në ritualet fetare dhe rritjen e numrit të jobesimtarëve, përkatësisht në vetëdijesimin ndër njerëz se çështja e fesë dhe moralit duhet dhe mund të reduktohet në sferën private të individit. U mor vesh, shteti modern nuk ka arritur të ketë sukses në këtë shtyrje, ashtu që aktualisht modelet si më sipër, të fokusuara në marrëdhënien kushtetuese të shtetit ndaj fesë, besimit fetar dhe besimeve të tjera, konsistojnë në sa vijon:

1. modeli ateist dhe i eliminimit proaktiv të religjionit (vendet komuniste si **Kina**);
2. modeli i laicitetit ofensiv dhe militant, i përqafuar zakonisht si reagim ndaj prapambeturisë dhe dominimit fetar (**Franca**, **Turqia** para ndryshimeve kushtetuese të **Erdoğanit** etj.);
3. modeli i ndarjes së shtetit nga besimet fetare si qëndrim neutral, zakonisht i shoqëruar me një qasje asimiluese ndaj dallimeve fetare dhe kulturore (**SHBA**);
4. modeli i ndarjes së butë të shtetit nga feja me akomodim *de facto* të diversitetit dhe dallimeve fetare, pa synuar asimilimin e tyre (**Afrika e Jugut**, **Kanadaja** etj.);
5. modeli i ndarjes së shtetit nga besimet fetare, mirëpo duke përcaktuar formalisht për çështje ceremoniale një fe si "fe shtetërore" (**Anglia**, **Norvegjia**, **Danimarka**, **Greqia**, **Islanda, Qiproja** etj.);
6. modeli i ndarjes formale të fesë nga shteti, por *de facto* tolerohet hegjemonia e kishës dhe e imoralitetit kishtar në sferën kushtetuese (**Irlanda**, **Italia**, **Malta**, **Polonia**, **Portugalia**, **Spanja** etj.);
7. modeli i akomodimit selektiv të fesë në fushat e caktuara të së drejtës, zakonisht me "enklava juridiksionale fetare" në çështjet e statusit personal, familjar dhe edukimit (**India, Izraeli**, **Kenia** etj.);

8. modeli i "enklavave laike juridiksionale", ku shumica e së drejtës është fetare por një pjesë e saj, kryesisht në fushën ekonomike-biznesore, shkëputet prej ndikimit të së drejtës fetare (**Arabia Saudite**, **Katari** etj., ku ligjet kanë rrënje të thella fetare dhe interpretimi i tyre duhet të bëhet sipas parametrave fetar kuranor); dhe, së fundi,
9. modeli i përzier i zbatimit të parimeve të përgjithshme fetare dhe parimeve të së drejtës laike, ashtu që tërë sistemi bazohet në lojalitetin e njëkohshëm ndaj librave të shenjta fetare dhe dispozitave laike kushtetuese (**Afganistani**, **Egjipti**, **Iraku**, **Irani**, **Jemeni**, **Pakistani**, **Sudani** etj., po ashtu ligjet kanë rrënjë të thella fetare dhe interpretimi i tyre duhet të bëhet sipas parametrave fetarë kuranorë).

Kosova, sipas redaktimit të dispozitës së nenit 8 të Kushtetutës, bën pjesë në grupin e vendeve që kanë qëndrim neutral ndaj fesë dhe besimeve fetare, pra, shteteve nën 2, 3 & 4. Nën 2 & 3, sepse laiciteti kosovar është kategori kushtetuese shprehimore, mirëpo nuk është laicitet militant dhe ofensiv dhe as që synon asimilimin e diversitetit fetar dhe kulturor në Kosovë. Shikuar nga këndvështrimi i fundit në nr. 4 i modelit kushtetues, **Kosova** më shumë i ngjason **Afrikës së Jugut** dhe **Kanadasë**. Kështu do të kishin menduar edhe autorët tanë sikur të kishin konsultuar literaturën aktuale kushtetuese mbi laicitetin dhe zgjidhjet kushtetuese krahasimore. Këtë nuk e kanë bërë dhe, për pasojë, i kanë ofruar lexuesit një mendim që fare nuk korrespondon me realitetin krahasimor kushtetues, përfshirë këtu edhe vendin e Kosovës në këtë realitet. Literatura që është dashur të konsultohet, në mes tjerash dhe në veçanti, paraqitet si vijon: Ran Hirschl, ***Constitutional Theocracy*** (Harvard UP: Harvard, 2010, fq. 26-40); Ran Hirschl, "Comparative Constitutional Law and Religion", botuar në Tom Ginsburg and Rosalind Dixon (eds.), ***Comparative Constitutional Law*** (Edward Elgar: UK & USA, 2011, fq. 422-437); András Sajó and Renata Uitz, "Freedom of Religion", botuar në Michel Rosenfeld & András Sajó (eds.), ***The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*** (Oxford UP: Oxford, 2012, fq. 922-926).

Lexuesi mund ta gjejë interesant dhe shumë enigmatik titullin e seksionit "Vetitë dhe atributet e kushtetutës". Është interesant sepse bëhet fjalë për dy cilësime që kanë kuptimin e njëjtë si nocione gjuhësore, kurse enigmatik sepse në shikim të parë do të sfidohet intelektualisht për të qëlluar se çfarë përmban ky seksion. Lidhur me këtë të fundit, në mënyrë apodiktike mund të thuhet se të a.q. veti/atribute të një kushtetute nuk janë veçse një riformulim kaotik i atyre që më herët u quajtën "funksione të kushte-

tutës". Lista e këtyre vetive/atributeve nis me "kushtetutën si një ligj themelor dhe suprem", kurse burimet e cituara për këtë konstatim janë të manipuluara dhe të përdorura në mënyrë abuzive. E kemi fjalën librin e sipërcekur të **Carl Schmitt**-it, të cituar fusnotën nr. 331, për të cilin pohohet se me cilësinë e kushtetutës si akt më i lartë juridik ka nënkuptuar "pothuajse të gjitha statutet ose marrëveshjet që janë dhe kanë qenë të një rëndësie të lartë politike janë quajtur ligje bazë". Sikundër shihet, ky ripohim është tërësisht konfuz dhe i pakuptueshëm. Përveç kësaj, dhe mbi të gjitha, ky pohim është jo i saktë për nga natyra e angazhimit intelektual dhe praktik të **Carl Schmitt**-it. Nuk ka mundur të thotë diçka të tillë një jurist konservator që tërë karrierën e vet profesionale e ka shpenzuar duke arsyetuar diktaturën e djathtë naziste dhe rolin vendimtar të vullnetit politik të ***führer***-it në definimin e statusit politik të kombit gjerman. Një leksim i ndërgjegjshëm, me kujdes dhe sipas rregullave të profesionit, i fq. 94 të librit të **Carl Schmitt**-it, qartë tregon për të kundërtën e asaj që citohet në Kosovë nga autorët tanë: në këtë vend, autori gjerman flet për aspektet pluralistike dhe relative të termit e drejtës kushtetuese, pra jo për kushtetutën. Me termin kushtetutë, ky autor kupton vendimin total mbi natyrën dhe formën e unitetit politik të një kombi, përkatësisht vendimin me të cilin ushtrohet ai lloj i pushtetit që cilësohet si pushtet kushtetutëbërës origjinal, me të cilin përcaktohet (definohet) unitetin politik nacional. Sipas këtij autori, ky vendim konkret është superior dhe jo teksti eventual kushtetues që më pastaj mund të prodhohet nga përfaqësuesit e sovranit. Ky është një dallim i madh me atë që thonë autorët tanë. Pas këtij manipulimi abuziv me idetë e këtij autori gjerman, autorët tanë, ripërsëritjen për të satën herë të arsyeve pse një kushtetutë cilësohet si akti më i lartë brenda një shteti. Këtë herë ripërsërisin *ad literam*, por pa cituar fare burimin, fjalët dhe konstatimet e **Kurtesh Saliut** nga fq. 52 i librit të tij të sipërcekur. Faqja në vijim ka plot moskuptime, ripërsëritje dhe tautologji si dhe paragrafë jashtë temës (fq. 114). Me konstatime të tilla pa asnjë kuptim dhe të pavenda mbyllet seksioni. Çfarë lidhje dhe kuptimi me cilësinë/atributin e një kushtetute ka citimi në fusnotën 343 (fq. 90) i librit ***Constitutions Compared*** (Intersentia: Antwerp, 2009), të autorëve **Aalt Willem Heringa** & **Philip Kiiver**, që flet për presidentin gjerman dhe francez?

Seksionin në vijim, "Supremacia si një atribut i kushtetutës dhe sfida nga e drejta ndërkombëtare", i dedikohet kryesisht sfidave që lidhen me atë që sot cilësohet si "ndërkombëtarizimi i të drejtës kushtetuese". Ky term përshkruan fenomenin gjerësisht të përhapur pas mbarimit të Luftës

së Ftohtë, por që ka nisur qysh me revolucionin amerikan dhe francez. Me të drejtë ndërkombëtare, autorët tanë nënkuptojnë ekskluzivisht zakonin ndërkombëtar dhe të drejtën e traktateve. Në ndërkohë, që të gjitha tekstet e së drejtës ndërkombëtare, në botën bashkëkohore i japin primat absolut marrëveshjeve ndërkombëtare kundrejt zakonit ndërkombëtar, apo normave të së drejtës ndërkombëtare zakonore, autorët tanë vijnë në konstatime të çoroditura duke thënë, në mes tjerash, se "[n]ë rendin e sotëm juridiko-ndërkombëtar, e drejta ndërkombëtare zakonore është ajo që apriori dominon ndaj të gjitha kushtetutave të botës, dhe ky fakt cënon në mënyrë absolute edhe supremacinë kushtetuese" (fq. 116). Kjo në fakt, nuk është e vërtetë aspak, siç nuk është i vërtetë as konstatimi i tyre që thotë se "[s]a i përket të drejtës ndërkombëtare zakonore, duhet pasur parasysh se kjo rregullativ ligjore ndërkombëtare nuk njeh supremaci kushtetuese". Ky konstatim jo vetëm që nuk është i vërtetë por në tërësi përbën një absurd të llojit të vet. E drejta ndërkombëtaren tërësinë e saj nuk njeh as supremaci kushtetuese e as supremaci qeveritare sepse marrëdhëniet që rregullon kjo degë e së drejtës janë marrëdhënie anarkike apo marrëdhënie ku nuk ka një qeveri centrale dhe një pushtet qendror homogjen. Këtë e mësojnë studentët e drejtësisë nga libri pambarimisht i qartë dhe i këndshëm për t'u lexuar ***E drejta ndërkombëtare publike*** i profesorit **Zejnullah Gruda** (cilido botim i tij). Këtë e thonë të gjithë librat e së drejtës ndërkombëtare nëpër botën bashkëkohore.

Ajo çfarë autorët tanë nuk kanë kuptuar ka të bëjë me llojin e së drejtës ndërkombëtare zakonore që ka supremaci ndaj kushtetutës vendore, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Në tekstet kushtetuese, kjo pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare zakonisht formulohet si "normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare", "normat universalisht të pranueshme të së drejtës ndërkombëtare", "e drejta e përgjithshme ndërkombëtare" apo "normat përgjithësisht të pranueshme të së drejtës ndërkombëtare" etj. Tri formulimet e fundit, në kohën e Luftës së Ftohtë dhe para saj, kanë pasur kuptime të sakta dhe tani sikur janë braktisur. Kjo mund të shihet nga trajtimi i kësaj tematike që iu është bërë nga **Antonio Cassese,** në ligjëratën e tij me titull *Modern Constitutions and International Law*, mbajtur në "Akademinë e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare", në vitin 1985 (*Collected Courses of the Hague Academy of International Law*, vol. 192, Brill Nijhoff: Leiden/Boston, 1985). Dy formulimet e para, ndërkaq, kanë një përdorim më të përhapur aktualisht. Në **Kosovë**, njëjtë si në shumicën e vendeve ish-komuniste, është për-

dorur formulimi "normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare" (neni 19.2 i Kushtetutës). Në këtë grup të normave hyjnë normat *jus cogens* apo normat e detyrueshme nga të cilat nuk mund të ketë shmangie. Ato mund të gjenden të shkruara nëpër traktate dhe burime të tjera të së drejtës ndërkombëtare apo të pashkruara. Në këtë grup të normave hyjnë ato që kanë të bëjnë me ndalimin e gjenocidit, skllavërisë, aparteidit, piratërisë, imunitetit dhe privilegjeve diplomatike etj. Vlen të theksohet këtu se shtetet në përgjithësi kanë rezerva sa i përket të drejtës ndërkombëtare zakonore të përgjithshme, pra të drejtës zakonore, që nuk ka natyrën e normave *jus cogens*. Në këtë kuptim, shumë të rralla janë shtetet që kanë dispozita kushtetuese që i japin vend meritor të drejtës zakonore të përgjithshme në sistemin e brendshëm (**Gjermania**, ta zëmë).

Më e udhës do të kishte qenë sikur autorët tanë të ishin marrë me analizën e teksteve kushtetuese, se që janë marrë me teoritë mbi marrëdhënien mes të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare, duke ripërsëritur konstatimet e autorëve **L. Omari** & **A. Anastasi**. Po ta kishin bërë këtë, do të kishin prodhuar një tekst me një narrativ koherent dhe të qartë për studentin tonë dhe lexuesit e tjerë, jo një kaotik si ky nga i cili asnjëherë nuk mund të kuptohet se cila është pozita e **Kosovës** ndaj të drejtës ndërkombëtare. Jo vetëm kaq, nga teksti i prodhuar i autorëve tanë, nuk mund të dihet se cilat pjesë të së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi përbëjnë objekt rregullimi të së drejtës kushtetuese nëpër botë. Të shohim tutje, veç si më sipër, cilat janë shkarjet profesionale të shfaqura në këtë seksion.

Në kontekstin e diskutimeve teorike të marrëdhënies mes të drejtës së brendshme dhe asaj kushtetuese dhe standardit përgjithësisht të pranuar sipas të cilit qëndrimi miqësor, ndaj të drejtës ndërkombëtare, mund të shkojë deri aty sa të pranojë epërsinë e saj ndaj çdo ligji veç kushtetutës, autorët tanë përdorin si argument në mbështetje të këtij standardi **Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve** (**KVDT**). U mor vesh, ky përdorim bëhet në mënyrë të gabuar: redaktimi dhe përmbajtja e nenit 47, të KVDT-së, ka një kuptim krejtësisht tjetër nga sigurimi i supremacisë të së drejtës ndërkombëtare kundrejt të drejtës së brendshme, veç kushtetutës (siç besojnë autorët tanë). Ai kuptim konsiston në si vijon: në marrëdhëniet e komunikimit ndërkombëtar, shtetet duhet të zbatojnë me mirëbesim (***bona fide***) detyrimet e tyre kontraktuese dhe nuk mund të thirren në pengesat që ekzistojnë në të drejtën e brendshme, për t'i mohuar ato. Kjo është arsyeja që në kushtetuat e reja, përfshirë atë të Kosovës, gjenden

dispozita që theksojnë qartë se tërheqja dhe denoncimi i një detyrimi kontraktues duhet të ndjekë të njëjtën procedurë në të cilën është pranuar. Thënë me fjalë të tjera, shteti kontraktues nuk mund të thotë pas marrjes së një detyrimi apo pas zotimit për të pranuar një detyrim me marrëveshje se ekzistojnë pengesa të brendshme ligjore që e pamundësojnë vënien në jetë të një detyrimit të tillë, ta zëmë pengesat me ratifikim kushtetues. Këtë e kemi parë në rastin e Kosovës, me **Marrëveshjen për Kufirin me Malin e Zi** (2015), të nënshkruar nga pala jonë në vitin 2015, por që i mohohej ratifikimi kushtetues në Kuvend, për një kohë të gjatë.

Kjo qasje kaotike e autorëve tanë, që përdor **KVDT**-në, si argument për një pozicion që nuk ekziston, shpërfaq nevojën për t'u sqaruar autorëve se aktualisht ekzistojnë modele të qarta praktike, që normojnë marrëdhënien mes të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare. Në këtë kontekst, me të drejtë ndërkombëtare nënkuptohen vetëm normat që kanë të bëjnë me burimet primare të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht me traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe zakonin ndërkombëtar. Kjo është arsyeja pse në shumicën e kushtetutave zakonisht definohet së pari marrëdhënia e së drejtës së brendshme me të drejtën e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, e tek më pastaj me të drejtën zakonore ndërkombëtare. Kështu është edhe në **Kushtetutën e Kosovës** (neni 19.2).

Në vijim të kësaj, aktualisht ekzistojnë disa modele lidhur me marrëdhënien mes të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme. **Modeli i parë** është ai britanik dhe i vendeve që modelohen sipas tij: këtu e drejta ndërkombëtare kontraktuale, për t'u bërë e drejtë britanike, duhet të transformohet në të drejtën e brendshme, përmes ligjit apo aktit tjetër relevant juridik, në vartësi të lëmit që normon marrëveshja e arritur ndërkombëtare, në emër të këtij vendi. Në këtë grup hyjnë edhe disa ish-koloni britanike. **Modeli i dytë** është më i përhapuri aktualisht dhe ia njeh marrëveshjeve të ratifikuara dhe të drejtës së përgjithshme zakonore ndërkombëtare, fuqinë më të lartë se ligjet e zakonshme dhe më të ulët se kushtetuta nacionale. Në këtë kategori hyn **Kosova** dhe një pjesë e ish-vendeve komuniste. **Modeli i tretë** është ai i vendeve që barazojnë marrëveshjet ndërkombëtare dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, me ligjin e vendit, u njohin traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut një status të privilegjuar, kurse nuk lejojnë që të lidhen marrëveshje ndërkombëtare në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet e vendit. **Modeli i katërt** është ai i **Holandës**, që i njeh përparësi të drejtës ndërkombëtare, asaj të përgjithshme dhe zakon-

ore, jo një përparësi të lehtë, siç thonë autorët tanë, por një përparësi të fortë dhe të qartë: dispozitat e neneve 91.3 & 93-95 të **Kushtetutës së Holandës** (1815), normojnë çdo aspekt të përparësisë së detyrimeve ndërkombëtare kontraktuese të këtij vendi, përkatësisht fuqinë e tyre juridike në sistemin kushtetues.

Sa i përket të drejtës zakonore, kushtetutat zakonisht përcaktohen për fuqinë absolute të detyrueshme, të së drejtës zakonore *jus cogens*, kurse, për pjesën tjetër të së drejtës zakonore ngelin të heshtura. Ka qenë **Kushtetuta e Vajmarit** (1919), ajo që për herë të parë ka normuar vendin dhe pozitën e së drejtës ndërkombëtare zakonore, në sistemin e brendshëm kushtetues, siç ka qenë edhe **Ligji Themelor i Gjermanisë** (1949), ai që për herë të parë në mënyrë të qartë ka përcaktuar pozitën dhe rolin e së drejtës ndërkombëtare zakonore ***jus cogens***, në sistemin kushtetues të këtij vendi. Zakonisht shtetet nuk prononcohen fare për vendin dhe pozitën e së drejtës ndërkombëtare zakonore ***jus cogens***, në sistemin e brendshëm juridik, por vetëm për të drejtë të përgjithshme zakonore. I tillë është rasti me Kushtetutën e Afrikës së Jugut, neni 232. Mirëpo, kjo nuk ka rëndësi sepse këto norma vlejnë dhe kanë epërsi ndaj çdo norme kushtetuese. Pjesa tjetër e së drejtës zakonore ndërkombëtare nuk ka këtë fuqi ashtu që, mospërfshirja e saj në kushtetutë nacionale, bën që ai lloj i të drejtës ndërkombëtare të mos gjejë zbatim në të drejtën e brendshme. **Kosova** hyn në kategorinë e shteteve që fuqishëm ka futur në sistemin e vet, epërsinë e së drejtës zakonore ndërkombëtare ndaj çdo ligji të zakonshëm, kurse sa u përket normave ***jus cogens*** nuk ka bërë prononcim – një gjë e tillë nuk ka nevojë të bëhet, ngaqë këto norma kanë epërsi absolute ndaj çdo norme kushtetuese. Në rastin e **Kosovës**, për një kategori të këtyre normave ***jus cogens***, në mënyrë shprehimore përcaktohet përparësia e tyre absolute ndaj Kushtetutës së Kosovës. Këtu e kemi fjalën për nenin 33.1 ["Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale"] të Kushtetutës. Kjo është specifika e parë e **Kosovës**, që e bën të dallueshme nga shumica e vendeve të **Evropës**, përfshirë vendet ish-komuniste.

Specifika tjetër e Kosovës, që gjendet edhe në **kushtetutat** e **Bosnjë-Hercegovinës** dhe të **Qipros**, ka të bëjë me statusin juridik të disa instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë njerëzore. Në disa vende, marrëveshjet ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë njerëzore kanë një status të privilegjuar sepse në kushtetutat nacionale figurojnë më lartë se ligji i zakonshëm. Në këtë kategori hyjnë një pjesë e vendeve ish-komuniste, përfshirë **Shqipërinë** dhe **Maqedoninë**, që me të

drejtë autorët tanë i përmendin si të tilla në fq. 117. Autorët tanë e kanë shumë gabim, ndërkaq, kur në këtë kategori e fusin edhe **Kosovën**: sipas nenit 19.2 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës, epërsi ndaj secilit ligj kanë marrëveshjet e ratifikuara dhe zakoni i përgjithshëm ndërkombëtar. Instrumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare nga neni 22 ["Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"] i Kushtetutës, kanë status të normës kushtetuese, jo status të privilegjuar. Kjo qasje siç u tha ekziston në **Bosnjë-Hercegovinë** dhe **Qipro**. Sa i përket të drejtës së përgjithshme zakonore dhe burimeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare, në Kosovë ato kanë statusin më të lartë juridik se ligjet vendore, kurse e drejta ndërkombëtare ***jus cogens*** ka epërsi mbi vetë **Kushtetutën e Kosovës**. Në këtë kontekst, një gabim edhe më i madh i autorëve tanë është kur në po të njëjtën fq. 117, duke cituar autoren e njohur **Anne Peters** dhe shkrimin e saj "Supremacy Lost: International Law Meets Domestic Constitutional Law", botuar në *Vienna Journal of International Constitutional Law* (vol. 3, issue 3, 2009, fq. 170-198), konstatojnë se "në përgjithësi është vërejtur kryesisht një tendencë e vendeve pas tranzicionit, sidomos tek kushtetutat e reja, që i është dhënë një përparësi e së drejtës ndërkombëtare ndaj asaj vendore". Shkrimi i autores Anne Peters, në fakt, mbron tezën e kundërt dhe jep një pasqyrë shumë reale, në planin global të marrëdhënies mes të drejtës kushtetuese dhe asaj ndërkombëtare, duke konstatuar se rendi plural i dy rendeve paralele, e bën këtë marrëdhënie të vështirë si pasojë e rezistencës permanente ndaj supremacisë të së drejtës ndërkombëtare. Ky shkrim, në tërësi teoriko-filozofik, në fq. që autorët e citojnë flet për të kundërtën e asaj që thuhet: seksioni nën tre mban këtë titull "III. Rejection of the Supremacy of International Law over Domestic Constitutional Law" (fq. 187-194) dhe trajton vendet e Evropës, si demokracisë tradicionale (në shumicë) ashtu dhe ish-vendet komuniste (në pakicë) dhe konstaton që as **Bosnjë-Hercegovina** nuk ia njeh supremacinë të drejtës ndërkombëtare në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, ani se kushtetua e këtij vendi është pjesë e një traktati ndërkombëtar (sic!).

Kjo aventurë e autorëve tanë me citime manipulative dhe abuzuese ka vazhduar edhe në fq. 119-135 të këtij kapitulli, në të cilën janë përmbajtur 12 seksione. Ne do të ndalemi vetëm në ato gabime dhe manipulime e abuzime me literaturë që janë të dukshme në shikim të parë, ***prima facie***, siç kemi premtuar në fillim të kësaj analize kritike. Në të shumtën e rasteve, citimet iu referohen thënieve e konstatimeve të autorëve që kanë na-

tyrë të përgjithshme, ***recta ratio***, që nuk kanë nevojë për citime fare sepse nuk kontestohet dhe as nuk provohet diçka e re. Në disa raste jepen definicione që i rezistojnë mendjes së shëndoshë dhe, meqë nuk citojnë asnjë burim, e shtyn lexuesin të besojë se fjala është për deklarata me hamendje dhe hamendësime që nuk i shkojnë një teksti që pretendon zënien e një vendi meritor në gjirin e shkencës juridike dhe profesionit të juristit. I tillë është rasti me definimin e rendit kushtetues në fq. 119. Në këtë vend, autorët tanë rendin kushtetues e definojnë si: "aplikim praktik i një kushtetute të miratuar. Përkatësisht, jetësimi në praktikë i një 'kushtetute në letër' është pikërisht një rend kushtetues. Në këtë drejtim, ka forma të ndryshme sa i përket relacionit kushtetutë dhe rend kushtetues, si dhe qartësimi i tyre". Sikundër u tha, për këtë definim, tërësisht konfuz dhe me një ndërtim mendimi që vështirë se mund të kuptohet nga lexuesi i vëmendshëm, autorët tanë nuk citojnë askënd. Nuk citojnë sepse vetë definicioni i tij dhe ideja për diskutimin e rendit kushtetues buron nga burimi që autorët tanë e fshehin. E kemi fjalën për fq. 9 ("The constitution and constitutional order") të librit të autorit të sipërcekur **Elliot Bullmer**. Ky autor e definon rendin kushtetues, në mënyrë të përmbledhur dhe të shkëlqyer, duke cituar disa autorë të tjerë, si koncept që ankorohet në kulturën politike të një shoqërie, përkatësisht në tërësinë e normave, praktikave, zakoneve, konventave, traditave, strukturave administrative, sistemeve partiake dhe vendimeve gjyqësore të cilat janë pjesë përbërëse e mënyrës së jetësimit të kushtetutës. Të kuptuarit e rendit kushtetues, nga studenti dhe lexuesi përbën një çështje jetike dhe me shumë relevancë. Këtë fakt si duket nuk e kanë pasur parasysh autorët tanë, të cilët në këtë seksion preokupimin më të madh si duket e kanë pasur si të fshehin burimet origjinale të idesë dhe konceptit mbi rendin kushtetues. Në këtë kontekst, duhet parë kotësinë e citimit të një burimi koti në fusnotën 356, që nuk provon asgjë dhe nuk flet për asnjë send që ka relevancë kushtetuese në lidhje me kuptimin e rendit kushtetues.

Kjo kotësi vazhdon edhe në lidhje me fusnotat tjera, si p.sh. fusnota nr. 365, ku citohet **Hilaire Barnett** dhe fq. 8-10 të librit të tij si më sipër, sikur gjoja ka thënë se Kushtetuta e SHBA-së, është krijuar për të shërbyer si "një garanci për bartjen e pushtetit sovran nga mbreti tek forcat e reja revolucionare, në rastin e Amerikës, në kuadër të 13 kolonive" (sic!). Citime të ngjashme janë me bollëk në fq. paraprake dhe në fq. që e pason: në fq. paraprake, autorët tanë citojnë jashtë kontekstit autorët **Mark Rayan** & **Steve Foster**, mesatarisht librin e tyre ***Unlocking Constitutional and Ad-***

ministrative Law, 3d ed. (Routledge: London, 2013). Në fakt, këtë libër e citojnë gabimisht. Megjithatë, fjala është për të njëjtin libër dhe autorët e njëjtë sepse fq. e cituara janë të njëjta dhe flasin për të njëjtën gjë. Në ndërkohë që definicioni i autorëve tanë për kushtetutën e pashkruar është tautologjik në tërësinë e vet, sepse thotë që "një kushtetutë e pashkruar është ajo që nuk paraqitet në formën e shkruar", **Mark Rayan** & **Steve Foster** në mënyrë të saktë e definojnë kushtetutën në fjalë si "një kushtetutë e pashkruar është kur rregullat kryesore kushtetuese të shtetit nuk mund të gjenden në një dokument të vetëm të shkruar, siç është rasti me Britaninë e Madhe" (fq. 15). Po këtë fq. autorët tanë e citojnë në mënyrë të gabuar, në fusnotën e tyre nr. 370, duke e përkthyer fjalën *parliamentary legislation* si "ligjet e parlamentit". Kuptimi i kësaj shprehjeje në **Britaninë e Madhe,** e ka kuptimin e shënjimit të aktivitetit ligjvënës të parlamentit britanik, si pasojë e supremacisë së tij, në çështjet e kushtetutëbërjes së tij, e cila manifestohet në mënyrë të njëjtë si me rastin e nxjerrjes së çdo ligji. Këtë dallim mes të këtyre dy llojeve të kushtetutave, autorët tanë më mirë do ta kishin sqaruar sikur të kishin cituar dhe asimiluar tekstet në gjuhën shqipe të autorëve të sipërcekur **L. Omari** & **A. Anastasi** dhe **K. Saliu**. Kur të citohen autorët e huaj, duhen cituar në origjinal, pa shtrembërime, ashtu siç kanë thënë. Në origjinal duhet të citohen, pas përpunimit të tyre, edhe autorët e vjetër që kanë krijuar së pari nocionet themelore mbi llojet e kushtetutave. E kemi fjalën për **A.V. Dicey** dhe librin e tij monumental ***The Law of the Constitution*** (1885) (Oxford UP edition, ed. J.W.F. Allison, 2013), i cili në fq. 69 ka definuar në mënyrë të saktë kuptimin e kushtetutës së fortë. Në ndërkohë që autorët tanë thonë se "kushtetutë e fortë është ajo kushtetutë për miratimin dhe ndryshimin e së cilës nevojitet një shumicë e kualifikuar në parlament, përfshirë edhe me miratimin me referendum", A.V. Dicey e definon atë "si një kushtetutë që nuk mund të ndryshohet në mënyrë të njëjtë si ligjet e zakonshme". Autorët e tjerë, vendorë dhe të huaj, pa asnjë përjashtim, këtij definimi të kushtetutave të forta i shtojnë procedurat e vështira për amendamentimin dhe shfuqizim të tekstit ekzistues kushtetues, në mënyrë kumulative apo selektive, po nuk e definojnë si autorët tanë referendumin si cilësi të pandryshueshme të këtij lloji të kushtetutave. Kjo lajthitje e tyre është pasojë e faktit se në të shumtën e rasteve kanë përdorur autorët britanikë, duke i manipuluar fq. dhe përmbajtjet e tyre, me qëllim përshtatjeje në një sistem dhe trajtim të së drejtës kushtetuese që diamterialisht dallon nga ai britanik (sic!). E tillë është edhe lajthitja në seksionin mbi "Kushtetutat federale dhe jo federale

(unitare) si dhe kushtetutat supreme dhe vartëse": këto klasifikime, në veçanti diskutimi mbi kushtetutat supreme dhe kushtetutat e nënshtruara, të cilat autorët i cilësojnë si "vartëse", në tërësinë e vet ka të bëjë me Britaninë dhe modelin britanik të qeverisjes. Të parat, kushtetutat supreme, nuk janë ekuivalente me kushtetutat federale por definohen sipas supremacisë (epërsisë) së organit legjislativ kundrejt çdo autoritetit tjetër, kurse kushtetutat e nënshkruara janë ato ku organi legjislativ kufizohet nga një autoritet tjetër më i lartë. Kjo situatë ekziston edhe në shtete unitare dhe nuk përbën prerogativë të vendeve federale vetëpërvete. Këtë duhet ta dijë lexuesi ynë. Kështu, me shumë të drejtë, e thotë **Hilaire Barnett** (fq. 11-13) dhe autorët **Mark Rayan** & **Steve Foster** (16-17).

Lexuesi i librit, seksionin mbi "Kushtetutat konstituive dhe jokonstituive" (fq. 125-127) mbase do ta ketë lexuar me padurim sepse, si titull, përbën një qasje të re dhe nuk haset lehtë në librat standard (universitar dhe të tjerë) mbi të drejtën kushtetuese. Kriter për ndarjen e kushtetutave në konstituive dhe jo konstituive është fakti nëse një kushtetutë në momentin e miratimit e ka themeluar një shtet të ri, konstatojnë autorët tanë në fq. 125 të librit. Me një sallto mendore të kundërt me këtë, autorët bëjnë konstatimin tjetër për kushtetutën jo konstituive, duke e cilësuar atë si një kushtetutë "e cila ekziston si e tillë, por nuk është kushtetuta e parë për një shtet, ose kushtetuta themeluese e tij". Nga diskutimi i tyre i më pastajmë, qartë shihet se në grupin e parë futen kushtetutat e vendeve si vijon: Kushtetutën e SHBA-së, të vitit 1787, Kushtetutat e Francës, të viteve 1791 dhe 1793 (sic!), Kushtetutën e Shqipërisë, e vitit 1998, por me një dallim që, siç thonë autorët, me këtë kushtetutë qe instaluar regjimi demokratik (pra jo me rrëzimin e komunizmit stalinist shqiptar!), Kushtetutën e Sllovenisë të vitit 1990 dhe 1991, njëjtë si me rastin francez (sic!), Kushtetutën e Malit të Zi, e vitit 2007 dhe, siç mund të pritet, **Kushtetutën e Kosovës,** të vitit 2008, aktualisht në fuqi, e cila, sipas autorëve tanë, paska pas themeluar Republikën e Kosovës. Krejt këto konstatime janë absurde, të mbledhura në mënyrë eklektike dhe me hamendje pa fije analize kritike. Si të tilla, e vënë studentin dhe lexuesin në lajthitje lidhur me atë se çka konsiderohet ***grundnorm*** dhe çka kushtetutë që bazohet në një ***grundnorm***. Kjo do të thotë se autorët tanë nuk e kanë të qartë teorinë bazike mbi origjinën e "kushtetutës së parë historikisht shikuar" (**Hans Kelsen**) apo mbi kushtetutën si "vendimin total mbi natyrën dhe formën e unitetit politik të një kombi" (**Carl Schmitt**). Thënë ndryshe, autorët tanë nuk e kanë të qartë origjinën e "normës së normave". Të shohim nga afër

dhe më gjerësisht se për çfarë bëhet fjalë këtu, meqenëse kemi të bëjmë me koncepte fundamentale të së drejtës kushtetuese bashkëkohore, si teori dhe si praktikë. Ka edhe një arsye tjetër, veç kësaj, që duhet gjerësisht ta trajtojmë këtë çështje kaq fundamentale: **Hans Kelsen** dhe **Carl Schmitt** askund më shumë se në çështjen e ***grundnorm***-ës nuk i ngjasojnë njëritjetrit doktrinarisht dhe konceptualisht, ani se në çdo aspekt tjetër ndryshojnë. Këtu nuk flitet për çështje teorike por për një çështje praktike që studenti ynë dhe lexuesi duhet ta ketë të qartë nëse dëshiron të matet në dijen themelore me të tjerët në Evropë dhe përtej. Ajo që thuhet në rreshtat në vijim për natyrën juridike dhe efektet praktike të Deklaratës së Pavarësisë, si "*grundnorm*" e Kosovës vlen, *mutatis mutandis*, për të gjitha deklaratat e pavarësisë, që nga ajo e SHBA-së (1776) deri te e Malit të Zi (2006).

Deklarata e Pavarësisë përbën "kushtetutën e parë historikisht shikuar", ekzistenca e së cilës prezumohet (**Hans Kelsen**), përkatësisht paraqet vendimin konkret politik të një populli të ndërmarrë në një kontekst të caktuar territorial dhe kohor (**Carl Schmitt**). Në kuptimin e sotëm modern të teorisë kushtetuese, ajo përbën një ushtrim të ***pouvoir constituant*** origjinal të popullit të Kosovës, rrethanë kjo e konstatuar në mënyrë të qartë nga **Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND)** në mendimin e saj këshillëdhënës, të cilit i kthehemi për diskutim më vonë sërish. Në kontekstin kosovar, me "kushtetutë të parë historikisht shikuar" nuk duhet nënkuptuar Kushtetutën e vitit 2008. Një qasje e tillë është e gabuar. Po ashtu gabim logjik është të besohet se **Plani Ahtisaari**, meqë asnjëherë nuk ka ndodhur miratimi i tij askund dhe nga asnjë organ (vendor apo ndërkombëtar), forcën e vet juridike e nxjerr nga Kushtetuta e vitit 2008 (Cf. më shumë për këtë qasje kësisoj në Dren Doli & Fisnik Korenica, "What about Kosovo's Constitution: Is there anything special? Discussing the grundnorm, the sovereignty, and the consociational model of democracy", botuar në *Vienna Journal on International Constitutional Law*, vol. 5, no. 1, 2011, fq. 49-70 në fq.54-5, 69). **Plani Ahtisaari** dhe Kushtetuta e vitit 2008, sa i përket burimit të forcës së tyre juridike, kanë të njëjtën fuqi juridike apo validitet (shprehje e **Hans Kelsen**-it). Ajo buron nga **Deklarata e Pavarësisë**. Ky dokument paraqet zotim të njëanshëm të shtetit të Kosovës, me efekt ***erga omnes***, me qëllim dhe mision të qartë – vënien në jetë të rregullimit kushtetues në Kosovë sipas germës, frymës dhe shpirtit të tij. Sa i përket rendit kushtetues të përkohshëm që ka ekzistuar gjatë periudhës së pavarësisë së mbikëqyrur, nuk ka asnjë dyshim se **Plani Ah-**

tisaari ka pasur supremaci (epërsi) ndaj Kushtetutës së vitit 2008. Kjo ka të bëjë me hierarkinë e normave në kuptimin kelsenian, ku ekzistimi i normës bazike (***grundnorm***) prezumohet: supremacia (epërsia) e **Planit Ahtisaari**, që ka pasur për normë bazike (***grundnorm***) ekskluzivisht **Deklaratën e Pavarësisë**, njëjtë si Kushtetuta e vitit 2008, ka qenë rezultat i qëndrimit të cilin, në parim, bashkësia ndërkombëtare zakonisht e mban gjatë kushtetutëbërjeve në shoqëritë post-konfliktuale. Në fakt, në këto situata, kushtetuta kuptohet si proces në të cilin realizohen shumë qëllime, jo si një moment apo dokument përfundimtar (Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding", *Leiden Journal of International Law*, vol. 27, issue 01, March 2014, fq. 141-168 në fq. 144-145). Ky ekzistim i prezumuar i normës bazike (***grundnorm***) mund të vijë, sipas **Hans Kelsen**-it, si pasojë e një zakoni, revolucioni apo amendamenti kushtetues. Në të gjitha rastet ***grundnorm***-a, përkatësisht "kushtetuta e parë historikisht shikuar" përbën një diçka meta-juridike që supozohet, njëjtë siç supozohet ekzistimi i Zotit. Këtë ***grundnorm*** të presupozuar, njeriu mund ta njohë dhe interpretojë ekskluzivisht përmes procesit kognitiv sepse ka natyrë meta-juridike, pra jo duke e parë si një akt të vullnetit të krijuesit të parë. Fundja, thotë **Hans Kelsen**, Zoti presupozohet dhe nuk mund të krijohet teoria mbi një tjetër subjekt që urdhëron Zotin: ne i marrim urdhrat e Zotit për të dëgjuar prindërit si të mirëqena, kurse ***grundnorm***-a është faktori meta-juridik, Zoti (Hans Kelsen, *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange: Clark, New Jersey: 2002, 2009) fq. 193-194; 198-205).

Në kontekstin kosovar, as **Plani Ahtisaari** dhe as Kushtetuta e vitit 2008, nuk përbën "kushtetutën e parë historikisht shikuar", por **Deklarata e Pavarësisë**: dy dokumentet e parë përbëjnë urdhra që dalin nga **Deklarata e Pavarësisë**. Kjo është kështu sepse Deklarata paraqet ushtrim të ***pouvoirs constituant*** origjinal të popullit të Kosovës, me efekt të një zotimi ndërkombëtar ***erga omnes***, përmbajtja e së cilës ngërthen **Planin Ahtisaari** dhe vetë Kushtetutën e vitit 2008. Ndryshe nuk do të kishte asnjë kuptim mendimi i **GJND**-së për Kosovën, me të cilin konstatohet se "kushtetutë e parë historikisht shikuar" në kontekstin kosovar është **Deklarata e Pavarësisë**, jo **Plani Ahtisaari** apo Kushtetuta e vitit 2008, ose ndonjë akt tjetër derivativ i kësaj deklarate, siç janë ligjet nga **Plani Ahtisaari**. Për ligjet nga Plani Ahtisaari, cf. nenin 2 ["Legjislacioni që duhet të miratohet gjatë periudhës së tranzicionit dhe pas saj"] të Aneksit XII ["Agjenda Legjislative"] të Planit Ahtisaari). Në këtë kuptim, **Hans Kelsen** konceptualisht nuk dallon shumë nga **Carl Schmitt**. Dallimi konsiston në arsyetimin

e gjenezës së normës së parë. Të dy pranojnë se "kushtetuta e parë historikisht shikuar" mund të burojë edhe nga revolucioni, por mund të burojë edhe nga një diçka që nuk ka ndërprerje radikale me të kaluarën, ani se C**. Schmitt** nuk e përdor shprehjen "kushtetutë e parë historikisht shikuar". Në vend të kësaj, ai me kushtetutë nënkupton vendimin konkret politik që manifeston një vullnet të një populli, kurse me të drejtë kushtetuese nënkupton atë që ne sot e cilësojmë si kushtetutë (të shkruar dhe të pashkruar) dhe që bazohet në një rend apo normë pararendëse (Carl Schmitt, *Constitutional Theory* (Duke UP: Durham and London, 2008) fq. 60-61, 67-68, 70-71, 74, 77-80, 82-84, 87-88, 102-103, 107-11, 125, 142, 148). Në këtë kuptim, në renditje hierarkike në kuptimin formal kelsenian dhe shmitian të së drejtës kushtetuese, **Plani Ahtisaari** vjen i pari sepse, siç e ka thënë njëri ndër hartuesit efektiv të Kushtetutës së vitit 2008 nga përtej Atlantiku, profesori **Louis Aucoin**, "në fakt, Plani Ahtisaari është arsyeja pse u krijua kjo kushtetutë" (Profesor Louis Aucoin Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview), *PRAXIS:The Fletcher Journal of Human Security*, vol. XXIII (2008), fq.123-128, në fq. 124).

Kjo si më sipër, megjithatë, nuk do të thotë se nuk ka dallime thelbësore mes juristëve **H. Kelsen**-it dhe **C. Schmitt**-it. Ai dallim lidhet me natyrën e gjenezës së normës së parë: për **H. Kelsen**, "kushtetuta e parë historikisht shikuar" çdoherë presupozohet, bazuar në logjikën e **Immanuel Kant**-it mbi imperativin kategorik dhe hipotezën metafizike. Te **Kelsen**, thënë ndryshe, "kushtetuta e parë historikisht shikuar" presupozohet edhe atëherë kur nuk buron nga një vullnet revolucionar origjinal, në mënyrë të njëjtë siç presupozohet ekzistenca e Zotit. Te **C. Schmitt** "kushtetuta e parë historikisht shikuar" paraqet shprehje të një akti konkret politik në një moment të dhënë kohor dhe historik me të cilin një popull definon formën e ekzistencës së vet politike. Në këtë kontekst, për **Hans Kelsen** nuk ekziston një akt konkret politik si moment që e lind një "kushtetutë të parë historikisht shikuar", sepse ai moment prezupozohet që ekziston në atë mënyrë siç presupozohet ekzistenca e Zotit. Çdo fjalë e Zotit përbën një urdhër të padiskutueshëm të cilit i nënshtrohen të gjitha urdhrat e tjerë, kurse ekzistenca e dhënësit të urdhrit, Zotit, nuk mund të vihet në pyetje sepse presupozohet ontologjikisht. Për **Carl Schmitt**-in, ndërkaq, ekziston çdoherë një akt politik konkret origjinal që definon një shoqëri në një moment të caktuar kohor dhe historik, nga i cili akt burojnë normat kushtetuese. Në kohët e sotme, si **Hans Kelsen** dhe ***grundnorm***-a e

tij, ekzistenca e së cilës presupozohet, ashtu edhe **Carl Schmitt** dhe vendimi i tij konkret politik i kuptuar si kushtetutë nga ku burojnë normat kushtetuese, bëjnë pjesë në kategorinë ***pouvoir constituant***. U mor vesh, ky emërues i përbashkët i kuptimit të kushtetutës te këta dy kolosë të dijes juridike dhe filozofisë të së drejtës ka kuptim vetëm nëse kemi të bëjmë me ***pouvoir constituant*** në kuptimin e tij origjinal ("kushtetuta e parë historikisht shikuar", përkatësisht "kushtetuta si vendim konkret politik"). Kjo është kështu sepse ky emërues i përbashkët nuk ka asnjë relevancë për ***pouvoir constituant*** në kuptimin derivativ (kushtetuta si bazë e çdo norme tjetër te **Hans Kelsen**, përkatësisht kushtetuta si e drejtë kushtetuese në kuptimin e së drejtës për amendamentim sipas **Carl Schmitt**-it). Këtë dallim, në mënyre të heshtur dhe pa pasur nevojë ta thotë shprehimisht, e ka shprehur dhe sqaruar **GJND** në mendimin e vet për **Kosovën**. Sipas saj, **Deklarata e Pavarësisë** së Kosovës nuk buron nga asnjë normë e një rendi tjetër pararendës, por përbën një vendim që shpreh një vullnet politik konkret të popullit të Kosovës dhe përfaqësuesve të tij, të cilët **GJND** me shumë të drejtë i ka pagëzuar si autorët e **Deklaratës së Pavarësisë**.

Këtë sqarim tonin e mbyllim me një sqarim tjetër për lexuesin. Në doktrinë me ***pouvoir constituant*** nënkuptohen dy lloje: **origjinal** dhe **derivativ.** I llojit të parë është çdo ushtrim i vullnetit për herë të parë dhe në mënyrë origjiinale me të cilin ushtrim konstituohet shoqëria e organizuar në shtet, jashtë rendit të mëparshëm juridik-kushtetues, kurse e llojit të dytë është çdo ushtrim i pushtetit përmes amendamentimit të një kushtetute ekzistuese. Cf. më shumë për këtë në **Arnaud Le Pillouer**, "Pouvoir constituant originaire et pouvoir constituant dérivé: à propos de l'émergence d'une distinction conceptuelle", botuar në *Revue d'histoire des facultés de droit et de la science juridique*, no. 25-6 (2005-6) fq.123-141; Martin Loughlin & Neil Walker (eds.), ***The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form*** (Oxford UP: Oxford, 2008). Nga kjo shihet që lindja dhe shuarja e shteteve nuk asociohet me nxjerrjen e kushtetutave të para por me aktin e lindjes së shteteve, përveç rasteve kur procesi i lindjes së shtetit ka zgjatur një kohë të gjatë. Në këtë rast bëhet fjalë për shtetet në lindje e sipër (***in statu nascendi***): edhe këtu akti i parë kushtetutëbërës, që ka nisur krijimin e shtetit, llogaritet si pika nisëse, jo nxjerrja e një kushtetuese në aspektin formal apo zhvillimi praktikave të pashkruara kushtetuese, pas aktit të parë të shpalljes së pavarësisë së stërzgjatur.

Seksionin në vijim, "Kushtetutat e oktruara ose të dhuruara" (fq. 128-

129), përbën trajtim politikanes dhe tërësisht të papranueshëm. Nuk besoj të gjendet një tekst universitar që definon këtë lloj të kushtetutave sipas mënyrës që bëjnë autorët tanë, që fusnin në një thes Statutin Organik të Shqipërisë (1914) dhe **Kushtetutën e Mbretërisë së Jugosllavisë** (1931) me kushtetutat në fuqi të **Bosnjë-Hercegovinës** (1996), **Kosovës** dhe **Maqedonisë** (sic!). Literatura e cituar në fusnotat nr. 401-403 në tërësi janë të manipuluara dhe nuk kanë fare të bëjnë me konstatimet e autorëve. Kështu ta zëmë, citohen fq. 317-323, të librit ***Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*** (KOHA: Prishtinë), të autorit të mirënjohur **Marc Weller**, njërit ndër këshilltarët ndërkombëtar në procesin e hartimit të Kushtetutës së vitit 2008. Në këto faqe, **Marc Weller**, në fakt, nuk e thotë as edhe një fjalë që ngjason me fjalët "kushtetutë e oktruar ose dhuruar". Në ato faqe, ky autor jep analizën e shkëlqyer të faktorëve strukturorë ekzistues gjatë negociatave për statusin e Kosovës. Asgjë tjetër!

Si nocion gjuhësor, fjala "e oktruar" rrjedh nga fjala frënge *octroyer* që ka kuptimin "dhuroj" apo "për të dhuruar". Si nocion kuptimor, ndërkaq, kushtetutat me këtë emër janë paraqitur në kohën e kalimit nga feudalizmi në epokën e kapitalizmit. Rasti i parë në Evropë i një kushtetute të dhuruar është ***Charte constitutionnelle,*** e vitit 1814, e dhënë nga Luigji i XVIII, pas restaurimit të dinastisë franceze **Bourbon**. Si të tilla mund të konsiderohen, ta zëmë, edhe kushtetutat e Japonisë (1889) dhe Rusisë Imperiale (1906). Si rregull, këto kushtetuta kanë paraqitur kompromis mes borgjezisë dhe aristokracisë së tokave lidhur me ndarjen e pushtetit. Sidoqoftë, ky term çdoherë në literaturë është asociuar dhe asociohet me monarkitë të cilat u dhurojnë kushtetutë shtetasve të vet, në shenjë vullneti të tyre të mirë dhe si mëshirë për ta. Në çdo akt dhurimi, mbreti apo perandori jep një deklaratë më të cilën thekson se i jep popullit të vet, një kushtetutë për t'u qeverisur me të, në emër të mbretit. Më këtë akt mbretërit kanë vetëkufizuar pushtetin e vet, kryesisht nga frika prej revolucioneve dhe përmbysjeve sociale gjatë revolucioneve të vitit 1848. Më pastaj, ky lloj i kushtetutave është përhapur në kolonitë e vendeve evropiane. Por, çdoherë ka qenë dhe është mbreti ai që nxjerr këtë lloj kushtetutash. Autorët tanë, si duket e ngatërrojnë situatën e kushtetutave të imponuara me kushtetutat e dhuruara: situatat e para shprehen përmes terminologjisë dhe përvojave politike, asnjëherë përmes kategorive juridiko-kushtetuese dhe që takojnë më shumë historisë.

Kjo sqarohet shumë bukur në artikullin e thukët dhe hulumtues të

Luigi Lacchè, me titull "Granted Constitutions: The Theory of *octroi* and Constitutional Experiments in Europe in the Aftermath of the French Revolution", botuar në *European Constitutional Law Review* (vol. 9, issue 02, Sept. 2013, fq. 285-314). Ky autor, më mirë së çdo kush, duke folur për lindjen e formës kushtetuese të kushtetutës së oktruar apo dhuruar, sqaron se ky fenomen ka tri dimensione të tij: dimensionin e kohor, vendor dhe përmbajtjesor. Në aspektin kohor, autori sqaron se për herë të parë një kushtetutë e tillë është dhënë nga Luigji XVIII dhe është draftuar nga **Konti Beugnot**. Më pastaj, ky fenomen është përhapur nëpër vendet e tjera evropiane, në Spanjë dhe Itali, si dhe në periferi të kontinentit të vjetër dhe përtej tij gjatë shekullit XIX e deri në mesin e shekullit XX. Për nga përmbajtja, ndërkaq, **Luigi Lacchè** sqaron se kjo formë kushtetute, ka qenë fenomen i ndërmjetëm mes fundit të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XX dhe ka pasur për synim frenimin e vullnetit revolucional dhe instalimin e demokracive parlamentare, krejt kjo me qëllim dhe në funksion të ruajtjes së legjitimitetit dinastik. Me këtë legjitimitet nënkuptohet forma e organizimit politik ku pushteti buron nga mbreti/perandori sipas vullnetit të fuqisë hyjnore. Këtë aspekt të kushtetutës së oktruar apo dhuruar, **Luigi Lacchè** e ka cilësuar, duke iu referuar **Kontit Beugnot**, si forma kushtetuese që ka për qëllim kryesor absorbimin e revolucionit dhe pushtetit konstituiv të popullit në monarki, jo anasjelltas siç kishte ndodhur me Revolucionin Francez. Kjo më së miri shprehet në redaktimin e paragrafit të fundit të tekstit të preambulës së ***Charte constitutionnelle***, që më vonë është përsëritur me të njëjtën përmbajtje gjithandej në Evropë dhe përtej. Ai tekst i Luigjit të XVIII, i dhënë në emër të Zotit, thoshte si vijon:

> Në emër të Zotit, Mbreti i Francës dhe Navarrës [...]. Në mënyrë vullnetare dhe duke ushtruar pushtetin tonë mbretëror, e akorduam dhe e akordojmë, e dhurojmë dhe e bëjmë koncesion për shtetasit tanë këtë Kartë Kushtetuese, si për hir tonin ashtu dhe të trashëgimtarëve tanë dhe përgjithmonë [...]

Në këtë që u tha më sipër për kushtetutat e oktruara apo të dhuruara, kuptimin dhe historinë e tyre, autorët tanë kanë pasur mundësi ta mësojnë edhe nga autorët vendorë, përkatësisht nga libri mjaft i strukturuar dhe me përmbajtje i autorëve **Hilmi Ismaili** dhe **Fatmir Sejdiu**, *Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore* (Fakulteti Juridik i UP: Prishtinë, 2009, fq. 373-375).

Tri seksionet e fundit (fq. 129-135) janë aq kaotike dhe pa përmbajtje

saqë vështirë se mund të bëhet një analizë profesionale e tyre, lëre më të kuptohet diçka në kontekstin e teorisë bashkëkohore të së drejtës kushtetuese. Çuditërisht, fjalitë përmbyllëse të seksionit të fundit, që njëkohësisht mbyllin këtë kapitull, janë kaotike dhe flasin për disa lloje të kushtetutave që supozohet se janë diskutuar më herët, si p.sh. të a.q. "kushtetutat postkomuniste dhe të vendeve në tranzicion" (fq. 135). Me këtë konstatim, këtë radhë, edhe ne mbyllim kritikën tonë ndaj autorëve tanë për këtë kapitull të librit të tyre.

KAPITULLI V.
PËRMBAJTJA DHE STRUKTURA E KUSHTETUTËS (FQ. 137–153)

Përgjithësisht

Ky kapitull ka gjithsej tri seksione. Seksioni i tretë, që flet për preambulën e kushtetutës, ndahet në disa nënseksione. Njëjtë si në kapitullin pararendës, seksionet karakterizohen me narrativ kaotik, i thurur me zigzage dhe me përmbajtje eklektike, duke manipuluar literaturën e autorëve të tjerë. Këtu, për dallim nga kapitulli paraprak, gabimet profesionale janë edhe më të theksuara dhe më dramatike, gjë që e bën librin edhe më të dyshimtë në aspektin shkencor, profesional dhe didaktik.

Në këtë kapitull, autorët që janë manipuluar apo cituar në mënyrë abuzive janë Luan Omari & Aurela Anastasi, ***E drejta kushtetuese*** (Shtëpia Botuese ABC: Tiranë, 2010) dhe **Kurtesh Saliu**, ***E drejta kushtetuese*** (Fakulteti Juridik i UP: Prishtinë, 2004). Shkrimet nga autorët e huaj, ndërkaq, janë manipuluar akoma më dukshëm, janë cituar apo reprodukuar fjalitë dhe mendimet origjinale të autorëve shqiptarë si më sipër, kurse në fusnota si aparaturë shkencore figuron literatura e autorëve të huaj, por që në të shumtën e rasteve nuk ka të bëjë me përmbajtjen që diskutohet apo fq. e cituara nuk janë fare të sakta.

Të shohim si duket kjo në pjesët kryesore, të cilat i kemi analizuar kryesisht duke veçuar gabimet profesionale që duken në shikim të parë, ***prima facie***. Kështu, kemi vepruar edhe me kapituj pararendës. Pra, krahas analizës së fusnotave dhe aparaturës shkencore të përdorur kemi analizuar gabimet ***prima facie***, të natyrës profesionale, që autorët tanë i kanë shpërfaqur gjatë prodhimit të narrativit të tyre.

Analizë kritike

Seksioni "përmbajtja e kushtetutës" (fq. 137-140) nis me një tentim të autorëve për të definuar kuptimin e fjalisë "përmbajtja e kushtetutës" dhe përfundon në një definicion kaotik dhe pa asnjë kuptim. Sipas tyre, "[p]ërmbajtja e kushtetutës nënkupton tërësinë e normave juridiko-kushtetuese, sipas të cilave norma rregullon çështjet e caktuara shtetërore dhe kushtetuese". Për këtë definicion të tyre, autorët tanë nuk citojnë asnjë autor tjetër, gjë që është krejt normale sepse nuk mund të gjendet edhe një autor tjetër që mendon si ata.

Në shikim të parë, vërehet gabimi themelor, që rezulton nga gabimet paraprake dhe paqartësitë e autorëve tanë rreth kuptimit të së drejtës kushtetuese dhe kushtetutës në kuptimin e formal dhe në atë material. Ky definicion i tyre këtu lidhur me përmbajtjen e kushtetutës nuk mund të pajtohet lehtë me kushtetutën në kuptimin material të vendeve që nuk kanë një tekst të kodifikuar kushtetues, siç është rasti me Britaninë e Madhe dhe vendet që ndjekin shembullin e saj. Përveç kësaj, sikundër kemi shënuar më herët, një kushtetutë e shkruar mund të përmbajë norma që normojnë materie që fare nuk është materie kushtetuese.

Duke provuar që të specifikojnë përbërësit e këtij definicioni të çuditshëm, autorët tanë në paragrafin e dytë, në vijim theksojnë se "normat juridiko-kushtetuese, të cilat janë pjesë e përmbajtjes së kushtetutës, janë norma ***sui generis***, që krijohen në procesin e veprimtarisë së organeve të pushtetit shtetëror, të një shteti të caktuar, dhe përmes së cilave sanksionohen çështje të caktuara". Nuk besoj se studentët dhe lexuesi i tyre, do të kuptojë ndonjë gjë nga kjo fjali. Ajo çfarë mund të thuhet me hamendje është se ka gjasë që autorët tanë me këtë fjali kanë pasur parasysh sistemin britanik të përmbajtjes së kushtetutës sepse ndryshe nuk ka sisteme të tjera që kanë një kushtetutë të kodifikuar, në formë të shkruar nuk mund të thuhet se normat kushtetuese janë *sui generis*, aq më pak se, ato krijohen *post festum* si pasojë e praktikës së veprimtarisë së organeve të pushtetit shtetëror. Kjo nuk mund të jetë kështu sepse normat kushtetuese dhe vetë kushtetutat kanë lindur në luftën e njerëzimit për të kufizuar pushtetin shtetëror, jo për të lejuar që pushteti të krijojë *post festum* norma sipas tekeve të momentit (sic!). Përveç kësaj, ku është sfera e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe përvoja në këtë sferë si mënyrë e lindjes së normave juridiko-kushtetuese të përmbajtjes së caktuar? Askund! Pas këtij kaosi të krijuar në narracion të librit, autorët në paragrafë të tërë flasin për normat

mbi zgjedhjen e presidentit si një dëshmi që provon qëndrueshmërinë e definicionit të tyre si më sipër. Krahasojnë **SHBA**-në, **Kosovën** dhe **Francën**. Në ndërkohë që për Kosovë dhe Francë kanë shumë të drejtë, për rastin e **SHBA**-së citojnë një autor inekzistent: libri që autorët tanë e citojnë në fusnotën nr. 436 nuk ekziston fare. Nga i njëjti autor dhe me përmbajte të përafërt ekziston vetëm ky autor me këtë libër: William C. Kimberling, *"The Electoral College": Essays in Election* (Federal Election Commission: Washington D.C., 1992). Këtu, në fakt, nuk bëhet fjalë për libër, por për një broshurë prej 14 faqesh që nuk ka asnjë relevancë për përmbajtjen e normave kushtetuese. Asgjë më shumë!

Në paragrafin e fundit të fq. 138, autorët provojnë të riprodhojnë atë që thotë autori **K. Saliu** në fq. 53 të librit të sipërcekur: për dallim nga ky autor dhe nga autorët **L. Omari** & **A. Anastasi**, të cilët parafrazojnë me saktësi **K. Saliun** dhe librin e tij, autorët tanë bëjnë edhe një zbulim të madh, duke konstatuar se "në përgjithësi përmbajtja e kushtetutës lidhet me vullnetin e kushtetutëvënësit ose hartuesve të kushtetutës, si dhe me vullnetin e popullit." Nga ky konstatim qartë shihet se, sipas tyre, potencialisht ekzistojnë dy kategori që përcaktojnë përmbajtjen e një kushtetute: kushtetutëvënësit ose hartuesit e kushtetutës (d.m.th. fjala është për njëjtësim të këtyre dy kategorive) dhe vullneti i popullit. Menjëherë në vijim pason definicioni tjetër i kategorisë së kushtetutëvënësit, i cili definohet në kuptimin e gjerë dhe në kuptimin e ngushtë. Në kuptimin e ngushtë, autorët tanë fusin "organet (populli, parlamenti, ose ndonjë organ tjetër) të cilat e miratojnë kushtetutën duke i dhënë fuqi dhe legjitimitet normës kushtetuese". A nuk është ky definicion konfuz dhe në kundërshtim të hapur me atë që thanë autorët tanë më sipër? Konfuziteti dhe pakuptimësia bëhet totale kur ata flasin për kuptimin e gjerë të termit "kushtetutëvënës". Sipas tyre, me këtë term nënkuptohen hartuesit e kushtetutës ose njerëzit (ekspertët) të cilët hartojnë përmbajtjen e kushtetutës. Mbi bazën e kësaj, gjithnjë sipas autorëve tanë, përmbajtjen e kushtetutës e caktojnë zakonisht kushtetutëvënësit (hartuesit e kushtetutës), si dhe ata që e miratojnë kushtetutën. Ky definicion dhe kjo qasje ndaj koncepteve themelore të së drejtës kushtetuese që lidhet me mënyrën e prodhimit të kushtetutës së shkruar dhe të përmbajtjes së saj është unik dhe nuk gjendet në asnjë libër mbi të drejtën kushtetuese, të autorëve vendorë apo të huaj. Kushtetutë-vënësit e definuar kësisoj, sipas autorëve, njihen si "baballarët ose etërit e shtetit" dhe për këtë citojnë një autor amerikan në fusnotën e tyre nr. 442. Ta shohim se për çfarë bëhet fjalë këtu. E kemi fjalën për autorin

Horst Dippel dhe shkrimin e tij **"**Modern constitutionalism: An introduction to a history in need of writing", botuar në *The Legal History Review* (vol. 73, issue 1-2, 2005, fq. 153-170). Në fakt, autorët tanë citojnë dorëshkrimin e këtij autori që gjendet në internet, nga **University of Kassel**, por që shprehimisht thotë se nuk mund të citohet pa lejen e autorit. Për këtë arsye ne i referohemi shkrimit tërësisht të njëjtë dhe pa asnjë ndryshim të botuar në revistën e sipërcekur: as njeri e as tjetri version, ndërkaq, nuk bëjnë fare fjalë për "baballarët e shtetit", siç thonë autorët tanë, por për një histori jashtëzakonisht të detajuar, si rezultat i hulumtimit të këtij autori, të lindjes së **Deklaratës së Virxhinas mbi të Drejtat e Njeriut** (1776), ndikimin francez në lindjen e tij, si dhe përhapjen e ideve liberale nga ky dokument në Evropë. Asgjë nuk flet për atë që ia mveshin autorët tanë. Teoria mbi "baballarët e kombit" apo "baballarët e kushtetutës" ka një kontekst tjetër historik dhe nuk lidhet me kushtetutëbërjen në SHBA, në vitin 1787: ata që sot me plotë të drejtë cilësohen si të tillë, cilësohen për shkak të rolit udhëheqës në Revolucionin Amerikan dhe forcës së tyre kolosale intelektuale të shprehur në shkrimet që sot e kësaj dite mësohen nëpër vendet liberale të botës. Jo vetëm kaq, krahas kësaj force intelektuale, secili prej tyre ka pasur një rol po aq kolosal në gjërat në terren, shumë vendimtar për lindjen e SHBA-së, si shtet liberal me organizim federal. E kemi fjalën për ***Letrat e Federalistit*** (**The Federalist Papers**), përmbledhjen e 85 artikujve dhe eseve të shkruara nga **Alexander Hamilton**, **James Madison**, dhe **John Jay** nën pseudonimin "Publius", me qëllim të promovimit të ratifikimit të Kushtetutës së SHBA-së. Ky angazhim i këtyre dijetarëve fare nuk mund të cilësohet si kushtetutëbërje, por si lobim me forcën e pendës për fuqizim të një kushtetute liberale, përmes ratifkimit të saj, proces që ka ndodhur më 21 qershor të vitit 1788.

Në luftën për ratifikim (1787-1788) u propozuan amendamentet e para kushtetuese që kishin për qëllim qetësimin e rrymave anti-federaliste. ***Letrat e Federalistit***, ndërkaq, paraqesin përpjekje për ratifikim të tekstit fillestar të Kushtetutës kurse **Karta e të Drejtave**, 10 amendamentet e para, paraqet një vepër ekskluzive të **James Madison** nën ndikimin e fuqishëm të **Deklaratës së Virxhinas** (1776). As kjo nuk mund të cilësohet si kushtetutëbërje sepse në fund ka pasur një proces ratifikimi të këtyre amendamenteve më 15 dhjetor 1791, në ndërkohë që vetë teksti i tyre përbën një ripërsëritje të të arriturave të **Deklaratës së Virxhinas** dhe filozofisë së **John Locke**. Autorët, për të dëshmuar se edhe **Karta e të Drejtave** është në tërësi vepër e kushtetutëbërësve, të kuptuar si hartues të tyre, edhe pse

fjala është vetëm për njërin nga autorët e ***Letrave të Federalistit***, citojnë **Richard H. Fallon** dhe shkrimin e tij "The Dynamic Constitution: An Introduction to American Constitutional Law" (Cambridge UP: Cambridge, MA, 2004, fq. 7-8). Nga leximi me kujdes i këtij shkrimi, gjithsej 20-faqësh, lexuesi do të gjejë diçka tjetër: vetë idenë e kuptimit të ngushtë të termit "kushtetutëvënës", të sajuar nga autorët tanë. Në fq. 3-4, **Richard H. Fallon** hamendëson nëse ata që injoruan **Artikujt e Konfederatës** (1781) në **Asamblenë Kushtetuese të Filadelfias** (1787), duhen trajtuar si të jashtëligjshëm sepse nuk kishin ndjekur procedurat kushtetuese ekzistuese. Në këtë rast, por vetëm duke iu referuar historisë kushtetuese amerikane, autori përdor thënien që zakonisht përdoret për "hartuesit e kushtetutës" dhe "ratifikuesit" e saj. Kaq! Nuk mund të ketë asnjë pasojë teorike jashtë kontekstit amerikan e aq më pak të ndërtohet një gjeneralizimin mbi bazën e saj, siç bëjnë autorët tanë, duke shfytyruar konceptin themelor të termit "kushtetutëbërje" apo "pushtet kushtetutëbërës", i njohur në doktrinë gjithandej me shprehjen franceze ***pouvoir constituant***. Ky pushtet ka dy trajta: pushteti kushtetues origjiner dhe pushteti kushtetues derivativ. I dyti, në literaturën shqip të së drejtës kushtetuese, zakonisht emërtohet edhe si "pushteti për të bërë kushtetutë". Në dy trajtat, ndërkaq, ushtrimi i ***pouvoir constituant*** ka disa forma të manifestimit, të cilat në asnjë mënyrë nuk mund të ndahen në kuptim të ngushtë dhe në kuptim të gjerë. Në të gjithë librat seriozë të mbi të drejtën kushtetuese, në veçanti të autorëve evropianë, format e manifestimit të ***pouvoir constituant***, përkatësisht të gjitha format e manifestimit të **pushtetit origjinal kushtetutëbërës**, konsistojnë në si vijon:

- e para, kushtetutëbërja përmes një organi të posaçëm që quhet Asamble Kushtetuese, e zgjedhur nga populli për kryerjen e kushtetutëbërjes origjinale (rasti i SHBA-së në vitin 1787, Francës në vitin 1793 etj.);
- e dyta, kushtetutëbërja përmes një organi të zakonshëm legjislativ përfaqësues, që nuk është zgjedhur nga populli për kryerjen e kushtetutëbërjes origjinale (për herë të parë është përdorur në Francë në vitin 1875, në ndërkohë që sot ka përdorim të gjerë);
- e treta, kushtetutëbërja përmes referendumit të drejtpërdrejtë popullor (është përdorur në ish-kolonitë e Amerikës së Veriut dhe në Zvicër, mirëpo si formë e veçantë dhe e vetme ka përdorim shumë të rrallë); dhe, së fundi,

- e katërta, kushtetutëbërja përmes kombinimit të tri formave si më sipër (zakonisht gjatë historisë janë kombinuar forma e tretë me të parën, siç ka qenë rasti me Spanjën në vitit 1978, apo Shqipërinë në vitin 1998; në rastet e kombinimit, referendumi mund të jetë i detyrueshëm ose fakultativ).

Paragrafët e tjerë deri në fund të seksionit flasin në mënyrë nihiliste për kushtetutëbërjen në kontekstin e Kosovës dhe vendeve nën mbikëqyrje ndërkombëtare, duke ripërsëritur sërish tezën tërësisht të pavend që definon kushtetutat e **oktruara** (dhuruara) si kushtetuta të imponuara nga jashtë. Në kapitullin pararendës treguam se kjo përbën një gabim dhe mosnjohje themelore të konstitucionalizmit evropian. Në kuadër të këtyre kushtetutave të oktruara (dhuruara) hyjnë, sipas autorëve tanë, kushtetutat e imponuara nga komuniteti ndërkombëtar ku Kosova e Bosnjë-Hercegovina zënë një vend të spikatur, konstatim ky që bie ndesh me tezën e autorëve për ekzistimin e kushtetutëbërësve në kuptim të gjerë të fjalës (sic!). Si në rastin e Kosovës, ashtu dhe në rastin e Bosnjë-Hercegovinës nuk bëhet fjalë asnjëherë për kushtetuta të imponuara sepse në dy rastet përfaqësuesit legalë dhe legjitimë kanë marrë pjesë në ndërtimin e vullnetit kushtetutëbërës. Sa i përket rastit të **Kosovës**, kjo është bërë përmes pjesëmarrjes aktive në negociata me ndërmjetësimin e ish-Presidentit të Finlandës, **Martti Ahtisaari**, dhe miratimin e **Planit Ahtisaari** nga ana e Kuvendit të Kosovës, më datën 5 mars 2007, kurse në rastin e **Bosnjë-Hercegovinës**, përfaqësuesit e këtij shteti sovran kanë marrë pjesë në negociata e **Dejtonit** dhe kanë nënshkruar **Marrëveshjen e Dejtonit** (nëntor 1995) që i dha fund luftës në këtë vend. Më vonë, **Kuvendi i Bosnjë-Hercegovinës** ka ratifikuar këtë marrëveshje ndërkombëtare, pjesë e së cilës Kushtetuta e Bosnjë-Hercegovinës si shtet sovran dhe i pavarur. **Kuvendi i Kosovës**, ndërkaq, pas deklaratës së datës **5 mars 2007**, kur ka pranuar **Planin Ahtisaari**, i ka hapur rrugë përgatitjeve për vënien e tij në jetë, duke pranuar detyrimet për mbikëqyrjen ndërkombëtare të pavarësisë së shpallur dhe, në të njëjtën kohë, nxjerrjen e kushtetutës së re të **Kosovës**. Në këto raste bëhet fjalë për pjesëmarrje të faktorit ndërkombëtar në ndërtimin dhe ushtrimin e ***pouvoir constituant***, përkatësisht pushtetit kushtetutëbërës origjinal dhe jo për imponim të këtij vullneti. Autorët ngatërrojnë ndikimin moral dhe intelektual të faktorit ndërkombëtar me imponimin e vullnetit. Pas Luftës së Dytë Botërore, ky ndikim ka qenë i njëjtë edhe në **Gjermani**, **Japoni**, por edhe në **Itali**. Asgjë të keqe, në parim, nuk ka nga ky ndikim, përkatësisht nga kjo pjesëmarrje e faktorit

ndërkombëtar në formësimin e ***pouvoir constituant*** (origjinal apo derivativ). Kështu e thonë, me shumë të drejtë, autorët si vijon: Emily Hay, "International(ized) Constitutions and Peacebuilding", *Leiden Journal of International Law*, vol. 27, issue 01, March 2014; Zaid Al-Ali, "Constitutional drafting and external influence", botuar në Tom Ginsburg and Rosalind Dixon (eds.), ***Comparative Constitutional Law*** (Edward Elgar Pub: UK & USA, 2011); P. Dann and Z. Al-Ali, "The Internationalized *Pouvoir Constituant*: Constitution-Making under External Influence in Iraq, Sudan and East Timor", *Max Planck Yearbook of United Nations Law* (2006). Ka edhe autorë të tjerë që mendojnë kështu. Në fakt, të gjithë veç autorëve tanë mbajnë këtë qëndrim.

Aq më pak këtu bëhet fjalë për kushtetutë të oktruar (dhuruar). Kjo pjesëmarrje e faktorit të jashtëm në procesin origjinal kushtetutëbërës vjen si pasojë e superioritetit intelektual të faktorëve të tillë ndërkombëtar dhe synimit të qëllimshëm pafundësisht të akterëve vendorë për t'u bërë pjesë e kulturave kushtetuese dhe kulturave politike të vendeve që ndihmojnë ushtrimin e pushtetit origjinal kushtetutëbërës në këto vende, përfshirë Kosovën. Në këtë kuptim, këto kushtetuta janë të imponuara po aq sa janë të imponuara kushtetutat e ish-vendeve komuniste dhe kushtetutat e tjera në **Amerikën Latine**, në vendet e **Magrebit**, të **Azisë Qendrore** dhe të disa vendeve të tjera ku **Komisioni i Venecias**, njëjtë si në rastin e Kosovës dhe vendeve të tjera ish-komuniste ka kontribuar në ndërtimin dhe ushtrimin e pushtetit kushtetutëbërës origjinal. Kështu konstatojnë sot të gjithë autorët e tjerë që merren dhe studiojnë kushtetutëbërjen në vendet e reja që kanë kaluar një periudhë transicioni nën mbikëqyrje ndërkombëtare si dhe në vendet ish-komuniste apo që kanë dalë nga dhuna e konflikti dhe përmbysjet e thella sociale. Autorët tanë, në fusnotën nr. 446, në mënyrë të gabuar dhe të shtrembëruar citojnë fq. 5 të një broshure joshkencore dhe joakademike që flet për shtetndërtimin dhe dizajnin kushtetues pas konfliktit, ku zihen në gojë raste si të **Ugandës, Afrikës së Jugut** dhe **Bosnjë-Hercegovinës**. E kemi fjalën për shkrimin "State-building and Constitutional Design after Conflict" të autorëve **Kirsti Samuels** dhe **Vanessa Hawkins Wyeth** (International Peace Academy: New York, 2006). Në këtë shkrim si raste studimi kanë shërbyer gjashtë shtete, përkatësisht vendet si vijon: Bosnjë-Hercegovina, Fixhi, Libani, Irlanda e Veriut, Afrika Jugut dhe Uganda. Në fq. e sipërcekur nga autorët tanë, këta autorë flasin për të kundërtën e asaj që besojnë autorët tanë. Aty flitet për faktin se në **Afrikë të Jugut** ka pasur një dialog të fuqishëm të brendshëm, kurse

në Ugandë një pjesëmarrje, në ndërkohë që vetëm **Bosnjë-Hercegovina** mund të cilësohet si zgjidhje e imponuar. Këta autorë dhe kjo broshurë, megjithatë, nuk kanë natyrë të një analize juridike dhe nuk operojnë me kategori juridike por me koncepte dhe analiza politike mbi pushtet-ndarjen ekzekutive dhe gjeografike në vendet nën studim si mënyrë e zgjidhjes së konflikteve. Kjo qasje shpjegon edhe futjen në vendet që janë studiuar të **Irlandës Veriore**, pra, bëhet fjalë për studim të konfliktit dhe pushtetndarjes pas konfliktit dhe legjitimitetin politik të kushtetutëbërjes përmes ndërhyrjes dhe pjesëmarrjes ndërkombëtare. Asgjë tjetër!

Në rastin e Kosovës, kjo si më sipër qartë dëshmohet nga ekspertë ndërkombëtarë që kanë marrë pjesë aktive në ndërtimin e vullnetit kushtetutëbërës origjinal, të kushtetutëbërësit kosovar, vullnet që në fund është ushtruar ekskluzivisht dhe me vullnet nga ana e organit përfaqësues të shtetit sovran dhe të pavarur, Republikës së Kosovës. Këta ekspertë në asnjë mënyrë dhe në asnjë rast nuk mund të cilësohen si kushtetutëbërës, siç nuk mund të cilësohet i tillë **Komisioni i Venecias**, ekspertiza e të cilit ka qenë e veçantë në procesin e ndërtimit të vullnetit kushtetutëbërës të kosovarëve. Këtu e kemi fjalën për ekspertët ndërkombëtarë që ndihmuan shumë me ekspertizën e tyre në procesin e lindjes së Kushtetutës, së vitit 2008. Në shkrimet që më pastaj i kanë botuar, këta autorë kanë shprehur mendimet e tyre lidhur me ecurinë e procesit të draftimit të Kushtetutës së Kosovës. E kemi fjalën për shkrimet si vijon: Professor Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)", *PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security*, vol. XXIII (2008); Joseph Marko, "The New Kosovo Constitution in a Regional Comparative Perspective", *Review of Central and East European Law,* vol. 33, no. 4 (2008); Marc Weller**, *Shtetësia e kontestuar: Admimnistrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi,*** kapitulli 14 (KOHA: Prishtinë, 2009)"; John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution", *Minnesota Journal of International Law*, vol. 18, issue 2 (2009).

Seksioni në vijim, me një titull dhe përmbajtje bombastike, "Ndikimi i sistemit juridik-ndërkombëtar në përmbajtjen e kushtetutës", lë përshtypjen se e drejta ndërkombëtare është burimi kryesor material i së drejtës kushtetuese si degë pozitive e sistemit juridik. Në këtë seksion, autorët tanë ngatërrojnë rolin dhe ndikimin e pashmangshëm që ka e drejta ndërkombëtare në përmbajtjet e caktuara të sistemeve juridike të shteteve sovrane dhe të pavarura me burimin material të së drejtës kushtetuese. Në fillim citojnë si argument të kësaj madhështie të së drejtës ndërkombëtare

si burim material i së drejtës kushtetuese, një shkrim të një autori amerikan. Citimi bëhet, sikur në të gjitha rastet e tjera, i fq. së parë dhe i fillimit të artikullit. Me këtë rast e kemi fjalën për fusnotën nr. 448 dhe shkrimin "International Law: The Impact on National Constitutions", botuar në *American University International Law Review* (vol. 21, issue 3, 2006, fq. 327-364), të autorit **Michael Kirby**. Ky shkrim, ndërkaq, më shumë se trajtim shterues krahasues mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme paraqet një kritikë të autorit (i cili vetë është gjyqtar amerikan) ndaj sistemit kushtetues amerikan dhe australian, të cilët nuk i vënë në jetë përmes gjykatave të tyre më të larta detyrimet ndërkombëtare të shteteve të tyre respektive. Autori i shkrimit fton për dialog ndërkombëtar dhe për sundim ndërkombëtar të ligjit. Nga leximi i tij i kujdesshëm shihet qartë se asnjë relevancë nuk ka për seksionin ku e citojnë autorët tanë. Kjo sepse, thjesht, autori i shkrimit nuk bën ndonjë analizë rreth ndikimit të së drejtës ndërkombëtare në sistemet kushtetuese të vendeve sovrane dhe të pavarura. Qëllimi i këtij shkrimi është që të jepet një perspektivë jurisprudenciale e mundësive të zbatimit të së drejtës ndërkombëtare në SHBA dhe Australi, duke analizuar aty-këtu edhe përvojën e vendeve të tjera, si p.sh. përvoja dhe zgjidhjet e Afrikës së Jugut.

Këtë nuk e bën as shkrimi tjetër në vijim i autorit **Jeremy Waldron**, të cilin autorët tanë e citojnë në fusnotën nr. 449. Ky burim që citohet këtu është edhe më skandaloz: shkrimi i **Jeremy Waldron** me titull "The Rule of International Law", botuar në *Harvard Journal of Law& Public Policy* (vol. 30, no. 1, Fall 2006, fq. 15-30) bën fjalë për një kritikë të ashpër që ky autor i bën diskursit praktik dhe shkencor në SHBA, rreth krimeve të luftës dhe luftës kundër terrorit të **Al-Qaeda**-s, përdorimit të torturës dhe trajtimit të supozuar jonjerëzor të personave të arrestuar pa urdhër gjyqësor në vazhdën e luftës globale të SHBA-së kundër terrorit të **Al-Qaeda**-s. Autori diskuton hipotezën e disave që thonë se SHBA-ja ka cenuar ligjet e luftës gjatë ndërmarrjes së veprimeve të tilla nëpër botë, pra kidnapimet dhe torturat e individëve të involvuar në luftë terroriste kundër SHBA-së. Për të qenë edhe më i saktë, ky autor flet në mënyrë shprehimore për talibanët dhe strukturat e ushtruara ndaj tyre dhe këshillat që disa juristë amerikanë i kanë dhënë për prokurorët e shtetit, duke mos e vënë fare në dyshim mundësinë e thyerjes së konventave të **Gjenevës** mbi të drejtën e luftës si dhe të normave të tjera ndërkombëtare që ndalojnë torturën dhe trajtimin johuman dhe degradues të robërve të luftës. Prandaj nuk është fare e vërtetë ajo që thonë autorët tanë në tekstin e tyre me fusnotën nr.

449, se "vlera më e madhe që sot e proklamon sistemi juridik ndërkombëtar janë të drejtat e njeriut". Këtë nuk e thotë as **Jeremy Waldron**, të cilin e citojnë në atë vend. Vlerat kryesore të sistemit ndërkombëtar, sot dhe dje, kanë qenë dhe janë paqja dhe siguria ndërkombëtare, kurse promovimi dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut përbën një ideal që synohet çdoherë për t'u arritur. Se kjo është kështu, vetë autorët e pranojnë në fusnotën në vijim, si për çudi (sic!). E kemi fjalën për fusnotën nr. 450 dhe tekstin që e shoqëron. Problemi me këtë tekst, ndërkaq, është si me pjesën dërrmuese të tekstit të prodhuar nga autorët tanë duke cituar në mënyrë manipulative dhe abuzuese burimet e literaturës së përdorur. Më këtë rast e kemi fjalën për fq. 4 të shkrimit të autorëve **Jan Wouters**, **Bart De Meester** dhe **Cedric Ryngaert** me titull "Demoracy and International Law", botuar në *Netherlands Yearbook of International Law* (vol. 34, December, 2003, fq. 139-197). Jo vetëm që këta autorë nuk e thonë që vlera më e madhe e sistemit juridik-ndërkombëtar janë të drejtat e njeriut por shkrimi flet për krejt diçka tjetër: për atë që njihet si teoria e paqes demokratike, e filluar me **Immanuel Kant**, në vitin 1795, e që në diskursin teorik të marrëdhënieve ndërkombëtare mbretëron si temë me emërtimin e drejta për demokraci. Autorët në këtë shkrim shpjegojnë evoluimin e kësaj teorie nga **Immanuel Kant**, e deri në ditët e sotme, duke sqaruar se pas Luftës së Parë Botërore ka pasur një respekt teoria e demokracisë, si kundërshtim ndaj parimit vestfalian mbi sovranitetin nacional shtetëror, por ka rënë përtokë gjatë Luftës së Dytë Botërore; pas kësaj lufte ka nisur një fokus më i madh në individin, por kryesisht duke nënkuptuar me demokraci të drejtën e individëve për pjesëmarrje, për të kulmuar në të drejtën për zgjedhje të lira dhe të drejta pas mbarimit të komunizmit. Të gjitha këto thuhen në këtë shkrim, në veçanti në seksionin e tretë të tij, të cilin autorët tanë e citojnë si provë mbështetëse të teorisë së tyre fiktive mbi të drejtat e njeriut si vlera themelore të sistemit juridik-ndërkombëtar. Këtë ide të tyre, në fund të fq. 141, autorët tanë e shtyjnë deri në absurd kur thonë se "e drejta ndërkombëtare zakonore është e obliguar për të gjitha shtetet". Edhe këtu, autori i cituar në fusnotën nr. 451 nuk mendon si autorët tanë lidhur me statusin e së drejtës ndërkombëtare zakonore në të drejtën e brendshme të shteteve. As edhe një fjali e vetme e shkrimit prej 82 fq. i autorit **Hazel Genn**, i cituar në mënyrë abuzive dhe për qëllime manipulimi, nuk bën fjalë për që thonë autorët tanë. Kjo është normal sepse ky autor flet për sistemin e së drejtës së përgjithshme (*common law*) dhe është i dizajnuar për ata që duan të mësojnë institucionet qendrore në

Angli, si dhe teknikat e interpretimit dhe arsyetimit ligjor. Kaq dhe asgjë tjetër!

Sa i përket statusit të së drejtës ndërkombëtare zakonore, së cilës i referohen autorët tanë, siç e kemi thënë në kritikën tonë për kapitullin pararendës, një gjë e tillë është e vërtetë vetëm sa i përket normave ***jus cogens*** të së drejtës ndërkombëtare zakonore. Nuk është e drejta ndërkombëtare zakonore e përbërë në tërësinë e saj vetëm prej normave ***jus cogens***. Vetëm një pjesë e vogël e normave të saj ka statusin e normave ***jus cogens***, siç është rasti, fjala vjen, me normat që kanë të bëjnë me gjenocidin, piraterinë, apartheidin, skllavërinë dhe kështu me radhë. Këto kanë epërsi (supremaci) mbi kushtetutën dhe çdo normë tjetër pozitive në Kosovë. Mirëpo, jo të gjitha normat e së drejtës ndërkombëtare zakonore kanë statusin e ***jus cogens***: një pjesë bukur e madhe e tyre nuk kanë epërsi (supremaci) ndaj kushtetutës nacionale. I tillë është rasti, ta zëmë, me dispozitat mbi zbatimin me mirëbesim (***bona fide***) të detyrime të marra ndërkombëtare, respektimi i parimit ***pacta sunt servanda***, ndalimi i përdorimit të forcës ose kërcënimit me forcë etj. Për këtë pjesë të normave të së drejtës ndërkombëtare zakonore flasin nenet 19.2 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës së Kosovës. Neni 33.1 ["Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale"], ndërkaq, flet për rastet e normave ***jus cogens***, që kanë epërsi (supremaci) ndaj Kushtetutës së Kosovës. Këtë e kemi sqaruar në kapitullin pararendës. Kjo, me fjalë të tjera, nënkupton se e drejta ndërkombëtare zakonore ka dy lloje të normave: pjesa e vogël e normave që kanë status të normave zakonore ***jus cogens*** dhe që kanë epërsi mbi kushtetutën nacionale, gjë që i takojnë kategorisë së parë si më sipër (gjenocidi, aparteidi, pirateria etj.); dhe, pjesa tjetër e normave të së drejtës ndërkombëtare zakonore dhe që janë në shumicë dhe që nuk kanë epërsi automatike ndaj kushtetutës nacionale (rastet e parimit ***bona fide***, parimit ***pacta sunt servanda***, ndalimi i kërcënimit dhe i përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare etj.). Në rastin e fundit, janë kushtetutat nacionale ato që përcaktojnë statusin e tyre në rendin e brendshëm juridik. Në rastin e Kosovës, dhe në një pjesë të vendeve ish-komuniste këto norma kanë statusin e njëjtë me normat nga e drejta kontraktuese, pra nën kushtetutë dhe më lartë se çdo ligj nacional.

Në vijim të diskutimit si më sipër, autorët tanë, duke u bazuar në autorët si më sipër arrijnë në një konstatim tërësisht të paqëndrueshëm dhe me hamendje, të cilin e citojmë në vazhdim për hir të lexuesit tonë:

> Sipas kësaj logjike, sistemi ndërkombëtar ndikon në masë të madhe edhe në përmbajtjen e kushtetutave. Ky ndikim ndodh në dy raste. Rasti i parë është kur draftohet një kushtetutë. Në mënyrë që një shtet dhe një kushtetutë të jetë e pranuar në arenën ndërkombëtare, ajo duhet të përshtatet me vlerat të cilat i proklamon sistemi juridik-ndërkombëtar. Mirëpo, nëse eventualisht një shtet nuk e ka bërë këtë në fillim, në mënyrën se si funksionon sistemi juridik-ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, ai shtet duhet të bëjë ndryshime në përmbajtjen e kushtetutës së vet në mënyrë që ajo të përputhet me vlerat që proklamon sistemi juridik-ndërkombëtar, një moment i tillë paraqet rastin e dytë [...].

Sikundër mund të shihet, autorët tanë bëjnë analiza të politikës ndërkombëtare, pa kontekstualizuar as kohën dhe as hapësirën. Nga kjo si më sipër, lehtë mund të arrihet në përfundim se fjala mund të jetë për sistemin e a.q. të kapitulacioneve që ka ekzistuar ndaj **Perandorisë Otomane** dhe disa vendeve të tjera aziatike gjatë shekullit XIX dhe deri në fillim të shekullit XX. Megjithatë, ky nuk është rasti sepse autorët tanë i tregojnë studentit dhe lexuesit se një kushtetutë duhet të pranohet në arenën ndërkombëtare dhe se ekzistuakan disa vlera ndërkombëtare me ndikim automatik kushtetues. Në vend se të flasin për krahasimet e teksteve juridike ndërkombëtare, kryesisht në lëmin e lirive dhe të drejtave njerëzore, sepse në aspektin e organizimit dhe funksionimit të pushteteve gjërat diametralisht ndryshojnë, me tekstet kushtetuese dhe ndikimin reciprok në mes tyre, autorët tanë mundohen të na tregojnë se burimet materiale të së drejtë kushtetuese janë kryesisht ndërkombëtare të ankoruara në një sistem vlerash për të cilat nuk thonë asgjë më konkretisht. Edhe **Kosova** edhe krejt vendet ish-komuniste synojnë integrimin në kulturën kushtetuese dhe politike të vendeve që përbëjnë civilizimin euro-atlantik, por kjo është një çështje ekstra-kushtetuese që duhet të shpjegohet në pjesën kur flitet për kuptimin politik dhe ndërkombëtar të kushtetutës, apo në pjesën për marrëdhëniet mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme. Këto gjëra i kemi diskutuar në kritikën tonë për kapitujt pararendës dhe nuk do të kthehemi këtu më shumë, përveç që duhet të ripërsërisim se këto çështjet si më sipër të marrëdhënieve mes këtyre dy degëve të së drejtës është një çështje tërësisht e ndryshme nga ndikimi i sistemit ndërkombëtar në përmbajtjen e kushtetutave konkrete: e para i takon lëmit të së drejtës kushtetuese dhe të së drejtës ndërkombëtare njëkohësisht, kurse e dyta fushës së Shkencave Politike, në kuptim të gjerë, përkatësisht disiplinës së

Teorisë së Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Seksioni në vijim titullohet "Struktura e Kushtetutës" (fq. 142-153). Ky seksion kryesisht mbështetet në fq. 54-55 të librit të **Kurtesh Saliu**, por në atë mënyrë që parafrazimi i fjalëve origjinale nga autorët tanë i ngjason një kaosi të vogël dhe një narrativi në mënyrë të përçartë. Për të mbuluar këtë lloj narracioni, autorët tanë edhe këtu përdorin autorë dhe burime të huaja që as edhe më voglën lidhje nuk e kanë me temën që diskutohet. Kështu, në fusnotën nr. 454 citojnë një broshurë, e cila gjoja vërteton atë që thonë autorët, përkatësisht këtë konstatim të tyre: "Përpos kësaj në preambulë ndonjëherë pasqyrohen edhe ngjarjet e rëndësishme historike, identiteti kombëtar ose vlerat e vendit dhe kushtetutës përkatëse". Broshura ***What is a Constitution? Principles and concepts*** (International IDEA: Stockholm, 2014), ndërkaq, të cilën e citojnë autorët në fusnotën e sipërcekur, thotë kështu në fq. saj të pestë:

> Kushtetutat shpesh provojnë, në përmasa të ndryshme, të reflektojnë dhe formësojnë shoqërinë përmes shprehjes se identitetit të përbashkët (ekzistues ose që synohet) dhe aspiratave të popullit, ose përmes proklamimit të vlerave dhe idealeve të përbashkëta. Këto dispozita përgjithësisht gjenden në preambula apo në deklaratat hyrëse, mirëpo mund të gjenden edhe në betimet, motot apo flamujt apo simbolet tjera që definohen me kushtetutë. Dispozitat tjera substanciale të kushtetutës, në veçanti ato që definojnë të drejtat socio-ekonomike, politikat kulturore ose gjuhësore dhe edukimin, gjithashtu mund të futen në këtë kategori.

Këtu shihet qartë se burimi origjinal flet për tërë kushtetutën, sepse edhe vetë titulli i seksionit në fq. e pestë është "kushtetutat si deklarata shoqërore". Ky shtrembërim i burimit bëhet nga autorët tanë me shpresën se mund të argumentojnë teket e tyre aprioristike, sipas së cilës kushtetuta domosdo reflekton atë që ata e kanë në mendjet e tyre të projektuar e që lidhet me sfondin ideologjik dhe historik të kushtetutës, si faktor përcaktues të tekstit të secilës preambulë. Këtu asgjë të keqe nuk ka përveç se nuk janë vetëm këta dy faktor përcaktues por edhe faktorët e tjerë identitarë që synohet të farkëtohen në të ardhmen apo të ruhen ata ekzistuesit. Kjo përshkon preambulat në pjesën dërrmuese të rasteve dhe përbën faktorin kyç që përcakton strukturën dhe gjatësinë e një preambule. Se kjo është kështu shihet edhe në rastin e Kosovës, ku pasqyrohet pikërisht e kaluara tragjike e Kosovës, të cilës synohet t'i shmanget identiteti i ri kushtetues kosovar i kornizuar brenda parametrave të Kush-

tetutës së vitit 2008. Autorët tanë gabimisht e mendojnë se në rastin e Kosovës preambula nuk reflekton historinë e saj. Kjo është kështu sepse me histori autorët tanë nënkuptojnë identitetin etnik (nacional) të shumicës shqiptare, gjë që nuk reflektohet në Kosovë në mënyrë të veçantë pos si pjesë e identitetit të tërësishëm të ri kosovar. Kjo mungesë e identitetit historik etnik (nacional) të Kosovës në preambulë, sipas tyre, rrjedh nga fakti se Kosova ka qenë për një kohë të gjatë nën administrim ndërkombëtar si dhe rolit që ka pasur faktori ndërkombëtar në procesin e hartimit të Kushtetutës të vitit 2008. Kësaj çështjeje sërish nuk kemi ndërmend t'i kthehemi pas që mjaft e kemi trajtuar më herët në këtë pjesë të kritikës sonë. Ky konstatim i autorëve pasohet nga një paragraf tërësisht hamendësues që nuk i shkon një teksti universitar, ku tregohen me tone konspirative hapat dhe teknologjia që ndërmerren gjatë hartimit (prodhimit) të një preambule. Pas kësaj vijnë preambulat e disa shteteve sovrane dhe të pavarura, deri në fq. 149 të librit, të marra nga interneti ***ad literam***. Në mes të kësaj faqeje, ndërkaq, pason konstatimi hutues që në tërësi është i kundërt me atë që u fol më sipër rreth faktorëve përcaktues dhe asaj se çfarë reflektohet në përmbajtjen e një preambule, dhe thonë kështu:

> Çështja e të pasurit ose jo të një preambule në kushtetutë, nuk është vetëm çështje teknike e hartimit të saj, por edhe reflektim i së kaluarës, respektivisht rrethanave në të cilat është shkruar kushtetuta respektive.

Për hir të së vërtetës, në preambulë reflektohet çdoherë konteksti i shkruarjes së saj dhe rrethanat që kanë kushtëzuar tekstin e saj. Kjo vlen për çdo tekst të prodhuar nga dora e njeriut. Secili tekst, po ashtu, ka një mesazh që është i ndarë nga konteksti dhe rrethanat e lindjes së tekstit dhe me kalimin e kohës ai mesazh fiton një jetë dhe kuptim autonom nga origjina e burimit të tij material. Këto gjëra i ngatërrojnë autorët tanë në mënyrë tragjike dhe shkaktojnë konfuzitet, aq sa nuk dallohet përmbajtja e preambulës nga kuptimi i saj: duke dashur të flasin për kuptimin e preambulën në terma profesional të së drejtës kushtetuese, autorët tanë ngatërrohen në përmbajtjen e preambulës (duke pasur para syve të tyre rastin e preambulës së Kosovës). Konfuziteti i tyre nuk ndalon vetëm në preambulë: rreshtat e paragrafit të parafundit të fq. 149 nisin me konstatimin që thotë se "[n]ë pjesën normative të kushtetutës zakonisht pas preambulës janë të vendosura dispozitat për të drejtat e njeriut ose parimet e përgjithshme". Sërish duke pasur parasysh vetëm një rast konkret, autorët tanë

bëjnë gabim dhe përgjithësojnë gjetjet e tyre duke lajthitur studentin dhe lexuesin e këtij libri, me tezën sipas së cilës gjoja kushtetutat nisin pjesën e tyre operative (normative) me kapitullin apo pjesën për liritë dhe të drejtat e njeriut. Autorët nuk e thonë, por kjo nënkuptohet, se këtu fjala është për **Ligjin Themelor të Gjermanisë** (1949), nga i cili janë është nxjerrë përgjithësimi si më sipër. Asnjë kushtetutë tjetër në botë nuk fillon me liritë dhe të drejtat e njeriut, përveç rastit gjerman. Kjo ka një shpjegim historik që lidhet me tragjedinë e shkaktuar nga **Hitleri** dhe synimin e fuqishëm të kombit gjerman për të mos lejuar edhe një herë nëpërkëmbjen e lirive dhe të drejtave të njeriut nga dora e pushtetit të tyre. Jo vetëm këto dispozita, por edhe dispozitat tjera mbi federalizmin, rolin krejt formal të shefit të shtetit gjerman, parlamentarizmin dhe shtetin social, në mes tjerash, derivojnë nga kjo histori tragjike gjermane dhe vendosmërinë e gjermanëve për të mos lejuar ripërsëritjen e historisë së **Hitlerit**.

Para se të mbyllim kritikën tonë të këtij kapitulli, që mbaron me një konstatim të gabuar të autorëve tanë në fjalinë e fundit ku thonë se "[z]akonisht në vendet ku organizimi i shtetit është federal, kushtetuta është më voluminoze sesa në vendet me karakter unitar", pa cituar asnjë burim, dëshirojmë që me këtë rast t'i japim lexuesit edhe disa raste brutale të manipulimit me literaturë. E kemi fjalën për fusnotat nr. 470, 471 dhe 476 të librit: në asnjërën prej tyre, autorët e tyre origjinal nuk thonë atë që e thonë autorët tanë. Meqenëse këto janë burime të hapura dhe mund të gjenden në internet, lexuesit farë lehtë mund ta konstatojnë përmes krahasimit të dy teksteve nëse është e saktë kjo që thuhet nga autori i këtyre rreshtave.

KAPITULLI VI.
MIRATIMI DHE NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS (FQ. 155–173)

Përgjithësisht

Ky kapitull ka gjithsej gjashtë seksione. Seksioni i pestë që flet për aspektet krahasimore të ndryshimit të kushtetutave ndahet në disa nënseksione. Njëjtë si në kapitullin pararendës, seksionet karakterizohen me narrativ kaotik, i thurur me zigzage dhe me përmbajtje eklektike, duke manipuluar literaturën e autorëve të tjerë. Këtu, njëjtë si te kapitulli paraprak, gabimet

profesionale janë të theksuara dhe qartësisht të dukshme, gjë që e bën librin edhe më të dyshimtë në aspektin shkencor, profesional dhe didaktik.

Në këtë kapitull, ndër autorët që janë manipuluar apo cituar në mënyrë abuzive është kryesisht autori kosovar **Kurtesh Saliu** dhe libri tij ***E drejta kushtetuese*** (Fakulteti Juridik i UP: Prishtinë, 2004), në ndërkohë që autorët **Luan Omari** & **Aurela Anastasi** dhe libri i tyre ***E drejta kushtetuese*** (Shtëpia Botuese ABC: Tiranë, 2010) nuk citohen fare. Kjo përbën një gabim nga ana e autorëve tanë sepse, po t'i kishin lexuar me kujdes fq. 32-41 të këtij libri, do ta kishin kuptuar si duhet dallimin mes fjalës "rishikim" dhe ndryshim" i kushtetutës dhe vetë esencën e procesit të ndryshimit të kushtetutës.

Shkrimet nga autorët e huaj janë manipuluar me një intensitet të njëjtë dhe në mënyrë të dukshme si në kapitullin paraprak: janë cituar apo reprodukuar fjalitë dhe mendimet origjinale të autorit kosovar si më sipër, kurse në fusnota si aparaturë shkencore figurojnë burimet e autorëve të huaj, të cilat në të shumtën e rasteve nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen që diskutohet ose fq. që citohen nuk janë të sakta.

Të shohim si duket kjo në pjesët kryesore, të cilat i kemi analizuar kryesisht duke veçuar gabimet profesionale që duken në shikim të parë, ***prima facie***. Kështu kemi vepruar edhe me kapituj pararendës. Me fjalë të tjera, krahas analizës së fusnotave dhe aparaturës shkencore të përdorur nga autorët tanë, kemi analizuar gabimet ***prima facie*** të natyrës profesionale që janë shpërfaqur gjatë prodhimit të këtij kapitulli të librit të tyre.

Analiza kritike

Seksioni "Miratimi i kushtetutës" të cilit i paraprinë seksioni "Vështrime të përgjithshme" do të duhej të ishte pasuar nga seksioni mbi ndryshimin e kushtetutës apo dyjat së bashku do të duhej të kishin përbërë një seksion të vetëm. Kështu figurojnë në të gjitha tekstet universitare të së drejtës kushtetuese. Kjo, megjithatë, ndryshon në rastin e autorëve tanë: si seksion pasues që i paraprin seksionit mbi ndryshimin e kushtetutës është seksioni inventiv me titull "Nga buron 'pushteti kushtetutë-bërës'" (fq. 150-160). Ky seksion është shtuar si vazhdim i akrobacioneve të autorëve në lëmin e pushtetit kushtetutëbërës dhe "baballarët e kushtetutës". Të shohim shkurt njëherë se për çfarë bëhet fjalë në dy seksionet e para. Te "Miratimi i kushtetutës", duke parafrazuar në tërësi konceptin e **K. Saliu**, të dhënë kryesisht në fq. 55-58 të librit të tij autorët tanë bëjnë gabime

faktike që lidhen me mënyrat e miratimit të kushtetutave të shteteve të caktuara. Kështu, në fq. 155 të librit, ku flasin për mënyrën referendumiane të miratimit të kushtetutave konstatojnë: "Si raste të tilla mund të përmenden: **Kushtetuta e Zvicrës** 1874, **Kushtetuta e Japonisë** 1946, **Kushtetuta e Irlandës** 1937, **Kushtetuta e Federatës Ruse** 1993, **Kushtetuta e Bullgarisë** 1991 etj". E vetmja gjë e saktë është rasti i miratimit të Kushtetutës së Federatës Ruse, në ndërkohë që për rastet e tjera gjendja faktike është kjo: Zvicra, Finlanda dhe Japonia e kanë miratuar kushtetutën e tyre me asamble dhe me referendum, kurse Bullgaria vetëm me Asamble Kushtetuese. Kështu thotë **K. Saliu** në fq. 56 të librit të tij, të cilin autorët tanë e citojnë gabim në këtë pjesë, në ndërkohë që në pjesët tjera mbi miratimin dhe ndryshimin e kushtetutës e parafrazojnë kryesisht pa e cituar duke shtuar literaturë tjetër të huaj në mënyrë manipulative. Kjo mënyrë e prodhimit të tekstit bën që të ketë gabime themelore profesionale dhe trajtime joadekuate të gjërave që vërtetë janë të thjeshta për një konstitucionalist mesatar. Këtë do ta shohim në fq. në vijim.

T'i kthehemi tani edhe pak këtij seksioni: fq. 118-112 të një burimi, i cili në fusnotën nr. 489 është i paqartë dhe jo i plotë, në fakt janë fq. e një raporti të Komisionit të Venecias, fq. 119 të së cilës e citojnë autorët tanë dhe atë në lidhje me Japoninë, në ndërkohë që aty nuk përmendet jo vetëm Japonia por as që flitet fare për temën që përmbahet në burimin origjinal. Në burimin origjinal fare nuk flitet për temën e miratimit të kushtetutave me referendum, përfshirë këtu edhe rastin e Kushtetutës së Japonisë, siç pretendojnë autorët tanë. Fjala është, në fakt, për seksionin me titull "XVI. Referendum in the constitution of the Slovak Republic and the powers of the Constitutional Court of the Slovak Republic – Contribution by Mr Ján KLUKA, Member of the European Commission for Democracy through Law, Judge at the Constitutional Court of Košice", të një materiali të **Komisionit të Venecias** me titull **Constitutional Justice and Democracy by Referendum** (Strasbourg, 23-24 June 1995), CDL-STD(1995) 014, or. Engl. (*Science and technique of democracy*, no. 14).

Në fq. tjetër të librit të tyre, fq. 156, autorët vazhdojnë me mënyrën e njëjtë të citimit: në fusnotat nr. 491 & 492, në mënyrë manipulative, citojnë dy autorë të huaj, ani se konstatimi i autorëve tanë i referohet mendjes së shëndoshë, ***recta ratio***, si dhe fakteve krejtësisht notore të teorisë kushtetuese. Kjo vlen edhe për fusnotën nr. 493, ku autorët citojnë titullin e **Asamblesë Kushtetutese Italiane** si ***Assamblea Constituente della Repubblica Italiana***, gjë që nuk është e vërtetë se atë emër e ka mbajtur ky

organ i përkohshëm italian e as që ashtu e ka thënë autori i cituar në atë fusnotë: **Temistocle Martines** nuk e thotë një gjë të tillë në librin që citohet, përkatësisht në librin ***E drejta kushtetuese*** (UET Press: Tiranë, 2011, fq. 142-145). Në fq. e cituara të këtij libri, autori italian në mënyrë të shkëlqyeshme sqaron gjendjen kushtetuese në Itali nga viti 1944, e deri në nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1948. Siç e kemi sqaruar në kritikën tonë për kapitullin e katërt, referendumi italian është cilësuar si **referendum institucional** (ital.: *referendum istituzionale*) apo **referendum për formën institucionale të shtetit** (ital. *referendum sulla forma istituzionale dello Stato*), përmes së cilit italianët duhej të vendosnin nëse kreu i shtetit të tyre do të ishte nga familja mbretërore e dinastisë së **Savojës** apo një president i ri i një republike të re. Ky referendum, i mbajtur më 2 dhe 3 qershor të vitit 1946, i dha fund mbretërisë, krijoi Asamblenë Kushtetuese të Republikës Italiane, që punoi deri në vitin 1948, kur u nxor **Kushtetuta e Italisë,** e vitit 1948. Me këtë referendum mbreti u depushtetizua kurse me kushtetutën tërësi iu ndalua qëndrimi në vend. Kjo do të thotë se **Asambleja Kushtetuese Italiane** nuk ka mundur të cilësohet si republikane, para se të formohej republika (sic!). Kjo është arsyeja që **Temistocle Martines** nuk e përdor atë shprehje që thonë autorët tanë dhe, për pasojë, kjo mënyrë citimi dhe atribuimi i thënieve autorëve të tjerë përbën manipulim me literaturë. Thënë me fjalë të tjera, asambleja kushtetuese italiane është cilësuar si "asambleja kushtetuese republikane" vetëm pas shpalljes së rezultateve të referendumit me të cilin është themeluar **Republika e Italiane** dhe, për pasojë, ka ndryshuar forma monarkike e qeverisjes.

Në ndërkohë që tek autori **K. Saliu** dhe tek autorët e tjerë seriozë qartë bëhet dallimi mes miratimit të kushtetutave nga një shtet sovran dhe i pavarur për herë të parë pas krijimit, autorët tanë, nuk e kanë të qartë se format e miratimit të kushtetutës përmes organit legjislativ, jo domosdo duhet të bazohen në një dokument kushtetues paraprak. Me fjalë të tjera, kuvendi legjislativ mund të bëjë miratimin e kushtetutës për herë të parë dhe pa pasur bazë juridiko-kushtetuese në rendin e kaluar kushtetues në po atë mënyrë siç bëhet nga një asamble kushtetuese e zgjedhur nergut për një gjë të tillë. Përmbajtësish janë të njëjta, por jo për nga forma dhe këtë duhet ta thonë konstitucionalistët që pretendojnë të mësojnë studentët për konceptet bazike të së drejtës kushtetuese. Ne kemi shpjeguar në kapitullin pararendës se ***grundnorm***-a (norma e parë), përkatësisht kushtetutat e parë historikisht shikuar (H. Kelsen) apo vendimi total që përcakton formën e ekzistencës politike të një populli (K. Schmitt) nuk për-

bën një tekst kushtetues operativ por një zotim me fuqi normative që një organ apo trup e bën në emër të sovranit. Lindja e kushtetutës në këto raste rrjedh si pasojë e ushtrimit të pushtetit konstituiv origjiner (***pouvoir constituant originaire***). Kështu ka lindur Kushtetuta e Kosovës, e vitit 2008, një fakt që e ka konstatuar pa asnjë ekuivoke Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), në mendimin e saj këshillëdhënës të datës 22 korrik 2010, për çka diskutojmë në vijim sërish. Në mënyrë të njëjtë ka lindur Kushtetuta e SHBA-së, e vitit 1787, Kushtetuta e Francës, e vitit 1791, Kushtetuta e Belgjikës, e vitit 1831, Kushtetuta e ish-Jugosllavisë, e vitit 1921; Kushtetuta e Bashkimit Sovjetik-së, e vitit 1924; Kushtetuta e ish-Jugosllavisë, e vitit 1946 etj. Në të gjitha këto raste fjala është për ndërprerje radikale me të kaluarën përmes ndryshimit të formës së qeverisjes ose lindjes së shtetit të ri. Në të gjitha rastet e tjera kur ndërprerja me të kaluarën bazohet në një tekst paraprak kushtetues dhe në procedurën e paracaktuar për ndryshimin e saj bëhet fjalë për ushtrimin e pushtetit konstituiv derivativ (***pouvoir constituant dérivé***). Në rastin e pushtetit konstituiv origjiner bëhet fjalë për pushtetin për të krijuar një kushtetutë (qoftë për herë të parë apo një kushtetutë të re), kurse në rastin e dytë të pushtetit konstituiv derivativ fjala është për pushtetin për amendamentim të një kushtetute ekzistuese. Në aspekt të teknikës juridike përmes së cilës shprehet ky dallim mes pushtetit origjiner dhe atij derivativ, një gjë e tillë më së miri shihet në preambulën e kushtetutës: në rastet kur fjalia e parë e preambulës fillon me vetën e parë në shumës, NE, ose fjalia e saj e fundit mbaron me të njëjtin përemër, atëherë fjala është për ushtrim të pushtetit origjiner kushtetutëbërës; në të gjitha rastet e tjera fjala është për ushtrim të pushtetit derivativ kushtetutëbërës, ani se ndryshimet kushtetuese mund të jenë shumë të thella dhe krejt antikushtetuese. Këtë fakt të thjeshtë, autorët tanë kanë mundur ta kuptojnë sikur t'i kishin analizuar vetëm pak preambulat e atyre vendeve që i kanë reprodukuar në mënyrë eklektike dhe pa asnjë analizë kritike në fq. 143-149 të librit të tyre.

Para se të shkojmë tutje, shënojmë se në këtë fq. vërehet një manipulim me literaturë kur autorët flasin për Libinë: në fusnotën 495, autorët citojnë një burim, më saktë fq. 43-60 të tij, në ndërkohë që fq. e sakta që është dashur të referohen janë fq. 43-45. Në fq. si më sipër të këtij seksioni bëhet fjalë për Libinë, por me një kuptim dhe përmbajtje tjetër: në burim sqarohen dilemat se përse libianët pas konfliktit dhe rrëzimit të diktatorit M. Gadafi kanë pasur hezitime që procesin e kushtetutëbërës t'ia besojnë kuvendit legjislativ, duke insistuar në themelimin e një kuvendi kushtetu-

es që do të kishte përfaqësim regjional (siç kishte ndodhur në vitin 1956 kur është nxjerrë kushtetuat e parë e këtij vendi).

Faqja në vijim, fq. 158, përbën uvertyrën e autorëve tanë për aventurën e tyre me shpjegimin tërësisht eklektik dhe pa asnjë bazë shkencore e profesionale të origjinës së "pushtetit kushtetutë-bërës". Pasi ripërsërisin sërish se marrëveshjet ndërkombëtare në rastet e Libanit (Marrëveshja e Cyrihut), Bosnjë-Hercegovinës (Marrëveshja e Dejtonit) dhe Kosovës (Plani Ahtisaari) kanë pasur rolin e kushtetutëbërësit, autorët tanë zbulojnë edhe një kushtetutëbërës tjetër që nuk është njohur deri më sot në teorinë kushtetuese, së paku nuk ka qenë i njohur nga autori i këtyre rreshtave – grupi i disa shteteve. Në raste të caktuara, thonë autorët tanë, në cilësinë e kushtetutëbërësit mund të paraqiten edhe disa shtete së bashku përmes traktateve me përmbajtje kushtetuese. Si rast tipik për këtë, gjithnjë sipas tyre, është **Traktati i Lisbonës** si traktat ndërkombëtar me përmbajtje juridiko-kushtetuese në kuadër të Bashkimit Evropian. Autorët ngatërrojnë, në mënyrë të dukshme, konceptin e kushtetutës nga materia kushtetuese që normohet më një dokument juridik. Historia kushtetuese e njerëzimit tregon se që në kohërat e Babilonisë, shteteve antike para Greqisë, pastaj në kohën e Perandorisë Romake dhe perandorive e shteteve të tjera deri në mbarim të Mesjetës (rreth vitit 1500) kanë ekzistuar norma dhe rende juridike që kanë pasur fuqi juridike më të lartë se normat apo rendet e tjera juridike brenda shteteve dhe në marrëdhëniet e shteteve të kohës ndërmjet vete. Të kësaj natyre janë edhe normat e Traktatit të Lisbonës apo normat e disa kushtetutave nacionale apo normat e së drejtës ndërkombëtare zakonore me fuqi ***jus cogens***: ato kanë epërsi ndaj normave të caktuara vendore dhe për situatat e caktuara, por vetë kushtetuta nuk janë. Nga trajtimi i autorëve tanë sikur del që shtetet sovrane dhe të pavarura në kohën më të madhe të zhvillimit njerëzor janë marrë dhe merren me ushtrimin e pushtetit kushtetutëbërës origjiner në emër të anëtarëve të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare (sic!).

Seksioni "Nga buron 'pushteti kushtetutë-bërës'?" (fq. 159-160) përbën margaritarin e këtij seksioni: në ndërkohë që janë të qartë sa i përket ushtrimit të pushtetit derivativ (por që nuk janë të vetëdijshëm për ekzistimin e këtij koncepti në të gjitha tekstet mbi të drejtën kushtetuese jashtë Kosovës), duke thënë se ndryshim i kushtetutës bëhet sepse ashtu thotë dhe parashikon kushtetuta ekzistuese, janë konfuzë pafundësisht kur bëjnë fjalë për pyetjen e pyetjeve në të drejtën kushtetuese bashkëkohore, pra nga buron norma e parë (***grundnorm***). Që në fillim, autorët tanë

ngatërrojnë normën e parë (***grundnorm***-ën) me të drejtën për hartim të kushtetutës. Vetëm këtë të dytën e cilësojnë si pushtet kushtetutëbërës, kurse për të parën as që janë të vetëdijshëm se çfarë statusi ka në procesin e formësimit kushtetues të një shoqërie. Pak më vonë, autorët tanë sqarojnë se pushteti kushtetutëbërës u takon edhe **baballarëve (etërve themelues) të kushtetutës**, duke konstatuar se hartimi teknik i një kushtetute është i barasvlershëm me tagrin apo të drejtën për të ushtruar pushtetin kushtetutëbërës origjiner, për herë të parë dhe jashtë një rendi ekzistues juridiko-kushtetues. Kështu duket ky konstatim epokal i tyre, i dhënë në paragrafin e mesëm të fq. 159 të librit:

> Por, ajo që vlen të përmendet në këtë drejtim, është se me rastin e miratimit të kushtetutës së parë, pushtetin kushtetutë-bërës nuk e kanë "*baballarët (etërit) e kushtetutës*". Ata janë thjeshtë bartës të pushtetit kushtetutë-bërës. Por, meqenëse ende nuk kemi kushtetutë, nga e marrin ata këtë pushtet?
>
> Përgjigja është thjeshtë në parim. Këtë pushtet ata e marrin nga populli, pasi populli është ai i cili ka pushtet kushtetutë-bërës, dhe "*baballarët (etërit themelues) të kushtetutës*" janë thjeshtë përfaqësues të vullnetit të popullit. Në këtë kontekst është pikërisht kjo arsyeja, pse Kushtetuta dhe Deklarata e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, fillon me fjalët "Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike." Një logjikë e tillë proklamohet edhe në kushtetutën e SHBA-ve dhe në frymën e saj.

Nuk besoj se ka student apo lexues që mund të marrë vesh se cili është kriteri për të dalluar pushtetin kushtetutëbërës nga pushteti jokushtetutëbërës dhe cilat janë format e manifestimit të pushtetit kushtetutëbërës ashtu siç mësohen sot. Kjo pashmangësish lidhet me emrin e arkitektit të këtij koncepti dhe të praktikës së bazuar në të. E kemi fjalën për shkrimtarin politik francez **Emmanuel Joseph Sieyès** (1748-1836), i njohur si **Abbé Sieyès**, dhe pamfletin e tij politik me titull ***Qu'est-ce que le Tiers-État?*** (janar 1789), që pati ndikim të fortë në Revolucionin Francez. Nuk ka libër serioz mbi të drejtën kushtetuese në dy anët e Atlantikut që nuk trajton kuptimin e pushtetit kushtetutëbërës dhe format e manifestimit të tij duke u nisur nga autor francez. Kjo në veçanti vlen për autorët francezë të cituar nga autorët tanë në mënyrë manipulative në fusnotat nr. 491-492. Në asnjë libër dhe te asnjë autor në dy anët e Atlantikut nuk mund të haset termi "*baballarët (etërit themelues) të kushtetutës*" në kontekst të diskutimit për cilëndo formë të pushtetit kushtetutëbërës. Këtë e kemi sqa-

ruar në kapitullin pararendës. Këtu ka nevojë për lexuesin tonë që të japim disa shqyrtime të koncepteve dhe mendimeve themelore të **Abbé Sieyès**-it, në mënyrë që të kontekstualizohet edhe më shumë esenca e kuptimeve themelore mbi pushtetin konstituiv dhe origjinën e tij (në dy trajtat e manifestimit si më sipër). Para se ta bëjmë këtë, lexuesin e njoftojmë se paragrafi në vijim pas konstatimit epokal të sipërcituar të autorëve tanë është në tërësi një tautologji që mund të dëgjohet nëpër ndeja të ndryshme nga njerëz të caktuar të jetës publike. Ky paragraf menjëherë ristruktohet duke e futur në përdorim mendimin e **GJND**-së për Kosovën ashtu që në fund të tij formohet një mendim tërësisht i saktë por që bie ndesh fund e krye me konceptin e autorëve tanë për kuptimin e pushtetit kushtetutëbërës dhe format e manifestimit të tij. Në fund të këtij seksioni, autorët i thonë studentit e lexuesit se "[n]ga kjo që thamë më lartë, kuptohet në parim nocioni 'pushtet kushtetutë-bërës', ndonëse këtu ka shumë vend për trajtim dhe elaborim të mëtutjeshëm". Nuk besoj se studenti e lexuesi pajtohen më këtë konstatim, përkatësisht nuk kuptoj se do ta kenë të qartë këtë që thonë autorët. Unë, për veten time, vetëm një gjë e kam shumë të qartë: autorët tanë kanë probleme serioze me kuptimin e këtij koncepti themelor dhe nuk mund të jetë e falshme asnjëherë diskutimi i tyre në mënyrë kaq konfuze dhe pa asnjë referim të **Abbé Sieyès**-it dhe evoluimit të kësaj doktrine përgjatë shekujve deri në kohën tonë. Pikërisht për këtë arsye, dhe për hir të lexuesit tonë, në vijim do t'i veçojmë disa aspekte të mendimit politik me rëndësi kushtetuese kolosale të autorit francez të sipërcekur.

Në fillim, duhet të sqarojmë se titulli i pamfletit në shqip do të thotë "Çka është shtresa e tretë?". Si i tillë, ai është shkruar me ftesë të qeverisë franceze të kohës në vigjilje të Revolucionit. Esenca e pamfletit është kjo: Para Revolucionit kanë ekzistuar tri shtresa – shtresa e parë ka qenë kleri; shtresa e dytë aristokracia; dhe shtresa e tretë ose popullsia e përgjithshme (shtresat fshatare dhe qytetare). Kjo e fundit përbënte pjesën dërrmuese të popullsisë, mbi 95 për qind, paguante taksa të larta dhe në kurriz të tyre jetonin dy shtresat e para. Mbreti **Luigji XVI** kishte vendosur që të thërras, pas më shumë se një shekull pushimi, një tubim të tri shtresave franceze, i njohur si Asambleja e Përgjithshme (***États généraux***), me qëllim të reformimit të sistemit shoqëror dhe politik. Ky moment i shërbeu **Abbé Sieyès**-it, hartuesit të **Deklaratës për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit**, që të luftojë për shndërrimin e Asamblesë së Përgjithshme në Asamble Nacionale, gjë që u bë në qershor të vitit 1789, për t'u kthyer në korrik

të atij viti në një tjetër organ të rëndësishëm revolucionar, në Asamble Kushtetuese. Në pamfletin si më sipër, ky autor ka fuqizuar deri në pafundësi rolin e masave popullore, duke qartësuar edhe më shumë dallimin mes sovranitetit shtetëror (kuptimi vestfalian), sovranitetit popullor (të gjithë shtetasit, pa dallime shtresore) dhe përfaqësimit demokratik (si përfaqësues të popullit, për dallim nga demokracia e drejtpërdrejtë). I tërë angazhimi i tij teorik dhe praktik konsiston në ndryshimin rrënjësor të kuptimit të origjinës së pushtetit: ky më nuk do të mund të ketë origjinë hyjnore por vetëm laike dhe të kësaj bote materiale. Kjo u cilësua si pushtet konstituiv, pra si pushtet që buron nga populli dhe që asnjëherë nuk konsumohet me një deklarim të popullit lidhur me një formë të organizimit politik. Në kushtetutat që pasuan, megjithatë, u pa se pushteti popullor nuk mund të lihej i pafrenuar sepse përbënte rrezik për kaos, anarki dhe dhunë permanente; për këtë arsye në kushtetutat dhe dokumentet e tjera të shkruara u bë sanksionimi i këtij vullneti origjiner kushtetutëbërës (konstituiv), duke lënë mundësinë e amendamentimit (ndryshimit) të formës fillestare të deklarimit të vullnetit konstituiv dhe të formës politike të ekzistencës së një shoqërie. Kjo e dyta u cilësua si pushtet derivativ kushtetutëbërës, kurse e para si pushtet origjiner kushtetutëbërës. Esenca e tërë kësaj ka qenë që mbreti asnjëherë më nuk mund të jetë burim i pushtetit kushtetutëbërës (konstituiv). Kjo situatë zgjati deri me rrëzimin e **Napoleonit** dhe restaurimin e dinastisë së **Bourbonëve**. Megjithëse u bë restaurimi i pushtetit kushtetutëbërës (konstituiv) origjiner në favor të dinastisë burbone, kjo pati për efekt anësor pozitiv atë se i hapi rrugë ndërtimit në Evropë të mbretërive kushtetuese; në këtë fazë, parimi i ndarje dhe balancimit të pushteteve kuptohej si kufizim i pushtetit ekzekutiv të monarkut, i cili mbante akoma pushtet të fortë ekzekutiv dhe konsiderohej si bartës i pushtetit konstituiv (kushtetutëbërës) në dy trajtat e manifestimit të tij. Me përjashtim të Kushtetutës së Belgjikës (1831) dhe Kushtetutës së Rajhut Gjerman (1849), të gjitha kushtetutat evropiane pak a shumë kanë sanksionuar monarki kushtetuese të llojit që u instalua në Francë pas restaurimit burbon në vitin 1814 (Rusia, u mor vesh, nuk bën pjesë në këtë grup, siç nuk bën pjesë as Perandoria Otomane).

Kushtetuta e Vajmarit (1919) bën kthesën e parë serioze në këtë drejtim, por pa një jetë të gjatë. Deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, tipi i monarkive kushtetuese do të ngelet forma e konservimit dhe shpërfaqjes së pushtetit kushtetutëbërës (konstituiv), origjiner dhe derivativ, me mbretin si personifikim i këtij pushteti. Pushteti i materializuar si pasojë e

ushtrimit të këtyre dy pushteteve, që përbëhet nga organet dhe organizatat e pushtetit, institucionet dhe format tjera të realizimit institucional të pushtetit kushtetues (konstituiv), në dy trajtat e tij, quhet pushtet i konstituuar (***pouvoir constitué***). Në kuadër të këtij të fundit hyjnë organet dhe institucionet si: parlamenti, presidenti, gjykatat, përfshirë këtu gjykatën kushtetuese nacionale, avokati i popullit dhe kështu me radhë. Këtë sqarim si më sipër, lexuesi mund ta gjejë në çdo tekst serioz universitar lidhur me të drejtën kushtetuese, në ndërkohë që në **Francë** ky aspekt i trajtimit reflektohet mjaft shpesh edhe në vetë titujt e teksteve mbi të drejtën kushtetuese, të cilat titullohen si "E drejta kushtetuese dhe organizimi politik", për të shënuar dallimin mes trajtimit të historisë kushtetuese krahasuese dhe të drejtës klasike kushtetuese dhe organizimit politik. Këtu përmendim, sa për ilustrim, vetëm disa nga tekstet më kryesore nga ku i kemi nxjerrë përfundimet tona si më sipër: Louis Favoureau et al., ***Droit constitutionnel*** (Dalloz: Paris, 2017, fq. 114-122); Olivier Duhamel, Guiallaume Tusseau, ***Droit constitutionnel et institutiones politiques*** (Seuil: Paris, 2013, fq. 104, 125-128, 166, 171-173, 264, 421-423, 449-453, 511-513); Brigitte Basdevant-Gaudemet, Jean Gaudemet, ***Introduction historique au droit: XIIIème-XXème siècles***, 3ème ed. (LGDJ: Paris, 2010, fq. 341, 343-344).

Kjo si më sipër dallon thellësisht dhe në mënyrë fundamentale nga modeli britanik, ku nuk ekziston kuptimi i pushtetit konstituiv (*pouvoir constituant*) dhe popullit si titullar i tij. Pse Revolucioni Madhështor (1688) nuk krijoi teorinë dhe praktikën e pushtetit kushtetutëbërës (*pouvoir constitutant*)? Kjo sepse ky revolucion ndryshoi vetëm autoritetin publik, duke zhvendosur pushtetin kah parlamenti anglez ashtu që pushteti konstituiv (*pouvoir constitutant*) u absorbua nga parimi i sovranitetit të parlamentit, jo të popullit: rregullat që kanë përbërë kushtetutën britanike, dje dhe sot, janë fundamentale por jo supreme. Në Revolucionin Francez (dhe në Revolucionin Amerikan), ndërkaq, u krijua sistemi i ri politik që bazohet në qeverisjen legjitime. Ky parim i legjitimitetit të qeverisë u vesh me forcë juridike dhe me petkun legal para se qeverisësit e rinj të merrnin pushtetin ashtu që qeverisja e tyre të ishte sipas një kuadri ligjor. Kjo nënkuptonte se parimi i legjitimimit të kushtetutës moderne nuk mund të ishte më sovraniteti monarkik apo parlamentar por sovraniteti popullor. Për dallim nga monarku sovran dhe parlamenti sovran, populli nuk mund të qeverisë me vetveten. Ata kanë nevojë për përfaqësues për të qeverisur në emër të tyre. Qeverisja demokratike, nga ana tjetër, është qe-

verisje me mandat, dhe si e tillë ka nevojë për kornizë juridike të fuqisë më të lartë, pra për një kushtetutë. Kështu ka rezonuar **Abbé Sieyès**, në tërë përvojën e tij dhe opusin teorik përtej veprës së sipërcituar. Këtë më së miri e ka shtjelluar **Pasquale Pasquino**, në veprën e tij ***Sieyès et l'invention de la constitution en France*** (Odile Jacob: Paris, 1998). Sot ky është standard i shumicës së kushtetutave të botës bashkëkohore demokratike, u mor vesh i modifikuar sa i përket statusit të pushtetit të konstituuar si pasojë e lindjes së partive politike dhe grupeve të interesit të cilat ndikojnë fuqishëm në natyrën e pushtetit modern dhe sanksionimin e tij kushtetues. Për këtë evoluim të pushtetit kushtetutëbërës (konstituiv) përgjatë historisë, gjithnjë në dritën e idesë fillestare të Abbé Sieyès-it, lexuesit tonë i sugjerojmë që të konsultojnë literaturën në vijim, ku përfshihen të gjitha aspektet krahasimore të natyrës dhe kuptimit të pushtetit kushtetutëbërës në të gjitha trajtat e tij të manifestimit: Diter Grim, "Types of Constitutions", botuar në Michel Rosenfled & András Sajó (eds.), ***The Oxford Handbook of Comparative Law*** (Oxford UP: Oxford, 2012; Stephen Holms, "Constitutions and Constitutionalism", botuar në vep. e cit.; Gunter Frankenberg, "Democracy", botuar në vep. e cit.; Claude Klein and András Sajó, "Constitution-Making: Process and Substance", botuar në vep. e cit., etj. etj.). Në asnjë prej këtyre punimeve studimore lexuesi nuk do të gjejë autorë që asociojnë në çfarëdo mënyrë të a.q. baballarët (etërit) e kushtetutës me ekzistencën dhe ushtrimin e pushtetit konstituiv (kushtetutëbërës), në cilëndo trajtë të tij (sic!).

T'u kthehemi tani seksioneve të fundit të këtij kapitulli. Seksioni "Mbi ndryshimin (amendamentimin) e kushtetutës" paraqet një ekzskursion të lirë të autorëve për çdo gjë që ka të bëjë me ndryshimin (amendamentimin) e një kushtetute por jo një diskutim mbi esencën e kuptimit, përmbajtjen dhe formën e tij. Që në fillim, në fusnotën nr. 505 citohet një burim që fare nuk ekziston, nuk ka datë dhe vend botimi (sic!). Ky burim nuk ekziston as në tekstin nga autorët e kanë marrë *ad literam*, metodë kjo e papranueshme për citim të burimeve. E kemi fjalën për burimin që vetë autorët e citojnë në fusnotën në vijim, fusnota nr. 506, nga ku autorët kanë marrë këtë burim inekzistent. Fundja, edhe po të ekzistonte ai burim, asnjë relevancë nuk e ka për temën e amendamenteve kushtetuese, kuptimin, përmbajtjen dhe formën e tyre. Pas disa rreshtave kaotikë që nuk tregojnë për asnjë esencë të temës që diskutohet, autorët tanë kalojnë në gjëra që edhe më tepër janë pa relevancë për lexuesin. Venë të citohet në tërësi paragrafi që vërtetë kalon kufijtë për nga jorelevanca e tij në

lidhje me temën që diskutohet, si dhe për shkak të nivelit deri në absurd të cektësisë intelektuale të autorëve. E kemi fjalën për paragrafin si vijon:

> Ka një ndryshim teorik në mes të amendamentimit (ndryshimit) dhe rishikimit të kushtetutës. Rishikimi i kushtetutës nënkupton një ndryshim rrënjësor të kushtetutës, ose më mirë thënë një ndryshim konceptual të saj. Gjithashtu për rishikimin e kushtetutës zakonisht kërkohen edhe procedura tjera, më të rrepta sesa për ndryshimin e saj. Edhe **Carl Schmitt**, duke ju referuar konceptit të rishikimit dhe të ndryshimit të kushtetutës potencon ndër tjera se dallimi në mes të ndryshimit dhe rishikimit ka të bëjë me kufijtë e ndryshimit.

Para se t'i tregojmë lexuesit tonë se asnjëherë **Carl Schmitt** nuk mund ta ketë thënë këtë si më sipër, duhet të shikojmë nëse autori **Richard Albert**, i cituar në fusnotën nr. 513, thotë ashtu siç thonë autorët tanë. Nga leximi i kujdesshëm i shkrimit të këtij autori me titull "Amending constitutional amendment rules", në mënyrë të qartë del se shkrimi flet për një materie krejtësisht të ndryshme nga ajo që mendojnë autorët tanë: **Richard Albert** flet për dispozitat mbi amendamentimin (ndryshimin) e dispozitave kushtetuese mbi amendamentimin e kushtetutave ekzistuese, jo për kufijtë e amendamentimit të dispozitave të caktuara kushtetuese që konsiderohen të rrënjosura (groposura) thellë në kushtetutë dhe në kulturën kushtetuese konkrete. Këto të fundit njihen si "klauzolat e përjetësisë", kurse doktrina mbi këtë lloj amendamentimi njihet si *unconstitutional constitutional amendments*. Këto dispozita kushtetuese të përjetësuara apo të rrënjosura thellë në një tekst kushtetues ankorohen zakonisht në pjesët që kanë të bëjnë me formën e qeverisjes, siç është rasti **Francës**, me laicitetin, siç është rasti me **Turqinë** para Erdoğanit, të drejtat e njeriut, siç është rasti me **Kosovën** dhe kapitullin e dytë të Kushtetutës së vitit 2008, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, siç është rasti me **Gjermaninë** dhe nenet 1 & 20 të Ligjit Themelor dhe kështu me radhë. Vendet islame kanë përjetësuar, në shumicën e rasteve, dispozitat lidhur me Kuranin, të cilin e konsiderojnë si burim primar për prodhimin e çdo norme juridike. Këto dispozita, pra dispozitat që kanë të bëjnë me përjetësimin e disa dispozitave kushtetuese, duke i bërë të pandryshueshme, gjenden të shkapërderdhura në pjesë të ndryshme të kushtetutave nacionale. Në Kosovë ato gjenden në kapitullin e dytë, por edhe në frymën dhe shpirtin e Kushtetutës si tërësi (sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese). Arkitekt ideor i tyre është pikërisht **Carl Schmitt**, duke u bazuar në analizën e tij të dispozitave të **Kushtetutës së Vajmarit** (1919) mbi të a.q. "kushtetutën e

dytë të Vajmarit" (shprehje e **Carl Schmitt**-it për të treguar se kapitulli i dytë i kësaj kushtetute ka qenë e përjetësuar dhe ka penguar ndryshimin e konceptit të Republikës së Vajmarit). Dispozitat për të cilat flet **Richard Albert**, ndërkaq, gjenden në fund të çdo kushtetute dhe kanë të bëjnë me rregullimin e mënyrës dhe procedurës së ndryshimit të kushtetutës ekzistuese. Vetë ky autor konstaton se dispozitat mbi amendamentimin janë të njëjta me shumicën e dispozitave kushtetuese ashtu që për ndryshimin e tyre vlejnë rregullat për amendamentimin e kushtetutës, me përjashtim të pjesëve që janë të rrënjosura. Për këto dispozita, thotë ky autor, çuditërisht ka shumë pak tekste kushtetuese që përcaktojnë ndonjë procedurë speciale për amendamentimin e tyre (krahaso pjesën II me titull "The Design of Constitutional Amendment Rules", fq. 4-12). Këtu pra, flitet për dy gjëra tërësisht të ndryshme që nuk kanë lidhje njëra me tjetrën, përkatësisht për krahasimin e ngjashmërive dhe dallimeve mes amendamentimit të kushtetutës në përgjithësi dhe amendamentimit të atyre dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me procedurën, kushtet dhe format e amendamentimit të vetë atyre dispozitave, të cilat zakonisht gjenden në fund të tekstit kushtetues. Në Kosovë, ato gjenden në nenin 144 të Kushtetutës.

Edhe diskutimin e këtij autori lidhur me dallimin mes amendamentimit dhe rishikimit, autorët tanë e marrin gabim sikur të bëhej fjalë për ndonjë teori ose praktikë kushtetuese që bën dallimin mes ndryshimit rrënjësor të një kushtetute dhe ndryshimit të saj në mënyrë të rregullt. Në seksionin të shkrimit si më sipër të **Richard Albert** (fq. 12-14), diskutimi nis lidhur tre kufijtë e heshtur që i vihen amendamentimit të rregullave mbi amendamentimin e një teksti ekzistues kushtetues. Ato tri kufizime janë: e para, dallimi mes rishikimit dhe amendamentimit; e dyta, mekanizmi i kontrollit kushtetues; dhe, e treta, mosamendamentimi i pashkruar. Në pjesën që ka të bëjë me diskutimin e dallimit mes rishikimit dhe amendamentimit, ky autor citon **Carl Schmitt**, të cilin autorët tanë e kanë marrë në mënyrë jokritike dhe e kanë transportuar në fusnotat e tyre nr. 414 & 515, siç kanë bërë edhe me autorin **Akhil Reed Amar**, i cili citohet në fusnotën nr. 509, të cilën po ashtu e kanë transportuar nga shkrimi i **Richard Albert**-it. Kjo mënyrë është e papranueshme nga aspekti i etikës profesionale. Këtu, kjo nuk ka rëndësi të madhe meqenëse duhet t'i kthehemi dallimit mes amendamentimit dhe rishikimit sipas **Richard Albert**-it, si dhe qëllimit dhe esencës së shkrimit të këtij autori.

Si në çdo shkrim serioz, që në hyrje autori duhet të japë qëllimin dhe

synimet e tij, pritjet nga lexuesi dhe strukturën e shkrimit. Këtë e bën **Richard Albert**: qëllimi i shkrimit, na thotë ai në fillim, ka të bëjë me ofrimin e sugjerimeve për kushtetutëbërësit në të ardhmen që të përqafojnë në dizajnin e tyre kushtetues strategjinë e a.q. rrënjosjes (groposjes) së rregullave mbi amendamentimin (***entrenching clause against amendement***). Më këtë autori nënkupton situatën kur në një kushtetutë futen tri lloje të dispozitave në pjesën e dispozitave që rregullojnë amendamentimin (ndryshimin) e kushtetutës ekzistuese: e para, dispozitat që tregojnë se cilat pjesë të kushtetutës nuk mund të ndryshohen asnjëherë (si p.sh. Forma e qeverisjes, liritë dhe të drejtat e njeriut, laiciteti, feja e caktuar dhe roli i saj udhëheqës etj.); e dyta, dispozitat që përcaktojnë procedurën, zakonisht të vështirësuar, që duhet të ndiqet për çdo amendamentim (ndryshim) të tekstit ekzistues kushtetues; dhe, e treta, dispozitat kushtetuese mbi amendamentimin (ndryshimin) që përfshijnë dy kategoritë si më sipër dhe që përcaktojnë rrënjosjen (groposjen) e këtyre dispozitave mbi amendamentimin. Kjo arrihet duke përdorur përemrin dëftor, njëjës ose shumës, që tregon se dispozitat mbi amendamentimin kushtetues kanë të njëjtin status me klauzolën e përjetshme, të rrënjosur (groposur) thellë, ashtu që dyja fitojnë cilësinë e dispozitave që nuk mund të amendamentohen. Për ta kuptuar këtë më mirë, më poshtë do të citojmë rastin e **Hondurasit**, si ndër rastet e rralla të cilin e citon **Richard Albert** në fusnotën nr. 74 të fq. 9. Kjo cilësohet si taktika e "amendamentimit të dyfishtë": një herë duhet të amendamentohen (ndryshohen) rregullat mbi amendamentimin kushtetues për të lehtësuar (ulur) pragun e amendamentimit (ndryshimit) që zakonisht është i lartë dhe i vështirë, kurse herën e dytë, pas këtij hapi, kryhen amendamentimet edhe në pjesën që ka të bëjë me dispozitat e paamendamentueshme (ndryshueshme), siç janë ato mbi formën republikane të qeverisjes (Franca, Italia etj.), laicitetin (Franca, Kosova etj), liritë dhe të drejtat e njeriut (Kosova, Afrika e Jugut etj.). Të shohim si duket kjo në **Kushtetutën e Hondurasit** (2013), aktualisht në fuqi, dispozitat kushtetuese përkatëse që gjenden në kapitullin me titull "Amendamentimi dhe pacenueshmëria e Kushtetutës":

> Neni 373
>
> Amandamentimi i kësaj Kushtetute mund të lejohet nga Kongresi Nacional, në sesion të rregullt, me dy të tretat e anëtarve të tij. Vendimi për lejim të amendamentimit duhet të saktësojë se cili nen apo cilat nene do të amendamentohen dhe më pastaj, me qëllim të hyrjes në fuqi, të kalojë për ratifikim në sesionin e rregullt legjislativ me një numër të njëjtë të votave.

> Neni 374
> Neni i mësipërm, ky nen dhe nenet e Kushtetutës që kanë të bëjnë me formën e qeverisjes, territorin nacional, mandatin presidencial, ndalimin e rizgjedhjes për President të Republikës të qytetarit që ka shërbyer si president nën çdo titull, si dhe dispozitat që kanë të bëjnë me personat që nuk mund të jenë President i Republikës për kohën e dhënë nuk mund të amendamentohen në asnjë rast.

Këto dispozita, sipas autorit, duhen dalluar nga dispozitat kushtetuese që e bëjnë të vështirë në aspektin procedural amendamentimin (ndryshimin) e kushtetutës. Në këtë drejtim përmendet si rast specifik Kushtetuta e SHBA-së. Si raritet, përveç rastit të **Hondurasit**, autori zë në gojë edhe rastin e tentimit të pa sukses të **Japonisë** për të ndryshuar Kushtetutën e vitit 1946, me qëllim të futjes së dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me amendamentimin kushtetues. Kaq!

Nga sa më sipër, krejt shkrimi ka të bëjë me diskutimin e kufijve të amendamentimit (ndryshimit) të dispozitave ekzistuese mbi amendamentimin. Autori konstaton se ato gjenden kryesisht në pjesën e dispozitave përfundimtare të kushtetutës dhe njihen si klauzola të përjetësisë apo klauzolat e rrënjosura (groposura) thellë në kushtetutë dhe vlerat e saj. Sipas autorit të shkrimit, këto dispozita nuk ndihmojnë shumë për ndryshimin radikal (rrënjësor) të kushtetutës, siç nuk ndihmojnë as dispozitat e përjetësisë të rrënjosura (groposura) thellë në tekstin dhe kulturën kushtetuese. Në këtë kontekst, autori ka përmendur dallimin teorik mes rishikimit dhe amendamentimit (ndryshimit). **Richard Albert** në fillim, në fq. 12, konstaton se dy këto kuptime janë specie të ndryshimit kushtetues. Sipas tij, në ndërkohë që amendamentimi nënkupton plotësim, fshirje ose ndryshim të dispozitave të tekstit ekzistues kushtetues, rishikimi kushtetues nënkupton shkaktimin e ndryshimeve të mëdha kushtetuese në një shoqëri të organizuar në shtet (fq. 13). Ky dallim mes rishikimit dhe amendamentimit nuk ka të bëjë me procedurën e vështirësuar për rishikim, siç besojnë autorët tanë, por me thellësinë e ndryshimit kushtetues. Ai ndryshim asnjëherë nuk mund të prekë themelet e rendit kushtetues, gjë që e konstaton vetë ky autor duke përmendur rastet e **Austrisë**, **Kostarikës**, **Spanjës** dhe **Zvicrës**, të cilat njohin shprehjen dhe dallimin mes rishikimit të pjesshëm dhe atij total: i pari i përgjigjet amendamentimit, kurse i dyti rishikimit rrënjësor. Në disa raste kërkohet referendum për rishikim kushtetues (Austria); në të tjerat raste kërkohet mbajtja e Asamblesë Kushtetuese për të ushtruar rishikimin kushtetues (Kostarika); në Spanjë kërkohet shpër-

ndarja e parlamentit dhe ratifikim në referendum para dhe pas harmonizimit të tekstit me të cilin kryhet rishikimi kushtetues; referendum dhe shpërndarje e parlamentit pas rishikimit total me referendum. Si në rastin e parë (rishikimi), ashtu dhe në rastin e dytë (amendamentimi), fjala është për ndryshime kushtetuese në kuadër dhe sipas autorizimeve ekzistuese kushtetuese. Kjo qartë shihet nga dispozitat e nenit 44 (3) të **Kushtetutës së Austrisë** (1920), neneve 195-196 të **Kushtetutës së Kostarikës** (1949), neneve 166-168 të **Kushtetutës së Spanjës** (1978), nenit 193 të **Kushtetutës së Zvicrës** (1999). Në të gjitha këto raste flitet për ushtrimin e pushtetit konstituiv derivativ (*pouvoir constituant dérivé*), që ushtrohet nga organet kushtetuese të konstituara si rezultat i ushtrimit të pushtetit konstituiv të popullit, qoftë drejtpërsëdrejti apo përmes përfaqësuesve të vet.

Sa i përket **Carl Schmitt**, autorët gabojnë kur thonë se dallimi mes rishikimit dhe amendamentimit (ndryshimit) konsiston në kufijtë e ndryshimit (fq. 162 e librit). Nuk bëhet fjalë për kufijtë e ndryshimit por për identifikimin nëse bëhet fjalë për ndryshime kushtetuese sipas dhe brenda autorizimeve kushtetuese të njohura nga kushtetua ekzistuese apo për ndryshime kushtetuese kundër dhe jashtë autorizimeve kushtetuese ekzistuese. Gabimi i autorëve tanë buron nga fakti se kanë transportuar ***ad literam*** fusnotat nr. 103-106 të autorit **Richard Albert**, pa lexuar asnjëherë librin e **Carl Schmitt,** *Constitutional Theory* (Duke UP: USA, 2008). Lidhur me dallimin mes amendamentimit (ndryshimit) dhe rishikimit kushtetues, ajo që thotë **R. Albert** është e njëjtë me atë që thotë vetë **C. Schmitt**. Sikundër kemi theksuar më herët, ky jurist konservativ gjerman ka bërë dallim të qartë mes kushtetutës dhe të drejtës (normës) kushtetuese: me të parën ka nënkuptuar një vendim total të një kombi lidhur me formën e ekzistencës së vet politike, kurse me të dytën ka nënkuptuar atë që ne sot e cilësojmë si kushtetutë të shkruar në kuptimin e saj formal. Kufijtë e amendamentimit, sipas **Carl Schmitt**-it, gjenden në të drejtën (normën) kushtetuese, e cila paraqet realizim të pushtetit kushtetutëbërës derivativ, kurse rishikimi kushtetues nuk i takon sferës që mund të normohet juridikisht sepse çdoherë populli ka të drejtën e vetë-deklarimit total lidhur me formën e ekzistencës së vet politike. Kjo është arsyeja pse **Carl Schmitt** ka theksuar se duhet të ekzistojnë disa dispozita kushtetuese që nuk mund të amendamentohen në bazë të kushtetutës ekzistuese sepse përbëjnë identitetin dhe kontinuitetin e një kushtetute të shkruar, vetë shpirtin dhe parimet e saj. Tejkalimi i këtij autorizimi kushtetues, sipas tij, paraqet diçka tjetër që nuk shpjegohet me konceptin e amendamentimit

kushtetues por me konceptin e rishikimit kushtetues në kuptimin e mësipërm shmitian. Ky i fundit, rishikimi kushtetues, gjithnjë sipas **Carl Schmitt**-it, asnjëherë nuk autorizohet me një normë paraprake por gjendet si autorizim i rrënjosur në popull, që ka të drejtën për të marrë vendim konkret total për formën e ekzistimit të vet politik. Kjo është esenca e dallimit të këtyre dy koncepteve, të cilin **Richard Albert** e ka shumë të qartë, gjë që shihet nga diskutimi i tij i këtij problemi në fq. në vijim pas fq. 13 të shkrimit si më sipër, i cili shkrim në ndërkohë është ribotuar edhe në *International Journal of Constitutional Law* (vol. 13, issue 3, 1 July 2015, fq. 655–685). Ftojmë lexuesin që ta krahasojë këtë shkrim dhe librin e **Carl Schmitt**. Në lidhje me librin, lexuesi në veçanti duhet të fokusohet tek analiza e titujve të kapitujve ku diskutohen këto çështje, përmbajtja e të cilave flet për esencën e dallimit të autorit mes kushtetutës dhe të drejtës (normës) kushtetuese dhe rishikimit dhe amendamentimit: i pari nuk përcaktohet me të drejtën (normën) kushtetuese kurse i dyti po. Po të ishte ndryshe, siç mendojnë autorët tanë, ky autor do të llogaritej në grupin e konstitucionalistëve liberalë krahas **Hans Kelsen**-it, me të cilin pikërisht këtë mosmarrëveshje e kanë pasur, pra rreth kuptimit të termit kushtetutë dhe e drejtë (normë) kushtetuese. Në asnjë tekst të së drejtës kushtetuese termit rishikim nuk i jepet kuptimi që pretendojnë autorët tanë, duke e dalluar nga amendamentimi (ndryshimi), sepse i tillë nuk është. Të vetmet kushtetuta që akoma e përdorin termin rishikim në kuptim të ndryshimeve rrënjësore, siç u pa më sipër, janë **Austria**, **Kostarika**, **Spanja**, **Zvicra**. Në këto tri vende, sërish duhet theksuar, fjala është për autorizim kushtetues për kryerjen e rishikimeve të thella kushtetuese, pra të amendamentimeve totale, përfshirë këtu nxjerrjen e kushtetutës së re pa prekur themelet e kushtetutës si vendim total mbi formën e organizimit politik. Kjo, zaten, ndryshe nuk mund të jetë sepse nuk ka asnjë kushtetutë në botë që parashikon procedurën e vetë-shkatërrimit total: shteti dhe kushtetuta shkatërrohen jashtë kontekstit juridiko-kushtetues dhe në kundërshtim me të. Këtë e ka vërejtur dhe shënuar me shumë të drejtë **K. Saliu** në fq. 57 ku flet për amendamentimin (ndryshimin) e tërësishëm dhe atë parcial.

Sikur ta kishin përcjellë me vëmendje narrativin e **K. Saliut**, autorët tanë nuk do të kishin bërë gabimet dhe lajthitjet e mësipërme, përfshirë këtu manipulimet me literaturë të shënuara më lartë: fq. 162-164 te autorët tanë janë, në thelb, ide dhe fjalë të **K. Saliu**, të cilin autorët nuk e citojnë. Në vend të tij, ata citojnë autorë e burime të tjera, si dhe vetëveten.

E kemi fjalën për fusnotat nr. 516, 519, 521-522, si dhe për paragrafin e fundit para se të nisë diskutimi mbi "Dispozitat për ndryshimin e kushtetutës në disa kushtetuta – aspekte krahasimore" (fq. 164-170), të cilat janë vepër e **K. Saliu** dhe gjenden në fq. 57 të librit të tij. Ky autor në mënyrë të shkëlqyeshme në librin e vet të sipërckeur flet për llojet e ndryshimit të kushtetutës: ndryshimin e pjesërishëm (parcial) dhe ndryshimin e tërësishëm, përfshirë këtu nxjerrjen e një kushtetute të re pa e prekur formën e ekzistencës politike të një populli (**K. Saliu**, fq. 57). Ky dallim korrespondon në tërësi me atë që thamë më sipër mbi dallimin mes amendamentimit si ndryshim parcial (i pjesërishëm) dhe rishikimit si ndryshimit rrënjësor por që nuk prek formën e ekzistencës politike të një shteti. Se kjo është kështu qartë shihet nëse analizohen dispozitat e kushtetutave si më sipër të cilat përmbajnë dispozita të veçanta mbi rishikimin, duke i dalluar ato në formë dhe përmbajtje nga procesi i amendamentimit, si dhe shkrimi i **Richard Albert**-it dhe libri i **Carl Schmitt**-it.

Seksionit si më sipër pasohet nga seksioni që flet për aspektet krahasimore të ndryshimeve kushtetuese (fq. 164-170), ku autorët në mënyrë jokritike parafrazojnë materialet notore të marra nga interneti për çështjet po ashtu notore. Kapitulli mbyllet me seksionin "**Roli i Gjykatës Kushtetuese në procesin e rishikimit (ndryshimit) të kushtetutës**" (fq. 170-173). Këtij seksioni i kthehemi në rreshtat në vijim, në ndërkohë që për pararendësin e tij nuk shohim asnjë arsye që të themi ndonjë fjalë më shumë.

Në këtë seksion autorët mendojnë se studentit dhe lexuesit i kanë sqaruar rolin dhe rëndësinë e gjykatës kushtetuese, të cilën e cilësojnë si ligjvënës negativ, ani se për të thonë se ka një rol shumë aktiv dhe plotëson kushtetutën duke shkuar përtej rolit të saj tradicional si ligjvënës negativ. Kjo, në fakt, është shumë e vërtetë dhe këtë do ta theksojmë në vijim: gjykatat kushtetuese nëpër botë sot kryejnë detyra të ligjvënësit negativ. Ajo që nuk është e vërtetë, ndërkaq, është se autorët tanë i fusin në grupin e aktiviteteve të ligjvënësit negativ edhe rastet kur një gjykatë kushtetuese prodhon norma të reja kushtetuese (këtë e ka bërë Gjykata Kushtetuese e RF të Gjermanisë, GJS e SHBA-së, disa gjykata kushtetuese në Amerikën Latine etj). Kjo është gabim sepse këtu flitet për ushtrimin e pushtetit kushtetutëbërës, jo për aktivitet legjislativ të gjykatës kushtetuese. Një gabim tjetër i autorëve tanë është po ashtu edhe ai në fq. 173: duke folur për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, sërish bëjnë gabim fatal elementar sepse i fusin në kategorinë e "ligjvënësit negativ" vendimet e kësaj gjykate në ras-

tet **B. Pacolli** dhe **F. Sejdiu**, në rastin e imunitetit të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe, siç e thonë, në disa raste të tjera, pa e thënë se cilat janë ato. Këto gabime janë krejt normale nëse kihet parasysh vetë titulli i këtij seksioni, ku akoma autorët vazhdojnë me dilemat e tyre absurde lidhur me dallimin mes amendamentimit dhe rishikimit kushtetues. Ky gabim i reflektuar në titull të këtij seksioni reflektohet që në fjalinë e parë të paragrafit të parë me të cilën nis ky seksion, ku autorët tanë theksojnë si vijon:

> Në ditët e sotme një rol tepër të madh në ndryshimin e kushtetutës është duke luajtur edhe Gjykata Kushtetuese përmes dy aspekteve kryesore. E para përmes kontrolli të amendamenteve kushtetuese dhe e dyta përmes interpretimit përfundimtar të kushtetutës. Aspekti i dytë është mjaft i rëndësishëm, pasi i jep mundësi Gjykatës Kushtetuese, si organ kompetent për interpretimin e kushtetutës që të shkojë përtej shkronjës së kushtetutës dhe të depërtojë në frymën dhe shpirtin e kushtetutës, ose thënë më ndryshe përtej normës kushtetuese.

Ky konstatim absurd domosdo na detyron që të ripërsërisim ato që kemi thënë në kapitullin e tretë të pjesës së parë, pjesa e analizës sonë për tekstin që ka të bëjë me fusnotën nr. 228, ku kemi folur për rastet **B. Pacolli** e **F. Sejdiu** si dhe për rastin **e imunitetit të funksionarëve të lartë shtetërorë në Kosovë**. Aty patëm theksuar edhe mosnjohje themelore nga ana e autorëve mes kontrollit dhe interpretimit kushtetues. Kjo sepse, këtu në këtë seksion, autorët tanë i bëjnë të njëjta gabime dhe lexuesi ynë ka nevojë të shoh sërish si dhe ku gabohet nga autorët tanë, përkatësisht gabimin e tyre të futjes në kategorinë e normës abstrakte të vendimeve të marra nga Gjykata Kushtetuese në rastin **Sejdiu** dhe **Pacolli.** Vendimi për imunitete ka qenë interpretim abstrakt, por i normës kushtetuese dhe jo i ligjit apo normës ligjore në kuptim të vlerësimit të përputhshmërisë së saj me Kushtetutën e Kosovës. Në këtë rast, me fjalë të tjera, nuk ka qenë objekt kontrolli kushtetues vlerësimi i përputhshmërisë me Kushtetutën e Kosovës të normave ligjore, por interpretimi i vetë normës kushtetuese që normon imunitetin kushtetues të funksionarëve të lartë shtetërorë në vend, duke përdorur në të njëjtën kohë si parametër të kontrollit normat dhe parimet e tjera kushtetuese kosovare si dhe përvojat kushtetuese krahasuese. Vendimet në rastin **B. Pacolli** e **F. Sejdiu**, ndërkaq, nuk kanë qenë vendime lidhur me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normave juridike dhe, për pasojë, Gjykata nuk ka pasur asnjë mundësi për të luajtur rolin e ligjvënësit, as negativ e as pozitiv: ky rol i Gjykatës mund të luhet dhe duhet të luhet vetëm në rastet e interpretimit abstrakt të kushte-

tutshmërisë së normave juridike, asnjëherë ne rastin e kontrollit të kushtetutshmërisë së një vendimi individual të një organi shtetëror apo publik. Vendimi i Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e **B. Pacollit** në pozitën e Presidentit të Republikës ka qenë vendim individual që e merr ky organ në vijim të zbatimit konkret të kompetencave të veta kushtetuese, pra nuk është aktivitet legjislativ. I tillë është edhe vendimi i ish-Presidentit **F. Sejdiu**: objekt kontrolli kushtetues kanë qenë sjelljet e tij dhe mospajtimi i tyre me Kushtetutën, pra jo kontrolli abstrakt i një norme juridike.

Nga tërë kjo si më sipër, si dhe nga vendimet e sipërcekura të analizuara, qartë shihet se autorët tanë nuk e kanë të qartë se **Kushtetuta e Kosovës** nuk bën dallim mes interpretimit kushtetues (***constitutional interpretation***) dhe kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë (***judicial review***). Këtë nuk e bëjnë as kushtetutat tjera. Këtë dallim e bën praktika kushtetuese. Me interpretim kushtetues nënkuptohet procesi i ndërtimit apo krijimit të kuptimit dhe i sqarimit të kushtetutës nacionale (nëse ekziston si tekst i shkruar), i teksteve të tjera kushtetuese dhe i normave e parimeve të tjera të pashkruara që kanë veçori kushtetuese; kontrolli kushtetues apo kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë, ndërkaq, quhet procesi në të cilin vlerësohet nëse sjellja e një akteri kushtetues është në pajtim me kushtetutën, me tekstet e tjera apo parimet që kanë cilësi kushtetuese. Kështu thotë autori **Maartje de Visser** në fq. 2 të librit të tij të njohur ***Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*** (Hart Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2015). Në këtë kuptim, interpretim kushtetues paraqet vetëm atë operacion mendor që kryhet si interpretim abstrakt nga neni 113 i Kushtetutës, paragrafët si vijon: 2 (pikat 1 e 2), 3 (pika 4), 4, 5, 8 dhe 9. Juridiksioni shtesë nga paragrafi 10 i nenit 113 të Kushtetutës nuk ka asnjë mundësi që të jetë juridiksion i kontrollit abstrakt të një norme të përgjithshme juridike sepse një situatë e tillë do të binte ndesh me vetë fizionominë e gjyqësisë kushtetuese të tipit **evropian/kelsenian**, ku juridiksioni i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme nënkupton në rend të parë autorizimin e gjykatës kushtetuese për shfuqizim/anulimin e normës së përgjithshme apo të dispozitave të caktuara të saj (**gjykata si ligjvënës negativ**). Pa këtë nuk ka gjyqësi kushtetues të tipit **evropian/kelsenian**. Kohëve të fundit, brenda këtij modeli gjykatat kushtetuese kanë marrë (uzurpuar) funksione të theksuara të **ligjvënësit pozitiv**. Kjo nuk ndryshon asgjë në këtë që thamë më sipër: gjërat do të ishin krejt ndryshe sikur gjykatat kushtetuese të tipit **evropian/kelsenian** të mos kishin për detyrë të tyre primare shfuqizimin/anulimin e ligjeve dhe normave të tjera

të përgjithshme (**gjykata si ligjvënës negativ**), krahas kompetencave të tjera. Cilësimi i gjykatave kushtetuese si "ligjvënës negativ" përbën cilësinë dalluese të gjykatave kushtetuese nga çdo juridiksion tjetër. E tillë ka lindur kjo cilësi me **Hans Kelsen**, e tillë do të ngelet për jetë dhe mote për sa të ekzistojnë vetë gjykatat kushtetuese. Autorët tanë mund ta konstatojnë këtë fare lehtë nëse lexojnë me kujdes shkrimet themeltare të konceptit "ligjvënës negativ", të shkruara nga **Hans Kelsen** gati një shekull më parë, dhe atë si vijon: Hans Kelsen, "La garantie juridictionnelle de la Constitution (La Justice constitutionnelle)", botuar në *Revue du droit public et de la science politique en France et à l'étranger* (avril-juin 1928, fq. 197-257); dhe Hans Kelsen, "Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution", botuar në *The Journal of Politics* (vol. 4, no. 2, May 1942, fq. 183-200).

Para se të mbyllim kritikën tonë për këtë kapitull, duhet të themi disa fjalë për një rast të cilin e citojnë në fq. 171, që ka të bëjë me një vendim të **Gjykatës Kushtetuese të Çekisë**. Këtë e bëjmë për dy arsye: e para, sepse ky rast asnjë relevancë nuk e ka për seksionin lidhur me ndryshimin e kushtetutës; më shumë relevancë do të kishte sikur të trajtohej në pjesën që flet për sundimin e ligjit dhe përbërësit e tij; dhe, e dyta, sepse paraqet një rast tërësisht të ngjashëm të vendosur nga **Gjykata Kushtetuese e Kosovës**, i njohur si rasti **Jahjaga** (Aktgjykimi KO 29/12 & 48/12, paragrafët 247-271). Autorit të këtyre rreshtave i është dashur ta lexojë dy herë rresht pjesën e autorëve në fq. 171 që bën fjalë për rastin çek, për ta kuptuar se për çfarë bëhet fjalë. Ashtu siç citohet nga autorët tanë, narrativi rreth vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Çekisë në tërësi është i pakuptueshëm, gjë që do ta vërejë çdo lexues i vëmendshëm. Kjo rrethanë përbën një arsye shtesë për nevojë e një sqarimi tjetër fare për lexuesin tonë. Esenca e vendimit është kjo: politikanët çekë, duke dashur që të mos shkojnë në zgjedhje të parakohshme sipas procedurës ekzistuese, e cila ishte shumë e komplikuar, patën nxjerrë një ligj kushtetues me të cilin ua shkurtuan mandatet kushtetuese deputetëve të Parlamentit të Çekisë dhe thjeshtëzuan procedurën e zgjedhjeve të parakohshme; kjo u bë me një ligj kushtetues ***ad hoc***, që shkurtonte mandatet vetëm për legjislaturën në detyrë në vitin 2009, njëjtë si në vitin 1998. Gjykata Kushtetuese e Çekisë, megjithatë, këtë herë e shpalli këtë ligj, me të cilin shkurtoheshin mandatet kushtetuese të deputetëve në vitin 2009, jokushtetues dhe atë për tri arsye: e para, sepse ligji ishte një vendim individual, pra jo një akt i përgjithshëm kushtetues ashtu siç parashihet ndryshimi i lejueshëm i **Kushtetutës së Çekisë**;

thënë ndryshe, nëse politikanët çekë vërtetë dëshironin ta ndryshonin kushtetutën çeke për të lejuar zgjedhjet e parakohshme, atëherë atë duhej ta bënin duke nxjerrë një ligj permanent kushtetues që rregullon zgjedhjet e parakohshme dhe parashikon mekanizmin e vetë-shpërndarjes së Parlamentit, jo përmes nxjerrjes së ligjeve kushtetuese ***ad hoc*** që velnin retroaktivisht dhe vetëm për një rast konkret të lindur aty për aty; e dyta, ligji kushtetues në fjalë kishte vepruar në mënyrë retroaktive, pra prodhonte efekte për krejt legjislaturën që nga krijimi i saj në vitin 2006, duke prishur të drejtat e fituara. Këto arsye kishin qenë të mjaftueshme për **Gjykatën Kushtetuese të Çekisë** për ta shpallur ligjin si jokushtetues sepse cenonte dy përbërësit kryesorë të parimit kushtetues mbi sundimin e ligjit: i pari është se çdo ligj, përfshirë ligjin kushtetues ***ad hoc*** për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme që ka qenë objekt i kontrollit kushtetues, duhet të përmbajë norma të përgjithshme dhe jo të ketë natyrë të normës konkrete që vlen vetëm për një rast të caktuar; dhe, e dyta, se ligji dhe norma e përgjithshme nuk duhet të kenë natyrë retroaktive (me përjashtim të rasteve të caktuara paraprakisht me kushtetutë). Në këtë kuptim, ky vendim i gjason në tërësi vendimit të **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës** në rastin **Jahjaga**, ku Gjykata nuk lejoi ndërprerjen para kohe të mandatit kushtetuese, pikërisht duke u bazuar në elementet kushtetuese që përbëjnë parimin e sundimit të ligjit në një vend. Si rasti çek, ashtu dhe rasti **Jahjaga**, megjithatë, nuk kanë ndonjë relevancë për seksionin rreth procesit të ndryshimit kushtetues, qoftë atij që kryhet me amendament apo përmes rishikimit rrënjësor.

KAPITULLI VII.
KUSHTETUTSHMËRIA, LIGJSHMËRIA DHE KONTROLLI KUSHTETUES
(FQ. 175–185)

Përgjithësisht

Ky kapitull ka gjithsej pesë seksione, të cilat nuk janë ndarë në nënseksione si në dy kapitujt pararendës. Nëse do t'i bënin një krahasim me kapitujt pararendës, ky kapitull ka disa cilësi të tjera: në rend të parë, narrativi i tij është më i paqarti nga të gjithë kapitujt e diskutuar; në rend të dytë, kjo paqartësi ka pasur për pasojë nxjerrjen nga ana e autorëve të konstati-

meve të gabuara në aspektin profesional dhe trajtimin jo të saktë të institutit të kontrollit gjyqësor dhe të institucionit të gjyqësisë kushtetuese si aktivitet i pavarur shtetëror i vendosur nga kushtetuta. Këto kanë qenë arsyet pse në këtë pjesë paraqiten më gjerësisht pikëpamjet e sakta lidhur më institutin i kontrollit kushtetues, lindjen, kuptimin dhe llojet e tij, si dhe kontekstin historik të lindjes së institucionit të gjyqësisë kushtetuese.

Manipulimi i literaturës ka vazhduar në këtë kapitull me të njëjtin intensitet si në kapitujt e tjerë. Këtu e kemi fjalën për literaturën e huaj, në ndërkohë që për literaturën vendore hulumtimi i korrektësisë së citimeve ka konsistuar në gjetjen e burimit origjinal nga ku autorët tanë kanë marrë tekstin dhe idenë për ndërtimin e narrativit të tyre. Për t'i ikur burimeve origjinale, autorët janë munduar të ndërtojnë një narrativ që nuk i shpërfaq tezat e burimit origjinal. Kjo bën që te lexuesi të krijohet një konfuzitet: në fund të leximit të këtyre seksioneve, që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë si dhe me mekanizmat për mbrojtjen e tyre, sado të vëmendshëm që mund të jenë, studenti dhe lexuesi asnjëherë nuk do të arrijnë të kuptojnë esencën e temave të sipërcekura të shtruara nga autorët tanë për diskutim.

Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, përkatësisht trajtimi i materies së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë si kapitull i veçantë në një tekst universitar mbi të drejtën kushtetuese i takon kryesisht universit akademik ish-jugosllav dhe nuk gjendet nëpër tekstet universitare të vendeve të tjera evropiane, përfshirë Shqipërinë. Ai në veçanti nuk gjendet në ish-vendet komuniste që kanë qenë nën ndikimin sovjetik. Në këto të fundit, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria si parime dhe praktika trajtohen nëpër pjesë të ndryshme të së drejtës kushtetuese, kryesisht në pjesën që ka të bëjë me sundimin e ligjit (në kuptimin e gjerë të dhe të ngushtë të fjalës). Deri te ky konstatim apodiktik mund të vihet edhe përmes hulumtimit të teksteve kryesore të së drejtës kushtetuese nga territori ish-jugosllav. Këtë kemi bërë edhe ne. Nga tekstet e autorëve ish-jugosllavë kemi vërejtur se materia në këtë kapitull që përbën objekt analize këtu dhe që ka të bëjë me trajtimin e parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, kuptimin, lindjen dhe zhvillimin e tij, kryesisht i takon librave si vijon: **Jovan Gjorgjeviq**, ***E drejta kushtetuese*** (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë 1972); **Kurtesh Saliu**, ***E drejta kushtetuese*** (Fakulteti Juridik i UP: Prishtinë, 2004); **Dimitrije Kulić**, ***Ustavno sudstvo u svetu*** (Naša reć: Leskovac, 1972); Dimitrije Kulić, "Constitutionality and Constitutional Justice", 22 *Collection Papers Faculty of Law Niš* 45 (1982)

54-61; Dimitrije Kulic, "Kontrola ustavnosti zakona u funkciji nadležnosti jugoslovenskih Ustavnih sudova", 23 *Collection Papers Faculty of Law Niš* 43 (1983).

Në vendet e demokracive tradicionale, si **Italia** dhe **Gjermania**, si dhe në vendet e tjera që i takojnë modelit evropian, përfshirë modelin e përzier të gjyqësisë kushtetuese (për këtë flasim në vijim), tekste universitare mbi të drejtën kushtetuese nuk kanë kapituj të veçantë mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Përjashtim nga kjo bën **Franca**, gjë që shpjegohet me traditën e gjatë të zhvillimit të parimit të kushtetutshmërisë, përkatësisht të traditës së kushtetutës së shkruar si mënyrë për juridifikimin e pushtetit politik dhe garantimin e rolit të individit në shoqëri. Në veçanti pas vitit 1970, në **Francë** ka filluar të zhvillohet një traditë e fortë e trajtimit të parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në kapituj të veçantë nëpër tekste universitare, si pasojë e fuqizimit të diskursit mbi të drejtat e liritë e njeriut në jurisprudencën e Këshillit Kushtetues Francez. Lexuesi ynë do të përfitojë nga konsultimi i librit lider mbi të drejtën kushtetuese franceze, i grupit të autorëve me në krye **Louis Favoreu** (Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian, et al., ***Droit constitutionnel***, 19[e] éd. (Dalloz: Paris, 2017, fq. 127-149).

Sistemi juridik ish-jugosllav, në sferën e së drejtës publike dhe administratës, tradicionalisht ka qenë i ndikuar nga sistemi francez. Kjo rrethanë mbase shpjegon se përse autorët ish-jugosllavë akoma ruajnë diskursin mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë nëpër tekstet universitare. Kjo përfshin edhe zgjidhjet kushtetuese të disa prej vendeve ish-jugosllave, kushtetutat e të cilave përmbajnë dispozita dhe kapituj të veçantë mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. I tillë është rasti, ta zëmë, me kushtetutat e **Sllovenisë** (1991), **Serbisë** (2006), **Malit të Zi** (2007) etj. Ky nuk është rasti me vendet gjermanishtfolëse dhe Italinë. Ekzistimi i këtyre kapitujve kushtetues mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, megjithatë, nuk duhet kuptuar se në këto vende dhe në vendet ku kushtetutat përmbajnë kapituj të tillë parimi i ligjshmërisë i konkurron atij të kushtetutshmërisë: parimi i ligjshmërisë në këto vende absorbohet në atë të kushtetutshmërisë si pasojë e parimit të prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kjo, në të njëjtën kohë, nënkupton se nuk mund të prezumohet kushtetutshmëria e akteve të tjera të përgjithshme dhe, në veçanti, e akteve individuale të nxjerra në vijim të zbatimit të një norme kushtetuese apo ligjore. Ky është standardi në shumicën e vendeve të botës demokratike, përfshirë Kosovën. Kushtetuta nuk përmban në mënyrë shprehimore një kapitull

mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, por nënkuptohet se kushtetuta është në qendër të rendit juridik dhe parimi i ligjshmërisë absorbohet në parimin e kushtetutshmërisë si pasojë e mbizotërimit të parimit të prezumimit të kushtetutshmërisë së çdo ligji (kuptimi material i kushtetutshmërisë).

Të shohim si duket kjo të autorët tanë në seksionet e këtij kapitulli.

Analiza kritike

Në seksionin e parë me titull "**Kuptimi i kushtetutshmërisë**" (fq. 175-176), autorët tanë mëtojnë të japin një definicion të këtij kuptimi kaq me rëndësi për të drejtën kushtetuese kontinentale. Duke provuar të definojnë tri kuptimet themelore dhe standarde të kushtetutshmërisë, të kryera nga autorët **J. Gjorgjeviq** dhe **K. Saliu**, të cilët nuk citohen fare, autorët tanë ripërsërisin në mënyrë të pakuptueshme dhe përçartë gjërat që definohen në mënyrë të qartë tek autorët e sipërcekur dhe te të gjithë autorët e tjerë të proveniencës ish-jugosllave. Nga tërë ky seksion, lexuesit mund të kuptojnë vetëm një gjë: parimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, të cilin autorët e ripërsërisin tërë kohën në dy faqet e këtij seksioni. Ky segment i kushtetutshmërisë, megjithatë, përbën vetëm një prej segmenteve të shumta që duhen ditur për të kuptuar mirë kushtetutshmërinë. Duke cituar **Sllovenině** si shembull unik, autorët theksojnë edhe këtë: "Në mënyrë që parimi i kushtetutshmërisë të jetësohet disa kushtetuta të njëjtin e kanë përfshirë edhe në përmbajtjen e tyre. Një rast i tillë është kushtetuta e Sllovenisë sipas së cilës ligjet, normat ligjore dhe aktet e tjera të përgjithshme duhet të jenë gjithnjë në pajtim me kushtetutën". Autorët tanë e kanë gabim sepse të shumta janë kushtetutat që e thonë një gjë të tillë si kjo e **Sllovenisë**. Në këtë grup hyjnë kushtetutat e **Serbisë**, **Malit të Zi**, por edhe **Kushtetuta e Shqipërisë** (1998) dhe shumë kushtetuta të tjera të vendeve demokratike.

Në librat e autorëve ish-jugosllavë, kushtetutshmëria përcaktohet sipas disa kuptimeve, siç janë:

- kuptimi pozitiv juridik, në të cilin hyjnë aspekti formal dhe material i kushtetutshmërisë (ligji dhe aktet e tjera duhet të jenë si në formë ashtu dhe në përmbajtje në pajtim me kushtetutën);
- kuptimi politik, që nënkupton se kushtetuta fut nën kornizë juridike pushtetin politik dhe nuk lejon krijimin e formave të reja të pushtetit faktik, arbitraritetit dhe absolutizmit; dhe, së fundi,

- kuptimi politiko-juridik, që ngërthen të dyja, përkatësisht që rendi juridik ka në qendër kushtetutën, çdo akt harmonizohet me të, origjina dhe ushtrimi i pushtetit kanë rrënjë dhe burim kushtetues, kurse rolin pozita e individit në sistem është e siguruar dhe e garantuar përmes mekanizimit të mbrojtjes dhe promovimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Të tri këto kuptime kanë përbërësit dhe konceptet e veta, të cilat autorët provojnë t'i shtjellojnë në seksionin me titull "**Elementet e kushtetutshmërisë**" (fq. 176). Pas kësaj kalojnë në definimin e parimit të ligjshmërisë. Mirëpo, para se ne të flasim më shumë për këtë, le t'i themi nja dy a tri fjalë shkurt rreth interpretimit të gabuar të përbërësve të kushtetutshmërisë. Në pikat 6, 9 & 10 autorët kanë shkruar disa konstatime që nuk qëndrojnë. Në lidhje me konstatimin nga pika 6 se të drejtat mund të kufizohen me kushtetutë dhe ligj, konstatimi nuk është i qartë sepse ato mund të kufizohen me kushtetutë dhe ligj nën rrethana të caktuara dhe sipas një procedure të përcaktuar me kushtetutë. Ky standard parashikohet edhe në Kushtetutën e Kosovës në nenin 55 ["Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore"], siç bëhet edhe në të gjitha kushtetutat evropiane dhe vendeve të tjera demokratike. Përcaktimi i kufizimit me ligj të lirive dhe të drejtave kushtetuese përbën vetëm njërin prej kritereve për kufizim të cilat i përcakton kushtetuta. Kufizimet duhet të jenë të domosdoshme në një shoqëri demokratike për arritjen e një qëllimi legjitim dhe asnjëherë nuk mund të prekin esencën e lirisë apo të drejtës së garantuar kushtetuese. Kjo njihet ndryshe si **parimi i proporcionalitetit**, i cili i ka rrënjët në jurisprudencën gjermane dhe zbatohet jashtëzakonisht shumë në praktikën e gjykatave kushtetuese evropiane dhe në vendet e tjera demokratike që kanë sistem të koncentruar të gjyqësisë kushtetuese. Në SHBA nuk ekziston një koncept i tillë. Atje përdoren koncepte e parime të tjera, siç është ***doctrine of necessity***, për të përshkruar këtë element përbërës të parimit të kushtetutshmërisë që ka rëndësi të madhe; lidhur me pikën 9, ku thuhet se çdo qytetar ka të drejtë të marrë nismën për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, kjo nuk është e vërtetë aspak: një sistem i tillë i qytetarëve vëzhgues (vigjilentë) ka ekzistuar në ish-Jugosllavi dhe në sistemin kushtetues jugosllav dhe i takon të kaluarës. Kjo fjali është bartur në tërësi nga shkrimet e autorëve të asaj kohe dhe nuk ka asnjë kuptim dhe asnjë vlerë në një shoqëri demokratike që synohet nga kushtetuta dhe ligji (sic!); në fund, në pikën 10, autorët konstatojnë në mënyrë apodiktike se mbrojtja e kushtetutshmërisë u takon gjykatave kushtetuese

dhe organeve të tjera. Edhe kjo nuk qëndron sepse përveç gjykatave kushtetuese, ka edhe gjykata të rregullta që kryejnë këtë funksion. Për më tepër, ekzistojnë organe të tjera që fare nuk janë gjyqësore, por kanë natyre politike dhe mbrojnë kushtetutshmërinë e një vendi (siç është rasti i Finlandës dhe i vendeve skandinave, Kanadasë dhe vendeve të tjera ku kushtetutshmëria mbrohet me mekanizma më specifikë dhe vetëm në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, jo në sferën e organizimit të pushtetit politik). Për të dëshmuar këtë që thamë lidhur me pikën nën nr. 9 si më sipër, lexuesin e udhëzojmë që të konsultojë shkrimet e autorëve të sipërcekur ish-jugosllavë: aty mund t'i gjejnë pikëpamjet e njëjta me këtë si më sipër të shprehura nga ana e autorëve tanë, por të cilat tani nuk kanë më asnjë vlerë apo relevancë kushtetuese dhe doktrinare për këtë kapitull.

Parimi i ligjshmërisë, ndërkaq, definohet në mënyrë më të qartë (cf. Seksioni "Parimi i ligjshmërisë", fq. 176-179). Kjo sepse autorët nuk i përsërisin gjërat e njëjta, siç bëjnë te përpjekja e tyre për definimin e parimit të kushtetutshmërisë. Duhet të shënojmë se kuptimi i a.q. i ligjshmërisë si proces lë shumë për të dëshiruar. Lexuesit tonë duhet t'i bëjmë me dije se ky kuptim, i dhënë në paragrafin e dytë të fq. 177, ka të bëjë me kuptimin material të ligjshmërisë, sipas të cilit çdo akt më i ulët se ligji në brendinë (substancën) e vet duhet vërtet të jetë në pajtim me ligjin. Për dallim nga parimi i kushtetutshmërisë ku në fokus të rendit juridik është kushtetuta, të parimi i ligjshmërisë qendër e fokusit është ligji. Në literaturën franceze këto sisteme quhen sistemet "legjicentrike" ("legecentrisme") (**Louis Favoreu** et al., vep. e cit. fq. 128.129). Këtu pra, flitet për shtete të caktuara në të cilat ligji është në qendër të sistemit juridik, jo kushtetuta. Në këto vende bën pjesë Britania e Madhe dhe disa nga ish-kolonitë e saj (Australia, Kanadaja, Zelanda e Re etj.) dhe nuk duhet të ngatërrohen me vendet ku kushtetutat nacionale përmbajnë kapitujt mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në të njëjtin vend. Kjo është një çështje tjetër, në këto vende dhe në vendet ku ka një kushtetutë të shkruar, parimi i ligjshmërisë absorbohet nga parimi i kushtetutshmërisë, si pasojë e prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Në këto raste, prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve përfshin si kuptimin formal (procedura e ndjekur për formimin e ligjit) ashtu dhe në atë material (substanca apo materia që rregullohet me ligj duhet të jetë substancë apo materie ligjore).

Në vijim si më sipër, thënë me fjalë të tjera, lidhur me epërsinë e normave juridike dallohen dy sisteme: i pari, që është në shumicë në botën liberale demokratike, përfshin vendet ku epërsia e kushtetutës është

absolute dhe arsyetohet me cilësinë sipërore të normave të saj; i dyti sistem, ndërkaq, përfshin vendet që nuk njohin fare parimin e kushtetutshmërisë, si p.sh. Britania e Madhe dhe një pjesë e ish-kolonive të saj që nuk kanë kushtetutë të kodifikuar në një tekst të vetëm (Australia, Kanadaja, Zelanda e Re etj.). Për këto vende flet autori i huaj në fusnotën nr. 566, **Dan Meagher**, të cilin autorët tanë jo vetëm që manipulojnë, por as idenë më të vogël nuk e kanë se çfarë ka thënë. E kemi fjalën për shkrimin "The Principle of Legality as Clear Statement Rule: Significance and Problems" (*Sydney Law Review*, vol. 36, no. 3, September 2014, fq. 413-443), të autorit **Dan Meagher**. Në këtë shkrim, autori bën fjalë për marrëdhënien e parimit të legalitetit, si manifestim i supremacisë (epërsisë) së parlamentit në jurisprudencën australiane, me të drejtën e përgjithshme (***common law***) në rastet kur ligji rregullon të njëjtën materie. Marrëdhënia që diskutohet këtu ka të bëjë me parimin e legalitetit i kuptuar si rregulli mbi qartësinë e deklarimit të normës ligjore (***clear-statement rule***) në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe relacionin e këtij rregulli me të drejtën e përgjithshme (***common law***): çfarë ndodhë kur ligji rregullon liritë dhe të drejtat e njëjta, si p.sh. lirinë e shprehjes, pronën, lirinë e lëvizjes etj., të cilat në të njëjtën kohë janë objekt rregullimi i të drejtës së përgjithshme (***common law***)? Kjo e fundit, sikundër dihet, ka epërsi ndaj ligjeve të parlamentit. Autori konstaton se janë gjykatat ato që duhet të japin një përgjigje në këtë pyetje: ato çdoherë duhet të interpretojnë rastet që rregullohen me ligj duke u nisur nga rregulla se ligjvënësi nuk ka pasur për qëllim kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe, për pasojë, të ndjekin interpretimin e vjetër me rrënjë në të drejtën e përgjithshme (***common law***).

Sikundër shihet, nuk bëhet fjalë për parimin e legalitetit si parim që promovon demokracinë, por për zgjidhjen e raportit mes ligjit dhe të drejtës së përgjithshme (***common law***) në sferën e lirive dhe të drejtave njerëzore që janë objekt i rregullimit të dy burimeve të së drejtës, burimeve ligjore dhe burimeve joligjore (të pashkruara) nga e drejta e përgjithshme (***common law***). Se kjo është kështu, lexuesi fare lehtë mund ta konstatojë nëse lexon shkrimet e tjera nga i njëjti autor. Të gjitha ato kanë të njëjtin objekt studimi dhe fare nuk kanë të bëjnë me diskutimin e parimit të legalitetit në sensin kontinental, diçka që besojnë autorët tanë në mënyrë krejt të gabuar (cf. Dan Meagher, "The Principle of Legality and *Contemporanea Exposition est Optima et Fortissima in Lege*", *Statute Law Review* vol. 38, issue 1, 1 February 2017, fq. 98-115; Dan Meagher, "The

Principle of Legality and a Common Law Billof Rights—Clear Statement Rules Head Down Under". *Brooklyn Journal of International Law*, vol. 42, issue 1, 2016, fq. 65-127; Dan Meagher, "The Common Law Principle of Legality", *Alternative Law Journal*, vol. 38, no. 4, 2013, fq. 209-213; Dan Meagher, "The Common Law Principle of Legality in the Age of Rights", *Melbourne University Law Review*, vol. 35, 2011, fq. 449-477). Thënë me fjalë të tjera, parimi i legalitetit në sistemin e së drejtës së përgjithshme (***common law***) ka kuptimin e rregullatorit të rendit juridik në kuptim që prezumohet se ligjvënësi çdoherë ka dashur të mbrojë dhe garantojë liritë dhe të drejtat njerëzore të parashikuara me të drejtën e përgjithshme (***common law***). Kjo detyrë e interpretimit u takon gjykatave, të cilat, konform këtij parimi (që ka si ekuivalent shprehjen amerikane ***clear-statement rule***) çdoherë duhet ta interpretojnë ligjin ashtu që shkon në favor të vërtetimit të standardeve të së drejtës së përgjithshme (***common law***) për garantimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Sikundër shihet, çdoherë flitet për sferën e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe rolin e parimit të legalitetit si mbrojtës dhe garantues i standardeve të vjetra të së drejtës së përgjithshme (***common law***) në sferën e mbrojtjes dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të njeriut (liria e shprehjes, prona etj.). Nëse ky nuk është rasti, sipas doktrinës së parimit të legalitetit i kuptuar si ***clear-statement rule*** gjykatat kanë autorizim për të injoruar zbatimin e ligjit dhe për të vërtetuar praktikën e së drejtës së përgjithshme (***common law***). Kjo është në kundërshtim të tërësishëm me atë që thonë autorët tanë, të cilët qartë shihet se nuk i kuptojnë sistemet juridike ku kushtetuta është në qendër të rendit juridik nga ato që kanë ligjin në qendër të këtij rendi, si dhe rolin dhe funksionin që kryen ligji nëpër këto sisteme.

Si pasojë e ngatërrimit të parimit të ligjshmërisë në sistemin britanik dhe vendet që modelohen sipas tij, autorët tanë në fq.177-179 ngatërrojnë parimet themelore kushtetuese me parimin e ligjshmërisë. Në pikën nën nr. 2 mendojnë se parimi i epërsisë së ligjeve federative përbën një pjesë përbërëse e parimit të ligjshmërisë, në ndërkohë që bëhet fjalë për një parim kushtetues, përkatësisht për parimin e hierarkisë së normave juridike ku norma kushtetuese gjenden në piramidën e normave juridike. Ky parim vlen në çdo federatë, zaten, parimi federal, garantimi dhe ruajtja e tij kanë qenë ndër arsyet kryesore të krijimit të institucionit të gjyqësisë kushtetuese. Këtë do ta shohim në vijim; në pikën nën 7, autorët thonë se përdorimi i gjuhës amtare hyn në parimin e ligjshmërisë, në ndërkohë që kjo është një parim dhe e drejtë kushtetuese; në mënyrë të njëjtë gabojnë

kur nën pikën 8 e fusin në parimin e legalitetit të drejtën dhe parimin e njohur kushtetues për përdorim të mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave individuale e kolektive; dhe, në fund, në vijim të këtyre gabimeve themelore hyn edhe gabimi nën pikën 9, ku parimi i barazisë para ligjit ngatërrohet me parimin e legalitetit. Këtu, shtrohet pyetja themelore, cili ligj ngërthen dhe manifeston parimin e ligjshmërisë, ashtu siç e kuptojnë autorët tanë në pikët si më sipër të fq. 177-179? Kjo qasje është qasje e autorëve të ish-sistemit jugosllav dhe në përgjithësi në vendet ish-komuniste ku kushtetuta ka shërbyer si një tekst që ka përcaktuar dhe promovuar mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, por çdoherë ka ekzistuar një klauzolë kushtetuese që thoshte se "nëse ndryshe nuk përcaktohet me ligj" apo "siç përcaktohet me ligj". Kjo qasje e këtyre kushtetutave, e njohur si **ligjshmëria socialiste**, çdoherë rezultonte në praktikë në zhvlerësimin efektiv të garancive të proklamuara në kushtetutë. Këtë gjendje e shpjegojnë autorët e ndryshëm në mënyrë të shkëlqyeshme, ndër të cilët ne kemi veçuar në rend të parë doajenin e së drejtës kushtetuese italiane dhe mikun tim **Giuseppe de Vergottini**. Në librin e tij të fundit, ***Diritto costituzionale comparato*** (CEDAM: Padova, 2004), dhuruar me dedikim autorit të këtyre rreshtave, De Vergottini flet për lindjen dhe zhvillimin e së drejtës socialiste dhe ndikimin e saj në mbarë botën, si dhe rolin dhe pozitën e lirive dhe të drejtave të njeriut në sisteme kushtetuese ish-komuniste (Kapitujt dy dhe tre të pjesës së parë, si dhe në kapitulli i katërt të pjesës së katërt). Njëjtë me këtë veprojnë edhe të tjerët (cf. Paolo Carrozza, "Il diritto socialista" dhe Giuseppe F. Ferrari, "Le liberta e i diritti: categorie concettuali e strumenti", dyjat botuar në P. Carrozza, A. Di Giovine & G.F. Ferrari, eds., ***Diritto costituzionale comparato*** (Editori Laterza: Roma–Bari, 2009).

Kjo paqartësi si më sipër ka vazhduar edhe në seksionin e tretë me titull "Kontrolli kushtetues – kuptimi" (fq. 179-182): lexuesi nga ky titull me plot të drejtë do të pres të gjejë një definicion të plotë mbi atë se çka është kontrolli kushtetues. Këtë nuk do ta gjejë nga shkaku se autorët tanë, duke përdorur autorët e respektuar shqiptarë, **Sokol Sadushi** dhe librin e tij ***Drejtësia kushtetuese në zhvillim*** (bot. Toena: Tiranë, 2012) dhe **Kristaq Traja** dhe librin e tij ***Drejtësia Kushtetuese*** (bot. Luarasi: Tiranë, 2000) kanë konfonduar kuptime dhe institute që nuk ka njeri që mund t'i marrë vesh. Këtyre nocioneve dhe instituteve u kanë futur në mes nga një citim të autorëve të huaj, për ta bërë edhe më të pakuptueshëm kuptimin themelor të institutit të kontrollit kushtetues. Ajo që autorët e citojnë si

definicion të **Kristaq Trajës**, në fakt është definicion standard që gjendet të autorët francezë. Shprehja "kontroll kushtetues" shënon tërësinë e institucioneve dhe teknikave përmes së cilave sigurohet, pa asnjë kufizim, supremacia (epërsia) e kushtetutës (Louis Favoreu et al., vep. e cit. fq. 245.). Autorët shqiptarë si më sipër, që citohen në fusnotat 573-575 dhe 582-583, në mënyrë shumë shteruese dhe me kompetencë definojnë dhe sqarojnë kuptimin e kontrollit kushtetues, gjithnjë duke u bazuar në literaturë burimore. Literatura burimore, ndërkaq, bën dallim të qartë mes kontrollit kushtetues si institut dhe gjyqësisë kushtetuese si një institucion. Kjo e dyta, në fakt, përbën objekt definicioni. Fjalën e kemi për autorët burimor **Hans Kelsen** dhe **Charles Eisenmann,** respektivisht: i pari, me gjyqësi (drejtësi) kushtetuese nënkupton garantimin juridiksional të kushtetutës (Cf. Hans Kelsen, "La Justice constitutionnelle", botuar në *Revue du droit public et de la science politique en France et à l'étranger*, avril-juin 1928, fq. 197-257; dhe Hans Kelsen, "Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution", botuar në *The Journal of Politics*, vol. 4, no. 2, May 1942, fq.183-200), kurse për të dytin, gjyqësia (drejtësia) kushtetuese është ai lloj i drejtësisë apo i juridiksionit që ka të bëjë me të drejtën kushtetuese si degë pozitive. Nga ky definicion i thjeshtë, ky autor nxjerr dallimin mes "drejtësisë (gjyqësisë) kushtetuese" dhe "juridiksionit kushtetues": me të dytin nënkupton organin që ushtron drejtësinë (gjyqësinë) kushtetuese. Kuptimi juridik i drejtësisë (gjyqësisë) kushtetuese, gjithnjë sipas këtij autori, në instancë të fundit konsiston në garantimin e ndarjes së kompetencave mes ligjvënies së zakonshme dhe kushtetutë-vënies (Cituar sipas **Louis Favoreu**, vep. e cit. fq. 245-246). U mor vesh, ky definicion ka pësuar ndryshime sepse sot gjykatat kushtetuese apo organet e tjera të barasvlershme me to (gjykatat supreme apo gjykatat e larta) ushtrojnë juridiksione shumë të llojllojshme dhe më të ndryshme se këto, siç janë kontrolli kushtetues i partive politike, *impeachment*-i dhe ushtrimi i juridiksionit penal ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë dhe kështu me radhë.

Kushtetuta e shkruar është kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm siç thonë autorët, për ushtrimin e gjyqësisë (drejtësisë) kushtetuese. Deri këtu, siç shihet, në fusim në kllapa kuptimin e gjyqësisë kushtetuese, duke e shënuar si sinonim të nocionit të drejtësisë kushtetuese. Këtu e tutje e braktisim këtë rrugë sepse, në gjuhën shqipe, italiane, franceze, portugeze dhe në gjuhët me rrënjë latine këto dy nocione gjuhësore, në fakt, nuk kanë asnjë dallim. Këtë e ka sqaruar shumë bukur **Lucio Pegoraro** në

monografinë e tij ***Giustizia costituttionale comparata: Dai modelli ai sistemi*** (G. Giappichelli Editore: Torino 2015, fq. 3-12). Kjo, fundja, nuk ka rëndësi me këtë rast. Ajo çfarë ka rëndësi është që lexuesit tonë t'i sqarojmë më tutje gjenezën dhe kuptimin thelbësor të institutit të kontrollit kushtetues.

Sikundër u tha, kushtetuta e shkruar nuk është kusht i mjaftueshëm. Përveç kushtetutës, duhet të ekzistojë edhe një mekanizëm, një institucion që ka të garantuar me kushtetutë të drejtën për të ushtruar kontrollin kushtetues, përkatësisht për të siguruar dhe mbrojtur epërsinë (supremacinë) e kushtetutës. Kjo nënkupton se vetë kushtetuta duhet të përcaktojë në mënyrë shprehimore dhe të qartë një juridiksion të tillë për kontroll kushtetues. Kjo është sot kështu dhe vlen vetëm për vendet që kanë përqafuar modelin kontinental, i njohur edhe si modeli kelsenian apo evropian i kontrollit kushtetues. Në modelin e njohur si modeli amerikan, ndërkaq, ky nuk është rasti, as dje dhe as sot. Lindja e këtij modeli në SHBA në rastin ***Marbury v. Madison*** (1803) ka ndodhur jashtë kontekstit të kushtetutës së shkruar, përkatësisht ka qenë rezultat ekskluziv i praktikës gjyqësore amerikane të rrënjosur me rastin e sipërcekur ***Marbury v. Madison***. Autorët tanë gabimisht mendojnë se ky rast ka lindur dhe gjendet i autorizuar sipas nenit III (paragrafët 1 dhe 2) të **Kushtetutës së SHBA**-së (1787). Kjo thuhet nga ta në fq. 180 (fusn. 579) dhe është gabim që buron nga mosnjohja e thellë e tyre të historisë së lindjes së kontrollit kushtetues në përgjithësi, duke besuar se ky rast përbën rastin e parë në histori që gjykatat kanë ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë. Rasti i parë, në fakt, ka ndodhur, paradoksalisht, në Angli në rastin e njohur si rasti ***Dr. Bonham*** (1603) dhe sqarohet shumë bukur në librin e **Sokol Sadushit** (cf. Sokol Sadushi, vep. e cituar, fq. 73-74). Para se të sqarojmë për lexuesin esencën e lindjes së rastit ***Marbury v. Madison***, duhet t'i themi dy a tri fjalë për modelin amerikan ashtu siç ai është sot, si dhe për rastin ***Dr. Bonham***.

Modeli amerikan nuk bazohet në kushtetutë, siç mendojnë autorët tanë, por në praktikë gjyqësore. Ka qenë praktika gjyqësore ajo që ka lindur kontrollin gjyqësor amerikan, jo kushtetuta. Kështu ka lindur, ta zëmë, edhe në rastin e Izraelit (rasti ***United Mizrahi Bank Ltd. v. Migdal Village***, 49 (4) P.D. 221, 1995). Për më tepër, ka vende që kanë kushtetutë të shkruar, mirëpo nuk kanë juridiksion shprehimor kushtetues që autorizon kontrollin kushtetues: edhe këtu, si në Amerikë dhe Izrael, kontrolli kushtetues ka lindur nga praktika gjyqësore. Këto vende gjenden gjith-

andej nëpër botë: në Evropë (p.sh. Irlanda), Afrikë (si p.sh. Bocvana, Gambia), Amerikën Veriore (p.sh. Kanadaja), Azi (p.sh. India, Japonia), dhe kështu me radhë. Lexuesi mund të gjejë detaje të dobishme të kësaj në librin ***The Constitutional Review*** (Vandeplas Publishing: U.S.A., 2013), të autores sllovene **Arne Mavčič**. Ky libër paraqet burimin më të cituar në këtë lëmë.

Rasti ***Dr. Bonham***, ndërkaq, lidhet me ndryshimin e botëkuptimeve lidhur me burimin e së drejtës dhe rendin juridik në përgjithësi. Kjo periudhë koincidon me luftën e anglezëve për kontroll të pushtetit absolut mbretëror dhe lidhet më shekullin XVII, deri në vitin 1688 (**Revolucioni i Lavdishëm**). Ky ndryshim në botëkuptim lidhur me burimin e ligjit dhe rendit juridik në tërësi është reflektuar në mënyrën e vënies në jetë të këtij ndryshimi. Hierarkia e re e burimeve të së drejtës, të cilat më nuk kishin rrënjë hyjnore, si dhe e rendit të krijuar nga këto burime, domosdo që krijuan detyrime për gjyqtarët që me rastin e vënies në jetë të këtij rendi juridik me rrënjë johyjnore të bazoheshin në mekanizma të rinj institucionalë. Në mesin e këtyre mekanizmave ishte edhe interpretimi gjyqësor për të treguar se cili rend ishte suprem, më i larti nga dy rendet ekzistuese, rendit që bazohej në ligj dhe atij që buronte nga e drejta e përgjithshme (***common law***). Kjo qasje e ndryshuar vërehet në mënyrë të qartë nëse analizohet origjina e rastit ***Dr. Bonham***. Në këtë rast, **Sir Edward Coke** (1552-1634), si kryegjyqtar, mbrojti supremacinë (epërsinë) e rendit të bazuar në të drejtën e përgjithshme (***common law***). Ai e pa këtë rend si një rend që kishte cilësitë e ***jus naturale***, kundrejt ***jus positivum*** që mishërohej në ligjvënien e parlamentit anglez të kohës. **Dr. Bonham** ishte dënuar me ligj, jo sipas të drejtës së përgjithshme (***common law***). Duke e njohur epërsinë e ***jus naturale*** që mishërohej në të drejtën e përgjithshme (***common law***), **Sir Edward Coke** ia mohoi mbretit anglez supremacinë (epërsinë) në ligjvënie. Me këtë, në mënyrë efektive, kryegjyqtari anglez provoi që mbreti ishte sovran vetëm së bashku me parlamentin. Kjo nënkuptonte se rendi i ndërtuar përmes të drejtës së përgjithshme (***common law***) nuk mund të shfuqizohej përmes ***jus positivum***. Ky hap pati për qëllim kufizimin e pushtetit të mbretit, i cili në atë kohë kishte autoritet të plotë në ligjvënie. Në këtë kontest duhet të shikohet, asnjëherë jashtë tij, kufizimi që më vonë kulmoi në revolucion në vitin 1688, vit që përfundimisht rrënjosi supremacinë (epërsinë) e parlamentit, pa mbretin si ligjvënës. Thënë shkurt, si "e drejtë kushtetuese" në rastin ***Dr. Bonham*** (1610) u konsiderua ajo e drejtë që buronte nga natyra e shoqërisë angleze, e njo-

hur si ***common law*** (**e drejtë e përgjithshme**) (Cf. Raoul Berger, "Doctor Bonham's Case: Statutory Construction or Constitutional Theory?", *University of Pennsylvania Law Review*, vol. 117, no. 4, February 1969, fq. 521-545.)

T'i kthehemi tani rastit ***Marbury v. Madison*** dhe kontekstit historik të lindjes së tij jashtë autorizimit të Kushtetutës së SHBA-së. Tërë këtë e bëjmë për të dëshmuar se modeli amerikan ka lindur jashtë autorizimit kushtetues, njëjtë siç ka lindur dhe është riprodhuar më vonë në vendet e tjera në katër anët e botës. Me këtë, thënë ndryshe, duam t'i tregojmë lexuesit se krahas autorëve të tjerë nëpër botë edhe ky autor mendon fuqishëm se kushtetuta e shkruar nuk ka qenë dhe nuk është kusht i mjaftueshëm për lindjen e institucionit të gjyqësisë kushtetuese jashtë modelit amerikan. Kështu nuk mendojnë autorët tanë, të cilët besojnë se kontrolli kushtetues ka lindur si pasojë e drejtpërdrejtë e autorizimit kushtetues në rastin ***Marbury v. Madison***. Nxjerrja e kushtetutave të shkruara ka nxitur dhe përshpejtuar nevojën e krijimit të mekanizmit të veçantë institucional për vënien në jetë të garancive kushtetuese të përmbledhura në një tekst. Kjo ndodhi gati dy shekuj pas rastit ***Dr. Bonham***, kur u bë nxjerrja e teksteve të para kushtetuese, të kushtetutave të shkruara, të cilat qartë sanksionon një rend superior krahasuar me të tjerët. **Në luftën mes pushteteve qendrore për të ruajtur supremacinë (epërsinë) e një rendi të bazuar në kushtetutë kundrejt një tjetri rend që bazohej në ligje dhe burime të tjera ka lindur koncepti modern i gjyqësisë kushtetuese.** Kjo nisi në SHBA me rastin ***Marbury v. Madison*** dhe ka një sfond historik që shpjegon lindjen e kontrollit efektiv gjyqësor në këtë vend. Ai sfond historik ka të bëjë me kohën koloniale dhe botëkuptimet e kohës për natyrën juridike të së drejtës koloniale dhe dallimin e kësaj të drejte krahasuar me metropolin. Në këtu dëshmojmë, thënë me fjalë të tjera, se para rastit ***Marbury v. Madison***, këtij viti historik në gjyqësinë kushtetuese, qenë krijuar të gjitha parakushtet për lindjen e një mekanizmi modern për kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve. Krijimi i këtyre kushteve lidhet me sundimin kolonial i cili, në mënyrë paradoksale, në **Britaninë e Madhe** bazohej në supremacinë e ***common law*** (**e drejtë e përgjithshme**), kurse nëpër koloni vlente supremacia (epërsia) e rendit pozitiv kolonial, i cili bazohej në të a.q. ***charters***. Këto kishin statusin e aktit më të lartë juridik në një koloni ("kushtetutat" e kolonive). Rendi pozitiv kolonial i bazuar në ***charters*** ("kushtetutat" e kolonive) nuk guxonte të binte ndesh me të drejtën e përgjithshme (***common law***) që vlente në Britani. Kjo nënkuptonte se e drejtë

pozitive dhe rend pozitiv në kolonitë amerikane konsideroheshin ***charters*** (kushtetutat) e kolonive, të cilat duhej të ishin në pajtim me të drejtën e përgjithshme (***common law***) dhe rendin britanik kolonial. Kjo gjendje krijoi një situatë paradoksale, e cila, megjithatë, i bëri mirë teorisë dhe praktikës së kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve, e cila u konsolidua fuqishëm në rastin e sipërcekur të Gjykatës Supreme të SHBA-së. Ky rast përfundimisht sanksionoi epërsinë e tekstit nacional kushtetues, tekstin e Kushtetutës së SHBA-së, kundrejt çdo rendi tjetër që ekzistonte nëpër shtetet anëtare në ish-kolonitë britanike. E njëjta gjë, siç e pamë, nuk ndodhi në Britani me rastin **Dr. Bonham**. Kjo për arsye se në Britani nuk pati një tekst kushtetues koherent, të qartë dhe të saktë që do të mund të interpretohej lehtë nga një mekanizëm gjyqësor. Rendi i bazuar në ***common law*** (e drejtë e përgjithshme) ishte rend i trubullt, i paqartë dhe jo shumë i saktë, i cili ishte krijuar përgjatë shekujve mesjetar të zhvillimit të gjyqësisë angleze. Për këtë arsye as vetë **Sir Edward Coke** nuk pati për qëllim sigurimin e ndonjë supremacie (epërsie) të ***common law*** (e drejta e përgjithshme). Ai pati për qëllim, në rend të parë, mohimin e sundimit të mbretërve të dinastisë Tudor në Angli, të cilët cilësoheshin si ligjvënës përmes parlamentit anglez. Duke thënë se ***common law*** (e drejtë e përgjithshme) kishte epërsi ndaj ligjeve të parlamentit, **Sir Edward** mohoi aktivitetin ligjvënës të parlamentit për aq sa ai identifikohej dhe ishte një me pushtetin e monarkut të dinastisë **Tudor**. Kjo, megjithatë, në të njëjtën kohë nuk nënkuptonte mohimin e supremacisë së parlamentit anglez në kuadër të sistemit kushtetues, por mohimin vetëm të pushtetit ligjvënës monarkik që ushtrohej përmes institucionit të parlamentit. Pra, fjala ka qenë këtu për kufizimin e pushtetit mbretëror, e assesi për themelimin e një mekanizmi që do të bënte kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve angleze, përmes përdorimit të ***common law*** (e drejtë e përgjithshme) si diçka që kufizonte të drejtën e pushtetit absolut të mbretërve anglezë të dinastisë **Tudor**.

Sikundër shihet, sistemi anglo-sakson i të drejtës së përgjithshme (***common law***), në kolonitë amerikane pati një kuptim tjetër: kërkesa britanike që çdo ***charter*** apo kushtetutë e kolonive amerikane të jetë në pajtim me ligjvënësin britanik, i cili personifikohej me parlamentin dhe supremacinë e tij të fituar me mund përgjatë shekullit XVII në luftën e gjatë kundër monarkisë, në koloni u përkthye si supremaci (epërsi) e kushtetutave vendore kundrejt ligjeve të tjera në nivel lokal. Me pavarësimin e këtyre kolonive, kjo traditë u kristalizua përmes vendimit në rastin ***Marbury***

v. Madison. Me këtë vendim u rikonfirmua dallimi thelbësor me vendin amë, Britaninë e Madhe, ku supremacia (epërsia) e parlamentit merrej si e mirëqenë. Kushtetuta e SHBA-së (1787), e ndërtuar mbi idetë e **John Locke**-ut (1632-1704) mbi të drejtat e patjetërsueshme të njeriut paraqiste një qasje që sovranizonte popullin. Kjo u shpreh me fjalët njohura **Ne, Populli...** (**We, the People...**). Kjo ishte e kundërt me konceptin anglez mbi supremacinë (epërsinë) parlamentare. Kjo nënkuptonte se disa veprime nuk do t'i lejoheshin as vetë Kongresit sepse sovrani ishte vetë populli.

E drejta e përgjithshme (***common law***) në Amerikë doli të ishte i ngjashëm me interpretimin e kryegjyqtarit **Sir Edward Coke** në rastin **Dr. Bonham**: të drejtat e patjetërsueshme, të mishëruara në traditën shekullore të së drejtës së përgjithshme (***common law***) kontrollonin edhe aktet ligjore të parlamentit. **Dr. Bonham** kishte ushtruar profesionin e mjekut pa lejen e autoriteteve angleze, e cila kërkohej sipas ligjit të ri. E drejta e përgjithshme (***common law***), ndërkaq, nuk kishte kërkuar asnjëherë leje për të ushtruar profesionin e mjekut. Kryegjyqtari anglez tha se ligjet nuk duheshin zbatuar asnjëherë nëse binin ndesh me të drejtën e përgjithshme (***common law***), si një e drejtë superiore (më e lartë). Këtë filozofi **Sir Edward Coke** e kishte kthyer në standard nga frika se mund të vinte deri te restaurimi i monarkisë absolute, duke ia mveshur të drejtës së përgjithshme (***common law***), cilësinë e standardit suprem të sjelljes, përkatësisht standardin e një kushtetute britanike. Kjo për arsye se në atë kohë parlamenti kuptohej si vetë goja ligjvënëse e mbretit dhe për mbretin (doktrina ***king-in-parlament***). Në ndërkohë, në Amerikë kuptimi llokean i të drejtës supreme (sipërore) bazohej në të drejtat e patjetërsueshme që garantoheshin nga vetë natyra e njeriut. Këto të drejta të patjetërsueshme në sistemin amerikan të së drejtës së përgjithshme (***common law***) u futën në një kushtetutë të shkruar, vështirë të ndryshueshme, e cila duhej mbrojtur jo vetëm nga vullneti i ligjvënësit të ri amerikan por edhe nga ekzekutivi, në të gjitha nivelet. Vënia në jetë e këtij botëkuptimi nisi me rastin ***Marbury v. Madison***.

Rasti në fjalë, në esencë, nuk ishte asgjë tjetër pos konfirmim katërçipërisht i ideve të **John Locke** dhe iluministëve të tjerë mbi origjinën njerëzore të pushtetit, mbi të drejtat e patjetërsueshme si dhe konceptin e ndarjes së pushteteve, të cilat influencuan dukshëm idetë e ideatorëve të Kushtetutës Amerikane. Këto ide ata i shprehën në 85 punimet dhe esetë e tyre, tanimë të njohura si ***Letrat e Federalistit*** (***Federalist Papers***, 1787-1788). Në Letrën nr. 78, më e njohura nga të gjitha, e shkruar nga **Alexander**

Hamilton (Aleksandër Hamilton, 1757-1804), kontrolli gjyqësor shihet si një instrument i pështatshëm për të ruajtur supremacinë (epërsinë) e kushtetutës kundër ndërhyrjeve të legjislativit dhe ekzekutivit amerikan. Pushteti gjyqësor, sipas tij, paraqet **pushtetin më pak të rrezikshëm** nga tri pushtetet (***the least dangerous branch***). Është i tillë, pra më pak i rrezikshëm se dy pushtet e tjera, sepse është më i dobët se ato, pra se legjislativi dhe ekzekutivi. Kjo është kështu sepse gjyqësori nuk ka as monopolin e ushtrimit të dhunës fizike e as fuqinë e parasë. Kjo rrethanë e bën gjyqësorin të përshtatshëm për të interpretuar kushtetutën me qëllim të ruajtjes së supremacisë (epërsisë) së saj kundrejt çdo veprimi tjetër të pushtetit legjislativ (Kongresi) dhe ekzekutiv (Presidenti dhe Administrata). I lidhur me rregulla të rrepta të profesionit dhe me precedent gjyqësore, pushteti gjyqësor forcën e vet e merr nga fuqia e gjykimit, jo nga forca fizike apo financiare të cilën e posedojnë dy pushtetet e tjera. Këto shtjellime të **Hamiltonit**, si dhe vulosja e tyre nga **John Marshall** në rastin ***Marbury v. Madison*** (1803), përbëjnë kontributin unik amerikan në sferën e teorisë politike dhe së drejtës kushtetuese komparative.

Fillimisht kontrolli gjyqësor u përligjësua vetëm në nivel federal. Më pastaj, ky kontroll iu shtri në të gjitha nivelit e pushtetit në sistemin kushtetues amerikan, si në aspektin vertikal ashtu dhe atë horizontal. Ky i dyti ka qenë dhe ngelet pika referuese më e diskutueshme ashtu që edhe përvojat gjyqësore në kontrollin gjyqësor të pushtetit horizontal, pra në kuadër të ndarjes së pushteteve, kanë qenë kuadri zhvillimor i të drejtës kushtetuese amerikane. Kjo sepse, sot e kësaj dite, debati zhvillohet rreth pyetjes se si është e mundur që gjyqësori pa bazë zgjedhore të këtë të drejtën e interpretimit të vullnetit suprem të popullit amerikan, vullnet të cilin ky popull e ka shprehur dhe shkrirë në Kushtetutë. Në nivel vertikal, ndërkaq, kontrolli gjyqësor, të cilin e ushtrojnë gjykatat supreme të shteteve anëtare, e ka të njëjtin funksion sikur kontrolli gjyqësor në nivel federal të cilin e ushtron Gjykata Supreme e SHBA-së.

Ky kontroll gjyqësor, i nisur në mënyrë autonome dhe jashtë dispozitave kushtetuese, ka nisur në fillim vetëm kundruall gjyqësorit në nivel federal, për t'u shtrirë më pastaj në të gjitha nivelet e gjyqësorit amerikan. Kjo rrethanë e bën sistemin amerikan të jetë pjesë e modelit të **decentralizuar** apo **difuz** të kontrollit të kushtetutshmërisë së veprimeve të autoriteteve publike. Në këtë sistem, me fjalë të tjera, secila gjykatë ka të drejtën e interpretimit kushtetues në mënyrë të pavarur dhe autoritative, duke vënë mënjanë ligjet dhe veprimet e tjera të autoriteteve publike që vlerësohet se

bien ndesh me kushtetutën federale. Kjo situatë ka një shpjegim që lidhet me historinë e zhvillimit të këtij sistemi të kontrollit kushtetues, si në nivelin federal ashtu dhe në nivel të shteteve anëtare.

Kontrolli kushtetues i veprimeve në nivel federal, **pra i veprimeve të ligjvënësit (Kongresit) dhe ekzekutivit (Presidenti dhe Administrata) amerikan**, bazohet në botëkuptimin e shprehur nga **John Marshall**, arkitektit ideor të ***Marbury v. Madison***. Sipas tij, Kushtetuta paraqet shprehjen më sublime të vullnetit popullor, të asaj që në Amerikë shprehet përmes vetës së parë të shumësit, **Ne, Populli...** (***We, the People...***). Kushtetuta, jo ligji, kontrollon çdo veprim të pushtetit legjislativ (Kongresit) dhe ekzekutiv (Presidenti dhe Administrata). Çdo pushtet buron vetëm nga Kushtetuta dhe jo nga ndonjë vullnet tjetër. Në këtë mënyrë, çdo ligj dhe çdo vullnet tjetër i shprehur nga ligjvënësi amerikan si dhe çdo veprim në vijim të implementimit të vullnetit të popullit amerikan i cili bie ndesh me vullnetin sublim të shprehur në kushtetutën federale nuk konsiderohet i vlefshëm dhe duhet të injorohet zbatimi i tij. Detyrën për të treguar se çka është veprim kushtetues dhe çka nuk është, pra çka është vullneti sublim i kategorisë së parë, tanimë i njohur si **Ne, Populli...** (***We, the People...***), sipas nenit III të Kushtetutës e ka vetëm gjyqësori. Është prerogativë dhe detyrë primare e gjyqësorit, ka thënë **John Marshall**, për të treguar se çka është kushtetutë e çka vullnet tjetër i legjislativit dhe ekzekutivit amerikan. Ky interpretim nuk ka ndodhur si pasojë e autorizimi shprehimor nga neni III apo ndonjë nen tjetër i **Kushtetutës Amerikane** (1787). Neni III flet për pushtetin gjyqësor në nivel federativ, i cili ushtrohet nga Gjykata Supreme lidhur me çdo **rast dhe mosmarrëveshje** (***case and controversy***) me bazë në ligj apo në të drejtën e përgjithshme (***common law***). Cilësimi i objektit vendimmarrës të Gjykatës Supreme si "rast dhe mosmarrëveshje" e ka kuptimin që Gjykata Supreme nuk mund të japë mendime këshillëdhënëse, prerogativë të cilën e kanë gjykatat supreme në nivel të shteteve federale.

Neni III si më sipër në praktikën gjyqësore amerikane është interpretuar lidhur me nenin VI, i cili bën fjalë për Kushtetutën si për ligjin suprem amerikan, të cilit ligj duhet t'i nënshtrohen të gjithë pa përjashtim. Ky nen përcakton në mënyrë shprehimore se asnjë kushtetutë dhe asnjë ligj tjetër i shteteve anëtare nuk mund të jetë në kundërshtim me kushtetutën federale, ngjashëm siç bën neni III në raport me ligjet dhe aktet e tjera të nivel federal, pra se çdo ligj apo veprim tjetër në nivel federal duhet të jetë në pajtim të plotë më kushtetutën federale. Interpretimi për-

mes praktikës gjyqësore amerikane i këtyre dy neneve të kushtetutës ka pasur për pasojë kristalizimin e modelit amerikan të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, model që sot e kësaj dite ngelet i **decentralizuar** apo **difuz**, sepse ushtrohet nga tërë gjyqësori amerikan në të gjitha nivelet, dhe **incidente**, sepse ushtrohet gjatë procedurës së vendosjes për një rast dhe mosmarrëveshje nga ana e gjykatës konkrete. Këtë model e ka krijuar dhe qartësuar Gjykata Supreme përmes interpretimit të Kushtetutës së SHBA-së me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj kundrejt veprimit legjislativ (Kongresit) dhe ekzekutiv (Presidenti dhe Administrata), duke lënë kësisoj një hapësirë të mjaftueshme për gjyqësorin në nivel shtetesh anëtare për të luajtur rolin e njëjtë. Kjo është sa i përket kontrollit kushtetues në nivel federal.

Modeli i dytë, i njohur si **modeli evropian** (kelsenian/kontinental), ka lindur ekskluzivisht në bazë të autorizimit shprehimor kushtetues. Kjo ka ndodhur vetëm atëherë kur ka ardhur deri të pozitivizmi parametrave kushtetues. Më këtë term nënkuptohet situata në të cilën normat kushtetuese jo vetëm që cilësohen si dispozita me fuqi të qartë normative por edhe se mund të vihen në jetë përmes një mekanizmi gjyqësor në mënyrë të njëjtë siç vihen në jetë dispozitat ligjore. Kjo nënkupton, me tutje, se normat kushtetuese shërbejnë si parametra për ndarjen (dhënien) e gjyqësisë kushtetuese në të gjitha format e saj të manifestimit juridiksional. Këtë e sqaron shumë bukur autori **Lucio Pegoraro** (vep. e cit., fq. 159-178).

Modeli tjetër është **modeli i përzier** i gjyqësisë kushtetuese që mund të ushtrohet përmes një gjykate të ndarë kushtetuese, apo përmes instancës më të lartë gjyqësore në vend. Mirëpo, në të njëjtën kohë edhe nivelet e tjera të gjyqësorit të rregullt janë të autorizuar për të ushtruar kontrollin kushtetues të ligjeve pa e pasur të drejtën e shfuqizimit apo abrogimit të tyre. Ky sistem ekziston në **Portugali** dhe në disa vende të Amerikës Latine.

Në "modelin" e fundit janë shtetet që nuk kanë fare kontroll juridiksional të gjyqësisë kushtetuese, të përcaktuar me kushtetutë. Këtu hyjnë Finlanda, Britania e Madhe dhe disa nga kolonitë e dikurshme të saj dhe kështu me radhë. Në Britani dhe në disa prej tyre as që njihet ky koncept, kurse në të tjerat raste, si në Finlandë e Suedi, ky kontroll është jojuridiksional dhe ushtrohen nga organet politike brenda parlamentit. Në kuptim të gjerë, *grosso modo*, ekzistojnë dy sisteme: sistemi i kontrollit juridiksional (i lindur nga praktika gjyqësore apo me autorizim kushtetues) dhe ai i kontrollit politik (jojuridiksional i kontrollit kushtetues). Në kuadër të sis-

temit juridiksional ekzistojnë modelet e përshkruara si më sipër. Të gjithë autorët seriozë perëndimorë e bëjnë këtë klasifikim si më sipër të modeleve dhe sistemeve duke u bazuar në tri kritere përcaktuese:

- së pari, në bazë të përkatësisë (vendit të organit që ushtron kontrollin kushtetues në kuadër të sistemit kushtetues), organizimit, përbërjes dhe strukturës së tij;
- së dyti, në bazë të modaliteteve për qasje apo vënie në veprim të organit që ushtron kontrollin kushtetues; dhe
- së fundi, në bazë të natyrës dhe fuqisë detyruese të vendimeve të organit që ushtron kontroll kushtetues.

E ripërsërisim, këto tri kritere janë zbatuar nga të gjithë autorët seriozë perëndimorë për ndarjen dhe dallimin e sistemeve dhe modeleve të kontrollit kushtetues. E kemi fjalën për autorët që përmenden një nga një në këto dy libra: Luca Mezzetti, "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", botuar në Luca Mezzetti (ed.), ***Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*** (CEDAM: Padova, 2009, fq. 1-98) & Luca Mezzetti, "Introduzione", botuar në Luca Mezzetti (ed.), ***Sistemi e modelli di giustizia costituzionale***, Tomo II (CEDAM: Padova, 2011, fq. VII-XXXV). Po ta kishin studiuar si duhet literaturën e huaj profesionale, autorët tanë nuk do të kishin bërë gabime të tjera veç atyre të evidentuara si më sipër:

- e para, kur nuk fusin **Francën** në grupin e vendeve që kanë gjyqësi kushtetuese juridiksionale të tipit evropian, me gjithë specifikat që ka; dhe
- e dyta, kur besojnë se gjyqësia kushtetuese nuk mund të vihet në veprim ***ex officio*.**

Këto gabime janë pjesë e gabimeve të tërësishme të autorëve, të cilat burojnë nga fakti se autorët tanë nuk kanë ndjekur asnjë kriter për klasifikim të modeleve, gjë që shihet nga seksioni me titull "Modelet e kontrollit kushtetues" (fq. 182-185). Në fakt, lexuesi do ta ketë të pamundur për ta kuptuar se çka paraqet ndarja në paragrafin e dytë të fq. 182 dhe cili është raporti i saj me ndarjen nga paragrafi i parë në fq. 183. Këtu autorët marrin parasysh vetëm një kriter, duke konstatuar si vijon:

> Varësisht nga mënyra se si realizohet kontrolli kushtetues dallojmë disa modele të kontrollit dhe atë:
> 1. Modeli i centralizuar i kontrollit;
> 2. Modeli i decentralizuar i kontrollit;
> 3. Modeli abstrakt i kontrollit;
> 4. Modeli konkret i kontrollit;

5. Modeli paraprak i kontrollit;
6. Modeli i mëpasshëm i kontrollit.

Sikundër e thamë më sipër, në literaturën perëndimore bëhet klasifikimi (tipologjia) e sistemeve dhe modeleve të kontrollit kushtetues mbi bazën e tri kritereve. Në asnjërin prej tyre nuk mund të futen këto si më sipër, të shpikura nga autorët tanë. Në fakt, vetëm dy të parat bëjnë pjesë në modelet kushtetuese, në atë amerikan dhe evropian (kelsenian/kontinental), kurse katër të tjerat fare nuk janë modele. Këtu bëhet fjalë për formën e manifestimit të kontrollit kushtetues, përkatësisht për juridiksionin e gjykatës apo organit tjetër që ushtron kontrollin kushtetues. Ato gjenden në çdo kushtetutë të kodifikuar dhe nuk mund të jenë rezultat i instalimit përmes rrugës jurisprudenciale. Në Kushtetutën e Kosovës gjenden në nenin 113 ["Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara"]. Thënë me fjalë të tjera, autorët tanë kanë ngatërruar pa të drejtë juridiksionin kushtetues me modelin. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës nga ana e tyre të një qartësie lidhur me kriteret për klasifikimi të sistemeve dhe modeleve kushtetuese, diçka që bëhet në çdo tekst mbi të drejtën kushtetuese. Literaturën që përdorin në këtë seksion, si ajo në fusnotën nr. 593, nuk ka vit të botimit, diçka kjo mjaft e shpeshtë te autorët. Përveç kësaj, ajo që bie në sy është se autorët në pjesën dërrmuese citojnë dy fq. e para të artikullit, kapitullit të librit apo librit. Kjo ndodh edhe me burimin në këtë fusnotë. Po ta kishin lexuar në tërësi tekstin, autorët do ta kishin kuptuar esencën e dallimin dhe kriteret për dallim mes sistemeve/modeleve në njërën anë dhe sistemeve/modeleve dhe juridiksionit kushtetues, në anën tjetër. Jo vetëm kaq, autorët tanë e cilësojnë **Hans Kelsen** si "babai modern i kontrollit kushtetues", në ndërkohë që burimi nga fusnota e sipërcekur e cilëson siç duhet, si "baba të kontrollit kushtetues modern". Kjo sepse, sikundër u pa më sipër, kontrolli gjyqësor ka nisur shumë më herët jashtë përcaktimit shprehimor kushtetues për një juridiksion të tillë. Në fakt, për herë të parë, kontrolli kushtetues siç kuptohet sot, pra si një teknikë dhe mekanizëm për të siguruar supremacinë (epërsinë) e një rendi juridik superior ka nisur në rastin **Dr. Bonham**, për t'u bërë standard përgjithësisht i pranuar me jurisprudencën amerikane me vendimin në ***Marbury v. Madison***. Këtë autorët fare nuk e kanë të qartë në fq. 183, në të cilën flasin një nga një për "modelet" e tyre të kontrollit kushtetues. Duke bërë fjalë për to, ata flasin në mënyrë të gabuar për kontrollin konkret kushtetues dhe besojnë se kontrolli konkret dhe kontrolli incidental kushtetues janë dy gjëra të

ndryshme. Në fakt, fjala është për të njëjtin kontroll kushtetues, të cilit nganjëherë i referohemi si kontroll incidental dhe çdoherë iniciohet nga vetë gjykata e rregullt pranë së cilës gjendet një rast apo mosmarrëveshje dhe pret për t'u vendosur nga ajo. Ky lloj kontrolli është relikt i modelit amerikan të kontrollit gjyqësor (cf. paragrafin e dytë të fq. 184).

Paragrafi i fundit i fq. 184, autorët flasin për kontrollin kushtetues paraprak dhe të mëpasshëm, të njohur ndryshe edhe si kontrolli kushtetues preventiv dhe represiv. Për kontrollin paraprak, autorët flasin vetëm në kontekstin e kontrollit të kushtetutshmërisë së normave ligjore, jo edhe të normave të tjera. Kjo është arsyeja pse autorët gabimisht mendojnë se përmes kontrollit paraprak "synohet që të parandalohet hyrja në fuqi e akteve të cilat janë në kundërshtim me kushtetutën". Ata harrojnë se në disa vende, përfshirë **Kosovën**, ekzistojnë dispozita të qarta që autorizojnë gjykatën kushtetuese për të ushtruar kontroll preventiv të amendamenteve kushtetuese para miratimit të tyre. Me fjalë të tjera, kontrolli paraprak i normave juridike përfshin jo vetëm rastet kur norma është miratuar nga përfaqësuesi i sovranit, por edhe ato raste kur norma akoma nuk është formuar dhe gjendet në letër, para se të hyjë në agjendë të parlamentit për t'u votuar. Çdo lexim i nenit 113.9 lidhur me nenin 144.2 të Kushtetutës së Kosovës e bën këtë dallim të qartë. Nuk është vetëm ky gabim konceptual i autorëve i bërë në fund të seksionit që diskutojmë: në fq. 185 flasin për rastin e **Asociacionit Serb** sikur të kishte qenë objekt kontrolli kushtetues i Gjykatës marrëveshja me Serbinë: në rastin KO 130/15 objekt kontrolli kushtetues nuk ka qenë **Marrëveshja me Serbinë për Asociacionin Serb**. Kjo procedurë është vënë në lëvizje me pyetje kushtetuese të parashtruara nga ana e **Presidentes Jahjaga**, që d.m.th. se objekt i kontrollit kushtetues ka qenë kërkesa e saj. Me këtë gabim, mbyllet ky kapitull, i cili është i fundit i pjesës së parë të librit të autorëve tanë.

Pjesa e dytë

RRETH HISTORIKUT TË KUSHTETUTËS SË KOSOVËS

Përgjithësisht

Kjo pjesë e librit përbëhet nga shtatë kapituj. Në përgjithësi ka pak dallime nga pjesa pararendëse, gjë që lexuesi ynë do ta vërejë në shtjellimet tona në vijim.

Analiza kritike

Cilësitë themelore të kësaj pjese janë si vijon:

- manipulimi me literaturë, si dhe mungesa e burimeve për gjërat që përbëjnë fakte apo ngjarje historike që nuk mund të dëshmohen me fjalë por ekskluzivisht me burime të faktuara;
- pasaktësia profesionale në trajtimin e kuptimeve themelore, ngjarjeve dhe shkaqeve që lidhen me historinë kushtetuese të vendit; dhe
- ndërtimi i teorive politike dhe gjysmë-juridike për të shpjeguar situatat dhe rrethanat që lidhen me historinë kushtetuese të Kosovës, të cilat teori nuk korrespondojnë me asnjë autor apo libër universitar nga lëmi i së drejtës kushtetuese.

KAPITULLI I.
HISTORIKU KUSHTETUES I KOSOVËS NË MES TË VITEVE 1945–1999
(FQ. 189–227)

Përgjithësisht

Ky kapitull përbëhet nga 22 seksione. Nga titulli, siç mund të supozohet, lexuesi pret që të shohë diçka konkrete rreth zhvillimit kushtetues të Kosovës. Kjo, megjithatë, nuk del se është kështu: autorët në pjesën dërrmuese të seksioneve të këtij kapitulli flasin për aspekte thjesht historike (kur flitet për ngjarje nga e kaluara jo fort e largët ose e largët) dhe politike (kur

bëhet fjalë për ngjarjet në Kosovës dhe rreth saj të ndodhura pas Luftës së Ftohtë dhe rrëzimit të komunizmit). Në të shumtën e rasteve, autorët për aspektet historike dhe politike, të cilat nuk e kanë vendin në një kapitull që mëton të trajtojë historinë kushtetuese të një vendi, nuk citojnë askënd: operojnë me terminologji të laikëve dhe njerëzve të zakonshëm kur diskutojnë rreth një problemi konkret historik apo politik. Në aspektin ideologjik të qasjes metodologjike, ndërkaq, trajtimi historik i historisë më të re të Kosovës, nga themelimi i ish-Jugosllavisë në vitit 1918 në veçanti, ka karakter të plotë të metodës materialiste dialektike marksiste: historia e Kosovës në këtë tekst, në thelb, është historia e lëvizjes së klasës punëtore jugosllave dhe kosovare, vetë historia e lindjes, zhvillimit dhe rënies së komunizmit në Kosovë. Këtë lexuesi i vëmendshëm do ta vërejë menjëherë. Lidhur me këtë qasje tërësisht të gabuar, autori i këtyre rreshtave e ka thënë mendimin e vet në vitin tanimë të largët 1997, në një kritikë të gjatë profesionale dhe shkencore. Kjo kritikë në ndërkohë është ribotuar në tërësi në seksionin e dytë të kapitullit III (fq. 81-144) të librit të këtij autori me titull ***Tema të zgjedhura nga e drejta kushtetuese*** (Univ. Prishtinës/Jalifat: Prishtinë/Hjuston, 2016): ajo që është thënë në vitin e 1997, në tërësi vlen për kohën e sotme; asgjë nuk ka dyshuar që atëherë sepse autorët tanë kanë ripërsëritur të njëjtat gjëra dhe konstatime tërësisht joshkencore dhe joprofesionale në aspektin historik, juridiko-ndërkombëtar dhe juridiko-kushtetues. Udhëzojmë lexuesin që të krahasojë këtë kapitull me kapitullin si më sipër të librit të këtij autori dhe të nxjerrë konkludime të pavarura. Para se t'i lexojë faqet e sipërcekura, lexuesit i bën mirë sikur të lexojë në fillim faqet hyrëse për kapitullin e tretë si më sipër. Kjo sepse, pas leximit do ta kuptojë në tërësi kontekstin e lindjes së këtij diskursi joshkencore, joprofesional dhe të dëmshëm për studentët tanë, atyre për të cilët për fat të keq është shkruar libri.

Këtu në këtë kapitull do të merremi vetëm me pjesën që ka të bëjë me ripërsëritjen e tri konstatimeve absurde të autorëve tanë që nuk i kanë qëndruar dhe nuk mund t'i qëndrojnë kohës dhe që, si të tilla, në tërësi janë provuar si konstatime eklektike të tejkaluara dhe fiktive për çdo kohë dhe hapësirë që lidhet me historinë kushtetuese të vendit tonë – Kosovës. Këto tri aspekte i trajtojmë vërtetë nga aspekti i historisë kushtetuese të Kosovës, në veçanti shikuar nga këndi i teorisë dhe praktikës së pushtetit konstituiv (origjiner dhe derivativ), rëndësisë dhe statusit aktual të këtij pushteti për shkencën e së drejtës kushtetuese në Kosovë. Kjo nënkupton, për pasojë, që nuk bëhet fjalë për të drejtën kushtetues si degë e sistemit

pozitiv juridik ndër ne, sepse në këtë aspekt kjo degë e së drejtës ka një rrjedhë të vetë që nuk varet nga trajtimet e pavend dhe joprofesionale të autorëve tanë dhe të kujtdoqoftë tjetër. E kemi fjalën për këto tri aspekte:

- e para, për tezën tërësisht të paqëndrueshme të autorëve tanë për Kosovën si njësi konfederale e Perandorisë Otomane;
- e dyta, për tezën tërësisht të paqëndrueshme të autorëve tanë për Konferencën e Bunjajt si shprehje dhe manifestim i ushtrimit të kosovarëve të pushtetit origjiner konstituiv (***pouvoir constituant originaire***); dhe, së fundi,
- e treta, për tezën tërësisht të paqëndrueshme dhe konfuze të autorëve për Kosovën si njësi konstituive e RSFJ-së, bazuar në Kushtetutën e viti 1974 si dhe reinkarnimin e pushtetit konstituiv të **Konferencës së Bunjajt** përmes **Deklaratës së 2 korrikut 1990** dhe akteve të tjera juridike që e pasuan atë.

Të shohim si duket kjo në trajtimet tona të seksioneve të këtij kapitulli. Ky trajtim merret vetëm me seksionet që i referohen tri aspekteve si më sipër, në ndërkohë që për të tjerat nuk dëshirojmë ta ngarkojmë më shumë lexuesin, i cili vetë do t'i gjejë lëshimet serioze që afërsisht janë parë në pjesën e parë të librit të autorëve tanë: literatura e huaj e përdorur, e cila kryesisht gjendet e qasshme në internet, në tërësi është manipuluar duke ua mveshur autorëve të cituar idetë dhe fjalët që ata nuk i kanë thënë.

Analiza kritike

Nga analiza jonë për seksionin e parë të kapitullit të dytë të pjesës së parë, e kemi parë se si autorët tanë japin konstatime tërësisht të paqëndrueshme shkencërisht dhe profesionalisht. Këtë e bëjnë duke u thirrur në burime dhe autorë të respektuar ndërkombëtarisht, në fakt duke i përdorur burimet e huaja në mënyrë abuzivisht manipulative. E kemi fjalën për konstatimin e tyre në vendin e sipërcekur që thoshte se **Perandoria Romake** ka qenë një **monarki kushtetuese**. Në ndërkohë që aty citojnë në mënyrë abuzive autorin e mirënjohur **F.W. Bussell**, në rastin që e diskutojmë në vijim nuk citojnë askënd sepse bëhet fjalë për një konstatim që nuk e duron mendja e shëndoshë: në fakt, ata citojnë në mënyrë manipulative historianin me famë botërore, **Noel Malcolm**, përkatësisht fq. 198-209 të librit të tij ***Kosovo: A Short History*** (Macmilllian: London, 1998). Para se ta citojnë atë, autorët tanë në fq. 191 konstatojnë si vijon:

> Vilajeti i Kosovës, në sistemin e tërësishëm të pushtetit shtetëror të Perandorisë Otomane, kishte një status të mëvetësishëm me elemente të shtetit konfederal. Organizimi i Vilajetit të Kosovës kishte disa specifika të veçanta nga vilajetet tjera, përkatësisht kishte atribute të shtetit, si njësi e veçantë e perandorisë turke. Në favor të këtij konstatimi është edhe e dhëna se në kuadër të Vilajetit të Kosovës kanë ekzistuar dhe kanë funksionuar mbi dhjetë mekanizma të pushtetit, kuptohet, me qëllim të institucionalizimit të veprimtarisë juridike të Perandorisë.

Kjo fjali e fundit ngërthen citimin e **Noel Malcolm**-it, mirëpo ato faqe që autorët tanë i citojnë fare nuk kanë të bëjnë me konstatimin e sipërcekur: në ato faqe, **Noel Malcolm** në mënyre brilante dhe shteruese flet për përbërjen etnike të Ballkanit, marrëdhënien ndëretnike ballkanike përgjatë historisë, në Kosovë në veçanti, si dhe për argumentet serbe lidhur me ndikimin e fesë ortodokse në identitetin e shqiptarëve; pas fq. 200 nis kapitulli për popujt e tjerë me të cilët shqiptarët kanë bashkëjetuar dhe bashkekzistuar në Ballkan për shekuj, përkatësisht për vllehët, romët, turqit, hebrenjtë dhe grupet e tjera etnike (çerkezët). T'i kthehemi tani çështjes së tezës së autorëve mbi **Kosovën** si një njësi konfederale dhe me atribute shtetërore.

Sikundër dihet, reformat e **Tanzimatit** (1839-1876) kanë mëtuar shndërrimin e Perandorisë Otomane nga një shtet teokratik në një shtet modern sipas parimeve evropiane. Po ashtu dihet që ato reforma më së shumti i kanë kundërshtuar ballkanasit, përkatësisht latifundistët e mëdhenj të tokave me orgjinë shqiptare dhe boshnjake. Përpjekja për të futur një sistem evropian të qeverisjes në Perandori ka zgjatur për dekada të tëra dhe ka rezultuar me pasoja shumë destabilizuese sepse ka prekur nervin e mënyrës së udhëheqjes së Perandorisë, sistemin e shpërndarjes së tokës që përbënte shtyllën e pushtetit perandorak. Pas një kohe të gjatë ngecjeje, si dhe pas humbjes në Luftën e Krimesë (1853-1856), Perandoria Otomani sërish u zotua se do të vazhdonte reformat e nisura, me një intensitet tjetër dhe më thellë se pas nisjes së Tanzimatit. Për këtë qëllim, Sulltani nxori një dekret që riniste këtë proces reformash, një hap që u përshëndet nga fuqitë evropiane me **Marrëveshjen e Parisit** (1856) vetëm një javë më pas. Kjo marrëveshje si shpërblim i njohu Perandorisë integritetin territorial, me kusht që kjo e fundit të kujdesej për reformën e administratës dhe mbrojtjen e pakicave të krishtera. Figura kyçe në krijimin e sistemit të Vilajeteve është **Mithat Pasha**, një reformator i madh që ka

futur për herë të parë kuptimin e parlamentit modern në traditën otomane. Në vitin 1864, si pjesë e reformave të tij të thella, bazuar në modelin francez të prefekturave, ai për herë të parë formoi **Vilajetin e Nishit**, që u parapri nga nxjerrja e një infrastrukture ligjore në po atë vit. Pas kësaj tërë Perandoria u përfshi nga sistemi i vilajeteve, përfshirë viset e banuara me shqiptarë. Në fillim **Kosova** u nda në dy vilajete, kurse në vitin 1868 u krijua **Vilajeti i Prizrenit**, që vazhdoi deri në vitin formativ të **Vilajetit të Kosovës** (1877). Ky vilajet, me seli në Shkup, ka pasur shumë më shumë territor se Kosova e sotme dhe qe krijuar e rikrijuar për arsye tërësisht strategjiko-ushtarke të **Perandorisë Otomane**. Kjo në veçanti u bë e qartë pas **Traktatit të Berlinit** (1878), kur shqiptarët dhe **Vilajeti i Kosovës** u bënë viset më të militarizuara të Perandorisë. As edhe një element të shtetësisë nuk kanë pasur vilajetet, lëre më elemente të ndonjë njësie konfederale. Po të dinin sulltanët otomanë se çfarë kuptimi ka teoria dhe praktika e konfederatës, sigurisht që nuk do të kishte pasur nevojë për nisjen e reformave të Tanzimatit. Sundimi otoman ka qenë tërësisht despotik dhe jashtë standardeve evropiane të kohës. Po të ishte ndryshe nuk do të kishte pasur nevojë për rropatje titanike për reformim të asaj perandorie. Shumë vonë, në fund të procesit të nisur të reformimit, Perandoria fitoi një kushtetutë, e cila megjithatë pati një jetë shumë të shkurtër. Historia kushtetuese e Kosovës nën Perandorinë Otomane, në fakt, duhet ta ketë këtë kushtetutë si pikënisje dhe të flitet për vendin e Vilajetit të Kosovës në këtë kontekst. Kështu kanë vepruar dhe veprojnë të gjithë popujt që ka qenë nën sundimin otoman. Kjo nuk mund të injorohet, siç nuk mund të injorohet fakti se **Kosova** ka qenë më vonë pjesë integrale e Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene/Jugosllave (1918-1945). Këtë fakt sikur e harrojnë autorët tanë: vetëm në një vend thonë se Kosova është ndarë ndërmjet tri banovinave: Banovinës së Vardarit, Moravës dhe të Zetës. Për këtë, në fusnotën nr. 614, si argument citojnë në mënyrë manipulative fq. 289-297 të librit të **Noel Malcolm**. Ky autor, ndërkaq, në këto faqe flet për Kosovën gjatë **Luftës së Dytë Botërore** dhe asnjë fjalë të vetme nuk e thotë për këto banovina. Rregullimi administrativ i Mbretërisë Jugosllave ka qenë kryekëput i lidhur e politikën anti-kroate dhe luftën e serbëve kundër nacionalizmit kroat. Vetë riorganizimi, ndërkaq, është bazuar në lumenj natyrorë dhe ka pasur për qëllim krijimin e ndjenjës dhe identitetit të ri jugosllav, duke mos respektuar asnjë kriter etnik apo ndarje të mëparshme administrative në dobi të asnjë populli. Kështu thotë **Noel Malcolm**, kështu thonë krejt historianët seriozë që janë marrë me ish-Jugosllavinë dhe historinë

së saj politike dhe kushtetuese. Identiteti territorial i Kosovës së sotme nuk ka qenë prezent as në kohën e Perandorisë e as të Mbretërisë SKS/Jugosllave: ai identitet ka qenë nacional dhe ka pasur shtrirje në tërë hapësirën ballkanike ku shqiptarët kanë qenë prezent dhe daton nga koha e Lidhjes së Prizrenit (1878). Kjo, megjithatë, fare nuk ka rëndësi këtu për historinë kushtetuese të Kosovës sepse paraqet histori të pastër që i takon sferës së historianëve. Konstitucionalistët duhet të merren me historinë kushtetuese, ashtu siç paraqitet ajo në rrjedhat historike. Në këtë kohë, shqiptarët dhe Kosova nuk kanë pasur identitet kushtetues dhe as që kanë qenë të njohur si të tillë. Çështjen e Vilajetit të Kosovës dhe statusin juridik-kushtetues të Kosovës dhe shqiptarëve në Mbretërinë SKS/Jugosllave, autorët tanë kanë mundur ta mësojnë si duhet, përveç nga **Noel Malcolm** edhe nga autorët e tjerë shqiptarë të historisë së shtetit dhe së drejtës. E kemi fjalën këtu në veçanti për burimet si vijon: Aurela Anastasi, *Historia e institucioneve* (Pegi: Tiranë, 2006) dhe Hilmi Ismaili & Fatmir Sejdiu, *Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore* (Fakulteti Juridik i UP: Prishtinë, 2009).

Nga **Noel Malcolm**, dhe nga autori tjetër burimin e të cilit e manipulojnë në fusnotën nr. 599, autorët tanë kanë mund t'i mësojnë me themel se cilat në të vërtetë janë argumentet juridike të qëndrueshme sa i përket statusit të Kosovës në kuadër të Mbretërisë SKS/Jugosllave. **N. Malcolm** dhe **Jure Vidmar**, autori tjetër nga fusnota nr. 599, më mirë se çdokush kanë sqaruar statusin e Kosovës në kuadër të asaj mbretërie sllave. Në fakt, **J. Vidmar**, në shkrimin e vet me titull "International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence", botuar në *Vanderbilt Journal of Transnational Law* (vol. 42, no. 3, 2009, fq. 779-851), të cilin autorët tanë e manipulojnë, i ka dhënë argumente juridike që arsyetojnë pavarësinë e Kosovës nga Serbia shumë kohë para se **GJND** të jepte verdiktin e saj meritor. Sipas këtij autori, si dhe **N. Malcolm**, Kosova nuk ka qenë pjesë e Serbisë asnjëherë sepse **Marrëveshja e Londrës** dhe **Marrëveshja e Bukureshtit** (1913), të cilat likuiduan çështjen e luftërave ballkanike, asnjëherë nuk janë ratifikuar nga Serbia. Në fakt, **Marrëveshja e Bukureshtit** as që i referohej Serbisë, sepse ajo nuk kishte qenë palë në marrëveshje. E vetmja marrëveshje e lidhur në mes Turqisë dhe Serbisë është **Marrëveshja e Stambollit** (1914), e cila gjithashtu asnjëherë nuk është ratifikuar si pasojë e fillimit të **Luftës së Parë Botërore**. Këto argumente janë të natyrës së argumenteve juridiko-ndërkombëtare. Pas kësaj vijnë argumentet e natyrës juridiko-kushtetuese: në dhjetor 1918 u krijua ish-

Jugosllavia dhe shqiptarët u bënë shtetas të saj, jo të Serbisë, në ndërkohë që Kushtetuta e Serbisë e vitit 1903 kishte parashikuar ratifikimin parlamentar të çdo ndryshimi territorial. Ky ratifikim asnjëherë nuk është bërë pas zgjerimit territorial të Serbisë në mbarim të **Luftërave Ballkanike** (1912-1913). Këto dy palë argumente si më sipër nuk janë të autorit të këtyre rreshtave por të **N. Malcolm**-it, me të cilat pajtohet në tërësi autori i mirënjohur slloven **J. Vidmar**. Sikur t'i kishin lexuar më kujdes këta dy autorë, autorët tanë do ta kishin lënë anash logjikën eklektike të arsyetimit të së drejtës për vetëvendosje të Kosovës me terma metafizikë që nuk korrespondojnë me asnjë autor apo burim tjetër jashtë universit të tyre gravitacional "intelektual". E kemi fjalën në veçanti për fq. 264-266 të librit të **N. Malcolm**. Njëjtë mendon edhe **J. Vidmar**, juristi i shkëlqyer slloven, artikulli i të cilit po ashtu manipulohet nga autorët tanë në fusnotën e tyre nr. 599: juristi slloven thotë atë që thotë **Noel Malcolm**, por e citon në mënyrë besnike dhe nuk e manipulon aspak. D.m.th. dy burimet në fjalë, të studiuesve **N. Malcolm** dhe **J. Vidmar** janë brutalisht të manipuluara nga autorët tanë: dy autorët e huaj pajtohen në tërësi për si më sipër. Për më tepër, **Jure Vidmar** shkon një hap më tutje kur thekson, një vit para verdiktit të **GJND** për Kosovës, se rasti i Kosovës përbën secesion origjinal, ***sui generis***, jashtë kontekstit jugosllav, përkatësisht thekson se fjala është për një secesion nga Republika e Serbisë dhe jashtë kontekstit legal. Kështu ishim shprehur edhe ne në polemikën tonë të sipërcekur më autorët tanë në vitin tanimë të largët 1997 (cf. **Enver Hasani**, vep. e cit. fq. 89-98). Kështu thonë të gjithë juristët seriozë nëpër katedrat e huaja. Kjo sepse këto janë argumente standarde të natyrës juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare lidhur me vetëvendosjen dhe lindjen e shteteve të reja jashtë kontekstit kolonial. Si të tilla, argumentet në fjalë janë të diametralisht të kundërta me atë që thonë autorët tanë në konstatimet e tyre absurde mbi **Vilajetin e Kosovës** si njësi konfederale. Të po kësaj natyre shterpe dhe absurde janë edhe argumentet e tyre lidhur me **Konferencën e Bunjajt** (dhjetor 1943–janar 1944). Kësaj çështje i kthehemi në rreshtat në vijim.

Një rezolutë e miratuar në këtë konferencë shërben për autorët tanë si argument vendimtar se fjala është për një akt konstituiv të shtetit të Kosovës, përkatësisht si realizim i vetëvendosjes kosovare. Thënë me fjalë të tjera, sipas tyre, rezoluta e kësaj konference përbën ushtrim të pushtetit origjiner të kosovarëve (***pouvoir constituant originaire***). Për të qenë edhe më korrekt dhe më i qartë me lexuesin tonë, do e citojmë në tërësi para-

grafin ku thuhet ky mendim, përkatësisht ku citohet **Noel Malcolm** si një dëshmi mbretërore e mendimit të autorëve tanë mbi rezolutën e Bunjajt si akt burimor konstituiv i vetëvendosjes së kosovarëve. Kjo, megjithatë, nuk mund të jetë e vërtetë, sikur që nuk është e vërtetë që **N. Malcolm** i ka thënë gjërat që autorët tanë ia mveshin në tekstin e prodhuar që shoqëron fusnotat nr. 602, 607, 614, 619, 657 & 684. Në fakt, një gjë të tillë nuk mund ta thotë asnjë autor në botë pos autorëve tanë dhe ata nga të cilët e kanë huazuar këtë konstatim. Të shohim për hir të lexuesit tonë se çka në të vërtetë kanë thënë autorët tanë rreth **Konferencës së Bunjajt** në fq. 194-195 të librit të tyre, ku citojnë në mënyrë manipulative **Noel Malcolm**. Aty gjendet kjo thënie:

> Duke u nisur nga këto përcaktime burimore të Konferencës, mund të thuhet se Rezoluta e Konferencës së Bujanit ishte një akt me fuqi konstituive dhe me garanci ndërkombëtare. Në fakt, Rezoluta e Bujanit paraqiste dokumentin themelore të vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës.

Diskursi mbi **Konferencën e Bunjajt** ka lindur pas rrënimit të komunizmit dhe shpërbërjes së ish-Jugosllavisë: asnjë tekst, asnjë rresht i një dokumenti ose libri të botuar në Kosovë mes viteve 1945-1990 nuk përmban diçka që ngre aktet e **Konferencës së Bunjajt** në nivel të akteve konstituive. Edhe aktualisht, por shikuar edhe në kontekstin historik, aktet e kësaj konference kanë qenë manifestim i vullnetit të vetëm një shtrese të popullit të Kosovës, me përfaqësim të theksuar të së majtës ekstreme të asaj kohe. Në të nuk ka marrë pjesë faktori ndërkombëtar për t'i dhënë përligjësimin (bekimin) juridiko-ndërkombëtar dhe juridiko-kushtetues të kohës, diçka që kërkohet që nga Paqja e Vetsfalisë e këndej (1648). Thënë me fjalë të tjera, aktet e **Konferencës së Bunjajt** nuk e kanë cilësinë e aktit konstituiv origjiner të ndërkombëtarizuar apo të aktit konstituiv origjiner në të cilin shprehja e vullnetit burimor të popullsisë vendore ndahet me faktorin ndërkombëtar. Këto koncepte i kemi diskutuar dhe sqaruar në kapitujt paraprakë, kur kemi kritikuar gjerësisht dhe me themel cilësimin e gabuar të këtyre akteve si kushtetuta të dhuruara (oktruara). Se kjo është kështu qartë shihet nga shtjellimi shkencor i **N. Malcolm** në faqet që autorët i manipulojnë në fusnotën e tyre nr. 619: në ato faqe, ky autor sqaron se lëvizja e majtë ndër shqiptarët e Kosovës ka qenë shumë e dobët, ashtu që për të penguar përhapjen e komunizmit ndër shqiptarët e Kosovës pas kapitullimit të Italisë, forcat gjermane kishin organizuar një konferencë, e cila njihet si **Lidhja e Dytë e Prizrenit**, me

qëllim të mobilizimit të shqiptarëve në luftë kundër forcave aleate. Për t'i dalë përpara këtij hapi gjerman, komunistët jugosllav kishin nxitur një konferencë tjetër, **Konferencën e Bunjajt**, duke vënë në lëvizje ndjenjat kombëtare të shqiptarëve nga prizmi komunist. Kjo konferencë ka qenë ajo për të cilën flasin autorët tanë si për aktin konstituiv me garanci ndërkombëtare, në ndërkohë që arsyeja e vetme e organizimit të saj, sipas mendimit të shprehur të **Noel Malcolm** në faqet që manipulohen nga autorët tanë, ka qenë dhe mbetet kundërvënia ndaj Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Asnjëherë dhe askund **N. Malcolm** nuk e ka thënë se Konferenca e Bunjajt e ka statusin e shprehjes burimore të vullnetit të kosovarëve, diçka që autorët tanë ia mveshin, e aq më pak të ketë thënë se shprehja e vullnetit në atë konferencë ka pasur garanci ndërkombëtare. Këtë, në fakt, nuk e ka thënë dhe nuk mund ta thotë askush pos autorëve tanë dhe të tjerëve që pas rënies së komunizmit krijuan këtë diskurs të çuditshëm mbi vetëvendosjen e Kosovës me pikë referimi "aktet burimore të Konferencës së Bunjajt". Këtë gabim po ashtu e kemi vënë në pah me kohë në polemikën tonë të vitit 1997 si më sipër (cf. **Enver Hasani**, vep. e cit. fq. 94-95 & 140-141).

Diskursi mbi **Konferencën e Bunjajt** nuk është i vetmi akt burimor, i ndarë nga aktet e tjera po ashtu burimore në aspektin origjiner: kjo konferencë, sipas tyre, paraqet një hallkë në zinxhirin e dokumenteve dhe akteve burimore të vetëvendosjes së Kosovës që mbyllen me Deklaratën e 2 korrikut të vitit 1990. Në ndërkohë që pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë deklarimi i kosovarëve më 2 korrik ka qenë i po asaj cilësie që kanë qenë edhe deklarimet e popujve të tjerë në ish-Jugosllavi, kjo nuk mund të thuhet për Kushtetutën e vitit 1974, si dhe për Kuvendin e Prizrenit (1945). Këto dy momente, sipas autorëve tanë, përbëjnë një vazhdimësi burimore e akteve konstituive të kosovarëve të nisur në **Konferencën e Bunjajt**. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: asnjë shtet, përfshirë ish-Jugosllavinë, nuk shpërbëhet me rrugë kushtetuese. Kuptimi kelsenian mbi kushtetutën e parë historikisht shikuar dhe ai shmitian mbi vendimin konkret që vendos mbi tërësinë e formës së ekzistencës politike të një shoqërie nuk mund t'i durojnë këto konstruksione metafizike të autorëve tanë. Asnjë bazë kushtetuese nuk kanë pasur Rezoluta e Bunjajt, Deklarata e Prizrenit, Deklarata e 2 korrikut me Kushtetutën e vitit 1974: si të tilla, pra si jokushtetuese kanë qenë të gjitha deklaratat për pavarësi të kroatëve, maqedonëve, sllovenëve dhe kështu me radhë të ndërmarra në vigjilje të shpërbërjes totale të ish-Jugosllavisë. Kjo nënkupton që, për pasojë, nuk

mund të ketë asnjë kontinuitet kushtetues mes vullnetit të shprehur në Konferencën e Bunjajt, në Kuvendin e Prizrenit dhe në Kuvendin e Kaçanikut me atë të shprehur më 2 korrik 1990 dhe më pas.

Në Kosovë, aspektin juridik-kushtetues ***grundnorm***-a e parë në historinë moderne, në vijim të ndërtimit të shtetit të ri sovran dhe të pavarur, ka qenë dhe ngelet Deklarata e 2 korrikut 1990. Ky dokument, megjithatë, ka ngelur në letër siç kanë ngelur me qindra deklarata të njëanshme dhe kushtetuta të popujve të robëruar gjatë historisë së tyre (ta zëmë, rastet e polakëve, gjermanët dhe italianëve, para unifikimit të tyre respektiv në shekullin XIX dhe XX). Në këtë kuptim, kjo ***grundnorm*** nuk dallon nga ajo e datës 17 shkurt 2008: i vetmi dallim është që në rastin e fundit u bë vënia në jetë e vullnetit të kosovarëve, vullnet i manifestuar me vrull pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, këtë herë duke pasur si bashkudhëtar dhe bashkëpjesëmarrës faktorin kyç ndërkombëtar të kohës. Me fjalë të tjera, **Deklarata e Pavarësisë** e datës 17 shkurt 2008 përbën një realizim dhe vënie në jetë të vullnetit të tërësishëm të kosovarëve, i ushtruar me ndihmën dhe nën mbikëqyrjen vigjilente të faktorit kyç ndërkombëtar të kohës. Ky faktor, në rastin e Kosovës, ashtu si dhe në rastet e ngjashme përgjatë historisë moderne që nga **Paqja e Vetsfalisë** (1648) paraqitet si bashkëpjesëmarrës në garantimin e ushtrimit siç duhet të pushtetit konstituiv origjiner. Kjo nënkupton se Kosova këtë pushtet e ka ushtruar siç duhet nën mbikëqyrjen dhe garantimin e faktorit ndërkombëtar, duke e bërë të njëjtin pushtet të ndërkombëtarizuar. Shprehja e 17 shkurtit 2008 është efektive dhe me legjitimitet ndërkombëtar si pasojë e faktit që Kosova tani ka arritur të plotësojë elementin e munguar të qenies shtet – pasjen e një qeverie me kontroll efektiv të territorit të vet, përkatësisht të një qeverie që ushtron pushtetin shtetëror kushtetues dhe sovran në një territor. Këtë argument e ka dhënë një ndër autorët më të njohur ndërkombëtar në lëmin e së drejtës ndërkombëtare. Po ky autor kishte thënë se Kosova nuk ka kontroll efektiv dhe nuk mund të bëhet shtet, gjatë kohës kur nisi shpërbërja e ish-Jugosllavisë. E kemi fjalën për shkrimin e autorit **Colin Warbrick** me titull "Kosovo: The Declaration of Independence", *International and Comparative Law Quarterly* (vol. 57, issue 03, July 2008, fq. 675-690). Këto argumente i ka shprehur autori i këtyre rreshtave menjëherë pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit (cf. **Enver Hasani**, ***Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare*** (Univ. Prishtinës/Jalifat: Prishtinë/Hjuston, 2016, fq. 202-242)).

Autorët tanë, për fat të keq, si duket nuk i kanë marrë seriozisht argu-

mentet juridike të autorëve të huaj kompetentë, duke u mbështetur vetëm në tezat e tyre eklektike që nuk kanë asnjë burim serioz të matshëm, pos arsyetimit të tyre arbitrar metafizik. Në këtë grup hyn edhe argumenti i tyre për Kushtetutën e vitit 1974: ajo kushtetutë, për dallim nga Kushtetuta e Bashkimit Sovjetik e vitit 1977, nuk ka njohur të drejtën për vetëvendosje. Në fakt, në ish-Jugosllavi vetëvendosja çdoherë konsiderohej e konsumuar me vetë aktin e krijimit të ish-Jugosllavisë në dhjetor 1918, përkatësisht në Kuvendin Kushtetues (1945). Shpërbërja e saj, për pasojë, ndodhi ***ab intra***, si dhe jashtë çdo konteksti legal: serbet gjatë tërë kohës janë thirrur në parimin e legalitetit duke shpresuar se bota do t'ua njihte të drejtën e kontinuitetit shtetëror me ish-Jugosllavinë. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë: me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë janë krijuar pesë shtete (1991-1992), në ndërkohë që më pastaj janë krijuar edhe tri të tjera (2006-2008), përkatësisht Mali Zi, Serbia dhe Kosova. Në aspektin kushtetues nuk ekziston asnjë kontinuitet mes Kosovës së 17 shkurtit 2008, Kosovës së 2 korrikut 1990 dhe Kuvendit të Kaçanikut (1990): deklarimet e bëra në vigjilje të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë kanë pasur forcë mobilizuese morale të pafund, kurse kjo e fundit paraqet akt konkret që vë në jetë një vullnet konkret mbi formën e ekzistencës politike të Kosovës, i ndërmarrë jashtë çdo rendi juridik ekzistues pararendës, përfshirë këtu rendin e ndërtuar nga ana e OKB-së përmes UNMIK-ut pas datës 10 qershor 1999. Kështu ka thënë GJND në verdiktin e vet për Kosovën. Kështu thonë të gjithë autorët seriozë të së drejtës kushtetuese dhe asaj ndërkombëtare. Kështu e kemi thënë edhe ne në vitin 1997, në polemikën tonë të sipërcekur (cf. **Enver Hasani**, vep e cit. 89-120). Për një trajtim të shkëlqyeshëm dhe shterues të të gjitha rasteve, përfshirë Kosovën, të referendumeve për pavarësi dhe shkëputje përgjatë historisë moderne, lexuesin tonë e udhëzojmë në punimet si vijon: **Peter Radan**, "Secessionist Referenda in International and Domestic Law", botuar në *Nationalism and Ethnic Politics*, vol. 18, no. 1, 2012, fq. 8-21 në fq. 12; **Dahlia Scheindlin**, "Phantom Referendums in Phantom States: Meaningless Farce or a Bridge to Reality?", botuar në *Nationalism and Ethnic Politics*, vol. 18, no. 1, 2012, fq. 65-87 në fq. 68, 73-74; **Matt Qvortrup**, "The History of Ethno-National Referendums 1791–2011", botuar në *Nationalism and Ethnic Politics*, vol. 18, no. 1, 2012, fq. 129-150 në fq. 145-148.

Kapitulli II. E drejta kushtetuese e Kosovës në tranzicion – Periudha e administrimit ndërkombëtar të Kosovës (fq. 229–241)

Përgjithësisht

Ky kapitull përbëhet nga 13 seksione. Vetë titulli është i gabuar sepse nuk mund të ketë të drejtë kushtetuese në një shoqëri që gjendet nën administrimin ndërkombëtar sepse bëhet fjalë për dy koncepte të papajtueshme. Lexuesi mbase mund të ketë pritur që autorët tanë të sqarojnë kuptimin dhe natyrën e administrimit ndërkombëtar, dje dhe sot. Këtë, u mor vesh, nuk kanë mund ta bëjnë sepse një gjë të tillë nuk e kanë bërë as për konceptet themelore të së drejtës kushtetues, për kushtetutën dhe kuptimin e saj, për natyrën juridike dhe origjinën e pushtetit dhe për shumë çështje të tjera themelore të së drejtës kushtetuese. Siç shihet nga ky kapitull, me sa duket preokupim themelor i autorëve tanë ka qenë manipulimi me literaturën e huaj, si dhe citimi fiktiv i saj, se sa prodhimi i një teksti koherent që sqaron një nga një konceptet themelore të së drejtës kushtetuese. Nuk mund të ketë të drejtë kushtetuese në kushtet e administrimit ndërkombëtar: ky i fundit nënkupton konceptin sipas të cilit ushtrohet një pushtet në mënyrë administrative ndaj një territori dhe njerëzve që gjenden në të. Kjo mund t'i referohet një shteti sovran dhe të pavarur, por që ka dështuar në qeverisjen e tij, apo edhe pjesëve të caktuara të shtetit sovran dhe të pavarur që ndaj të cilave ka humbur kontrollin qeverisës. Si në rastin e parë, ashtu dhe në të dytin, bëhet fjalë për administrim me mirëbesim (***bona fide***), si pasojë e okupimit ushtarak dhe tjetër nga forcat e huaja të territorit të një shtetit sovran dhe të pavarur.

Në rastin e **Kosovës**, administrimi ndërkombëtar që ka pasuar okupimin ushtarak është kryer sipas një dokumenti të një organi kompetent ndërkombëtar, **Këshillit të Sigurimit**, me një mandat të qartë të paracaktuar. Në shkencat politike dhe në diskursin politik kjo cilësohet si protektorat, por në gjuhën e së drejtës ndërkombëtare nuk ka emërtim tjetër pos administrim ndërkombëtar me mirëbesim (***bona fide***), i një territori të një shtetit sovran dhe të pavarur. Kjo dallohet nga territoret e a.q. të **internacionalizuara**, të cilat kanë ekzistuar apo janë propozuar për t'u krijuar në

të kaluarën, si pasojë e kontesteve legal lidhur me statusin e një territori të një shteti sovran dhe të pavarur. Në literaturë si rast tipik i kësaj kategorie përmendet **Qyteti i Lirë i Danzingut** (**Gdansk**) në **Poloni**. Ka pasur edhe raste të tjera të ngjashme, si p.sh. **Jerusalemi** dhe **Triestja,** por që në praktikë asnjëherë nuk janë realizuar. Lexuesi udhëzohet për këtë të konsultojë librin e shkëlqyer të **Meir Ydit** me titull ***Internationalised Territories from the "Free City of Cracow" to the "Free City of Berlin.": A Study in the Historical Development of a Modern Notion in International Law and International Relations (1815-1960)*** (botim i A.W. Sythoff: Leyden, 1961, fq. 16-21, por edhe kapitujt e tjerë ku bëhet fjalë për rastet e konkrete të këtyre territoreve që nga viti 1815 e deri në vitet 1950). Edhe më vonë janë prodhuar libra të shkëlqyeshëm që kanë shpjeguar përpjekjet, hezitimet dhe sukseset e OKB-së në administrimin e pjesëve të caktuara të territoreve të shteteve sovrane dhe të pavarura apo edhe të shteteve të tëra sovrane dhe të pavarura në rastet e kolapsit total të rendit dhe ligjit. Në të gjitha rastet, përfshirë këtu edhe propozimet e vendeve sovrane për formën dhe përmbajtjen e administrimit ndërkombëtar të bëra në vigjilje të formimit të OKB-së, autorët e ndryshëm çdoherë kanë vënë në pah një fakt dhe kanë tërhequr vëmendjen për të: natyra juridike dhe origjina e administrimit nën ombrellën e OKB-së nuk mund të kërkohet në shprehjen e vullnetit origjiner të sovranit, por në vullnetin dhe dëshirën e OKB-së për të ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Këtë e shpjegon më bukur se rrallëkush **Simon Chesterman** në veprën e tij të shkëlqyer ***You, the People: The United Nations, Transitional Administration, and State-Building*** (Oxford UP: Oxford, 2004).

Sikundër dihet, në rastin e Kosovës, as Rezoluta 1244 dhe asnjë dokument tjetër nuk ia ka kontestuar titullin juridik (sovranitetin territorial) ish-RFJ-së (Serbia e Mali i Zi) në lidhje me pjesën që ka të bëjë me Kosovën: ajo çka është kontestuar dhe që kontestohet sot e kësaj dite ka qenë sundimi brutal i Kosovës nga regjimi i **Serbisë së Millosheviqit**, dhuna dhe represioni sistematik ndaj shqiptarëve si popullsi shumicë. Kjo gjendje, pas okupimit ushtarak të forcave të NATO-s, bazuar në Rezolutën 1244, është zëvendësuar me një administrim civil ndërkombëtar. E parë nga ky kënd, baza e bazave apo norma e normave, nëse përdorim shprehjet e së drejtës kushtetuese, për administrimin civil në Kosovë pas datës 10 qershor 1999 e deri në ditën e shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, ka qenë Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Marrëveshja e Kumanovës as nuk ka qenë dhe as nuk mund të jetë bazë e asnjë veprimi

nisës për administrim ndërkombëtar në Kosovë. Ky është gabimi themelor i autorëve tanë, i bërë në fq. 230-231 të librit, të cilët besojnë se kjo marrëveshje ushtarake ka qenë nisja e misionit civil dhe tjetër ndërkombëtar në Kosovë. Këtë e sqarojmë në diskutimin tonë në vijim.

Në vijim si më sipër, gabimi i radhës i autorëve tanë, në të cilin fokusohemi në këtë kapitull, gjendet më i shprehur në fq. 239 të librit: këtu autorët konstatojnë dhe besojnë se origjina e pushtetit në Kosovë gjatë fazës së administrimit ndërkombëtar ka qenë e bazuar në sovranitetin popullor dhe ka shprehur vullnetin e sovranit (sic!).

Nga këto dy gabime derivohet edhe narrativi me zigzage, shumë herë kontradiktor dhe i pakuptimtë, që karakterizon këtë kapitull të autorëve tanë. Kjo sepse, këto dy momente përbëjnë esencën e një administrimi ndërkombëtar dhe natyrës së tij juridike. Këtë esencë dhe këtë natyrë duhet ta sqarojë shkenca juridike për lexuesin, jo shkencat e tjera të përafërta me shkencat juridike, të interpretuara me shumë hamendje nga autorët tanë.

Të shohim si duket kjo në rreshtat në vijim, gjithnjë duke mos harruar që të evidentojmë sjelljen e papranueshme të autorëve tanë me literaturën dhe burimet e huaja, të cilat i kanë manipuluar si gjatë prodhimit të tekstit në kapituj paraprak: nuk ka asnjë dyshim që manipulimi me literaturën dhe citimi fiktiv i saj përbëjnë një aktivitet konstant të ndjekur nga autorët e librit që është objekt i analizës sonë kritike.

Analiza kritike

Pas seksionit të parë me titull "Vështrime të përgjithshme", ku autorët manipulojnë dhe citojnë në mënyrë fiktive e pa asnjë relevancë për temën tri burime të huaja (cf. fusnotat 688-690), autorët tanë nisin diskutimin për fazën e parë të administrimit ndërkombëtar: seksioni i dytë titullohet "Faza e parë e administrimit ndërkombëtar të Kosovës 1999-2001" (fq. 230-231), kurse i dyti në vijim si "Marrëveshja e Kumanovës dhe tërheqja e forcave serbe nga Kosova" (231-232). Në seksionin e dytë po ashtu bien në sy manipulimet me literaturën në fusnotat 693 & 695. Kjo, megjithatë, nuk është e vetmja esencë e problemit. Teksti i prodhuar është i pasaktë dhe nuk bazohet aspak në literaturën që citohet në mënyrë manipulative: po të kishin përpunuar si duhet literaturën në fjalë të autorëve të huaj, autorët tanë do ta kishin prodhuar një tekst profesional dhe të saktë në aspektin shkencor. Duke folur për fazën e parë, autorët konstatojnë, *inter*

alia, si vijon:

> Momenti i fillimit të fazës së parë të zbatimit të Rezolutës 1244 dhe administrimit ndërkombëtar lidhet me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes tekniko-ushtarake të Kumanovës. Siç u theksua kjo marrëveshje është e lidhur në mes të Ushtrisë Jugosllave dhe NATO-s, si dhe e njëjta përcakton modalitetet e tërheqjes së forcave serbe nga Kosova.

Këtë konstatim autorët e përforcojnë sërish në seksionin në vijim që flet për marrëveshjen në fjalë, duke theksuar se: "Faza e parë e administrimit ndërkombëtar të Kosovës ka filluar me miratimin e rezolutës 1244 dhe nënshkrimin e marrëveshjes së ashtuquajtur të Kumanovës, si marrëveshje Tekniko-Ushtarake [...]". Më tutje autorët bëjnë fjalë për kapitullimin e Serbisë dhe njohjen e këtij kapitullimi nga ana e vet Serbisë.

Në përgjithësi, diskutimi i autorëve tanë në këto dy seksione pak i ngjason diskutimit juridik: kryesisht operohet me terma laike për të përshkruar gjendjen vërtetë të rënd të popullsisë në Kosovën e asaj kohe dhe gjëra të ngjashme. Këto janë gjëra që duhen trajtuar dhe studiuar gjetiu. Kjo, megjithatë, nuk ka ndonjë rëndësi të madhe.

Ajo çfarë ka rëndësi është se studentit e lexuesit i ofrohet një sqarim që fare nuk qëndron, krejt kjo në emër të profesionit dhe dijes juridike: Marrëveshja e Kumanovës përbën një aneks të thjeshtë të Rezolutës 1244 dhe nuk ka paraqitur asnjëherë dhe në asnjë rrethanë pjesë të administrimit dhe të administratës ndërkombëtare në Kosovë. Vendi ynë, për fat të keq, ka pasur një histori të hidhur me administrimin ushtarak në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, gjendje që shpjegohet shumë mirë nga **Noel Malcolm** në fq. 314-319 të librit të tij ***Kosovo: A Short History*** (New York UP: New York, 1999). Ka edhe libra tjerë me bollëk, të autorëve vendorë, që po ashtu përshkruajnë gjendjen e administrimit ushtarak të asaj kohe. Në aspektin juridik asnjëherë, as dje dhe as sot, marrëveshjet tekniko-ushtarake nuk mund të shërbejnë si bazë për administrim civil: kështu ka qenë çdoherë gjatë historisë. Ky lloj i marrëveshjes në të drejtën ndërkombëtare i nënshtrohet rregullave të tjera të krijimit të marrëveshjeve ndërkombëtare; për nga natyra juridike këto marrëveshje kanë natyrë të përkohshme dhe i shërbejnë ndërprerjes së armiqësive në një pjesë të frontit; kur kanë të bëjnë me krejt vijën e frontit apo me krejt teatrin e luftës, atëherë këto marrëveshje përbëjnë hyrje në marrëveshjen e paqes dhe likuidimin e gjendjes së armiqësive mes palëve. **Marrëveshja e Kumanovës** bën pjesë në grupin e marrëveshjeve ushtarake lokale, që kanë pasur për qëllim ndër-

prerjen e armiqësive në pritje të një marrëveshje paqësore dhe pajtimi mes palëve të karakterit civil. Si e tillë, marrëveshja në fjalë është lidhur mes komandantëve ushtarak dhe kështu lidhen këto çdoherë; në momentin e dhënies së pëlqimit nga ana e Serbisë për ndërprerjen e armiqësive, ka pasur Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, që shërben si zëvendësim për marrëveshjen e paqes, si një marrëveshje civile që likuidon pasojat e tërësishme të konflikti të armatosur dhe armiqësive mes palëve, në rastin konkret mes RFJ-së (Serbi dhe Mali i Zi), NATO-s dhe vendeve anëtare të NATO-s një nga një. Jashtë kësaj, asnjë efekt tjetër nuk ka pasur dhe nuk mund të ketë **Marrëveshja e Kumanovës**. Këtë autorët tanë kanë mund ta mësojnë nga leximi i shpejt i librit ***E drejta ndërkombëtare publike*** (cilido botim), të autorit **Zejnullah Gruda** apo të librit homonim të cilitdo autor serioz. Në pjesën mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare, ku flitet për hapësirën e zhvillimit të konflikteve të armatosura dhe armiqësive, lexuesi zakonisht gjen diskutimin mbi marrëveshjet ushtarake dhe vendin e tyre në të drejtën ndërkombëtare humanitare. Hapi i parë, për pasojë, që ka futur në jetë administrimin civil ndërkombëtar ka qenë miratimi i Rezolutës 1244: çdo akt juridik i nxjerrë më pastaj nga ana e Përfaqësuesit të Special të Sekretarit të Përgjithshëm (më tej shkurt: PSSP), siç dihet, ka përmbajtur klauzolën që thoshte se efektet e tyre juridike konsideroheshin të prodhuara që nga 10 qershori 1999 (dita e miratimit të Rezolutës 1244).

Duke u munduar të ndërtojnë një të drejtë kushtetuese në kushtet e administrimit ndërkombëtar në Kosovë, autorët kanë krijuar koncepte që nuk i shkojnë natyrës së administrimit ndërkombëtar. Në këtë kategori hyn analiza e tyre sipas së cilës origjina e pushtetit të administratës ndërkombëtare në instancë të fundit duhet kërkuar në vullnetin e sovranit të Kosovës. Kjo bëhet në kontekstin e trajtimeve të tyre të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (më tej shkurt: Korniza Kushtetuese), një rregullore e UNMIK-ut e derivuar nga autoriteti suprem dhe unik i PSSP në sferën legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Kështu, megjithatë, nuk mendojnë autorët tanë, të cilën në fq. 239 konstatojnë si vijon:

> Sipas Kornizës Kushtetuese, Kosova kishte ndërtuar një sistem institucional funksional. Për më tepër për nga përmbajtja Korniza Kushtetuese ishte një kushtetutë e mirëfilltë, ajo dallonte nga kushtetuta në kuptimin e plotë të fjalës vetëm emërtimi. Korniza Kushtetuese kishte instaluar një rend kushtetues dhe formë të qeverisjes tipike parlamentare, ku sistemi shtetëror bazohej në parimin e sovranitetit

> populloor dhe ndarjes së pushteteve në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor [...].

Në ndërkohë që është shumë e vërtetë që Korniza Kushtetuese ka instaluar në Kosovë një sistem tipik parlamentar të qeverisjes, ka promovuar ndarjen e pushteteve dhe ka nisur procesin e ndërtimit të institucioneve funksionale të Kosovës, esenca e origjinës së tërë këtij prodhimi institucional të autoriteteve publike nuk ka qenë dhe nuk ka mundur të jetë sovrani por vullneti i bashkësisë ndërkombëtare i shprehur përmes Rezolutës 1244 të KS të OKB-së. Kjo origjinë e këtij pushteti ka pasur për pasojë edhe faktin tjetër: në ndërkohë që ka pasur ndarje të pushteteve, balancimi i tyre ka munguar nisur nga fakti se tri pushtete kanë qenë në duart e PSSP-së. Gjithashtu, pushteti absolut dhe i pakontestueshëm i PSSP-së ka bërë që sistemi parlamentar në Kosovë të jetë vetëm në formë, ndërsa vetë parlamenti nuk ka mundur të jetë as *de facto* e as *de jure* përfaqësues i vullnetit të sovranit të Kosovës, duke shërbyer deri në fund vetëm si ligjvënës që ekzekuton vullnetin suprem të bashkësisë ndërkombëtare, përkatësisht vullnetin konsensual të pesë vendeve anëtare të përhershme të KS të OKB-së. Kjo është arsyeja që në këtë kohë në Kosovë nuk ka pasur kuptim themelimi i një gjykate kushtetuese për të mbrojtur kushtetutshmërinë. Kjo sepse kushtetutshmëria dhe mbrojtja e saj kanë kuptim vetëm atëherë kur norma e normave ka kufij nacionalë të identifikueshëm të krijimit, realizimit dhe zhvillimit të saj progresiv. Ky nuk mund të jetë rasti me jetën juridike nën administrimin ndërkombëtar. Kjo ka qenë kështu pa asnjë përjashtim në tërë përvojën e administrimeve ndërkombëtare nën ombrellën e OKB-së. Roli dhe pozita e administrimit ndërkombëtar në Kosovë, sipas Rezolutës 1244, ka qenë që të krijojë kushtet për një vetëqeverisje substanciale të Kosovës deri në zgjidhjen e statusit të saj përfundimtar, përkatësisht deri të krijohen institucione e organe të përhershme që do të marrin përgjegjësinë sipas një marrëveshje politike. Këtë e kanë të qartë autorët tanë dhe e sqarojnë relativisht bukur, gjë që nuk është rasti kur duan të ndërtojnë një kushtetutë dhe të drejtë kushtetuese kosovare në kushtet e administrimit ndërkombëtar. Kaq! Nuk është turp që studentit e lexuesit t'i jepet pasqyra e qartë e gjendjes juridike në Kosovë në kohën e administrimit ndërkombëtar: japonezët, gjermanët dhe italianët pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore kanë pasur institucione dhe përvoja të administrimit nga tjerët dhe e evidentojnë në librat e tyre të historisë dhe të së drejtës kushtetuese. Përvojë të tilla kanë

pasur edhe shumë nga popujt e tjerë pas Luftës së Dytë Botërore dhe e reflektojnë në librat e tyre (Kongo, Nigeria, Koreja, Qipro, Libani, Ruanda, Bosnjë-Hercegovina e Kroacia dhe kështu me radhë).

Kapitujt III–IV. Procesi i zgjidhjes së statusit final të Kosovës (pavarësisë së Kosovës) dhe ndikimet në rendin kushtetues aktual të Republikës së Kosovës (fq. 243–254). Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës (Pakoja e Ahtisarit) si rezultat i bisedimeve të Vjenës (255–273).

Përgjithësisht.

Këtu trajtohen dy kapituj, kapitulli i tretë dhe i katër, për arsye se kanë shumë cilësi të përbashkëta. Në vijim do të veçojmë vetëm dy cilësi të tilla të përbashkëta, në ndërkohë që në pjesën analitike të kritikës ndalojmë në tri aspekte konkrete, në të cilat shpërfaqen hapur dhe në shikim të parë mosnjohja profesionale e koncepteve themelore nga ana e autorëve dhe atë sa u përket:

- e para, statusit të **Pakos Ahtiasari** në rendin juridik-kushtetues kosovar dhe marrëdhënia e saj me Kushtetutën e Kosovës;
- e dyta, dispozitave të **Pakos Ahtisaari** që kanë të bëjnë me borxhin e jashtëm të Kosovës; dhe
- e treta, dispozitave të **Pakos Ahtisaari** që kanë të bëjnë me kufijtë e Kosovës dhe mënyrës së përcaktimit të tyre në të ardhmen.

Kapitulli i tretë përbëhet nga tetë seksione, kurse i katërti nga 20 sosh. E përbashkëta e këtyre dy kapitujve është materia që diskutohet: e para, procesi që ka çuar në zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës; dhe, e dyta, dokumenti i prodhuar nga procesi i zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës, i njohur si Pakoja Ahtisaari. Ajo që bien në sy, megjithatë, konsiston në mosqenien materie kushtetuese e lëndës së trajtuar në kapitullin e tretë: aty diskutohet në mënyrë kaotike dhe në mënyrë të koklavitur nisja e procesit dhe momentet kyçe të atij procesi, aq sa vështirë që studenti e lexuesi mund të marrin vesh diçka. Fjalori i përdorur është vende-vende politikanesk, kurse narrativi i prodhuar në këtë pjesë të tekstit esencialisht është ai i autorit **Marc Weller** dhe dy tekstet që janë autorësi e tij: autorët tanë, këto dy tekste i parafrazojnë si të vetat, në të shumtën e

kohës, duke cituar autorë dhe burime tjetra në gjuhën angleze (cf. në veçanti fusnotat dhe tekstin që i shoqëron, për sa vijon: fus. nr. 731-732; 734-735; 743-744747; 773; 780-781; 783 etj.). Këtë metodë pune e kemi hasur edhe në kapituj pararendës, por nuk kemi dashur të tërheqim vëmendjen e lexuesit tonë në metodën e punës, duke dashur që më shumë të fokusohemi në gabimet profesionale dhe shkencore të natyrë së hapur dhe të drejtpërdrejtë.

Cilësi tjetër e përbashkët, në vijim si më sipër, e dy këtyre kapitujve është edhe ajo se gjuha e përdorur në shpjegimin e dokumenteve burimore parastatusore, siç janë dokumenti i njohur "Standardet para Statusit" apo Pakoja Ahtisaari, paraqet një gjuhë që nuk është gjuhë kushtetuese, ashtu siç do të priste me të drejtë studenti e lexuesi i një libri që pretendon të jetë libër mbi të drejtën kushtetuese. Në të shumtën e rasteve, autorët analizojnë fenomenet që kanë lindur gjatë procesit të bisedimeve apo që janë reflektuar në Pakon Ahtisaari me terma politikaneskë dhe me një gjuhë të përditshme që përdorin laikët. Jo rrallë, fjalori i përdorur është folklorik dhe me premisa të thella diskriminuese ndaj komuniteteve pakicë në Kosovë (cf. në veçanti fq. 264-265).

Të shohim si duket gjendja në këta dy kapituj, në ato aspekte që i kemi veçuar për analizë konkrete.

Analiza kritike

Në lidhje me Pakon Ahtisaari dhe vendin e saj në rendin kushtetues kosovar është diskutuar në analizën tonë për kapitujt pararendës. Siç kemi vërejtur atje, autorët tanë kanë vështirësi konceptuale për të kuptuar se çfarë përbën ***grundnorm*** apo **normë mbi normat** në kontekstin kosovar. Cila ka një status të tillë: Pakoja Ahtisaari, Deklarata e Pavarësisë apo Kushtetuta? Kjo vështirësi sërish shpërfaqet tek autorët tanë në fq. 258 & 273. Në paragrafin e parafundit të fq. 258 autorët e cilësojnë kushtetutën e re të Kosovës si "kushtetutën që themelonte shtetin", kurse në fq. 273 ritheksojnë mendimin e tyre sipas të cilit Pakoja Ahtisaari "ka qenë në fuqi de jure deri në vitin 2012, këtë fuqi ia kishte dhënë vetë Kushtetuta e Kosovës". Shkëputëm këto dy konstatime sepse, si të tilla, përshkojnë shumicën e konstatimeve konfuze të autorëve lidhur me normën e normave në kontekstin kosovar, pa u ndaluar në disa segmente të tjera që janë po ashtu lëshime serioze (si p.sh. trajtimi i tyre i politikës së UNMIK-ut "Standardet para Statusit" etj.).

Sikundër kemi theksuar më herët, Deklarata e Pavarësisë përbën normën e normave në kontekstin kosovar, si në aspektin kushtetues ashtu dhe në atë juridiko-ndërkombëtar: në aspektin e parë, sepse përbën themelin për nxjerrjen e Kushtetutës së Kosovës, kurse në aspektin e dytë sepse paraqet një zotim juridiko-ndërkombëtar të Kosovës për të nxjerrë një kushtetutë të re që do të ngërthente në vete parimet dhe normat e Pakos Ahtisaari, në mesin e shumë detyrimeve të tjera të ndërmarra. Ka qenë **Deklarata e Pavarësisë** ajo që i ka dhënë fuqi **Paktit Ahtisaari** akoma pa u miratuar kushtetuta, e cila vetë nuk është asgjë tjetër pos vënie në jetë dhe operacionalizim i zotimit të marrë më datën 17 shkurt 2008. Ai zotim i marrë me këtë datë ngërthen edhe dokumentin e njohur si **Pakoja Ahtisaari**, normat dhe parimet e së cilës janë operacionalizuar përmes Kushtetutës së 15 prillit 2008. Kjo mund të duket tautologji pa ndonjë kuptim, diçka teorike dhe e pavlerë, por megjithatë nuk është e tillë: këtë konstatim tonin katërçipërisht e kemi marrë nga leximi me kujdes i konstatimeve të mendimit të **GJND**-së për Kosovën. Ky organ i drejtësisë ndërkombëtare e ka dhënë verdiktin e vet që nuk dallon asnjëherë nga kjo që ne themi këtu duke ripërsëritur esencën e atij verdikti. Në fakt, nuk ka vend që nuk e di se cila është norma e parë kushtetuese me të cilën ka nisur jeta e tij e re si shtet sovran dhe i pavarur. Kosova nuk guxon të ketë paqartësi të kësaj natyre: duhet njëherë e mirë të dihet se cila ka qenë, cila është e cila do të jetë natyra juridike e **Deklaratës së Pavarësisë** në rendin kushtetues të Kosovës. Përgjigja në këtë është fare e lehtë sepse e ka sqaruar në mënyrë të mrekullueshme **GJND** në mendimin e saj, historik për Kosovën, të datës 22 korrik 2010.

Të vazhdojmë kritikën tonë me aspektin e dytë të gabimeve të autorëve tanë që lidhet me borxhin e jashtëm, për të ecur pastaj me aspektin e fundit për kufijtë e Kosovës.

Aneksi VI i Pakos Ahtisaari ka gjithsej tri nene. Autorët për këtë flasin në mënyrë krejt të gabuar në fq. 266. Në shtjellimin e tyre aty, lexuesi dhe studenti e kanë të vështirë të marrin vesh se për çfarë bëhet fjalë. Në fillim ata besojnë se Kosova trashëgon një pjesë të borxhit të RSFJ-së (Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë), gjë që nuk është ashtu. Sikundër dihet, rasti i krijimit të Kosovës është *sui generis*. Në këtë cilësi të veçantë dhe të papërsëritshme hyn edhe trashëgimi ekskluzivisht vetëm i Serbisë në të gjitha sferat e trashëgimit të shteteve (traktatet, kufijtë, borxhi i jashtëm dhe asetet, prona shtetërore dhe arkivat, pensionet dhe të drejtat e fituara dhe çështjet e tjera). Autorët thonë se sipas pretendimeve të Serbisë

Kosova ka mbi 800 milion borxh të jashtëm; thonë se ka paqartësi rreth borxhit që duhet trashëguar dhe se kryesisht ka të bëjë me borxhet që kanë qenë të dedikuara për projektet në Kosovë; thonë se donatorët do të falin borxhin e Kosovës; thonë se vlera e borxhit të Kosovës do të varet nga kreditorët, pra se nuk ekziston asnjë kriter për ndarjen dhe marrjen e borxhit; thonë e çfarë nuk thonë autorët tanë! Krejt thëniet e tyre janë me hamendësim brutal, që nuk shkon në një tekst universitar. Në ndërkohë që ekziston një metodologji e saktë për marrjen dhe ndarjen e borxhit të jashtëm, e cila është zbatuar dhe ka vlerë për krejt territorin e RSFJ-së, përfshirë territorin e shtetit të Kosovës. Këtë e ka konstatuar **Pakoja Ahtisaari** në nenin e parë të Aneksit VI, duke sqaruar se e njëjta procedurë do të ndiqet edhe në trashëgimin mes Kosovës dhe Serbisë, kurdo që të vijë deri te një rast i tillë. Kjo, në fakt, kështu do të ndodhë. Pra, fjala është për zbatimin e standardeve të njëjta që janë zbatuar me rastin e mbylljes së procesit të trashëgimit të RSFJ-së. Mbyllja në fjalë ka ndodhur në vitin 2001 me nënshkrimin e marrëveshjes mbi trashëgimin mes pesë ish-republikave jugosllave, të krijuara si shtete sovrane dhe të pavarura pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë. Titulli në origjinal i saj është **Agreement on Succession Issues and Annexes A to G**, nënshkruar në Vjenë më 29 qershor 2001 mes Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë (më pas quajtur Unioni Serbi dhe Mal i Zi, i cili formalisht ka përfshirë dhe Kosovën në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të datës 10 qershor 1999). Në tekstin e mëtejmë i referohemi si MT.

Të shohim në vijim se cila, pra, qenka procedura dhe metodologjia që është ndjekur në rastin e RSFJ-së (por edhe dy federatave të tjera komuniste, Bashkimi Sovjetik dhe Çekosllovakia) në lëmin e trashëgimit. Ne këtu do ta tregojmë vetëm pjesën që ka të bëjë me borxhin e jashtëm (asetet dhe detyrimet financiare). Lexuesin tonë e udhëzojmë që për këtë materie të gjejë kohë dhe të konsultojë artikullin e detajuar në gjuhën shqipe, botuar në Kosovë, të autorit të këtyre rreshtave, në ndërkohë që një version i tij origjinal në gjuhën angleze është botuar në SHBA në vitin 2006 në ***Thomas Jefferson Law Journal*** (vol. 29, no. 1, Fall 2006, fq. 111-150). E kemi fjalën për shkrimin tonë me titull **Specifikat e trashëgimit të ish Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të**, botuar në revistën ***E Drejta/Law*** (viti XXXV, nr. 1, 2012, Prishtinë, fq. 7-54). T'i kthehemi tani temës së trashëgimit të borxhit të jashtëm.

Asetet dhe detyrimet financiare janë pjesa më e parregulluar me **Kon-**

ventën e Vjenës mbi Trashëgimin e Pronës, Arkivave dhe Borxhit të Jashtëm (1983), së cilës i referohemi si KV II, kurse praktika e bazuar në të deri më 1991 ka qenë kryesisht në kontekstin kolonial. Si KV II, ashtu dhe praktika shtetërore e kësaj kohe, kanë mangësi në definimin e borxhit shtetëror dhe në parimin sipas të cilit duhen ndarë asetet dhe borxhet e shtetit pararendës. Në pikëpamje të borxhit, KV II pranon si borxh shtetëror vetëm nëse kreditori është "shtet, organizatë ndërkombëtare ose subjekt i së drejtës ndërkombëtare", kurse për mënyrë të ndarjes ofron "ekuilibrin mes borxhit që merret dhe aseteve që trashëgohen". Sikundër mund të vërehet, këtu merret parasysh vetëm interesi i vendeve trashëgimtare të cilat marrin përsipër borxhin (personi i debitorit), jo interesi i atyre të cilëve u duhet paguar borxhi (personi i kreditorit). Interesat e kreditorëve privat të cilët nuk janë "subjekte të së drejtës ndërkombëtare" do të ishin dëmtuar rëndë nëse do të ishte ndjekur kjo praktikë. Për të evituar zbatimin praktik të këtij definicioni dhe të kësaj praktike të mëparshme, organizatat ndërkombëtare qeveritare, si p.sh. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) etj., por edhe vendet kreditore ("Klubi i Parisit") dhe kreditorët komercialë ("Klubi i Londrës") kanë ndërhyrë fuqishëm në procesin e ndarjes së aseteve dhe të borxhit të jashtëm, si në ish-Jugosllavi ashtu dhe në rastet e Bashkimit Sovjetik dhe Çekosllovakisë. Kjo ndërhyrje ka qenë interes jo vetëm i faktorëve të sipërcekur ndërkombëtar por edhe i vendeve trashëgimtare për shkak të nevojës së tyre për integrim në tregun e kapitalit ndërkombëtar dhe zhvillimit të tyre ekonomik, një gjendje kjo e ndryshme nga koha e trashëgimit kolonial. Në këtë pikëpamje duhen shikuar hapat e Sllovenisë dhe të ish-republikave të tjera jugosllave, përjashtim ish-RFJ-në (Serbia e Mali i Zi), të cilat në periudhën prej vitit 1993 deri më 1996 kanë bërë marrëveshje dypalëshe me vendet e "Klubit të Parisit" dhe kreditorët e "Klubit të Londrës" për pagesën e pjesës së borxhit të tyre sipas proporcioneve të FMN-së (Proporcionet e FMN-së kanë qenë për sa vijon: Bosnjë-Hercegovina 13,20 për qind, Kroacia: 28,49 për qind, Maqedonia: 5,40 për qind; Sllovenia: 16,39 për qind; dhe RFJ: 36,52 për qind). Çelësin e FMN-së e kanë pranuar edhe institucionet e tjera qeveritare, ndërkombëtare dhe komerciale, përfshirë dhe Bankën Botërore, kurse vetë MT në mënyrë shprehimore thotë, në nenin 3 të Aneksit C, se "ndarjet e tilla të bëra më herët janë definitive dhe nuk mund të rihapen dhe të diskutohen nga asnjëri prej vendeve trashëgimtare në kontekstin e trashëgimit", duke ia lënë RFJ-së pjesën e borxhit të saj të paalokuar dhe

asetet që i takojnë sipas përqindjes së njëjtë sikur trashëgimtarëve të tjerë. Shenjat e para se do të ndiqet një rrugë e tillë e ndarë për zgjidhjen e problemeve të aseteve dhe të borxheve financiare të RSFJ-së i kishte dhënë **Komisioni Badinter**, i cili pati theksuar, në mes tjerash, se mosbindja ndaj zgjidhjes me marrëveshje të problemeve të trashëgimit nga ana e ndonjërit prej shteteve trashëgimtare nuk është pengesë që tjerët të fillojnë një proces të tillë me ato vende trashëgimtare që janë kooperativ në këtë proces.

Në vijim si më sipër, MT ka pranuar çelësin e institucioneve financiare ndërkombëtare si kriter për ndarjen e aseteve dhe borxhit të jashtëm të RSFJ-së, duke lënë të paprekur marrëveshjet individuale të cilat trashëgimtarët e ish-Jugosllavisë i kanë lidhur gjatë periudhës 1993-1996 me vendet kreditore, bankat komerciale dhe organizatat tjera ndërkombëtare financiare. Vetëm në këtë mënyrë ka pasur mundësi që të arrihet deri te realizimi i parimit të drejtësisë në kontekstin e RSFJ-së, jo duke zbatuar KV II dhe praktikën e kontekstit kolonial. Ndërhyrja e institucioneve financiare ndërkombëtare ka qenë vendimtare në arritjen e marrëveshjes mes palëve trashëgimtare si në RSFJ, por edhe në Bashkimin Sovjetik dhe Çekosllovaki, sepse ka përcaktuar qartë kriteret e ndarjes së drejtë dhe ka imponuar disiplinë në këtë proces. Në rastin e RSFJ-së, kjo reflektohet fare qartë në Aneksin A (me dy shtojcat e tij) të MT-së.

Sikundër u tha, në parim MT ka pranuar çelësin e FMN-së me rastin e ndarjes së aseteve të RSFJ-së. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se palët në tërësi kanë zbatuar çelësin e përcaktuar nga FMN, i cili qe bazuar në disa faktorë, siç janë kontributi i ish-republikave jugosllave në prodhimin e përgjithshëm shoqëror, në eksport të ish-Jugosllavisë, si dhe fuqia e tyre ekonomike karshi njëra-tjetrës (një zbatim të shumë faktorëve e kanë aplikuar edhe vendet e Bashkimit Sovjetik, kurse praktika e Çekosllovakisë e ndarjes së aseteve dhe borxheve financiare bazohet vetëm në një faktor: madhësia e popullsisë së vendeve trashëgimtare). Modifikimet e çelësit të ndjekur nga FMN u sanksionuan në nenin 5 (2) të MT. Ato në fund ngelën kështu: Bosnjë-Hercegovina, 15.5 për qind; Kroacia, 23 për qind; Maqedonia, 7.5 për qind; Sllovenia, 16 për qind; dhe RFJ 38 për qind. Kjo ndarje ka vlejtur në veçanti për këto asete: për 27 për qind të kapitalit të ish-Bankës së RSFJ-së për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar; për shumën neto të kërkesave të Bankës Nacionale të RSFJ-së ndaj vendeve të tjera; për asetet e huaja financiare, siç janë paratë e gatshme, ari dhe metalet e tjera të çmueshme; llogaritë e depozituara dhe sigurimet e drejtpërdrejta ose bashkërisht me bankat e huaja të mbajtura nga RSFJ ose

Banka Nacionale e RSFJ-së; dhe, në fund, për asetet financiare të jashtme aktualisht të panjohura për palët.

Mënyra si është bërë ndarja e borxhit të jashtëm të RSFJ-së paraqet risi në disa drejtime. Në rend të parë, vlen të theksohet se palët në MT kanë pranuar çelësin e FMN-së edhe për ndarjen e borxheve. Në rend të dytë, ndarja e borxhit të jashtëm në MT nuk ndjek rrugën e KV II sipas së cilës duhet të ketë një ekuilibër mes aseteve që trashëgohen dhe borxhit që merret përsipër nga trashëgimtari. Zbatimi i kësaj formule është provuar në kontekstin e Bashkimit Sovjetik dhe Çekosllovakisë, por pa sukses. Kreditorët e jashtëm nuk kanë pranuar një gjë të tillë dhe kanë insistuar në përgjegjësinë e solidare apo të përbashkët (*joint and several liability*). Mënjanimi i kësaj klauzole është bërë i mundur vetëm kur kreditorët e jashtëm kanë vërejtur se vendet trashëgimtare të ish-federatave socialiste janë serioze në marrjen përsipër të borxhit të tyre të paalokuar (borxhin federal). Ky ka qenë një proces i vështirë, i komplikuar dhe i gjatë. Ky borxh, në praktikën standarde të së drejtës ndërkombëtare, nuk përfshinte as borxhin lokal (të kontraktuar nga autoritetet regjionale, ish-republikat dhe krahinat autonome) e as borxhin e lokalizuar (të kontraktuar nga ish-federatat komuniste në dobi të autoriteteve regjionale, ish-republikave dhe krahinave autonome). Këto dy lloje të borxhit kalojnë në mënyrë automatike në barrë të shteteve të reja trashëgimtare sipas rregullës së "përfituesit të fundit" – pra, kush ka qenë përfitues nga borxhi i tillë. Shënojmë për lexuesin tonë se borxhi i jashtëm publik në të drejtën ndërkombëtare ndahet në **borxhin nacional**, **borxhin lokal** dhe në **borxhin e lokalizuar**. Borxhi nacional është borxhi për të cilin përgjigjet në mënyrë ekskluzive shteti. Në rastin e ish-federatave socialiste, ai quhet borxh federal. Përveç kësaj ndarje, borxhet nganjëherë ndahen edhe në borxhe të a.q. **odioze** (borxhet e marra për qëllim të zhvillimit të operacioneve luftarake dhe për shuarjen e kryengritjes), të cilat nuk mund të jenë objekt trashëgimi, dhe borxhet e ndërmarrjeve publike, trashëgimi i të cilave është mjaft i diskutueshëm në praktikën e shteteve.

Kjo mënyrë e ndarjes së borxhit të paalokuar të ish-Jugosllavisë ka nënkuptuar se ndarja e kryer borxhit të paalokuar të ish-Jugosllavisë, sipas çelësit të FMN-së, si dhe veprimet e kryera dypalëshe mes FMN, Bankës Botërore, vendeve të "Klubit të Parisit", si dhe bankave komerciale të "Klubit të Londrës", paraqesin një zgjidhje të përhershme dhe të mbyllur. Këtë e ka thënë në mënyrë shprehimore MT në nenin 3 parag. 3, Aneksi C, kurse në paragrafin e dytë të po këtij neni theksohet se palët nuk mund

të ndërmarrin asnjë veprim ligjor kundër njëra-tjetrës ose të hapin ndonjë procedurë karshi njëra-tjetrës për kërkesat që kanë të bëjnë me kërkesat financiare të cilat lidhen me detyrimet ndaj Klubit të Parisit ose Klubit të Londrës. Kjo është bërë për të siguruar vendet e Klubit të Parisit dhe kreditorët komercialë të Klubit të Londrës se mosmarrëveshjet eventuale mes palëve nuk do të reflektohen në asnjë mënyrë në marrëveshjet e arritura bilaterale mes kreditorëve të sipër cekur dhe ish-republikave jugosllave. Mungesa e kësaj klauzole sigurisht që do ta kishte vënë në lëvizje rikthimin e sistemit të "përgjegjësisë se ndarë dhe të përbashkët" (*joint and several liability*) të ish-republikave jugosllave.

Kosova nuk përbën përjashtim nga kjo qasje si më sipër, pra nga qasja e zbatuar ndaj ish-Jugosllavisë për sa i takon aseteve dhe detyrimeve financiare. Këtë e ka bërë të qartë Pakoja Ahtisaari në aneksin VI si më sipër. Nuk pranohet si mënyrë ndarje ndjekja e "ekuilibrit mes borxhit që merret dhe aseteve që trashëgohen" nga neni 41 i KV II e as zbatimi i parimit të "përgjegjësisë solidare apo të përbashkët" (*joint and several liability*) për arsye se Kosova është e fundit si shtet sovran dhe i pavarur që del nga territori ish-jugosllav më 17 shkurt 2008. Kjo do të thotë se karshi Kosovës qëndron një proces i mbyllur i trashëgimit shtetëror të RSFJ-së i bazuar në MT, kurse Kosova si shtet nuk mund të trashëgojë më RSFJ-së, por vetëm Republikën e Serbisë. Kjo më tutje nënkupton se formalisht nuk mund të zbatohet MT, por që në esencë, sa u takon aseteve dhe detyrimeve financiare, por edhe kufijve dhe disa segmenteve të tjera, në tërësi do të ndiqet rruga dhe fryma e njëjtë me atë të ndjekur me rastin e zbatimit të MT-së. Këtë kuptim e ka dispozita e nenit 2 të Aneksit VI të Pakos Ahtisaari, të cilën autorët tanë nuk e kanë të qartë dhe e interpretojnë sikur fjala është për borxhin e ish-RSFJ-së të cilin e trashëgon Kosova.

Se gjendja është si më sipër, shihet qartë nga qarkullimi i dokumentacionit tejet sekret të FMN-së, Bankës Botërore, që ngërthen edhe detyrimet ndaj "Klubit të Parisit" dhe "Klubit të Londrës". Në këtë dokumentacion me saktësi përcaktohet shuma e borxhit aktual të paalokuar të Kosovës, i cili kap shumën afro 689 milion euro. (Cf. **Enver Hasani**, art. i cit., fq. 39, fusnota nr. 95). Borxhi i alokuar i Kosovës nuk është kontestues. Kjo domethënë se në shumën e sipërcekur hyn edhe shuma nga borxhi i alokuar: Kosova në mënyrë automatike ka trashëguar borxhin e tillë si "përfitues i fundit" dhe kryesisht ka të bëjë me dy-tri kredi të marra nga Banka Botërore në mesin e viteve 1970. Këtu e kam fjalën për borxhin regjional të cilin Kosova vetë sipas Kushtetutës së vitit 1974 ka pasur të

drejtë ta kontraktojë. Mirëpo, në sasinë e borxhit të lokalizuar, të cilin RSFJ e ka kontraktuar në emër të Kosovës hyjnë edhe shumë kontraktime të tjera të kryera për ose në emër të Kosovës me qëllim të zhvillimit të bujqësisë dhe promovimit të ndryshimeve strukturore në ekonominë e atëhershme të Kosovës. Tekstet e këtyre marrëveshjeve duhet të gjenden në arkivat e Beogradit dhe të ish-republikave jugosllave (kopjet e tyre), sepse ato kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e borxhit (në mënyrë automatike) të alokuar të Serbisë të marrë në emër të (territorit) të Kosovës sipas dispozitave të MT.

Duke folur për aneksin VIII të Pakos Ahtisaari (fq. 268), autorët në mënyrë nebuloze flasin për kufijtë e Kosovës, duke hutuar studentin e lexuesin sa i përket statusit të kufijve tonë me Maqedoninë. As që bëhet fjalë që studenti e lexuesi të gjejë diçka konkrete rreth situatës që u krijua me Malin e Zi përgjatë viteve 2015-2017, as lidhur me rrugën që duhet ndjekur nga ana e Kosovës në vijim të caktimit të kufirit tonë me fqinjin verior, Serbinë. Kjo ka rëndësi të theksohet sepse Kosova, sikundër e kemi sqaruar më herët, përmes pranimit në Kuvend të Pakos Ahtisaari ka marrë detyrim ndërkombëtar të njëanshëm për vënien e saj në jetë. Kjo përfshinë edhe çështjen e kufijve, në fakt në veçanti kjo ka rëndësi për sferën e kufijve sepse u jep siguri fqinjëve dhe krejt garantuesve të integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës se Kosova nuk do të ketë pretendime territoriale ndaj tyre. Kjo është arsyeja pse dispozita për kufijtë është vënë në aneksin që flet për sigurinë. Në fakt, autorët tanë, në vitin 2018, flasin për Planin Ahtisaari dhe kufijtë e Kosovës sikur të ishte akoma gjendja para shpalljes së pavarësisë së vendit. Kjo është arsyeja që lexuesi ynë duhet ta dijë saktë statusin e kufijve të Kosovës, sot dhe nesër, si dhe parametrat e metodologjinë e ndjekur për caktimin e tyre. Këtë do të provojmë ta bëjmë në rreshtat në vijim.

Kur **Mali i Zi** u pavarësia në qershor të vitit 2006, atëherë Serbia trashëgoi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shtetit pararendës, i njohur atëherë si Unioni Serbi–Mal i Zi (më tej shkurt: USMZ). Këtu hynin edhe të drejtat që kishin të bënin me territorin e Kosovën. RFJ, e krijuar më 1992 nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq, u transformua sipas një marrëveshje të lidhur në Beograd më 14 mars të vitit 2002 në USMZ (më tej shkurt: Marrëveshja për USMZ). Kjo kreaturë ishte njëri prej pesë shteteve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë. Nga shpërbërja e RSFJ-së në pranverën e vitit 1992 ishin krijuar këto pesë shtetet të reja trashëgimtare: Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) dhe

Sllovenia. Procesi i trashëgimit të ish-Jugosllavisë u mbyll më 2001 me lidhjen e marrëveshje së Vjenës (për të cilën folëm më sipër). Trashëgimi i Serbisë ndaj territorit të Kosovës bazohej në Marrëveshjen për USMZ. Kjo marrëveshje, për të cilën kemi shkruar gjerësisht gjetiu, ka pasur dispozita të veçanta të cilat i njihnin një të drejtë të tillë Republikës së Serbisë. Ato dispozita ishin formuluar në atë mënyrë që hapur ia njihnin Serbisë të drejtat preferenciale ndaj Kosovës në rast të shpërbërjes së unionit të ri shtetëror serbo-malazez. Lexuesi mund të gjejë informata të dobishme lidhur me këtë në librin tonë ***Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare*** (Univ. Prishtinës/Jalifat: Prishtinë/Hjuston, 2016, fq. 48-77).

Me pavarësimin e Kosovës më 17 shkurt 2008 aktivizohet vënia në jetë e **parimit *uti possidetis juris***, sipas zbatimit automatik të këtij parimi në të drejtën ndërkombëtare, i cili konsiston në transformimin e kufijve të fundit administrativë në kufij ndërkombëtarë. Kjo nënkupton se kufijtë e fundit të Kosovës, të cilët në thelb ishin ata që kishin qenë më 1974, janë bërë kufij të rinj ndërkombëtarë të shtetit të Kosovës. Vija kufitare e Kosovës së 17 shkurtit 2008, jo domosdo ishte e njëjtë me vijën kufitare që kishte ekzistuar në shkurt të vitit 1974, kur ishte miratuar Kushtetuta e ish-KSA të Kosovës. Se kjo është kështu u pa qartë kur filloi caktimi i kufijve të Kosovës me fqinjët e saj: Maqedoninë dhe Malin e Zi. Në ndërkohë që me Maqedoninë kishte një marrëveshje për delimitim, sipas së cilës kufijtë e RFJ-së (Serbi e Mal i Zi) caktoheshin mbi bazën e gjendjes së fundit kadastrore dhe kritereve të tjera shtesë nga e drejta ndërkombëtare klasike (pozita gjeografike, interesi ekonomik i vendeve dhe i qytetarëve të afektuar më caktimin e kufirit etj.), me Malin e Zi nuk pati asnjë marrëveshje paraprake ashtu që caktimi i kufijve të Kosovës me Malin e Zi doli të jetë jo identifikim i vijës kufitare të vitit 1974, sipas rregullës ***uti possidetis juris***, por caktim i një kufiri të ri shtetëror të Kosovës. Me **Maqedoninë** gjërat ishin më të qarta sepse flitej për trashëgim nga ana e Kosovës së Marrëveshjes së vitit 2001, e cila ishte lidhur mes Maqedonisë dhe RFJ-së. Këtu Kosova nuk kishte shumë zgjidhje: kufiri i caktuar dhe i ndryshuar më 2001 në mënyrë automatike trashëgohej nga shteti i ri i Kosovës sipas rregullave mbi trashëgimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për kufijtë, të cilat janë absolute dhe nuk mund të ndryshohen nga palët në mënyrë të njëanshme. Se kjo do të jetë kështu, Kosova e kishte bërë të qartë në mënyrë të njëanshme me momentin e pranimit të Pakos Ahtisaari përmes Deklaratës së Pavarësisë së datës 17 shkurt 2008. Në nenin e tretë [Kufiri]

të Aneksit VIII [Sektori i Sigurisë në Kosovë] të Planit Ahtisaari, qartë flitet për ndryshim të trashëgimit klasik të kufijve të vitit 1974 të Kosovës, të ndryshuar me marrëveshjen e sipërcekur të vitit 2001 të lidhur mes RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) dhe Maqedonisë). Ky nen në pikën 3.2 thotë si vijon:

> Territori i Kosovës nga vija kufitare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ashtu siç kanë qenë këto vija kufitare më 31 dhjetor 1988, përveç ndryshimit të vijës kufitare nga marrëveshja e demarkacionit mes Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë më 23 shkurt 2001.

Se fjala është për zbatim të së drejtës klasike ndërkombëtare mbi trashëgimin në marrëveshje ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me kufijtë, qartë shihet edhe nga një deklaratë e kryesuesit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 7 mars 2007, të cilën në fusnotën nr. 7 me nenin e tretë si më sipër e citon Plani Ahtisaari. Kryesuesi i Këshillit të Sigurimit me atë rast pat thënë, ndër tjera, se: "Këshilli i Sigurimit bën thirrje për nevojën e respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në këtë kontekst thekson se marrëveshja mbi demarkacionin e kufirit, e nënshkruar në Shkup më 23 shkurt 2001 "duhet të respektohet nga të gjithë". Kjo është kështu edhe për faktin se marrëveshjet ndërkombëtare mbi caktimin e kufijve bëjnë pjesë në grupin e marrëveshjeve ndërkombëtare që regjistrohen në Sekretariatin e OKB-së ani se njëra nga palët nënshkruese nuk është anëtar i OKB-së, në këtë rast Kosova. E njëjta procedurë që është ndjekur me Malin e Zi do të ndiqet me Serbinë, përkatësisht po ajo procedurë që ka ndjekur Serbia me Maqedoninë lidhur me kufirin e Kosovës në kohën sa ka qenë kompetente ndërkombëtarisht për një gjë të tillë.

Në vijim si më sipër, e njëjta rregull vlen edhe me marrëveshjen për kufijtë me Shqipërinë, e njohur si **Protokolli i Firences** i vitit 1926, me të cilën janë caktuar kufijtë e sotëm të Shqipërisë, ku pjesa kah Kosova dikur ka qenë nën sovranitetin e RSFJ-së. Kosova trashëgon këtë protokoll, dhe me Shqipërinë nuk do të ketë asnjë ricaktim apo nevojë për diskutim të çështjeve kufitare.

KAPITUJT V–VI. PROCESI I HARTIMIT TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (2008) (FQ. 275–280). DEKLARATA E PAVARËSISË SË KOSOVËS – 17 SHKURT 2008 (PROCESI I SHPALLJES SË PAVARËSISË) (FQ. 281–297).

Përgjithësisht

Edhe këtu trajtojmë dy kapituj njëherësh, kapitullin e pestë dhe të gjashtë, për shkak të vetë përmbajtjes së tyre. Në këta dy kapituj autorët sërish trajtojnë Kushtetutën e Kosovës si pararendëse të shtetit dhe pavarësisë së Kosovës, si "një normë të parë historikisht shikuar" (**Hans Kelsen**), përkatësisht si një "vendim konkret total që definon formën e ekzistencës politike të një shoqërie" (**Carl Schmitt**). Përkundër kësaj, autorët sërish e cilësojnë kushtetutën si një tekst të dhuruar (oktruar), kurse Pakon Ahtisaari si një dokument që ka pasur supremaci (epërsi) ndaj saj, krejt në mënyrë të pashpjegueshme. Këtë e bëjnë në kapitullin e pestë, kurse në të gjashtin provojnë t'i sqarojnë studentit e lexuesit se cili ka qenë raporti mes tyre. Këtë e bëjnë, siç do të shihet, pa asnjë sukses: krijojnë një narracion tërësisht konfuz me zigzage. Kjo gjendje krijohet si pasojë e manipulimit brutal të literaturës së autorëve të huaj, përkatësisht si pasojë e citimit të autorëve të caktuar të huaj në mënyrë krejtësisht manipulative: citojnë një autor, në ndërkohë që teksti dhe fq. që citohen i takojnë krejtësisht një autori tjetër. Kjo në veçanti vërehet në fusnotat si vijon: fusnotën nr. 827-828; 834-835; 837; 849-852. Në këto fusnota kryesisht është përdorur teksti i librit të **Marc Weller**, të cilin vetë autorët e citojnë në fusnotën nr. 829, përkatësisht fq. 377-378; 401-402 & 405 të librit.

Kapitulli i pestë ka katër seksione, kurse i gjashti ka tetë seksione dhe disa nënseksione.

Të shohim si duket gjendja në këta dy kapituj, në ato aspekte që i kemi veçuar për analizë konkrete.

Analiza kritike

Sikundër vërehet, trajtimi i procesit të hartimit të Kushtetutës bëhet para Deklaratës së Pavarësisë. Ky është gabim logjik sepse kjo e dyta përbën një

para kusht të domosdoshëm për të dytën: nuk ka asnjë tekst kushtetues i një vendi që nis me diskutimin për kushtetutën e më pastaj për procesin e lindjes së ***grundnorm***-ës së vet. E kemi theksuar më herët dhe sërish e ritheksojmë se Deklarata e Pavarësisë, jo Kushtetuta, paraqet "normën e parë historikisht shikuar" (**Hans Kelsen**), përkatësisht "vendimin konkret total që definon formën e ekzistencës politike të një shoqërie" (**Carl Schmitt**). Arsyeja pse autorët bëjnë një trajtim të tillë nuk është metodologjike por thjesht për arsye oportuniteti: procesi i hartimit të Kushtetutës së Kosovës, e thonë autorët në paragrafin e parë të fq. 275, ka nisur në muajin janar të vitit 2007, andaj si momentum trajtohet para shpalljes së pavarësisë (sic!). Pse ka ndodhur kështu në pikëpamje kohore, gjithnjë sipas autorëve, ka të bëjë me arsye politike dhe obstruksionet serbe. Këto argumente ne nuk na interesojnë: me rëndësi është të theksohet se për shkencën dhe profesionin e autorit serioz kushtetues nuk çojnë peshë argumentet ekstra-juridike. Vetëm në kësi argumente duhet të përqendrohet fokusi sepse këtë ka nevojë ta dijë studenti e lexuesi ynë, jo aspektet politike të problematikës. Në këtë kontekst, shtojmë se sipas autorëve që kanë qenë pjesëmarrës në bisedimet e Vjenës që sollën **Pakon Ahtisaari**, bisedat shtesë për statusin e Kosovës kanë nisur në shtator 2007 kurse versioni përfundimtar i Pakos Ahtisaari është kryer në mars 2007. Ky plan parashikonte formimin e një komisioni kushtetues me detyrë hartimin e një teksti kushtetues brenda afatit shtesë prej 120-ditëve (**Marc Weller**, vep. e cit në fusnotën nr. 829 nga autorët, fq. 391). Njëri nga këta autorë, **John Tunheim**, në një shkrim të tij thekson se draftimi i Kushtetutës ka nisur në mars 2007 dhe ka përfunduar në dhjetor 2007 (Cf. John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution", *Minnesota Journal of International Law*, vol. 18, issue 2, 2009, fq. 371-379, në fq. 378). Njëjtë e thotë edhe **Louis Aucon**, njëri ndër pjesëmarrësit aktivë ndërkombëtarë në procesin e draftimit të tekstit të Kushtetutës (Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)", *PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security*, vol. XXIII, 2008, fq. 123-128, në fq. 125). Në fusnotat 827 & 828, autorët tanë citojnë në mënyrë fiktive mendimet që në të vërtetë i takojnë autorit **Marc Weller**, siç e sqaruam më sipër. Për të ndërtuar një narrativ real dhe koherent, autorët tanë është dashur të citojnë autorët si më sipër ndërkombëtar që kanë qenë, krahas **Marc Weller**, pjesë aktive dhe substanciale e ndërtimit të tekstit të Kushtetutës së Kosovës, ashtu siç duket sot ai. Në fakt, autori që citohet në fusnotën nr. 827 fare nuk bën fjalë për atë që thonë autorët tanë.

Në fund të këtij kapitulli, kapitullit të pestë, autorët provojnë të sqarojnë për studentin dhe lexuesin marrëdhënien mes Kushtetutës së Kosovës dhe **Pakos Ahtisaari**. Për të dëshmuar tezat e tyre eklektike që asnjëherë nuk mund t'i qëndrojnë asnjë kriteri shkencor dhe profesional, ata konstatojnë në fq. 279 si vijon:

> Kjo nënkupton që ky komision kishte qenë i kufizuar dhe nga kjo del që vartësia që kanë pasur hartuesit e Kushtetutës së Kosovës nga përmbajtja e Pakos së Ahtisarit e bën Kushtetutën e Kosovës një kushtetutë kushtimisht të "dhuruar" e cila ka buruar kryesisht nga propozimi i Ahtisarit.

Sikundër kemi sqaruar në analizën tonë kritike në kapitujt paraprakë, autorët tanë nuk e kanë të qartë se pushteti konstituiv i një populli mund të ushtrohet në mënyrë të koordinuar me faktorin e jashtëm: ky faktor mund të jetë shtet ose grup shtetesh apo një organizatë ndërkombëtare apo disa sosh. Kjo ka qenë kështu në të kaluarën, kjo është kështu dhe sot: këtë e dëshmon procesi i lindjes së **Greqisë, Serbisë** dhe **Malit të Zi** (gjatë shekullit XIX), i ish-republikave jugosllave në veri (**Kroacia** dhe **Sllovenia**) dhe ish-republikat sovjetike në Baltik (**Letonia, Lituania** dhe **Estonia**). Fundja, kështu ka lindur shteti shqiptar në nëntor të vitit tani më të largët 1912.

Kapitulli i gjashtë nis me seksionin që flet për shpalljen e koordinuar të pavarësisë së Kosovës: autorët menjëherë rrëshqasin në gabime themelore dhe ngatërrojnë, përkatësisht nuk dallojnë rekomandimin e **Martti Ahtisaari**-t për pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës si opsion i vetëm, dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, nga raporti i tij që sot njihet si **Pakoja Ahtisaari**. Kjo e dyta nuk ka propozuar pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës por rekomandimi personal i **Martti Ahtisaari**-t, i dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, me të cilin rekomandim ky i fundit është pajtuar në tërësi. Kjo rrethanë i ka dhënë legjitimitet juridiko-ndërkombëtar, sado gjysmak, shpalljes së pavarësisë së Kosovës: sikur të kishte qenë ndryshe, pra sikur rekomandimi në fjalë të ishte kundërshtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, apo nga përfaqësuesi i tij special në Prishtinë (shefi i **UNMIK**-ut), atëherë gjërat do të ishin shumë keq për Kosovën dhe betejën e saj juridike në **GJND**.

Seksioni në vijim, me disa rreshta, por me shumë gabime thelbësore, flet për përgatitjen e Deklaratës së Pavarësisë (fq. 282). Gabimi i parë që bëhet është se autorët vazhdojnë ta kenë të paqartë se cila është natyra juridike e një akti të njëanshëm juridik në të drejtën ndërkombëtare: Dekla-

rata, thonë autorët tanë, më shumë përbën një proces të koordinuar sesa një proces të njëanshëm. Për këtë citojnë një autorë, në fusnotën nr. 849, i cili në tërësi ka qëndrim të kundërt me atë që thonë autorët tanë: në fakt, ky autor ka një qëndrim që ashpër kundërshton pavarësinë e Kosovës dhe fq. që i citojnë autorët tanë asnjë lidhje nuk kanë me konstatimin e tyre të pasaktë dhe të pavërtetë. Në këtë seksion, autorët tanë mundohen që draftimin e tekstit të Deklaratës së Pavarësisë t'ia atribuojnë aktorëve vendorë, gjë që nuk është aspak e vërtetë. Këtë e dëshmon katërçipërisht jo vetëm Ugo Caruso, që citohen në fusnotën nr. 852, por edhe autorët e sipërcekur që kanë qenë pjesë kryesore e aspekteve juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare të procesit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kështu ta zëmë, autorët tanë në fusnotën 850 japin shënime që thonë se anëtarët vendorë të grupit për hartimin e Kushtetutës kishin qenë të kyçur drejtpërdrejtë në procesin e hartimit të tekstit të Deklaratës së Pavarësisë, gjë që nuk është e vërtetë aspak. Këtë e konstaton Marc Weller, në fq. 377-378 të librit të tij të cituar nga autorët tanë në fusnotën e tyre nr. 829.

Edhe ky kapitull përfundon me një seksion ku autorët tanë sërish mundohen të sqarojnë marrëdhëniet mes akteve kryesore juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare në Kosovë. Këtë herë në fokus është sqarimi i marrëdhënies mes **Deklaratës së Pavarësisë** dhe **Kushtetutës së Kosovës** (fq. 286-287). Menjëherë zhyten në gabim themelor, që buron nga koherenca e tyre për të gabuar në definimet e natyrës juridike të akteve themelore të Shtetit të Kosovës: vazhdojnë të pohojnë se "përderisa Deklarata e Pavarësisë paraqet akt historik të karakterit politik me të cilin u shpall mëvetësia e Kosovës, Kushtetuta paraqet akt konstituiv me të cilin krijohet shteti i Kosovës dhe përcaktohen bazat e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës". Nuk është Deklarata e Pavarësisë ekskluzivisht një akt politik. Ajo ka një natyrë të qartë dhe thellësisht juridike, si në aspektin e së drejtës ndërkombëtare ashtu dhe në aspektin e së drejtës kushtetuese. Në aspektin e parë, Deklarata paraqet një normë themelore, bazike, apo një ***grundnorm*** (normë fundamentale), kurse në aspektin ndërkombëtar Deklarata përbën një zotim të njëanshëm të Kosovës, të marrë sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare, që ka efekt ***erga omnes***. Këtë e kemi sqaruar gjerësisht më herët. Përkundër kësaj, autorët sërish çuditën dhe thonë, *inter alia*, se "është interesante se shumica e shteteve filluan njohjet ndërkombëtare mbi bazën e deklaratave të pavarësisë e jo të kushtetutave të tyre të para". (fq. 286). Kjo habi e tyre është krejt normale për shkak se vetë autorët tanë kanë prodhuar koncepte e

kategori fiktive, eklektike dhe pa asnjë bazë shkencore dhe jashtë çdo rregulle të profesionit. Kjo ka bërë që rresht pas rreshti, studenti e lexuesi të gjejnë shumëzim konstant dhe në mënyrë progresive të gabimeve të autorëve tanë. I kësaj natyre është edhe gabimi në fund të fq. 286, ku autorët sërish mundohen të sqarojnë për studentin dhe lexuesin se mes Deklaratës dhe Kushtetutës nuk ekziston asnjë marrëdhënie hierarkike: ky sqarim vjen sërish si pasojë e faktit se autorët e cilësojnë Deklaratën si një akt politik. Po ta kishin cilësuar ashtu siç duhet, pra si një akt që ka natyrën juridike të një norme themelore, ***grundnorm***, mbi të cilën nis jetën dhe ndërtohet sistemi politik i Kosovës sovrane dhe të pavarur, atëherë do ta kishin kuptuar se në një sistem juridik çdoherë ekziston një hierarki e rregullave të sjelljes së subjekteve të së drejtës. Kjo, u mor vesh, nuk ndodh me autorët tanë, të cilët operojnë me koncepte metafizike e kategori të pabaza mbi kushtetutën e dhuruar (**oktruar**), "baballarët e kushtetutës dhe të deklaratës së pavarësisë" si burim i pushtetit konstituiv, mbi kushtetutën si një akt konstituiv shtetëror në rastin kosovar etj., etj.

Menjëherë pas këtij konstatimi tërësisht metafizik dhe pa asnjë lidhje logjike, kalojnë në gabimin tjetër: në fq. 287, faqja në fundit e kapitullit, autorët tanë konstatojnë, në mënyrë kundërthënëse me krejt çfarë kanë thënë më herët, se Deklarata përbën një burim pozitiv të së drejtës kushtetuese të Kosovës. Me burim pozitiv, siç e dimë çdo jurist, nënkuptohet situata kur një tekst juridik mund të shërbej si bazë juridike për një vendimmarrje konkrete. Kjo që thonë autorët tanë, megjithatë, nuk është kështu: Deklarata nuk mund të përbëjë një burim pozitiv të së drejtës sepse përbën një ***grundnorm*** (**Hans Kelsen**) apo një vendim total konkret për formën e organizimit politik (**Carl Schmitt**): në dy rastet, siç e kemi shpjeguar gjerësisht më herët, ekzistenca e saj supozohet. Te **Hans Helsen**, ajo ekzistencë është e njëjtë si te rasti me Zotin, ekzistenca e të cilit nuk mund të vihet në dyshim ashtu që çdo urdhër që del nga ai duhet të merrte si i mirëqenë, kurse te **Carl Schmitt** ekzistenca e *grundnorm*-ës është e njëjtë si te **Thomas Hobbes**, pra që kur ushtrohet njëherë i takon pambarimisht sovranit (mbretit apo liderit) dhe nuk mund të revokohet asnjëherë. Si në rastin e parë ashtu dhe në të dytin, një deklaratë për shpalljen e pavarësisë nuk mund të jetë veçse si një pikë referimi dhe udhërrëfyes me rastin e interpretimeve të normave kushtetuese që rrjedhin prej saj me qëllim të gjetjes së aktivitetit të parë normativ pas lindjes së normës së parë (*grundnorm*-ës). Ai aktivitet i parë normativ pas shpalljes së deklaratës së pavarësisë zakonisht konsiston në nxjerrjen e kushtetu-

tës, por nganjëherë mund të ketë për pasojë edhe nxjerrjen e ligjeve dhe normave të tjera që nuk janë kushtetutë. I tillë është, ta zëmë, rasti me Izraelin: Deklarata Hariri kishte premtuar se Izraeli pas një kohe do të nxirrte një kushtetutë integrale, por kjo asnjëherë nuk ka ndodhur si pasojë e rrethanave historike dhe faktit që izraelitët konsiderojnë sot e kësaj dite se asnjë gjeneratë nuk mund ta kornizojë vullnetin e gjeneratave të ardhshme përgjithmonë. Pra, duhet pritur që procesi i kthimit të krejt izraelitëve në "tokën e premtuar" të merr fund dhe të nxjerrët një kushtetutë unike dhe e përhershme.

Në rastet e tjera zakonisht deklarata mbi shpalljen e pavarësisë për herë të parë pasohet me nxjerrjen e kushtetutës nacionale. Kosova nuk bën përjashtim në këtë drejtim. Kjo nuk do të thotë se nuk ekziston një lidhje e plotë dhe e njëjtë mes Deklaratës së Pavarësisë dhe Kushtetutës së Kosovës. Një gjë e tillë ka ndodhur dhe ka dalë në pah vetëm me rastin e miratimit të Kushtetutës më 15 prill 2009. Me këtë rast, njëjtë si me rastin e miratimit të Deklaratës së Pavarësisë ka ardhur deri të ushtrimi i pushtetit origjiner konstituiv të sovranit (***pouvoir constituant originaire***). Këtu mbaron çdo njëjtësi (barazim) i Kushtetutës me Deklaratën e Pavarësisë. Sikundër kemi sqaruar më herët, çdo amendamentim i Kushtetutës në Kosovë përbën ushtrim të pushtetit konstituiv derivativ (***pouvoir constituant derivée***) që ushtrohet në emër të sovranit, në ndërkohë që **Deklarata e Pavarësisë** nuk mund të ndryshohet asnjëherë sepse përbën një akt të papërsëritshëm në aspektin historik dhe juridiko-kushtetues. U mor vesh, këtu përjashtohen rastet e ndryshimeve të thella revolutive ose konsensuale që mund të ndodhin në sistemin kushtetues kosovar: në një rast të tillë do të bëhet fjalë për krijim të një ***grundnorm***-e të re, tjetërfare nga ajo e krijuar me Deklaratën e Pavarësisë. Kushtetuta, ndërkaq, mund të ndryshojë çdoherë sipas procedurës së parashikuar kushtetuese, deri në rishikim të tërësishëm të saj (nxjerrjen e një kushtetute të re). As Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e as deklaratat mbi pavarësinë të vendeve të ndryshme nuk parashikojnë një procedurë për ndryshimin apo rishikimin e tyre. Mund të ndodhë që rishikimi rrënjësor i kushtetutës ekzistuese shpie në ndryshimin revolutiv të themeleve të organizimit politik dhe kushtetues: në një rast të tillë kushtetuta nacionale e reviduar në themel shërben si një ***grundnorm*** e re, si normë e parë mbi të cilën qëndron rendi i ri kushtetues. E tërë kjo procedurë për ndryshim kushtetues, përfshirë nxjerrjen e kushtetutës së re mund të ketë trajta e forma të ndryshme procedurale, kurse vetë ndryshimi i deklaratave të pavarësisë (apo i kushtetutës së re të

nxjerrë në vijim të revidimit të tërësishëm të bazave mbi të cilat qëndron sistemi kushtetues) është vetëm një mundësi teorike. Kjo është arsyeja kryesore (themelore) pse **Deklarata e Pavarësisë** në Kosovë, por edhe gjetiu në vendet e tjera, nuk mund të ketë statusin e një norme të së drejtës kushtetuese pozitive. Një status të tillë e ka pasur vetëm herën e parë kur ka shërbyer si normë për prodhimin e normave të tjera, në rend të parë për nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 2008. Pas kësaj, këtë rol, pra rolin e së drejtës pozitive kushtetuese si burim për nxjerrjen e normave të tjera, përfshirë dhe të normave kushtetuese, e ka marrë Kushtetuta e vitit 2008. Kjo është kështu edhe me rastin e shteteve të tjera që kanë shpallur pavarësinë për herë të parë dhe kanë nxjerrë një kushtetutë për herë të parë, siç ka qenë rasti me **SHBA**-në dhe me **Francën** dhe vendet që kanë ndjekur modelin e tyre. Këtu nuk përjashtohen as rastet e vendeve ish-komuniste, përkundër faktit që arsyetimi dhe retorika e arsyetimit kushtetues dhe politik është bazuar në vlerat, traditën dhe parimet nga e kaluara para-komuniste e këtyre vendeve. Për t'u kuptuar esenca e këtij problemi, duhet të kuptohet se cila ka qenë në një rast konkret, përfshirë këtu **Kosovën**, qasja e pushtetit konstituiv ndaj revolucionit dhe nëse ekziston mundësia për një kushtetutëbërje pa revolucion. Në dy rastet, fjala është për ndërprerjen me të kaluarën, ku dallimet e mëdha vijnë në shprehje vetëm në këtë pikë, në pikën e marrëdhënies mes pushtetit konstituiv të sovranit apo përfaqësuesve të tij dhe përmbysjes së kryer revolucionare dhe të mundësisë nëse një kushtetutëbërje mund të kryhet fare pa revolucion por me efekt krejt të thellë dhe rrënjësor ndaj sistemit ekzistues kushtetues. Në Francë ka ardhur deri te shkëputja e tërësishme e pushtetit konstituiv dhe rrënimi i mbretit si pushtet konstituiv, kurse në SHBA ka ndodhur e kundërta: asambletë ekzistuese të vendeve anëtare të konfederatës nuk u delegjitimuan, siç kishte ndodhur në Francë me kuvendet franceze, por shërbyen si bazë për rilegjitimim në emër të sovranit të projektit tjetër kushtetues, atij federal që krijoi atë që sot është SHBA-ja. Në rastet e vendeve ish-komuniste ndodhi një marrëdhënie specifike e pushtetit konstituiv: në disa raste, ai u shpreh si "tryezë e rrumbullakët", në tjerat si transformim paqësor i tërë sistemit, duke lënë në fuqi kushtetutat e vjetra për një kohë të caktuar pas shpalljes së pavarësisë. (Cf. lidhur me këtë çështje më shumë në Norman Dorsen, Michel Rosenfled, András Sajó and Suzsanne Baer (eds.), ***Comparative Constitutionalism: Cases and Materials*** (WEST: USA, 2010, fq. 116-122).) Në të gjitha rastet, megjithatë, ndryshimet ishin thellësisht revolucionare dhe ndryshuar në themel

bazat e sistemit politik në vendet ish-komuniste. Kosova, në këtë drejtim, bën përjashtim sepse procesi i krijimit të shtetit nuk ka qenë imediat pas rrënimit të sistemit komunist por si një proces i stërzgjatur: rendi i fundit juridik me të cilin Kosova kishte ndërprerë lidhjet për të lindur vetë si një shtet ***sui generis***, si në aspektin kushtetues ashtu dhe në atë ndërkombëtar, ka qenë rendi i **UNMIK**-ut i instaluar sipas Rezolutës 1244 të KS të OKB-së. Në aspektin kushtetues, kjo specifikë buron nga fakti se **Deklarata e Pavarësisë** pranon kontinuitetin e disa detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë dhe ato të natyrës juridiko-kushtetuese (mbrojtja e komuniteteve etnike dhe të tjera, ndërtimi i një demokracie kushtetuese liberale, marrëdhëniet fqinjësore paqësore dhe kështu me radhë), ashtu siç janë krijuar ato nga administrata e **UNMIK**-ut. Ky pranim në të njëjtën kohë pasohet nga zotimi i Kosovës për shkëputje totale në çështjet e sovranitetit shtetëror bazik. Në aspektin ndërkombëtar, ndërkaq, specifika e Kosovës konsiston në faktin se nuk përbën një precedent që mund të përdoret nga asnjë shtet apo organizatë ndërkombëtare në të ardhmen. Kjo gjendje *sui generis* e krijimit të shtetit të Kosovës ka edhe dimensionin tjetër specifikim që thotë se lindja e Kosovës nuk ka qenë rezultat i ushtrimit joligjor të dhunës, siç kanë bërë serbët në **Bosnjë-Hercegovinë** (Republika Sërpska) apo turqit në **Qipro** më herët (Republika Turke e Qipros së Veriut) dhe kështu me radhë. Një pjesë të këtyre argumenteve i kemi shtjelluar më herët, kurse në vijim i kthehemi kapitullit të fundit të pjesës së dytë të librit që ka të bëjë pikërisht me këtë temë që u diskutua deri këtu – **Deklarata e Pavarësisë së Kosovës** dhe natyra e saj në të drejtën ndërkombëtare. Këtë aspekt autorët tanë mendojnë se e kanë trajtuar si duhet. Ky, megjithatë, fare nuk është rasti.

Kapitulli VII. Argumentimi i GJND-së për pavarësinë e Kosovës (fq. 289–297)

Përgjithësisht

Ky kapitull përbëhet nga tetë seksione (me disa nënseksione) dhe karakterizohet, njëjtë si kapitujt e tjerë, me trajtime kaotike, eklektike deri në fund të temës së mendimit kështillëdhënës të GJND-së lidhur me Kosovën. Ky mendim, i një rëndësie kolosale për vendin, nga autorët tanë trajtohet

duke cituar pjesë të tij, pa përmendur asnjë paragraf të vetëm, duke futur në të njëjtën kohë fusnota të tjera fiktive. Kjo qasje bëhet krahas dhe ndaras prej manipulimit të literaturës: në fusnotat nr. 868-869, 872 & 879 citohen autorë të huaj në mënyrë brutalisht manipulative dhe iu mvishen thëniet që ata nuk i kanë thënë. Në fakt, autorët e huaj që manipulohen në fusnotat si më sipër thonë gjëra krejtësisht të kundërta me ato që u mvishen.

T'i shohim më nga afër gabimet e tjera themelore të autorëve tanë në këtë pjesë kaq të rëndësishme për historinë më të re të Kosovës.

Analiza kritike

Gjëja e parë që bie në sy është trajtimi kaotik i materies: në seksionin e parë "Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe jurisdiksioni i saj" (fq. 289), autorët flasin për GJND-në dhe rolin e saj. Nga ky shqyrtim, megjithatë, nuk ka asgjë që mund të kuptohet si duhet nga studenti. Në këtë vend është dashur të flitet për rastin e Kosovës pranë GJND, si u krijua dhe çfarë ka qenë gjendja para se rasti të përfundojë në GJND. Në fusnotën nr. 858, autorët tanë flasin në mënyrë të shtuar për GJND-në, duke dhënë statistika jorelevante për lexuesin, pa cituar asnjë burim (sic!). Ky seksion pasohet nga seksioni "Kërkesa e Serbisë drejtuar Kombeve të Bashkuara" (fq. 289-290), e marrë nga mendimi i GJND-së, pa asnjë trajtim tjetër juridiko-kushtetues ose juridiko-ndërkombëtar të esencës së problemit të lindur. Këtij trajtimi jokritik i shtohet seksioni tjetër "Sigurimi i dokumenteve nga Kombet e Bashkuara" (fq. 290), që asnjë logjikë dhe kuptim nuk ka: kjo pjesë, në fakt, përbën anën procedurale të ngritjes së çështjes, e cila gjendet në mendimin e GJND-së, të cilët autorët e përvetësojnë si të tyrin pa asnjë citim relevant të paragrafëve të mendimit të GJND-së ku trajtohet kjo pjesë.

Në ndërkohë që seksioni "Procedurat gjyqësore para gjykatës" (fq. 290-291) dhe "Dëgjimet publike dhe argumentet ligjore të palëve" (fq. 291-294) mund të kuptohet se janë trajtime të brishta të pjesëve të caktuara të mendimit të GJND-së për Kosovën, ani se autorët tanë nuk citojnë asnjë paragraf se nga ku i kanë marrë, nënseksioni i fundit me titull "Argumentet ligjore" do ta sfidojë studentin e lexuesin për të zbuluar se për çfarë bëhet fjalë: për mendime të pavarura të autorëve apo për qëndrime të palëve në procedurë në rastin e Kosovës (sic!). Seksioni në vijim "Implikimet për të drejtën ndërkombëtare" (fq. 295) nuk është aspak më i qartë

se nënseksioni mbi argumentet ligjore të shpalljes së pavarësisë.

Në seksionin tjetër, "Dhënia e mendimit nga ana e GJND-së" (fq. 295), autorët tanë ia mveshin këtij organi të drejtësisë ndërkombëtare një thënie që nuk ekziston në mendimin e dhënë për Kosovën, duke konstatuar si vijon:

> Më 22 korrik 2010 gjykata vendosi që shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare; [...] Gjykata po ashtu tha se përderisa shpallja e pavarësisë nuk ka qenë e paligjshme, çështja e njohjeve ishte politike.

As për këto konstatime pompoze dhe arbitrare, autorët tanë nuk japin ndonjë paragraf të mendimit të GJND-së për Kosovën. Kjo është krejt normale sepse paragrafët e tilla nuk ekzistojnë për një arsye fare të thjeshtë: kjo që thonë autorët tanë nuk është mendim i GJND-së, por i tyre i sajuar në tërësi. Objekt i mendimit këshillëdhënës nuk ka qenë shpallja e pavarësisë e as nëse Kosova ka të drejtë për vetëvendosje por akti i shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Këtë që thonë autorët tanë, në fakt, e ka thënë Serbia në Asamblenë e Përgjithshme: qëndrimi serb, që u bë politikë e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së përmes Rezolutës nr. 63/3 të datës 30 shtator 2008, ka pasur të bëjë me marrjen e një përgjigje nga ana e OKB-së lidhur me atë nëse është në pajtim më të drejtën ndërkombëtare shpallja e pavarësisë së njëanshme nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë. Këtë qëndrim serb, GJND e ka formuluar ndryshe, sipas kompetencave që ka ky organ për të riformuluar pyetjet e parashtruara asaj, duke e rindërtuar objektin e mendimit sipas rregullave të tjera që nuk paragjykojnë përgjigjen përfundimtare të saj ndaj ligjshmërisë së aktit të njëanshëm të shpalljes së pavarësisë së vendit tonë. Pikë kthese në këtë drejtim ka qenë riemërtimi i autorëve të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, duke i cilësuar ata me terma neutral si **autorët e deklaratës së pavarësisë**. Autorët tanë, ndërkaq, gabimisht mendojnë se ky term është përzgjedhur sipas dëshirës nga vetë pala kosovare që ka prezantuar çështjen e Kosovës në GJND (sic!). Kjo tregon për ekzistimin e një dyshimi të thellë te autori i këtyre rreshtave lidhur me atë nëse me të vërtetë autorët tanë e kanë lexuar mendimin e GJND-së për Kosovën!?

Te kjo pjesë si më sipër, seksioni që mëton t'i shpjegojë studentit dhe lexuesit se cilat kanë qenë argumentet e palës kosovare pranë GJND-së, qartë e vërejnë se asnjë nga argumentet e tyre për **Vilajetin e Kosovës** si

"status konfederal", për identitetin e Kosovës nën mbretërinë jugosllave, për **Konferencën e Bunjajt** si shprehje e vullnetit plebishitar për vetëvendosjen tonë, për Kosovën si element konstituiv i Federatës Jugosllave dhe të tjera të ngjashme me këto nuk janë përdorur nga pala e Kosovës.

Në lexim të parë, lexuesi mund të qefohet duke shpresuar se në këtë kapitull me titull bombastik do të gjejë shtjellimin e duhur për argumentimin e GJND-së për pavarësinë e Kosovës. Ky, megjithatë, nuk është rasti: brendia e këtij kapitulli, as një për qind nuk përputhet me titullin e dhënë. Në fakt, lexuesi nga faqet e këtij kapitulli mund të kuptojë vetëm një qëndrim implicit të **GJND**-së, përkatësisht qëndrimin që thotë se akti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës paraqet ushtrim të pushtetit konstituiv origjinal (***pouvoir constiutant originaire***). Kjo, megjithatë, nuk është veçse hamendësim i autorëve tanë, i cili mund të arsyetohet me terma shkencorë, përkundër faktit që një mendim i tillë nuk është shprehur nga ana e GJND-së në mënyrë shprehimore. Kjo është bërë për shkak se një konstatim i tillë shprehimor do të kishte implikuar GJND-në në dhënien e përgjigjes në një pyetje të ndjeshme dhe që nuk i takon natyrës së punës së saj, përkatësisht lidhur me atë nëse Kosova ka pasur të drejtë për shkëputje sipas të drejtës ndërkombëtare. Dhënien e përgjigjes së tillë GJND e ka shmangur me shumë mjeshtëri. Përgjigjen në këtë pyetje e ka pritur edhe Serbia dhe aleatët e saj.

Se fjala ka qenë vetëm për një konstatim implicit lidhur me ushtrimin e ***pouvoir constituant originaire*** të Kosovës e ka thënë në botën shqiptare profesori i mirënjohur i drejtësisë **Xhezair Zaganjori**: në fq. 37 të librit të tij ***Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare*** (ABC: Tiranë, 2011), ky autor konstaton se me vendimin e vet GJND efektivisht ka konstatuar se në Kosovë ka ardhur deri te ushtrimi i pushtetit konstituiv origjinal nga ana e përfaqësuesve të popullit të Kosovës. Një konstatim i tillë si i prof. **Xh. Zaganjori** është ndjekur edhe nga autori i këtyre rreshtave në një shkrim të botuar në Tiranë më 2012 me titull "Vendimet kryesore që bënë historinë e Kosovës" (fq. 221-222). Ky shkrim është pjesë e përmbledhjes së **Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë**, botuar si libër me titullin *Ndarja dhe balancimi i pushteteve dhe roli i kontrollit kushtetues* (në gjuhën angleze dhe shqipe). Këtë konstatim autorët tanë e përsërisin, pa cituar asnjërin nga ne dy, por edhe askënd tjetër: lexuesi ynë mund ta gjejë këtë konstatim të tyre në fq. 296 të librit. Në fakt, rreshtat e kësaj faqeje janë tërësisht të këtij autori, të cilët janë marrë nga një punim imi në gjuhën shqipe (Cf. Enver Hasani, "Rasti i asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të

Kosovës", *E drejta/Law*, nr. 1-4/2015, fq. 11, teksti në fusnotën nr. 5). Mënyra se si autorët flasin për ushtrimin nga ana e Kosovës të ***pouvoir constituant originaire*** nuk ka asnjë lidhje me asnjë pjesë të këtij kapitulli dhe zihet në gojë jashtë çdo konteksti, në ndërkohë që përbën vetë esencën e mendimit të GJND-së për Kosovën. Kjo ka një histori.

Qëndrimi implicit i GJND-së si më sipër gjendet i elaboruar në mënyrë të shkëlqyer në mendimin **Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo**, *Advisory Opinion*, 2010 I.C.J. 404 (July 22), të cilin autorët pretendojnë ta kenë lexuar dhe, si të tillë, pretendojnë se e prezantojnë para studentëve dhe lexuesve të tjerë. Ky, megjithatë, nuk duket të jetë rasti: pasi diskutojnë për vendin dhe rolin e GJND-së në botë, diçka që nuk i shkon formatit dhe natyrës së një libri mbi të drejtën kushtetuese, autorët flasin për kërkesën e Serbisë lidhur me pavarësinë e Kosovës, pa dhënë asnjë analizë autonome shkencore lidhur me mënyrën e parashtrimit të pyetjes në fjalë si dhe defekteve eventuale të saj, defekte që do t'i kushtojnë Serbisë me humbjen e rastit në GJND.

Në tri seksionet në vijim, pa asnjë kuptim dhe relevancë, autorët flasin për procedurat gjyqësore e në fakt nuk ka asnjë fjalë për ecurinë e kërkesës dhe pozicionimin e GJND-së lidhur me juridiksionin dhe riformulimin e pyetjes së bërë nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (me kërkesë të Serbisë), një moment kyç i këtij rasti, për të dalë të argumentet gjoja të natyrës ligjore. Te kjo pjesë, lexuesi asnjëherë nuk do ta marrë vesh se për cilat argumente ligjore bëhet fjalë, për ato të dhëna nga palët, ndërhyrësit, apo nga vetë GJND-ja me rastin e vendosjes, si dhe gjëra të tjera të ngjashme me këto. Po në këtë vend, autorët flasin për normat ***jus cogens*** të së drejtës ndërkombëtare dhe thonë që **Timori Lindor** nuk është krijuar si shtet në kontekstin kolonial, gjë që është gabim themelor sepse ky shtet ka qenë rasti i fundit i shtetndërtimit në kontekstin kolonial.

Më pastaj, autorët tanë diskutojnë për **Kosovën** si për njërën nga pesë njësitë federale (së bashku me ish-republikat jugosllave) që ka pasur të drejtën për vetëvendosje. Autorët tanë nuk tregojnë se të kujt janë këto argumente ligjore që shtrohen kaotikisht në këtë seksion (sic!). Në mbështetje të këtyre tezave të tyre fiktive, autorët citojnë fq. 835-837 & 845-847 të autorit **Samuel Ethan Meller** nga shkrimi i tij i shkëlqyeshëm "The Kosovo Case: An Argument for A Remedial Declaration of Independence" (*Georgia Journal of International & Comparative Law*, vol. 40, no. 3, 2012: 833). Nga ajo që thotë ky autor, megjithatë, shihet qartë se fjala është për

manipulim brutal të literaturës sepse **Samuel Ethan Meller** shpjegon në mënyrë shumë të stërholluar dhe argumentuese se GJND ka arritur t'i shmanget krijimit të precedentit në rastin e Kosovës duke riformuluar pyetjen serbe nga "A është shpallja e pavarësisë së njëanshme nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?" në "A është deklarata për shpalljen e pavarësisë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?". Përmes këtij riformulimi, pohon ky autor, GJND ka ndërtuar rastin e **Kosovës** në tërësi duke u bazuar në të a.q. **shkëputje shëruese** (***remedial secession***). **Samuel Ethan Meller** në asnjë vend nuk thotë se Kosova paska pas qenë njësi federale sikur republikat tjera: në fakt, në fq. 836 ky autor e cilëson Kosovën si provincë serbe me një autonomi parciale të fituar në vitin 1974, e cila është rrënuar nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq në vitin 1990. Kaq! Asgjë tjetër! T'i kthehemi sërish çështjes së mësipërme lidhur me riformulimin e pyetjes nga ana e GJND-së si moment kryesor për fitoren e Kosovës.

Ky riformulim i pyetjes si më sipër nga ana e GJND-së, në teorinë e së drejtës ndërkombëtare gjerësisht pranohet se ka qenë vendimtar për vendimmarrjen e GJND në rastin e Kosovës, në sensin që është shmangur përgjigja në pyetjen nëse ekziston secesioni si e drejtë në të drejtën ndërkombëtare dhe, nëse ekziston, cilët janë titullarët e kësaj të drejte. Në vend të kësaj, GJND ka bërë riformulimin e pyetjes: një gjë e tillë i ka mundësuar GJND-së për t'u fokusuar ekskluzivisht në natyrën juridike të deklaratës për shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Në këtë kuptim flet edhe artikulli i **Samuel Ethan Meller**-it: autori arsyeton verdiktin e GJND-në duke ripohuar se deklarata e pavarësisë së Kosovës ka ndodhur jashtë rendit juridik të OKB-së dhe nuk ka për autorë IPVQ-të (Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë), por autorë krejtësisht të tjerë. Ata quhen **autorët e deklaratës se pavarësisë** (Cf. paragrafët 102-109 të mendimit të GJND-së për Kosovën). Sikundër shihet fare nuk bëhet fjalë për shpjegime rreth të drejtës për secesion dhe vendin e Kosovës në këtë aspekt.

Mosndërhyrja e PSPP-së (Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm) në emër të OKB-së në procesin e shpalljes së pavarësisë përbën argumentin tjetër të rëndësishëm juridik që dallon Kosovën nga çdo rast tjetër, siç është **Kebeku** në **Kanada**, të cilin e patën cituar si shembull kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës në paraqitjet e tyre në GJND. Megjithatë, riformulimi i pyetjes nga ana e GJND-së, i kryer përmes ricilësimit të autorëve të saj si **autorët e deklaratës së pavarësisë**, ka bërë që objekt i

mendimit këshillëdhënës të jetë natyra juridike e **Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës** e datës 17 shkurt 2008. Kjo qasje ka përjashtuar kërkesën serbe me të cilën kërkohej që si objekt i mendimit të GJND-së të ishte përcaktimi nëse Kosova përbënte një entitet me të drejtë për secesion. Kjo qasje dhe ky shtjellim i shkëlqyer i ushtrimit nga ana e Kosovës të pushtetit konstituiv origjinal (***pouvoir constituant originaire***) përbën esencën e shkrimit të **Samuel Ethan Meller**-it dhe tezës së tij brilante që thotë se GJND ka vendosur për të a.q. drejtën shëruese për shpalljen e pavarësisë (*remedial declaration of independence*) në të drejtën ndërkombëtare, e cila krijohet si rezultat i mohimit të vazhdueshëm të së drejtës interne për vetëvendosje. Këtë autori e shpreh në fq. 835-854 të këtij shkrimi të shkëlqyer dhe mjaft standard lidhur me natyrën juridike të shpalljes së pavarësisë së njëanshme nga ana e Kosovës. Për këtë temë janë shkruar me dhjetëra e qindra artikuj e libra dhe në pjesën dërrmuese konfirmojnë qëndrimin e GJND-së në favor të Kosovës. Autorët tanë, megjithatë, i citojnë vetëm dy autorë të huaj dhe atë në mënyrë manipulative.

Përveç punimit si më sipër, në paragrafin e fundit të shtjellimit të tyre tërësisht kaotik, një distopi që nuk e bart asnjë mesazh te studenti dhe lexuesi, autorët tanë me një narrativ të përçartë citojnë fq. 45-47 të disertacionit të **Bridgette Martin**-it, i titulluar *Secession and Statehood: The International Legal Status of Kosovo* (2008). Citimi që bëjnë autorët tanë lidhet me konstatimin e tyre që thotë se **Rusia** ka kundërshtuar mendimin e GJND-së për Kosovën kurse **Abhazia** dhe **Osetia e Jugut** e kanë përshëndetur. Kjo, jo vetëm që nuk është e vërtetë, gjë që lexuesi fare lehtë mund ta konstatojë nga leximi i faqeve si më sipër të burimit në fjalë, i cili gjendet në internet, por edhe përbën një shtrembërim të dukshëm të shtjellimeve elokuente të autores **Bridgette Martin:** në kapitullin e katërt, kjo autore bën fjalë për **Kosovën** si për një rast që paraqet përjashtim ashtu që nuk mund të shërbejë asnjëherë si precedent. Këtë fakt autorja e argumenton në mënyrë të shkëlqyer me premisa juridike dhe politike nga e kaluara dhe e tashmja e gjendjeve në Rusi dhe në vendet satelite të saj, të krijuara me dhunë dhe përmes rrugëve tërësisht ilegale nga aspekti i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në fund, si një përmbledhje e jonë për këtë kapitull, ritheksojmë se esenca e mendimit të GJND-së për Kosovën, të cilën autorët fare nuk e kuptojnë, konsiston në si vijon: përmes riformulimit të pyetjes si më sipër, ky organ i drejtësisë ndërkombëtare i ka cilësuar përfaqësuesit e popullit të Kosovës, jo si titullarë të IPVQ-ve por si **autorë të deklaratës së**

pavarësisë. Ky cilësim i ka mundësuar GJND-së ta ndryshonte objektin e shqyrtimit, duke pasur tani si objekt shqyrtimi dhe mendimi vetëm natyrën juridike, efektet dhe statusin në të drejtën ndërkombëtare të deklaratave të njëanshme mbi shpalljen e pavarësisë. Me këtë rast, GJND ka zënë në gojë, për qëllime krahasimi, të gjitha deklaratat e njëanshme të shpalljes së pavarësisë të bëra gjatë shekullit XIX dhe XX. Këtu ka pasur parasysh rastet e Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi (shek. XIX) dhe rastet e dekolonizimit dhe shtet krijimet pas rrënimit të komunizmit ku vendet që kishin përbërë federatat komuniste shfrytëzuan të drejtën e tyre për vetëvendosje eksterne krijuan shtetet e tyre. Kjo qasje e GJND-së nuk është veçse një emër tjetër për të treguar format e manifestimit të ndryshëm të mënyrave në të cilat mund të ushtrohet pushteti origjinal konstituiv (***pouvoirs constituant originaire***). Sipas kësaj qasjeje të GJND-së nuk ka rëndësi nëse entiteti që e ushtron këtë të drejtë e ka pasur të pranuar ndërkombëtarisht tagrin juridik për një ushtrim të tillë. Kjo e fundit, tagri juridik, ka të bëjë me të drejtën për secesion dhe nuk ka qenë fare objekt diskutimi dhe vendosje në GJND, ashtu siç kishte besuar dhe shpresuar Serbia me juristët e saj, të cilët e kishin formuluar pyetjen e tyre për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Të gjitha këto lexuesi mund t'i gjejë të shtjelluara gjerësisht në paragrafët 52-56; 74-84; 96-109; 114-121 të mendimit këshillëdhënës të GJND-së për Kosovën. Kjo vlen edhe për autorët tanë, të cilët me ose pa hiri në këtë kapitull që shtjelluam kanë mbrojtur qëndrimet serbe për mendimin e GJND-së për Kosovën.

Pjesa e tretë

E DREJTA E APLIKUESHME NË KOSOVË (DISPOZITAT E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS)

Përgjithësisht

Kjo pjesë e librit përbëhet nga 13 kapituj. Sa i përket cilësisë nuk ka dallim thelbësor me dy pjesët pararendëse.

Analiza kritike

Në trajtimet e tyre të pjesës së tretë të librit, pjesa pozitive dhe aplikative e së drejtës kushtetuese kosovare, autorët tanë manifestojnë mungesë të theksuar të njohjes profesionale të koncepteve fundamentale të së drejtës kushtetuese, të institucioneve dhe kategorive të saj. Të kësaj natyre janë trajtimet e tyre mbi konceptet mbi ndarjen dhe balancimin e pushteteve, unitetin e popullit dhe kuptimin e tij në një sistem kushtetues parlamentar, natyrën juridike të pushtetit ekzekutiv dhe vendin që ka shërbimi civil në këtë mes dhe kështu me radhë.

Ajo që do ta trandë lexuesin më së shumti ka të bëjë me mungesën e njohurive themelore nga ana e autorëve tanë lidhur me rolin dhe pozitën e shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare. Në këtë aspekt, gabimet nisin që nga bindja e tyre se Presidenti i Kosovës mund të paraqitet në disa vende si mbret ose monark (fq. 381) e deri të përsiatjet e kota për të shpjeguar se përse në Kushtetutën e Kosovës nuk ka dispozita që e definojnë rolin dhe pozitën e shefit të shtetit (fq. 383 bis).

Cilësia tjetër e pjesës së tretë të librit të autorëve tanë është manipulimi masiv i burimeve të literaturës, kryesisht i asaj të huaj. Kjo praktikë ngelet e pandryshuar edhe në këtë pjesë të librit.

Të shohim kapitull për kapitull si duken cilësitë si më sipër.

KAPITULLI I.
KARAKTERISTIKAT E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (FQ. 301–314)

Përgjithësisht

Ky kapitull përbëhet nga 12 seksione. Si i tillë, kapitulli ka disa cilësi që duhen veçuar: e para, manipulimi me literaturën vazhdon me po atë intensitet, kryesisht i literaturës së autorëve të huaj; e dyta, autorët krejt fokusin e kanë, deri në obsesion, në synimin për të përligjësuar Kushtetutën e vitit 2008 si akt konstituiv të Shtetit të Kosovës; dhe, e treta, në këtë kapitull nis aventura tjetër e autorëve që mëton ta paraqes Kosovën si një vend me sistem gjysmëpresidencial dhe parlamentar në të njëjtën kohë, diçka që nuk ekziston askund në botë. Të shohim një nga një si duken këto tri cilësi, para se të kalojmë në analizën e seksioneve.

Në këtë shkrim, në fusnotën nr. 892, autorët tanë citojnë autorin **Atanas Slavov**. Ky autor për **Bullgarinë** dhe sundimin e ligjit në këtë vend; për çështjet e trashëgimisë komuniste të vendit dhe vështirësitë e realizimit të **Kushtetutës së Bullgarisë** të vitit 1991 në një kontekst ish-komunist dhe rural; punimi kryesisht ka karakter nacional dhe jokrahasues, me të vetmin qëllim sqarimin e rrethanave konkrete nacionale të sfidimit të supremacisë së kushtetutës dhe sundimit të ligjit sipas përcaktimeve të demokracive perëndimore liberale. Punimi, thënë me fjalë të tjera, nuk është një qasje teorike ku definohen konceptet e supremacisë dhe sundimit të ligjit por më shumë dhe ekskluzivisht një hulumtim konkret nacional. E njëjta gjë vlen edhe për burimin që autorët tanë e citojnë në të njëjtën fusnotë, në fusnotën nr. 892, me këtë titull "Shaken Order: Authority and Social Trust in Post-Communist Societies" (Case Studies in Law, fq. 5-9). Këto fq. që i citojnë autorët tanë janë fiktive sepse bëhet fjalë për diçka që nuk ekziston: ky burim është në fakt një skicë e një projekti ndërkombëtar me të njëjtin titull dhe ka selinë e vet në Sofje të Bullgarisë. Kaq! Asnjë vlerë teorike dhe akademike nuk ka: hulumtimi mund të shërbejë si bankë e të dhënave për gjendjen e sundimit të ligjit në disa prej vendeve ish-komuniste dhe asgjë më shumë.

Në kapitullin me titull "Judicial Review and the Rule of Law", autori

Amy Street flet për sundimin e ligjit në kontekstin britanik: faqja 13, që autorët tanë e citojnë, fare nuk ka të bëjë me atë që thuhet në fusnotën nr. 900 dhe tekstin që e shoqëron atë. Në këtë vend, **Amy Street** flet për dy botëkuptimet standarde mbi sundimin e ligjit, teorinë mbi sundimin e ligjit në kuptim formal dhe teorinë mbi sundimin e ligjit në kuptimin substancial. Sikur ta kishin lexuar me kujdes këtë libër autorët tanë, së paku do ta kishin pasur të qartë konceptin e sundimit të ligjit dhe do t'i kishin implementuar në kontekstin kosovar dy teoritë standarde që gjenden në të gjitha librat universitarë mbi të drejtën kushtetuese. Edhe vetë **Komisioni i Venecias** ka bërë një *checklist* të standardeve dhe përbërësve të sundimit të ligjit, i cili aktualisht shërben si një udhërrëfyes për vendet që synojnë demokracinë liberale perëndimore. E kemi fjalën për raportin ***Rule of Law Checklist*** (Study No. 711/2013: Strasbourg, 18 mars 2016), ku përpunohen në detaje aspektet formale dhe substanciale të konceptit mbi sundimin e ligjit për të cilat flet autori **Amy Street**.

Fq. 7-10 të shkrimit të **Clive Baldvin**, të cilat i citojnë autorët tanë në fusnotën nr. 922, kanë të bëjnë me diçka krejt tjetër: ato fq. bëjnë fjalë për historinë e **Kosovës**, minoritetet e saj në të kaluarën dhe logjikën e transformimit të tyre në komunitete. Në fakt, shkrimi më shumë i referohet kohës para vitit 1999: pas këtij viti, shkrimi flet vetëm në kuptimin historik dhe socio-politik, pa ndonjë relevancë juridiko-kushtetuese që vlen të veçohet me këtë rast. Gjendja paraqitet edhe më skandaloze me burimin që autorët tanë e citojnë si të binjakëzuar në fusnotën nr. 923: tekstin që e shoqëron këtë fusnotë është i njëjtë me atë të fusnotës paraprake, fusnotës nr. 922, mirëpo autori i fusnotës 923 ka qëndrim jashtëzakonisht negativ ndaj **Kosovës** sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të komuniteteve kosovare. Krejt esenca e shkrimit të autores serbe **Ivana Krstić**, që citohet si burim në fusnotën nr. 923, ka të bëjë me argumentimin e autores serbe se bashkësia ndërkombëtare duhet t'ia marrë **Kosovës** të drejtën për pavarësi dhe sundim të serbëve dhe komuniteteve të tjera në mënyrë të njëjtë siç ka vepruar me Serbinë sepse, gjithnjë sipas saj, kosovarët janë treguar të paaftë për të mbrojtur komunitetet joshqiptare. Me fjalë të tjera, ky shkrim në tërësi është i kundërt me atë që autorët thonë në tekstin që shoqëron fusnotën 923, ku citohet ky burim.

Burimi që citohet në fusnotën 927, i autorit **Thomas Poole**, po ashtu manipulohet sepse autori në fjalë flet për krejt diçka tjetër: analiza e tij konsiston në tri baza të arsyetimit të kontrollit gjyqësor. Baza e parë është rreziku, e dyta siguria, dhe, e treta, historia formative e normës përmbajtja

e të cilës duhet të kontrollet nga një gjykatë. Autori **Thomas Poole** në fillim jep teoritë e **Giddens**-it, **Marquand**-it, **Tocqueville**-it etj. Në fund jep kontrastin në mes teorive të sigurisë dhe frikës me teoritë legale, sipas të cilave nuk shikohet frika apo siguria si koncepte por fokusi-përqendrohet në analizimin e historisë së formimit të normës. D.m.th., me rastin gjykimit të përmbajtjes së normës duhet të merret parasysh historia dhe evoluimi i përmbajtjes së saj që nga krijimi. Krejt esenca e këtij krahasimi është për të treguar se gjykatat kanë rrezik kompromet imi kur gjykojnë për përmbajtjen e normave juridike në kohë lufte dhe gjatë kohës sa zgjatë gjendja e jashtëzakonshme, në veçanti kur bëhet fjalë për luftën kundër territorit si një lloj i gjendjes së tillë. Në këto situata gjykatat ndeshen me sfidën kryesore si të ruajnë standardet mbi liritë dhe të drejtat njerëzore dhe, në të njëjtën kohë, të luftojnë terrorizmin, përkatësisht si të përballojnë gjendjen e jashtëzakonshme. Për të dëshmuar këtë, autori **Thomas Poole** i jep rastet e gjykatave në Britani dhe SHBA, në të cilat gjykatat kanë vendosur sipas disa kritereve nga e kaluara historike e këtyre vendeve, duke cenuar standardet kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Kaq! Asnjë relevancë nuk ka shkrimi për atë që e citojnë autorët tanë. Manipulim klasik i burimit!

Në fusnotën nr. 936, autorët tanë citojnë artikullin shumë kompetent dhe hulumtues të autorëve të respektuar **Rebecca Ananian-Welsh** dhe **George Williams**, të cilët diskutojnë rastin e pavarësisë gjyqësore në Australi dhe zbrazëtirat juridike dhe të metat tjera të gjyqësorit australian. Ky hulumtim është krahasimor. Autorët tanë e citojnë këtë shkrim në mënyrë manipulative dhe tërësisht abuzive, për të mbuluar një konstatim krejtësisht notor, përkatësisht konstatimin sipas të cilit parimi i pavarësisë së gjyqësorit përbën një ndër parimet kryesore që është i mishëruar në të gjitha kushtetutat dhe sistemet e vendeve demokratike. Jo vetëm kaq: në fusnotën në vijim, fusnota nr. 937, autorët tanë kanë vjedhur nga shkrimi i autorëve **Rebecca Ananian-Welsh** dhe **George Williams** fusnotën nr. 5 nga fq. 594-595 të tekstit origjinal të këtyre autorëve (sic!). Fq. e punimit që autorët tanë i citojnë në fusnotën nr. 936 nuk vërtetojnë konstatimin e tyre tërësisht notor si më sipër: në këto faqe, **Rebecca Ananian-Welsh** dhe **George Williams** flasin për aspektet krahasuese të pavarësisë së gjyqësorit, në ndërkohë që më vonë, në pjesën III ("Australian Cases") dhe IV ("Gaps and Weaknesses") bëhet fjalë për Australinë.

Obsesioni i autorëve tanë me Kushtetutën e vitit 2008 si akt konstituiv i Shtetit të Kosovës përshkohet në tërë tekstin e këtij kapitulli, kurse

çështja e sistemit hibrid parlamentar-presidencial vihet në kontekstin e librit "Kushtetuta e Kosovës në një vështrim krahasues" (Dudaj: Tiranë, 2009), të autorit shqiptar **Luan Omari**. Kjo bëhet në tekstin që shoqëron fusnotën nr. 920: autori **Luan Omari**, megjithatë, nuk sugjeron, lëre më ta thotë një gjë të tillë. Këtë nuk e thotë askush në këtë botë sepse nuk është ashtu. Këtë aspekt do ta trajtojmë gjerësisht në pjesën që bën fjalë për Presidentin e Republikës së Kosovës (kapitulli IV i kësaj pjese). Me këtë rast, megjithatë, duhet ta ritheksojmë të plotë atë që në të vërtetë e thotë **Luan Omari** në fq. 21, të cilën fq. e manipulojnë autorët tanë. Në këtë faqe, Luan Omari thotë si vijon:

> Republika e Kosovës ka një formë qeverisjeje parlamentare sepse Parlamenti (Kuvendi i Kosovës) dhe Qeveria janë të lidhur me një raport besimi, ndërsa Presidenti i Republikës është një organ kushtetues, i ndarë nga Qeveria.

Nuk ka si më qartë të sqarohet me pak fjalë esenca e një forme parlamentare të qeverisjes. T'i kthehemi tani analizës sonë kritike të seksioneve të këtij kapitulli.

Analiza kritike

Seksionin e parë "Misioni i Kushtetutës së Republikës së Kosovës" (fq. 301-302), autorët e fillojnë me një konstatim apodiktik që thotë se "Kushtetuta te populli shqiptar nuk kuptohet thjeshtë vetëm si akt më i lartë juridiko-politik. Ajo për ne ka domethënie shumë të gjërë dhe jo rrallë edhe emocionale". Nuk do shumë mend për të kuptuar se kjo vlen për çdo popull, jo vetëm për shqiptarët: para lindjes së borgjezisë, ky ka qenë një slogan i aristokracisë evropiane që po shndërrohej në borgjezi dhe, më pastaj, slogan i vetëm borgjezisë. Përveç kësaj, Kushtetuta e vitit 2008 nuk hyn në radhën e kushtetutave nacionaliste, përkatësisht në radhën e kushtetutave që definohen sipas kriterit etnik-nacional. Këtë më vonë e thonë edhe vetë autorët tanë. Kjo, megjithatë, këtu nuk ka rëndësi: e cituam vetëm për të vënë në dukje narrativin jojuridik dhe sociologjik-politik të kultivuar nga autorët tanë për çështjet fundamentale të së drejtës kushtetuese. Ky narracion përshkon tërë tekstin. Citimi si më sipër nuk është përjashtim: në po të njëjtën faqe, fq. 301, autorët tanë në paragrafin e dytë e vejnë Kushtetutën në të njëjtin nivel me Deklaratën e Pavarësisë, për ta ngritur në rend të parë vetëm një paragraf më pas: duke folur për misionin e Kushtetutës së vitit 2008, në vend se kjo të diskutohej në pjesën mbi

Deklaratën e Pavarësisë dhe Preambulën e Kushtetutës, autorët potencojnë se Kushtetuta e Kosovës ka qenë dhe është dokument themelues i Shtetit të Kosovës dhe e cilësojnë si "kushtetutë konstituive". Këto lloj kushtetutash, gjithnjë sipas tyre, njihen si kushtetuta themeluese të shtetit. Këtë e thonë në fusnotën e tyre nr. 882, pa cituar asnjë burim për këtë konstatim, dhe e ripërsërisin në fq. 302 të seksionit të njëjtë. Kjo nuk mund të jetë aspak e vërtetë për një arsye të thjeshtë: kushtetuta, që nga lindja e saj, ka pasur dhe ka për objekt rregullimin e organizimit shtetëror dhe politik dhe të origjinës së tij. Më vonë kanë hyrë në objekt të rregullimit kushtetues edhe çështjet e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe çështjet e tjera që dikur nuk kanë qenë objekt rregullimi kushtetues. Është e vërtetë se koncepti i kushtetutave konstituive është i njohur në teorinë e së drejtës kushtetuese, mirëpo me një kuptim krejtësisht të ndryshëm nga ajo që thonë autorët tanë: kushtetutat e tilla nuk formojnë shtet, sepse kushtetutat asnjëherë nuk themelojnë shtetet. Të llojit konstituiv konsiderohen ato kushtetuta që, pas një revolucioni të suksesshëm, krijojnë institucionet e reja nga e para, pra nuk bëhet fjalë për ndryshimin e aparatit shtetëror dhe mënyrës së funksionimit të tij por për krijimin nga e para të një strukture shtetërore. Te këto kushtetuta, fokusi është gjithnjë normimi i strukturës organizative të shtetit, origjinës së pushtetit dhe rolit të individit në raport me pushtetin dhe në përgjithësi normimi i pozitës së individit në shoqëri. Kështu e thonë autorët eminentë të së drejtës kushtetuese (Cf. Dieter Grimm, "Types of Constitutions", botuar në Michael Rosenfeld & András Sajó, eds., ***The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*** (Oxford UP: Oxford, 2012, fq. 98-132 në fq. 108).

Seksioni në vijim, i dyti me radhë, "Tiparet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës" (fq. 302-305), po ashtu nis dhe mbyllet me konstatimin se Kushtetuta e vitit 2008 përbën dokumentin që themeloi Shtetin e Kosovës. Mirëpo, në fund të seksionit japin një cilësim interesant duke thënë se përkundër karakterit konstituiv dhe shtetformues, Kushtetuta promovon një sovranitet të kufizuar. E kanë fjalën për pavarësinë e mbikëqyrur, ani se flasin me foljet në kohën e tashme. As edhe një fjalë nuk thonë se cili është lloji i demokracisë që promovon Kushtetuta e Kosovës (sic!). Lexuesi duhet ta dijë se demokracia në Kosovë është e llojit konsociacional, i zbatuar në rastin e Libanit, Qipros dhe Bosnjë-Hercegovinës. Kjo shpjegon pse në Kosovë nuk mund të ketë minoritete por komunitete, si dhe faktin që asnjë ndryshim kushtetues dhe asnjë përbërje e organeve shtetëror edhe organeve të tjera publike nuk mund të përjashtojë nga pjesë-

marrja substanciale komunitetet kosovare që janë në pakicë. Kjo shpjegon gabimin që e bëjnë autorët tanë në fq. 303-304 kur konstatojnë në mënyrë pompoze se askund në botë nuk ka trajtim të favorshëm të minoriteteve siç e ka Kosova. Ka raste të tjera, përveç atyre si më sipër, siç janë, ta zëmë, Rumania dhe Finlanda.

Në seksionin "Parimi i supremacisë së Kushtetutës" (fq. 305-306), autorët provojnë të arsyetojnë me terma dogmatikë supremacinë e **Pakos Ahtisaari** në një periudhë të caktuar, kurse në atë në vijim, "Parimi i sundimit të ligjit" (fq. 306-307) barazojnë në tërësi konceptin e parimit të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, parimin e sundimit të ligjit. Parimi kushtetues i sundimit të ligjit, në njërën anë, dhe parimi i supremacisë së ligjit, në anën tjetër, janë dy gjëra të ndryshme: ky i fundit vlen akoma në Britaninë e Madhe dhe në sistemet kushtetuese që modelohen sipas saj (disa nga ish-kolonitë britanike), në ndërkohë që sundimi i ligjit paraqet një standard të përbashkët që ekziston si në vendet që kanë mbështetje në supremacinë (epërsinë) e kushtetutës ashtu dhe në ato që kultivojnë supremacinë (epërsinë) e ligjit.

Në përfundim të seksionit "Parimi i enumeracionit taksativ të juridiksionit kushtetues" (fq. 307-308), autorët konstatojnë se Kosova ka përqafuar formën pozitive të këtij parimi. Sipas tyre, ekzistojnë dy forma: njëra formë (pozitive) niset nga numërimi taksativ i fushës së veprimtarisë së një organi kushtetues, kurse tjetra formë (negative) niset nga e kundërta e kësaj – ndalon në mënyrë shprehimore se në cilat çështje nuk mund të përcaktohet juridiksioni kushtetues. Për këtë konstatim tërësisht hamendësues, autorët tanë nuk citojnë asnjë burim, gjë që është krejt normale sepse nuk ekziston një burim tjetër pos autorëve tanë që thotë një gjë të tillë. Esenca e këtij parimi, që nuk përcaktohet me kushtetutë por përbën një qasje doktrinare moderne, qëndron në atë se, sipas rregullit, çdo veprimtari e një organi, fizionomia e tij dhe çështjet e tjera themelore rreth organizimit dhe të drejtave e detyrimeve që i takojnë duhet të përcaktohen me kushtetutë. Kosova nuk bën përjashtim në këtë drejtim: çdo juridiksion i organeve publike ka bazën në Kushtetutën e vitit 2008. Ka raste, megjithatë, kur Kushtetuta autorizon që edhe normat tjera mund të shërbejnë si parametër kushtetues për vlerësimin e juridiksionit të një organi. I tillë është rasti, ta zëmë, me normat që kanë të bëjnë me Rregulloren e Punës të Kuvendit të Kosovës apo me juridiksionin shtesë të Gjykatës Kushtetuese nga neni 113.10 i Kushtetutës. Në vendet evropiane, një rast interesant që vlen të veçohet paraqet **Franca** dhe i a.q. ***bloc de***

constitutionalité: me këtë term nënkuptohet situata që **Këshilli Kushtetues i Francës** duhet të marrë parasysh edhe normat, frymën dhe shpirtin e Deklaratës për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit (1789) dhe Preambulën e Kushtetutës së vitit 1946 me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve franceze. Nga kjo del se Këshilli Kushtetues Francez nuk ka të numëruar taksativisht juridiksionin e vet por ai gjendet i shkapërderdhur në disa dokumente kushtetuese, të cilat së bashku shërbejnë si parametra vendimtarë me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve franceze. (Cf. më shumë për këtë në Dominique Rousseau, ***Droit du contentieux constitutionnel***, 10ème édition, LGDJ: Paris, 2013, fq. 95-132)

Në seksionin "Parimi i demokracisë kushtetuese dhe parlamentare" (fq. 309-311), lexuesi mbase mund të presë sqarime për fizionominë e vërtetë të demokracisë kosovare: autorët nuk e zënë në gojë fare demokracinë konsociacionale në Kosovë, e cila dominon dhe përshkon secilin institucion shtetëror dhe publik, si dhe përcakton përmbajtjen e ligjeve dhe normave të tjera juridike. Ky lloj demokracie e radhit Kosovën në të njëjtin vend me **Qipron, Libanin** dhe **Bosnjë-Hercegovinën.** Autorët tanë përzgjedhin vetëm dy cilësi të demokracisë liberale perëndimore kosovare: e para, cilësinë e demokracisë kushtetuese dhe, e dyta, cilësinë e demokracisë parlamentare. E keqja e këtij seksioni qëndron se, përkundër titullit të fuqishëm, lexuesi fare nuk do ta marrë vesh në fund se çfarë nënkuptohet me njërën e çfarë me tjetrin lloj të demokracisë. Që në fillim, autorët thonë, *inter alia*, se:

> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në bazë të këtij parimi proklamon Republikën e Kosovës, si një shtet me rregulla të qarta të demokracisë parlamentare, ku pak a shumë ka disa kritere të ngjashme të demokracisë parlamentare, në përjashtim të asaj që prish këto rregulla në Kosovë, e që ka të bëjë me pozitën e pakicave dhe vendet e rezervuara. Pra vendet e rezervuara në këtë rast prishin kriterin e parimit të proporcionalitetit.

Në paragrafët në vijim, autorët konstatojnë se zgjedhja e Presidentit nga ana e Kuvendit të Kosovës përbën një ndër cilësitë e sistemit parlamentar kosovar, krahas cilësisë tjetër të këtij të fundit e që është "institucioni më aktiv kushtetues". Fjalitë si më sipër, përveç që si ndërtim (konfiguracion) mendimi paraqiten shumë kaotike, siç është shumica e tekstit të këtij libri, brendia e pohimeve që përbëjnë fjalitë nuk kanë të bëjnë me realitetin për shkaqet si vijon:

- e para, në Kosovë më nuk ka vende të rezervuara për komunitetet kosovare dhe citimi i autorëve **Fisnik Korenica** e **Dren Doli** është një manipulim brutal sepse ata nuk thonë të njëjtën gjë: përkundrazi, në fq. 45-48 të librit të tyre ***Constitutional Law in Kosovo*** (Kluwer Law International: The Netherlands, 2012), të cilin autorët tanë e manipulojnë në fusnotën nr. 911, bëjnë fjalë për demokracinë konsociacionale në Kosovë, si një demokraci kundërmazhoritare; diskutimi i autorëve **Fisnik Korenica** dhe **Dren Doli** është mjaft afirmativ, me kompetencë dhe shterues, duke konkluduar se, në krahasim me Bosnjë-Hercegovinën, modeli kosovar i demokracisë konsociacionale është integrativ, jo akomodues, gjë që nuk lejon bllokimin e institucioneve për shkak të natyrës së tij fleksibile;
- e dyta, sistemi zgjedhor proporcional nuk prishet si pasojë e ekzistimit të vendeve të rezervuara, të cilat kanë ekzistuar si zgjidhje e përkohshme dhe kanë qenë pjesë e diskriminimit pozitiv, sepse një sistem proporcional zgjedhor ka me dhjetëra modalitete ku asnjëri nuk është i ngjashëm me tjetrin, pos cilësorit "proporcional";
- e treta, në vijim të kësaj si më sipër, një sistem parlamentar nuk përcaktohet nga fakti nëse parlamenti zgjedh shefin e shtetit e as nëse i njëjti organ përfaqësues është aktiv në krahasim me organet e tjera kushtetuese. Ajo që përcakton një sistem si parlamentar konsiston në rolin vendimtar të përfaqësuesit të sovranit në formimin, kontrollimin dhe delegjitimimin e ekzekutivit të vendit, si dhe të organeve të tjera dhe institucioneve që ushtrojnë autorizime ekzekutive në emër të shtetit.

Autorët në këtë seksion nuk ndalojnë vetëm me këto gabime themelore: në fq. 310 konstatojnë se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në rastin KO 119/14: "ka përcaktuar rregullat e konstituimit të Parlamentit si rregulla themelore të funksionimit të demokracisë parlamentare". Asnjëherë Gjykata Kushtetuese nuk ka përcaktuar rregullat e konstituimit të Kuvendit të Kosovës: ajo vetëm ka interpretuar ato ashtu siç janë shkruar në Kushtetutën e vitit 2008. Ky konstatim i autorëve bie ndesh edhe me parimin e enumeracionit pozitiv, të cilin ata vetë e kanë zbuluar: ky parim nuk lejon që Gjykata Kushtetuese të përcaktojë një gjë të tillë, pra normat mbi konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Këtë kompetencë Kushtetuta ia ka lënë vetë këtij organi si ligjvënës dhe si kushtetutë-vënës nacional i Kosovës. Përveç kësaj, ky konstatim i autorëve bie ndesh edhe me vetë juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese nga nenet 112

dhe 113 të Kushtetutës. Konstatimi i mësipërm i autorëve tanë buron, siç e kemi thënë më herët, nga mosnjohja e tyre e dallimit mes interpretimit dhe kontrollit kushtetues.

Seksioni në vijim nuk është diçka më i mirë se pararendësi: përveç që ripërsërisin në mënyrë krejtësisht dogmatike normat kushtetuese që flasin për ndarjen dhe balancimin e pushteteve, autorët tanë nuk bëjnë asgjë tjetër. Kjo qasje e tyre përfundon me tautologji dhe lojë fjalësh pa asnjë relevancë: lexuesi asnjëherë nuk do të kuptojë se çfarë përmban ky parim dhe cila është esenca e tij. Që nga viti 1748 kur dijetari francez **Montesquieu** e formuloi e deri më sot koncepti bazë i parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk ka ndryshuar: si një mekanizëm, ndarja bazohet në saktësimin e qartë të kompetencave dhe fushës së veprimit të organeve kryesore kushtetuese, legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, si dhe caktimin e jokompatibiliteteve personale dhe vendimmarrëse në kushtetutë në një mënyrë të qartë. Ajo që dallon nga koha e **Montesquieu** konsiston në modalitet e balancimit, të cilat janë zhvilluar jashtë mekanikës monteskiane të ndarjes së pushteteve si më sipër, përkatësisht në zbulimin e modaliteteve të tjera të balancimit të dinamikave të pushtetit. Në këtë kuadër hyn edhe roli i shefit të shtetit, si një balancues i fortë në veçanti në një demokraci parlamentare dhe gjysmëpresidenciale (sepse në sistemin e mirëfilltë presidencial shefi i shtetit vetë është pjesë e pushteteve të ndara dhe nuk mund të balancojë). Nuk bëjnë pjesë në instrumentet balancuese gjykatat kushtetuese: roli i tyre nuk është balancimi por ruajtja e kushtetutës, frymës dhe shpirtit të saj përmes interpretimit dhe kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë. Këto dy kompetenca nuk i ka asnjë organ tjetër, përfshirë këtu shefin e shtetit. Këtë e diskutojmë më gjerësisht në vijim në pjesën për Presidentin e Republikës në kapitullin IV të kësaj pjese. Në disa vende ish-komuniste, shefit të shtetit i jepet roli i ruajtësit të Kushtetutës, mirëpo ato modele janë gjysmëdiktatura, në emër të instalimit të sistemit presidencial: këtu e kemi fjalën kryesisht për disa vende të Azisë Qendrore dhe të Amerikës Latine.

Seksioni i mësipërm i këtij kapitulli mbyllet nga autorët tanë me një konstatim që ka të bëjë me rolin dhe pozitën e Presidentit të Kosovës, i cili aspak nuk qëndron: në fq. 311 thonë se Kosova ka sistem gjysmëpresidencial që veçohet me disa kompetenca të forta të Presidentit. Nuk ka asnjë kompetencë ekzekutive Presidenti i Kosovës: nga të gjithë kompetencat që ka sipas nenit 84 të Kushtetutës, asnjë nuk ka natyrë autonome dhe ekzekutive në të njëjtën kohë.

Seksioni që do të duhej të sqaronte për studentin dhe lexuesit esencën e parimit të diskriminimit pozitiv (fq. 311-312) fillon mbrapsht: pasi konstatojnë se këtë parim e proklamon Kushtetuta e Kosovës (pa cituar asnjë dispozitë relevante për këtë konstatim), autorët tanë thonë se kapitulli i tretë i saj paraqet bazën e diskriminimit pozitiv në Kosovë. Kjo përbën një gabim themelore sepse ky kapitull reflekton formën e demokracisë konsociacionale në Kosovë dhe ka natyrë të përhershme, për dallim nga diskriminimi pozitiv që ka natyrë të përkohshme sepse synon adresimin e pabarazive mes grupacioneve dhe individëve të ndryshëm në një shoqëri. Kapitulli i tretë i Kushtetutës së Kosovës, siç e thotë vetë dispozita kushtetuese e nenit 57.1, përmban të drejta të veçanta për komunitetet krahas atyre nga kapitulli pararendës. Miratimi i masave adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore nuk konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit. Kështu thotë dispozita e nenit 58-4 të Kushtetutës. Kapitulli i tretë, thënë me fjalë të tjera, mishëron llojin e demokracisë konsociacionale kosovare dhe fare nuk ka të bëjë me diskriminim pozitiv. Këtë seksion, autorët e mbyllin me konstatimin që thotë se Gjykata Kushtetuese e Kosovës, jo Kushtetuta e vitit 2008, ka vënë bazat e diskriminimit pozitiv sipas kapitullit të tretë (sic!).

Seksioni "Parimi i rishikimit gjyqësor të legjislacionit" (fq. 312-313) po ashtu nis me shpërfaqje të mosnjohjes themelore të dallimit mes kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë dhe interpretimit kushtetues: për të parin thonë se i takon doktrinës "juridical review" (e pakuptimtë në tërësi), kurse për të dytin nuk dinë ta thonë asnjë fjalë. Për më tepër, autorët këtë parim, parimin e rishikimit gjyqësor të legjislacionit e lidhin me parimin e sigurisë juridike: dhe ekziston në të gjitha kushtetutat e vendeve demokratike të botës (fq. 313). As e para e as e dyta nuk është e saktë në aspektin profesional dhe shkencor. Kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë së ligjeve nuk e rrit sigurinë juridike: përkundrazi, instituti i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve rrit pasigurinë juridike dhe ankthin e qytetarëve, me të vetmin qëllim sigurimin e një vlere më të madhe dhe më sublime se siguria e individit. Ajo vlerë më sublime dhe më e madhe që sigurohet përmes institutit të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve quhet supremaci (epërsi) e kushtetutës, e vlerave dhe parimeve të saj. Kjo është arsyeja që për procedurat e vënies në jetë të këtij instituti çdokund parashikohen afate të sakta dhe prekluzive, pikërisht për të ndërprerë ankthin e qytetarëve në mënyrë që një ditë të jenë të sigurt se të drejtat e njohura

apo të fituara sipas ligjit do të bëhen të përhershme. Ajo që kontribuon dukshëm në sigurinë juridike të qytetarëve mishërohet në një parim tjetër, të cilin autorët tanë fare nuk e përmendin në asnjë vend. E kemi fjalën për parimin e prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kjo është esenca e sigurisë juridike kundrejt institutit të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave e veprimeve të tjera juridike.

Sa i përket asaj që thonë autorët se parimi i rishikimit gjyqësor të legjislacionit gjendet në çdo kushtetutë të vendeve demokratike, vlen të rikujtojmë të njëjtit se vendet skandinave, Holanda dhe Britania e Madhe (së bashku me disa prej ish-kolonive të saj) nuk njohin fare kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave juridike (që autorët tanë e shprehin me fjalët e këtij seksioni si "parimi i rishikimit gjyqësor të legjislacionit").

Seksioni i parafundit, i titulluar çuditshëm si "Parimi i prezumcionit absolut të lirisë së qytetarit dhe shtetasit" (fq. 313-314), nga fillimi deri në fund përmban të dhëna e shtjellime jo të sakta. Titulli është i çuditshëm sepse bën dallimin mes qytetarit dhe shtetasit, një dallim ky që i takon konstitucionalizmit ish-jugosllav dhe që sot nuk ka një kuptim dhe nuk e njeh Kushtetuta e vitit 2008, kurse pasaktësia qëndron në keqkuptimin e dispozitave kushtetuese që mbrojnë këtë parim. Ato dispozita, në çdo tekst kushtetues të vendeve demokratike (që kanë kushtetutë të shkruar), njihen si "karta mbi liritë dhe të drejtat e njeriut" dhe përcaktojnë me saktësi kufijtë e lirive dhe të drejtave njerëzore dhe rastet kur mund të ketë shmangie nga zbatimi i disa prej tyre në gjendjet e jashtëzakonshme, të shkaktuara nga lufta, shtetrrethimi, katastrofat natyrore dhe faktorët e tjerë. Në të njëjtën kohë, dispozitat kushtetuese mbi të drejtat e liritë njerëzore përmbajnë edhe garancitë absolute, kur disa nga të drejtat e liritë njerëzore, siç është e drejta për jetë, asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk mund të derogohen. Në Kushtetutën e vitit 2008, këto dispozita gjenden në nenet 55 & 56.

Kapitulli II. Përmbajtja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (2008): Preambula dhe parimet themelore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (fq. 315–333)

Përgjithësisht

Ky kapitull përbëhet nga 14 seksione. Edhe në këtë kapitull, cilësitë themelore janë të njëjta me kapitujt pararendës: e para, narrativi është shumë kaotik dhe përmban konstatime paushalle dhe jo të sakta, të cilat i diskutojmë në vijim një nga një; dhe, e dyta, literatura e përdorur në masë të madhe është e manipuluar. Në fakt, në këtë kapitull kemi hasur një burim që fare nuk ekziston: e kemi fjalën për fusnotën nr. 966. Sidoqoftë, teksti i prodhuar përmes përdorimit të burimeve në këtë kapitull, qartë duket se ka përmbajtje të dyshimtë ngaqë brendia e burimeve është e ndryshme nga ajo për çka i citojnë autorët tanë. Të shohim si duket kjo më nga afër.

Duke folur për strukturën e Kushtetutës së vitit 2008, autorët në mënyrë të paskrupullt citojnë dy fusnota, fusnotën nr. 939 & 934, të cilat si dije dhe si fakt janë të marra nga fq. 55 e librit *E drejta kushtetuese* (Fakulteti Juridik i UP-së: Prishtinë, 2004) të autorit **Kurtesh Saliu.** Ajo çfarë kanë bërë autorët tanë është se fare nuk e kanë cituar autorin e sipërcekur dhe, në vend të kësaj, kanë dhënë një konstatim notor dhe të ditur nga çdokush, sipas të cilit çdo kushtetutë e shkruar, jashtë çdo dyshimi, rregullon fushat e caktuara sipas kapitujve, seksioneve, neneve, paragrafëve dhe kështu me radhë. Këtë e thotë shumë bukur autori **Kurtesh Saliu** në librin e sipërcekur, pa pasur nevojë të citojë askënd sepse një gjë e tillë dihet botërisht. Ajo që e dallon tekstin e autorëve tanë nga ai i **Kurtesh Saliut**, në fakt, konsiston në atë se autorët tanë kanë një tekst kaotik dhe jo të sistemuar. Në fusnotën tjetër, fusnotën nr. 934, duke përdorur idenë nga teksti i autorit **Kurtesh Saliu,** autorët tanë përmendin rastet e **Gjermanisë**, **Austrisë**, **Argjentinës** etj., në ndërkohë që autori **Kurtesh Saliu** në mënyrë shumë precize konstaton se federatat kanë dispozita të veçanta kushtetuese që normojnë marrëdhëniet mes qendrës dhe njësive federale.

Në fusnotën nr. 941, autorët tanë thonë se ka ekzistuar një grup i ngushtë për hartimin e Kushtetutës së vitit 2008, i cili ka bërë edhe harmonizimin përfundimtar të tekstit të saj, në ndërkohë që në pjesën e tek-

stit sipër që e shoqëron këtë fusnotë konstatojnë diçka krejtësisht tjetër: Preambula, thonë autorët tanë, ishte shkruar në fund të procesit, pasi ishte përpiluar pjesa tjetër e tekstit të Kushtetutës. Autorët e huaj të cilët kanë qenë intensivisht të involvuar në procesin e draftimit të tekstit të Kushtetutës, ndërkaq, thonë krejt diçka tjetër. **John Tunheim** thekson se në fund të dhjetorit 2007 ka qenë gati teksti i asaj që sot është Kushtetuta e vitit 2008, e cila, sipas tij, është shpallur në internet disa orë pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008 me qëllim të fillimit të debatit publik për draftin; po ashtu, ky autor thekson se harmonizimi i tekstit ishte bërë me disa vështirësi, por versioni në gjuhën angleze ishte përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe menjëherë pas dhjetorit 2007 (cf. John Tunheim, "Rule of Law and the Constitution of Kosovo", *Minesota Law Review*, vol. 18, issue 2, 2009, fq. 371-379 në fq. 377-378). Autori tjetër, **Louis Aucoin** nuk thotë diçka ndryshe në një intervistë të tij (Cf. "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo. Interview with Professor Louis Aucoin". *PRAXIS The Fletcher Journal of Human Security*, vol. XXIII, 2008, fq. 123-128). I treti autor, **Marc Weller**, në këtë drejtim është më i detajuar: krahasimi i asaj që thotë ky autor me dy autorët e mësipërm e plotëson në tërësi mozaikun rreth procesit (ecurisë) së draftimit të Kushtetutës së vitit 2008 dhe rolit të ekspertizës ndërkombëtare në ndërtimin e pushtetit konstituiv origjiner (***pouvoir constituant originaire***) të kosovarëve. E kemi fjalën për librin Marc Weller, ***Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*** (KOHA: Prishtinë, 2009). Ky autor, pasi konstaton se autorët vendorë, ndër ta edhe autori i parë i librit që është objekt i kësaj analize, kanë pasur kryesisht rolin e zbutësve të disa prej anëtarëve vendorë të Komisionit Kushtetues, të cilët, gjatë procesit të draftimit dilnin me propozime të "egra" dhe të kundërta me Planin Ahtisaari, në të njëjtën kohë i jep arsyet reale se përse hartimi i Preambulës ka hasur në vështirësi (Cf. **Marc Weller**, vep. e cit., fq. 399-403). Vështirësitë kryesore rreth Preambulës nuk kanë pasur fare të bëjnë me anën profesionale, siç thonë autorët tanë, por me diçka krejt tjetër. Për këtë arsye ne do të citojmë në tërësi pjesën nga faqja 406 e librit të Marc Weller:

> Preambula e Kushtetutës është shumë e shkurtër. Përmbajtja e saj ka shkaktuar një betejë të gjatë me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Kosovarët donin ta reflektonin luftën e tyre për shtetësi, përfshirë edhe sakrificat e tyre në preambulë. Mirëpo, kjo u paraqit si e papranueshme, ngase referenca të tilla do të mund të sugjeronin se

> Kosova e konsideronte veten si vatër e titullarit – kombit shqiptar etnik – duke i përjashtuar komunitetet tjera.

Në fusnotat 945-946, autorët në mënyrë shumë brutale manipulojnë me një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese. Një rast i iniciuar sipas kërkesës individuale, rasti **KI 25/10**, u ka mjaftuar autorëve tanë për të ardhur te konstatimi se Gjykata Kushtetuese ka fuqizuar të gjitha normat e Kushtetutës së vitit 2008 pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ky rast nuk ka pasur për objekt vendosje lidhur natyrën juridike të pushtetit konstituiv origjiner (***pouvoir constituant originaire***) të kosovarëve, por lidhur me një ankesë individuale të AKP-së (Agjencia Kosovare e Privatizimit), e cila kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Rasti i mendimit të **GJND**-së është përdorur nga ana e Gjykatës Kushtetuese për të treguar se **Gjykata Supreme e Kosovës**, përfshirë strukturat vendimmarrëse ndërkombëtare në kuadër të saj, duhet të zbatojë ligjin në mënyrë uniforme për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Kjo duhej të bëhej sepse **GJND** kishte konstatuar se Kosova nuk ka shkelur asnjë prej llojeve të së drejtës ndërkombëtare. Kaq! Asgjë tjetër!

Manipulimi i radhës haset në fusnotën nr. 950, ku autori i cituar gjoja ka thënë se **Jean-Jacques Rousseau** ka qenë frymëzues i **Revolucionit në Amerikë**. Kjo nuk është e saktë: autori **C.E. Merriam Jr.**, i cili citohet në fusnotën nr. 950, në fq. 5-20 diskuton gjerësisht idenë e sovranitetit dhe e nis me Aristotelin, vazhdon me romakët dhe kalon në dalje të Mesjetës te **Jean Bodin**, autori i parë që në modernitet ka trajtuar gjerësisht teorinë e sovranitetit. Pastaj, Merriam tregon dallimet mes Bodinit dhe autorëve të mëvonshëm si **Johannes Althuser**, **Hugo Grotius**, **Thomas Hobbes** e deri te **Rousseau**. D.m.th., **Rousseau** është i fundit dhe atë në vetëm një fq. me të cilin merret Merriam. Faqet që citohen nga autorët tanë në fusnotën nr. 950, pra fq. 5-11, asnjëherë nuk zënë në gojë **J.J. Rousseau**. Kjo qasje tregon se autorët tanë nuk e kanë të qartë se cilët mendimtar evropianë kanë pasur ndikim në **Revolucionin Amerikan** e cilët në **Revolucionin Francez**: në të parin, **John Locke** ka qenë vendimtar, kurse në të dytin **J.J. Rousseau**. Ky ndikim ka prodhuar dy sisteme politike dhe kushtetuese shumë të ndryshme në dy anët e Atlantikut sot e kësaj dite.

Manipulimi i burimeve këtë herë vazhdon me një autor vendor: në fusnotën nr. 1005, autorët citojnë fq. të një shkrimi të autorit **Qerim Qerimi** të botuar në ***E drejta/Law*** (nr. 2/2010). Sipas tyre, **Qerim Qerimi** paska

thënë se ekzistojnë tri lloje kryesore të marrëveshjeve ndërkombëtare ose thënë ndryshe, siç e thonë ata, të traktateve:

- marrëveshjet ndërkombëtare kontrata;
- marrëveshjet ndërkombëtare ligjbërëse; dhe
- marrëveshjet ndërkombëtare legjislative.

Qerim Qerimi nuk ka thënë kështu siç e thonë autorët tanë, përkatësisht e ka thënë në një kontekst krejt tjetër, jo në kontest të diskutimit lidhur me llojet e marrëveshjeve ndërkombëtare. Shkrimi në fjalë ka të bëjë me definimin e natyrës juridike të marrëveshjeve ndërkombëtare: sipas këtij aspekti, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare ndahen në dy lloje, në ndërkohë që autori **Qerim Qerimi** mendon se ekziston edhe një kategori e tretë e marrëveshjeve ndërkombëtare, por që manifestohet shumë rrallë. Kjo, në thelb, nuk ndryshon esencën e dikotomisë së marrëveshjeve ndërkombëtare sipas efektit të tyre juridik që e prodhojnë ndaj ambientit të jashtëm (Cf. **Qerim Qerimi**, vep. cit., 74-75). Klasifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërkaq, është një çështje tjetër dhe është shumë më i gjerë se kaq. Në fakt, është i pafund, aq i pafund sa nuk lejon që këtu ta torturojmë lexuesin tonë me çështje që nuk kanë asnjë relevancë për të drejtën kushtetuese. Ajo që ka relevancë për të drejtën kushtetuese është marrëdhënia mes të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme, jo llojet e marrëveshjeve ndërkombëtare sipas natyrës së tyre juridike: një gjë e tillë komandohet nga rregullat e së drejtës ndërkombëtare mbi traktatet. Lexuesi kurioz mund të gjejë informata të sakta dhe me bollëk rreth dallimit mes **traktateve ligje** (normëvënëse) dhe **traktateve kontrata** në secilin libër të së drejtës ndërkombëtare publike, përfshirë të gjitha botimet e librit të së drejtës ndërkombëtare nga prof. **Zejnullah Gruda**.

Para këtij manipulimi, autorët tanë në fusnotën nr. 1003 abuzivisht manipulojnë me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969 (**KVDT**), pa ia cituar asnjë nen dhe pa ia kuptuar dispozitat kryesore, të cilat sqarojnë se zbatimi i tyre gjen vend vetëm në marrëveshjet që kanë formën me shkrim. Kjo domethënë se autorët tanë e kanë shumë gabim kur thonë se "Termi marrëveshje ose traktat duhet të kuptohet gjithnjë në frymën e Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, atë të 23 majit të vitit 1969".

T'i kthehemi tani analizës sonë kritike të seksioneve të këtij kapitulli.

Analiza kritike

Në seksionin e parë, "Struktura e Kushtetutës së Republikës së Kosovës" (fq. 315-316) konstaton se "Kushtetuta e Republikës së Kosovës paraqet një tekst modern juridik të shkruar me një elegancë juridike dhe me standarde të larta të shkrimit juridik". Në aspektin juridik-kushtetues, gjuha e Kushtetutës së vitit 2008 lë shumë për të dëshiruar, aq shumë sa gabimet dhe joeleganca e shkrimit të saj tradhton jo rrallë herë konfiguracionin logjik të mendimit të zakonshëm. Kështu, ta zëmë, neni 113.5 në gjuhën shqipe dallon dukshëm nga versioni në gjuhën serbe (dy gjuhët janë gjuhë me status të barabartë kushtetues në tërë territorin e Kosovës). Në të shumtën e rasteve, teksti i Kushtetutës në gjuhën shqipe dhe serbe kanë shpërputhje dhe pasaktësi, të cilat nuk figurojnë në gjuhën origjinale në të cilën është shkruar teksti i saj, në gjuhën angleze. Sikundër e pamë më sipër, autorët e huaj që kanë marrë pjesë në procesin e draftimit të saj, na tregojnë se në dhjetor të vitit 2007 ka qenë i gatshëm teksti në gjuhën angleze dhe më pastaj ka ardhur deri te përkthimi i saj. Njëri nga ta, për më tepër, tregon se në debatin publik rreth tekstit përfundimtar kanë pasur ndryshime vetëm rreth 30 për qind dhe atë pjesa e tekstit që nuk ka pasur efekt të drejtpërdrejtë në dispozitat e Planit Ahtisaari (Cf. **Louis Aucoin**, vep. e cit., fq. 125).

Konstatim mjaft absurd kanë dhënë autorët në seksionin "Preambula e Kushtetutës së Kosovës" (fq. 316-317). Ai absurd konsiston si në vijim:

> Jo rrallë, teksti i paekuilibruar i preambulës në pikëpamje etnike ka qenë burim i konflikteve dhe tensioneve politike, siç është rasti i Bosnjës, por edhe i Kosovës.

Nuk besoj të gjendet edhe një autor tjetër të konstatojë se preambula e një kushtetute paraqet shkakun e një konflikti ndëretnik! Nuk besoj se kërkon koment shtesë ky konstatim i autorëve tanë, të cilët preambulën e një kushtetute e shohin si shkak të konflikteve në **Ballkan**!

Duke komentuar nenin 1 të Kushtetutës së vitit 2008, "Përkufizimi kushtetues i Republikës së Kosovës" (fq. 317-318), autorët tanë konkludojnë se "kjo dispozitë kushtetuese është materializim i deklaratës së pavarësisë së Kosovës si dhe i aspiratave shekullore për pavarësi, e cila është vërtetuar edhe me Opinionin e GJND-së". Deklarata nuk materializohet: ajo ka jetën e vet autonome dhe në momentin e shpalljes së saj ka ndodhur materializimi i saj. Natyra e saj juridike është e vetë-ekzekutueshme në sensin që ka krijuar Shtetin e Kosovës (Cf. Colin Warbrick, "Kosovo: The Dec-

laration of Independence", *International and Comparative Law Quarterly*, vol. 57, issue 03, July 2008, fq. 675-690 në fq. 679 & 684; **Marc Weller**, vep. e cit., fq. 377-378). Kjo nënkupton se **Deklarata e Pavarësisë** do të ekzistonte, së bashku me Shtetin e Kosovës të cilin e ka krijuar, edhe pa nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 2008: nxjerrja e kushtetutës sipas germës dhe frymës së Planit Ahtisaari ka qenë detyrim ndërkombëtar i Kosovës me efekt ***erga omnes*** dhe kusht thelbësor për fitimin e njohjeve ndërkombëtare dhe integrimin e vendit në struktura regjionale evropiane dhe në ato të natyrës universale (Cf. **Marc Weller**, vep. e cit., fq. 405; **John Tunheim**, vep. e cit., fq. 375; **Louis Aucoin**, vep. e cit., fq. 125). Thënë me fjalë të tjera, Shteti i Kosovës, i krijuar me Deklaratën e Pavarësisë, do të kishte ekzistuar edhe sikur Kosova të kishte një infrastrukturë tjetër kushtetuese dhe ligjore, siç është ta zëmë rasti i **Izraelit**, që sot e kësaj dite nuk ka kushtetutë: nga premtimi i dhënë me të a.q. **Deklaratën Hariri** për nxjerrjen e një kushtetute, kanë kaluar gati një gjysmë shekulli dhe sot e kësaj dite vendi nuk ka kushtetutë të shkruar.

Në seksionin "Përkufizimi i sovranitetit dhe ushtrimi i tij" (fq. 319-320), autorët tanë nxjerrin disa konstatime eklektive të një natyre shumë të çuditshme, aq sa lexuesit tonë duhet t'ia paraqesim *ad literam* për të kuptuar më mirë qëndrimin tonë dhe të vërtetën rreth asaj që ata thonë. Ai konstatim thotë kështu:

> Kushtetuta e Kosovës sovranitetin ja atribuon përfaqësuesve të popullit, përkatësisht deputetëve dhe qeverisë që rrjedhimisht zgjidhet nga deputetët. Sovraniteti i atribuohet edhe presidentit i cili është edhe përfaqësues i unitetit të popullit. Në praktikën kushtetuese në Kosovë, në vitin 2014 kriza politike qeveritare e cila zgjati disa muaj shfaqi dilema në lidhje me atë që si ushtrohet sovraniteti. Në rastin KO 103/14 Gjykata Kushtetuese e Kosovës sqaroi që Qeverinë kanë të drejtë ta krijojnë vetëm partia politike ose koalicioni i cili ka shumicën në Kuvend, me kusht që kjo shumicë të jetë krijuar para zgjedhjeve dhe që populli të ketë pasur mundësi ta votojë një parti ose një koalicion në fletëvotim. Ky rast ka treguar se shumica krijohet vetëm pas verdiktit të popullit, përmes votës së drejtpërdrejtë. Sipas kësaj logjike një shumicë parlamentare që do të qeverisë vendin dhe që krijohet pas zgjedhjeve nuk është vullneti i popullit andaj ky rast shënon një moment shumë të rëndësishëm në praktikën kushtetuese kosovare, për sa i përket maksimës që sovraniteti i takon vetëm popullit dhe mund të ushtrohet vetëm nga ai.

Nga një lexim fare i përciptë shihet se autorët bëjnë gabim trashanik

lidhur me çështjet si vijon:

- e para, as Kushtetuta e Kosovës dhe asnjë kushtetutë tjetër e një vendi me demokraci liberale kushtetuese nuk ia atribuon sovranitetin përfaqësuesve të popullit sepse sovraniteti është një dhe i pandashëm dhe i takon popullit, që këtë atribut më pastaj e ushtron përmes përfaqësuesve të vet dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me referendum; thënë ndryshe, sovraniteti nuk i takon asnjëherë përfaqësuesve të popullit, të cilët janë përfaqësues të sovranit dhe jo sovrani vetë;
- e dyta, shefi i shteti në një republikë, Presidenti i Republikës, asnjëherë nuk mund të jetë përfaqësues i vullnetit të popullit, por i unitetit të tij juridik-kushtetues, atribut që do ta sqarojmë në detaje në pjesën kur të flasim për Presidentin e Republikës (kapitulli i katërt i pjesës së tretë të analizës sonë kritike);
- e treta, kriza politike e vitit 2014 nuk ka qenë lidhur më mënyrën e ushtrimit të sovranitetit por lidhur më mënyrën e inaugurimit të organeve qendrore të Republikës së Kosovës pas zgjedhjeve nacionale: Gjykata Kushtetuese me vendimin e vet në rastin KO 103/14 asnjëherë nuk ka thënë se shumica duhet të formohet para zgjedhjeve por vetëm se vullneti i shumicës relative në një sistem zgjedhor proporcional siç është Kosova, për qëllimet e inaugurimit (formimit të parë) të organeve qendrore, formohet gjatë procesit zgjedhor të drejtë dhe të rregullt; dhe
- e katërta, në rastin KO 103/14 Gjykata nuk ka thënë se nuk është vullnet i popullit shumica parlamentare që krijohet pas zgjedhjeve: vullnet i popullit është secila votë, po aq sa është tërësia e tyre, kurse formimi i organeve pas zgjedhjeve është një çështje krejtësisht tjetër që nuk duhet të ngatërrohet me vullnetin e popullit ngaqë u nënshtrohet dinamikave politike paszgjedhore dhe rirreshtimeve politike momentale.

Në vijim të këtij konstatimi absurd, në fund të fq. 320 vjen konstatimi tjetër po aq absurd. Edhe ky ka të bëjë me kontekstin e interpretimit të gabuar të vendimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO 103/14: autorët thonë se Gjykata paska pas thënë se "secili ndryshim i raportit të forcave në Kuvend pas seancës së parë (konstituive) nuk pasqyron verdiktin e popullit por vullnetin e partive dhe kalkulimeve politike". Kurrën e kurrës nuk e ka thënë një gjë të tillë Gjykata Kushtetuese: vendimi në rastin KO 103/14 fare nuk ka të bëjë me çështjen e sovranitetit por me rrugën që du-

het ndjekur për inaugurimin e organeve qendrore të pushtetit pas certifikimit të zgjedhjeve nacionale dhe çdoherë kur bie qeveria dhe nuk shkohet në zgjedhje të reja. Sa i përket vullnetit të popullit, ndërkaq, ritheksojmë sërish se atë e përfaqëson secila votë e votuesit, pa marrë parasysh nëse subjekti për të cilin është votuar apo individi kanë kaluar ose jo pragun zgjedhor.

Seksioni mbyllet më një konstatim në vazhdën e konstatimeve jo të sakta në aspektin profesional: thuhet se garant për ruajtjen dhe mbrojtjen e sovranitetit janë Presidenti, deputetët dhe mekanizmat kushtetues të sigurisë etj. Si dëshmi për këtë merret teksti i betimit të Presidentit të Republikës (fq. 321). Kjo nuk mund të jetë e vërtetë në aspektin profesional për arsyen e thjeshtë se në një demokraci kushtetuese presidenciale presidenti nuk mund të ketë një kompetencë të tillë: asnjërin prej mjeteve nga neni 2.2 i Kushtetutës së vitit 2008 nuk i ka në dorë Presidenti i Kosovës. Në vendet me sistem gjysmëpresidencial (**Franca**) dhe në ato me sistem të mirëfilltë presidencial (**SHBA**), shefit të shtetit me kushtetutë ka në dorë mjete të duhura represive të cilat mund të vihen në lëvizje me qëllim të garantimit dhe mbrojtjes së sovranitetit shtetëror. Në disa vende, siç është rasti me Gjermaninë, kjo e drejtë mund t'u takojë edhe qytetarëve në rrethana të caktuara. Kjo, megjithatë, përbën përjashtim dhe rrjedh nga e kaluara tragjike e popullit gjerman me diktatorin nazist **Adolf Hitler**.

Seksioni "Bartja e sovranitetit" (fq. 321-322) nis po ashtu me gabime thelbësore profesionale: sovraniteti cilësohet si "pushteti më i lartë kushtetues", në ndërkohë që i njëjti nuk është asgjë tjetër pos një cilësi e shtetit si subjekt, kurse logjika e ndjekur në nenin 20.1 të Kushtetutës paraqet "zbehje të teorisë së sovranitetit absolut". Vlen të theksojmë, për lexuesin tonë, se çdo kushtetutë në rruzullin tokësor, përfshirë edhe ato që janë me stof kulturor islamik dhe ideologjik, përmbajnë dispozita që rregullojnë bartjen e sovranitetit, organet dhe procedurat e bartjes, në subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare. Ky nuk është lëshimi i vetëm në këtë seksion: me miratimin e Ligjit nr. 04/L-274 është ratifikuar marrëveshja ndërkombëtare mes Kosovës dhe BE-së, e cila është lidhur përmes letërkëmbimit mes shefit kosovar të shtetit dhe shefes evropiane për politikë të jashtme dhe të sigurisë. Këtë letër autorët tanë e marrin si "një formë të komunikimit zyrtar kushtetues", gjë që është tmerrësisht gabim: letërkëmbimi përbën njërën nga pesë format e shprehjes së vullnetit për të qenë marrë përsipër detyrime kontraktuale mes subjekteve të së drejtës ndërkombëtare. Këtë e përcakton shumë qartë dispozita e nenit 11 të **KVDT.** Thënë ndry-

she, letërkëmbimi nuk është komunikim zyrtar por marrëveshje ndërkombëtare që i nënshtrohet ratifikimit në të gjitha rastet kur bëhet fjalë për bartje të sovranitetit, konform nenit 20.1 të Kushtetutës. Në rastet kur ky nuk është rasti, atëherë vlejnë dispozitat e nenit 18.2 të Kushtetutës, pra letërkëmbimi shërben si instrument juridik implementues i një detyrimi tjetër të marrë që është në fuqi. Disa kushtetuta, për këso raste në mënyrë shprehimore letërkëmbimet dhe marrëveshjet ndërkombëtare që implementojnë një detyrim ekzistues ndërkombëtar, që ka kaluar procedurat e ratifikimit parlamentar, i cilësojnë si marrëveshje të natyrës teknike, administrative ose ekzekutive. I tillë është rasti, ta zëmë, me seksionin 231.3 të **Kushtetutën së Afrikës së Jugut** (1996) (për komentet doktrinare cf. më shumë trajtimin krahasimor të kësaj teme në punimin e shkëlqyer të autorëve **Gerrit Ferreira** & **Werner Scholtz**, "Has the Constitutional Court found the lost ball in the high weeds? The interpretation of section 231 of the South African Constitution", botuar në *The Comparative and International Law Journal of Southern Africa* (vol. 42, no. 2, July 2009, fq. 264-271).

Seksioni "Ndarja e pushteteve dhe sistemi i qeverisjes" (fq. 322-324), që në titull vërehet se është i gabuar. Autorët, qartë shihet, besojnë se ka një kauzalitet dhe njëjtësi mes ndarjes së pushteteve dhe sistemit të qeverisjes. Kjo shihet qartë nga brendia e tekstit të këtij seksioni: që në fillim konstatohet se pothuajse të gjitha kushtetutat e njohin parimin e ndarjes së pushtetit, gjë që nuk është ashtu (p.sh. vendet ish-komuniste, islame etj.). Po ashtu, ekzistojnë raste kur një kushtetutë e njeh formalisht këtë parim dhe proklamon ndarjen e pushtetit në ndërkohë që në renditje të organeve dhe në përmbajtje të kompetencave në tërësi është diktaturë personale (ta zëmë, ish-**Kushtetuta e Vidovdanit**, 1921, apo **Kushtetuta e Turqisë,** 2017). Forma e qeverisjes nuk përcaktohet nga fakti nëse ka ndarje të pushtetit apo jo, por nga marrëdhënia mes ekzekutivit dhe legjislativit, pastaj nga marrëdhënia e këtyre dyjave ndaj gjyqësorit si pushtet i tretë. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve është i pajtueshëm si me sistemin parlamentar ashtu dhe me atë presidencial dhe gjysmëpresidencial të qeverisjes. Dhe, anasjelltas: çdo sistem parlamentar, presidencial dhe gjysmëpresidencial i qeverisjes mund të akomodojë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Dallojnë vetëm teknikat me të cilat balancohet mekanika dhe dinamika e pushteteve. Për këtë arsye, shefi i shtetit në një demokraci parlamentare, siç është Kosova, ka rol dhe rëndësi tjetër në sistemin e balancimit të tri pushteteve dhe nuk bën pjesë në

asnjërën prej pushteteve: këtu gabojnë autorët tanë kur e fusin, në fq. 322, Presidentin e Republikës në grupin e pushteteve të ndara, siç gabojnë rënd kur thonë, në fq. tjetër, fq. 323-324, se i njëjti organ ka kompetenca ekzekutive të cilat e bëjnë të dyshimtë faktin nëse Kosova është një demokraci parlamentare. Për këtë, autorët citojnë në mënyrë abuzive një autor, në fusnotën nr. 921, që len përshtypjen se ky autor i huaj mendon si autorët tanë, pra se Presidenti i Republikës paska kompetenca të forta që janë cilësi e një republike gjysmëpresidenciale.

Nuk ka asnjë rëndësi nëse kushtetuta e definon shprehimisht nëse Kosova është demokraci parlamentare, siç bëjnë autorët tanë në fq. 323, por përshkrimi i kompetencave dhe ndarja e tyre në detaje mes tri pushteteve, ku Presidenti i Republikës nuk hyn në asnjërën prej tyre: ajo/ai në Kosovë ka rolin e balancuesit dhe asgjë tjetër, si pasojë e kompetencave të natyrës neutrale dhe të ndërmjetme. Këtë do ta diskutojmë gjerësisht, sikundër kemi paralajmëruar më herët, në pjesën e analizës për kapitullin e katërt të kësaj pjese të librit. Aq më pak ka rëndësi fakti që autorët e thërrasin në ndihmë të tezës së tyre mbi Presidentin si një lloj gjysmë ekzekutivi kosovar, përkatësisht se kjo ka qenë objekt bisedimi mes forcave politike kosovare gjatë procesit të draftimit të Kushtetutës së vitit 2008 (fq. 323).

Paragrafi në vijim i fq. 324, i fundit që ka të bëjë me këtë seksion, ka një trajtim kaotik që vështirë se mund të kuptohet nga dikush: para se të konstatojnë në fund të paragrafit se Kosova ka një sistem gjysmëpresidencial, autorët i referohen rastit **KO 98/11** (rasti i njohur si rasti i imuniteteve të deputetëve dhe funksionarëve të lartë shtetërorë) dhe mundohen të tregojnë se me atë rast paska pas ardhur deri te prishja e parimit të ndarjes së pushteteve. Këtu aludojnë në faktin se kërkesën për Gjykatën Kushtetuese e ka pas adresuar Qeveria. Ajo çfarë në të vërtetë mund të kontestohet ka të bëjë me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur për çdo kërkesë të ngritur nga Qeveria e Kosovës, dhe jo nëse çështja e vendosjes për imunitetin e deputetëve dhe funksionarëve të lartë shtetërorë sipas kërkesës së një pale të autorizuar bie ndesh me parimin e ndarjes së pushteteve. Kjo për faktin se ekziston një juridiksion tjetër i Gjykatës Kushtetuese që në mënyrë specifike ka të bëjë me sigurimin dhe ruajtjen e parimit kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe gjendet në nenin 113.3 (1) të Kushtetutës së vitit 2008 (konflikti për kompetencë).

Pasi dështojnë për të sqaruar demokracinë konsociacionale që ekziston në Kosovë, autorët kënaqen me konstatimin e tyre krejt laik se "Kosova karakterizohet me pjesëmarrjen e theksuar të të gjitha komuniteteve

në jetën publike" (fq. 325), për të vazhduar tutje me diskutimin për simbolet shtetërore të vendit (fq. 325-326). Këtu sërish i kthehen trajtimeve të tyre jo të sakta profesionalisht lidhur me raportin e shtetit me fenë në Kosovës, diçka që gjerësisht kemi folur më herët. Në fusnotën nr. 985 sërish e fusin Greqinë në një thes me vendet demokratike të Lindjes së Mesme (sic!). Kjo është krejt normale sepse, sipas tyre, ka vetëm dy praktika kushtetuese lidhur me raportin mes shtetit dhe fesë. Në fq. përballë, fq. 327, autorët fusin si shembull të laicitetit në Kosovë një aktvendim të Gjykatës Kushtetuese, i njohur si rasti **Arijeta Halimi**. Ky rast, në fakt, fare nuk ka vendosur për asgjë: kjo sepse, çdoherë kur ka aktvendim nuk vendoset për meritat e kërkesës por vetëm për atë nëse kërkesa e palës është e lejueshme për t'u shqyrtuar dhe gjykuar. Këtë, qartë shihet, nuk e kanë të qartë autorët tanë. Të njëjtin gabim e përsërisin lidhur me vendimin për **Presidentin Pacolli**: autorët besojnë se vendimi në rastin **KO 47/16** ka ndryshuar precedentin e vënë me aktgjykimin **KO 29/11** (fq. 405, fusnotat 1258 & 1259). Mënyra si janë trajtuar këto dy raste dhe interpretimet e autorëve në thelb janë një mënyrë oportuniste, me një narrativ kaotik, që ka për qëllim të përçojë një mesazh pajtimi me lexuesin që eventualisht mund të ketë prirje fetare islamike, përkatësisht mund të ketë qëndrim ndryshe rreth emrave të përveçëm që kanë shërbyer ose shërbejnë si presidentë të vendit (sic!). Në një tekst të së drejtës kushtetuese duhet të shtjellohen gjërat ashtu siç thotë kushtetuta dhe teoria krahasuese kushtetuese, përfshirë këtu praktikën gjyqësore vendore dhe krahasuese, jo me hamendësime dhe me konstruksione të pathemelta: precedenti edhe në vendet ku paraqet burim primar të së drejtës i referohet aspekteve meritore, jo procedurale, të kërkesës. Në dy raste si më sipër vendimet e gjykatës kanë natyrën e aktvendimit dhe me këtë lloj vendimi asnjëherë nuk mund të ndërtohet një precedent e as të ndryshohet. Përveç më një vendim tjetër meritor, që ka formën e aktgjykimit në sistemin kosovar, precedenti mund të ndryshohet edhe me amendament kushtetues: kjo për faktin se norma që interpretohet më një vendim të gjykatës kushtetuese ka kuptim vetëm nëse interpretohet në dritën e vendimit të gjykatës së dhënë kushtetuese. Ky standard vlen çdokund që ka gjyqësi të ndarë kushtetuese, përfshirë Kosovën.

Në seksionin për shtetësinë (fq. 328), autorët besojnë se në Kosovë ekziston një mënyrë e veçantë e fitimit të shtetësisë për ata persona që "janë regjistruar si banorë të Kosovës në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2000/13, si dhe të gjithë banorëve që më 1 janar 1998 kanë qenë shtetas të

Republikës Federative të Jugosllavisë". Kjo, në fakt, fare nuk është e veçantë për rastin e Kosovës: kështu kanë vepruar edhe ish-republikat jugosllave kundrejt shtetësisë së RSFJ-së dhe kanë marrë si datë prerëse vitin e fundit para nisjes së luftës në territorin ish-jugosllav dhe kohës së pavarësimit të tyre. Kjo logjikë është ndjekur edhe me rastin e pavarësimit të ish-kolonive në **Afrikë** dhe **Azi** gjatë mesit të viteve '50 dhe '60 të shekullit të kaluar. Në rastin e Kosovës, i vetmi dallim dhe e vetmja specifikë që e dallon me ish-republikat jugosllave është se nuk ka qenë shtet dhe, për pasojë nuk ka pasur shtetësi të dytë (shtetësia e a.q. republikane). Këtë shtetësi e kanë pasur të gjitha republikat ish-jugosllave gjatë tërë kohës sa ka ekzistuar RSFJ, që nënkupton se kosovarët kanë pasur si shtetësi të dytë shtetësinë serbe. Për këtë arsye, në rastin e Kosovës si datë prerje për fitim dhe humbje të shtetësisë është marrë data 1 janar 1998 që pren kohën para nisjes së luftës (ndërkombëtarisht e njohur si konflikt i brendshëm) deri në fitimin e pavarësisë së vendit.

Për marrëveshjet ndërkombëtare kemi thënë fjalën tonë në kapitujt pararendës. Këtu vetëm ripërsërisim atë që thamë më lartë në analizën tonë për këtë kapitull: autorët tanë, kur manipulojnë autorin **Qerim Qerimi**, bëjnë gabime themelore sepse ia mveshin këtij autori një diçka që nuk e ka thënë dhe, në të njëjtën kohë, mashtrojnë lexuesin për një përmbajtje të së drejtës kushtetuese që asnjëherë nuk ekziston askund dhe në asnjë libër. Paragrafi i fundit i këtij seksioni ("Marrëveshjet ndërkombëtare", fq. 329-330), mbyllet më një tautologji tërësisht të pakuptimtë dhe pa asnjë logjikë. Studenti e lexuesi do të bindet në këtë që e themi në lexim të parë.

Përveç që duhet çuditur pse çështjet e marrëdhënies mes të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare i kanë trajtuar në këtë kapitull, në fund të trajtimit tonë për këtë kapitull u detyruam të çuditemi edhe për një fakt tjetër: në seksionin e fundit, "Parimet tjera themelore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës" (fq. 333), autorët diskutojnë për parimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore, parimin e kryeqytetit të Kosovës dhe, në fund, vërtet ia qëllojnë kur theksojnë se parim kushtetues është parimi i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. Mirëpo, dy "parime kushtetuese" si më sipër vërtet njeriu nuk mund t'i gjejë askund në ndonjë tekst tjetër: hera e parë që dëgjova për këtë! U mor vesh, seksioni pararendës, "Hyrja në fuqi e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe statusi i tyre" (fq. 331-333), përmban po aq gabime themelore sa edhe seksionet e tjera. Këtë e kemi evidentuar në analizën tonë të mëhershme lidhur me marrëdhënien ndërmjet të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare. Këtu evidentojmë

sërish, në mënyrë të përciptë, disa nga to:

- autorët gabimisht mendojnë se statusi kushtetues i Presidentit të Republikës, si bartës i politikë së jashtme dhe përfaqësues i Kosovës brenda dhe jashtë, është përcaktues për të drejtën e tij për të nënshkruar marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo nuk është e vërtetë, për dy arsye: e para, statusi i shefit të shtetit në marrëdhëniet me jashtë i takon të drejtës ndërkombëtare zakonore, përfshirë këtu të drejtën për nënshkrim të marrëveshjeve ndërkombëtare; e dyta, arsyeja pse neni 18.2 i Kushtetutës së vitit 2008 dallon nga neni 18.1 ka të bëjë me natyrën e marrëveshjeve që hyjnë në fuqi me nënshkrim të shefi të shtetit dhe Kryeministrit. Në rastin e marrëveshjeve nga neni 18.2 i Kushtetutës çdoherë supozohet se ekziston një detyrim kuadër i marrë përsipër me marrëveshje ndërkombëtare nga neni 18.1 i Kushtetutës. Në këtë sens, marrëveshjet e nenit 18.2 kanë karakter teknik, administrativ ose implementues të marrëveshjeve dhe detyrimeve të tjera nga neni 18.1 i Kushtetutës.
- autorët gabimisht besojnë se në Kosovë vendimet e GJEDNJ-së zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për këtë citojnë nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës. Kjo është shumë gabim sepse neni i parë flet për zbatimin e drejtpërdrejtë të instrumenteve ndërkombëtare të numëruara në atë nen, kurse neni 53 flet për detyrimin kushtetues të të gjitha organeve publike në Kosovë për të interpretuar në frymën e praktikën së GJEDNJ-së çdo dispozitë kushtetuese dhe ligjore që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Për ta zbatuar drejtpërdrejtë një vendim të GJEDNJ-së duhet të jesh anëtar i Këshillit të Evropës dhe të marrësh përsipër me marrëveshje ndërkombëtare një detyrim të tillë. Në Kosovë, sot për sot, nuk zbatohen vendimet e GJEDNJ-së, e as ne nuk mund të jemi palë në procedurat para saj për të mbrojtur liritë dhe të drejtat tona.

KAPITUJT III–IV. INSTITUCIONET KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS: KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS (FQ. 335–380). INSTITUCIONET KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS: PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS (FQ. 381–409).

Përgjithësisht

Në këtë pjesë të analizës kemi bashkuar dy kapitujt si më sipër. Këtë e kemi bërë për disa arsye: e para, sepse autorët tanë nuk janë të qartë lidhur me atë se cilit sistem të qeverisjes i takon Kosova, atij parlamentar apo presidencial, dhe flasin në mënyrë tërësisht të pakuptueshme për cilësitë e sistemit kosovar të qeverisjes; e dyta, sepse intensiteti i manipulimit të literaturës është i njëjtë si në dy kapitujt, ani se në kapitullin për Kuvendin shumë pak ka literaturë të cituar (në fakt, vetëm një autor, **Luan Omari**, librin e të cilit e manipulojnë, në ndërkohë që në kapitullin për Presidentin manipulimi i literaturës së huaj është gati total); dhe, e treta, sepse në dy kapitujt ka shumë parafrazime të dispozitave kushtetuese (dhe nga pak edhe të atyre ligjore), pa asnjë analizë të tyre kritike ose karahasimore. Të shohim si duken këto cilësi të këtyre dy kapitujve para se të lëshohemi në analizën kritike të brendisë së tyre.

Në tërë librin, jo vetëm në këta dy kapitujt, autorët tanë kanë diskutuar çështjen e sistemit qeverisës në vend. Pikëpamjet e tyre mund të përmblidhen në tri grupe: njëherë thonë se Kosova është një sistem tipik parlamentar i qeverisjes; herën tjetër thonë se Kosova ka një sistem gjysmëpresidencial të qeverisjes për shkak të kompetencave të fuqishme ekzekutive të Presidentit; dhe, herën e tretë, thonë se vendi ka një sistem parlamentar por që anon kah gjysmëpresidencializmi. Ftojmë lexuesin që vetë të krahasojë fq. si vijon të librit: fq. 301, 311, 323-324, 335, 382, 385, 571. Në këto fq. gjendet të shpërfaqura tri pikëpamjet tërësisht konfuze.

Libri ***Sistemi parlamentar***, botim i katërt (Botimet Elena Gjika: Tiranë, 2006) i autorit **Luan Omarit**, nga autorët tanë citohet në dy fusnota, në fusnotën 1058 dhe 1092. Në rastin e parë citohen fq. 95-104 kurse në të dytin fq. 95-124. Fjala është për citimin e pjesëve përkatësisht të krejt faqeve të kapitullit 5 "Mandati i deputetit dhe statusi i tij" i librit si më sipër të autorit shqiptar **Luan Omari**. Autorët tanë thonë se ka dy teori për atë

se kur fillon mandati i deputetit: një teori thotë se ky mandat nis ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve kurse tjetra thotë, gjithnjë sipas tyre, se mandati nis ditën kur nis punën (konvokohet/konstituohet/inaugurohet), parlamenti i parë i ri i dalë nga zgjedhjet. Në dy rastet, megjithatë, **Luan Omari** fare nuk flet për teoritë që thonë autorët tanë. Në fakt, këtë çështje, përkatësisht teoritë si më sipër i trajton gjerësisht një autor tjetër shqiptar: e kemi fjalën për fq. 253-258 të librit ***Tempulli i demokracisë*** (Ombra GMG: Tiranë, 2010) të autorit **Ylli Bufi**. Vlen të theksohet se autorët tanë në dy këto fq. ku gjendet teksti që shoqërojnë fusnotat e tyre si më sipër, në mënyrë të saktë bëjnë dallimin mes fitimit të mandatit dhe momentit kur fillon ushtrimi i tij në sistemin kushtetues kosovar. Në fakt, këtë dallim e ka bërë të qartë Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj në rastin **KO 119/14** (Cf. arsyetimin në paragrafin nr. 123 të vendimit).

Sa i përket manipulimeve të tjera të autorëve të huaj në kapitullin mbi Presidentin e Republikës, gjendja është shumë më alarmante. Të shohim një nga një si duket kjo.

Në fusnotën nr. 1161, autorët citojnë fq. 21 të një shkrimi të autorit **Timothy Frye**, në mbështetje të konstatimit të tyre apodiktik dhe tërësisht notor që thotë se në disa raste presidentët e disa prej vendeve ish-komuniste kanë zgjeruar kompetencat e tyre ekzekutive në vitet e para të transicionit post-komunist. Shkrimi i cituar, në fakt, bën fjalë për arsyet e zgjerimit të kompetencave në disa prej vendeve ish-komuniste dhe është një hulumtim empirik kuantitativ. Faqja e cituar, ndërkaq, nuk është ajo që thonë autorët por lista e literaturës së përdorur për shkrimin e shkrimit të cituar (sic!)

Në fusnotën nr. 1162, autorët ftojnë studentin dhe lexuesin që të shikojnë autorin **Foroud Shirvani** dhe shkrimin e tij të cituar nëse duan të dinë më shumë për transformimin historik të figurës së presidentit pas rrënimit të demokracisë vajmariane. Lexuesit në fq. 314 të këtij shkrimi që preferohet nga autorët tanë nuk do të gjejnë asgjë pos një trajtim të qeverisjes partiake në kulturën politike gjermane që nga Kushtetuta e vitit 1871 (pas unifikimit të Gjermanisë) e deri te **Ligji Themelor** (1949). Në fq. e këtij shkrimi, autori në fjalë tregon për ndikimin e partive politike në formimin e ekzekutivit gjerman dhe jo për ndonjë trajtim të rolit dhe pozitës së shefit të shtetit, aq më pak transformimin e tij siç e thonë autorët tanë.

Në fusnotën nr. 1166 citohen dy shkrime: njëri i autorëve **Louis Pereira Coutinho**, **Massimo La Torre** dhe **Steven D. Smith** dhe tjetri i autorit

Stanley L. Paulson. I pari fare nuk prek esencën e debatit **Carl Schmitt–Hans Kelsen** përgjatë vijave që thonë autorët tanë, përkatësisht si debat lidhur me unitetin e popullit dhe pozitën e shefit të shtetit në kohën e Kushtetutës së Vajmarit: shkrimi flet për atë se kush duhet të jetë gardian i kushtetutës në kohën e krizës financiare pas vitit 2010 nëpër të cilën po kalonte **Portugalia** dhe **Evropa**. Debati si më sipër i dy kolosëve të dijeve juridike përdoret në këtë shkrim që citohet në dritën e rrënimit të konstitucionalizmit si pasojë e krizës financiare dhe konstatohet se si **Carl Schmitt** ashtu dhe **Hans Kelsen** kanë tërhequr vërejtjen për politizimin e vendimmarrjes në gjyqësinë kushtetuese në situata e rrethana të caktuara, siç ishin këto të krizës së sipërcekur financiare dhe vendimmarrjes së disa gjykatave kushtetuese nacionale dhe të **Gjykatës Evropiane të Drejtësisë** (vendimet që kanë pasur të bëjnë me menaxhimin e krizës financiare të viteve 2010-2014). Sa i përket autorit **Stanley L. Paulson**, gjendja është më skandaloze: ky shkrim ka të bëjë me debatin mes **Hans Kelsen**-it dhe **Eric Kaufmann**-it. Asnjë pjesë, asnjë rresht e këtij shkrimi nuk ka të bëjë me pozitën dhe rolin e shefit të shtetit (sic!). Në fakt, ky shkrim trajton transformimin e **E. Kaufmann**-it nga një autor i të drejtës natyrore dhe përkrahës i fuqishëm i forcës politike, jo normës juridike, në një autor që ka përqafuar idetë neokantiane mbi barazinë dhe rolin e normës në progresin shoqëror. Kjo ka ndodhur në një referat të **E. Kaufmann**-it të lexuar në vitin 1926 në një kongres të juristëve gjermanë të së drejtës publike.

Fusnota nr. 1175 na sjell një shkrim që bën fjalë për **Shrilankën** dhe pushtetin diktatorial komunist të shefit të shtetit në këtë vend. Autorët tanë e citojnë në mbështetje të tezës së tyre se Presidenti është shef i qeverisë. Në këtë vend, Presidenti jo vetëm që është shef i qeverisë, por edhe i gjyqësorit dhe i parlamentit: siç e thonë autorët **H. Ranjith** dhe **A.G.T. Somarthana**, sipas Kushtetutës së vitit 1978, e cila përbën pikën e referimit të këtij shkrimi në këtë fusnotë, Presidenti i Shrilankës është president ekzekutiv me autorizime të pafund diktatoriale dhe pa asnjë organ balancues. Nuk besoj që ka nevojë të komentohet më shumë fakti se **Shrilanka** me këtë nivel të sistemit kushtetues paraqet një shembull të mirë për t'u mësuar si model i presidencializmit. Këtu bëhet fjalë për diktaturë, jo për sistem presidencial.

Në fusnotën nr. 1176, autorët citojnë autorin **Matthew Søberg Shugart** në ndërkohë që teksti që citohet është i një autori krejtësisht tjetër. E kemi fjalën për autorin e njohur francez, **Maurice Duverger**, ideator dhe apologjet i termit "gjysmëpresidencializëm". Përkundër këtij ngatërrimi të

autorësisë, kjo fusnotë së paku jep një autor të prekshëm, gjë që nuk është rasti më fusnotën në vijim, fusnotën nr. 1178, e cila nuk mund të gjendet askund (sic!). Dy fusnotat tjera të kontrolluara për saktësi të përmbajtjes së tyre, fusnotat nr. 1187 & 1198, nuk janë asgjë pos sajte koti të disa blogerëve që nuk ofrojnë asnjë informacion relevant për të drejtën kushtetuese si lëndë që mësohet në universitet. Të natyrës së njëjtë fiktive, të cituar sa për sy e faqe janë edhe dy fusnotat e fundit të autorëve të huaj të cilat i kanë vënë autorët tanë: fusnota nr. 1239, citon ish-artistin e filmave aksion të Hollivudit, **Arnold Schwarzenegger**, në kohën sa ka qenë guvernator i Kalifornisë. Vështirë është të kuptohet se çfarë relevance mund të ketë ligji kalifornian që citohet nga autorët tanë në mbështetje të tezës së tyre mbi "teorinë kushtetuese mbi gjendjen e jashtëzakonshme" dhe autorizimin e Presidentit të Kosovës për të vendosur lidhur me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në konsultim me Kryeministrin (sic!). Po aq fiktiv është edhe citimi në fusnotën nr. 1246, përkatësisht pa asnjë relevancë për tekstin që e shoqëron: libri që citohet, citohet pa faqe. Përveç kësaj, asnjë fjalë për historinë e faljes jashtë kontekstit britanik nuk trajton ky libër: trajtimi historik në tërësi i referohet Britanisë dhe atë nga viti 1535, përkatësisht nga koha kur Mbreti Henriku VIII (1509-1547) e shndërroi këtë një prerogativë ekskluzive mbretërore. Deri atëherë, falja kishte qenë prerogativë e kishës, feudalëve dhe kategorive të ndryshme të lordëve britanikë. Në vitin 1535 u nxor një ligj që nuk lejonte askënd tjetër pos mbretit për të bërë falje. Ky libër në veçanti orientohet në vitin 1907, kur u krijua një organ apelues për të rishikuar vendimet mbi dënimin në rastet veçanërisht të rënda, por duke ruajtur sërish prerogativën mbretërore. Kaq! Libri në fjalë nuk trajton tema të tjera historike, siç thonë autorët, që kanë të bëjnë më kohën e Hamurabit dhe të ngjashme.

Në fund, shënojmë se fq. të tëra për Kuvendin dhe Presidentin janë të riprodhuara ashtu siç janë në tekstin origjinal të Kushtetutës së vitit 2008 apo në instrumentet e tjera ligjore e rregullative, pa asnjë analizë kritike krahasuese për të kuptuar esencën e kompetencave të këtyre dy organeve kushtetuese. Kjo është arsyeja që në këtë pjesë ne analizojmë përmbajtjet e tekstit të prodhuar nga autorët tanë, në veçanti të tekstit që ka të bëjë me pozitën dhe rolin e **Presidentit të Republikës**. Këtë kritikë analitike e bëjmë nga një këndvështrim krahasues dhe historik të institucionit të shefit të shtetit në një republikë parlamentare dhe rolin e këtij institucioni në balancimin e pushteteve të ndara.

Analiza kritike

Kapitulli mbi Kuvendin e Kosovës nis me një shqyrtim hyrës, që në fakt është thellësisht definues dhe përmbyllës: autorët bëjnë konstatime apodiktike, pa asnjë bazë diskutuese paraprake, të cilat konsistojnë, sipas tyre, në si vijon:

- Kuvendi qenka vendi ku buron sovraniteti popullor;
- Kuvendi, sipas kushtetutave demokratike, trajtohet si burim i sovranit; dhe
- Kosova i përket një sistemi tipik parlamentar, ku dominimin kryesor në jetën publike dhe në vendimmarrjen kushtetuese e ka Kuvendi, me specifika të caktuara që lidhen me pozitën e Presidentit dhe kompetencat e tij (fq. 336).

Asnjëra nga këto nuk qëndrojnë. E para, sikundër dihet **Montesquieu**, **Abbé Sieyès** dhe **Benjamin Constant**, predikuesit e demokracisë përfaqësuese, e cila sot dominon në botën demokratike bashkëkohore, nuk e trajtojnë parlamentin si burim sovraniteti dhe si burim i sovranit por, krejt anasjelltas, atë e trajtojnë si përfaqësues të sovranit. Në këtë pikë, këta autorë pajtohen me **Jean-Jacques Rousseau** dhe teorinë e tij mbi ***volonté générale***: te të dyja grupet e autorëve, populli është bartës dhe burim sovraniteti në të njëjtën kohë. Kështu thotë edhe Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008 në nenin e saj 2.1 ["Sovraniteti"]:

> Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.

Nuk është dominimi në jetën politike dhe publike përcaktues e as vendimmarrja kushtetuese, por fakti që parlamenti shërben si hallka legjitimuese kryesore e ekzekutivit dhe organeve e institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike të natyrës ekzekutive. Kjo nënkupton se marrëdhënia mes legjislativit dhe ekzekutivit përbën përcaktuesin themelor, ku ekzekutivi është i varur dhe gjendet në mëshirën e besimit të legjislativit për të mbijetuar, jo cilësitë e tjera që i thonë autorët.

Seksioni i dytë me radhë, "Ciklet e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës prej vitit 2002- deri në vitin 2017" (fq. 335-338), paraqet një diskutim që i shkon shkencave politike sepse në tërësi merret me aspektet e dinamikave zgjedhore, jo me anën juridiko-kushtetuese të sistemit të zgjedhjeve në Kosovë. Analiza politike përfundon më një konstatim, po ashtu i natyrës

së shkencave politike, që thotë si vijon:

> Cikli i fundit (i gjashtë) i zgjedhjeve parlamentare (të përgjithshme) u mbajt më 11 qershor 2017. Ky cikël zgjedhjesh u karakterizua me krijimin e koalicioneve parazgjedhore, që erdhën si pasojë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014.

Këto qëndrime lexuesi i ka dëgjuar pas themelimit të pushtetit aktual, gjë që është tërësisht e pasaktë: Gjykata Kushtetuese nuk ka vendosur se kur dhe si do të formohen koalicionet qeverisëse, para apo pas zgjedhjeve. Një gjë e tillë nuk përbën çështje kushtetuese por një çështje të pastër politike. Formimi i koalicioneve parazgjedhore për zgjedhjet e qershorit 2017 ka ndodhur pikërisht si pasojë e interpretimit të gabuar dhe laik të vendimeve të vitit 2014, për të cilat gabimisht mendohet sot e kësaj dite se kanë përcaktuar formimin e detyrueshëm të koalicioneve parazgjedhore. Në aspektin politik, ndërkaq, e vërteta e formimit të koalicioneve parazgjedhore ka qenë frika nga pësimi i një debakli në zgjedhje të partive që sot janë në pushtet. Kaq! Kjo është e vërteta juridiko-kushtetuese dhe politike e formës dhe përmbajtjes së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014.

Duke folur për pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në Kosovë në jetën publike, përkatësisht për vendet e garantuara (dhe të rezervuara që kanë ekzistuar deri në shtator të vitit 2012), në seksionin "Përkufizimi i Kuvendit sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe struktura e tij" (fq. 338-340), autorët bëjnë këtë konstatim të çuditshëm:

> Ajo që bie në sy në përbërjen e Kuvendit të Kosovës, në raport me vullnetin e popullit është fakti që populli i Kosovës është i privuar nga e drejta për të zgjedhur 120 deputetë, meqenëse votat e shumicës shqiptare zakonisht ndahen në vetëm 100 mandate deputetësh, nga 120 mandate deputetësh sa i ka tërë Kuvendi i Kosovës" (fq. 339-340).

Në vend se të sqarojnë konceptet bazë të demokracisë konsociacionale kosovare, që është dominuese, autorët tanë angazhohen në një diskurs që ka premisa të hapura diskriminuese dhe raciste: komunitetet joshqiptare janë po aq shtetas të këtij vendi sa edhe popullsia shumicë. Kosova ka pranuar demokracinë konsociacionale si një çmim për fitimin e pavarësisë dhe sovranitetit të saj, me qëllim të fitimit të njohjes dhe ndërtimit të një shoqërie që bazohet në vlera të tolerancës dhe mosdiskriminimit. Zoti i Kosovës i marrë me Planin Ahtisaari përbën, siç e kemi sqaruar, një detyrim ***erga omnes*** të cilin ka të drejtë ta vërë në jetë forcërisht çdo shtet dhe

organizëm ndërkombëtar që ka interes për një gjë të tillë. Këto gjëra duhet t'i dinë studentët tanë dhe lexuesi tjetër i librit, jo diskurse politike dhe diskriminuese.

Nga ky seksion, deri në fq. 360 ku autorët mëtojnë se sqarojnë për studentin dhe lexuesin tjetër një vendim të Gjykatës Kushtetuese lidhur me imunitetin e deputetëve dhe funksionarëve të lartë shtetërorë, pak a shumë riprodhohen tekste kushtetuese e ligjore ashtu siç janë. Pas diskutimit të rastit të imuniteteve si më sipër, autorët sërish me fq. të tëra riprodhojnë tekste kushtetuese, ligjore dhe të tjera në një mënyrë jokritike. Aty pak kritikë ku mëtojnë se kanë bërë, autorët bëjnë gabime: i tillë, ta zëmë, është rasti me analizën e tyre të dispozitave mbi shpërndarjen e Kuvendit (fq. 378-380). Në fq. 379 konstatojnë se kushtet për shpërndarje të Kuvendit krijohen vetëm pas zgjedhjeve parlamentare kur nuk mund të formohet një shumicë parlamentare për të formuar ekzekutivin. Në realitet, kjo situatë mund të krijohet edhe më vonë dhe vjen deri të shpërndarja e Kuvendit. Këtë e përcakton Kushtetuta e vitit 2008 dhe kushtetutat e çdo sistemi kushtetues që matet me kriteret e demokracisë kushtetuese liberale. Kjo është kështu sepse përbën vetë esencën e demokracisë parlamentare. Faqe të tjera, nga pjesa për imunitetin deri në fq. 378, në thelb nuk kanë asnjë substancë që mund të jetë e ndryshme nga ç'ka thënë kushtetutëbërësi e ligjbërësi i Kosovës. T'i kthehemi pak çështjes së imuniteteve dhe e mbyllim këtë kapitull për të kaluar në pjesën dramatikisht më të dobët në aspektin profesional, pjesën që ka të bëjë me **Presidentin e Kosovës**.

Në fq. 360-361, autorët flasin me terma konspirativë për një korrespondencë mes kryetarit të atëhershëm të **Kuvendit të Kosovës** dhe autoriteteve të **EULEX**-it për heqjen e imunitetit të njërit prej deputetëve të Kuvendit; pas kësaj korrespondence, ish-kryetari i Kuvendit paska pas refuzuar nxjerrjen e një rezolute për heqjen e imunitetit dhe kjo ka bërë që të ketë një debat të gjerë rreth kësaj çështje; ky debat, sipas autorëve paska pas çuar në aktivizimin e **Gjykatës Kushtetuese**, sipas tyre, duke qenë kështu një rrugë dytësore. Pra, **Gjykata Kushtetuese** dhe mekanizmi i saj konsiderohen si rrugë dytësore, e gabuar dhe e paduhur për të sqaruar çështjen e imunitetit të deputetëve dhe funksionarëve të lartë shtetërorë (sic!). Për tërë këtë narrativ, tërësisht në stilin e artistit të lirë, autorët tanë nuk citojnë as edhe një burim të vetëm pos e prodhojnë me një hamendësim që studenti e lexuesi mund ta ketë dëgjuar kuluareve të rrugëve të Prishtinës. Autorët vazhdojnë me hamendësime edhe në seksionin në vijim, "Rasti i imunitetit në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Nr. KO 98/11"

(fq. 361-362): nuk ka kaluar pa debat as çështja, se a ka të drejtë në fakt Qeveria për të kërkuar një interpretim në Gjykatën Kushtetuese, e thonë autorët tanë në fq. 361, pa cituar as edhe një burim se kush ka qenë protagonist i debatit që ka çuar në Gjykatën Kushtetuese rastin e imuniteteve si më sipër. Ky diskurs vazhdon edhe në fq. tjetër deri në fund të këtij seksioni: pjesa kryesore e narrativit, në fakt, përbën rilexim dhe interpretim kaotik të vendimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO 98/11 dhe asgjë më shumë. Një shtesë e vogël, në formë të fletërrufesë, jepet në fusnotën nr. 1123, ku autorët thonë se "Kur i referohemi 'Njohës të çështjeve kushtetuese' është fjala për ata që kanë dhënë këto opinione përmes mediave elektronike dhe të shkruara". Kaq! Me këtë konstatim arsyetojnë narrativin e tyre, i cili, siç e thamë, në tërësi ka të bëjë me një rilexim kaotik të pjesëve të vendimit si më sipër që kanë të bëjnë me historikun procedural të rastit.

Në vend se të sqarojnë për studentin dhe lexuesin tjetër se çfarë nënkuptohet me imunitetin funksional, siç e përcakton Kushtetuta dhe siç është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese, autorët tanë angazhohen në një diskurs të rileximit kaotik të tërë vendimit si më sipër të Gjykatës Kushtetuese: imuniteti funksional sot për sot, me përjashtim të Italisë dhe shumë pak vendeve demokratike, përbën esencën e imunitetit të një deputeti dhe funksionari tjetër publik. Këtë e ka sqaruar Gjykata sepse kështu thotë Kushtetuta e Kosovës: asnjë imunitet nuk kanë deputetët dhe askush tjetër për veprat penale sepse kryerja e një vepre penale nuk përbën funksion të deputetit e as të asnjë funksionari tjetër. Kjo më tutje domethënë se për atë që thuhet dhe bëhet në ushtrim të detyrave të deputetit dhe funksionarit të lartë shtetëror, nuk ka përgjegjësi penale apo civile dhe përgjegjësi tjetër. Këtu ka përjashtime: nuk ka imunitet kur në Kuvend apo në zyrën e funksionarit të lartë shtetëror kryhen vepra penale të karakterit ordiner, siç janë rrahja dhe ushtrimi i dhunës apo veprat tjera ngjashëm me këto. Këtë e ka thënë Gjykata sepse kështu thotë Kushtetuta e vitit 2008, pra se nuk ka imunitet për veprat penale të kryera para nisjes së mandatit dhe gjatë mandatit por që nuk lidhen me funksionin e deputetit dhe të funksionarit tjetër të lartë shtetëror. Gjykata në këtë vendim ka saktësuar dispozitat kushtetuese për imunitet që kanë të bëjnë me veprat penale mbi pesë vjet, për rastet e arrestimit ***in flagrantia***, për rolin e Prokurorit të Shtetit të Kuvendit në këtë mes; pastaj, ka precizuar se përse **Presidenti i Republikës** nuk mund të arrestohet edhe kur bën një vepër penale që nuk lidhet me ushtrimin e kompetencave të saj/tij (pra hetimi mund të vazhdojë, por jo arrestimi, në kohën sa është në detyrë si shef shteti) dhe

kështu me radhë. Këto gjëra ka nevojë t'i dijë studenti ynë dhe lexuesi tjetër, jo përralla konspirative dhe elaborime duke ripërtypur rreshtat e vendimit të Gjykatës Kushtetuese në mënyrë tërësisht të pakuptueshme dhe kaotike.

Kapitulli i katërt, përkatësisht kapitulli për **Presidentin e Republikës së Kosovës** (fq. 381-409) paraqet kryesisht riprodhim të tekstit kushtetues (cf. nga fq. 386 bis). Nëse merret kjo parasysh dhe hiqen fusnotat që janë manipuluar, lexuesi ynë mund të imagjinon se çfarë vëllimi i tekstit do të dilte në këtë kapitull. Vëllimi, megjithatë, këtu nuk ka asnjë rëndësi: ajo që qon peshë dhe që tmerrësisht është e papranueshme është mungesa e dijes së autorëve tanë për konceptet themelore lidhur me pozitën dhe rolin e shefit të shtetit në një sistem parlamentar. Që në fillim, autorët konstatojnë se "në disa vende Presidenti paraqitet mbret ose monark, kurse në shumicën prej vendeve si i zgjedhur, respektivisht si president kushtetues" (fq. 381). Domethënë, autorët tanë besojnë se president i një republike mund të jetë një monark ose mbret. Po ashtu, autorët tanë besojnë se ekziston koncepti "presidenti parlamentar"(387), gjë që e bën të vështirë për lexuesin, përfshirë autorin e këtyre rreshtave, për të kuptuar se cili lloj tjetër i presidentit ekziston aktualisht në praktikat dhe teoritë kushtetuese bashkëkohore (sic!).

Për mbretin president, autorët tanë flasin në fillim, në pjesën që supozohet se studenti e lexuesi tjetër duhet të gjejë sqarime të përgjithshme të koncepteve dhe asaj që vjen në kapitull (sic!). Gjendja nuk paraqitet më mirë as në seksionet në vijim, ku autorët tanë flasin për idenë sipas së cilës atributi kushtetues që thotë se presidenti është përfaqësues i unitetit të popullit ka lindur në debatin mes dijetarëve **Carl Schmitt** dhe **Hans Kelsen** (fq. 382), diçka krejt e pavërtetë dhe jo e saktë. Për më tepër, në po të njëjtën fq. konstatojnë se "edhe në aspektin kushtetues, por edhe në aspektin e normës 'uniteti i popullit' dhe përfaqësimi i tij nga ana e presidentit më shumë është një nocion filozofik sesa kushtetues". Ky konstatim shumë i pasaktë dhe i pavend e vënë studentin dhe lexuesin në lajthitje në sensin që i bën të mendojnë se Kushtetuta e Kosovës përmban koncepte filozofike dhe teorike pa ndonjë vlerë normative. Studenti dhe lexuesi, por edhe çdokush tjetër duhet ta kenë të qartë se uniteti i popullit, sintagmë që figuron në të gjitha kushtetutat e demokracive liberale, ka përmbajtje normative dhe shpjegim fare të qartë. Ajo çka qëndron, ndërkaq, konsiston në faktin se autorët tanë gabimisht mendojnë se kuptimi i normave kushtetuese dhe përmbajtja e tyre normative mund të nxirren nga interpretimi

tekstual auto-referencial i tyre. Kjo nuk mund të ndodhë asnjëherë me asnjë dispozitë apo pjesë të asnjë kushtetute. Institucionet dhe kategoritë që janë universale dhe të papërcaktuara në tekstin kushtetues, siç janë fjalët "sovraniteti", "ndarja dhe balancimi i pushteteve", "demokracia", "kreu i shtetit", "stabiliteti i institucioneve", "dinjiteti" dhe kategori e institute të tjera kushtetuese nuk mund të shpjegohen sipas metodës dogmatike autoreferenciale. Të kësaj natyre janë edhe kompetencat e Presidentit të Republikës, natyra juridike dhe qëllimi i tyre.

Në vijim të diskutimit si më sipër, autorët tanë më tutje na mësojnë se "Kushtetuta e Kosovës ka dizajnuar një President jo karakteristik për vendet tipike parlamentare" (fq. 382), duke u çuditur dhe duke mos e pasur të qartë se si Kushtetuta e vitit 2008 "nuk jep sqarime të mëtutjeshme, si mund të përfaqësoj Presidenti unitetin e popullit" (fq. 383). Kjo do të thotë se autorët tanë kërkojnë që vetë teksti kushtetues të japë sqarime për dispozitat lidhur me pozitën dhe rolin e Presidentit të Republikës, fizionomisë të cilën e kanë të gjithë presidentët në një sistem parlamentar. Nuk ka asnjë dispozitë kushtetuese, në asnjë kushtetutë demokratike, që është vetë-referuese (*self-referential*), në sensin që duke iu referuar vetvetes e jep kuptimin e vet. Kjo është arsyeja që jo rrallë, gjykatat kushtetuese i qasen edhe burimeve të huaja (literaturës, jurisprudencës, burimeve të a.q. të buta të së drejtës dhe kështu me radhë) për të interpretuar tekstin e tyre kushtetues. Kjo vlen si për interpretimet abstrakte të normës ashtu edhe për vendimet e gjykatës që kanë të bëjnë me kontrollin kushtetues të akteve individuale të organeve shtetërore dhe të organeve të tjera që ushtrojnë funksione publike. Këtë shfrytëzim të burimit të huaj si më sipër, gjykatat kushtetuese e bëjnë për të vërtetuar, refuzuar apo ndryshuar pikëpamjet e veta gjatë një interpretimi kushtetues, përkatësisht gjatë një procedure të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë (cf. më shumë në **Sir Basil Markensinis** & **Jorg Fedtke**, ***Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source of Inspiration?*** Routledge: London and New York, 2006, kapitulli 2; **Vicki C. Jackson**, ***Constitutional Engagement in a Transinational Era***, Oxford UP: Oxford, 2010, kapitulli 9; **Tania Groppi, Marie-Claire Pontthoreau**, eds., ***The Use of Foreign Precedents by Constitutional Judges***, HART Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2014; Hyrja dhe Përfundimet). Të kësaj natyre janë edhe dispozitat që autorët tanë nuk i kuptojnë, ato që definojnë rolin dhe pozitën e Presidentit të Republikës, të cilat gjenden në nenin 4.3 ["Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit"] dhe 83 ["Statusi i Presidentit"] të **Kushtetutës së Republikës së Kosovës**.

Në mënyrë që lexuesi ynë ta ketë më të lehtë për të përcjellë diskutimin tonë rreth rolit dhe pozitës së shefit të shtetit në një sistem parlamentar, ne do të japim *ad literam* dy nenet si më sipër të Kushtetutës së Kosovës. Do t'i japim edhe për faktin se të njëjtat dispozita apo të ngjashme me to gjenden në të gjitha kushtetutat e vendeve që kultivojnë demokraci kushtetuese parlamentare. Kjo ka një histori pse kjo është kështu, të cilën ne do ta japim gjerësisht në rreshtat në vijim. Paraprakisht citojmë nenin 4.3 të Kushtetutës së Kosovës, i cili thotë:

> Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.

Neni tjetër, neni 83 i Kushtetutës, nuk përsëritë këtë definicion të shefit kosovar të shtetit, por vetëm fjalinë e parë dhe thotë: "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës".

Këtë e bën sepse ky definim i statusit të Presidentit të Kosovës, në një fjali, që është krejt i zakonshëm dhe gjendet, me formulime që ndryshojnë vetëm në nuanca, në kushtetutat e vendeve me demokraci kushtetuese parlamentare, pa marrë parasysh nëse shefi i shtetit është monark apo president. Kjo fjali, në rastin konkret të Kosovës, absorbon definimin që Kushtetuta i jep në fjalitë e tjera në vijim të saj në nenin 4.3 si më sipër. Kjo nënkupton se fjalitë që pasojnë pas fjalisë "Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit" nga neni 4.3 i Kushtetutës përshkruajnë fizionominë e shefit të shtetit në Kosovë dhe e definojnë atë sipas teorisë dhe praktikës standarde mbi pozitën dhe rolin e shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare. Kjo ka një histori që nis në kohën e **Revolucionit Francez** dhe menjëherë pas rrëzimit të **Napoleonit** dhe restaurimit të dinastisë franceze **Bourbon**.

Për lexuesin tonë duhet të flasim gjerësisht për teorinë dhe praktikën e definimit të shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare. Para se ta bëjmë këtë, pra para se të tregojmë si dhe kur lindi ideja si më sipër, duhet të sqarojmë tri konceptet themelore të temës sonë:

1. Çka është shefi i shtetit?
2. Çka është demokracia kushtetuese parlamentare?
3. Çka nënkuptohet me shefin e shtetit si "kreu i shtetit"?

Fjala "shef i shtetit" është emërues i përbashkët për mbretin në një monarki dhe presidentin në një republikë. Kjo nënkupton se në mbretëri

(monarki) nuk mund të ketë president: i vetmi përjashtim ka qenë dhe ngelet rasti me ***Reich***-un gjerman: neni i parë Kushtetutës së Vajmarit (1919) e definonte ***Reich***-un si një republikë. Ky përjashtim, që tanimë i takon historisë, shpjegimin e vet e ka në ngjarjet e Luftës së Parë Botërore dhe kolapsin e **Perandorisë së Bizmarkut** (1871): termi republikë u përdor, së bashku me futjen e postit të presidentit me kompetenca të fuqishme imperiale, për të ngushëlluar forcat konservatore gjermane dhe për të qetësuar gjermanët e thjeshtë për humbjen e perandorisë së tyre në mbarim të **Luftës së Parë Botërore**. Kjo krijoi një ekzekutiv dualist, në ndërkohë që vendi ngeli një republikë parlamentare. Sipas **Hugo Preuss**-it, arkitektit ideor të Kushtetutës së Vajmarit, Gjermania kishte nevojë për një president të fortë i zgjedhur nga populli, jo vetëm për një president si shef shteti, por edhe si lider politik dhe ruajtës i kushtetutës. Këto autorizime duheshin për ta frenuar parlamentin, në veçanti në kohët e krizës dhe gjendjeve të jashtëzakonshme. Kjo situatë gjermane, që nga emërtimi i shtetit, që në brendi aspak nuk ishte monarki, e deri te strukturat institucionale të pushtetit që u ndërtuan, sot e kësaj dite e bëjnë Gjermaninë e Vajmarit si një model që nuk duhet ndjekur verbërisht, në veçanti sa i përket marrëdhënieve mes legjislativit dhe ekzekutivit dhe pozitën e rolit kushtetues të shefit të shtetit. Këto të meta vajmariane u morën shumë seriozisht me rastin e draftimit të **Ligjit Themelor të Gjermanisë** (1949) (cf. **Shen Yu-chung**, "The Anomaly of the Weimar Republic's Semi-Presidential Constitution", *Journal of Politics and Law*, vol. 2, no. 3, September 2009, fq. 35-43; **Nigel Foster** & **Satosh Sule**, ***German Legal System***, 4th ed., Oxford UP: Oxford, 2010, fq. 36-40; 159-161; 168-169; 204-207).

Demokracia kushtetuese parlamentare është ai lloj i demokracisë ku parlamenti, sipas normave shprehimore kushtetuese, jo sipas tekeve apo raportit momental të forcave, paraqet hallkën e legjitimimit dhe delegjitimimit të ekzekutivit të vendit në të gjitha format e tij.

Në fund, kreu i shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare (mbretëri apo republikë) nënkupton që ajo/ai nuk mund të jetë edhe kreu i ekzekutivit dhe as të ketë kompetenca (fuqi) të pavarur (autonome) ekzekutive. Ky status i shefit të shtetit si kreu i shtetit, për pasojë, ka disa veçori, të cilat, pa asnjë përjashtim reflektohen, me formulime të ndryshme, në të gjitha kushtetutat e vendeve demokratike me sistem parlamentar të qeverisjes. Formulimet e tilla përmblidhen në disa fjali: ajo/ai (mbreti apo presidenti), përveç që është kreu i shtetit është edhe garantuesi i funksionimit normal të institucioneve dhe i stabilitetit të tyre dhe përfaqëson uni-

tetin e popullit dhe të shtetit, jo anasjelltas. Në asnjë definim kushtetues të shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare nuk mund të gjendet formulimi që thotë se shefi i shtetit përfaqëson vullnetin e popullit. Kjo është kështu edhe në demokracitë kushtetuese me sistem gjysmëpresidencial ku ekzekutivi legjitimohet dhe delegjitimohet në situatat dhe sipas procedurave të përcaktuara saktësisht me kushtetutë (p.sh. Franca). Kjo është kështu sepse ai vullnet përqendrohet në një organ tjetër, i cili i vetmi paraqitet si përfaqësues i sovranit, pra parlamenti. Ky organ ka çdoherë këtë cilësim, edhe atëherë kur nuk thuhet në kushtetutë, krahas cilësisë tjetër, atë të ligjvënësit (në disa raste edhe të kushtetutëvënësit, siç është rasti me Kosovën dhe me disa vende të tjera në dy anët e Atlantikut). Vullneti origjinal, ndërkaq, nuk i preket: ai i takon popullit dhe vetëm atij.

Në vendet e tjera me sistem gjysmëpresidencial (Franca) dhe presidencial (SHBA, dhe disa vende demokratike në Amerikën Latine), shefi i shtetit ka edhe cilësi të tjera që kanë të bëjnë me sa vijon: ruajtjen e kushtetutës dhe rendit kushtetues, integritetit dhe sovranitetit territorial, kontinuitetit të shtetit, respektimit të traktateve ndërkombëtare dhe kështu me radhë. Këto cilësi janë pasojë imanente e faktit se shefi i shtetit në një sistem gjysmëpresidencial apo presidencial ka në kompetencë të vet autonome përdorimin e gjithë aparatit shtetëror për arritjen e objektivave kushtetuese që lidhen me vënien në jetë të funksionit kushtetues si shef (kreu) i shtetit dhe si bartës i ekzekutivit. Pse kjo është kështu ka një histori që lidhet me emrat e teoricienëve dhe politikanëve francezë, **Abbé Sieyès** (1748-1836) dhe **Benjamin Constant** (1767-1830), dy njerëzit më me ndikim në Revolucionin Francez dhe kahet e tij të mëpastajme. Pa e kuptuar teorinë dhe praktikën e këtyre dy dijetarëve francezë, si dhe zhvillimet e mëpastajme kushtetuese në Evropë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore asnjëherë nuk mund të kuptohet fizionomia e shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese (parlamentare, gjysmëpresidenciale dhe presidenciale). Kjo teori dhe praktikë është zhvilluar në vazhdën e kërkimit të gjetjes së rrugëve për ta "rikthyer djallin në shishe", përkatësisht për ta frenuar ushtrimin e pakontrolluar të vullnetit të përgjithshëm të avokuar nga **Jean-Jacques Rousseau** (1712-1778), që gjeti shprehjen e vet më të plotë në vitet e para të Revolucionit Francez (1789-1794). Në këto vite ka lindur ideja mbi demokracinë përfaqësuese, që më pastaj u materializua me Kushtetutën e vitit 1795 për t'u zhvilluar përgjatë shekujve nëpër dy anët e Atlantikut në formën që e njohim sot. Pjesë e kësaj ideje është edhe Kush-

tetuta e Kosovës. Koncepti kyç në tërë këtë përpjekje teorike dhe praktike ka qenë neutralizimi (frenimi) i pushtetit të pakontrolluar të sovranit. Si pikë nisëse, ky proces ka pasur idetë e **Montesquieu**-s mbi ndarjen funksionale të pushtetit. Mirëpo, më vonë kjo ide është përpunuar për t'u plotësuar me qëllim të zbutjes dhe moderimit të pushtetit me teorinë dhe praktikën e ndërtimit të institucioneve, mekanizmave dhe trupave të ndryshëm kushtetues jashtë trikotomisë klasike të ndarjes së pushtetit në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Në vijim si më sipër, tipologjinë e formave të neutralizimit të pushtetit askush më mirë nuk e ka bërë se **Carl Schmitt**, në një shkrim të tij, të botuar para debatit me **Hans Kelsen**-in. (Cf. Sandrine Baume, "De l' usage des pouvoirs neutres", *Revue Française d'Histoire des Idées Politiques*, vol. 4, no. 143, 2012, fq. 17-27, në fq. 18, fusnota nr. 6.) Në këtë shkrim, **Schmitt** i jep dy kuptime të mëdha të neutralitetit të pushtetit. I pari është kuptim pasiv i neutralitetit, ku nuk kërkohet ndërhyrja, arbitrimi apo vendimi i një organi për të siguruar balancimin (ekuilibrimin) e pushteteve. I dyti, ndërkaq, është kuptimi i kundërt i neutralitetit, sipas të cilit kërkohet ndërhyrja, arbitrimi apo vendimi i një organi me qëllim të sigurimit të balancimit (ekuilibrimit) të pushteteve. Në kuptimin aktiv të neutralitetit, sipas **C. Schmitt**-it, ekzistojnë katër forma të manifestimit të tij. Në rend të parë, në këtë kategori hyn neutraliteti aktiv i kuptuar si pavarësi dhe paanësi që bazohet në një normë apo në një kuadër legale që ekziston paraprakisht. I tillë është rasti, mendon **C. Schmitt**, i neutralitetit të gjyqtarëve: vendimi i një gjyqtari nuk ka asnjë ngjyrim politik. Në kundërshtim me këtë, **Hans Kelsen** vendimmarrjes në gjykatë kushtetuese ia njeh një cilësi gjysmëpolitike. Në kategorinë e dytë, gjithnjë sipas kategorizimit të **C. Schmitt**-it të llojeve të neutralitetit aktiv hyn neutraliteti që bazohet në një kompetencë të ngushtë profesionale të zhveshur nga interesat egoistë. Më këtë, **Schmitt** nënkupton vendimmarrjen që bazohet në ekspertizën e ekspertit të fushës përkatëse (dije teknike). Kategoria e tretë, e cila lidhet me pozitën dhe rolin kushtetues të shefit të shtetit në **Gjermaninë e Vajmarit**, përfshin neutralitetin që është shprehje e një tërësie dhe uniteti në të cilin ngërthehen dhe shpërthehen të gjithë antagonizmat gruporë (parciale) duke u relativizuar deri në atë shkallë (masë) sa bëhet e njëjtë me vendimmarrjen e organit të krijuar për të siguruar balancimin (ekuilibrimin) e pushteteve. Ky neutralitet është neutralitet i vendimit shtetëror, i cili, në ndeshje me fërkimet partiake dhe ndarjet e veçanta në shtet, shtyp konfliktet dhe dallimet brenda-shtetërore sepse ky vendim

përfaqëson interesin shtetëror dhe totalitetin. Ky është neutraliteti i presidentit dhe vendimmarrjes së tij, të cilin e ndërton **C. Schmitt** duke u bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Vajmarit. Këtë koncept, **Schmitt** e ka ndërtuar duke u bazuar në shtjellimet e **Benjamin Constant** mbi monarkun si ***pouvoir neutre et intermédiaire*** (pushtet neutral dhe i ndërmjetëm) një monarki kushtetuese.

Pikëpamjet në fjalë, **B. Constant** i ka paraqitur për herë të parë në vitin 1802, duke iu referuar shefit kolektiv të shtetit në një republikë parlamentare dhe monarkut si shef shteti (Cf. Patrice Rolland, "Comment préserver les institutions politiques? la théorie du pouvoir neutre chez Benjamin Constant", *Revue Française d'Histoire des Idées Politiques*, vol. 1, no. 27, 2008, fq. 43-73, në. fq. 44 fusnota nr. 2). Pas restaurimit të dinastisë Bourbon (1814), **Benjamin Constant** i bëri akoma më të qarta tezat dhe pozicionin e vet për monarkun si shef shteti, përkatësisht si një pushtet i tretë neutral dhe i ndërmjetëm, duke e braktisur shefin kolektiv të shtetit në një sistem republikan parlamentar. Këtë e bën në veprën e tij monumentale me titull ***Réflexions sur les constitutions, la distribution des pouvoirs, et les garanties, dans une monarchie constitutionnelle*** (H. Nicolle: Paris 1814). Shtjellimet e **C. Schmitt**-it, ndërkaq, sado që bazohen në këto dy vepra të **B. Constant**, në thelb janë arsyetime pragmatike të diktaturës së një individi, një specializim ky i ngushtë i tij. Nuk është vetëm ky dallim mes tyre: objekt neutralizimi te **B. Constant** janë pushtetet e ndara sipas konceptit të mekanikës së **Montesquieu**-s, balancimi i të cilave tani propozohet të bëhet përmes krijimit të një pushteti të tretë, të ndarë dhe të ndërmjetëm që nuk ka rol aktiv por pasiv dhe që nuk bën pjesë në asnjërën prej tri pushteteve klasike.

Para se të shohim si duket ky pushtet neutral dhe i ndërmjetëm, gjë që është esenca e shtjellimeve tona, kush është ai dhe cili duhet të jetë roli dhe pozita e tij kushtetuese, relevanca e tij që nga koha e **B. Constant**-it e deri më sot, duhet të flasim pak edhe për llojin e katërt dhe të fundit të manifestimit të pushtetit aktiv sipas **C. Schmitt**-it. Ai pushtet, sipas tij, është pushteti i një shteti të tretë, i cili pacifikon (shtyp) konfliktet brendashtetërore sipas një mandati (autorizimi) të fituar (marrë) në mënyrë ligjërisht të pranueshme sipas të drejtës ndërkombëtare. Këtu fjala është, sipas **Schmitt**-it, për protektoratet, të cilat i zënë në gojë në mënyrë shprehimore (Cf. më gjerësisht për shtjellimet e katër llojeve si më sipër të pushtetit neutral dhe të ndërmjetëm të faktuara nga **C. Schmitt**, në **Sandrine Baume**, vep. e cit., fq. 18-19). E njëjta gjë vlen sot për të gjitha rastet e

shtetndërtimit dhe kushtetutëbërjes të ndërmarra me ndihmën e faktorit të jashtëm që nga koha e pavarësimit të Greqisë (1821-1830) e deri në rastet e **Bosnjë-Hercegovinës**, **Timorit Lindor**, **Irakut**, **Kosovës** dhe kështu me radhë. Kjo do të thotë se këtu bëhet fjalë për ushtrimin bashkërisht me faktorin e jashtëm të pushtetit konstituiv (***pouvoir constituant***), ku si balancues i kundërthënieve brendashtetërore shfaqet, krahas vullnetit të popullit edhe vullneti i faktorëve relevant ndërkombëtar (shtetet e caktuara, bashkësia ndërkombëtare e kohës, ndonjë organizatë ndërkombëtare apo organizëm tjetër joformal ndërkombëtar dhe kështu me radhë).

T'i kthehemi tani konceptit të ***pouvoir neutre et intermédiaire*** ("pushtet neutral dhe i ndërmjetëm") të **B. Constant**-it. Në këtë koncept gjendet origjina fillestare e fizionomisë aktuale kushtetuese të shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare (monarki apo republikë). Për shtjellimet në vijim ne do të përdorim burimet si vijon të literaturës: **Benjamin Constant**, ***Réflexions sur les constitutions...***; **Benjamin Constant**, ***Principles of Politics Applicable to All Governments*** (Liberty Fund: Indianapolis, 2003); **Patrice Rolland**, "Comment préserver les institutions politiques?...; **Sandrine Baume**, "De l'usage des pouvoirs neutres". Burimet e tjera i citojmë sipas ideve e shtjellimeve të shpërfaqura në tekstin në vijim. Librit të **Benjamin Constant**-it me titull ***Fragments d'un ouvrage abandonné sur la possibilité d'une constitution républicaine dans un grand pays***, të vitit 1802, i referohemi sipas autorit **P. Rolland** sepse ne vetë nuk kemi pasur mundësi të sigurojmë kopjen e librit në origjinal. Në ndërkohë, i kujtojmë lexuesit se ky shkrim, i botuar në vitin 1802, trajton pikëpamjet e **Benjamin Constant**-it si republikan. Mirëpo, siç e thotë vetë **P. Rolland**, këto pikëpamje në thelb nuk ndryshojnë esencën e problemit sepse koncepti i shefit të shtetit si ***pouvoir neutre et intermédiaire*** (pushtet neutral dhe i ndërmjetëm) nuk ndryshon nga shkrimi i **B. Constant**-it i vitit 1814 e tutje. Dallimi i vetëm është se autori këtë rol të këtij pushteti ia mvesh një trupi kolektiv republikan, diçka ngjashëm me presidencën kolektive ish-jugosllave, duke konstatuar se republika është e vetmja formë qeverisëse që siguron ndarjen e pushteteve. Në vitin 1814, ndërkaq, këtë cilësi ia njeh vetëm monarkut kushtetues si shef shteti, jo trupit kolektiv republikan. Të shohim cilat janë arsyet për këtë zhvendosje të qëndrimit të **B. Constant**-it.

Pasi Revolucioni Francez mori rrugën e terrorit si pasojë e veprimit të shfrenuar të ***volonté générale*** (vullnetit të përgjithshëm) të avokuar nga **J.J. Rousseau**, **B. Constant** propozoi futjen në kushtetutë të disa garan-

cive kushtetuese. Ato garanci kishin qenë: bikameralizmi, e drejta e vetos në favor të ekzekutivit, e drejta e shpërndarjes së parlamentit, përgjegjësia e ekzekutivit, pavarësia e gjyqësorit dhe, në fund, kufizimet e ekzekutivit në lidhje me përdorimin e ushtrisë. Në të njëjtën kohë, mësuesi i tij **Abbé Sieyès** kishte dalë me propozimin për një "juri kushtetuese" (***jurie constitutionnaire***), që do të ushtronte kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Ky propozim u refuzua. Në vend të tij, u pranua ideja e themelimit të një **Tribunati** dhe një parlamenti dydhomësh. Kjo përbënte zbatim të idesë së **Montesquieu**-s, jo të **J.J. Rousseau**-s. Ideja e parë e kuptonte pushtetin si një kategori që mund të racionalizohej ashtu që edhe ndarja e tij ndiqte logjikën e veprimit racional të mekanikës si pasojë e ndarjes së detyrave mes pjesëve të sistemit të pushtetit. Në krye të sistemit gjendej një trup aristokratik, **Tribunati**, i cili shërbente si balancues i mekanikës së pushtetit. Ideja e dytë, ndërkaq, bazohej në pushtetin si pasion: kjo nënkuptonte se brenda ligjvënësit mund të formohej një trup konservator, i cili duhej të kujdesej për ruajtjen e vullnetit absolut të sovranit përmes kontrollimit të cilësisë së ligjeve të tij. Me këtë hap, u pranua se **J.J. Rousseau** e kishte pasur gabim kur kishte thënë se sovrani është i pagabueshëm. Pak vite më vonë, u miratua edhe një zgjidhje tjetër, që përbënte një sukses shtesë në luftën për demokraci përfaqësuese: u miratua krijimi i një organi tjetër kontrollues i vullnetit të sovranit. Ai organ u quajt **Senati Konservator**, ekzistenca e të cilit u përkrah si dominante në Kushtetutën e vitit 1799. Të gjitha këto ide dhe praktika të garancive kushtetuese, si dhe paefektshmëria e tyre në sigurimin e ndarjes së pushteteve, dhuna dhe terrori i ushtruar nga i a.q. Komiteti i Shpëtimit dhe më pas me një intensitet më të vogël bënë që **B. Constant** të vazhdojë traditën e kërkimit të mekanizmave për balancimin e pushteteve të ndara në pikëpamje mekanike. Në këtë kohë, **Napoleon Bonaparte** kishte nisur ndërtimin e **Perandorisë së Francës** dhe, për pasojë, shkatërrimin e rendit kushtetues ekzistues. Pas rrëzimit të tij dhe rikthimin në pushtet të dinastisë Bourbon sërish u riaktualizua nevoja për krijimin e mekanizmave balancues të pushteteve të ndara në mënyrë mekanike. Në bazë të përvojës së vet të hidhur me dhunë dhe terrorin revolucionar, **B. Constant** kërkoi shpëtimin jashtë pushteteve klasike, diçka që askush nuk e kishte menduar më herët. Kur pushtetet janë të ndara duhet të frikësohemi njëjtë si kur janë të bashkuara, thoshte **B. Constant**. Kjo sepse, sipas tij, në rastin e parë shoqëria futet në anarki kurse në të dytin në despotizëm dhe diktaturë. Kjo nënkupton që pushteti që duhet të luajë rolin e balancuesit të tri pushteteve duhet kërkuar jashtë

tyre. Në këtë kohë, kushtetuta është kuptuar si një dokument që rregullon vetëm mekanikën e pushtetit, jo dinamikën e tij, pra si diçka që shërben vetëm për të treguar vendin që ka secili pushtet në shoqëri në kuadër të mekanikës së tërësishme të pushtetit shtetëror. Ky pushtet i jashtëm dhe balancues, sipas **B. Constant**-it, duhej të posedonte disa atribute (cilësi) që nuk i kanë tri pushtetet e ndara ashtu që të mund t'i përdorë të njëjtat kundër tyre në rast të ngatërrimit ndërmjet veti dhe paralizimit të mekanizmit të tërësishëm të pushtetit si pasojë e ngatërresave të tilla. Thënë me fjalë të tjera, atributet (cilësitë) e pushtetit të jashtëm duhet të jenë të atilla që të mundësojnë ndërhyrjen efektive në ngatërresat dhe ndërskamcat që tri pushtetet ia vënë njëri-tjetrit në mënyrë që të mos vijë deri të paralizimi i mekanizimit të pushtetit si tërësi. Vlen të theksohet se **B. Constant** nuk e llogarit gjyqësorin në kuadër të tri pushteteve klasike që duhen balancuar. Këto atribute (cilësi), të cilat e bëjnë këtë pushtet të tretë të jashtëm dhe neutral, duke i dhënë mundësinë e balancimit të tri pushteteve të tjera kanë të bëjnë me sa vijon:

- të drejtën e shkarkimit të ekzekutivit kur pamundësohet funksionimi i tij;
- të drejtën e tij për të shpërndarë legjislativin kur paralizohet puna e tij si pasojë e humbjes së shumicës parlamentare dhe arsyeve të tjera objektive; dhe
- të drejtën e faljes.

Tri këto atribute (pushtete) e bëjnë këtë pushtet të jashtëm neutral sepse, në rastin e parë dhe të dytë, ky pushtet e kthen gjendjen në pikën zero, duke ia lënë në dorë vullnetit të popullit si sovran që të zhbllokojë situatën me votën e vet ose të përfaqësuesve të tij. Ky pushtet këtu vetëm konstaton se janë plotësuar kushtet për ndërhyrjen e tij për të zgjidhur ngërçin sepse qeverisja dhe ligjvënia kanë humbur legjitimitetin e popullit. Këtu është fjala për një situatë që e kanë krijuar vetë përfaqësuesit e popullit. Sa i përket të drejtës së faljes, **B. Constant** thekson se kjo nuk paraqet ndërhyrje në punën e gjyqësorit sepse pushteti neutral nuk merret me zhvlerësimin e vendimeve të formës së prerë të gjyqësorit, të dhëna në një rast individual. Këtu bëhet fjalë për zbutjen e sanksionit, jo për prishjen e vendimit të gjyqësorit: në rastet kur pushteti neutral konsideron se sanksioni i shqiptuar në vazhdën e vënies në jetë të normave abstrakte penale, atëherë vjen deri te zbatimi i institutit të faljes mbretërore. Përveç këtyre karakteristikave të këtij pushteti neutral dhe të ndërmjetëm, **B. Constant** e thekson edhe një tjetër që ka shumë rëndësi: asnjëri prej tri at-

ributeve (cilësive) si më sipër të tij nuk ka të bëjë me qytetarin. Meqenëse kjo është kështu, pra që nuk ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me qytetarin, atëherë shtrohet pyetja se çfarë qëllimi synon të arrijë ushtrimi i këtij pushteti të tretë, neutral dhe të ndërmjetëm, dhe kujt i takon ky lloj pushteti? Ushtrimi i këtij pushteti neutral dhe të ndërmjetëm konsiston në arritjen e qëllimeve si vijon:

- ruajtjen e lirisë së popullit;
- ruajtjen e dinjitetit të pushtetit legjislativ;
- ruajtjen e interesit për stabilitet të ekzekutivit.

Për hir të arritjes së këtyre qëllimeve si më sipër, ky pushtet mund t'i takojë vetëm monarkut si shef individual i shtetit (apo një trup kolektiv kur flitet për republikën parlamentare). Shënojmë këtu se në kohën kur ka shkruar **B. Constant** për këtë nuk ka ekzistuar asnjë republikë parlamentare. Ajo u krijua në Francë më 1870, pas kolapsit të **Perandorisë së Dytë Franceze**. President i parë i saj u zgjodh **Adolphe Thiers**, moto e të cilit kishte qenë: "mbreti mbretëron, nuk qeveris" (***Le Roi règne mais ne gouverne pas***). Ky person u bë simbol mishërues i ideve të **B. Constant** mbi pushtetin neutral dhe të ndërmjetëm të shefit të shtetit, të cilat tani po i vente në jetë në një republikë parlamentare, në **Francë**. Në fakt, këto fjalë **Adolphe Thiers** i kishte thënë që në vitin 1830 në një artikull të tij të botuar në gazetën parisiene ***Le National*** (20 janar 1830). Më këtë shprehje, **A. Thiers** ka treguar anën balancuese të postit të shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare. Në këtë shkrim të tij, ai ka përshkruar mbretin si një person që ndan dhurata dhe merret me aspektet protokollare të Monarkisë së Francës së viteve '30 të shekullit XIX. Ky ideal i mishëruar në këtë moto që përshkruan shefin e shtetit si një organ të tretë të veshur me pushtet pasiv dhe të ndërmjetëm u tradhtua në demokracinë parlamentare vajmariane sepse shefi i shtetit, **Presidenti i Rajhut**, gëzonte pushtete diktatoriale: neni 48 i Kushtetutës së Vajmarit u provua fatal për luajtjen e rolit të neutralizuesit dhe balancuesit të tri pushteteve të tjera sepse i jepte të drejtën Presidentit të Gjermanisë që të udhëhiqte me dekrete, duke suspenduar në tërësi punën e **Rajhstag**-ut në kohët e krizave dhe gjendjeve të jashtëzakonshme.

Pse monarku duhej të ishte pushteti i tretë, neutral dhe i ndërmjetëm sipas **Benjamin Constant**-it? Kjo sepse ajo/ai në një monarki kushtetuese parlamentare nuk është bartëse e pushtetit ekzekutiv, të cilin **B. Constant** e quan **pushtet aktiv**, ashtu që ngelet jashtë lojës konkurrente që bëhet mes tri pushteteve dhe nuk është pjesë e tyre. Trashëgimi, tradita familjare

mbretërore dhe lartmadhëria e bëjnë një mbret apo mbretëreshë të qëndrojë mbi konfliktet politike dhe, për pasojë, të ngelet neutral dhe balancues i tri pushteteve të ndara kushtetuese. Këtë rol shefi i shtetit në një monarki e luan përmes ushtrimit të autorizimeve balancuese si më sipër që kanë për synim arritjen e tri qëllimeve si më sipër e kjo do të thotë rikrijimin e stabilitetit kushtetues në sistem kurdo që ai prishet si pasojë e luftës së brendshme mes tri pushteteve, duke ridërguar sërish në mëshirën e votës së popullit dy pushtetet e ndara (gjyqësori nuk llogaritet-futet në këtë mes). Ky pushtet është **pushtet pasiv**, rri jashtë tri pushteteve të ndara dhe qëndron i pari në maje të hierarkisë. Cilësitë e një shefi kolektiv të shtetit në një republikë parlamentare, sipas **B. Constant**-it, do të ishin se ai trup do të përbëhej nga njerëz të moshuar dhe me përvojë të gjatë në ekzekutiv e legjislativ. Interesi i tyre për të shërbyer si pushtet neutral dhe i ndërmjetëm (balancues) është i ngjashëm me atë të monarkut: ruajtja e eminencës së tyre të fituar me mund dhe me punë të gjatë në shërbim të shtetit. Këta individë si shef kolektiv i shtetit, njëjtë si monarku nuk kanë asnjë arsye për t'u sjellë me pasion të pushtetit sepse nuk kanë çfarë të fitojnë më shumë se që e kanë fituar gjatë karrierës së tyre e as të frikësohen nga konkurrenca e pushtetit.

Në vijim si më sipër, kur është në pyetje monarku, gjërat janë edhe më të qarta: interesi i monarkut për të ruajtur popullin, dinjitetin e legjislativit dhe stabilitetin e ekzekutivit e njëjtëson atë me shtetin. Tani më nuk është si në kohën e monarkive absolute dhe të **Luigjit XIV** kur monarku ishte shteti. Ky i fundit tani paraqitet në fytyrën e një organi pasiv, i cili nuk absorbon pushtetet e tjera: ajo/ai tani paraqitet në majën e piramidës së institucioneve shtetërore të cilat përfaqësojnë tri pushtetet e ndara, si një balancues dhe garantues i stabilitetit të tyre dhe ruajtës i lirisë së popullit si burim i tërë pushtetit. Të qenët në piramidë, pa ambicie për pushtet aktiv dhe pa asnjë frikë nga konkurrenca ndërmjet tri pushteteve, e bën shefin e shtetit (si monarkun ashtu shefin republikan) të jetë në rend të parë kreu i shtetit. Sipas **B. Constant**-it, kjo paraqet cilësinë e parë të këtij organi kushtetues dhe vlen si për monarkun e një monarkie kushtetuese parlamentare ashtu edhe për shefin kolektiv të shtetit në një demokraci kushtetuese republikane. Kjo e bën këtë pushtet ruajtës dhe balancues të institucioneve që përfaqësojnë pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kjo ruajtje e balancës nënkupton ruajtjen e balancës mekanike, jo të dinamikës së pushtetit. Me mekanikë këtu nënkuptojmë modelimin kushtetues të një sistemi të ndarjes së pushteteve dhe balancimin e tyre që nuk ndodhë

vetëm si rezultat i ndeshjes gravitacionale ndërmjet institucioneve shtetërore që përfaqësojnë tre pushtete klasike. Apo, e thënë me fjalën e autorëve të ***Letrat e Federalistit*** nr. 51, një modelim ku "një pushtet (pasion) balancohet me një pushtet (pasion) tjetër". Janë cilësitë e institucioneve që përfaqësojnë pushtetet, jo pasionet e individit, ato që sigurojnë dhe garantojnë funksionimin mekanik të balancimit ndër-institucional. Një gjë e tillë arrihet kryesisht përmes specializimit të ngushtë të kompetencave të këtyre institucioneve. Krahas kësaj nevojitet krijimi i një pushteti të tretë, ndaras nga tri pushtetet klasike, i një kundërpushteti me kompetenca të natyrës neutrale dhe të ndërmjetme, pra me kompetenca dhe autorizime që nuk i takojnë asnjërit prej tri pushteteve të ndara, të cilat duhen balancuar (ekuilibruar) (Cf. **Marie-Hélène Caitucoli-Wirth**, "La vertu des institutions: l'héritage méconnu de Sieyès et de Constant", *Histoire@Politique*, vol. 1, no. 16, 2012, fq. 121-139). Kjo është krejt e ndryshme nga koncepti i **Montesquieu**-s dhe **Rousseau**-s, por edhe më i ndryshëm nga përvoja amerikane: për **Montesquieu**-n balancimi kryhet përmes veprimit të organit aristokratik kontrollues, kurse për **Rousseau**-n, përmes dominimit të ***volonté générale*** dhe parlamentit si një zë i tij. Në SHBA, ndërkaq, kjo arrihej, thjesht, përmes balancimit reciprok të një pushteti me tjetrin; secili nga pushtetet kishte autorizimet e veta që duhej t'i ruante me kujdes dhe xhelozi. Edhe në SHBA, me kalimin e kohës, u pa se vetëm veprimi mekanik i gravitacionit të pushteteve nuk mjaftonte për të siguruar balancimin ndërmjet tyre: me vendimin në rastin *Marbury v. Madison* (1803) u hap dera për kontrollin gjyqësor të balancimit të pushteteve me qëllim të sigurimit të supremacisë së Kushtetutës në të cilën ishin gdhendur normat kushtetuese mbi ndarjen e pushteteve. Ky autorizim iu dha gjyqësorit, si degë e pushtetit që Montesquieu, Abbé Sieyès dhe B. Constant e kishin cilësuar kaherë si jopushtet apo, siç do ta quante më vonë **Alexander Bickel**, "pushteti më së pakut i rrezikshëm". I tillë u cilësua sepse nuk kishte në dispozicion as shpatën dhe as forcën e parasë (Cf. më shumë në **Alexander M. Bickel**, ***The Least Dangerous Branch: The Supreme Court at the Bar of Politics***, 2d ed., Yale UP: Yale, 1986).

Nëse e krahasojmë me ligjet e inxhinierisë mekanike, pushteti neutral dhe i ndërmjetëm i shefit të shtetit luan rolin e një lubrifikanti të makinerisë së pushtetit (makinerisë legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore), me qëllim që kjo makineri të lëvizë në një drejtim të përgjithshëm me qëllim të përbashkët të përcaktuar me kushtetutë. Pa këtë lubrifikant në duart e pushtetit të tretë neutral dhe të ndërmjetëm, me autorizime të qarta balancu-

ese të cilat nuk i kanë asnjëri prej tri pushteteve dhëmbëzoret e makinerisë së tri pushteteve, e thënë kjo në mënyrë figurative, do t'ia thyenin dhëmbët njëri-tjetrit dhe do të bëheshin jofunksionalë dhe pa vlerë marrë si tërësi. Një gjendje e tillë do të përfundonte ose në centralizim të pushtetit dhe në despotizëm ose në shkapërderdhjen e tij dhe, për pasojë, në një anarki totale. Në këtë kuptim duhet të kuptohen çdoherë kompetencat neutrale dhe të ndërmjetme të secilit president apo monark në një demokraci kushtetuese parlamentare. U mor vesh, kushtetutat bashkëkohore e kanë mjaft të pasur listën e kompetencave të tilla, larg më të pasur dhe më të ndryshme se nga koha kur **B. Constant** ka shkruar. Koncepti teorik dhe praktika e vënies së tij në jetë, megjithatë, ngelen të pandryshuar që nga ajo kohë. Në kuadër të listës së tillë, tani hyjnë kompetencat si iniciativa legjislative dhe kushtetuese, dekretimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, dekretimi i zyrtarëve të caktuar shtetëror dhe kështu me radhë. Këto kompetenca janë vendimmarrje zinxhirore, tërësisht në funksion të neutralizimit të njërit prej tri pushteteve, me kapacitet të ndërmjetëm sa i përket natyrës së tyre. Të kësaj natyre janë edhe kompetencat tjera, siç janë dhënia e mandatit për formimin e ekzekutivit dhe shpërndarja e parlamentit pas plotësimit të kushteve të caktuara me kushtetutë (kur të njëjtat organe delegjitimojnë vetveten). Ka edhe shumë kompetenca të tjera që gjenden në menynë e kategorisë së pushtetit neutral dhe të ndërmjetëm. Në këtë grup hyn edhe shpallja e ligjeve dhe e drejta e faljes. As në Kosovë e as në vendet e tjera që kultivojnë demokraci kushtetuese parlamentare, shefi i shtetit (monarku ose presidenti) nuk mund të ketë asnjë kompetencë ekzekutive autonome, pra asnjë kompetencë që mund ta ushtrojë në mënyrë të pavarur dhe që i takon kategorisë së pushtetit aktiv. Çdo vendimmarrje e shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare është zinxhirore dhe ka për qëllim të vetëm neutralizimin e tri pushteteve të tjera dhe garantimin e funksionimit të tyre stabil dhe në pajtim me kushtetutën.

Pushteti jo mekanik, përkatësisht aspekti dinamik i pushtetit dhe institucioneve që e përfaqësojnë ndjekin rrugën evolutive. Kjo është kështu sepse shefi i shtetit në një demokraci parlamentare nuk bën pjesë në aparatin qeverisës por ka rolin e ruajtësit të institucioneve përmes ushtrimit të autorizimeve neutrale dhe të ndërmjetme, jo të konservimit të gjendjes së tyre fillestare. Logjika e këtij postulati të **B. Constant**-it është kjo: shoqëria evoluon sipas dinamikave dhe ligjshmërive të saj; në mënyrë të njëjtë evoluojnë edhe institucionet, gjë që manifestohet në secilin rezultat zgjedhor që prodhohet periodikisht si rezultat i shprehjes së vullnetit të sovranit;

kjo shprehje, e cila reflekton dinamikat shoqërore, mund të çojë edhe në ndryshime kushtetuese të një përmbajtjeje të dhënë dhe një gjë e tillë është krejt legjitime dhe këtë shefi i shtetit duhet ta animojë dhe respektojë deri në fund në tërësinë e vet.

Shtjellimet si më sipër të **B. Constant**-it gjetën shprehjen e tyre kushtetuese në dy kushtetutat e para të nxjerra pas rrëzimit të **Napoleon Bonapartes**. E kemi fjalën për kushtetutat e **Brazilit** (1824) dhe të **Portugalisë** (1826). Në dy këto kushtetuta, shefi i shtetit, perandori (Brazil) dhe mbreti (Portugali) respektivisht, u cilësua si kreu i shtetit duke u veshur me pushtet neutral dhe të ndërmjetëm. Qëllimi i kësaj veshje me këtë pushtet ishte që ky shef i ri i shtetit të qëndronte ndaras nga tri pushtetet e tjera me qëllim parësor ruajtjen e institucioneve funksionale dhe stabile. Në rastin e Brazilit, perandori paraqitet edhe si ruajtës i kushtetutës dhe aspekteve vitale të sovranitetit nacional dhe territorial, standard ky që më pastaj do të vihet nëpër kushtetutat e tjera me sistem presidencial dhe gjysmëpresidencial. E fundit e këtij lloji është Kushtetuta e **Francës** e vitit 1958, e cila ia njeh shefit të shtetit tagrin për të qenë ruajtës i kushtetutës dhe i aspekteve vitale të sovranitetit nacional dhe territorial. Vetë gjenerali **Charles de Gaulle** (1890-1970) ka insistuar që shefi i shtetit të merr rolin e arbitrit në ngatërresat dhe luftën mes ekzekutivit dhe legjislativit francez. Kjo, megjithatë, bie ndesh me botëkuptimet e **B. Constant**-it dhe rolin tërësisht pasiv, neutral dhe të ndërmjetëm, të shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare. Franca, megjithatë, nuk është e tillë në sistemin qeverisës. Postulati i tillë i **B. Constant**-it akoma është i qëndrueshëm për regjimet e demokracive kushtetuese parlamentare: shefi i shtetit në këto demokraci asnjëherë nuk mund të bëhet pjesë e lojës së tri pushteteve dhe as të hyjë në konkurrencë me to; vetë nuk duhet të ketë asnjë iniciativë tjetër pos të ndërhyrjes në rastet e delegjitimimit të institucioneve që përfaqësojnë mekanikën e tri pushteteve klasike (pa marrë parasysh arsyet e delegjitimimit të tillë).

Kjo kërkesë e gjeneralit **De Gaulle**, megjithatë, nuk u plotësua në tërësi. Në Francë mbretëron sistemi gjysmëpresidencial ku shefi i shtetit përveç që është kreu i shtetit ka edhe autorizime ekzekutive dhe mund t'i përdor ato por vetëm për të arritur objektivat kushtetuese. Në vet renditjen e organeve kushtetuese, **Presidenti i Francës** figuron i pari (Titulli II, nenet 5-19 të Kushtetutës së vitit 1958): kompetencat e tij nga neni 5, dhe masat që mund t'i ndërmarrë sipas nenit 16 të Kushtetutës për t'i vënë ato në jetë, tregojnë se në sistemin gjysmëpresidencial dhe presidencial shefi i

shtetit ka prerogativat që dikur i ka pasur mbreti si shef shteti e që kanë të bëjnë me garantimin e sovranitetit nacional dhe territorial. Këto prerogativa kanë të bëjnë edhe me përfaqësim të vullnetit të popullit. Pikërisht kjo qe arsyeja që krijoi nevojën që mekanika e re e ndarjes së pushteteve të plotësohej me krijimin edhe të një organi tjetër balancues, i cili u vesh me prerogativa specifike neutrale dhe të ndërmjetme me qëllim të ruajtjes së ekuilibrit mes legjislativit dhe ekzekutivit francez. Presidentit iu mor e drejta e arbitrimit në ngatërresat mes pushteteve të ndara. E kemi fjalën për Këshillin Kushtetues (***Conseil constitutionnel***): në fillim u themelua si organ për të arbitruar në ngatërresat eventuale mes legjislativit dhe ekzekutivit francez për t'u shndërruar në mënyrë graduale në një gjykatë të mirëfilltë kushtetuese. Ky shndërrim e ka zanafillën në një vendim të këtij organi në vitin 1971 kur u krijua termi ***bloc de constitutionalité***: ky term nënkupton që si parametër për vlerësimin e kushtetutshmërisë në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut shërben jo vetëm Kushtetuta e vitit 1958 por edhe Preambula e Kushtetutës së vitit 1946 dhe, përmes saj edhe Deklarata mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit (1789). Në prill të vitit 2010, ky evoluim u pasurua me një sukses tjetër: që nga kjo kohë, **Këshilli Kushtetues i Francës** vepron edhe si kontrollues represiv i kushtetutshmërisë së ligjeve franceze, në të gjitha rastet kur flitet për liritë dhe të drejtat e njeriut. Kjo njihet si ***contrôle préliminaire de constitutionalité*** dhe ka qenë e paimagjinueshme në kohën e gjeneralit **De Gaulle**.

B. Constant ka shërbyer si shkëndijë dhe bazë teorike për konsolidimin e teorisë dhe praktikës mbi shefin e shtetit si ruajtës i funksionalitetit dhe stabilitetit të institucioneve që përfaqësojnë tri pushtete klasike. Jo pa të drejtë, ky autor është cilësuar si teoricieni i parë dhe themeltar i demokracisë përfaqësuese. Në vijim të përdorimit dhe shpërdorimit të idesë së tij, si një efekt anësor ka lindur edhe debati **Carl Schmitt–Hans Kelsen**. Ky ka qenë ndër debatet me konsoliduese të gjyqësisë kushtetuese ashtu siç e njohim sot, duke hapur rrugën e ndërtimit dhe konsolidimit përfundimtar të gjyqësisë kushtetuese materiale (substanciale). I ka hapur rrugën, thënë me fjalë të tjera, jo vetëm gjyqësisë formale kelseniane që merret me ligjvënien negative, duke pranuar se gjykatat mund të kenë edhe rol aktiv në sferën e bashkëligjvënies dhe bashkë-amendamentimit, kontrollit kushtetues të referendumeve, përgjegjësisë kushtetuese dhe tjetër të shefit të shtetit dhe funksionarëve të tjerë publikë, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe shumë autorizime të tjera që kanë qenë të paimagjinueshme në kohën e debatit si më sipër.

Ky debat u zhvillua duke pasur për pikë referimi Kushtetutën e Vajmarit (1919): në ndërkohë që **C. Schmitt**, duke u bazuar në shkrimet e **B. Constant**-it, pohonte me këmbëngulje se shefi i shtetit duhej të ishte jo vetëm garantues i stabilitetit dhe funksionalitetit të institucioneve por, bazuar në nenin 48 të Kushtetutës së Vajmarit, duhej të ishte edhe garantues i vetëm i kësaj kushtetute. Ky nen i jepte shefit të shtetit të drejtën për të qeverisur pafundësisht përmes dekreteve në dëm të Rajhstagut (parlamentit gjerman). Këtë dispozitë, **C. Schmitt** e shihte si shpëtim të demokracisë së brishtë vajmariane, e cila kishte një parlament të përçarë dhe të ngatërruar në luftë të përhershme politike. Kjo bënte që parlamenti asnjëherë, sipas tij, të mos mund të shërbente si përfaqësues i vullnetit të popullit gjerman. I tillë, pra përfaqësues i vullnetit të të gjithë gjermanëve, mund të ishte vetëm **Presidenti i Rajhut**, i cili, duke qenë i zgjedhur nga tërë populli gjerman paraqiste emëruesin e përbashkët të të gjithë gjermanëve. Kjo, gjithnjë sipas tij, ishte arsyeja që vetë **Hugo Preuss**, njëri ndër arkitektët e **Kushtetutës së Vajmarit**, ia kishte lënë **Presidentit të Rajhut** autorizimet diktatoriale nga neni 48 si më sipër. Vetëm Presidenti, dhe asnjëherë Parlamenti, mund të shprehte vullnetin total të krejt kombit gjerman. Në kohë paqeje, ndërkaq, i njëjti President kishte autorizime neutrale dhe të ndërmjetme, të cilat, sipas **C. Schmitt**-it, korrespondonin me idetë e **B. Constant**-it. Kjo, megjithatë, nuk ishte e vërtetë: ardhja në pushtet e **Adolf Hitler**-it, jo vetëm që provoi të kundërtën por bëri që vetë gjermanët pas Luftës së Dytë Botërore të kujdeseshin shumë për fizionominë e shefit të ri të shtetit të shkatërruar nga lufta: **Ligji Themelor** me përpikëri ruajti themelet e demokracisë përfaqësuese parlamentare të trasuar nga **B. Constant**, me shefin e shtetit si kreu i shtetit dhe garantues i stabilitetit dhe funksionalitetit të institucioneve kushtetuese, duke pasur në tërësi autorizime ekskluzivisht neutrale dhe të ndërmjetme. Dinamikat institucionale dhe vetë **Ligji Themelor** ngelën në duart e një organi tjetër, të tretë, i veshur me autorizime të reja neutrale dhe të ndërmjetme, të cilat autorizime nuk i kishte asnjëri prej tri pushteteve të ndara. E kemi fjalën për **Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë**.

Kjo si më sipër nuk do të thotë se gjermanët në tërësi përqafuan idetë **e B. Constant** dhe **H. Kelsen** respektivisht. Koncepti, megjithatë, ngelet i njëjtë: për t'u moderuar pushteti nuk mjaftojnë vetëm ndarja e tij dhe shpresa se mekanika e lëvizjes së tij do të jetë e rregullt dhe do të çojë automatikisht kah balancimi reciprok i pjesëve. Kjo sepse krejt e kundërta ndodh: kur pushteti vepron sipas logjikës së gravitacionit mekanik do-

mosdo që degjeneron duke absorbuar pushtetet e tjera. Kjo ka ndodhur me **Gjermaninë e Vajmarit**, ku Presidenti nuk shërbeu vetëm si kreu i shtetit por edhe si lexues dhe interpretues i vullnetit politik të tërë popullit gjerman dhe, për pasojë, si garantues i unitetit të tij socio-politik në çdo kohë dhe hapësirë. Për të mos ndodhur kjo, **H. Kelsen** kishte mbrojtur fuqishëm idenë se vetëm një pushtet i tretë, i ndarë nga tri pushtetet klasike, mund të shërbente si ruajtës i Kushtetutës dhe i ekuilibrit mes pushteteve. **H. Kelsen** e pranonte se në këtë mes ka ngapak politikë sepse një gjykatë kushtetuese duke e kthyer prapa ligjin si jokushtetues, domosdo që bëhet bashkë-ligjvënës apo, siç e ka cilësuar vet ai, ligjvënës negativ. Esenca ngelet e njëjtë si te **B. Constant**: pushteti ruajtës i institucioneve dhe i stabilitetit të tyre duhet të jetë pushtet pasiv, pa asnjë ingerencë aktive, tërësisht neutrale dhe i ndërmjetëm. Ky pushtet duhet të jetë jashtë tri pushteteve të tjera dhe të ketë autorizime vetanake që kanë natyrë si më sipër (neutrale dhe të ndërmjetme). Këto autorizime, **H. Kelsen** i cilëson si autorizime autonome juridiksionale të përcaktuara qartë në kushtetutë. Si të tilla, këto autorizime kanë evoluar shumë nga koha kur janë thënë prej pendës së **H. Kelsen**-it, duke e ndryshuar dukshëm fizionominë dhe përmbajtjen e gjyqësisë kushtetuese bashkëkohore. Mirëpo, siç e ka thënë një autor i njohur, ne jemi mirënjohës ndaj **H. Kelsen**-it, por jo skllevër të tij: sot gjykatat kushtetuese nëpër botë, përfshirë këtu edhe Kosovën, kanë kompetenca të ligjvënësit dhe kushtetutëbërësit aktiv, të mbrojtësit rigoroz të parimit të ndarjes mekanike të pushteteve (konflikti për kompetencë), të mbrojtësit të ndarjes dinamike të pushteteve si pjesë thelbësore e parimit kushtetues mbi sundimin e ligjit (të gjitha autorizimet e tjera kushtetuese, përveç konfliktit për kompetencë, të cilat kanë për synim sigurimin e supremacisë së kushtetutës), të mbrojtësit të lirive dhe të drejtave individuale dhe kështu me radhë. Krejt këto autorizime ekzistojnë me qëllim të moderimit të pushtetit përmes një pushteti të tretë që ka autorizime të qarta juridiksionale që nuk i takojnë asnjërit prej pushteteve klasike të ndara.

Përveç shefit të shtetit dhe gjykatës kushtetuese, kohëve të fundit, dekadave të fundit, me rritjen e shtetit administrativ ka lindur edhe metodologjia tjetër e neutralizimit të pushtetit ekzistues. Këtë herë bëhet fjalë për qasje apo metodologji për neutralizim të pushtetit, jo për krijimin e një pushteti të tretë dhe të ndarë nga tri pushtetet klasike. E kemi fjalën për autoritetet e pavarura rregullative, të cilat ekzistojnë në praktikë dhe në kushtetutat e vendeve me demokraci kushtetuese liberale. Ato kanë emër-

time të ndryshme: në Britaninë e Madhe quhen "trupat publikë jodepartamentalë" ose "organizatat gjysmë-autonome joqeveritare" (Quangos); në SHBA ato kanë emërin "agjensionet e pavarura rregullative"; në Francë, "autoritetet e pavarura administrative" dhe kështu me radhë (Sandrine Baume, vp. cit. fq. 24-25). Kosova në këtë drejtim nuk bën përjashtim: kapitulli i XII përbën bazën kushtetuese për themelimin e institucioneve, komisioneve dhe agjencive të pavarura të cilat luajnë rol të rëndësishëm në moderimin e pushtetit publik në Kosovë. Në këtë qasje të re të neutralizimin, e lindur si pasojë e rritjes së nevojave të shtetit për rregullim të shpejtë të jetës dhe aktiviteteve të tjera shtetërore dhe me qëllim të ruajtjes së individit dhe lirës së tij, vendet e Evropës kanë ndërtuar edhe rregullativa administrative të nivelit evropian. Kjo e bën këtë mënyrë të neutralizimit të pushtetit shtetëror mjaft specifike (Cf. më shumë për qasjet në nivel nacional, evropian dhe ndërkombëtar ndaj fuqisë rregullative të shtetit, në punimet si vijon: **Fabrizio Gilardi**, "Policy credibility and delegation to independent regulatory agencies: a comparative empirical analysis", *Journal of European Public Policy*, vol. 9, no. 6, 2002, fq. 873-893; **Mark Thatcher**, "Regulation after delegation: independent regulatory agencies in Europe", *Journal of European Public Policy*, vol. 9, no. 6, 2002, fq. 954-972).

Në fund të këtij ekskursioni mbi teorinë dhe praktikën e neutralizimit të pushtetit të ndarë në demokracitë kushtetuese, rendi e do që të themi disa fjalë për fushat në të cilat sovrani çdoherë, përmes përfaqësuesit të vet, ka mbajtur dhe mban një sy të hapur duke qenë pjesë e vendimmarrjes. E kemi fjalën në veçanti për fushat që kanë të bëjnë me statusin e territorit shtetëror, me hyrjen e shtetit borxh dhe me vendosjen për luftën dhe paqen dhe gjendjet e tjera që kufizohen me to. Në këto fusha asnjëherë nuk ka ndodhur që shefi i shtetit, çoftë kur është vetëm kreu i shtetit apo edhe kreu i ekzekutivit në të njëjtën kohë, roli i përfaqësuesit ka qenë dhe ngelet vendimtar në të gjitha fazat e vendosjes në këto tri fusha. Kjo listë ka pasur zgjerime, ashtu që aktualisht në disa kushtetuta në këtë kategori futen edhe aspekte tjetra të veprimtarisë së shtetit, siç janë liritë dhe të drejtat e njeriut, aleancat politike dhe ushtarake dhe kështu me radhë. Pse kjo është kështu si në sistemin parlamentar, ku shefi i shtetit është vetëm kreu i shtetit, ashtu dhe në atë gjysmëpresidencial apo presidencial, ku shefi i shtetit është edhe kreu i ekzekutivit? Gjetja e përgjigjes në këtë pyetjes sërish na kthen te Revolucioni Francez: me këtë revolucion dhe kushtetutat që u prodhuan nga ai nisi ndërtimi i praktikës shtetërore të ratifikimit të të gjitha llojeve të traktateve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me

statusin e territorit, borxhin e jashtëm shtetëror dhe hyrjen e shtetit në luftë apo shpalljen e gjendjes së përafërt me luftën. Këto tri fusha prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë elementet kyçe të sovranitetit shtetëror ashtu që involvimi vendimtar i përfaqësuesit të sovranit (ose i vetë sovranit përmes referendumit) u fut si një standard i ri. Këto fusha në të kaluarën, gjatë kohës së monarkive absolute që u krijuan pas **Paqes së Vestfalisë** (1648) e deri në **Revolucionin Francez** (1789), kanë qenë prerogativë e monarkut, i cili, jo vetëm që ishte kreu i shtetit por mbante në duart e veta edhe ekzekutivin: tërë territori, financat publike dhe ushtria konsideroheshin si pronë e tij private me të cilin monarku mund të dispononte lirshëm. E njëjta vlente për shtetasit e mbretërisë të cilët konsideroheshin të nënshtruar ndaj vullnetit mbretëror dhe mund të niseshin për luftë në çdo kohë (Cf. më shumë për evoluimin historik të prerogativave mbretërore deri në ditët e sotme në shkrimet si vijon: **Thomas Poole**, "United Kingdom: The royal prerogative", *International Journal of Constitutional Law*, vol. 8, no. 1, 2010, fq. 146-155; **Andrew Blicka**, "Emergency powers and the withering of the Royal Prerogative", *The International Journal of Human Rights*, vol. 18, no. 2, 2014 fq. 195-210; **Teemu Heikkinen**, "Challenging the Royal Prerogative: The Decision on War against Iraq in Parliamentary Debates in 2002–3", *Parliamentary History, v*ol. 35, pt. 1, 2016, fq. 54–66). Tani kur territori shtetëror përbën njërin prej elementeve të qenies shtet, kur individi nuk i nënshtrohet veçse kushtetutës dhe ligjit dhe gëzon liri e të drejta individuale të garantuara, kurse financat publike, buxheti dhe ushtria gjenden nën vëzhgimin dhe kontrollin e një ligjvënësi transparent mbajtja nga ana e monarkut të autorizimeve të tilla as që mund të imagjinohet. Balancimi i këtyre autorizimeve shtetërore, të cilat dikur kanë qenë prerogativa mbretërore, kryhet përmes përcaktimit të saktë të kompetencave neutrale dhe të ndërmjetme ushtrimi i të cilave çdoherë ndodhë nën syrin vigjilent të përfaqësuesit të sovranit ose të vetë sovranit: nuk ka kushtetutë demokratike që këto autorizime nuk i vë nën vendimmarrjen direkt ose të bashkërenditur të sovranit ose përfaqësuesit të tij së bashku me ekzekutivin e shtetit. Kjo në Kushtetutën e Kosovës gjendet e sanksionuar në nenin 18.1 të Kushtetutës së vitit 2008.

Shpresojmë se nga kjo si më sipër, lexuesi do ta ketë të lehtë për të konstatuar arsyen pse Kushtetuta e Kosovës, por asnjë kushtetutë e vendeve demokratike nuk parashikon dhe sqaron domethënien e definimeve të fizionomisë së shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare: fizionomia e tij e të qenët shef i shtetit reflektohet dhe zbërthehet nga lista

e gjatë e kompetencave që ky organ ka statusin e pushtetit neutral dhe të ndërmjetëm, funksion parësor i të cilit është ruajtja e institucioneve kushtetuese që përfaqësojnë tri pushtetet e ndara, stabilitetit dhe funksionimi normal të tyre, si dhe ushtrimi i kompetencave kushtetuese çdoherë kur institucionet shtetërore ngatërrohen ndërmjet veti ose rrezikojnë funksionimin normal të mekanikës së pushtetit shtetëror.

Kapitujt V–VI. Qeveria e Republikës së Kosovës (fq. 411–426). Sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës (fq. 427–454).

Përgjithësisht

Në këtë pjesë të analizës sërish kemi bashkuar dy kapitujt si më sipër. Këtë e kemi bërë ekskluzivisht për një arsye të thjeshtë: shtjellimet e autorëve janë kryesisht dogmatike dhe paraqesin përfolje të tekstit ekzistues kushtetues dhe zgjidhjeve ligjore që i vejnë në jetë zgjidhjet e tilla kushtetuese, pa asnjë analizë kritike të koncepteve bazë që kanë të bëjnë me ekzekutivin në një sistem parlamentar dhe vendin e sistemit të drejtësisë në një sistem të tillë.

Manipulimi i literaturës është i intensitetit të njëjtë: nëse krahasohet numri i burimeve të huaja dhe i faqeve të prodhuara kundrejt shkallës së manipulimit, në fakt, këtu gjendja del më e rëndë. Të shohim si duket kjo më konkretisht.

Në fusnotën nr. **1270** citohet një shkrim i autorëve indianë **Nidhi Singh** & **Anurag Vijay** lidhur me ndarjen e pushteteve në kontekstin e Indisë: artikulli trajton tekstin e Kushtetutës së Indisë, praktikën gjyqësore dhe, në fund, flet për perspektivat e ndryshimit në kushtet e reja të globalizmit në mënyrë që shteti të respektojë sundimin e ligji dhe lirinë e qytetarëve. Autorët tanë citojnë, në mënyrë krejt manipulative, fq. 4 të këtij artikulli: në këtë faqe, artikulli jo vetëm që nuk thotë ashtu siç thonë autorët tanë, por flet për evoluimin e ekzekutivit indian, me Presidentin e Indisë në krye, i cili emëron gjyqtarët, shërbyesit e lartë shtetërorë, shpërndan parlamentin, jep falje për kriminelët e dënuar dhe kështu me radhë. Ajo që bie në sy këtu është se në këtë vend Presidenti dhe guvernatorët kanë kompetenca gjyqësore dhe ligjvënëse në raste të caktuara. Thënë shkurt, këta autorë indian flasin për ndarjen e pushteteve në kontekstin indian.

Kështu, ta zëmë, autorët sqarojnë se supremacia e parlamentit ka qenë idol dhe cilësi që e ka dalluar këtë organ nga tjerët, mirëpo në ndërkohë roli i Gjykatës Supreme të Indisë ka avancuar aq shumë sa që ka marrë kompetenca të theksuara në bashkëligjbërje, në veçanti kur flitet për ruajtjen e balancës së pushteteve dhe mbrojtjen e qytetarëve të këtij vendi.

Në fusnotën nr. **1272**, autorët tanë manipulojnë edhe vetë Kushtetutën e vitit 2008, kur citojnë nenin 4 të saj, që flet për formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve: këtu ky nen citohet sikur flet për mjetet e kontrollit parlamentar dhe rregullat e brendshme të demokracisë parlamentare kosovare (sic!).

Njëjtë veprohet me autorin nga fusnota nr. **1279**: në këtë artikull brilant, autorja **Jenny S. Martinez** shtjellon nga aspekti krahasues të a.q. pushtetet e ngërthyera apo inherente të ekzekutivit. Këtë e bën duke krahasuar pesë vende me modelin amerikan të pushtetit të ngërthyer (inherent) ekzekutiv: **Gjermania**, **Franca**, **Koreja e Jugut**, **Meksika** dhe **SHBA**. Esenca e krahasimit është për të treguar se ekzekutivi nuk mund të ketë pushtete të ngërthyera apo inherente por vetëm shprehimisht të përcaktuara. Si shkas për këtë shkrim i ka shërbyer presidencializmi i fortë i **George W. Bush** dhe të a.q. dekretet mbi luftën kundër terrorizmit. Fushat që janë krahasuar kanë pasur të bëjnë me marrëdhëniet e jashtme (lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare në rend të parë), autorizimet e luftës dhe në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme, siguria nacionale (mënyrat për luftimin e terrorizmit brenda kufijve të shtetit) dhe kështu me radhë. Thënë ndryshe, objekt krahasimi kanë qenë diskutimet lidhur me atë nëse ka një pushtet ekzekutiv të pashkruar, pra që ngërthehet apo merret si inherent në pushtetin ekzistues ekzekutiv të përcaktuar në mënyrë shprehimore me kushtetutë? Autorja konstaton se tendenca është krejt e kundërt, pra që pushteti të kufizohet sa më shumë dhe të mos vetëkuptohet kufizimi i tij, kurse dy vendet që autorët tanë i citojnë, **Franca** e **Gjermania**, përmenden në kontekst krejtësisht tjetër: për **Francën**, autori thekson se, përkundër asaj që ka një sistem gjysme-presidencial, në kohën pas gjeneralit **De Gaulle** ka pasur një kohabitim dhe fuqizim të kryeministrave francezë, kurse për Gjermaninë thotë se ka ndodhë e kundërta: në ndërkohë që formalisht **Presidenti i Gjermanisë** ka disa autorizime në politikën e jashtme (lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe pranimi i përfaqësuesve të jashtëm, përfaqësimi i vendit në botën e jashtme), megjithatë roli i shefit të shtetit në këtë vend është simbolik në tërësi. Autori, sikundër shihet, diskuton shpërputhjen mes tekstit kushtues dhe realitetit në këto dy vende,

diçka kjo krejt e kundërt me atë që thonë autorët tanë.

Në fusnotën **1282**, autorët tanë ftojnë studentin dhe lexuesin të shikojnë më shumë rreth çështjes së cilësi i referohet fusnota: çështja ka të bëjë me kompetencën e dytë të Qeverisë së Kosovës, nga neni 93.2 i Kushtetutës, që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik të vendit. Autorët tanë aty citojnë një material joakademik që ka të bëjë me partitë politike, funksionimin dhe organizimin e tyre. Fq. 68-72 të këtij materiali janë cituar në mbështetje të pohimeve të tyre krejtësisht notore, sipas të cilave një qeveri në një sistem parlamentar detyrohet të koordinojë me një shumicë të caktuar politikat e saj në mënyrë që të ketë sukses. Këto faqe, megjithatë, nuk bëjnë asnjë fjalë për politikat ekonomike dhe koordinimin ndërpartiak si parakusht për shtyrjen përpara të agjendës ekonomike qeveritare. Këto fq. flasin për rolin e grupeve parlamentare dhe mandatin e lirë të deputetëve, në ndërkohë që konstatojnë se praktikë janë vijat partiake ato që dominojnë politikat e qeverisë, jo vetëm të atyre ekonomike.

Është e papranueshme për një tekst universitar mbi të drejtën kushtetuese që nuk përmend dhe trajton **Maurice Duverger**, arkitektin e gjysmëpresidencializmit: krejt ajo që sot quhet semipresidencializëm është lëruar në mënyrë akademike nga ai dhe është pasuar nga tjerët më pastaj. Për këtë bën fjalë shkrimi që citojnë autorët tanë në fusnotat nr. **1320-1321**. Autori i librit përmbledhës ***Semi-Presidentialism in Europe*** (Oxford UP: Oxford, 1999), **Robert Elgie**, krahas të qenit editor i librit me përmbledhje të punimeve mbi gjysmëpresidencializmin në Evropë ka shkruar dy kapitujt e këtij libri: kapitullin e parë ["The Politics of Semi-Presidentialism", fq. 1-22] dhe kapitullin e katërmbëdhjetë ["Semi-Presidentialism and Comparative Institutional Engineering", fq. 281-300]. Në fq. 4, të cilën e citojnë autorët tanë, nuk del një konstatim i njëjtë siç thonë ata: kjo fq. është pjesë e seksionit me titull "Evolution of the Concept of Semi-Presidentialism" (fq. 2-4). Në këtë seksion së pari konstatohet se vetë **M. Duverger** ka pasur dilema një kohë të gjatë lidhur me atë se çka përmban koncepti i gjysmëpresidencializmit. Kjo dilemë e tij ka zgjatur deri në vitin 1978, ku ka definuar këtë koncept. Sipas tij, gjysmëpresidencializmi duhet të këtë tri elemente kryesore në mënyrë kumulative: e para, presidenti duhet të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli; e dyta, duhet të ketë pushtet të konsiderueshëm ekzekutiv; dhe, së fundi, e treta, duhet të ekzistojë një qeveri krahas presidentit, e cila për mbijetesë varet nga besimi i parlamentit. Më pas, në këtë seksion diskutohen definicionet e autorëve **P.H. O'Neil** dhe **G. Sartori**, për të vazhduar me seksionin tjetër të kritikës

së konceptit të **M. Duverger**-it si më sipër, më fillim nga **Georges Vedel** dhe autorët e tjerë në Francë dhe jashtë saj. Nga kjo qartë shihet se autorët tanë flasin me hamendje për koncepte që janë të qarta dhe, për më tepër, flasin në një vend ku nuk e kanë vendin fjalët dhe shtjellimet e tilla: gjysmëpresidencializmi është dashur të shtjellohet në kuadër të kapitullit mbi shefin dhe shtetit. Kjo sepse sistemi gjysmëpresidencial ka lindur në Francë në vazhdën e luftës për ta bërë shefin e shtetit kreun e qeverisë, krahas të qenët kreu i shtetit. Në këtë mënyrë është synuar për të evituar dobësitë e sistemeve parlamentare të dy republikave të mëparshme franceze (1870-1940 & 1946-1958). Kjo situatë ka lindur në veçanti në kushtet shumë specifike franceze pas kompromet imit të qeverisjes parlamentare në kohën e Luftës së Dytë Botërore.

Në fq. 426, studenti dhe lexuesi do të gjejnë fusnotën 1331, që shoqëron tekstin e autorëve tanë që thonë, *inter alia*, se "parimi i ndarjes së pushteteve dhe pavarësia e pushtetit gjyqësor është mishëruar qysh në Kushtetutën e SHBA-së". Për këtë citojnë autorin **Sam J. Ervin Jr.** Ky autor, ndërkaq, në fq. 115, pasi jep një histori të gjatë të ndarjes së pushteteve dhe ndërtimit të gjyqësorit të pavarur, që nga Aristoteli, Roma, Mesjeta e deri te **John Locke**, **Baroni Montesquieu**, flet në detaje për sistemin amerikan të gjyqësisë dhe si ka lindur ai. Në këtë faqe, ky autor me plot të drejtë thekson se **Kushtetuta e SHBA**-së nuk ka ndarë pushtetet në mënyrë specifike, ashtu siç ka thënë **Montesquieu**, por ka krijuar atë që në popull cilësohet si **sistemi i kontrollit dhe i balancimit**. Ky term, në fakt, shërben si substitut për atë që autorët tanë mendojnë në mënyrë të gabuar se gjendet e shkruar në **Kushtetutën e SHBA**-së, gjë që e bën sistemin amerikan jashtëzakonisht të veçantë dhe unik sa i përket realizimit të parimit të ndarjes së pushteteve. Kjo nënkupton se në **SHBA** nuk ka një kontrollues dhe balancues të jashtëm jashtë sistemit të tri pushteteve të ndara, por sistemi i kontrollit dhe i balancimit (***checks and balances***) është i integruar në vetë sistemin kushtetues amerikan: ta zëmë, autorizimi për emërim i takon ekzekutivit mirëpo ushtrohet me pëlqim dhe këshillim të Senatit, kurse ***impeachement***, një funksion thellësisht gjyqësor i është dhënë Kongresit. Në këtë shkrim, tutje, autori shpjegon se tradita koloniale britanike ka qenë në themel të ndërtimit të pavarësisë së gjyqësorit, ashtu siç duket sot në seksionin 1 të nenit III të Kushtetutës ë SHBA-së dhe në shtjellimet e **Alexander Hamilton**-it në ***Letrën e Federalistit*** **nr. 47**. Nga kjo shihet se autorët tanë i kanë tërësisht të ngatërruar konceptet bazike të së drejtës kushtetuese lidhur me mekanikën dhe dinamikën e rea-

lizmit të parimit kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe formave të manifestimit të tij në dy anët e Atlantikut.

Lidhur me pavarësinë e gjyqësorit, autorët tanë thonë se përbën një koncept teorik dhe mbetet një debat i hapur se si kjo pavarësi realizohet në praktikë. Për këtë konstatim absurd, ata manipulojnë artikullin e shkelqyer të autorit **Stephen B. Burbank**. E kemi fjalën për fusnotën nr. **1334**. Ky autor, ndërkaq, në këtë shkrim të jashtëzakonshëm flet për pavarësinë e gjyqësorit amerikan duke konstatuar se ky gjyqësor identifikohet me **Gjykatën Supreme Amerikane**, duke neglizhuar sistemin gjyqësor në nivel shtetesh dhe në nivel federal (gjykatat federale në nivel fakti dhe apeli). Ky autor fare nuk mohon vlerën normative dhe instrumentale të pavarësisë së gjyqësor dhe e shpreh përmes konceptit se pavarësia dhe përgjegjësia e kësaj dege të pushtetit nuk është qëllim në vete por një mjet për arritjen e një qëllim të caktuar. Ai qëllim është mbrojtja e lirisë dhe të drejtave të individit dhe të vetë formës së qeverisjes. Krahas kësaj, autori thekson se pavarësia gjyqësor nuk është një koncept apo teori monolite por diverse dhe përfshinë tërë sistemin gjyqësor amerikan, jo vetëm Gjykatën Supreme. Në tërësi, ky shkrim asnjëherë nuk len hapësirë për të teorizuar lidhur me pavarësinë e gjyqësorit në kuptimin që thonë autorët tanë, pra si një sistem i mbyllur filozofik dhe si një koncept teorik pa kontekst praktik, instrumental dhe normativ.

Në fusnotat nr. **1372** & **1373**, autorët manipulojnë dy mendimet të **Komisionit të Venecias**: njëri ka të bëjë me ndryshimet kushtetuese në **Ukrainë** dhe tjetri në IRJ të **Maqedonisë**. Dy këto dokumente shumë më rëndësi dhe udhëzuese të Komisionit të Venecias e thonë të kundërtën e asaj që thonë autorët tanë: në këto dokumente shtetet udhëzohen të ikin sa më shumë nga emërimi i gjyqtarëve të përkohshëm apo të gjyqtarëve me punë provuese sepse një gjë e tillë komprometon pavarësinë e tyre dhe cenon nenin 6.1 të **KEDNJ**-së. Në fakt, Komisioni ka ofruar edhe shembuj konkret nga praktika gjyqësore e Skocisë kur ka ardhur deri të cenimi i pavarësisë së gjyqësorit. Për të evituar këtë, Komisioni udhëzon në dy raste që sa më shkurt të jetë puna provuese apo caktimi i gjyqtarëve të përkohshëm dhe kriteret për emërim dhe largim të tyre të jenë krejtësisht të njëjta me ato që vlejnë për gjyqtarët e përhershëm. Në fund, Komisioni rekomandon që sa më rrallë të përdoret instituti i caktimit të gjyqtarëve të përkohshëm apo të gjyqtarëve me punë provuese. Sikundër shihet, kjo në tërësi është e kundërt me atë që thonë autorët tanë dhe përbën manipulim të literaturës.

Të shohim tani përmbajtjen e tekstit që kanë prodhuar autorët tanë mbi bazën e kësaj literature dhe interpretimeve të tjera të bëra nga ana e tyre të teksteve ekzistuese kushtetues e ligjore dhe të teksteve të tjera.

Analiza kritike

Në seksionin e parë, "Parimet e përgjithshme" (fq. 411-412), studenti dhe lexuesi do të gjejnë disa paragrafë kaotikë dhe eklektikë që dëshmojnë për mungesën e njohjes nga ana e autorëve tanë të parimit themelor përcaktues të një sistemi qeverisës. Se kjo është kështu shihet qartë se për rastin e Japonisë thonë "e ashtuquajtura Qeveri e cila funksionon sipas rregullave parlamentare", duke dëshmuar kështu se nuk e kanë të artë që një sistem parlamentar i qeverisjes mund të ekzistojë si në republikë ashtu dhe në monarki. Sipas autorëve tanë, përcaktues i formës së qeverisjes është "përbërja, mënyra e themelimit përgjegjësitë dhe roli i Qeverisë", në ndërkohë që marrëdhënia mes degëve të pushtetit, jo vetëm kjo që thonë për qeverinë janë përcaktues të formës së qeverisjes.

Lidhur me kompetencat e Qeverisë së Republikës së Kosovës (fq. 412-415), autorët tanë theksojnë se kompetenca për zhvillimin ekonomik të vendit

> është më shumë një vizion i secilës Qeveri sesa një obligim kushtetues i domosdoshëm andaj operacionalizimi dhe zbatimi në praktikë i kësaj kompetence varët shumë edhe nga programi i partive politike të cilat qeverisin me vendin, si dhe me mënyrën se si ky program i tyre zbatohet në praktikë, pra, kjo varet shumë dhe nga orientimet partiake dhe mënyra se si programi ekonomik i tyre inkorporohet në qeverisjes.

Nga ky redaktim i kësaj fjalie, qartë shihet se fjala është për qasje tërësisht politike, që nuk ka asnjë premisë juridiko-kushtetuese. Përdorimi i literaturës në mbështetje të kësaj teze, sikundër e kemi parë më sipër, në tërësi është manipulim. Si mund të jetë vizion një urdhër konkret, apo një autorizim që përmbahet në një normë kushtetuese?! Si mund t'u thuhet studentit dhe lexuesit se kompetenca taksativisht e numëruar në listën e kompetencave të ekzekutivit kosovar paraqet një synim të dëshiruar, jo një detyrim kushtetues të shkruar në bardhezi?! Nejse! Ky seksion mbyllet, pas një ekskursioni kaotik lidhur me kompetencat e Qeverisë, me çështjen e imunitetit ku në fusnotën nr. 1292 e recitojnë për të dhjetën herë të njëjtin rast, të plotë dhe jashtë çdo konteksti.

Në seksionin që bën fjalë për kompetencat e Kryeministrit (fq. 415-416), autorët mendojnë se kompetenca e kryeministrit për të shkarkuar ministrat e tij në mënyrë të pavarur paraqet një cilësi që e dallon Kosovën nga modelet tipike parlamentare, në ndërkohë që dihet shumë mirë se neni 97.1 i Kushtetutës në mënyrë të qartë përcakton se "Qeveria, për punën e vet i përgjigjet Kuvendit" dhe kjo është përcaktues, jo kompetencat e shefit të qeverisë.

Seksioni në vijim, që flet për zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës dhe krizën që ka prodhuar neni 95 i Kushtetutës (fq. 416-420) përmban konstatime konspirative dhe jo të sakta në aspektin profesional: në fq. 417, autorët tanë flasin për situatën e njohur si ngërçi politik (verë 2014) dhe thonë se "situata e krijuar determinoi edhe aktivizimin e ekspertëve juridik dhe juristëve të ndryshëm të cilët kishin interpretime të atilla që mbështetnin të dyja blloqet politike". Ky konstatim nuk është relevant dhe nuk i takon një libri të së drejtës kushtetuese. Nëse veç kanë vendosur të fusnin gjëra të tillë në libër, autorët duhet të citojnë mendimet pro dhe kundër, argumentet e sakta të secilës palë, me emër dhe mbiemër, jo si në fusnotën nr. **1297,** ku jepen të dhënat e një makine hulumtuese së cilës mund t'i ndërrohet lokacioni në internet në çdo moment (sic!). Kjo nuk është shumë e dëmshme, nëse krahasohet me konstatimin e pasaktë të autorëve tanë se: "Sipas Gjykatës Kushtetuese, është tërësisht në diskrecionin e Presidentit se cilës parti ose cilit koalicion dëshiron të ia jap të drejtën për ta formuar Qeverinë në raundin e dytë [...]". Jo vetëm kaq! Në po të njëjtën faqe, fq. 418 (sipër), autorët thonë se Gjykata Kushtuese ka thënë se "Presidenti i Kosovës duhet t'ia jap mandatarin partisë ose koalicionit parazgjedhor që ka fituar shumicën relative ose absolute në Kuvendin e Kosovës". Sipas autorëve, këtë duhet ta bëjë sepse, "Presidenti duhet të ketë parasysh që të përfaqësoj unitetin e popullit dhe që qeverinë ta krijojë në përputhje me vullnetin e votuesve (sovranit)". Këtu me këtë rast, autorët tanë e kanë fjalën për Aktgjykimin e Gjykatës në rastin **KO 103/14**. As njëra e as tjetra nuk janë ashtu siç thonë autorët tanë: këtë mendim, studenti lexuesi ka mundur ta dëgjojë në diskursin laik kosovar, asnjëherë nga goja dhe verdikti i Gjykatës Kushtuese. Nuk ka diskrecion të tërësishëm Presidenti herën e dytë, sepse duhet t'i respektojë kriteret mbizotëruese për formimin e qeverisë, ndër të cilat është fuqia e votës së dalë nga dora e sovranit në zgjedhjet e fundit nacionale. Në këtë rast, Presidenti nuk vepron si përfaqësues i unitetit të popullit por si ruajtës i institucioneve të vendit dhe i stabilitetit të tyre, funksion që kemi sqaruar në kapitullin paraprak se

çfarë nënkupton dhe si ka lindur. Presidenti kështu vepron edhe në herën e dytë kur duhet ta ricaktojë mandatarin e ri, pas dështimit të parë: i vetmi dallim është që herën e dytë nuk guxon t'ia japë mandatin personit të njëjtë. Kështu, në fakt, ka thënë neni 95.4 i Kushtetutës, duke ndjekur procedurën e njëjtë. Gjykata nuk ka krijuar normë të tillë të çuditshme, siç e thonë autorët tanë, por ka interpretuar normën e nenit si më sipër të Kushtetutës së Kosovës. Sikur të kishte të drejtën Presidenti që të vendos vetë se kujt duhet t'ia japë mandatarin, atëherë do të ishte përfaqësues i unitetit socio-politik të popullit, gjë që nuk është e as nuk mund të jetë. Si përfaqësues i unitetit të popullit ai vepron atëherë kur përfaqëson Kosovën brenda dhe jashtë, gjë që në rastin konkret nuk mund të jetë sepse fjala është për formim të institucioneve dhe ky funksion i takon Presidentit përmes kompetencës së tij që burojnë nga vetë natyra e ruajtësit të institucioneve nacionale, i stabilitetit dhe i funksionimit të tyre normal.

Në fq. 422, ku flasin për përgjegjësinë e Qeverisë, autorët tanë demantojnë atë që vetë e kanë thënë në fq. 415, siç e përshkruam më sipër: këtu thonë, më plot të drejtë, se marrëdhëniet e ekzekutivit me parlamentin janë përcaktuese të formës së qeverisjes, jo siç konstatojnë me sipër në fq. 415. Në mënyrë të njëjtë, në fq. 423 demantojnë vetveten dhe atë që kanë thënë në fusnotën nr. 1272: këtu theksojnë, me plot të drejtë, se të gjitha mjetet e kontrollit parlamentar, përveç institutit të votëbesimit të Qeverisë janë të përcaktuara me rregullore të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kapitullin e shtatë, autorët tanë e nisin me konstatime absurde: në seksionin e parë, "Parimet e përgjithshme kushtetuese" (fq. 427-428), autorët tanë konstatojnë se Kushtetuta e Kosovës në kapitullin e shtatë bën fjalë për pushtetin e tretë kushtetues duke e cilësuar atë si "sistemi i drejtësisë". Donë të thotë, autorët nuk e kanë të qartë se kuptimi "sistemi i drejtësisë" është shumë më i gjerë se pushteti i tretë apo pushteti gjyqësor (sic!). Në po këtë seksion, pavarësinë e gjyqësorit e cilësojnë si një koncept teorik, gjë që nënkupton se studenti e lexuesi mund të teorizojnë tërë kohën lidhur me këtë dhe janë të lirë të besojnë dhe mendojnë çfarë të duan. Kjo, nënkuptohet, përbën një gabim trashanik dhe mendim të pasaktë: pavarësia e gjyqësorit paraqet një kategori që sanksionohet dhe garantohet me kushtetutë nacionale në të gjitha vendet e ish-Lindjes komuniste, përfshirë këtu diktaturat si Bjellorusia apo vetë Rusinë e Putinit.

Në seksionin "Organizimi dhe juridiksioni i Gjykatave në Republikën e Kosovës" (fq. 429-431), i cili në fakt paraqet ripërshkrim të dispozitave kushtetuese e ligjore, autorët tanë nuk u tregojnë studentit e lexuesit që në

Kosovë ekziston një gjykatë speciale, si pjesë e sistemit gjyqësor kosovar dhe si koncesion i bërë komunitetit serb. Kjo gjykata ka dalë si rezultat e votës së sovranit të Kosovës dhe ka për kompetencë materiale gjykimin e rasteve të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare humanitare. Përveç kësaj, kjo gjykatë është kompetente për vendosjen lidhur me çështjet kushtetuese që dalin nga gjykimi i rasteve të krimeve si më sipër. Gjykata ka selinë në **Hagë** dhe në tërësi funksionon sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës. Për lexuesin tonë duhet të themi pak fjalë rreth historisë së formimit të saj dhe infrastrukturës juridike mbi të cilën qëndron kjo gjykatë.

Në ndërkohë që në shtator të vitit 2012 Kosova po përgatitej për heqjen qafe të kufizimeve të vetimponuara në ushtrimin e kompetencave të një shteti sovran dhe të pavarur, në publik doli një akuzë e rëndë nga një ish-prokurori zviceran, i njohur si raporti **Dick Marty**. Ky raport u miratua nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (**AP** e **KE**-së). Bazuar në autorizimet kushtetuese, organi përfaqësues i sovranit të Kosovës, Kuvendi, mori përsipër zotimin për ta vënë në jetë këtë raport dhe për të nisur hetimet speciale për konstatimin e vërtetësisë së akuzave të bëra nga **Dick Marty** lidhur me krimet e kryera në **Kosovës** gjatë luftës dhe në vitin e parë pas mbarimit të saj. Organet e tjera, presidenti dhe qeveria, ndoqën këtë zotim të Kuvendit. Krimet për të cilat u bën hetimet dhe u themelua **Gjykata Speciale** janë në rend të parë krimeve të luftës, krimet kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare por edhe krime të tjera që nuk kanë këtë natyrë e që janë të ndëshkueshme sipas legjislacionit penal të **Kosovës** në fuqi pas luftës deri në mbarim të vitit 2000. Ky zotim, krahas zotimit të marrë njëanshëm nga **Kosova** me rastin e shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, siç është reflektuar në përmbajtjen e **Deklaratës së Pavarësisë**, përbën një detyrim shtesë ndërkombëtar për vendin. Në vijim të zbatimit të këtij detyrimi ndërkombëtar, këtë herë të marrë me vullnet të shprehur në planin bilateral, **Kosova** hyri në disa marrëveshje ndërkombëtare dhe nxori një ligj për vënien në jetë të zotimit për themelimin e **Gjykatës Speciale**. Kjo bëri që të kufizohet në mënyrë të dukshme juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese: në këtë gjykatë kaluan të gjitha kompetencat juridiksionale nga neni 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës e që kanë të bëjnë me krimet e supozuara të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe pas saj deri në fund të vitit 2000.

Të shohim këtu më konkretisht si duket kjo bartje e juridiksionit të **Gjykatës Kushtetuese** në **Gjykatën Speciale**.

Në dokumentin e miratuar më 7 janar 2011 (Cf. "Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo", Report, Doc. 12462, 7 January 2011), **AP** e **KE**-së theksonte krimet që ishin kryer në Kosovë gjatë luftës dhe menjëherë pas saj, duke kërkuar nga autoritetet kosovare dhe **EULEX**-i që të ndihmonin dhe bashkëpunonin në hetimin e pohimeve të senatorit zviceran dhe ish-prokurorit **Dick Martyt**. Këto hetime duheshin kryer nga një prokuror i pavarur për të vërtetuar pohimet e tij nëse në **Kosovë** ishin kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare si dhe krime të tjera të rënda pas hyrjes së trupave të **NATO**-s në qershor të vitit 1999. Për këtë qëllim u urdhërua krijimi i një **Task-Force për Hetime Speciale** brenda misionit **EULEX**, por në tërësi e pavarur nga ky mision. Detyrimet e **Kosovës** nga ky raport i **AP** të **KE** u pranuan me një vendim të përfaqësuesit të sovranit kosovar, **Kuvendit të Kosovës**, që ratifikonte marrëveshjen ndërkombëtare mes **Kosovës** dhe **BE**-së për vazhdimin e mandatit të misionit **EULEX** në **Kosovë**, në kuadër të të cilit gjendej edhe **Task-Forca** (Ligji nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 32/14). Ky ligj përmban zotimin e Republikës së Kosovës për krijimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës që do të përdoren për procedurat gjyqësore dhe të apelit që dalin nga hetimi i **Task-Forcës për Hetime Speciale të Republikës së Kosovës** në lidhje me dokumentin 12462 më të cilin **AP** të **KE** më datën 7 janar 2011 ka miratuar raportin Dick Marty. Këto dhoma, sipas këtij ligji, do të mund të zhvendosen në një shtet të tretë). Në kuadër të këtij zotimi ndërkombëtar ka qenë edhe amendamentimi i Kushtetutës, me qëllim që të lejohet themelimi i **Gjykatës Speciale** për trajtimin dhe gjykimin e kryesve eventualë të veprave penale si më sipër, në të gjitha shkallët e gjyqësorit të rregullt. Në këtë kuadër parashikohej edhe themelimi i një **Dhome të Specializuar Kushtetuese**. Ky amendament njihet me emrin **amendamenti kushtetues nr. 24**, tani neni 162 i Kushtetutës dhe është miratuar me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 05-V-139 të datës 3 gusht 2015. Ky amendament, si çdo amendament tjetër kushtetues, paraqet ushtrim të **pushtetit konstituiv derivativ** (***pouvoir constituant dérivé***) të përfaqësuesit të sovranit të Kosovës. Amendamenti në tërësi është përpiluar nga akterët ndërkombëtar dhe paraqet ushtrim të përbashkët të pushtetit konstituiv, sic e kemi

shpjeguar më herët (Cf. Po ashtu Fisnik Korenica, Argjend Zhubi & Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it?", *European Constitutional Law Review*, vol. 12, issue 3, December 2016, fq. 474–498, në fq. 479). Kjo nënkupton se akterët ndërkombëtarë janë hisedarë në këtë ushtrim të pushteti konstituiv të kosovarëve. Në literaturë, siç e kemi konstatuar më herët, këto quhen kushtetuta të ndërkombëtarizuara. Si të tilla, ato imponojnë kufizime në nivel nacional, përligjësojnë një pabarazi të vendorëve kundrejt faktorit ndërkombëtar për një periudhë të caktuar dhe lidhur me çështje të caktuara (Cf. Emily Hay, "International(ized) Constitutions and Peacebuilding", *Leiden Journal of International Law*, vol. 27, issue 01, March 2014, fq. 141-168 në fq. 147).

Amendamenti si më sipër ka gjithsej 14 paragrafë. Në paragrafin e parë përcaktohet, *inter alia*, se:

> organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i **Dhomave të Specializuara** dhe **i Zyrës së Prokurorit të Specializuar** rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë.

Fizionomia e **Dhomës së Specializuar Kushtetuese**, ndërkaq, rregullohet me paragrafin e tretë të amendamentit. Në këtë paragraf dalin në syprinë dy aspekte: së pari, aty thuhet se kjo dhomë do të përbëhet nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë, të cilët do të jenë të ndryshëm nga ata që janë emëruar sipas nenit 114.1 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës; dhe, së dyti, ajo dhomë do të vendosë ekskluzivisht mbi referimet kushtetuese sipas nenit 113 të Kushtetutës në lidhje me **Dhomat e Specializuara** dhe me **Zyrën e Prokurorit të Specializuar** në përputhje me ligjin e veçantë. Me ligj të veçantë nënkuptohet **Ligjit nr. 05/L-053** (Cf. **Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar**, datë 3 gusht 2015, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, nr. 20, 5 gusht 2015). Kur flitet për referimet nga neni 113, ndërkaq, mendohet për palët e autorizuara sipas atij neni. Teorikisht, si të tilla mund të paraqiten të gjitha që janë të numëruara aty në atë nen, por praktikisht ekziston vetëm një palë e autorizuar që në mënyrë shprehimore **amendamenti nr. 24** shpreh interes për ta normuar.

Në këtë amendament në mënyrë shprehimore vetëm një palë të autorizuar. Në fjalinë e fundit në paragrafin 11 thuhet se "**Ombudspersoni i Kosovës** mund të referojë çështje në përputhje me nenin 135 (4)". Fjala është për nenin 135.4 ["Raportimi i Avokatit të Popullit"] të Kushtetutës,

që thotë: "Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute." Këtu shtrohet pyetja themelore se për cilin ombudsperson është fjala: për këtë që zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës sipas nenit 134.1 ["Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit"] të Kushtetutës apo për atë tjetrin ombudsperson që themelohet sipas nenit 34.9 ["Zyra Administrative"] të **Ligjit nr. 05/L-053** si më sipër? Këtë dilemë e largon vetë ligji në fjalë që përcakton deri në detaje: përveç nenit 34.9 si më sipër, edhe neni 49 pikat 1, 2 dhe 5 ["Peticioni në Gjykatën Kushtetuese"] përcakton se kush mund të jenë palë të autorizuara në procedurën pranë saj. Para se të shohim si duken formulimet e këtyre dy neneve, duhet thënë edhe disa fjalë rreth ombudspersonit të ri si më sipër. Sikundër shihet, **Ligjit nr. 05/L-053** përdor termin "Gjykatë Kushtetuese". Ky emërtim shfaqet edhe në versionin anglisht të këtij ligji. Kjo bëhet për të treguar se çdo çështje kushtetuese që ka të bëjë me **Gjykatën Speciale**, edhe sikur rastësisht në mënyrë të gabuar të jetë paraqitur në Kosovë, në **Gjykatën Kushtuese të Republikës së Kosovës**, lidhur me te kompetente do të jetë **Dhoma e Specializuar Kushtetuese**. Kjo nënkupton se në Kosovë efektivisht ka dy gjykata kushtetuese, sikundër që ka edhe dy gjykata penale të të gjitha shkallëve dhe një prokuror shtetëror të të gjitha niveleve. U mor vesh, fjala është gjithnjë për rastet që bien në kuadër të kompetencës lëndore që ka të bëjë me **Gjykatën Speciale**. T'u kthehemi tani formulimeve të dy neneve si më sipër, përkatësisht të formulimeve të nenit 34.9 dhe nenit 49 pikat 1, 2 dhe 5 të **Ligjit nr. 05/L-053.**

Neni 34.9 i **Ligjit nr. 05/L-053** përcakton:

> 9. Zyra Administrative përmban brenda vetes **Zyrën e Ombudspersonit**, e cila e kryen detyrën e **Ombudspersonit e Dhomave të Specializuara** me përgjegjësi ekskluzive për **Dhomat e Specializuara** dhe **Zyrën e Prokurorit të Specializuar** sipas Amendamentit nr 24 të Kushtetutës. Ligji për Ombudspersonin, Ligji nr. 03/L-195, nuk zbatohet për punën e **Dhomave të Specializuara** dhe **Zyrën e Prokurorit të Specializuar**. Ombudspersoni do të emërohet nga **Autoriteti Emërues** pas shqyrtimit të aplikantëve të kualifikuar. Ombudspersoni ka karakter të lartë moral dhe është kompetent në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Roli dhe funksioni i **Ombudspersonit të Dhomave të Specializuara** rregullohet në Rregullat e Procedurës dhe Provave. **Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara** mund t'i jap rekomandime Kryetarit të **Dhomave të Specializuara** ose **Zyrës së Prokurorit të Specializuar** sipas nenit 135(3) të Kushtetutës dhe

mund të bëjë referime për tek Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113(2) dhe 135(4) të Kushtetutës dhe nenin 49 të këtij ligji.

Neni 49 pikat 1, 2 dhe 5 **Ligjit nr. 05/L-053** thotë:

1. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me juridiksionin lëndor dhe punën e **Dhomave të Specializuara** dhe **Zyrës së Prokurorit të Specializuar**.

2. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ka juridiksion mbi çdo referim tek Gjykata Kushtetuese të bërë nga personat e autorizuar për të bërë referime në bazë të nenit 113 të Kushtetutës që ndërlidhen me, apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi, punën, vendimet, urdhrat apo aktgjykimet e **Dhomave të Specializuara** apo me punën e **Zyrës së Prokurorit të Specializuar.**

[…]

5. Në pajtim me **Amendamentin nr. 24** dhe nenin 135(4) të Kushtetutës, **Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara** i caktuar sipas nenit 34(9) të këtij ligji, si dhe Ombudspersoni i Republikës së Kosovës, mund t'i referohen sipas nenit 113(2) **Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese** […].

Nga këto dispozita shumë qartë shihet se fjala është për një ombudsperson paralel me seli në **Hagë**, që është themeluar sipas **amendamentit kushtetues nr. 24**. **Ligji nr. 05/L-053** nuk bën asgjë veçse, përmes dy neneve të sipërcekura, operacionalizon rolin dhe funksionin e këtij institucioni paralel në kuadër të sistemit kushtetues kosovar. Kjo më tutje nënkupton se këtu nuk është fjala për **Avokatin e Popullit** që ka selinë në **Prishtinë** dhe që funksion sipas autorizimeve nga nenet 132-135 të Kushtetutës së vitit 2008. Kjo është kështu për faktin se **amendamenti kushtetues nr. 24** rezervon një rol të privilegjuar dhe një fizionomi tjetërfare për **Ombudspersonin e Dhomave të Specializuara**. Avokatit të Popullit me seli në Prishtinë nuk ia prek të drejtën për t'u paraqitur si palë në procedurë pranë **Gjykatës Speciale** për çështjet nga neni 113.2 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës, gjithnjë me kusht që fjala është për çështjet që kanë të bëjnë me juridiksionin lëndor dhe punën e **Gjykatës Speciale.** Me këtë qasje të **amendamentit kushtetues nr. 24** dhe të **Ligji nr. 05/L-053**, Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara fiton një pozitë të privilegjuar kundrejt Avokatit të Popullit me seli në Prishtinë sepse mban monopolin e palës së autorizuar për çdo referim kushtetues që ka të bëjë me juridiksionin lëndor dhe punën e **Gjykatës Speciale** e që mund të sub-

sumohet (nënvihet) nën nenin 113.2 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] lidhur me nenin 135.4 ["Raportimi i Avokatit të Popullit"] të Kushtetutës.

Afatet për ushtrimin e këtij autorizimi janë të njëjta sepse për këtë vlen në tërësi **Ligji nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**. Ky ligj vlen vetëm sa u përket procedurave nga paragrafi i parë i nenit 113.2 të Kushtetutës së vitit 2008 meqenëse vështirë se mund të krijohet ndonjë situatë në të cilën një statut i një komune kosovare do të kishte për objekt normimin e çështjeve që bien në kompetencën lëndore dhe apo që lidhen me punën e **Gjykatës Speciale**. Janë nenet 29 dhe 30 të **Ligjit nr. 03/L-121** me të cilat rregullohen procedurat e veçanta lidhur me nenit 113.2 të Kushtetutës, sqarohen veprimet, procedurat dhe efektet e tyre. Sipas këtyre neneve, kërkesa për kushtetutshmërinë e ligjeve, dekreteve të Presidentit dhe të Kryeministrit, si dhe të rregulloreve të Qeverisë mund të paraqitet brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtyre akteve juridike. Kontestimi i kushtetutshmërisë së tyre mund të jetë i tërësishëm apo i pjesshëm, ndërsa efektet e vendimeve të **Dhomës së Specializuar Kushtetuese** është i njëjtë me çdo vendim tjetër të **Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**.

Sikundër u tha me sipër dhe siç shihet nga dispozitat që sapo u komentuan, palët tjera të autorizuara nga neni 113 i Kushtetutës ngelin të njëjta. Kjo do të thotë se ajo që vlen për juridiksionin aktual të Gjykatës Kushtetuese nga neni 113 I Kushtetutës vlen, ***mutatis mutandis***, edhe për palët e tjera të autorizuara dhe procedurat që mund të iniciohen nga to sipas këtij neni, gjithnjë me supozim se fjala është për çështje që bien në kompetencën lëndore apo kanë të bëjnë me punën e **Gjykatës Speciale**.

Të seksioni mbi emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve (fq. 431-434), autorët tanë theksojnë se kjo përbën një kompetencë të Presidentit "që lidhet drejtpërdrejtë me administrimin e drejtësisë", një interpretim ky tërësisht i gabuar. Kjo kompetencë e Presidentit të Kosovës nuk asgjë tjetër veçse pjesë e pushteteve neutrale dhe të ndërmjetme që i ka në dorë me qëllim të balancimit të tri pushteteve të tjera. Në këtë rast bëhet fjalë për balancimin e gjyqësori, ku Këshilli Gjyqësor, si një mekanizëm që ka përgjegjësitë kryesore në udhëheqjen me gjyqësorin, bën propozimet e tij për emërim të gjyqtarëve të cilin më pastaj Presidenti vetëm e animon një propozim të tillë. Presidenti ka të drejtë vetëm njëherë të kthejë prapa propozimin e Këshillit Gjyqësor, që do të thotë se herën tjetër detyrohet ta animojë propozimin e dërguar nga Këshilli. Kjo është kështu sepse fjala

është për pushtet pasiv të Presidentit, siç e kemi sqaruar gjerësisht në komentet tona me kapitullin për Presidentin e Kosovës. Një rast i tillë ka ndodhur me një gjyqtar, kur ishte refuzuar për dekretim nga ish-Presidentja Jahjaga sepse kishte qenë i involvuar në rastin e **Diana Kastratit** të ndjerë. Herën e dytë, Presidenti të njëjtin gjyqtar u detyrua ta dekretonte. Kjo domethënë se autorët tanë e kanë shumë gabim kur konstatojnë në fq. 433 se nuk ka pasur asnjë rast në praktikën e deritanishme kushtetuese që Presidenti të ketë kthyer prapa një propozim të Këshillit për emërim të gjyqtarëve. E njëjta gjë, ***mutatis mutandis***, vlen edhe për sistemin prokurorial të Kosovës dhe rolin e Presidentit të Kosovës në emërimin dhe shkarkimin e prokurorëve të Kosovës. Krijimi i këshillave gjyqësore dhe prokuroriale, në thelb, përbën një mekanizëm shtesë për neutralizimin e pushtetit dhe është krijuar dhe po zbatohet në masë të madhe pas rënies së komunizmit dhe përbën një institucion që fuqishëm rekomandohet nga ana e **Komisionit të Venecias** për demokracitë e reja kushtetuese.

KAPITULLI VII. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (FQ. 455–484)

Përgjithësisht

Ky kapitull përbëhet prej 17 seksioneve. Cilësitë kryesore të këtij kapitulli janë si vijon:

- e para, përshkrimi dhe përfolja e teksteve kushtetuese dhe ligjore pa asnjë analizë kritike dhe përmbajtjesore që do ta bënte tekstin e prodhuar më dinamik dhe më krahasues për lexuesin;
- e dyta, si pasojë e qasjes së tillë dogmatike, lexuesi e ka problem për të kuptuar institutet themelore të institucionit të gjyqësisë kushtetuese kosovare, siç janë kontrolli incidental, kontrolli konkret, kontrolli i konvencionalitetit dhe institutet e tjera të ngjashme; mbi të gjitha lexuesi e ka vështirë të kuptojë se cili është instrumenti kryesor me të cilin vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese si pasojë e faktit se autorët tanë përdorin koncepte dhe fjalë që nuk gjenden në tekstin kushtetues, ligjor apo në rregullativën e brendshme të Gjykatës Kushtetuese: këtu e kemi fjalën për të a.q. **padinë kushtetuese**, **kon-**

testin kushtetues dhe koncepte e gjëra të ngjashme, të cilat i diskutojmë në vijim; dhe, së fundi,

- e treta, literaturë e huaj e përdorur, në aspektin nominal është vetëm një në fusnotën nr. **1456** dhe, si e tillë, është e manipuluar; në internet nuk gjendet një burim i tillë, por me tituj të ngjashëm me të: e kemi fjalën për botimin e autorit **Herbert Hausmaninger**, me titull ***The Austrian Legal System*** (4th ed., Manzsche Verlags und Universitätsbuchhandlung: Wien, 2011). Kjo këtu nuk ka rëndësi: ajo që ka rëndësi është se teksti që shoqëron fusnotën nr. **1456** të autorëve tanë fare nuk mund të provohet me asnjë burim sepse në Austri Presidenti nuk ka rol vendimtar në caktimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Austrisë; ky vend ka një sistem të përzier të caktimit të gjyqtarëve kushtetues, të cilin e sqarojmë në vijim.

Analiza kritike

Në seksionin e parë, "Rreth historikut të Gjykatës Kushtetuese në Kosovë" (fq. 455-456), autorët flasin për rrënimin antikushtetues të autonomisë së Kosovës, pastaj për Kornizën Kushtetuese dhe gjoja përpjekjet për themelim të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në kohën e UNMIK-ut. Harrojnë se në Marrëveshjen e Rambujesë ka pasur një tekst që ka folur gjerësisht për themelimin e një gjykate kushtetuese kosovare, të veçantë dhe me prerogativë specifike dhe të çuditshme. Më pas, pas cituar asnjë burim, autorët tanë tregojnë për një refuzim të UNMIK-ut për të krijuar një gjykatë kushtetuese me arsyetimin, gjithnjë të thënë nga autorët tanë, se një institucion i tillë "reflekton një atribut të shtetësisë" që do të prejudikonte statusin përfundimtar të Kosovës. Këtu ka disa dilema dhe dyshime: e para, pak ka gjasa të ketë qenë ky argumenti i UNMIK-ut kur dihet se aty ka pasur dhe ka një staf të fortë të juristëve që e dinë fare mirë se themelimi i një gjykate kushtetues përbën çështje parimi dhe nuk ka të bëjë me statusin përfundimtar. Kjo është kështu sepse administrimi ndërkombëtar, ***per definitionem***, bazohet në një mandat të një organi politik të OKB-së, që quhet Këshilli i Sigurimit, ashtu që për nga natyra është i papajtueshëm çdo kontroll i kushtetutshmërisë së veprimeve të tij. I vetmi organ që mund të kontrollojë punën e tij, dhe atë përmes procedurës së dhënies së mendimeve këshillëdhënëse është GJND dhe askush tjetër; dhe, e dyta, pasja e një gjykate kushtetuese jo domosdo ka të bëjë me të qenët shtet: Kosova ka pasur një gjykatë kushtetuese, siç e thonë vetë autorët, në ko-

hën e komunizmit dhe nuk ka qenë shtet. Ka edhe **Bavaria** në Gjermani dhe nuk është shtet.

Dy seksioneve në vijim (fq. 456-460) nuk mund t'u bëhet ndonjë vërejtje serioze meqenëse kryesisht paraqesin riprodhim të teksteve kushtetuese e ligjore lidhur me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe institucionin e kontrollit abstrakt. Vërejtje të pashmangshme, dhe atë të natyrës serioze, nxiten nga leximi i seksionit me titull "Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare" (fq. 460-461). Ky seksion paraqet dështim total të autorëve tanë, mashtrim të studentit dhe lexuesit të librit të tyre. Në Kushtetutën e Kosovës nuk ekziston institucioni i kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare. Në paragrafët e parë, autorët tanë ripërsërisin në mënyrë nebuloze konstatimet e mëhershme mbi statusin e privilegjuar të së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut në sistemin kushtetues kosovar, për marrëdhënien miqësore të së drejtës kushtetuese kosovare ndaj të drejtës ndërkombëtare dhe kështu me radhë. Asnjëra nga këto nuk hyn në titullin e kësaj teme. Në asnjë mënyrë nuk përputhet ky diskutim me titullin e seksionit, të cilin vetë autorët e kanë vënë. Në fq. tjetër, autorët konstatojnë se në Kosovë nuk ka kontroll paraprak të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare sepse, gjithnjë sipas tyre, këtë standard e paska pas vënë Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj në rastin KO 95/13 (sic!). Se në Kosovë nuk ka fare kontroll kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare e ka thënë Kushtetuta e Kosovës: neni 113.3 (4) i Kushtetutës fare nuk ka të bëjë me atë që mendojnë autorët tanë por me kontrollin e konvencionalitetit të amendamenteve të propozuara kushtetuese. Instituti i **kontrollit të konvencionalitetit** paraqet një mekanizëm të veçantë të kontrollit të kushtetutshmërisë, i cili konsiston në vlerësimin nga gjykata nëse një normë apo akt i brendshëm juridik (normë ligjore, normë kushtetuese, normë tjetër e përgjithshme apo një akt juridik individual) bie ndesh me dispozitat e një marrëveshjeje apo detyrimi tjetër ndërkombëtar që ka natyrë kontraktuale. Ka disa kushtetuta që kanë këtë kompetencë, përfshirë Kosovën por vetëm sa i përket kontrollit të amendamenteve kushtetuese. Në këtë drejtim, dispozita e nenit 113.3 (4) të Kushtetutës është tepër e qartë kur përcakton si vijon:

> 3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:
> […]
> (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj

> Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur.

Ky institut meriton një shtjellim pak më të gjerë për lexuesin tanë, gjë të cilën do ta bëjmë në vijim.

Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese nga nenet 112 dhe 113 i Kushtetutës së Kosovës reflekton veçoritë më të theksuara të dizajnit kushtetues **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese: brenda këtij juridiksioni kushtetues gjenden të gjitha llojet e juridiksionit klasik nga modeli **evropian/kelsenian.** Ekzistojnë, megjithatë, disa specifika jostandarde për gjyqësinë kushtetuese, siç janë ato që kanë të bëjnë me **kontrollin kushtetues të amendamenteve kushtetuese** dhe **kontrollin kushtetues të konvencionalitetit**, përkatësisht me kontrollin nëse ndonjë amendament kushtetues është në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare të Kosovës të marra përsipër në mënyrë kontraktuale (Cf. më shumë për analizën krahasuese të kontrollit të konvencionalitetit në **Igor Spirovski**, *The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with the International Treaties: New Trends in Constitutional Justice*, botuar nga European Commission for Democracy Through Law (**Venice Commission**) in co-operation with The Constitutional Court of Montenegro and the OSCE (Report), CDL-JU(2009)036, Engl. only, Strasbourg, 17 November 2009). Në kategorinë e detyrimeve kontraktuale të Kosovës hyjnë edhe ato detyrime që vendi i ka marrë njëanshëm, siç është zotimi ndërkombëtar i Kosovës për të zbatuar të drejtën ndërkombëtare, i marrë përmes **Deklaratës së Pavarësisë**, si dhe zotimi tjetër, po ashtu i njëanshëm, i cili figuron në nenin 22 ["Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"] të Kushtetutës së Kosovës. Ky nen numëron një nga një instrumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare që zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë. Këto detyrime dhe këto zotime ndërkombëtare, të cilat Gjykata Kushtetuese i merr si bazë të vendimmarrjes së saj meqë paraqesin burim të së drejtës kushtetuese kosovare, ekzistojnë krahas dhe paralel me detyrimet ndërkombëtare nga neni 19 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës, i cili normon zbatimin e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare në **Kosovë**. Dallimi mes detyrimeve kushtetuese nga neni 22 dhe atyre nga neni 19 i Kushtetutës konsiston në atë se të parat janë detyrime të pastra kushtetuese kurse të dytat janë detyrime ligjore, me fuqi juridike më të ulët se Kushtetuta e Kosovës. Mbi bazën e këtij zotimi bilateral nga neni 19 i Kushtetutës, të marrë nga

Kosova në mënyrë vullnetare, sot ekziston efektivisht një gjykatë e ndarë kushtetuese me seli në **Hagë**. E kemi fjalën për **Dhomën e Specializuar Kushtetuese**, e cila është themeluar në bazë të **amendamentit kushtetues nr. 24**, që sot është bërë neni 162 i Kushtetutës së vitit 2008. Ky amendament ka hyrë në fuqi më datën 3 gusht 2015, ditën e miratimit nga **Kuvendi i Kosovës**. Me të është parashikuar themelimi i asaj që sot njihet si **Gjykata Speciale e Kosovës**, e cila ngërthen tri lloje të gjykimit:

- gjykimi penal në të gjitha shkallët;
- zyra e prokurorit special pranë kësaj gjykate; dhe, së fundi,
- gjykimi për çështjet kushtetuese që kanë të bëjnë me punën e dhomave të kësaj gjykate.

Si një lloj i ndërmjetëm i juridiksionit ekziston ai që i takon institucionit të ombudspersonit, që është themeluar vetëm për mbrojtjen e lirive dhe të njeriut në procedurat pranë apo në lidhje me **Gjykatën Speciale të Kosovës**.

Pas këtij digresioni të shkurtër lidhur me Gjykatës Speciale si një detyrim kontraktual ndërkombëtar i marrë nga Kosova, sërish i kthehemi temës kyçe të diskutimit lidhur me konceptin e **kontrollit të konvencionalitetit**, të cilin autorët tanë fare nuk e kanë të qartë. Këtë që e diskutuam për Gjykatën Speciale, e bëmë me qëllim që t'i tregojmë lexuesit tonë se nuk mund të ketë një amendament tjetër kushtetues që shfuqizon këtë gjykatë: një amendament i tillë eventual do të vlerësohet nga Gjykata Kushtetues si jokushtetues sepse bien ndesh me detyrimet e marra ndërkombëtare të Kosovës mbi baza kontraktuale.

Juridiksion që ka të bëjë me **kontrollin e konvencionalitetit** rregullohet me pikën e katërt të paragrafit të tretë të nenit 113 të Kushtetutës së Kosovës. Kjo pikë si më sipër përcakton juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar përputhshmërinë e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara sipas Kushtetutës së Kosovës, si dhe rishikimin e procedurës së ndjekur. Ky kontroll, siç e përmendëm me sipër, njihet me emrin **kontrolli i konvencionalitetit** dhe është mjaft i përhapur në vendet e modelit **evropian/kelsenian**. Kjo dispozitë kushtetuese ndërton një detyrim pozitiv për Gjykatën Kushtetuese që të kontrollojë përputhshmërinë e amendamenteve kushtetuese me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare të lidhura nga ana e Kosovës. Në një interpretim teleologjik dhe në lidhmëni me dispozitat tjera kushtetuese i kësaj dispozite del se kjo imponon detyrimin që amendamentet kushtetuese nuk munden dhe nuk guxojnë të prishin detyrimet ndërkombëtare të

Kosovës të marra sipas të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, pra jo vetëm të detyrimeve kontraktuese. Kjo bëhet e qartë në nenin 19.1 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës ku përcaktohet se detyrimet e Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare (kontraktuese dhe jashtë kontraktuese) kanë përparësi ndaj ligjit nacional kosovar. Ky juridiksion i Gjykatës Kushtetuese është në përputhje me nenin 56 ["Dispozitat e së Drejtës së Brendshme lidhur me Kompetencën për të lidhur Marrëveshje"] të **KVDT**-së, i cili përcakton që shtetet nuk mund të shfrytëzojnë mjetet e brendshme juridike për t'i anuluar detyrimet e tyre ndërkombëtare (Cf. **Vienna Convention on the Law of Treaties**, 1155 *UNTS* 331, 8 *ILM* 679, në fuqi nga 1980, Art. 46). Kjo është në përputhje edhe me kërkesat e **Komisionit të Venecias** sa i përket mekanizmave të së drejtës së brendshme që duhen ndërtuar me qëllim të ndalimit të zhvlerësimit të detyrimeve të marra sipas së drejtës ndërkombëtare (Cf. më shumë lidhur me analizën gjithëpërfshirëse të kësaj materie nga **Komisionit të Venecias**, i cili këtë qasje e ngre në rang të standardit evropian, në dokumentet si vijon: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), *The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with International Treaties: New Trends in Constitutional Justice*, CDL-JU(2009)036 English only, Strasbourg, 17 November 2009, fq. 2, dhe *Comments on the Draft Law on the Constitutional Court of the Republic of Serbia,* Opinion no. 445/2007, CDL-AD(2007)039 English only, Strasbourg: 7 November 2007; Cf. gjithashtu edhe punimet: **Marta Cartabia**, "The Italian Constitutional Court and the Relationship between the Italian Legal System and the European Community", *Michigan Journal of International Law*, vol. 12, issue 1, 1990, fq. 173-192, ku autorja flet për rolin e **Gjykatës Kushtetuese të Italisë** sa i përket detyrimeve që rrjedhin nga traktatet e **BE**-së **Dren Doli** & **Fisnik Korenica**, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", *German Law Journal*, vol. 11, no. 8, 2010, fq. 824-826).

Në rastet kur vendos sipas juridiksionit të përshkruar si më sipër, Gjykata Kushtetuese vendoset në pozitën e mekanizmit që kontrollon përgjegjësinë ndërkombëtare të **Shtetit të Kosovës** sa u përket marrëveshjeve të nënshkruara ndërkombëtare, por edhe të detyrimeve të tjera jashtëkontraktuale të **Kosovës** sipas të drejtës ndërkombëtare, duke u bërë kësisoj një mekanizëm shtetëror që garanton nga brenda përgjegjësinë e Kosovës ndaj së drejtës ndërkombëtare dhe zbatimit ***bona fide*** të detyrimeve ndërkombëtare. Kjo dispozitë në **Kushtetutën e Kosovës** që barazon detyrimet

kontraktuale me ato jashtëkontraktuale të së drejtës ndërkombëtare paraqet pjesë të një trendi pozitiv të nisur pas **Luftës së Ftohtë** kur demokracitë e reja, ish-vendet komuniste të Evropës, u hapën me vrull ndaj pranimit të së drejtës ndërkombëtare si pjesë të rendeve të reja kushtetuese.

Përveç si një juridiksion i specializuar për Gjykatën, ky paragraf, përmes një obligimi pozitiv që e vendos mbi Gjykatën, bën që realisht të sendërtojë një raport shumë **monist** të së drejtës së brendshme me të drejtën ndërkombëtare, me kuptim epërsinë e kësaj të fundit. Kjo vërtetohet nga dispozitat e nenit 36 ["Efekti Suspensiv"] të **Ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**, sipas të cilës ngritja e kërkesës nga palët e autorizuara ka për pasojë të drejtpërdrejtë pezullimin e votimit për draft-amendamentin kushtetues: amendamenti mund të miratohet në Kuvend vetëm pas vendimit të Gjykatës dhe duke i marrë parasysh në tërësi të gjeturat e saj të dhëna në verdiktin lidhur me kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Kjo ka për qëllim zbutjen e pasojave eventuale të cilat një amendament do të mund t'i shkaktonte në planin ndërkombëtar, përkatësisht në aspektin e detyrimeve të Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare (kontraktuale dhe jokontraktuale). Në jurisprudencën komparative ekzistojnë raste kur një gjykatë kushtetuese ka vendosur që asnjë detyrim ndërkombëtar nuk shfuqizohet në rastet kur ajo konstaton jokushtetutshmëri të plotë apo të pjesshme të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga parlamenti nacional (**Cf. Gjykata Kushtetuese e Hungarisë**, *Decision* No. 4/1997 (I.22.) AB, Budapest, 21.01. 1997).

Detyrimi që e drejta e brendshme të qëndrojë në linjë me detyrimet ndërkombëtare projekton një lloj hierarkie ku e drejta e brendshme, duke përfshirë të drejtën kushtetuese, qëndrojnë të varura për të drejtën ndërkombëtare (një version **kelsenian** i raportit mes së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, i cili nuk sheh nevojë për kundërvënie sepse e drejta ndërkombëtare është vazhdim i të drejtës së brendshme që bazohet në normën themelore). Në anën tjetër, ky juridiksion i specializuar mundëson që Gjykata përveç që të ketë nën kontroll kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese sa i përket përputhshmërisë së tyre me kapitullin II të Kushtetutës, gjithashtu të kontrollojë përputhshmërinë e tyre me traktatet ndërkombëtare të marra përsipër nga **Kosova**. Në këtë mënyrë, juridiksioni për kontrollimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese zgjerohet shumëfish ashtu që e drejta ndërkombëtare (kontraktuale dhe zakonore) bëhet baza e dytë (parametri kontrollues) mbi të cilën

gjykohet kushtetutshmëria e amendamenteve kushtetuese. Kjo kompetencë duhet të dallohet thelbësisht nga **kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare**, gjë të cilën nuk e kanë të qartë autorët tanë: ky kontroll zakonisht është preventiv, siç është rasti me **Shqipërinë** dhe me disa vende të tjera, në të cilat gjykata kushtetuese bën kontrollin e kushtetutshmërisë së një marrëveshje para ratifikimit. I tillë ka qenë rasti, ta zëmë, me deklarimin jokushtetuese të marrëveshjes për kufijtë detar mes **Shqipërisë** dhe **Greqisë** (Cf. "Gjykata Kushtetuese rrëzon Marrëveshjen për kufirin detar me Greqinë", *Gazeta Shqiptare / TV News 24 / Pashtriku.org*, 27.01. 2010; për komentet, Cf. Xhezair Zaganjori, *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare*, Morava: Tiranë, 2011, fq. 39-52). Hartues i vendimit ka qenë vetë prof. **Xhezair Zaganjori**, si referues i rastit, fakt që e ka ndarë në një bisedë me autorin e këtyre rreshtave). Mirëpo, ky kontroll mund të jetë edhe represiv, siç është rasti me **Serbinë** dhe disa vende të tjera ish-komuniste ku mund të bëhet kontrolli i kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare edhe pas ratifikimit të tyre. (Për vendet e tjera ish-komuniste, si dhe për modalitetet e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare gjetiu, Cf. **Helmut Steinberger**, *Models of Constitutional Jurisdiction*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 1993, kapitulli I ("Review of the Constitutionality of Laws"), fq. 5-20.)

Në kryerjen e këtij juridiksioni, Gjykata realisht nuk kontrollon kushtetutshmërinë në kuptimin klasik, por shndërrohet në një mekanizëm që kontrollon ligjshmërinë dhe legjitimitetin ndërkombëtar të amendamenteve kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata vihet në pozitën e një organi gjysmëndërkombëtar sepse mbron dispozitat e **KVDT** dhe, përmes saj, rendin juridik-kushtetues ndërkombëtar. Kjo është kështu sepse, përmes vënies në jetë të këtij detyrimi kushtetues, partnerët ndërkombëtarë të **Kosovës** sigurohen se detyrimet e saj sipas të drejtës ndërkombëtare mbisundojnë kundrejt detyrimeve të brendshme juridiko-kushtetuese. Në këto raste, caqet e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese janë më të gjëra se caqet e këtij kontrolli kur ndërmerret në zbatim të nenit 113.9 lidhur me nenin 144.3 të Kushtetutës. Në këtë rast nuk flitet për kapitujt I-III të Kushtetutës, por për respektim të letrës, frymës dhe shpirtit të Kushtetutës si një tërësi organike dhe e pandarë. Këtu flitet, për të qenë më i saktë, për detyrueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara sipas Kushtetutës por edhe të detyrimeve të tjera jashtë kontraktuese që dalin nga e drejta zakonore ndërkombëtare. Edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur, u mor vesh, mund të jetë cak i

kontrollit kushtetues. Në një rast të tillë do të ishte, ta zëmë, vlerësimi nëse marrëveshjet ndërkombëtare nga neni 18.1 (pikat 1-4) i Kushtetutës janë ratifikuar me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Edhe seksioni në vijim, "Kontrolli incidental në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës" (fq. 461-462) mund të quhet i pranueshëm, me gjithë narrativin kaotik, gjë që nuk vlen për seksionin në vijim: në fq. 462-464, autorët tanë përshkruajnë ***ad literam*** një vendim të **Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë**, pa asnjë shtesë teorike apo krahasuese që do ta bënte tekstin më të kuptueshëm dhe origjinal.

Mosnjohjen themelore të kategorive dhe instituteve të gjyqësisë kushtetuese manifestohen sërish në seksionin në vijim që flet për ankesën kushtetuese (fq. 464-466). Autorët nuk e kanë të qartë dallimin mes kontrollit konkret dhe kontrollit abstrakt, në njërën anë, dhe këtyre dy instituteve dhe ankesës kushtetuese në anën tjetër (sic!). Në rastin e kontrollit konkret, që nuk iniciohet me ankesë kushtetuese siç mendojnë autorët tanë, objekt kontrolli kushtetues është një normë juridike që duhet të zbatohet në zgjidhjen e një rasti apo mosmarrëveshje që ka lindur mes palëve në një gjykatë të rregullt. Kjo procedurë çdoherë iniciohet incidentalisht, pra si dytësore në raport me çështjen kryesore. Në rastin e ankesës kushtetuese nuk bëhet fjalë për kontroll konkret por për kontrollin e kushtetutshmërisë së një akti individual të një autoriteti publik kosovar dhe niset me kërkesën individuale të palës, personit fizik apo juridik që pretendon se i janë shkelur liritë dhe të drejtat e garantuara me kushtetutë. Autorët tanë flasin për shkeljen e të drejtave dhe interesave juridikë, gjë që nuk është e saktë. Pse? Sepse në interesa juridikë bëjnë pjesë shkeljet që kanë natyrë ligjore dhe, si të tilla, nuk bien në kuadër të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

Autorët tanë është dashur që në fillim t'ia sqarojnë studentit, lexuesit dhe vetvetes llojin e ankesës kushtetuese kosovare e vetëm pastaj të flasin për dispozitat konkrete kushtuese lidhur me këtë. Kosova, që të jetë lexuesi ynë në dijeni, ka një ankesë kushtetuese të a.q. të tipit të plotë, që domethënë se me të mund të goditen vendimet individuale që cenojnë liritë dhe të drejtat kushtetuese si atëherë kur ky cenim ka të bëje me anën faktike ashtu dhe me anën juridike të shkeljes së supozuar. U mor vesh, kjo me kusht që, në parim, së pari janë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike dhe janë plotësuar kushtetues tjera që e bëjnë të lejueshëm shqyrtimin meritor të kërkesës.

Seksioni në vijim në fq. 466-468 sërish del, me gjithë konfuzitetin e tij, më i pranueshëm për studentin dhe lexuesin, siç del i kundërt me këtë seksioni tjetër me titull "Përcaktimi i objektit të kontestit – padisë kushtetuese" (fq. 468-469). Në fund të këtij seksioni përmblidhet krejt mosdija themelore e autorëve tanë rreth objektit të një kërkese individuale, të cilën gabimisht e cilësojnë si padi kushtetuese, dhe dallimin mes objektit të kërkesës dhe objektit të procedurës. Si objekt i kërkesës (***petitum***-i) çdoherë paraqitet një liri apo e drejtë kushtetuese cenimi i së cilës pohohet nga paraqitësi i kërkesës, kurse objekt i procedurës së iniciuar me kërkesë individuale çdoherë paraqitet një akt apo veprim individual i një autoriteti publik kushtetutshmëria, jo ligjshmëria, e të cilit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Fjala padi apo objekt i kontestit nuk përdoret në procedurat pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në pikën nën nr. 6 (fq. 469), autorët flasin për një juridiksion të Gjykatës Kushtetuese që nuk ekziston: autorët këtu thonë se Gjykata Kushtetuese ka juridiksion ndaj anëtarëve të Parlamentit dhe zyrtarëve të tjerë shtetërorë në procedurat e revokimit, gjë që fare nuk është e vërtetë. Ka disa gjykata kushtetuese që kanë një juridiksion të tillë, siç janë Turqia, Shqipëria, Gjermania etj., por jo Kosova.

Në seksionin rreth përbërjes së Gjykatës Kushtetuese dhe mënyrës së zgjedhjes së gjyqtarëve (fq. 469-471), autorët janë përpjekur për t'u dhënë studentit dhe lexuesit një pasqyrë të sistemeve të zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues. Në këtë përpjekje, megjithatë, nuk kanë pasur sukses sepse sërish e vejnë studentin dhe lexuesin në lajthitje rreth çështjeve themelore. Flasin për modelin kosovar të zgjedhjes si për një model bashkëpunimi dhe këtu fusin në një thes Kosovën dhe Austrinë, duke konstatuar se në dy rastet presidenti i vendit ka rol kyç, gjë që fare nuk është e saktë. Po ashtu nuk është e saktë dhe nuk ekziston i a.q. sistemi i kombinuar, shprehje që përdorin autorët për modelin rumun dhe bullgar, ku caktimi i gjyqtarëve është i ndarë mes organeve qendrore të pushtetit (shefit të shtetit, legjislativit dhe gjyqësorit). Për rastin e Austrisë treguam në fillim se kanë abuzuar me referencën në fusnotën nr. 1456. Për hir të lexuesit tonë, e shohim të arsyeshme që të japim skicën dhe disa sqarime themelore të modeleve të caktimit të gjyqtarëve kushtetues ashtu siç ekzistojnë sot nëpër vendet demokratike.

Aktualisht ekzistojnë tri modele për caktimin e gjyqtarëve kushtetuese. Modeli parë është ai model në të cilin caktimi i gjyqtarëve është i ndarë mes dy apo më shumë organeve, të cilat veprojnë ndaras dhe në mënyrë të

pavarur nga njëri-tjetri. Secili organ ka kuotat e veta të gjyqtarëve që duhet t'i caktojë, zakonisht çdo tre vjet. Ky ndryshe quhet edhe **modeli i caktimit të drejtpërdrejtë**. Në këtë model bëjnë pjesë **Austria, Bullgaria**, **Franca, Italia**, **Rumania**, **Spanja**, **Ukraina** etj. Modeli i dytë është ai model në të cilin gjyqtarët caktohen ekskluzivisht me votën e parlamentit. Ky model njihet me emrin **modeli i zgjedhjes**. Ekziston në **Gjermani** dhe në shumicën e vendeve ish-komuniste të Evropës, siç janë **Polonia** dhe **Hungaria**, por edhe **Kosova.** Modeli i tretë është ai model në të cilin caktimi i gjyqtarëve bëhet përmes bashkëpunimit mes dy organeve, zakonisht ligjvënësit dhe shefit të shtetit. Ky model njihet me emrin **modeli i bashkëpunimit**. Si i tillë ekziston në **Shqipëri**, **Rusi**, **Slloveni**, **Sllovaki**, **Çeki** etj. Në këto vende nominimi bëhet nga shefi i shtetit e konfirmohet nga ligjvënësi, apo anasjelltas. Në këtë model kërkohet një shkallë e lartë e kulturës së bashkëpunimit (Cf. më shumë për trajtimet doktrinare të tri modeleve tek autorët si vijon: Zdenk Kühn and Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic", *European Constitutional Law Review*, vol. 2, issue 02 (June 2006) fq. 183-208 në fq. 185-188; Katalin Kelemen, "Appointment of Constitutional Judges in a Comparative Perspective – with a Proposal for a New Model for Hungary", *Acta Juridica Hungarica*, vol. 54, no. 1 (2013) fq. 5-23 në fq. 11-19; për një klasifikim pak më ndryshe të modeleve cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "The Composition of Constitutional Courts", në ***Science and Technique of Democracy***, no. 20 (Strasbourg, December 1997), **CDL-STD(1997)020**, paragrafi 1.1 ["Systems of Appointment"], dhe *Judicial Appointments* (Venice, 22 June 2007), **Opinion No. 403/2006**, **CDL-AD(2007)028**, paragrafët 8-17).

Sikundër u tha, **Kosova** i takon **modelit të zgjedhjes**. Në këtë model, organi përfaqësues ka fjalën kryesore në caktimin e gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese. Një procedurë e tillë, megjithatë, vlen akoma dhe ka qenë e saktë çdoherë vetëm sa i përket caktimit të gjyqtarëve vendorë: për gjyqtarët ndërkombëtarë, gjatë tërë kohës sa kanë qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, ka vlejtur një version specifik i **modelit të caktimit të drejtpërdrejtë**. Kjo për faktin se ata janë caktuar me emërim nga ana e **PCN**-së (2009-2014), përkatësisht nga ana e shefit të shtetit të kosovar (2014-2018), pa ndarë këtë autorizim për caktimin e tyre me asnjë organ tjetër, qoftë me **GJEDNJ**-në apo **Kuvendin e Kosovës**. Këto janë sqaruar gjerësisht në seksionin pararendës.

Në rastin e gjyqtarëve vendorë, procedura e **modelit të zgjedhjes**, e definuar si më sipër, normohet me nenin 114.2 të Kushtetues që flet për përbërjen dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues, i cili thotë:

> 2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi.

Sikundër shihet, në rastin e Kosovës nuk ekziston modeli i bashkëpunimit të organit përfaqësues dhe shefit të shtetit kosovar. Kjo nga shkaku se ky i fundit bën vetëm emërimin ceremonial të gjyqtarëve të zgjedhur nga Kuvendi. Ky sistem garantohet me Kushtetutë, e cila në mënyrë të qartë flet për një gjë të tillë. Procedurat e vënies në jetë të këtyre dispozitave kushtetuese që garantojnë dhe sanksionojnë këtë **model të zgjedhjes** në **Kosovë** specifikohen me **Ligjin nr. 03/L-121**. Propozimi i Kuvendit nuk mund të jetë homogjen: ai duhet të jetë mjaft divers dhe të reflektojë parimin themelor kushtetues mbi ruajtjen dhe sigurimin e diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor dhe tjetër në **Republikën e Kosovës**. Kjo përbën një detyrim kushtetues: në ndërkohë që konkurrimi për pozitën e gjyqtarit kushtetues është mjaft liberal dhe nuk pengon askënd që vlerëson se është jurist i shquar për të aplikuar ***sua sponte*** për pozitë të tillë, propozimi i Kuvendit duhet të jetë qartazi në harmoni me vlerat dhe parimet kushtetuese mbi barazinë e të gjithëve si dhe mosdiskriminimin mbi asnjë bazë. Kjo në rend të parë ka të bëjë me vendet për gjyqtarë të komuniteteve joshumicë, por në të njëjtën kohë i referohet edhe barazisë gjinore dhe ndalimit të diskriminimit në fitimin dhe ushtrimin e posteve publike.

Sikundër shihet, me propozim të Kuvendit, i cili voton për kandidatët nga lista e përzgjedhur për postin e gjyqtarit kushtetues nga ana komisionit ***ad hoc***, Presidenti i Republikës bën emërimin e tyre. Konkursi është publik, kurse konkurrimet, siç u tha më sipër, janë shumë liberale: nominimet për të konkurruar mund t'i bëjnë organet dhe institucionet e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, si dhe vetë kandidatët që konkurrojnë (vetë-konkurrimi).

Procedura që ven në jetë dispozitat e mësipërme kushtetuese për caktimin e gjyqtarëve kushtetues rregullohet vetëm me një nen, me nenin 6 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese"] të **Ligjit nr. 03/L-121**.

Çdoherë kur duhet të propozohet një gjyqtar kushtetues formohet një komision i posaçëm për udhëheqjen e procedurave të kandidimit deri në

përpilimin e listës prioritare dhe dërgimin e saj në Kuvend për votim me qëllim të propozimit të gjyqtarëve për emërim (dekretim) te **Presidenti i Republikës**. Komisioni reflekton përbërjen politike të Kuvendit, të sistemit gjyqësor, institucioneve të pavarura, diversitetit kulturor, etnik, gjuhësor dhe tjetër. Në të merr pjesë edhe përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese. Në respekt të organit që propozon kandidatët, kryesimi i këtij komisioni i takon kryetarit të Kuvendit apo përfaqësuesit të deleguar të saj/tij. Kjo rrethanë, pra roli kyç i Kuvendit, shpjegon përse i vetmi është posti i kryetarit të Kuvendit që mund të delegohet në një tjetër person brenda kryesisë së Kuvendit për të ushtruar kryesimin e këtij komisioni. Kjo mundësi delegimi nuk stipulohet për asnjërin prej përbërësve të tjerë të komisionit në fjalë. Se kjo është kështu shihet edhe nga fakti se vota e kryetarit të Kuvendit ka fuqi të dyshfishtë në rastet kur votat janë baras, diçka që ndodh shumë shpesh në një trup që merr vendime me shumicën e thjeshtë. Në rast të ekzistimit të **konflikti i interesit**, një gjë e tillë duhet të raportohet. Mosraportimi përbën shkelje të rëndë të **etikës** dhe parimit të barazisë së kandidatëve për gjyqtar kushtetues në procedurën e përzgjedhjes së tyre për votim në Kuvend.

Pas katër kapitujve përshkrues të teksteve kushtetuese dhe ligjore vjen seksioni mbi rastet që identifikojnë praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (fq. 475-485). Përzgjedhja e rasteve që identifikojnë praktikën e Gjykatës Kushtetuese është bërë pa ndonjë qasje metodologjike, duke qenë kështu në tërësi arbitrare dhe pa asnjë kriter metodologjik. Që në fillim autorët bëjnë gabim themelor kur konstatojnë se Gjykata Kushtetuese ka bërë interpretime të Kushtetutës përmes aktgjykimeve dhe aktvendimeve. Më aktvendim asnjëherë dhe në asnjë rast nuk mund të ndodhë interpretimi i Kushtetutës sepse me te vendoset mbi lejueshmërinë e kërkesës, pra nëse kërkesa e parashtruar është e lejueshme për shqyrtim dhe vendosje. As interpretimi i Kushtetutës së Kosovës dhe as ndryshimi i praktikës së saj gjyqësore, sërish duhet ta ripërsërisim, nuk mund të ndodhë përmes formës së vendimit që ka emrin "aktvendim": vetëm me vendimin që ka formën e aktgjykimit bëhet krijimi dhe ndryshimi i praktikës gjyqësore, asnjëherë me aktvendim (sic!). Këtë duhet ta dinë dhe ta kenë të qartë njëherë e mirë autorët tanë.

Në fq. në vijim, fq. 476, autorët flasin për **vetëpërmbajtjen** dhe **aktivizmin gjyqësor**. Këtë të fundit e quajnë "aktivizim", gjë që është gabim themelor sepse në gjyqësinë kushtetuese ka vetëm aktivizëm gjyqësor, si pandan i vetëpërmbajtjes gjyqësore (sic!). Më të parin nënkuptohet ven-

dimmarrja kur një gjykatë del nga standardet e vendosjes së një rasti kushtetues duke përvetësuar të drejtat juridiksionale në aspektin material apo procedural apo duke vendosur mbi aspektet e kërkesës që fare nuk janë ngritur nga palët në procedurë. E kundërt me këtë është vetëpërmbajtja, sipas së cilës një gjykatë kushtetuese rezervohet në mënyrë të skajshme për të vendosur për një rast kushtetues duke gjetur arsyetime të ndryshme. Ndër arsyetimet më të shpeshta dhe më të njohura të vetëpërmbajtjes është e a.q. doktrina e çështjes politike (***political question doctrine***). Kjo doktrinë ka lindur në SHBA dhe haset atëherë kur një gjykatë refuzon të lëshohet në shqyrtim apo vendosje të rastit me arsyetim se rasti përbën një çështje politike që nuk mund të zgjidhet me mjete juridike të profesionit gjyqësor. Lexuesi ynë duhet të jetë i njoftuar lidhur me atë se si, në cilën sferë dhe me cilin rast Gjykata Kushtetuese e Kosovës vërtetë ka tejkaluar juridiksionin e saj, duke ushtruar aktivizëm gjyqësor. Të shohim si duken fillet e para të aktivizmit gjyqësor në Kosovë.

Që në fillim theksojmë se kanë qenë nenet 84.9 ["Kompetencat e Presidentit"] dhe 93.19 ["Kompetencat e Qeverisë"] të Kushtetutës së Kosovës ato që kanë shërbyer si shtylla ankorimi për aktivizmin gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese në vitet e saj formative, aktivizëm që ka prodhuar një standard sa i përket juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur meritorisht çdoherë kur Presidenti dhe Qeveria e Kosovës ngrejnë çështje kushtetuese. Redaktimi i dispozitave të dy neneve si më sipër është i njëjtë: aty theksohet se Presidenti dhe Qeveria **mund të referojnë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese**. Të shohim në fillim rastet e ngritura nga Qeveria dhe pastaj vazhdojmë me rastet e Presidentit, sepse kjo histori së pari ka nisur nga Qeveria.

Paragrafi 9 i nenit 84 të Kushtetutës i vesh të drejtën presidentit të republikës për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Shikuar në aspektin e përgjithshëm, pozita e palës së legjitimuar për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese i jep hapësirë presidentit të republikës për të materializuar në një mënyrë apo tjetër kompetencën e tij si "garantues" i funksionimit kushtetues të institucioneve kushtetuese. Dy janë çështje të rëndësishme:

- Çfarë lloj pyetjesh mund të referojë presidenti i republikës në kuptim të këtij neni?
- Çfarë është efekti juridik i pyetjes që bën presidenti i republikës?

Sa i përket pyetjes së parë, në kuptim të këtij paragrafi, nocioni "çështje kushtetuese" mund të kuptohet në dy kuptime, të ngushtë dhe të gjerë.

Në kuptim të gjerë, termi "çështje kushtetuese" i referohet çdo parashtrese që presidenti i republikës mund të dërgojë në Gjykatën Kushtetuese. Në kuptim të ngushtë, parashtresa që mund ta dërgojë presidenti mund dhe duhet konsideruar vetëm në kuptim të atyre çështjeve brenda juridiksionit të rregullt të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuar nga neni 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës. Kjo do të thotë se pyetjet që mund t'i dërgojë në Gjykatën Kushtetuese presidenti i republikës duhen parë në kontekst të plotësimit të kushteve që lidhen me juridiksionin e vet Gjykatës të përcaktuar me Kushtetutë. Prandaj, nocioni "çështje kushtetuese" nuk i referohet çfarëdo lloj pyetjeje, por një parashtrese që e vë në lëvizje cilindo juridiksion të cilin e ka Gjykata Kushtetuese sipas nenit 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës. Në praktikën e deritanishme të Gjykatës, megjithatë, nuk ka gjetur zbatim ky kuptim, kuptimi i ngushtë, por ai i gjerë i termit "çështje kushtetuese". Ky përfundim rrjedh nga analizimi i disa rasteve të cilat janë ngritur pranë Gjykatës Kushtetuese në fillim të punës së saj, njëri prej të cilëve është ngritur nga qeveria duke u mbështetur në formulimin tërësisht të njëjtë të nenit 93.10 të Kushtetutës ku thuhet se qeveria, *inter alia*, "mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese".

Rasti i parë kërkesës si më sipër, i ngritur nga Qeveria, kërkonte sqarim nga Gjykata nëse duhej proceduar në Kuvend me zgjedhjen e shefit të shtetit nëse paraprakisht dihet që nuk do të ketë në sallë mbi 80 deputetë. Në rastin e dytë, ndërkaq, sërish të ngritur nga Qeveria, u kërkua nga Gjykata mbi bazën e dispozitës së njëjtë kushtetuese një interpretim abstrakt, tekstual, i dispozitave të neneve përkatëse të Kushtetutës që flasin për imunitetin dhe privilegjet e funksionarëve të lartë të shtetit të Kosovës. Më një fjalë, këtu Qeveria kishte kërkuar që Gjykata të sqaronte caqet dhe vëllimin e imunitetit dhe privilegjeve të funksionarëve të lartë shtetërorë të Kosovës.

Derisa në rastin e parë Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin meritor të rastit sepse bazohej në një gjendje hipotetike që pritej të ndodhte në të ardhmen, pra votimi i shefit kosovar të shtetit pas vendimit të Gjykatës që shpallte antikushtetues vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e zt. **Behgjet Pacolli** për President të Kosovës më datën 22 shkurt 2011, në rastin e dytë Gjykata shqyrtoi meritat e rastit. Ato merita të rastit të dytë kishin të bënin jo me një gjendje faktike por më një interpretim abstrakt dhe hipotetik të neneve përkatëse të Kushtetutës që flasin për imunitetin dhe privilegjet e funksionarëve të lartë shtetërorë të Kosovës. Me një fjalë, Gjykata nuk vlerësoi kushtetutshmërinë e një norme ligjore të përmbajtur në një

draft-ligj, as të një norme kushtetuese të përmbajtur në një draft-amendament kushtetues, por bëri interpretim abstrakt dhe tërësisht hipotetik të caqeve dhe vëllimit të imunitetit dhe privilegjeve të funksionarëve të lartë shtetërorë. Sikundër mund të vërehet, në këto dy raste dhe në rastet e ngritura më vonë nga Presidenti dhe ushtruesi i detyrës së Presidentit të Kosovës, Gjykata ka bërë një interpretim ekstensiv të juridiksionit të vet nga nenet 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetues, duke pranuar si palë të autorizuar Qeverinë dhe Presidentit për ngritje (dërgim) në Gjykatë të "çdo çështje kushtetuese". Kjo efektivisht domethënë se cilësia e të qenët president dhe qeveri përcaktojnë se çka është "çështje kushtetuese", jo juridiksioni i Gjykatës sipas nenit 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës (Cf. Lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të diskutuar këtu: sqarim i Aktgjykimit në Rastin nr. KO 29/11 Sabri Hamiti dhe deputete të tjerë: Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-04, te 22 shkurtit 2011, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës se Kosovës; Sqarimet e kërkuara për Vendimin e shumicës, te 30 marsit 2011, datë 1 prill 2011, nr. ref. SQ 111/11, paragrafët 14-19; dhe Aktgjykim në Rastin nr. K098/11, Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputeteve te Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 20 shtator 2011, nr. ref. AGJ 138/11, paragrafët 4, dhe 51-135).

Cilësimi që Presidenti dhe Qeveria ia bëjnë një çështje e përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese tani e tutje. Këtu kemi të bëjmë me **vendime interpretative**, të cilat njihen në mënyrë shprehimore në disa vende, si p.sh. në Itali dhe deri vonë në Bullgari, por ka raste kur vetë gjykatat, si në rastin e Kosovës, kanë bërë interpretim ekstensiv të dispozitave kushtetuese për t'i krijuar vetes një juridiksion shtesë. Për rastin e Italisë dhe të Bullgarisë, lexuesi mund të gjejë informacione të bollshme të libri ***The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe*** (The University of Chicago Press: Chicago, 2000, fq. 164-193) i autorit **Herman Schwartz**, pastaj te artikulli i **Giancarlo Rolla** & **Tania Groppi**, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy", botuar në përmbledhjen e redaktuar nga **Wojciech Sadurski** (ed.), ***Constitutional Justice East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective*** (Kluwer Law International: The Hague, 2010, fq. 143-159). Për rastet krahasuese të krijimit të këtij juridiksioni përmes interpretimit ekstenziv të

dispozitave kushtetuese, ftojmë lexuesin të konsultojë librin voluminoz dhe hulumtues ***Constitutional Courts as Positive Legislators: A Comparative Law Study*** (Cambridge UP: Cambridge, 2011, Kapitulli 5: "Constitutional Courts as Legislators on Matters of Judicial Review", fq. 173-188), të autorit **Allan R. Brewer-Carias**: në këtë kapitull, autori jep një analizë komparative të rasteve të gjykatave të cilat krijojnë rregulla materiale dhe procedurale në dobi të zgjerimit të juridiksionit të tyre vetanak.

Rasti i parë që Presidenti i Republikës vuri në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, bazuar në nenin 84.9 të Kushtetutës, ka pasur të bëjë me kërkesën për sqarim se cili institucion ishte përgjegjës për të vlerësuar efektshmerinë dhe validitetin e dorëheqjes dhe për të konstatuar përfundimin eventual të mandatit të kryetarit të një komune në Kosovë në bazë të një komunikate drejtuar qytetarëve ku thuhej se kishte dhënë dorëheqje nga posti i kryetarit të komunës. Kjo komunikatë, përkatësisht kjo dorëheqje e bërë publike përmes kësaj komunikate shkaktonte paqartësi dhe ia bënte të pamundur Presidentit të Kosovës veprimin e mëtejshëm në përputhje me parimin kushtetues për zgjedhje të lira dhe të barabarta (Cf. Aktgjykim, Rasti nr. KO 80/10, Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska, datë 7 tetor 2010, ref. nr. AGJ 46/10, paragrafi 10). Rasti tjetër u paraqit nga ushtruesi i detyrës së Presidentit, dr. **Jakup Krasniqi**, po ashtu në bazë të nenit 84.9, i cili kërkonte që Gjykata Kushtetuese t'i jepte një sqarim nëse ushtruesit të detyrës së Presidentit i ndalohej mbajtja dhe ushtrimi i postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) (Cf. Aktgjykim, Rasti nr. KO 97/10, Kërkesa e parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), datë 22 dhjetor 2010, ref. nr. AGJ 78/10).

Sa i përket pyetjes së dytë për sa më sipër, efekti juridik i parashtresës që mund ta dërgojë presidenti i republikës apo qeveria është i njëjtë me efektin juridik të çdo pale tjetër të autorizuar. Në këtë aspekt, pyetjet që mund t'i parashtrojnë Gjykatës Kushtetuese presidenti dhe qeveria e republikës nuk kanë efekt juridik tjetër, pos të asaj të një pale të autorizuar që mund të vërë në lëvizje juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Është e rëndësishme, gjithashtu, të kihet parasysh që kjo kompetencë e presidentit dhe qeverisë së republikës duhet kuptuar në kuptim të ngritjes

së çështjeve në Gjykatën Kushtetuese të cilat ai/ajo i has gjatë ushtrimit të kompetencave të garantuara me Kushtetutë e me qëllim të realizimit të rolit primar të tyre kushtetues: në ndërkohë që te presidenti si përfaqësues i unitetit juridik-kushtetues të popullit të Kosovës dhe si garantues u funksionimit normal të institucioneve të sistemit kushtetues kosovar kjo ka një kuptim dhe përmbajtje kushtetuese, te rasti i qeverisë, njohja e kësaj kompetence përbën një problem serioz sepse fjala është për organin ekzekutiv që lehtë mund të abuzojë me të. Kjo, megjithatë, ngelet të shihet dhe nuk i takon natyrës së një teksti të së drejtës kushtetuese apo një recensioni për një tekst të së drejtës kushtetuese hamendësimi për një rast hipotetik që mund të ndodhë në të ardhmen.

Kështu duhet të jetë qasja e autorëve tanë, neutrale dhe shkencore, jo duke bërë gjykime arbitrare dhe personale lidhur me disa nga rastet më të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Këtë qasje e kërkon natyra e një teksti universitar, jo qasjen arbitrare dhe paragjykuese pa asnjë kriter shkencor dhe profesional metodologjik. Mënyra e komentimit të rasteve që, sipas autorëve, paskan pas identifikuar praktikën e Gjykatës Kushtetuese deri më sot, në tërësi është laike dhe pa asnjë kriter profesional: autorët flasin për aktivizëm gjyqësor (në fakt në mënyrë të gabuar për "aktivizim", gjë që nuk ekziston si koncept i të drejtës kushtetuese) dhe për vetëpërmbajtje gjyqësore me terma që i dëgjon njeriu nëpër rrugët dhe kafenetë e Prishtinës. Këtë gjuhë dhe këto koncepte nuk mund t'i kuptojnë studenti dhe lexuesi.

Kapitulli VIII. Sektori i Sigurisë në Republikën e Kosovës (fq. 485–501)

Përgjithësisht

Ky kapitull përbëhet prej 17 seksioneve, ndonjëri nga të cilët ka edhe nënseksionet e veta. E kemi fjalën për seksionin lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme (fq. 497-498). Ky seksion është i vetmi në krejt kapitullin që ka një burim të huaj: në fusnotat nr. 1544 & 1546, autorët kanë përdorur një broshurë prej tetë faqesh, të përkthyer në gjuhën shqipe, që është botim i Qendrës së Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura. Në vend të kësaj broshure, autorët më mirë të ishin mbështetur në li-

teraturën akademike lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme, kuptimin dhe llojet e saj, normimin kushtetues dhe kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në gjendje të jashtëzakonshme. Këto përbëjnë materie kushtetuese, jo diskutimi lidhur me parimet e vlerësimit politik se kur ekziston një gjendje e jashtëzakonshme dhe si duhet të menaxhohet ajo sipas kritereve standarde. Kjo është me rëndësi, pa asnjë diskutim, por për studentin dhe lexuesin e së drejtës kushtetuese ka shumë rëndësi të dihen standardet që i ka vënë Gjykata e Strasburgut, precedentët e së cilës, bazuar në nenin 53 të Kushtetutës së Kosovës, të gjithë janë të detyruar t'i zbatojnë. Për këtë arsye ne në pjesën e analizës kritike i diskutojmë standardet e vëna nga **GJEDNJ** lidhur me situatat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe që kanë të bëjnë me materien kushtetuese.

Në vijim si më sipër, në këtë kapitull autorët tanë fare nuk e kanë të qartë, apo qëllimisht i ngatërrojnë çështjet lidhur me faktet dhe rrethanat si vijon:

- jo vetëm sektori i sigurisë por asnjë sektor tjetër në Kosovë nuk rregullohet me ligje organike sepse ato ligje nuk i njeh Kushtetuta e Kosovës (fq. 485);
- nuk mund të jetë mision i **FSK**-së (Forca e Sigurisë së Kosovës) mbrojtja e Qeverisë së Kosovës (fq. 486); në një rast të tillë, ky organ do të paraqiste një falangë, ushtri private e dikujt dhe jo kategori kushtetuese me emërtimin që ka dhe me mandat krejt të qartë kushtetues si një forcë kombëtare për sigurinë e Kosovës që mbron qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj (neni 126 pikat 1 & 2 i Kushtetutës së Kosovës);
- nuk mund të përdoret në një tekst të së drejtës kushtetuese gjuha politike e cila viktimizon njërin prej komuniteteve të Kosovës, të cilët janë qytetarë të barabartë të këtij vendi (fq. 458); çdoherë duhet të përdoret gjuha dhe fjalori kushtetues, jo ai politik; përveç kësaj, për hir të së vërtetës, duhet theksuar se amendamentet kushtetuese në vitin 2014 nuk janë votuar nga ana e deputetëve shumicë, jo nga serbët; përdorimi i një gjuhe të tillë, siç bëjnë autorët tanë në fq. 458 të librit prish kohezivitetin socio-politik dhe shtetëror të vendit sepse objektivisht viktimizon shtetasit e Kosovës që i përkasin komunitetit serb;
- shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, thonë autorët tanë, duhet të bëhet nga dy mekanizmat e ekzekutivit (fq. 499); një konstatim i tillë

> fare nuk qëndron sepse ekzekutivi kosovar nuk është dual në asnjë rast dhe në asnjë segment; shpallja formale e gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e Presidentit të Kosovës nuk e bën atë, përkatësisht nuk e vesh Presidentin me një kompetencë ekzekutive: gjendja e jashtëzakonshme shpallet, menaxhohet dhe kontrollohet në bashkërenditje dhe me pëlqim (autorizim) shprehimor të tri organeve të tjera, Qeverisë, Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe, mbi të gjitha, me përfaqësuesin e sovranit si mbikëqyrës i tërë situatës gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe të vetë punës së tri organeve të sipërcekura të involvuara në shpalljen dhe menaxhimin e saj.

Shkrimi i këtij kapitulli karakterizohet me përshkrim të teksteve ekzistuese kushtetuese dhe ligjore dhe me një narrativ jokreativ, të cilit i mungon perspektiva krahasuese. Të shohim nga afër si duket kjo gjendje në këtë kapitull.

Analiza kritike

Në seksionin e parë që flet për parimet e përgjithshme, studenti dhe lexuesi nuk mund të gjejë asnjë parim dhe asnjë përmbajtje që do ta lehtësonte kuptimin e këtij kapitulli. Në fillim, autorët sërish flasin për ligje organike, të cilat nuk ekzistojnë dhe nuk njihen në sistemin kushtetues kosovar. Në të njëjtin vend konstatojnë se te institucionet e sigurisë shihet qartë ndikimi ndërkombëtar në hartimin e Kushtetutës së Kosovës (fq. 485). Ky konstatim bie ndesh me të a.q. etërit e kushtetutës si hartues të saj, në ndërkohë që autori i këtyre rreshtave pajtohet në tërësi me këtë fakt, përkatësisht me faktin se pushteti konstituiv origjiner (*pouvoir constituant originaire*) në Kosovë është ushtruar në mënyrë të përbashkët me faktorin ndërkombëtar. Kosova, siç kemi konstatuar në analizën tonë për kapitujt pararendës, nuk është e vetme në këtë drejtim.

Në seksionin e dytë (fq. 486-487), ngërthehen dy gabime themelore dhe trashanike: e para, autorët tanë konstatojnë se "Forca e Sigurisë së Kosovës [...] është forca e vetme e ushtarake vendore"; dhe, e dyta, sipas tyre, kjo forcë shërben si një instrument i sigurisë që ka për mision ta mbështesë Qeverinë e Kosovës në aspektin e sigurisë. Nuk është FSK forcë ushtarake, e aq më pak të ketë një mision të tillë: sikur FSK të kishte misionin e mbështetjes së Qeverisë së Kosovës në aspektin e sigurisë, atëherë do të kishte statusin e një falange apo ushtrie private qeveritare. Kjo nuk mund të jetë e vërtetë.

Seksionet e tjera deri në fund nuk janë veçse përfolje joanalitike e tekstit kushtetues dhe ligjeve relevante që merren me organizimin dhe veprimtarinë e organeve që janë pjesë përbërëse të sektorit të sigurisë së Kosovës dhe trupat e tyre menaxhues.

Siç premtuam më sipër në analizën tonë për këtë kapitull, në vijim do t'i japim pikëpamjet tona lidhur me standardet e **GJEDNJ**-së për gjendjet e jashtëzakonshme dhe situatat e ngjashme me të. Kjo doemos na çon në shtjellimin e dispozitave të nenit 113.3 (pika nën 3) të **Kushtetutës së Republikës së Kosovës**.

Pika e tretë e nenit 113.3 përcakton juridiksionin e Gjykatës sa i përket kontrollit kushtetues të aktit të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe të veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Sovran është ai që vendos mbi gjendjen e përjashtimit, e thotë apologjeti i shtetit totalitar **Carl Schmitt** (Cf. Carl Schmitt, *Political Theology: Four Chapters on the Concept of Sovereignty*, University of Chicago Press: Chicago, 1985, kapitulli 1: "Definition of Sovereignty", fq. 5-15). Situata e jashtëzakonshme paraqet një gjendje njerëzore në të cilën individi dhe bashkësia ndeshen më një pushtet shtetëror dhe politik në tërësi të liruar nga normat juridiko-kushtetuese, përkatësisht një gjendje njerëzore kundrejt pushtetit që prezantohet si i shtrënguar (i detyruar) për të ushtruar atë pothuajse pa asnjë kontroll efektiv. Kjo gjendje njerëzore, kur pushteti vërtetë është sovrani, mund të shkaktohet si pasojë e faktorëve njerëzorë, siç janë luftërat, revolucionet, konfliktet e intensitetit të lartë dhe kështu me radhë, ose e faktorëve jashtë vullnetit të njeriut, siç janë tërmetet e vërshimet, katastrofat tjera natyrore dhe kështu me radhë. Në një gjendje të tillë, pra në një gjendje të jashtëzakonshme, liritë dhe të drejtat e njeriut mund të suspendohen, duke përjashtuar liritë dhe të drejtat absolute (Cf. Daniel Prémont, Christian Stenersen & Isabelle Oseredczuk (eds.), ***Droits intangibles et états d'exception / Non-Derogable Rights and States of Emergency*** (Bruylant: Brussels, 1996), fq. 644). Pikërisht për këtë arsye ka rëndësi që akti i atij që është sovran, akti i shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, së bashku me veprimet e ndërmarra gjatë saj, të normohen paraprakisht me norma juridike-kushtetuese sepse përbëjnë një hapësirë të madhe për keqpërdorim real të pushtetit dhe cenim të të drejtave dhe lirive njerëzore (Shih p.sh.: **Giorgio Agamben**, "A Brief History of the State of Exception: An excerpt from *State of Exception*", në rrjet press.uchicago.edu/Misc/Chicago/009254.html (shikuar në shtator 2018).

Në demokracitë liberale perëndimore, thuajse pa asnjë përjashtim, ek-

zistojnë dispozita të detajuara lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme: **konstitucionalizmi i aktit të shpalljes si dhe monitorimi i gjendjes dhe veprimeve të kryera më pastaj përbëjnë një shenjë dalluese në mes tyre dhe vendeve autoritare, në të cilat *a priori* nënkuptohet se pushteti është sovran dhe nuk ka asnjë kufizim serioz juridik-kushtetues.** Dispozitat kushtetuese nëpër këto vende liberale, megjithatë, i lejojnë pushtetit shtetëror të drejtën e derogimit (shmangies) nga disa dispozita kushtetuese që garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut por me kusht që një gjë e tillë të jetë e kufizuar, e përkohshme dhe nën mbikëqyrje të vazhdueshme të "syrit të popullit", përfaqësuesit të sovranit si organ përfaqësues dhe ligjvënës i tij – parlamentit. Në këtë drejtim, siç do të shohim, **Kosova** nuk bën përjashtim: jo vetëm që kjo pikë e nenit 113.3 që flet për juridiksionin kushtetues në çështjet e gjendjes së jashtëzakonshme, por edhe dispozitat e tjera materiale të Kushtetutës flasin gjerësisht me terma e standarde të vendeve të demokracive liberale kushtetuese perëndimore sa i përket gjendjes së jashtëzakonshme, nga shpallja dhe deri te përfundimi i saj. Dispozitat materiale mbi gjendjen e jashtëzakonshme gjenden në kapitullin XI që flet për sektorin e sigurisë. Aty, në vetëm një nen, në nenin e fundit 131["Gjendja e Jashtëzakonshme"] të Kushtetutës përcaktohen deri në detaje rregullat dhe institucionet që vendosin për gjendjen e jashtëzakonshme, kushtet për mbajtjen e saj në fuqi dhe llojin e veprimeve të ndërmarra. Ky nen bën pjesë ndër nenet më të gjata të Kushtetutës së Kosovës. Në fakt, ky është neni më i gjatë i saj nëse merret parasysh fakti se i dedikohet një gjendje që potencialisht mund të ndodhë në Kosovë, pra nuk flet për fizionominë dhe kompetencat e një organi apo institucioni konkret kushtetues.

Para se të diskutojmë zgjidhjet kushtetuese kosovare, vlen të theksojmë këtu se nuk është vetëm e drejta e brendshme ajo që ka treguar një interes për rregullimin juridik të situatave të gjendjes së jashtëzakonshme: neni 4 i **KNDCP**-së lejon suspendimin e të drejtave të garantuara me të në rastet e emergjencave publike, që është një referim për gjendjen e jashtëzakonshme. Suspendimi në fjalë, megjithatë, ka disa kufizime:

- e para, ai duhet të të bëhet vetëm në kufijtë e kërkuar për ta sjellë situatën nën kontroll;
- e dyta, të drejtat absolute (p.sh. e drejta për jetë, ndalimi i torturës, skllavëria, kufizimi i lirisë për marrje të borxhit, respektimi i ***nullum crimen sine lege*** dhe ***nulla poena sine lege***, njohja dhe respektimi i

personalitetit para ligjit, liria e mendimit, fesë dhe ndërgjegjes) nuk mund të suspendohen; dhe

- e treta, gjendja e tillë duhet që të lajmërohet tek Sekretari Gjeneral i **OKB**-së (Cf. neni 4, KNDCP, *International Covenant on Civil and Political Rights*, miratuar nga Asambleja e Përgjitshme e OKB-së, më 19 dhjetor 1966, *United Nations: Treaty Series*, vol. 999, p. 171, vol. 1057, fq. 407); për shtjellime të detajuara doktrinare të raportit mes gjendjes së jashtëzakonshme dhe të drejtave të njeriut, si dhe të rasteve e modeleve të kufizimeve të këtyre të fundit në gjendjet e tilla, Cf. Gad Barzilai, ***Wars, Internal Conflicts, and Political Order*** (State University of New York Press: New York, 1996).

Stipulim të ngjashëm ka instrumenti kryesor i referimit në Kosovë, krahas Kushtetutës: **KEDNJ**, e cila flet për këtë në nenin e saj 15 ["Suspendimet gjatë Emergjencave"]. Në bazë të këtij neni vihen disa kushte **substanciale** dhe disa të tjera të natyrës **procedurale** që shtetet duhet t'i marrin parasysh dhe t'i respektojnë me rastin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjatë kohës sa zgjatë ajo.

Në kushtet **substanciale** bëjnë pjesë:

- e **para**, suspendimi i të drejtave dhe lirive njerëzore mund të kryhet vetëm në kohën e gjendjes së luftës apo gjendjes tjetër të jashtëzakonshme që rrezikon jetën e shtetit;
- e **dyta**, shteti mund të shmangë detyrimet nga **KEDNJ** dhe të marrë masa të caktuara për shmangie nga detyrimet kontraktuale sipas **KEDNJ**-së vetëm deri në masën që kërkohet nga situata e tillë; dhe,
- e **treta**, suspendimet e lirive dhe të drejtave të njeriut nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me detyrimet e tjera të shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare.

Në kushtet **procedurale**, ndërkaq, bëjnë pjesë ato kushte që shteti duhet t'i respektojë në secilën situatë të gjendjes së jashtëzakonshme apo të luftës: sipas nenit 15 paragrafi 3 të **KEDNJ**-së, shteti që shfrytëzon të drejtën e suspendimit detyrohet që të njoftojë sekretarin e përgjithshëm të **KE**-së. Një njoftim i tillë duhet të specifikojë masat e ndërmarra, arsyet për marrjen e tyre dhe datën kur masat e tilla pushojnë së vepruari.

Siç dihet në Kosovë, dispozitat e **KNDCP**-së dhe të **KEDNJ**-së kanë status të normave kushtetuese dhe duhet të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga të gjithë. Dispozitat e këtyre dy instrumenteve ndërkombëtare, së bashku me nenin 131 të Kushtetutës, përcaktojnë juridiksionin

material të Gjykatës sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë së gjendjes së jashtëzakonshme. Ai juridiksion në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, ***grosso modo***, përfshijnë kontrollin kushtetues të aktit të parë mbi vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të të gjitha veprimeve që ndërmerren gjatë saj me qëllim të ratifikimit nga organet mbikëqyrëse të gjendjes së jashtëzakonshme – Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese.

Sa i përket aktit me të cilën shpallet gjendja e jashtëzakonshme, Gjykata kontrollon nëse ekziston situata e atillë që mund të subsumohet (nënvihet) nën kuptimin e gjendjes së vërtetë të jashtëzakonshme. Me fjalë të tjera, këtu Gjykata vendos nëse janë plotësuar kushtet për shpalljen e gjendjes së tillë. Situatat e krijuara që shërbejnë si shkak për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme mund të jenë të natyrës njerëzore (lufta, konflikti i madh civil, çrregullimet e rënda në vend etj.) apo të natyrës ekstra-njerëzore (tërmetet, sëmundjet epidemike të natyrës katastrofale etj.). Në kryerjen e këtij kontrolli, Gjykata shërben si një mekanizëm i kontrollimit të ekzistimit të shkaqeve për shfrytëzim të kompetencës për vendosje të gjendjes së jashtëzakonshme dhe të caqeve të aktit mbi shpalljen e saj. Nuk do mend që shkaqet mund të ekzistojnë dhe të jenë të dukshme, mirëpo akti i shpalljes duhet të japë vlerësimin e vet nëse shpallja e gjendjes është nevojë e domosdoshme e shtetit si dhe caqet e derogimeve (shmangieve) nga standardi i respektimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Sa i përket aspektit të dytë, Gjykata kontrollon veprimet e ndërmarra prej momentit të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme e deri në përfundim të saj. Kjo nënkupton që Gjykata kontrollon arsyeshmërinë dhe proporcionalitetin e masave të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, nevojën për suspendimin e të drejtave të njeriut, gjykon nëse ndonjë nga të drejtat absolute të njeriut janë shkelur gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe nëse është tejkaluar arsyeja për të vazhduar gjendja e tillë. Kushtetuta dhe parimet e përfaqësimit demokratik nuk mund të ndryshohen apo suspendohen gjatë kohës sa zgjatë gjendja e jashtëzakonshme sepse një gjë e tillë i hap rrugë abuzimit dhe arbitraritetit të pafund. Këtë e ka konstatuar **Komisioni i Venecias** në rastin e dekreteve të Presidentit të Republikës së Turqisë **Recep Tayyip Erdoğan**, përmes të cilëve ai ka bërë shkarkimin e kryetarëve të komunave duke i zëvendësuar ata me lojalë të vet, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme që ekziston atje që nga korriku i vitit 2016. Kjo nuk përbën standard sepse nuk mund të prishen organet lokale të zgjedhura përmes votës së lirë. (Cf. European Commission

for Democracy Through Law (Venice Commission), *Turkey: Opinion on the Provisions of the Emergency Decree Law No. 674 of 1 September 2016 Which Concern the Exercise of Local Democracy in Turkey*, adopted by the Venice Commission at its 112th Plenary Session, Venice, 6-7 October 2017, Strasbourg, 9 October 2017, Opinion No. 888/2017, CDL-AD(2017) 021, në veçanti paragrafët 80-92 dhe përfundimet e opinionin në paragrafët 93-101.)

Kjo si më sipër është vitale sa i përket nevojës për të siguruar që gjendja e jashtëzakonshme nuk keqpërdoret nga institucionet ekzekutive në dëm të të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe në dëm të formës dhe caqeve përmbajtjesore kushtetuese për ushtrim të pushtetit shtetëror, duke kontrolluar vazhdimisht nëse masat e ndërmarra janë në linjë me parimin e proporcionalitetit. Në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme hyn edhe kohëzgjatja e saj: organi përfaqësues dhe ligjvënësi i sovranit, parlamenti nacional, kujdeset që gjatë mbikëqyrjes së gjendjes së jashtëzakonshme mos të lejohet që gjendja e njëjtë të shndërrohet në gjendje permanente, përkatësisht të degjenerojë në një diktaturë. Kufizimi kohor i gjendjes së jashtëzakonshme përbën një ndër standardet kushtetuese të botës perëndimore të demokracive liberale kushtetuese. Kosova nuk bën përjashtim në këtë aspekt (Cf. Neni 131. 5 & 6 ["Gjendja e Jashtëzakonshme"] i Kushtetutës).

Edhe këtu, në dy aspektet, si sa i përket aktit ashtu edhe sa i përket veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme parimi i proporcionalitetit del si definues i kushtetutshmërisë së gjendjes së jashtëzakonshme marrë si tërësi (akti mbi shpalljen dhe veprimet e ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e autoriteteve publike). Një gjë standard të tillë e ka përmbledhur në mënyrë të shkëlqyer GJEDNJ në rastin ***Lawless v. Ireland*** (No. 3, Judgment of 1 July 1961, [law part] § 22), në të cilin ka konstatuar si vijon:

> Qeveria e secilës palë kontraktuese ka të drejtë që në rast lufte apo situate të jashtëzakonshme që rrezikon jetën e shtetit të ndërmarrë masa me të cilat suspendon detyrimet e saj ndaj Konventës përveç atyre të numëruara në nenin 15, paragrafi i dytë, me kusht që masat në fjalë të jenë të kufizuara ekskluzivisht në nevojat e situatës dhe nuk bien ndesh me detyrimet tjera nga e drejta ndërkombëtare [...].

Gjykata merr vendime përfundimtare, të cilat janë efektive, që nënkupton se mund t'i shpallë kundër-kushtetuese dhe t'i përjashtojë nga rendi juridik veprimet që janë ndërmarrë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme,

përfshirë vetë aktin e shpalljes së gjendjes së tillë. Në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata vishet me detyrën e garantimit që gjendja e jashtëzakonshme të mos keqpërdoret nga pushteti, duke u bërë institucioni i vetëm i autorizuar nga kushtetuta për të kontrolluar kushtetutshmërinë dhe arsyeshmërinë e gjendjes dhe masave të ndërmarra në të. Këtë detyrë Gjykata duhet ta ushtrojë shumë shpejt: sipas nenit 35 ["Afati"] të **Ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**, afati është shumë i shkurtër, vetëm 24 orë.

Kapitujt IX–XI. Institucionet e pavarura në Republikën e Kosovës (fq. 503–514). Marrëdhëniet ekonomike sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (fq. 515–520). Qeverisja lokale dhe organizimi territorial sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (fq. 521–532).

Këtu trajtojmë tre kapituj përnjëherë për shkak se nuk kanë substancë analitike dhe paraqesin ekskluzivisht përshkrime dhe përfolje të teksteve juridike, të Kushtetutës, ligjeve respektive dhe infrastrukturës tjetër ligjore. Përveç kësaj, asnjë burim relevant i huaj apo tjetër nuk është shfrytëzuar për prodhimin e tekstit të asnjërit prej këtyre kapitujve, gjë që nuk është e zakonshme në një tekst universitar të së drejtës kushtetuese. Këto kanë qenë arsyet pse këtyre kapitujve u mungon analiza analitike.

Kapitulli IX përbëhet prej tetë seksionesh. Në këtë kapitull nuk ka asnjë rresht kreativ të natyrës akademike, profesionale apo shkencore që do t'u shërbente qëllimeve didaktike të lëndës e drejta kushtetuese, të cilën e mësojnë studentët, lexuesit dhe të tjerët që duan të përndriten rreth çështjeve themelore që kanë të bëjnë me institucionet dhe agjencitë e pavarura në sistemin kushtetues kosovar. Përmbajtja e asaj që figuron në këtë kapitull nuk është asgjë tjetër pos përshkrim ***ad literam*** i Kushtetutës, ligjeve dhe i dokumenteve të tjera publike, të cilat gjenden në internet në qasje të hapur për çdokënd. Lexuesi nuk e ka të qartë, as studenti e as dikush tjetër, se përse formohen institucionet dhe agjencitë e tjera, si dhe cili është statusi i tyre kushtetues. Thënë me fjalë të tjera, autorët tanë nuk e kanë të qartë se cilit pushtet i takojnë dhe çfarë natyre kushtetuese kanë këto institucione dhe agjenci të pavarura në sistemin kushtetues kosovar. Këto janë thelbi i problemit. Se kjo është kështu shihet nga komenti i tyre në fq.

511 ku thonë se "të ashtuquajturat agjenci të pavarura, janë institucione të pavarura të cilat krijohen nga Kuvendi i Kosovës si dhe funksionojnë me ligj të veçantë. Përveç Kuvendit, agjensi të pavarura ka krijuar dhe ka mbikëqyrur edhe Qeveria e Republikës së Kosovës". Në çdo tekst serioz të së drejtës kushtetues sqarohet në pjesën e vështrimeve të përgjithshme ashtu që lexuesi ta ketë të qartë esencën lidhur me këto institucione dhe agjenci të pavarura kushtetuese. Kjo pyetje kërkon qasje krahasuese dhe analizim të institucioneve dhe agjencive të pavarura në sistemet kushtetuese të vendeve të tjera, në veçanti të vendeve ish-komuniste. Një sqarim modest të kësaj çështje e kemi dhënë në pjesën tonë të analizës për kapitullin mbi presidentin e Kosovës. Ftojmë lexuesin t'i kthehet asaj analize për ta kuptuar sado pak natyrën juridike, vendin dhe pozitën e institucioneve dhe agjencive të pavarura në sistemin kushtetues të Kosovës.

Kapitulli X i ka gjithsej 13 seksione. Edhe ky kapitull kryesisht është përshkrues, pa asnjë sqarim të koncepteve kushtetuese nga prizmi krahasues. Edhe aty ku ka gjoja sqarime, citohen nenet e Kushtetutës të cilat në thelb japin pak sqarime të vetëkuptueshme për studentin dhe lexuesin e zakonshëm. Për dallim nga kapitulli pararendës, në këtë kapitull citimet nga Kushtetuta, në fakt, nuk janë të sakta dhe nuk e pohojnë atë që thonë autorët tanë. Kjo është kështu, pra që teksti kushtetues që citohet nuk përputhet me pohimet e autorëve tanë, sepse një gjë e tillë nuk i shkon natyrës së normave kushtetuese. Mjafton të krahasohen me tekstin kushtetues që citohet me fusnotat si vijon: 1593, 1595, 1597, 1598, 1600, 1602, 1605.

Kapitulli XI i ka 14 seksione. Kapitulli po ashtu është përshkrues dhe nuk përmban asnjë trajtim teorik lidhur me konceptet fundamentale mbi vetëqeverisjen lokale, lindjen dhe zhvillimin e saj, si dhe mbi specifikat kosovare të këtij lloji të pushtetit publik. Në veçanti autorët kanë lëshuar rastin për të sqaruar natyrën juridike të juridiksionit shtesë të Gjykatës Kushtetuese nga neni 113.10 i Kushtetutës, që ka të bëjë me procedurën e shkarkimit të kryetarit të komunës.

Kapitujt XII–XIII. Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve pakicë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (fq. 533–561). Amendamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (fq. 565–586).

Përgjithësisht

Në këtë pjesë diskutojmë përnjëherë dy kapitujt e fundit të librit. Radhitja e tyre në fund është arsyeja e vetme që kemi vendosur për t'i trajtuar së bashku, jo pse kanë një lidhshmëri tematike ndërmjet veti. Në fakt, asnjëri nga këta dy kapituj nuk kanë lidhshmëri tematike me të drejtën kushtetuese si lëndë që mësohet në fakultetet juridike bashkëkohore për faktin se tematikisht e kanë vendin nëpër kapitujt dhe seksionet paraprake që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe amendamentimin kushtetues respektivisht. Në ndërkohë që për kapitullin e fundit edhe mund të ketë një arsyetim për faktin se, amendamentimi kushtetues zakonisht gjendet në fund të tekstit kushtetues. Kjo, megjithatë, nuk domethënë se në librat mbi të drejtën kushtetuese kapitulli i fundit bën fjalë për amendamentimin kushtetues. Asnjë libër i të drejtës kushtetuese në rajon dhe në vendet evropiane, që ky autor i ka konsultuar, përfshirë Shqipërinë, nuk ka një trajtim të tillë të amendamentimit kushtetues. Kapitulli pararendës, ndërkaq, as në tekstin kushtetues dhe as si materie e së drejtës kushtetuese si lëndë mësimore universitare nuk e ka vendin në fund të një teksti universitar mbi të drejtën kushtetuese: kushtetutat e vendeve liberale demokratike zakonisht liritë dhe të drejta e njeriut i normojnë në kapitullin e dytë (në të shumtën e rasteve) ose në të parin (në disa prej rasteve). Kushtetuta e Kosovës i takon kategorisë së parë të kushtetutave. Tekstet universitare mbi të drejtën kushtetuese, asnjëherë dhe në asnjë rast nuk trajtojnë liritë dhe të drejtat e njeriut në kapitullin e parafundit ose të fundit të tekstit. Kjo, megjithatë, nuk ka ndonjë rëndësi materiale sepse studenti dhe lexuesi do ta lexonin dhe do të mësonin çështjet lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe mbi amendamentimin kushtetues, kudo që gjendet ai në një tekst universitar. Ajo që ka rëndësi konsiston në atë se në këto dy kapituj pak ka për t'u mësuar: autorët sërish kanë ndjekur rrugën e manipulimit të literaturës apo të citimit fiktiv të saj. Kjo vlen për kapitullin XII, sepse

kapitulli në vijim, kapitulli i fundit, Kapitulli XIII nuk ka literaturë të huaj: çdo gjë që është thënë aty paraqet parafrazim dhe ripërsëritje kaotike e teksteve kushtetuese, ligjore dhe teksteve e dokumenteve të tjera juridike pozitive.

Të shohim si duket kjo për secilin kapitull. Për përmbajtjen e tekstit të dy kapitujve si më sipër flasim në pjesën analitike, kurse këtu në vijim diskutojmë, njëjtë si në kapitujt e tjerë, pjesët që kanë të bëjë me literaturën dhe qasjen metodologjike inekzistente të autorëve tanë.

Kapitulli XII përbëhet prej 23 seksioneve dhe karakterizohet, njëjtë si kapitujt pararendës, me manipulim brutal të literaturës dhe me një narrativ tërësisht kaotik. Ajo pjesë e tekstit që ka harmoni strukturore dhe logjike, i referohet pjesëve të Kushtetutës apo ligjeve dhe akteve të tjera të përfolura nga autorët tanë.

Manipulimi brutal nis me manipulimin brutal të literaturës së përdorur në fusnotën nr. 1649. Autori **Vincent Robert Johnson**, në një shkrim të tij me titull "The French Declaration of the Rights of Man and of Citizens of 1789, the Reign of Terror, and the Revolutionary Tribunal of Paris", botuar në *Boston College of International and Comparative Law* (vol. 13, no. 1, 1990, fq. 2-45), flet në mënyrë të detajuar për historinë kushtetuese të **Revolucionit Francez** (1789), ndikimin e tij në ish-kolonitë franceze dhe nëpër botë, në veçanti për ndikimin e **Deklaratës mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit** (1789), dokumentit me të cilin nisi ky revolucion, në praktikën gjyqësore të **Gjykatës Supreme të SHBA**-së. Autori në këtë shkrim tërësisht hulumtues dhe analitik gjen se, në Gjykatën Supreme të SHBA-së, ky dokument nuk ka pasur asnjë ndikim, gjë që nuk është rastësi me ***Magna Carta Libertatum*** (1215), kurse në disa gjykata shtetërore dhe federale ka pasur raste të izoluara të përmendjes së saj. Kjo shpjegohet, sipas autorit, me faktin që sistemi kushtetues amerikan në thelb është i ndikuar nga sistemi *common law* (e drejta e përgjithshme), më shumë se sistemi i kodifikuar francez, por edhe me vetë dhunën e madhe të ushtruar nga revolucionarët francez dhe rezervat ndaj saj në SHBA. Autori konstaton se teksti i Deklaratës së vitit 1789 paraqet një ndër aktet juridike më të mira që ka prodhuar civilizimi ligjor perëndimor dhe se ndikimi i saj, që ne sot e marrim si të mirëqenë, ka qenë rezultat i një historie tragjike njerëzore. Sa i përket rolit të gjyqeve dhe dështimit të tyre në kohën e sundimit të territorit (1789-1794), autori fajëson kontekstin historik të gjyqësorit francez në kohën e mbretërisë franceze njëmijë-vjeçare dhe pozitën jo të pavarur që ka pasur gjyqësori në monarkitë absolute në për-

gjithësi. Nga ky shkrim, në mënyrë të qartë shihet se asnjë fjalë nuk thuhet për ndikimin e saj në Kushtetutën e SHBA-së. Nuk ka mundur ta thotë një autor serioz një gjë të tillë që thonë autorët tanë sepse **Kushtetuta e SHBA**-së është nxjerrë para **Deklaratës mbi të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit**, përkatësisht më 17 shtator 1787, kurse ***Bill of Rights*** është ratifikuar më 15 dhjetor 1791. D.m.th., jo vetëm në fq. 2 & 3, por në asnjë fq. të krejt këtij shkrimi hulumtues nuk del ajo që thonë autorët tanë. Objekt hulumtimi, në fakt, nuk ka qenë ndikimi i Deklaratës së vitit 1789 në Kushtetutën e SHBA-së, por ekskluzivisht në gjyqësorin amerikan dhe në arsyet pse kjo deklaratë fare nuk ka pasur ndikim në këtë gjyqësor, në veçanti në **Gjykatën Supreme të SHBA**-së. Arsyet pse Deklarata e vitit 1789 nuk ka pasur asnjë ndikim, nuk i ka shpjeguar askush më mirë se dijetari **Georg Jellinek** në veprën e tij me titull ***The Declaration of the Rights of Men and Citizens*** (Henry Holt and Company: New York, 1901). Ky autor i ditur në këtë libër na tregon gjerësisht pse ndikimi i Kushtetutës së SHBA-së ka qenë vendimtar në tekstin e Deklaratës së vitit 1789. **G. Jellinek** në fillim sqaron se vepra ***Du contrat social ou Principes du droit politique*** (1762) e dijetarit francez **J.J. Rousseau** nuk ka qenë dhe nuk ka mund të jetë burim inspirimi për faktin e thjeshtë se, sipas teorisë së kontratës sociale, individi bart te shteti pakthim çdo të drejtë individuale dhe ngelet tërësisht nën pushtetin ekskluziv të shtetit (**G. Jellinek**, vep. e cit. fq. 8-12). Në kapitullin në vijim, kapitulli III, me një elokuencë të pashoq, autori jep analizën e burimit real të Deklaratës së vitit 1789: duke analizuar kartat mbi të drejtat e njeriut, të nxjerra nga 13 ish-kolonitë britanikë të Amerikës së Veriut, autori konstaton se burim i vërtetë dhe inspirim real i Deklaratës së vitit 1789 kanë qenë pikërisht këto ish-koloni britanike, në veçanti **Deklarata e Shtetit Virxhinia mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut** (1776). Kjo provohet edhe me faktin se vetë propozuesi i saj ka qenë ushtaraku dhe aristokrati **Marquis de Lafayette** (1757-1834), revolucionari francez që kishte luftuar më parë për lirinë e SHBA-vë (**G. Jellinek**, vep. cit. fq. 13-21& 22-26).

Kulmi i manipulimit me literaturë, ndërkaq, janë fusnotat nr. 1671-1677 të faqeve 540-541: të gjitha këto fusnota dhe teksti që i shoqëron janë marrë *ad literam*, në mënyrë të paturpshme, nga libri me përmbledhje i edituar nga autorët **Afrim Hoti** & **Igor Kosir** me titull ***European Perspectives of the Western Balkan Countries (I)*** (botim i AAB College: Prishtina, 2015). Lexuesi këtë mund ta vërtetojë nëse konsulton fq. 107-108 të kësaj përmbledhje të këtyre dy autorëve. Në fakt, fq. në fjalë janë pjesën e

punimit të autorit **Zenun Halili** me titull **The Protection of Ethnic and Linguisitic Minorties in Europe**, botuar në fq. 103-128 të këtij libri me përmbledhje. Për dallim nga origjinali, autorët tanë nuk kanë riprodhuar siç duhet as fusnotat e as tekstin që i shoqëron, cilësi kjo e çdo plagjiaturë.

Për dallim nga kapituj tjetër, ky kapitull ka më shumë fusnota dhe citime fiktive. E tillë është fusnota nr. 1650. Ky është një citim fiktiv i diçkaje që nuk ekziston: citohet fq. 4 e materialit hulumtues të **Danish Institute for Human Rights** (2014), që titullohet ***The Constitutional Protection of Human Rights*** (2012), e cila i takon parathënies së këtij materiali. Kjo domethënë se autorët tanë citojnë në mënyrë fiktive fq. e parë të parathënies, nga ku nuk mund të nxirret asnjë përfundim që e nxjerrin autorët në fq. 533. Pse? Sepse në fq. 4 të materialit në fjalë thuhet si vijon:

> Në Evropë, Norvegji, kurse në Azi, Nepali, janë duke debatuar projektet e tyre kushtetuese dhe hapësirën që duhet ta ketë mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Për të provuar konstatimin e tyre fiktiv, autorët tanë është dashur ta lexojnë tërë materialin dhe të shohin së çfarë ka ndodhur në ndërkohë në Norvegji dhe Nepal, jo të japin konstatime vetëm përmes leximit të fq. së parë të materialit si më sipër (sic!). Në fakt, siç kemi theksuar më herët, autorët tanë në 99 për qind të rasteve kanë lexuar dhe cituar vetëm dy-tri fq. e para të materialit të cituar që e kanë përdorur si burim literature.

I njëjtë, pra tërësisht fiktiv është edhe burimi i cituar në fusnotën nr. 1657: ajo që thuhet se ka thënë autori i cituar, në fakt është dispozita e nenit 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] i Kushtetutës së Kosovës, i cili thotë si vijon:

> Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Njëjtë me si më sipër është edhe fusnota nr. 1685: në këtë vend citohet **Stipe Mesić** dhe libri i tij me kujtime që flasin për vitet e fundit të ish-Jugosllavisë. Ky libër nuk ka pjesë historike dhe paraqet një rrëfim personal dhe ekskluziv të kryetarit të fundit kroat të ish-Jugosllavisë. Fjala është për librin e tij me titull *Si u shkatërrua Jugosllavia* (2011). Autorët tanë nuk citojnë fq. të këtij libri, të cilat do të konfirmonin atë që ata thonë. Mosdhënia e faqeve konkrete është e kuptueshme sepse **Stipe Mesić** fare nuk flet për diçka të ngjashme, pra për persekutimin e shqiptarëve nën ish-Jugosllavi përgjatë historisë, por vetëm për vitet e fundit të ekzistimit të atij

shteti. Autori i këtyre rreshtave i referohet versionit në gjuhën kroate të librit të njëjtë.

Kapitulli XIII përbëhet prej 16 seksioneve. Si i tillë, sikundër u tha më sipër, kapitulli nuk ka ndonjë burim të literaturës së huaj. Kjo është arsyeja që nuk kemi thënë asgjë sa i përket autenticitetit të burimit të prodhimit të tekstit nga ana e autorëve tanë. Përveç kritikës analitike, që pason në vijim, për këtë kapitull sa i përket metodologjisë mund të konstatojmë në mënyrë krejt apodiktike se fq. 584-586 nuk e kanë vendin në këtë kapitull por në pjesën për sistemin e drejtësisë. Në këto faqe, autorët tanë kanë folur për **Gjykatën Speciale** duke përdorur sistemin ***copy & paste*** të prodhimit të tekstit: kjo kështu dëmton studentin dhe lexuesin, të cilët kurrë nuk do ta kuptojnë se çka është Gjykata Speciale; si dhe pse u themelua; cili është juridiksioni i saj; çka domethënë një gjykatë hibride; cilat janë kompetencat e saj; dhe kështu me radhë. Këto i kemi sqaruar ne për lexuesin tonë në komentet tona për kapitullin mbi sistemin e drejtësisë, aty ku e ka vendin ky trajtim mbi **Gjykatën Speciale**.

T'i kthehemi tani substancës së tekstit, përmbajtjes së prodhuar në një kohë që kaq shumë literaturë është abuzuar apo cituar në mënyrë fiktive (kapitulli XII), përkatësisht është riprodhuar në mënyrë dogmatike pa asnjë qasje metodologjike apo analizë kritike të teksteve, në veçanti duke përdorur metodën krahasimore të hulumtimit dhe analizës.

Analiza kritike

Kapitulli XII tregon qartë se autorët tanë besojnë që ekzistojnë mbinorma kushtetuese, përkatësisht se në Kosovë ka hierarki të normave kushtetuese. Kjo është gabim! Autorët tanë nuk kuptojnë dhe nuk dinë të bëjnë dallimin mes parametrit kushtetues, të cilin e përdor një gjykatë kushtetuese dhe çdo jurist kushtetues me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së normave kushtetuese, në njërën anë, dhe kontrollit paraprak (preventiv) kushtetues të amendamenteve kushtetuese, në anën tjetër. Ky gabim i tyre ka bërë që disa nga normat kushtetuese, në sytë e tyre të duken si mbinorma apo supernorma kundrejt tjerave.

Aspak më mirë nuk është gjendja në fq. 538-539. Në këto fq. autorët tanë zbulojnë kufizime ekstra-kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut, pa i treguar studentit dhe lexuesit se për cilat norma kushtetuese behët fjalë. Nuk ka nevojë t'u tregohet studentëve dhe lexuesit për kufizimet konkrete por për kufizimet si kategori kushtetuese. Shikuar nga ky

kënd, pra nga këndvështrimi kushtetues, kufizimi i lirive edhe të drejtave të njeriut në Kosovë çdoherë duhet të bëhet duke respektuar të a.q. parimin e proporcionalitetit. Ky është një standard evropian i mishëruar thellë në praktikën e **GJEDNJ**-së dhe të cilin Kosova duhet ta vërë në jetë si një detyrim të saj kushtetues. Në vend se të shikojnë redaktimin e dispozitës së nenit 55 të Kushtetutës, e cila ngërthen dhe shtjellon parimin e proporcionalitetit ashtu siç definohet në praktikën e **GJEDNJ**-së, autorët tanë flasin për të në një mënyrë krejt dogmatike dhe duke ripërsëritur në mënyrë tautologjike dispozitat e tij.

Proporcionaliteti përbën njërin ndër parimet themelore të **GJEDNJ**-së, i cili mundëson kontrollimin e veprimeve të autoriteteve nacionale të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës me të cilat kufizohen të liritë dhe të drejtat e garantuara me **KEDNJ**. Zbatimi i këtij parimi, *inter alia*, jep përgjigjen në pyetjet si vijon: Kur është arrestimi i një personi joproporcional krahasuar me peshën e krimit të kryer? Si të balancohet liria e shprehjes së gazetarëve me të drejtën e privatësisë së një personi publik? A ka pasur mjete të tjera në dispozicion shteti kur vendos lidhur me kufizimit e lirisë së ushtrimit të profesionit të mjekut privat dhe kështu me radhë. Në raste si këto ekziston një konflikt mes lirisë dhe të drejtës individuale dhe interesit publik apo mes lirisë dhe të drejtës individuale me një liri dhe të drejtë tjetër të individit tjetër. Vënia në jetë e parimit të proporcionalitetit për të balancuar interesat në konflikt ka qenë dhe ngelet një teknikë rutinë e praktikës së **GJEDNJ** me rastin e dhënies së përgjigjeve në aplikacionet e panumërta të parashtruara nga individët dhe personat e tjerë juridikë. Në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës**, testi i proporcionalitetit përbën një teknikë rutinore të cilën e përdor Gjykata me rastin e zgjidhjes jo vetëm të kërkesave individuale por edhe të atyre që për objekt kontrolli kushtetues kanë normat e përgjithshme. U mor vesh, parimi i proporcionalitetit nuk përbën një normë të shkruar të **KEDNJ**-së, por pjesë përbërëse dhe invencion i **GJEDNJ**-së. Në Kosovë, sipas nenit 53, ne jemi të detyruar t'i përmbahemi rreptësisht praktikës së **GJEDNJ**-së, përkatësisht të ndjekim atë lloj interpretimi të **KEDNJ**-së që e prodhon **GJEDNJ**.

Pjesa tjetër e këtij kapitulli paraqet një përshkrim të asaj që zbatohet në Kosovë dhe që njihet si modeli i demokracisë konsociacionale. Këtë koncept të modelit kushtetues kosovar, siç e kemi thënë më herët disa herë, autorët tanë nuk e kanë fare të qartë. Vështirë është të gjendet një libër serioz mbi të drejtën kushtetuese që nuk diskuton **demokracinë konsociacionale** dhe arkitektin ideor të saj, **Arend Lijphart** (sic!). Studenti

dhe lexuesi kanë nevojë të lexojë një literaturë që u mundëson zotërimin e aparaturës konceptuale të kategorive themelore të demokracisë kushtetuese dhe llojeve të saj, jo të përtypë tekstet bruto të kushtetutës, ligjeve dhe dokumenteve të tjera juridike.

Edhe në këtë kapitull ka gjëra interesante për studentin dhe lexuesin, siç është zbulimi i një perandorie të re: në fq. 540, autorët flasin për Perandorinë Prusiane. Zbulim tjetër i autorëve tanë është ai që ka të bëjë me zbulimin e një dege të re të së drejtës publike: në fq. e njëjtë, autorët tanë flasin për "ligjin e përgjithshëm ndërkombëtar dhe ligjin zakonor". Margaritari i fundit zbulimor është ai i zbulimit të një bashkësie specifike njerëzore që po jetuaka në Kosovë: në fq. 546 flasin për "minoritetet pakicë". Nuk ka nevojë të shpjegojmë sa shumë e hutojnë studentin konceptet kushtetuese që nuk gjenden në tekstin kushtetues dhe në literaturën krahasuese mbi të drejtën kushtetuese.

Kapitulli XIII trajton amendamentimin e Kushtetutës së Kosovës sipas një qasje ***déjà vu***: një ripërsëritje jokritike, dogmatiko-eklektike e gjërave të njëjta, të cilat janë thënë në kapitujt paraprakë me dhjetëra herë. Në këtë kapitull, autorët tanë shpërfaqin një jokonsistencë me atë që kanë thënë më herët. Ajo që duhet të na shqetësojë, megjithatë, nuk ka të bëjë me jokonsistencën e tyre por me gabimet tmerrësisht të thella në aspektin profesional dhe shkencor dhe me trajtimin thellësisht jodidaktik të materies: autorët akoma nuk e kanë të qartë se ekziston një dallim i madh mes amendamentimit dhe rishikimit kushtetues. Mjafton që studenti dhe lexuesi të shikojnë fq. 581 të librit dhe ta krahasojnë me fq. 160-164 dhe me komentet tona për këto faqe.

Didaktikën anash, në vijim lexuesit tonë i ofrojmë disa lëshime serioze shkencore dhe profesionale për çështjet si vijon:

- të vërtetën mbi rolin dhe pozitën kushtetuese të Presidentit të Kosovës sipas ndryshimeve të propozuara kushtetuese: a kanë qenë ato propozime për ta shndërruar Kosovën në një sistem gjysmëpresidencial, siç e thonë dhe besojnë autorët tanë, apo për ta bërë edhe më të qartë pozitën e shefit të shtetit kosovar në kushtet e një sistemi ekzistues parlamentar (Cf. 565-575);
- keqkuptimet e fuqisë juridike të normave të Pakos Ahtisaari lidhur me komunitetet e Kosovës (Cf. 575-583); dhe, së fundi,
- rolin dhe statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin kushtetues dhe juridik të Kosovës (Cf. fq. 580-581).

Pjesa dërrmuese e këtij kapitulli përbën elegji për kalimin në sirtarët e

historisë së mbi 60 për qind të amendamenteve të propozuara nga Komisioni Kushtetues, i cili udhëhiqej nga autori i parë i librit që analizojmë në mënyrë kritike. Fokusi i elegjisë, në fakt, kryesisht ka të bëjë me amendamentet lidhur me Presidentin e Kosovës (fq. 567-575). Sikundër dihet, Gjykata Kushtetuese pati theksuar se amendamenti që propozon largimin nga detyra të shefit të shtetit, por edhe të çdo zyrtari tjetër të lartë shtetëror, të zgjedhur sipas Kushtetutës, domosdo që bie ndesh me Kushtetutën. Mandatet e marra sipas procedurës kushtetuese mund të ndërpriten dhe mbarojnë vetëm sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me kushtetutë dhe asnjëherë ndryshe. Kjo këtu nuk përbën esencën e gabimeve të autorëve tanë por besimi i thellë i tyre se ato amendamente kanë pasur për qëllim që të qartësonin siç duhet pozitën gjysmëpresidenciale të shefit të shtetit në Kosovë (Cf. fq. 568) dhe faktin se, gjithnjë sipas tyre, mungesa e konsensusit politik ka çuar në mosmiratimin e amendamenteve të propozuara kushtetuese me të cilat, *inter alia*, do të ndryshohej pozita dhe roli i Presidentit të Republikës në Kosovë (565 & 575). Esenca e mosmiratimit të tyre ka qenë shpallja si jokushtetuese e pjesës dërrmuese të amendamenteve. Sikundër dihet, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjithë, përfshirë gjyqësorin. Kështu thotë neni 116 ["Efekti Juridik i Vendimeve"] i Kushtetutës. Për këto arsye, gabim i madh është të mësohen studentët dhe lexuesit që mosmiratimi i tyre ka qenë si pasojë e mungesës së konsensusit politik dhe se vendimi i Gjykatës Kushtetuese paraqet vërejtje (Cf. fq. 575). Ky është fjalor politik dhe mendim konjuktural që nuk duhet të përdoret në një tekst të së drejtës kushtetuese.

Besimi tjetër i autorëve konsiston në atë se ndryshimet e propozuara kushtetuese si më sipër kanë pasur për qëllim saktësimin e pozicionit gjysmëpresidencial të Presidentit të Kosovës sepse, gjithnjë sipas tyre, mbi gjysma e 30 kompetencave të Presidentit të Kosovës janë të natyrës ekzekutive. Në vijim me këtë, autorët tanë po ashtu gabojnë kur besojnë se mund të ndryshohet roli dhe pozita e Presidentit të Kosovës pa ndryshuar sistemin e marrëdhënieve të ekzekutivit kosovar me parlamentin (sic!). Sikundër e kemi sqaruar në pjesën tonë të analizës mbi Presidentin e Kosovës dhe historikun e krijimit të shefit të shtetit në një sistem parlamentar kushtetues, asnjë kompetencë e Presidentit të Kosovës nuk ka natyrë ekzekutive siç nuk kanë pasur natyrë të tillë as vetë propozimet për amendamentim, të cilat Gjykata Kushtetuese i shpalli si jokushtetuese me Aktgjykimin KO 29/12 dhe 48/12 të datës 20 korrik 2012 (sikundër u tha, mbi 60 për qind të tyre). Ato propozime që kanë pasur të bëjnë me saktë-

simin e koordinimit të Presidentit me Qeverinë në lëmin e politikës së jashtme, emërimin e shefit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), themelimin e përfaqësive të jashtme diplomatike dhe kështu me radhë janë as më pak e as më shumë se instituti i kundërfirmës, që gjendet në shumicën e kushtetutave të vendeve me sistem parlamentar të qeverisjes. Ky institut e liron nga përgjegjësia shefin e shtetit, i cili kundërfirmos vendimet e ekzekutivit (kryeministrit apo ministrave) në vijim të ushtrimit të detyrave të tyre kushtetuese dhe ligjore. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, se tërë përgjegjësia për emërimin e shefit të **AKI**-së, themelimin e përfaqësive diplomatike në botën e jashtme dhe për rastet e tjera të ushtrimit të kompetencave zinxhirore ku shefi i shtetit është i fundit në proces të formimit të vendimit, bie mbi ekzekutivin dhe ministrat e resorëve përkatëse, kurse nënshkrimi i shefit të shtetit ka vetëm natyrën e kundërfirmës. Në shumë kushtetuta të botës, lirimi nga përgjegjësia i shefit të shtetit në këto raste parashikohet në mënyrë shprehimore. Në Kosovë ky nuk është rasti, mirëpo një gjë e tillë nënkuptohet sepse kjo paraqet një standard të përgjegjësisë së shefit të shtetit në një regjim parlamentar kushtetues të qeverisjes, qoftë në një mbretëri apo republikë.

Sa i përket natyrës juridike të dispozitave të Pakos Ahtisaari, besojmë se mjaft kemi thënë dhe sqaruar në kapituj paraprak. Autorët sërish nuk e kanë të qartë natyrën e tyre juridike: ai dokument ka qenë shtjellim paraprak i demokracisë konsociacionale në Kosovë, e cila duhej të instalohej pas pavarësisë së vendit. Ky dokument nuk e ka bërë Kushtetutën e vitit 2008 si dokument inferior, por vetëm ka shërbyer si udhëzues kalimtar për kohën e transicionit deri në konsolidim të shtetësisë së Kosovës për një periudhë të pacaktuar. Ai dokument nuk ka vënë standarde të reja për vazhdimin dhe vlefshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare, siç besojnë autorët tanë në fq. 581, por vetëm ka vënë në spikamë rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare zakonore mbi të drejtën e traktateve. Kjo domethënë se nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë kushtetuta si bazë për rivlerësimin e tyre por standardet ekzistuese për lidhjen, rivlerësimin dhe përfundimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Fundi i fundit, dy këto tema, natyra juridike e dispozitave të **Pakos Ahtisaari** dhe roli e vendi i marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin kushtetues kosovar, nuk e kanë vendin në këtë pjesë të librit por në pjesët e para ku flitet për ndërtimin e sistemit kushtetues kosovar dhe historikun e këtij ndërtimi. Këtë e kanë bërë autorët tanë, siç e kemi konstatuar, në një mënyrë shumë kaotike dhe me gabime themelore profesionale e shkencore. Pse i rikthehen sërish gabi-

meve të njëjta në këtë vend, këtë nuk e kemi të qartë. Më këtë paqartësi në mendim, e cila fundja nuk ka asnjë relevancë, mbyllim, këtë analizë kritike të librit të autorëve tanë më shpresë së kemi dhënë një kontribut modest në përparimin e shkencës dhe profesionit tonë të arsimtarit universitar, shkencëtarit dhe hulumtuesit të devotshëm të dijes juridike.

Përfundim

Kam parë dy autorë të tjerë që kanë trajtuar të drejtën kushtetuese, të dy nga universitetet publike që u hapën në Kosovë viteve të fundit. Ato tekste universitare u takojnë atyre dy universiteteve ku autorët e tyre japin mësim, në ndërkohë që libri që është objekt i kritikës sonë studimore ka përmasa gjithë-kosovare (asnjëherë gjithëshqiptare sepse autorët nga Shqipëria të këtij lëmi shkëlqejnë në trajtimet e tyre teorike dhe pozitiviste). Kjo ka qenë arsyeja kryesore që nuk kam denjuar të shkruaja për dy librat e autorëve të dy universiteteve të tjera kosovare, përkundër të metave jashtëzakonisht të mëdha që kanë: pasojat lokale të atyre dy librave, megjithatë, duhet të adresohen dhe menaxhohen nga vetë kolegët e autorëve të tyre.

Përmbajtja e librit të autorëve tanë, i cili është objekt i studimit tonë kritik, në fillim të lë përshtypje të mirë dhe joshëse për ta lexuar: reflekton, në shikim të parë, materien standarde të lëndës dhe duket premtues për lexuesin. Gjatë leximit të faqeve të para, megjithatë, qartë shihet se përmbajtja nuk është veçse një përmbledhje eklektike e lëndës, gjë që vërtetohet nga trajtimi tërësisht distopik i secilës fazë të zhvillimit të së drejtës kushtetuese, i koncepteve dhe instituteve të saj. Shtjellimi me zigzage, i shoqëruar me manipulim të hapur dhe brutal të literaturës së përdorur në libër, qartazi asnjëherë pa u prekur e lexuar nga ana e autorëve tanë, nuk paraqet veçse një tregim halucinativ dhe të pasaktë në pjesën e vet dërrmuese.

Në vijim për si më sipër, tri përfundime pashmangshëm vijnë ndër mend pas studimit kritik që i kemi bërë librit të autorëve tanë. E para, libri ka një kompozicion dhe narrativ kaotik që e dominon pjesën e tij derrmuese. Në shikim të parë të përmbajtjes së librit, të secilit kapitull e seksion veç e veç, në mënyrë të qartë reflektohet kompozicioni kaotik dhe jokonsistent ashtu që në të shumtën e rasteve nuk ka asnjë lidhje strukturore me tërësinë e kapitullit dhe me librin si tërësi. Në brendi të tekstit, lexuesi do të gjejë një narracion kaotik, të përçartë dhe pas asnjë përmbajtje relevante: në të shumtën e rasteve, narracioni s'korrespondon fare me titullin e kapitullit apo të seksionit. Edhe aty kur korrespondon, përmbajtja është e paqartë dhe e dyshimtë.

Përfundimi i dytë lidhet me literaturën, llojin dhe mënyrën e përdorimit të saj. Sa i përket aspektit formal-metodologjik, autorët përdorin një mënyrë citimi që nuk ekziston askund në rajon dhe, besoj shumë, as gjetiu nëpër botë: nuk më ka ndodhur asnjëherë që të shoh dikund tjetër një mënyrë të tillë citimi, përfshirë kohën e ish-sistemit komunist jugosllav. Sikundër do ta vërejë çdo lexues i librit, autorët tanë citojnë çdoherë nga fillimi secilin burim, në formën e vet të plotë, ani se fizikisht mund të ketë dallim vetëm dy centimetra brenda tekstit të njëjtë (sic!). Jam kureshtar të di se nga buron kjo mënyrë citimi te autorët tanë. Ajo çka e di me siguri të madhe është se në asnjë fazë të studimit në ish-Jugosllavi, në Fakultetin Juridik, nuk janë mësuar metodat si këto të citimit dhe përdorimit të burimeve të literaturës.

Sa i përket aspektit përmbajtjesor të literaturës, ndërkaq, gjërat qëndrojnë edhe më keq: autorët tanë kanë cituar autorë vendorë, duke përdorur si fusnotë autorë të huaj. Edhe atëherë janë cituar autorët vendorë, në të shumtën e rasteve citimi i faqeve është bërë në mënyrë fiktive ashtu që fare nuk korrespondojnë me tekstin e prodhuar nga autorët tanë. Në literaturën shkencore dhe profesionale, kjo quhet manipulim i literaturës dhe përbën shkelje serioze të kodit të etikës profesionale dhe shkencore.

I treti përfundim i referohet substancës së librit të autorëve tanë, përkatësisht se ky libër ka një përmbajtje që nuk ka vlerë për t'u shitur dhe për t'u mësuar nga studentët tanë. Sa i përket kësaj të dytës, nuk është punë e këtij autori për të gjykuar. Le ta gjykojnë organet e institucionet kompetente nëse ky duhet të jetë një libër për studentët e Fakultetit Juridik të të gjitha niveleve. Sa i përket të parës, pra vlerës monetare të librit, fuqishëm mendoj se asnjë cent të vlerës monetare nuk ka ky libër. Për më tepër, mendoj se autorët tanë duhet t'ua kthejnë studentëve dhe krejt atyre që eventualisht e kanë blerë çdo cent të tyre. Do të ishte shumë e ulët nga ana e autorëve nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë, sepse kontributi i tyre në profesion dhe shkencë me këtë libër është tejet i mangët dhe, në fakt, i paqenë. Krahas kësaj, autorët duhet t'u kërkojnë falje publike krejt atyre që kanë paguar për këtë libër duke shpresuar se po blejnë një libër të mirëfilltë profesional dhe shkencor.

Kohë më parë, një profesor i mirënjohur i Fakultetit Juridik u detyrua ta tërheqë nga përdorimi librin e tij sepse, siç u konstatua me të drejtë nga leximi rutinë, libri përmbante një fjali me konstatime fyese për gjininë femërore: kishte thënë ky profesor, në këtë libër të tij që u tërhoq nga përdorimi, se gratë e "përdala" janë të prira për t'u dhunuar më shumë se ato

që nuk janë të tilla. Në rastin që e trajtojmë në këtë shkrim, fjala nuk është për një fjali, por për një libër të tërë që ka dështuar në misionin e vet primar – ofrimin e informacioneve profesionale mbi lëndën e së drejtës kushtetuese. Nga ky libër studentët vetëm sa marrin padije të thellë që nuk korrespondon me asnjë dije profesionale bashkëkohore nga ky lëmë. Autorët e kanë për detyrim, shikuar në këtë kontekst, që së paku të mos marrin asnjë lek nga studentët dhe dashamirët e librit dhe, atyre që tanimë ua kanë marrë, t'ua kthejnë. Kjo për shkak se studentët me siguri që në mënyrë të sinqertë do të kenë besuar, sikur edhe vetë autori i këtyre rreshtave, se po marrin një libër vërtetë profesional dhe të saktë shkencërisht.

Përvetësimi i ideve dhe dijeve të të tjerëve, manipulimi i literaturës, prodhimi i faqeve të tëra me narrativ tërësisht joprofesional dhe joshkencor paraqet një shkelje të rëndë të dinjitetit të të gjithë atyre që seriozisht merren me kërkim hulumtues dhe punë shkencore. Vetëm ata që hulumtojnë dhe bëjnë shkencë në mënyrë profesionale dhe korrekte në pikëpamje etike e kuptojnë sa punë dhe mund të madh kërkon një përpjekje e tillë njerëzore: kërkon sakrificë familjare, sociale dhe shëndetësore. Gjithë ky mundim i madh i të tjerëve, i atyre që merren seriozisht dhe në mënyrë korrekte nga ana etike me hulumtim dhe punë shkencore, shkelet me të dy këmbët në çdo rast kur dikush pa i bërë këto sakrifica përvetëson frytet dhe të mirat e kësaj pune të bërë nga tjerët.

Mënyra si është shkruar ky libër na mëson një gjë themelore: si nuk duhet shkruar një tekst universitar. Duke qenë kështu, ofrimi i tij për studentët, përveçse është joligjor është edhe joetik sepse dëmton rëndë formimin e tyre profesional. Në fakt, kjo e fundit ka qenë arsyeja themelore pse unë i kam hyrë punës për të bërë këtë studim kritik. Rrethana që edhe vetë jam pjesë e edukimit të tyre profesional ka qenë arsye shtesë për të shkruar këtë studim kritik. Sikur të bëhej fjalë për një libër që nuk u dedikohet studentëve, gjërat do të kishin qenë më ndryshe. Duke qenë kështu si janë, mbesim me shpresë se kjo kritikë do të mirëkuptohet. Në të njëjtën kohë besojmë fuqishëm se rreshtat e këtij studimi kritik do të ndihmojnë studentin dhe lexuesin që të korrigjojnë gabimet e rënda profesionale e shkencore të librit të autorëve tanë. Në fakt, këtë tekst e kemi konceptuar si një lloj udhëzuesi për të ndihmuar studentin dhe lexuesin që të orientohen gjatë leximit të librit të autorëve tanë sepse, si i tillë, ka gabime shumë të thella profesionale dhe shkencore që kanë përmbajtje të pasaktë që dëmton çdokënd që e lexon.

Shtojca 1

Reagimi i autorëve Bajrami e Muçaj

PËRGJIGJE NJË KRITIKE JO SHKENCORE, TENDENCIOZE DHE SUBJEKTIVE TË PRODHUAR NGA ENVER HASANI

Prishtinë, 8 Tetor 2018

1. Hyrje

Gjithçka filloj të kuptohej në një tryezë diskutimi të mbajtur të martën me 2 Tetor 2018, ku temë debati ishte "**Dialogu Kosovë-Serbi**", dhe panelistë kryesor ishin Arsim Bajrami (autor i parë i librit "E Drejta Kushtetuese") dhe Enver Hasani (Autor i një kritike të botuar në portalin Koha Net). Nga pikëpamjet e paraqitura në atë tryezë të diskutimit, në mënyrë krejt jo të sinqertë dhe jo kolegiale, Enver Hasani, "i kishte dhënë urdhër", njërës prej gazetave ditore, për të filluar përgatitjen e "lajmit të madh", për një goditje radhës që do të bënte ndaj kolegëve të tij të Fakultetit Juridik, me njërin prej të cilëve (autorin e parë të librit), atë ditë kishte pirë kafe kolegialisht.

Qasja "kolegiale" u kuptua qartë, nga pyetjet që i bëri kjo gazetë rreth kritikës së Enver Hasnit, pikërisht gjatë kohës sa po mbahej tryeza e diskutimit, autorit të parë të librit, siç u tha edhe pjesëmarrës në panelin kryesor të diskutimit të kësaj tryeze. Këtë lajm, po atë ditë, në mënyrë pothuajse triumfuese, Enver Hasani e kishte shpërndarë edhe tek kolegët e tjerë të Fakultetit, duke e cilësuar ketë veprim si një "fitore revolucionare" të tij të radhës, ndaj kolegëve të Fakultetit Juridik.

Në orët e vona të mbrëmjes, mediumi KOHAVISION (KTV), paralajmëroj titullin "bombastik" të Gaztës KOHA DITORE, të prodhuar nga të bëmat "shkencore" të Enevr Hasanit. Në artikullin e datës 03.10.2018 me titull "**Hasani ia cilëson librin nën nivel, Bajrami e quan kritikë tendencioze**" portali koha.net dhe gazeta KOHA DITORE, hapi siparin e lajmeve të ditës, me të cilin rast tregonte mbi atë se si Arsim Bajrami dhe

Florent Mucaj në librin e "Drejta Kushtetuese", sipas kritikës së Enver Hasanit, nuk kishin haberin se çfarë është E Drejta Kushtetuese dhe Kushtetuta. Ani pse, njëri prej autorëve të librit (Arsim Bajrami), ketë lëndë e ligjëron që 37 vite në Fakultetin Juridik si dhe ka qenë i përfshirë në të gjitha proceset më të rëndësishme kushtetuese në Kosovë dhe më gjerë (siç janë: Hartimi i amendamenteve të Kushtetutës së Kaçanikut; Hartimi i Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme 2001; ndër hartuesit kryesor të Kushtetutës së Republikës së Kosovës 2008; Kryetar i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës 2011/2012, pjesëmarrës në procesin e hartimit të Kushtetutës së Shqipërisë 1998 etj).

Për të qenë krejtësisht të sinqertë me të gjithë ata që presin përgjigjen tonë, që Enver Hasani ishte duke përgatitur një "book review" të tipit të recensionit shkencor, (në gjuhën e tij të preferuar) për librin "E Drejta Kushtetuese" ishim njoftuar dy javë më parë nga disa prej kolegëve tanë të fakultetit, të cilëve, si pa-dashje, Profesor Hasani u kishte ndarë lajmin dhe "kontributin shkencor" të madh. E pranuam ketë lajm me shumë kënaqësi, sepse pas shumë viteve në Kosovë po tentohej të nxitej një debat akademik dhe shkencor, siç e thotë edhe vete Enver Hasani. Duke pritur këtë "kontribut shkencor", ne në anën tjetër, prisnim që t'i përgjigjeshim këtij "kontributi shkencor" të paktën në kuadër të hapësirës shkencore, që kemi në Revistën "E Drejta", dhe atë për dy arsye themelore.

Së pari besonim që kritika "shkencore" e librit nuk mund të bëhet jashtë modelit të zakonshëm të kritikës në vendet e tjera të botës, përfshirë edhe ato në të cilat Enver Hasani ka shpenzuar kohë për të ndërtuar profilin e tij prej shkencëtari. Kritikat e mirëfillta shkencore, së pari u adresohen lexuesve të fushës së ngushtë të studimit, dhe që debati të merr përmasa akademike, ajo rëndom kufizohet në ato margjina. Të publikosh kritikën në gazetën ditore Koha Ditore (pavarësisht faktit që kjo mbetet ndër gazetat më e besueshme në Republikën e Kosovës), e cila e sjellë atë si lajm, dhe duke mos vlerësuar edhe anën tjetër të cilësisë së kritikës është e pa pranueshme. Andaj, kjo e bën kritikën të mbetet jashtë kornizave të debatit akademik dhe dukshëm tendencë për të përlyer, më shumë se sa për të zhvilluar shkencën dhe artikuluar saktësinë e librit, siç e thotë edhe Enver Hasani në kritikën e tij.

Së dyti, dhe duke pasur parasysh të parën, s'mund të besonim që kritika shkencore e një libri mund të fillonte dhe mbaronte me paragrafin, citoj: "*…kurse u struka në vend, sepse e marr me mend që studentët që do ta*

lexojnë për të dhënë provimin nga lënda 'E drejta kushtetuese' do të shohin në secilin prej nesh, si arsimtarë të Fakultetit Juridik, njeriun e padijshëm dhe manipuluesin e shkencës që fshihet pas titullit fiktiv, shkencor dhe akademik...". **Kjo e fundit**, por edhe shumë cilësime tjera subjektive, ndaj librit dhe autorëve të tij, të përmendura në mënyrë masive në këtë kritikë, në esencë tregojnë arsyen, motivin dhe kualitetin e kritikës "shkencore". Çdo gjë mbetet në margjina të personales, të mungesës së arsyes dhe etikës shkencore dhe akademike, krejt kjo nga një material jo shkencor i prodhuar, nga një Profesor siç mëton që është Enver Hasani. Prandaj, për çdo profesor dhe akademik, të bëhesh pjesë e një debati që ka këtë qasje komunikimi mbetet problematike dhe apriori fyese. Natyrisht, një gjë e tillë është e dukshme edhe në çdo pjesë të "kritikës shkencore" të publikuar në portalin **KohaNet**. Ndoshta, kjo mund të ishte një konstatim, jo i besueshëm, sikur të mos bëhej fjalë për përvojën akademike dhe shkencore 37 vjeçare, të autorit të parë të librit. Siç u tha, me një përvojë të madhe edhe profesionale në hartimin e disa kushtetutave. Për aq kohë sa ka qenë e mundur dhe duke pasur parasysh moshën, një përvojë e larmishme akademike dhe profesionale e këtij niveli e ka shoqëruar edhe autorin e dytë të librit. Për çdo mendje të shëndoshë, ta vësh në pikëpyetje aftësinë e autorëve të librit për të njohur definicionin e së drejtës kushtetuese dhe vet kushtetutës mbetet e tepër utopike dhe e pabesueshme.

Një kritikë e mirëfilltë shkencore, do të duhej mbetur larg modelit të shantazhit, denigrimit, fyerjes dhe mungesës së respektit ndër kolegjial dhe njerëzor. **Goditje të tilla pa hak**, me qasje fyese dhe denigruese, aq më pak në një debat që do të duhej të ishte shkencor, nuk kanë ndodhur mes kolegësh në Fakultetin Juridik dhe Universitetin e Prishtinës në tërësi, as në kohën e diktatorit famëkeq Sllobodan Millosheviç.

2. Disa sqarime bazike dhe fillestare për lexuesin

Kjo përgjigje i dedikohet një kritike të botuar në portalin **Koha Net**, me titull: "**E drejta kushtetuese e autorëve Arsim Bajrami dhe Florent Muçaj, një libër me vlera të dyshimta profesionale, shkencore dhe didaktike**", me autor, Enver Hasanin, dedikuar librit universitar, "**E Drejta Kushtetuese**" të autorëve Arsim Bajrami dhe Florent Muçaj, botuar në muajin Prill të vitit 2018.

Këtë përgjigje, nuk po e bëjmë, sepse mendojmë që Enver Hasani, ka të drejtë në atë çfarë thotë, në prodhimin e tij kritik, por për tri arsye tjera

kryesore: **e para**, sepse kemi qenë dhe jemi të bindur në vlerën e librit dhe asaj çfarë është thënë në të, pasi që këtë më së miri do ta vlerësojnë studentët; **e dyta** dëshirojmë ti sqarojmë lexuesve besnik dhe komunitetit juridik, që presin përgjigje nga ne, pretendimet e ulëta, jo etike, jo shkencore, subjektive dhe tendencioze, si ndaj librit ashtu edhe ndaj autorëve të tij, të prodhuara në mënyrë masive nga Enver Hasani, në materialin e tij, të botuar në portalin Koha Net. **Arsyeja e tretë** për këtë përgjigje, është mbrojtja e dinjitetit tonë personal dhe profesional, të prekur nga kritika "shkencore" e prodhuar nga Enver Hasani.

Për informacion të lexuesit, në këtë përgjigje, kritikës së botuar, do ti referohemi si kritikë jo shkencore, për shkak se kjo për ne nuk përbën një kritikë shkencore, kurse autorit të saj (Enver Hasani), si autori i kritikës jo shkencore. Librit "E Drejta Kushtetuese" do ti referohemi si Libri kurse autorëve e tij (Arsim Bajrami dhe Florent Muçaj), si autorët e librit ose autorët e kësaj përgjigje.

Në kuadër të kësaj përgjigje, autorët e librit, do ti përgjigjen shumicës së pretendimeve të autorit të kritikës jo shkencore, sepse e konsiderojnë që disa gjëra çfarë ai i thotë Enveri, në stilin "Enver Hasançe", janë pa vlerë për autorët e librit dhe i përkasin mendimeve dhe pikëpamjeve të tij, nga prizmi i lirisë akademike dhe shkencore.

Paraprakisht, i kërkojmë falje lexuesit (por jo autorit të kritikës jo shkencore) dhe publikut për gjuhën jo shkencore që do ta përdorim në këtë përgjigje, por kjo vjen si nevojë e pamundësisë që ti shmangemi dhe nevojës që ti përgjigjemi gjuhës jo shkencore, jo etike, tendencioze dhe subjektive, të autorit të kritikës jo shkencore, gjuhë kjo që përmban edhe elemente shpifëse dhe fyese.

Këtë kërkim falje, ndaj lexuesit dhe publikut e bëjmë edhe për faktin, që autori i parë i librit, në karrierën e tij 37 vjeçare si ligjërues universitar dhe si autor i shumë librave dhe punimeve shkencore, nuk ka përdorur asnjëherë fjalë, që nuk kanë karakter jo shkencor dhe që nuk korrëspondojnë me etikën shkencore dhe akademike. Ky parim vlen edhe për autorin e dytë të librit. Sidoqoftë, e gjithë gjuha e përdorur në këtë përgjigje, nuk përbën as 1 (një) përqindëshin (%) e gjuhës, jo shkencore, subjektive, tendencioze dhe fyese, që përdor autori i kritikës jo shkencore, në materialin e tij të prodhuar dhe të botuar në portal. Këtë lexuesi mund ta vërtetoj lehtësisht, por ç'të bësh, "kështu ia lyp mushka drutë", Enver Hasanit.

Autorët e librit edhe sikur të dëshirojnë të marrin parasysh sugjerimet e kritikës, me rastin e ribotimit të librit, një gjë e tillë është e pamundur,

sepse nuk ka çfarë të merret parasysh, bazuar në përmasat e mëdha të subjektivizmit dhe personales mbi bazën e të cilave parime është e ndërtuar kjo kritikë jo shkencore.

Gjithashtu, i sqarojmë lexuesve dhe publikut, se autorët e librit, përveç kësaj përgjigje do të analizojnë të gjitha elementet dhe cilësimet fyese dhe shpifëse ndaj tyre, të publikuara në kritikën jo shkencore në portalin Koha Net, dhe me kohë do të ndërmarrin të gjitha veprimet juridike, për ti adresuar ato.

3. Pretendimet kyçe në kritikën jo shkencore dhe disa veçori të tjera kundërthënëse të saj

Kritika jo shkencore, e publikuar në portalin Koha Net, përveçse në përmbajtën e saj instalon gjuhën fyese, shpifëse dhe jashtë të gjitha margjinave shkencore dhe akademike, ajo në vete bartë një numër shumë të madh të gabimeve bazike profesionale dhe shkencore, të cilat i bën autori i saj.

Është shumë lehtë të konstatohet se kritika jo shkencore, pas një pune disa mujore të autorit të saj, për të cilën "punë të vyeshme" autorët e librit e falënderojnë, u botua në një momentin kur po fillonte viti i ri akademik. Ky argument lidhet me qëllimin e autorit të kritikës jo shkencore, për të diskualifikuar dhe diskreditуar librin dhe autorët e tij, në këtë moment të rëndësishëm për ne dhe studentët. Nga frika që nuk po mund ta arrinte këtë efekt, autori i kritikës jo shkencore, e publikoj "kontributin shkencor të madh", me plot gabime teknike dhe strukturore, në portalin Koha Net. Shihet qartë se nga ngutia për të arritur efektin e tij të dëshiruar, nuk kishte pasur kohë të merrej me këto detaje teknike. Por si duket koha nuk i ka mjaftuar autorit të kritikës jo shkencore edhe ti ri-shikoj gabimet profesionale dhe kundërthëniet në përmbajtjen e kritikës jo shkencore, të cilat autorët e librit do ti shtjellojnë në këtë përgjigje.

Një gjë me të cilin krenohet në kritikën jo shkencore të tij, autori i saj është vëllimi i kritikës jo shkencore, siç e thotë ai 268 faqe, ani pse të deformuara teknikisht, kjo qartazi për shkak të ngutisë për ta botuar, në fillim të vitit akademik, me qëllim që të arrihej efekti që dëshironte autori i saj. Vëllimin prej 268 faqesh të kritikës jo shkencore e kishte vërtetuar edhe "lajmi i madh", i botuar në gazetën Koha Ditore.

Lidhur me këtë fakt, në këtë kritikë jo shkencore, autori i saj, ndër të tjera me krenari thotë: "***...Vëllimi pak i rritur i kësaj kritike shkencore (268 faqe) është përcaktuar nga ashpërsia dhe vëllimi i gabimeve shken-***

core, profesionale, didaktike dhe i lëshimeve tjera serioze të librit të autorëve tanë. E megjithatë, këtu nuk janë përfshirë të gjitha të metat e natyrës si më sipër të librit. Kjo mospërfshirje e të gjitha gabimeve profesionale, shkencore dhe didaktike është bërë për dy arsye: e para, sepse një gjë e tillë do të çonte kritikën tonë në një vëllim shumë më të madh se ky që sot i prezantohet lexuesit; dhe, e dyta, sepse do të ripërsëriste gjërat e thëna në këtë pjesë të kritikës sonë nisur nga fakti se libri cilësohet me të njëjtat gabime përgjatë tërë tekstit..."

Ky vëllim, siç e quan autori i kësaj kritike jo shkencore, për autorët e kësaj përgjigje, nuk është krijuar nga ky pretendim i autorit të kritikës jo shkencore, por nga përsëritjet e shumta që ai bën, duke nxjerrë një prodhim të pa kuptueshëm, që nuk ka asnjë lidhje me librin e në shumë raste as me materien e të drejtës kushtetuese si lëndë mësimore. Kështu për shembull autori i kritikës jo shkencore, në disa faqe të prodhimit të tij përsërit disa herë, në shumë raste jashtë kontekstit, teorinë e tij për **grundnormën** (normën themelore), duke u mbështetur në atë çfarë thonë **Carl Schmit dhe Hans Kelzen**. (**krahaso faqet 78, 79, 80, 98, 100, 136, 144, 152, 154, 155, 156, të kritikës së botuar në portalin Koha Net, 03.10. 2018**), në të gjitha këto faqe autori i kritikës jo shkencore i përsërit, gjërat e njëjta për këtë temë. Ky argument është faktori i parë i një vëllimi të rritur dhe të prodhuar, me qëllime krejt tendencioze dhe subjektive.

Faktori i dytë i vëllimit të rritur të kësaj kritike jo shkencore, për autorët e kësaj përgjigje janë edhe cilësimet subjektive dhe jo etike të autorit të kësaj kritike jo shkencore, të cilat janë të përmasave të mëdha, vështirë të durueshme për lexuesin që kupton qasjen e mirëfilltë shkencore. Këtu veçojmë, fjalën *"manipulim" apo "manipulative"* e cila përmendet mbi 130 herë në tërë kritikën jo shkencore, ani pse në mënyrë krejt jo të saktë, gjë të cilën do ta sqarojmë në këtë përgjigje, rast pas rasti.

Faktori i tretë vëllimit të rritur të kritikës jo shkencore, për të cilin autori i saj, e ritheksojmë krenohet, janë përsëritjet që ai i bën, gjatë ndërtimit të strukturës së kritikës së tij jo shkencore. Kështu për shembull, në hyrje të çdo pjese, fillimisht përsërit gjërat që do ti thotë më poshtë, vetëm sa për të rritur numrin e faqeve, gjëra këto që nuk janë të nevojshme për lexuesin, madje as në një produkt shkencor, e lere më në prodhim të tillë jo shkencor, çfarë e ka bërë autori i kritikës jo shkencore. (Për shembull: Krahaso vetëm pjesën e përmbledhjes ku flitet për shefin e shtetit, në kritikën jo shkencore. Autori i saj ngarkon këtë pjesë me përsëritje nga një punim i tij, siç do të shihet edhe më poshtë, ku ai në disa vende përsërit pa

nevojë pjesët e punimit të tij, pa pasur lidhje me temën).

Faktori i katërt i një vëllimi të rritur të kësaj kritike janë pjesët e librit, të cilat autori i kritikës jo shkencore, i merr ***ad literam*** (***saktësisht, fjalë për fjalë***), dhe këtë e bën vetëm për të nxjerrë jashtë kontekstit, për të shtrembëruar të vërtetën që thotë libri dhe për të m 'veshur gjëra që nuk thuhen në libër. Qëllimi i autorit të kritikës jo shkencore në këtë rast është që para lexuesit të paraqes gjoja të pasakta gjërat që janë thënë në libër. Autorët e librit, me këtë çështje do të merren më poshtë, rast pas rasti, bazuar edhe në masën e keqpërdorimit dhe mashtrimit që tenton të ja bëjë lexuesit, autori i kësaj kritike jo shkencore.

Faktori i pestë i një vëllimi të rritur të kritikës jo shkencore, është edhe fakti, që shumë pjesë, të përfshira në kuadër të saj, janë pjesë e punimeve të botuara më herët nga autori i kësaj kritike jo shkencore, ose pjesë e produkteve të tij që do ti botojë në të ardhmen, të cilat autorët e kësaj përgjigje i posedojnë, pasiqë vetë autori i kritikës jo shkencore ju ka dërguar, për shembull pjesa e kontrollit kushtetues dhe ajo për shefin e shtetit, por edhe të tjera, fakt ky që nuk ka shumë rëndësi.

Faktori i gjashtë që ka ndikuar në rritjen e vëllimit të kësaj kritike jo shkencore, është edhe fakti se autori i kritikës jo shkencore, në shumë raste fillon dhe trajton tema të ndryshme dhe të njëjtat i sqaron deri në detaje duke përmendur pikëpamje prej më të ndryshmeve dhe të shumë autorëve, e gjithë kjo me qëllim dhe rritjes së vëllimit të kritikës jo shkencore, dhe jo me qëllim që të rrëzoj argumentet e ngritura nga autorët e librit, pasi që këto argumente nuk mund ti ndërtoj. Po ashtu, në shumë pjesë të kritikës jo shkencore, autori i saj, fillon dhe sugjeron punime dhe libra të tërë, duke i cituar ato me komplet titullin e tyre, dhe e gjithë kjo që të shtohen fjalë në këtë kapitull, për të prodhuar "kontribut i madh shkencor" të botuar në portale.

Nën ndikimin e krenarisë së vëllimit, të kritikës jo shkencore, autori i saj, përmend tri cilësi themelore, siç e quan ai të "gabimeve" të autorëve të librit. Këtu flet për tre gjëra: **e para** Manipulimin e literaturës, të cilën ai e krijon si qasje të tij, sulmuese, për të diskualifikuar librin dhe autorët; **e dyta**, i duket i pakuptueshëm dhe kaotik narracioni, (siç e quan ai) i librit dhe **e treta**, flet për pa kuptimsinë e librit si një cilësi kryesore. Në një farë forme, me këtë tenton të krijojë një fotografi të pa dëshirueshme për librin dhe autorët e tij.

Lidhur me "manipulimin e literaturës", autori i kritikës jo shkencore këtë e ka kryefjalë të prodhimit të tij. Megjithatë, ani pse flet për "manipu-

lim të literaturës", autori i kritikës jo shkencore nuk e sqaron për lexuesin se si mund të ndodh kjo dhe çka nënkupton kjo çështje. Në fakt, kjo nuk është aspak e vërtetë dhe nuk është rasti për librin. Por në ketë rast, autori i kritikës jo shkencore, ngatërron mënyrën e citimit që e bëjnë autorët e librit, me atë që dëshiron të argumentoj ai, se gjoja kjo është një manipulim i literaturës. Këtë do ta sqarojnë autorët e kësaj përgjigje, rast pas rasti, dhe lexuesi do të vërej keqpërdorimin, shtrembërimin dhe vetë manipulimin që i bën literaturës së përdorur, në libër autori i kritikës jo shkencore, me të vetmin qëllim, për të nxjerrë në pah "teorinë e tij të madhe për manipulim literature".

Një motiv i madh sulmues ndaj librit dhe autorëve të tij, duket qartë se ka shtyrë autorin e kritikës jo shkencore të krijojë gënjeshtra dhe mashtrime, për "teorinë e tij të madhe për manipulim literature". Në fakt, ai këtë a ngatërron me mënyrën e citimit, që bëjnë autorët e librit, në librin e tyre. Në këtë kuptim, autorët kanë cituar dhe përdorur fusnota në libër për tri qëllime: **E para** për të mbështet argumentet në atë që lexojnë, jo domosdoshmërisht citim fjalë për fjalë; **e dyta** citime fjalë për fjalë, apo citime ose të drejtpërdrejta; **e treta** citime udhëzuese, ku udhëzohen studentët për literaturë shtesë si dhe **e katërta** citime sqaruese, që të gjitha këto standarde normale, kjo do të sqarohet më poshtë, për lexuesin në pjesën e kësaj përgjigje, kur flitet për mënyrën e përdorimit të literaturës.

Ajo që bie në sy në rastin e autorit të kritikës jo shkencore, është se ai, me rastin e librit, i përdor citimet dhe fusnotat, sipas stilit të citimit fjalë për fjalë. Këtë e bën me qëllimin e vetëm, që të argumentojnë "teorinë e tij të madhe për manipulim literature". Mirëpo edhe gjatë tentimit të tij për vërtetimin e kësaj "teorie të madhe" autori i kritikës jo shkencore, bën huqje të rënda jo etike dhe atë: **1)** ngatërron autorët që janë cituar në libër, me autorë të tjerë që as ai vetë nuk e di nga i nxjerr; **2)** ngatërron burimet e tjera të cituara në libër, me burime të tjera, të cilat i ka gjëndëruar interneti në momentin e klikimit nga ai; **3)** i quan burime fiktive ato që nuk mund ti gjej në internet dhe që autorët e librit i posedojnë. Se për çka bëhet fjalë në këtë rast, lexuesi do ta shoh në pjesën e përgjigjes, që i referohet këtyre rasteve. Aty ndër të tjera lexuesi i kësaj përgjigje, do të ketë rastin të shoh edhe profesorin hutuar dhe të trembur, nga llojllojshmëria burimeve dhe literaturës që gjendet në internet.

Në të gjitha rastet e përdorimit të burimeve nga autorët e librit, është me rëndësi të thuhet se është punuar me burimin origjinal, respektivisht burimin e dorës së parë. Përveç kësaj, i zhytur në "argumentimin" e "teo-

risë së madhe për manipulim të literaturës", autori i kritikës jo shkencore, nuk e kupton një parim themelor shkencor, atë që jo të gjithë autorët, i përdorin dhe i kuptojnë njëjtë burimet e literaturës që shfrytëzojnë. Në rastin e kritikës jo shkencore, autori i saj, i shtrembëron dhe i keqpërdor skajshmërisht burimet e përdorura në libër, vetëm për të arritur qëllimin e tij përfundimtar, për diskualifikimin e librit dhe arritjen e qëllimit të tij subjektiv ndaj autorëve.

Se çka në të vërtetë është manipulimi me literaturë, autorët e kësaj përgjigje do të sqarojnë më poshtë, dhe këtu do të shihet se ky nuk është rasti me librin por thjesht ka të bëjë me mënyrën e citimit dhe të përdorimit të burimeve. Siç u tha, ndërlidhur me këtë autorët e kësaj përgjigje, do të sqarojnë për lexuesin më poshtë edhe disa rregulla themelore të citimit, të përdorura edhe në libër, të cilën autori i kritikës jo shkencore nuk e kupton. Nga ky shtjellim e ka rastin të mësoj edhe autori i kritikës jo shkencore.

Cilësimi dhe pretendimi i dytë i autorit të kritikës jo shkencore është se i duket i pakuptueshëm dhe kaotik narracioni, (siç e quan ai) i librit. Për këtë cilësim të tij, autorët e librit nuk kanë përgjegjësi, sikur nuk kanë përgjegjësi as për faktin, se ai nuk i kupton nocionet themelore të së drejtës kushtetuese, që i trajtojnë autorët në libër, të cilat në prodhimin e tij bën përpjekje ti sqarojë, por në fund përsëri kthehet në atë që kanë thënë vetë autorët e librit në librin e tyre. Këtu është rasti, ta zëmë: me kuptimin e të drejtës kushtetuese, të kushtetutës, burimeve të së drejtës kushtetuese, strukturës së kushtetutës etj. Edhe këto dilema për "paqartësi" autorët e kësaj përgjigje, do të ja heqin autorit të kritikës jo shkencore, në pjesën e përgjigjes, rast pas rasti, në të gjitha pretendimet subjektive që ngrit ai.

Në këtë aspekt, lehtësisht mund të haset edhe një veçori kundërthënëse e autorit të kritikës jo shkencore. Ai në njërën anë thotë autorët tanë kanë prodhuar narracion, kurse në anën tjetër thotë që se kinse autorët e librit tentojnë të ja imponojnë lexuesit idetë e tyre. Kjo mund të vërehet në faqen 3 të kritikës jo shkencore. Në fakt ky element është kundërthënës, sepse autori i kritikës jo shkencore, nuk e kupton që "imponimi" nuk mund të bëhet me narracion por vetëm me argumente shkencore dhe të qëndrueshme, ani pse autorit të kritikës jo shkencore nuk mund ti duken si të tilla.

Cilësimi i tretë i autorit të kritikës jo shkencore është jo kuptimësia e librit për lexuesin, kjo gjithnjë sipas tij. Për më tepër, të kuptuarit është një çështje krejt subjektive, që varet prej shumë faktorëve dhe që dallon

prej një personi në person. Autori i kritikës jo shkencore se ka kuptuar që qëllimi i librit ka qenë që ta kuptojnë studentët e vitit të dytë dhe të katërt, të Fakultetit Juridik.

Andaj, ky qëllim është më së miri do të vlerësohet nga studentët. Të kuptuarit e librit nga ana e autorit të kritikës jo shkencore, për autorët e librit do të ishte relevant vetëm sikur i njëjti do ta shqyrtonte mundësinë për të përfunduar edhe njëherë provimin "E Drejta Kushtetuese". Andaj në këto rrethana, kjo çështje nuk është fare relevante.

4. "5 gabimet themelore" që autori i kritikës jo shkencore deshi t'i shesë si "lajmin e madh medial"

Në stilin e një "komunikate për media", autori i kritikës jo shkencore, në kuadër të pretendimeve të tij, për "5 gabimet themelore profesionale" të autorëve të librit, flet njëjtë, me gjuhë jo etike dhe cilësime subjektive. Më poshtë do ti përgjigjemi këtyre pretendimeve të tij për "gabimet themelore profesionale të librit". Këtë do ta bëjmë edhe në pjesën e përgjigjes së plotë, rast pas rasti, varësisht nga vlerësimet dhe rëndësia e asaj që thuhet, në raport me librin dhe autorët e tij, në kritikën jo shkencore.

Në këtë kritikë joshkencore, shihet se si e fillon "kontributin e madh" autori i kritikës jo shkencore, kur gjoja ai paska zbuluar "5 gabimet themelore në libër". Në këtë drejtim, ai me nis fjalinë me "*disa nga gabimet e thella dhe tmerrësisht të rënda nga aspekti profesional dhe shkencor*", gjuhë kjo e paparë më parë në recensione kritike serioze. Qasja e tij tendencioze vërehet qysh në hyrje të këtyre "5 gabimeve themelore" që përmend autori i kritikës jo shkencore. Të shohim si është e vërteta e këtyre "5 gabimeve themelore".

I. Pretendimi i parë tendencioz, i pabazuar dhe jo serioz i autorit të kritikës joshkencore është se "mosnjohja themelore e dallimit në mes të drejtës kushtetuese dhe kushtetutës, si degë e sistemit pozitiv juridik dhe si teori, si dhe në kuptimin e tyre material dhe formal". Lidhur me këtë çështje, autori i kritikës jo shkencore thotë se *"Në kapitullin e parë të librit të autorëve tanë, studenti dhe lexuesi tjetër krejt natyrshëm do të presin që të gjejnë informacione të bollshme mbi kuptimet themelore lidhur me të drejtën kushtetuese dhe kushtetutën. Informacionet lidhur me këto kuptime nuk do t'i gjejnë. Nuk do t'i gjejnë sepse vetë autorët nuk e kanë të qartë se çfarë paraqet e drejta kushtetuese si degë e sistemit pozitiv juridik dhe çka si teori apo degë e shkencës juridike"*.

Si përgjigje në këtë pretendim, do të shohim fillimisht se çka decidivisht thuhet në libër lidhur me dallimin në mes të drejtës kushtetuese *(jo "..dhe kushtetutës"... siç autori i kritikës jo shkencore e shpik këtë fjalë, pasi nuk flitet fare për kushtetutën në këtë pjesë të produktit të tij)* si degë e sistemit pozitiv juridik dhe si shkencë, si dhe me kuptimin material dhe formal të Kushtetutës.

"Në teorinë e së drejtës kushtetuese, dallohet shkenca e së drejtës kushtetuese. Shikuar të drejtën kushtetuese në këtë prizëm, e drejta kushtetuese kuptohet si një disiplinë shkencore me karakter pedagogjik, që ka për qëllim edukimin e studentëve dhe të komunitetit të juristëve, me përmbajtjen e çështjeve që hyjnë në sfondin e objektit të studimit të së drejtës kushtetuese. Gjithashtu, e drejta kushtetuese si shkencë ka kuptimin e një doktrine teorike, e cila na ndihmon të kuptojmë objektin e studimit të së drejtës kushtetuese përmes argumenteve të ndryshme shkencore. Përmes së drejtës kushtetuese si shkencë, objekti i së drejtës kushtetuese studiohet në një prizëm më të gjerë. Ndryshe kuptimi i së drejtës kushtetuese si shkencë njihet edhe si teoria kushtetuese, duke ngërthyer në vete pashmangshëm dimensionin shkencor.

Kuptimi tjetër i së drejtës kushtetuese, si degë e së drejtës, është më i ngushtë, sepse lidhet vetëm me një segment të objektit të studimit të kësaj dege, pra atë normativ, të cilin e përbëjnë kryesisht normat e kushtetutës, si akti më i lartë që i përmban këto norma. Pra e drejta kushtetuese si degë e së drejtës e shikon objektin e studimit të saj, vetëm në prizmin normativ dhe jo në një prizëm më të gjerë sikurse e drejta kushtetuese si shkencë, ose thënë ndryshe teoria kushtetuese.

Çështja e dykuptimësisë ka qenë dhe mbetet edhe më tutje një debat i hapur, sidomos në aspektin e dallimeve, kur kihet parasysh fakti që këto dy kuptime janë të lidhura me njëra tjetrën. Arsyeja e paraqitjes së nevojës, për të trajtuar këto dy dimensione, lidhet më shumë me faktin se vetëm njëri nuk është i mjaftueshëm, për të nxjerrë në pah kuptimin e plotë të së drejtës kushtetuese. E drejta kushtetuese si shkencë qartazi është një kuptim më i gjerë se sa kuptimi i të qenit vetëm degë e së drejtës" thuhet në libër.

Secili që ka lexuar këtë përgjigje deri këtu, do ta shohë se në këtë drejtim gjithçka është shumë e qartë dhe është mendim tejet profesional dhe i qëndrueshëm. Po ti qasej me objektivitet dhe sinqeritet librit autori i kritikës jo shkencore edhe vetë do ta kuptonte në këtë mënyrë, atë çfarë autorët thonë në libër. Sido që të jetë, ne përsëri do ti përgjigjemi këtij

pretendimi tendencioz. Në këtë pjesë, faqe **28 dhe 29**, qartësisht mund të lexohet që nuk është fjala për dy kuptimësi të së drejtës kushtetuese, që mund të ngatërrohet, siç e sheh autori i kritikës jo shkencore, por thjesht bëhet fjalë për dy kuptime të së drejtë kushtetuese, që shpërfaqin dy elemente: **aspektin teorik shkencor** të çështjeve kushtetuese dhe **aspektin normativ-pozitivist**. Këtë e thotë edhe autori i cituar në fusnotën nr.1 të librit (***Thomas E. Baker, "Constitutional Theory in a Nutshell", William & Mary, Bill of Rights Journal, Volume 13 | Issue 1, kjo do të sqarohet edhe në pjesën e më poshtme të përgjigjes, aty ku e ka vendin***). Pra gjithnjë e drejta kushtetuese kuptohet si shkencë (doktrina kushtetuese) dhe si degë e sistemit juridik, ose aspekti normativ. Pra këtu autori i kritikës jo shkencore, tenton që të krijojë një pakuptimësi, duke shfaqur vetë probleme me të kuptuarit e nocioneve themelore. Këtë e bën vetëm për të krijuar një kuptim të turbullt të nocioneve themelore, që ndoshta e ka problem ti kuptojë vetë. Nocioni i kushtetutës, është botërisht i ditur dhe për të flasin shumë autor, në shumë kuptime. Ndoshta pas këtyre sqarimeve autori i kritikës jo shkencore do ti ketë të qarta këto nocione themelore.

1. "*Qëndrimet për nocionin e kushtetutës ndahen në dy grupe themelore. Në grupin e parë përfshihen qëndrimet të cilat kushtetutën e përkufizojnë në kuptimin material, në të dytin qëndrimet të cilat kushtetutën e përcaktojnë në kuptimin formal. Kjo ndarje ende ekziston, edhe pse është e vjetër pothuajse 200 vjet.*" (**Shih: Svetomir Shkariq Gordana Siljanovska Davkova, Ustavno pravo, vtoro dopolnitelno I izmeneto izdanie, Kultura 2009, fq.143.**) Pra, gjithçka është shumë e qartë dhe e shkruar me një profesionalizëm të lartë, për dallim nga kritika jo shkencore. Lexuesi dhe studenti tanimë e ka të qartë se nuk qëndron pretendimi i autorit të kritikës jo shkencore se lexuesi dhe studenti "*...informacionet lidhur me këto kuptime në libër, nuk do t'i gjejnë...*", siç e thotë autori në kritikën jo shkencore. Pra libri i sqaron qartë këto nocione, në fillim të kapitullit të parë, të pjesës së parë. Po të arrinte lexuesi ta deshifronte atë që ka thënë autori i kritikës jo shkencore, do ta shoh se nuk ka thënë asgjë më shumë se sa që është thënë në libër, përpos që autori i kritikës jo shkencore, këtë e ka thënë në formë pështjelluese, jo konstruktive dhe të pakuptimtë.

Në përgjigjen e plotë, më poshtë, lexuesi do ta gjejë përgjigjen e detajuar të të gjitha pretendimeve të autorit të kritikës jo shkencore, "fjalë për fjalë", përfshirë edhe "gabimin e parë themelor", siç e quan ai.

II. "Gabimi i dytë themelor" sipas autorit të kritikës jo shkencore është

"*mosnjohja themelore e rrjedhave dhe rëndësisë së mendimit filozofik dhe juridik të proveniencës perëndimore, në të cilin bën pjesë Kosova dhe sistemit i saj juridik-kushtetues*".

Për këtë "gabim themelor" autori i kritikës jo shkencore thotë se ka të bëjë "*...për idetë e para lidhur me të drejtën kushtetuese, autorët flasin në mënyrë krejtësisht të përçartë dhe pa asnjë fije konsistence. Trajtojnë Perandorinë e Romës e pastaj Greqinë, të parën si "monarki kushtetuese", kurse të dytën e anashkalojnë; mendojnë se kanë jetuar në të njëjtën kohë John Locke dhe Baroni Monstesuieu; nuk e kanë të qartë Renesancën dhe Iluminizmin, Reformacionin dhe asnjë koncept themelor perëndimor që ka qëndruar përgjatë shekujve në themelet e konstitucionalizmit perëndimor; flasin për Kushtetutën e Medinës si për kushtetutën e parë në botë, pa thënë asnjë fjalë për Instrumentin e Qeverisjes në Angli (1653); as idenë më të vogël nuk e kanë se kush, pse dhe si e përdori për herë të parë termin e drejta kushtetuese, si nocion gjuhësor dhe përmbajtjesor; flasin edhe për shumë gjëra tjera në mënyrë të gabuar. Këtë mosnjohje drastike i kemi analizuar në faqet 28-41 të kësaj kritike, në fund të së cilës lexuesi mund t'i gjejë të mbarështruara pikëpamjet tona të sakta...*".

"*...Nuk e kanë të qartë Renesancën dhe Iluminizmin, Reformacionin dhe asnjë koncept themelor perëndimor që ka qëndruar përgjatë shekujve në themelet e konstitucionalizmit perëndimor...*" është një "argument" për të cilin në faqet **28-41** të kritikës jo shkencore autori i saj nuk jep kurrfarë përgjigje. Andaj mbetet një pikëpyetje e madhe rreth asaj se çfarë ka dashur të thotë autori i kritikës jo shkencore me këtë fjali.

Sa i përket asaj se libri flet për historikun e të drejtës kushtetuese dhe kushtetutës *"pa fije konsistence"*, secili student dhe lexues e ka shumë të lehtë ta verifikoj se kjo është një e pavërtetë: mjafton leximi i librit në pjesën kur flet për historikun e së drejtës kushtetuese. Tutje, të shohim sa është e vërtetë se autorët e librit "*trajtojnë Perandorinë e Romës e pastaj Greqinë, të parën si "monarki kushtetuese", kurse të dytën e anashkalojnë"*. Të shohim po ashtu, se çfarë nënkupton "monarkia kushtetuese" në Perandorinë Romake dhe nëse është e vërtetë se autorët e anashkalojnë Greqinë.

Në paragrafin e fundit të faqes 43 të librit thuhet se: "*...Në kuptimin e së drejtës kushtetuese, si tërësi e normave më të larta në fuqi dhe të zbatueshme, të njëjtat kanë ekzistuar qysh në Perandorinë Romake dhe në Greqinë Antike. Roma e Vjetër ka pasur akte të zbatueshme që kanë pasur fuqinë më të lartë dhe të cilët në disa raste e kanë bërë Perandorinë Romake*

të duket si një "Monarki kushtetuese". Madje edhe vetë fjala kushtetutë në etimologjinë e saj ka marrë emrin nga fjala latine constituio, ky emërtim në ishte përdorur nga romakët dhe kishte kuptime të ndryshme si: urdhër, akt më i lartë ose akt i perandorit...".

Në fakt, konstatimi për Romën, si "*Monarki Kushtetuese*" ka ardhur nga autorët e librit, për faktin se në shumë faqe të librit të autorit *F. W. Bussel*, i cituar në librin e autorëve të kësaj përgjigje, flitet për kushtetutën e Romës në format e ndryshme të qeverisjes në Romë, varësisht na periudhat qeverisëse. Autorët e librit asnjëherë nuk konstatojnë që autori i mirënjohur ***F. W. Bussel*** në librin e tij, flet për Romën si "**monarki kushtetuese**", thjesht ky konstatim pra buron nga fakti i mënyrës së funksionimit të Perandorisë Romake, duke pasur parasysh zhvillimin e historisë kushtetuese të saj, të cilën autori në fjalë e trajton në mënyrë kronologjike dhe shteruese. Autori i kritikës jo shkencore, nuk e kupton që kur përdoret një burim literaturë, lejohet që nga përmbajtja e tij të nxjerrën edhe konkluzione, siç e përmend edhe **Umberto Eco**, në veprën "***Si bëhet një punim diplome***", e cituar nga autorët e kësaj përgjigje më poshtë. Ajo që është edhe më interesante dhe që nuk e kupton autori i kritikës jo shkencore, ka të bëjë edhe me faktin që, autorët në libër, Romën, si "**monarki kushtetuese"** e përdorin në thonjëza. Sigurisht autori i kritikës jo shkencore, nuk e ka kuptuar fare këtë fakt, kur ka bërë "analizën" e një paragrafi që e përmendin autorët në libër, ku përmendet "monarkia kushtetuese", në kontekstin e Romës, por në thonjëza. Për më tepër ndoshta autori i kritikës jo shkencore, ka nevojë që të mësoj përdorimin e thonjëzave.

Sa i përket "anashkalimi të Greqisë" që përmend autori i kritikës jo shkencore, citojmë faqen 45 të librit ku thuhet se "*...Prej qytet-shteteve greke, në historinë kushtetuese të tyre njihet rregullimi shtetëror dhe kushtetues i Athinës. Përmes akteve kushtetuese në fuqi, Athina promovohej si një qytet-shtet i cili kishte një rregullim shtetëror të mirëfilltë dhe një numër të caktuar të organeve kushtetuese. Pozitën dhe rregullimin shtetëror të qytet shteteve Greke në një kohe të caktuar e gjithashtu e pasqyron edhe Aristoteli në veprën e tij "Kushtetuta e Athinës", ku përfshihet e gjithë forma e organizimit ta Athinës dhe mënyra e qeverisjes. Ashtu sikurse edhe në Perandorinë Romake edhe në historinë kushtetuese të Greqisë antike nuk duket të ketë qenë shumë e zhvilluar shkenca e së drejtës kushtetuese, kjo edhe për faktin e njohur tashmë, që në atë kohë problemet shkencore ishin trajtuar kryesisht përmes filozofisë, sepse nuk ka pasur një ndarje të qartë në mes të filozofisë dhe shkencës ashtu siç është sot, andaj edhe trajtimet e*

Aristotelit, të cilat i përmendëm më lart duhet t'i marrim më shumë si trajtime në kuadër të filozofisë antike greke...". Kaq për autorin e kritikës jo shkencore për këtë çështje dhe se e njëjta do të sqarohet në këtë përgjigje, më poshtë, aty ku e ka vendin, bazuar në pretendimet "argumentuese" të autorit të kritikës jo shkencore.

Në këtë "gabim themelor" autori i kritikës jo shkencore thotë se autorët e librit "*...flasin për Kushtetutën e Medinës si për kushtetutën e parë në botë, pa thënë asnjë fjalë për Instrumentin e Qeverisjes në Angli (1653)...*".

Në faqet në të cilat "argumentohet" kjo e thënë, mohohet se Kushtetutën e Medinës profesorët **Hilmi Ismaili dhe Fatmir Sejdiu** e kanë cilësuar si Kushtetutën e parë në botë. Në këtë drejtim, është pikërisht faqja 124 dhe 125 e librit ***Historia e Shtetit dhe e së Drejtës I*** e këtyre dy autorëve ku thuhet një gjë e tillë. Për më tepër, përpos një autori tjetër, Prof.Dr. Hilmi Ismaili përmend ketë edhe një tjetër tekst të tij, që e citon në faqen 124 të librit bashkë autorial. Edhe përgjigjen, lidhur me kartën e Medinës, autori i kritikës jo shkencore, do ta marrë më poshtë, aty ku ka ngritur pretendimet, në kuadër të përmbajtjes së kritikës jo shkencore të tij. Për më tepër, kjo është një fakt notor i cili mësohet për shumë vite në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe që i njëjti asnjëherë nuk është kontestuar.

Sa i përket asaj që nuk është përmendur si Kushtetutë e parë Instrumenti i Qeverisjes në Angli, vitin e të cilit e dinë edhe autori i kësaj kritike jo shkencore (1653), është e vërtetë se ky instrument nuk është cilësuar si Kushtetuta e parë në kuadër të librit. Siç duket, autori i kësaj kritike jo shkencore nuk e ka të qartë se kur ka jetuar profeti Muhammed. Sipas po të njëjtit libër të profesorëve **Ismajli dhe Sejdiu**, thuhet se "pas vendosjes në Medine më **622 (viti 1 sipas hixhrit)** Muhamedi në konsultim me besimtarët e tij, por edhe me jomyslimanët e Medinës, përpiloi dhe miratoj një "shkresë" (kitab) që njihet si "Karta e Medinës" dhe paraqet jo vetëm kushtetutën e parë të shtetit islam, por njëherësh edhe kushtetutën e parë të shkruar në cilindo shtet të botës duke cituar, **M. Hamidullah, Muhammed, a.s. I, Zivot, Zagreb, 1977, f.174; po ashtu, më gjerësisht lidhur me këtë dokument shih "Dr. H. Ismaili, Burime të zgjedhura juridiko-historike I, Prishtinë, 2011"** thuhet në faqet 124 dhe 124 të këtij libri. Pra, është logjike që Instrumenti i Qeverisjes në Angli nuk është cilësuar si Kushtetuta e parë në botë, pasi nga Karta e Medinës, sa për informim të autorit të kritikës jo shkencore, ka dallim hiq më pak se **1031 vite**. Me-

gjithatë, edhe në këtë çështje, autorët e librit, do të përgjigjen në pjesën e mëposhtme, në mënyrë më të zgjeruar.

Fjalia në faqen 40 të librit "*...çështjet kushtetuese u trajtuan edhe gjatë shekullit XVII, nga Monteskjeu, Machiavelli, John Stuart Mill etj*" ka mjaftuar që për këtë fakt autori i kritikës jo shkencore të thotë se autorët e librit gjoja "*mendojnë se kanë jetuar në të njëjtën kohë John Locke dhe Baroni Monstesuieu...*". Në faqen 24 të kësaj kritike jo shkencore thuhet se "*...pak mund të besohet që këta dy autorë eminentë të së drejtës kushtetuese dhe filozofisë të së drejtës të kenë thënë se Baroni Monteskie kalindur dhe ka botuar para Nikolo Machiavellit, apo se Baroni Monteskie e Xhon Stjuart Mill kanë punuar dhe jetuar në shekullin e XVII...*".

Autori i kritikës jo shkencore, ka të drejtë në këtë kur vendos kriterin e kohës, si kriter i renditjes së autorëve (**Psh: Loku, Monteskjeu etj)** dhe kjo vërehet qartë në libra e punime tjera, mirëpo autori i kritikës jo shkencore, nuk e kupton që jo gjithmonë autorët e ndryshëm kur shkruajnë, renditjen e autoreve të tjerë e bëjnë sipas kriterit kohë, kjo vërtetohet **lehtësisht** (***psh: Shih: Stanley L. Paulson, Some Issues in the Exchange between Hans Kelsen and Erich Kaufmann, fq.270***) ku qartë renditje e autorëve nuk bëhet në bazë të kriterit kohë (**vitit të lindjes**). E fundit në këtë pikë: autorët e librit nuk e kuptojnë atë se me çfarë baze autori i kritikës jo shkencore thotë se autorët e librit nuk e kanë të qartë "*...asnjë koncept themelor perëndimor...*". Për më tepër, këto pretendime "serioze" të autorit të kritikës jo shkencore do të marrin një përgjigje më të detajuar më poshtë, aty ku e kanë vendin.

III. "Gabimi i tretë themelor" të cilën autori i kritikës jo shkencore është munduar ta shes sikur "lajmin e madh medial" është *"...mosnjohja themelore e natyrës juridike të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, e rolit dhe pozitës së saj në procesin e krijimit të shtetit të Kosovës..."*. Në kritikën e tij jo shkencore, në kuadër të përmbledhjes së "5 gabimeve themelore" ai thotë: "*...Në kapitullin e parë të pjesës së tretë por edhe në kapitujt tjerë atykëtu, autorët tanë flasin për Kushtetutën e Kosovës si për dokumentin themelues të shtetit të Kosovës. Kjo do të thotë se studentët tanë mësojnë se si Kushtetuta e Kosovës përbën dokumentin kyç dhe kryesor që ka themeluar Shtetin e Kosovës. Kjo, u mor vesh, nuk mund të jetë e saktë as në rastin e Kosovës e as në rastin e asnjë shteti në rruzullin tokësor. Në të shumtën e rasteve, në veçanti këtu në Evropë përgjatë shekujve 19 dhe 20. Shtetet janë themeluar përmes deklaratave të njëanshme të shpalljes së pavarësisë..."* kjo është mënyra se si autori i kritikës jo shkencore e koncepton

kushtetutën konstituive. Në këtë pjesë, autori i kritikës jo shkencore e përmend faktin se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) ka thënë se deklarata e pavarësisë nuk e cenon asnjë dispozitë të së drejtës ndërkombëtare. Ndonëse kjo që e thotë autori i kritikës jo shkencore është e vërtetë, e njëjta nuk ka asnjë ndërlidhje me atë që ai mundohet ta thotë, se Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk është një Kushtetutë konstituive.

Në faqen **303** të librit thuhet se "*...karakteri konstituiv i Kushtetutës së Republikës së Kosovës konsiston në faktin se ajo për herë të parë themelon shtetin e Kosovës duke e proklamuar atë si shtet sovran dhe të pavarur. Si e këtillë kjo Kushtetutë është akt i shtetkrijimit të Kosovës dhe të themelimit të institucioneve të pavarura të saj. Pa tendencën e zvogëlimit të rëndësisë së Deklaratës së Pavarësisë të 17 shkurtit 2008, që ka deklaruar aktin e pavarësisë, kushtetuta në aspektin legal dhe kushtetues ka themeluar shtetin e Kosovës dhe ka përcaktuar bazat e funksionimit të tij...*".

Autorët e librit ritheksojnë që është gabim të mendohet që deklarata e pavarësisë, në këtë rast e Kosovës është një kushtetutë, siç e thotë autori i kritikës jo shkencore, duke përmendur **Hans Kelzen dhe Carl Schmitt**, ndërlidhur me çështjen e teorisë për **grundnorm** (normën themelore). Së këndejmi për autorët e librit është tërësisht në rregull që autori i kritikës jo shkencore, të mendoj ndryshe, duke e marrë si normë themelore deklaratën e pavarësisë, në rastin e Kosovës për shembull. Por është po aq e pakuptueshme që njeriu të mos mendoj që Kushtetuta e vitit 2008 nuk e paska jetësuar dhe funksionalizuar shtetin dhe nuk qenka kushtetutë themeluese e Republikës së Kosovës. Autorët e librit, këtu kanë folur për kushtetutat dhe jo për pushtetin kushtetutëbërës. Si duket autori i kritikës jo shkencore nuk e ka keqkuptuar, konceptin e pushtetit kushtetutbërës dhe kushtetutës konstituive, e cila themelon dhe funksionalizon një shtet. "*...E kemi thënë më lart se Kosova në të ardhmen mund të ketë edhe kushtetuta të tjera, por në historinë e saj politike e kushtetuese Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 9 prill 2008 do të mbetet si akt konstituiv i shtetkrijimit...*" thuhet në faqen 303 të librit. Autori i kritikës jo shkencore përpos që e ngatërron kushtetutën konstituive me pushtetin kushtetutbërës, si duket edhe nuk e ka të qartë dallimin në mes të shpalljes së shtetit (pavarësisë) me funksionalizimin e tij, përderisa e para është bërë me deklaratën e pavarësisë ndërsa e dyta është bërë me kushtetutë, çfarë e ka bërë Kushtetutën e Republikës së Kosovës të marrë edhe epitetin e Kushtetutës konstituive. Edhe debatit për normën themelore **(grundnorm),** në rastin e Kosovës, do ti përgjigjemi aty ku e ka vendin, në strukturën e shthurur të

kritikës jo shkencore, të botuar në portalin e lartpërmendur. Me këtë rast, autori i kritikës jo shkencore, do të ketë rastin të kuptojë edhe njëherë mendimin e autorëve të librit, për normën themelore në rastin e Kosovës. "*...Hartuesit e saj janë bartës të pushtetit të sovranit të Kosovës, apo bartës të asaj që në të drejtën kushtetuese njihet si pushteti konstituiv origjinal. Ky konstrukt nuk ka asnjë mbështetje shkencore e morale*" është pjesa e dytë e "*gabimit themelor...*" që autori përmend në kritikën e tij jo shkencore.

Fillimisht, autori i kritikës jo shkencore thotë se, pretendim të tij do ta sqarojë në faqet **165-173** të kritikës së tij jo shkencore. Por, për këtë çështje në këto faqe ai nuk flet fare. Për këtë arsye, ne i kemi marrë dy raste kur autori i kritikës jo shkencore flet për çështje të natyrës së njëjtë, për ti dhënë përgjigje në këtë pjesë hyrëse, dhe që përgjigjen e zgjeruar sipas metodës rast për rast do ta marrë për pak kohë.

"*Ata që e hartuan kushtetutën e parë të një vendi, nga e morën të drejtën që të hartojnë kushtetutë?. Kjo është një çështje filozofike dhe doktrinare, e cila kërkon sqarim në parime dhe lëndë të tjera, siç është e drejta e vetëvendosjes së popujve, ndarja e një shteti nga një shtet, shpallja e një shteti si shtet i pavarur etj., tema këto të trajtuara sidomos në të drejtën ndërkombëtare publike. Por, ajo që vlen të përmendet në këtë drejtim, është se me rastin e miratimit të kushtetutës së parë, pushtetin kushtetutëbërës nuk e kanë "baballarët (etërit themelues) e kushtetutës". Ata janë thjesht bartës të pushtetit kushtetutëbërës. Por, meqenëse ende nuk kemi kushtetutë, nga e marrin ata këtë pushtet?*" thuhet në faqen 159 të librit, ku libri sqaron çështjen e pushtetit kushtetutbërës, përkatësisht se nga e marrin "baballarët (themeluesit e kushtetutës) pushtetin kushtetutbërës. Janë disa çështje që duhet qartësuar, ndonëse të tilla janë, për autorin e kritikës jo shkencore. Çështja kruciale është se në këtë rast është duke u trajtuar çështja e doktrinës së pushtetit kushtetutëbërës në përgjithësi në të drejtën kushtetuese, dhe jo si e veçantë për rastin e Kosovës. Edhe më thjeshtë për autorin e kritikës jo shkencore: nuk është duke u folur këtu për Kosovën edhe pse kjo do të bëhet, në përgjigjen më poshtë. Çështje tjetër potenciale në të cilën autori i kritikës jo shkencore aludon, në ketë "gabim themelor" është edhe se sipas autorit të kritikës jo shkencore, autorët e librit theksojnë "*...se hartuesit e saj janë bartës të pushtetit të sovranit të Kosovës, apo bartës të asaj që në të drejtën kushtetuese njihet si pushteti konstituiv origjinal...*". Autori i kritikës jo shkencore nuk e ka idenë se për çfarë "argumenton" në këtë rast. Ai nuk e ka parasysh se në këtë pjesë të librit, respektivisht në faqe 138, nuk flitet fare për pushtetin kushtetutëbërës por

flitet për kuptimin e termit "kushtetutvënës". Në këtë drejtim, libri thotë qartë se "*...Në përgjithësi përmbajtja e kushtetutës lidhet me vullnetin e kushtetutëvënësit ose të hartuesve të kushtetutës, si dhe me vullnetin e popullit. Në kuptimin e përmbajtjes së kushtetutës, "kushtetutëvënësi" i ka dy kuptime, kuptimin e ngushtë dhe të gjerë. Me termin "kushtetutëvënës" në kuptim të ngushtë nënkuptojmë organet (populli, parlamenti, ose ndonjë organ tjetër) të cilat e miratojnë kushtetutën duke i dhënë fuqi dhe legjitimitet normës kushtetuese. Në anën tjetër me termin "kushtetutëvenës" në kuptim të gjerë nënkuptohen edhe hartuesit e kushtetutës ose njerëzit (ekspertët) të cilët e hartojnë përmbajtjen e kushtetutës...*". Sa i përket kuptimit të ngushtë, është shumë e qartë se kush janë kushtetutëvënësit, pra është fjala për popullin, për përfaqësuesit e tyre – deputetët e Kuvendit, apo ndonjë organ tjetër me këto tipare. Termi i gjerë përfshin një kuptim tjetër – atë se edhe hartuesit e kushtetutës janë "kushtetutvënës", pasi janë shkruesit e një kushtetute, e cila kushtetutë në fund të fundit do të duhet ti nënshtrohet kuptimit të ngushtë të termit "kushtetutvënës" e që është miratimi i saj nga Populli, Kuvendi ose nga ndonjë organ tjetër. Pra, nuk është duke u folur për atë që në të drejtën kushtetuese njihet si pushteti konstituiv origjinal. Autori i kritikës jo shkencore, në këtë rast nuk e ka ditur se çfarë është duke shkruar. Përpos kësaj, ai thotë se gjoja autorët e librit në këtë rast flasin për Kosovën, për këtu është fjala për pjesën hyrëse të librit, saktësisht pjesën e parë, ku flitet në përgjithësi për çështje të caktuara të teorisë kushtetuese, dhe nuk është duke u folur fare për rastin e Kosovës. Përkundër kësaj, siç e thamë më lartë, mbi teorinë dhe filozofinë e kësaj çështje, autori i kritikës jo shkencore, do të marrë përgjigje të detajuar në pjesë e tjera të kësaj përgjigje.

IV. "Komunikata" në stilin "Enver Hasançe" vazhdon me atë që ai e quan "gabimi i katërt themelor", e që sipas tij është "*mosnjohja themelore e modeleve të kontrollit kushtetues dhe të vetë gjyqësisë kushtetuese*".

Sipas kësaj "komunikate", "*...në mesin e gabimeve të shumta të natyrës themelore veçohet ai i mosdijes së tyre lidhur me modelet e kontrollit të kushtetutshmërisë. Për këtë arsye ata zbulojnë modelet që fare nuk ekzistojnë... Autorët tanë, si të tillë cilësojnë modelin abstrakt të kontrollit dhe modelin konkret të kontrollit të kushtetutshmërisë, si dhe modelin preventiv (paraprak) dhe modelin e represiv (të mëpasshëm) të kontrollit të kushtetutshmërisë...*", thotë autori i kritikës jo shkencore, ndër të tjera.

Siç ka mundur ta sheh edhe autori i kritikës jo shkencore dhe siç mundet ta shoh edhe secili student dhe lexues, këto modele të kontrollit

kushtetues nuk janë modele "*të zbuluara që fare nuk ekzistojnë*". Për kategorizimin e këtyre modeleve, në fusnotën 592 përmendet libri i autorit Prof.Dr.Visar Morina, (i cituar në libër) i cili i liston në këtë formë. Për trajtimin në këtë formë të këtyre modeleve të kontrollit kushtetues, Morina përmend autorë të ndryshëm, siç janë **L.Vinx, Schwartz, S.W. Sheive, Sadurski, M. Shapiro dhe A.S. Sweet, Traja, M. Rosenfeld dhe A.Sajo, H.Steinberder, G.Nolte** dhe po ashtu përdorë edhe letrat e federalistit. Pra, këto modele autori i kritikës jo shkencore nuk i ka lexuar, dhe për këtë fakt ka menduar se këto nuk ekzistojnë. Do të ekzistonin sikur të lexohej libri i Prof. Dr. Visar Morina!. Edhe në botimin e vitit 2017, Prof. Dr.Visar Morina në librin e tij mbi Gjyqësinë Kushtetuese e bënë trajtimin e njëjtë. Kontrolli paraprak dhe i mëpastajshëm, trajtohen si forma dhe nën-modele të kontrollit abstrakt, ashtu siç është trajtuar edhe në libër.

Në këtë drejtim, autorët e shohin shumë të pranueshme kategorizimin e modeleve të kontrollit kushtetues sipas kritereve të tjera (siç e bën edhe autori i kritikës jo shkencore), por të thuash se këto modele nuk ekzistojnë për shkak të "*...mos dijes së autorëve...*", është njëri ndër elementet fyese dhe subjektive, që e përbëjnë këtë kritikë jo shkencore. Asgjë më shumë! Në këtë "gabim themelor" autori i kritikës jo shkencore thellohet në atë që autorët e librit e kanë pasur shumë të vështirë ta besojnë se një profesor universitar dhe ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese do të mund ta bënte. Ta shohim për çfarë bëhet fjalë.

Autori i kritikës jo shkencore në faqen 6 të kësaj kritike thotë se "*...Në kapitullin e VII të pjesës së tretë që flet për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, autorët vazhdojnë me gabime tjera të shumta. Ndër to hyn edhe zbulimi i jurisdiksionit të ri kësaj gjykate, juridiksion që fare nuk ekziston. Autorët besojnë se në nenin 113.3 (4) të Kushtetutës së Kosovës gjendet jurisdiksioni për kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare..... lexuesi ynë mund t'i gjejë në faqet 220-233; 243-250 të kësaj kritike...*".

Në "argumentimin" e kësaj çështje në faqen 224 të kësaj kritike jo shkencore, autori në vend të arsyetimit shkencor bënë shpifje të pastër. Ta shohim "arsyetimin" e autorit të kritikës jo shkencore, dhe ndërlidhjen e këtij "kontributi shkencor" me Ligjin nr. 02/L-65 Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Autori i kësaj kritike jo shkencore në këtë prodhim të tij, në faqe 224 thotë se: "*...Vërejtje të pashmangshëm, dhe atë të natyrës serioze, nxiten*

nga leximi i seksionit me titull "Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare" (fq. 460-461). Ky seksion paraqet dështim total të autorëve tanë, mashtrim të studentit dhe lexuesit të librit të tyre. Në Kushtetutën e Kosovës nuk ekziston institucioni i kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare.... Se në Kosovë nuk ka fare kontroll kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare e ka thënë Kushtetuta e Kosovës: neni 113.3 (4) i Kushtetutës fare nuk ka të bëjë me atë që mendojnë autorët tanë por me kontrollin e konvënçiaonalitetit të amendameneteve të propozuara kushtetuese...". Pas kësaj, në mënyrë krejt jo etike dhe shumë të pakuptimtë, autori i kësaj kritike jo shkencore nuk mjaftohet me shpifjen e bërë, por vazhdon dhe e sqaron nenin 1133.3(4), se ky nen ka të bëjë me vlerësimin e amendamenteve kushtetuese nëse të njëjta janë në përputhje me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtarë, gjoja se një çështje e tillë qenka e diskutueshme në rreshtat e librit. Më pastaj, në faqen 228, autori i kësaj kritike jo shkencore thotë se "*...Kjo kompetencë duhet të dallohet thelbësisht nga kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare, gjë të cilën nuk e kanë të qartë autorët tanë: ky kontroll zakonisht është preventiv, siç është rasti me Shqipërinë dhe me disa vende tjera, në të cilat gjykata kushteteuse bënë kontrollin e kushtetutshërisë së një marrëveshje para ratifikimit të saj. I tillë ka qenë rasti, ta zëmë, me deklarimin jo kushtetues të marrëveshjes për kufijtë detar në mes të Shqipërisë dhe Greqisë...*".

Të shohim tash se a është e vërtetë se kjo që po e thotë autori i kësaj kritike jo shkencore në këtë prodhim jo shkencor, dhe arsyetimin se pse kjo që po thotë ky autorë është shpifje. Në faqen **460-461** të librit fjalë për fjalë thuhet "*...Ky status i privilegjuar i së drejtës ndërkombëtare në kuadër të Kushtetutës së Kosovës dokumentohet edhe në kontekst të mbrojtjes së përputhshmërisë së amendamenteve kushtetuese në raport me të drejtën ndërkombëtare. Së këndejmi Gjykata Kushtetuese është kompetente të shqyrtojë kushtetutshmërinë e përputhshmërisë së një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe të bëjë rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur. Ngritja e kërkesës kushtetuese në kuadër të këtij procesi të kontrollit kushtetues ka efekt pezullues, ndërsa Kuvendi i Kosovës vepron në bazë të ndryshimit të kontestuar vetëm pasi Gjykata Kushtetuese të deklarohet me vendim final. Ajo çfarë në realitet paraqitet si mungesë në relacion me kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare është kontrolli apriori i kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre. Kjo në esencë përbën një prerogativë tipike të gjykatave ku-*

shtetuese. Në Shqipëri për shembull Gjykata Kushtetuese është kompetente që të bëjë rishikimin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre1428. Pra Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk ka kompetencë që të vlerësojë nëse një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar ose e ratifikuar është ose jo në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, për sa i përket përmbajtjes së saj. Një standard të tillë Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka vendosur në rastin Nr. KO95/13, në të cilin ndër të tjera konstaton se "Sa i përket përmbajtjes së Marrëveshjes së parë ndërkombëtare, Gjykata vëren se asnjë nen i Kushtetutës nuk parasheh vlerësimin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së marrëveshjeve ndërkombëtare nga Gjykata Kushtetuese" 1429. Në rastin Nr. KO95/13 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, kishte konstatuar vetëm procedurën e ndjekur për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërsa siç e thamë kishte vërtetuar jo kompetencën e saj për të vlerësuar kushtetutshmërinë e përmbajtjes së një marrëveshje ndërkombëtare e cila është në fuqi në rendin juridik të Kosovës...".

Pra autorët e librit, nuk e thonë atë që e m 'vesh ai për shpikjen e juridiksionit. Këtë shpifje të pamoralshme në stilin "Enver Hasançe", pa kurrfarë përgjegjësie publike, di ta bëjë vetëm një autor si ky në një prodhim jo shkencor, çfarë është kritika e tij. Ajo çfarë ai thotë se thuhet në libër, ajo fare nuk ekziston. Këtu nuk ka arsyetim për autorin me injorancë, por mbajtje në përgjegjësi, për veprim jo etik dhe për shpifje.

Secilin lexues të librit, kritikës jo shkencore, të kësaj përgjigje e ftojmë që ti krahasojë të gjitha këto tekste dhe të vërtetoj nëse është e vërtetë ose jo, ajo që e thotë autori i kësaj kritike jo shkencore.

Në këtë drejtim, **Ligji nr. 02/L-65 Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes** në nenin 3 pika a, jep edhe përkufizimin e "shpifjes", ku thotë se "*...Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër...".*

Ky arsyetim i dhënë në këtë përgjigje e i cili do të zgjerohet më poshtë, në mënyrë analoge do të përdoret edhe nga autorët e librit me rastin e analizimit të rrethanave dhe fakteve, për parashtrimin e padisë për shpifje kundër autorit të kësaj kritike jo shkencore.

V. Stili "Enver Hasançe" i kësaj "komunikate" reflekton edhe në "gabimin e pestë themelorë" të kësaj kritike jo shkencore, ku autori i saj, flet për "mosnjohja themelore e sistemit politik të cilit i takon Kosova, gjë që shihet nga keqkuptimi mbi rolin dhe pozitën e presidentit të Kosovës". Sipas autorit të kritikës jo shkencore, "*...në asnjë vend nuk mund të haset*

shpjegimi, të cilin më së shumti e dëshiron studenti dhe lexuesi, lidhur me atë se cilit pushtet i takon shefi i shtetit në Kosovë...".

Krejt në hyrje, autori i kritikës jo shkencore tenton të bëjë "argumentimin" e tij mbi këtë "fakt" duke marrë bllanko një pjesë të një punimi të tij që e ka botuar në Revistën E Drejta. *"...Gjëja më shokuese është kur studenti e dhe lexuesi do të gjejnë në faqen 381 të librit konstatimin e autorëve tanë sipas të cilit edhe mbreti mund të jetë president, krahas shtjellimeve të tyre përmes së cilave bëhet e qartë përtej çdo dyshimi mosnjohja e tyre e kuptimit të shefit të shtetit në një demokraci parlamentare dhe jo parlamentare, si emërues i përbashkët për mbretin/mbretëreshën dhe presidentin e republikës...*" vazhdon qasje jo profesionale dhe jo shkencore e kësaj kritike jo shkencore.

I fiksuar pas asaj që ka thënë në punimin e tij në Revistën E Drejta (**Shih: Prof. dr. Enver Hasani, Kontrolli Abstrakt Dhe Preventiv (Paraprak) I Amendamenteve Kushtetuese Dhe Mbrojtja Nga Shkarkimi I Shefit Të Shtetit: Rasti i Kosovës, Revista E Drejta, 2013, f.13-60**), autori i kësaj kritike jo shkencore nuk lexon kontekstin, por krahason fjalë për fjalë atë që thuhet në libër, me punimin e tij "të së vërtetës absolute".

Në libër thuhet se "*...përveç kësaj në anën tjetër emërtimi shef i shtetit është i dallueshëm nga kreu i Qeverisë dhe tregon titullarin ose të parin e shtetit, që mund të jetë Mbreti ose Presidenti. Pothuajse të njëjtin kuptim sikurse emërtimi shef i shtetit e ka edhe emërtimi kreu i shtetit, në fakt edhe ky emërtim nënkupton liderin e një vendi, Mbretin, Mbretëreshën ose Presidentin...*" (**Libri, fq. 381**).

Pas kësaj, në këtë pjesë, meqenëse jemi duke trajtuar kreun e shtetit të Republikës së Kosovës, i cili emërtohet si PRESIDENT, pas këtyre sqarimeve të detajuara, shpjegimi vazhdon me termin president. Kështu, në rastin kur thuhet se "*...Kështu në disa vende Presidenti paraqitet si mbret ose monark, kurse në shumicën prej vendeve si i zgjedhur, respektivisht si President kushtetues...*" këtu nënkuptohet Presidenti me funksionet **e kreut të shtetit**, i cili domosdoshmërisht se mund të jetë edhe monarku ose mbreti.

Autori qëllimkeq i kësaj kritike jo shkencore duhet ta ketë parasysh se nuk mundet **që shefin e shtetit, kreun e shtetit** dhe **presidentin** ta kuptojë si një kategori **puro teorike**, mbi bazën e të cilës janë të ndërtuara "teoritë" e tjera që korrespondojnë me emërtime të ndryshme në raport me kreun shtetit. Ky nocion është plotësisht praktik, varësisht prej asaj se si rregullohet roli i kreut të shtetit (shefit të shtetit) në një sistem kushtetues.

Këtu, autorët e librit nuk flasin për filozofi, por për aspekte praktike dhe kushtetuese që përcaktojnë pozicionin dhe rolin që ka kreu i shtetit në një sistem të caktuar kushtetues.

Në këtë drejtim, siç do ta shohim këtu përgjithësisht dhe në përgjigjen më poshtë detajisht, këtu trajtohet **kreu i shtetit** përkrah pozicionit kushtetues që ai ka, që në këtë kontekst mund të quhet **president dhe mbret, (emërtimi kreu i shtetit apo shef i shtetit, është emërtim kushtetues, që realisht nënkupton presidentin dhe mbretin)** etj. Emërtimi i tij në këto raste jepet për shkak të mënyrës së zgjedhjes *(që janë tri sosh, të cilat do ja shpjegojmë autorit të kritikës jo shkencore në përgjigjen e zgjeruar),* dhe nuk ka të bëjë me pozicionin që ai ka në një sistem kushtetues. Pra, ai mund të jetë kreu i shtetit me trashëgim (monark) apo i zgjedhur (president), por që në të dy rastet ka pozicionin e njëjtë, atë të kreut të shtetit/shefit të shtetit. Si shembull për këtë, do të shohim pozicionin kushtetues të kreut të shtetit në disa kushtetuta ku ai quhet president si dhe në disa të tjera ku i njëjti quhet mbret, por që funksionet i ka të njëjta. Në raste të tjera kur presidentit i jepen atributet e shefit të shtetit, e në disa raste të tjera i jepet emërtimi si kreu i shtetit. Stër detajizimet autori i kritikës jo shkencore lidhur me ketë çështje, do ti marrë në pjesën e mëposhtme të përgjigjes.

Disa Kushtetuta që i referohen presidentit si kreu i shtetit janë: Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se Presidenti është kreu i shtetit (neni 83), ngjashëm sikurse e përcakton edhe Kushtetuta e Shqipërisë (neni 86), Kushtetuta e Angolës (neni 108), Kushtetuta e Banglladeshit (neni 48), Kushtetuta e Belaruesit (neni 79), Kushtetuta e Bostëanës (neni 30), ajo e Bullgarisë (neni 92) etj. Kushtetuta e Spanjës thotë se mbreti është kreu i shtetit (neni 56) sikurse edhe Kushtetuta e Bahrejnit (neni 33). **Disa kushtetuta që i referohen presidentit si shef i shtetit janë**: Kushtetuta e Beninit (neni 41); Kushtetuta e Kolumbisë (neni 5); Kushtetuta e Republikës Dominikane (neni 128.1); Kushtetuta e Gabonit (neni 8); Kushtetuta e Lebanonit (neni 49); Kushtetuta e Malit (neni 29) dhe e Sao Tome dhe Princime (neni 77).

Autori i kritikës jo shkencore, duhet ta dijë që ka edhe kushtetuta të cilat e quajnë presidentin si kreu i shtetit apo shefi i shtetit. Andaj, si duket autori i kritikës jo shkencore, nuk e ka parasysh dallimin e emërtimit, që përdorin kushtetuta, si shef i shtetit apo kreu i shtetit dhe që bëhet fjalë në fakt për presidentin.

Jashtë të gjitha këtyre emërtimeve kushtetuese, në praktikën kushtetu-

ese krahasimore, ka edhe raste të tjera kur epiteti i kreut të shtetit i ipet edhe dikujt që nuk quhet fare president apo mbret. **Kushtetuta e Bhutanit (neni 2)** përcakton se **Druk Gyalpo** është kreu i shtetit. Sipas traditës së Bhutanit, Druk Gyalpo cilësohet si populli dragon, sipas asaj që edhe kuptimi i emrit të këtij shteti është "vendi i dragonjve", simbol i cili gjendet edhe ne flamurin e këtij shteti. Pra, autori i kësaj kritike jo shkencore këtë kategori praktike dhe kushtetuese e shikon sikurse ajo të ishte roman, dhe që rëndësia ekskluzive të ishte në emërtimin dhe fjalën që i referohet kësaj çështje. Ai nuk e ka parasysh se këto çështje praktike dhe kushtetuese kanë të bëjnë me rolin dhe pozicionin që ka kreu i shtetit në një sistem kushtetues, ndonëse në praktikën kushtetuese krahasimore dhe vetë brenda këtyre emërtimeve ka dallime të mëdha, e që të gjitha këto sqarohen në momentin kur këto nocione shpjegohen në mënyrë praktike, dhe jo në mënyrë absurde, të pakapshme dhe me ekskluzivitetin e të qënurit vetëm çështje teorike, siç mendon ti paraqes autori i kësaj kritike jo shkencore.

Po ashtu, lidhur me rolin dhe pozicionin e kreut të shtetit në një sistem kushtetues, autori i kësaj kritike jo shkencore do të marrë përgjigje të detajizuar, në pjesën e përgjigjes, që ka të bëjë me presidentin e Kosovës.

Autori i kritikës jo shkencore, duket sikur më parë të ketë "vuajtur" që prodhimi i tij, të ketë një audiencë më të madhe, dhe pasi këtë nuk e ka arritur në punimin e tij në Revistën e Drejta, pretendimet e njëjta i ka përdorur në këtë kritikë jo shkencore për të nxjerrë lajmin bombastik mbi "*...mosnjohjen themelore e sistemit politik të cilit i takon Kosova, gjë që shihet nga keqkuptimi mbi rolin dhe pozitën e presidentit të Kosovës...*". Fatkeqësisht për autorin e kritikës jo shkencore dhe fatmirësisht për shkencën juridike kosovare, kjo nuk është arritur. Autori i kësaj kritike jo shkencore kur flet për këtë "gabim themelor" duke përdorur tekstin në punimin e tij të cituar në fillim të kësaj kritike jo shkencore, përkatësisht në "komunikatë", ai thotë se "*Pikëpamjet tona lidhur me këtë, lexuesi ynë mund t'i gjej në fq 185-207 të kësaj kritike*". Por, kur të mbërrish këtu do shohësh "argumentet e shumëpritura": është përsëri teksti nga punimi i cituar në Revistën E Drejta mbi konstatimet e Benjamin Konstant. Autori i kësaj kritike jo shkencore duhet të ketë motiv për ta pritur me padurim përgjigjen e plotë të kësaj kritike qëllim keqe, në të cilën do të marrë përgjigje mbi njohjen apo mosnjohjen e sistemit politik të cilit i takon Kosova, mbi rolin dhe pozitën e presidentit të Kosovës, ku do të ketë rastin të kuptoj shumë deformime të tij profesionale, të cilat ishin shprehur më parë edhe në Komentarin e Kushtetutës, të shkruar, nga vet ai. Ani pse të

gjitha këto sqarohen mjaft bukur për studentët në libër, autori i kritikës jo shkencore nuk i kupton apo nuk ka dashur ti kuptojë.

5. Konstatime të tjera kundërthënëse dhe moralizuese të kritikës jo shkencore

"*...Mënyra si është shkruar ky libër na mëson një gjë themelore: si nuk duhet shkruar një tekst universitar...*" Këtë konstatim "të madh" e bën autori i kritikës jo shkencore, kur e vlerëson librin, në pjesën hyrëse, të kritikës jo shkencore. Poqëse ky konstatim do të ishte i sinqertë dhe jo subjektiv, atëherë autori i kritikës jo shkencore, është dashur ti tregoj lexuesit se sa libra universitar i ka shkruar deri më tani? Përgjigje në këtë pyetje është asnjë. Për të qenë korrekt, këtu autorët e kësaj përgjigje, nuk kanë për qëllim assesi të mohojnë botimet kombëtare dhe ndërkombëtare, të autorit të kritikës jo shkencore. Promovimin e tij dhe të punimeve të tij, autori i kritikës jo shkencore e bën në mënyrë të pa shembullt edhe në këtë prodhim të tij, kësaj radhe jo shkencor.

Një tjetër copëz moralizuese lidhur me librin e autorit të kritikës jo shkencore, që pjesën e hyrjes është si vijon: "*...Duke qenë kështu, ofrimi i tij për studentët, përveç se është jo ligjor është edhe jo etik sepse dëmton rëndë formimin e tyre profesional. Në fakt, kjo e fundit ka qenë arsyeja themelore pse unë i kam hyrë punës për të bërë këtë studim kritik...*" Ky assesi nuk është konstatim i sinqertë dhe etik i autorit të kritikës jo shkencore. Motivi themelor i tij ka qenë vetëm subjektiv dhe krejt personal, si me librin ashtu dhe autorët e tij. Po të ishte ashtu siç e thotë autori i kritikës jo shkencore, atëherë ai do të duhej të angazhohej për të shkruar një libër nga fillimi dhe do të ishte lexuesi dhe studenti, që do ta vlerësonte konkurueshmërinë, saktësinë dhe cilësinë e librave të tij eventual. Megjithatë, autori i kritikës jo shkencore nuk e ka bërë këtë, as nga kjo fushë dhe as nga fusha të cilës i përket ekspertiza e tij, ajo e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Më tutje, autori i kritikës jo shkencore përsëri moralizon, kur pretendon që kritika jo shkencore e tij, do të jetë një "*...udhëzues për të ndihmuar studentin dhe lexuesin që të orientohen gjatë leximit të librit të autorëve tanë sepse, si i tillë, libri ka gabime shumë të thella profesionale dhe shkencore me një përmbajtje jo të saktë ashtu që leximi i tij i pavarur dëmton rëndë çdokënd...*" Kjo kritikë jo shkencore, jo që nuk përbën një **udhëzues** por përbën një **devijues** për studentin, për shkak se autori i kritikës jo

shkencore, thotë gjëra që fare s'kanë të bëjnë me librin, i shtrembëron ato dhe mashtron lexuesin lidhur me përmbajtjen e librit, për çka autorët e librit, e ritheksojnë që do të vlerësojnë kujdesshëm edhe elementet e shpifjes. Për më tepër, gjuha e këtij "udhëzuesi", siç e quan autori i kritikës jo shkencore, përveç subjektive është tepër e rëndë për ta kuptuar, për studentin e studimeve themelore, e kur ja shtojmë kësaj edhe komplikueshmërinë dhe thënien e gjërave krejt jashtë kontekstit, në mënyrë të kotë nga autori i kritikës jo shkencore, një gjë e tillë për lexuesin bëhet edhe më e vështirë. Ky argument mbështetet edhe në faktin tjetër, që në përmbajtjen e kritikës jo shkencore, ka edhe shumë gjëra, të cilat janë jashtë materies të studimit të së drejtës kushtetuese (***këto lexuesi do të ketë mundësinë ti vlerësoj, në këtë përgjigje, në pjesën më poshtë, rast pas rasti, ashtu siç i ka ngritur autori i kritikës jo shkencore***). Në fakt, nëse flasim për saktësinë e librit, e ritheksojmë se këtë do ta dëshmojë koha, mirëpo "pasaktësia", siç pretendon autori i kritikës jo shkencore, është vetëm një e bëmë e tij, e bazuar në cilësimet subjektive dhe trajtimet jo etike që i bën ai në kritikën jo shkencore. Cilësimin krejt jo etik, se "*...leximi i tij i pavarur dëmton rëndë çdokënd...*", këtu është fjala për libër, autorët e librit dhe të kësaj përgjigje i cilësojnë asgjë më shumë se model të reklamave dhe fushatave kundër pirjes së duhanit, për të cilat reklama dhe fushata nuk kanë pasur dijeni, se di t'i bëjë kaq mirë autori i kritikës jo shkencore, në stilin "Enver Hasançe".

Edhe në këtë rast, në kuadër të përgjigjes rast pas rasti, autorët e kësaj përgjigje do ti përgjigjen të gjitha pretendimeve për "pasaktësi" dhe pasaktësive të vetë autorit të kritikës jo shkencore. Një tjetër element kundërthënës, i kritikës jo shkencore, vërehet lehtësisht në faqen 13 dhe 14 të kritikës jo shkencore. Autori i saj në njërën anë thotë si vijon: ***"....diku në fillim të qershorit nisa leximin, studimin dhe analizimin me kujdes të çdo detaji të librit..."***, (**shih kritika jo shkencore fq.13**), në anën tjetër, në faqen 14 të kritikës jo shkencore, autori i saj ndër të tjera thotë: ***"...Kjo do të thotë se nuk jemi ndaluar në secilën të metë dhe gabim të librit, por vetëm në ato që prima facie kapin syrin e lexuesit të vëmendshëm..."*** Tani këtu nuk është e qartë, a e ka trajtuar dhe analizuar, autori i kritikës jo shkencore librin me kujdes dhe në çdo detaj të tij siç e thotë vetë ai, apo vetëm ***prima facie***, siç e thotë përsëri vetë ai?!

Se autori e ka lexuar në çdo detaj librin ajo është qartë e kuptueshme. Madje ai në çdo detaj, e ka lexuar librin, me një diskurs krejt negativ, jo etik, subjektiv, jo shkencor dhe mbi të gjitha lag çdo standardi të moralit

njerëzor. Përveç kësaj, qartazi shihet që ka qenë i motivuar për shpifje, fyerje dhe goditje pa hak, të autorëve të librit, jashtë çdo standardi etik e kolegial. Nga ngutia dhe motivi i madh, për të arritur efektin dhe qëllimin e tij ndaj librit dhe autorëve të tij me fillimin e vitit të ri akademik, autori i kritikës jo shkencore, dy herë në pjesën hyrëse e udhëzon lexuesin, se si do ti referohet autorëve të librit (e thotë si autorëve tanë). (**Krahaso faqe 1 dhe 14 të kritikës jo shkencore**). Njëjtë në faqen 1 dhe 14 të kritikës së tij jo shkencore, autori i kritikës jo shkencore merret përsëri me vëllimin e faqeve të kritikës së tij. Këto huqje të autorit të kritikës jo shkencore janë të ndikuara qartazi nga ngutia edhe nga motivi i tij sulmues, subjektiv dhe keqdashës, ndaj librit dhe autorëve të tij. Kjo vërtetohet në çdo rresht që nga hyrja deri në fund të kritikës jo shkencore.

6. Qasja monopolisitike në dije dhe shkencë, karakteristikë themelore e kritikës dhe autorit të saj

Ajo çfarë më së shumti bie në sy, në kuadër të kritikës jo shkencore është qasja e autorit të saj, i cili në gjithçka që e thotë, mendon se është ashtu dhe e thotë në atë mënyrë, sikur të ishte e vërtetë absolute. Këtë e bënë në atë mënyrë që tenton t'i paraqes gjërat e tij si krejt të sakta dhe të bind lexuesin për këtë. Kjo tendencë, qartazi e tregon qasjen e autorit të kritikës jo shkencore, që të shpall të gjithë të padijshëm dhe të krijojë përshtypjen se vetëm ai di dhe i thotë gjërat saktë. Autori i kritikës jo shkencore, duhet të kuptoj që në shkencë nuk ka monopol dhe se nuk mund të monopolizojë dijen dhe shkencën. Gjithashtu, autori i kritikës jo shkencore duhet të dijë se nuk mund ti tregoj askujt, e aq më pas autorëve të librit, se çka të citojnë apo çka të lexojnë, siç e bën në kritikën e tij jo shkencore. Është liri akademike dhe shkencore e gjithsecilit që të zgjedh burimet, çfarëdo qofshin ato, për të ndërtuar argumentet e tij/saj. Ky është edhe një argument, për tendencën e autorit të kritikës jo shkencore për të transmetuar monopol në dije dhe shkencë. Andaj kjo qasje e tij, në pjesën më të madhe të kritikës jo shkencore është monopolistike, ndaj dijës dhe shkencës. Madje autori i kritikës jo shkencore, duke transmetuar skajshmërisht këtë qasje të tij, promovon vetën dhe punimet e tij në kritikën jo shkencore, bile në një rast i ngelet hatri, se përse autorët e librit nuk e kanë cituar atë, ani pse autorët e kanë bërë, por këtë nuk ka mundur ndoshta ta kuptoj autori i kritikës jo shkencore (**shih kritika jo shkencore e botuar në portalin Koha Net, fq. 160**.)

Atë çfarë nuk e ka kuptuar autori i kritikës jo shkencore është mendomi ndryshe për çështje të caktuara, që në shkencat sociale është shumë normale. Në një punim të tyre, autorët **Carol Mutch, Philippa Hunter, Andrea Milligan, Roger Openshaw dhe Alexis Siteine** në mënyrë të zgjeruar flasin për kuptimin e shkencave sociale dhe trajtimet e ndryshme të pikëpamjeve në këto shkenca **(Shih: Carol Mutch, Philippa Hunter, Andrea Milligan, Roger Openshaw dhe Alexis Siteine, "Understanding the Social Sciences as a Learning Area, support by the Christchurch College of Education for hosting the writing days", February 2008 (published in august 2009)**. Në këtë drejtim, këta autorë flasin për kohezionin social, ku ndër të tjera thuhet se "*...përshkroi aspektet e mëposhtme si të rëndësishme për kohezionin social: një vlerësim se ekziston një sërë vlerash relativisht universale, të cilat **Zelandasit e rinj** i çmojnë shumë, por pranimi se disa prej tyre mund të kundërshtohen ose interpretohen ndryshe për kontekste të ndryshme...*" (**Mutch, Hunter etj; punimi i cituar, fq.9**). Autori i kritikës jo shkencore pra nuk e kupton vetë natyrën e shkencave sociale, pjesë e së cilës është edhe shkenca juridike. Me një qasje të tillë përjashtuese ndaj të gjitha mendimeve të tjera jashtë atyre të autorit të kritikës jo shkencore, tekst i natyrës profesionale nuk do të dalë asnjëherë nga autori i kritikës jo shkencore. Krejt në fund të pjesës hyrëse, autori i kritikës jo shkencore, në mënyrë naive pret të mirëkuptohet nga lexuesi për kritikën e tij. Pas përmasave tmerruese të cilësimeve subjektive, jo etike, fyese, shpifëse, denigruese dhe tendencioze, ndaj autorëve të kësaj përgjigje dhe librit, është e pabesueshme, nga një njeri normal, që të mund të pritet mirëkuptim nga lexuesi. Autori i kritikës jo shkencore duhet ta dijë, që lexuesi dhe studenti që ka ardhur në fakultet të arsimohet, nuk ka nevojë për produkte subjektive, që të shoh profesion e tij se si godet në mënyrë të ulët kolegët e tij, por ka nevojë për një produkt të mirëfilltë shkencor që të mësojë për të dhënë provimin ose edhe më shumë. Duke marrë parasysh nivelin e kritikës jo shkencore, në këtë rast është absurde të pritet mirëkuptim.

Literatura që është përdorur në përgatitjen e kësaj përgjigje është: literatura e librit, e cila është mjaft e bollshme dhe kredibile si dhe literatura tjetër, e përdorur për argumentim shtesë të kësaj përgjigje. Pjesë e literaturës në këtë përgjigje është edhe libri, me qëllim të sqarimit të pretendimeve subjektive të shprehura nga autori i kritikës jo shkencore, në kritikën e tij. Për fund, gjëja më themelore që nuk e kupton fare autori i kritikës jo shkencore është se teksti universitar, në këtë rast "E Drejta Kushtetuese",

bazohet në një plan program (syllabus) të lëndës, së akredituar, sipas të cilit është shkruar libri dhe shpjegohet lënda. Siç u tha, pjesa më e madhe e përmbajtjes së kritikës jo shkencore, trajton gjëra që nuk lidhen fare me plan programin e lëndës, dedikuar studentëve, madje edhe janë krejt jashtë materies të së drejtës kushtetuese. Kjo megjithatë është një huqje e madhe didaktike e autorit të kritikës jo shkencore. Këtë do ta shohim në përgjigjen tonë edhe më poshtë.

Autorët e kësaj përgjigje, ftojnë lexuesin që të krahasojë faktet e dhëna në këtë përgjigje, me atë që ka thënë autori në kritikën jo shkencore dhe do të binden në qëllimin e kritikës jo shkencore si dhe tendencat jo etike, subjektive dhe tendencioze të autorit të kësaj kritike jo shkencore.

7. Karakteri dhe gjuha e kritikave (recensioneve) të mirëfillta shkencore dhe karakteri jo shkencor i kritikës së botuar në portalin Koha Net

Kevin Smith në një artikull të tij lidhur me rregullat e shkrimit të një kritike shkencore, përmend edhe atë se cila duhet të jetë gjuha e një autori me rastin e paraqitjes së një kritike në raport me autorin tjetër. Smith ndër të tjera nënvizon "***...Toni i kritikës (rishikimit) tuaj duhet të pasqyrojë një qëndrim të sjellshëm. Edhe nëse nuk pajtoheni me autorin, shkruani në mënyrë kolegiale...***" (**Shih: Kevin Smith, How to Write a Book Review, fq.3.; artikulli i arritshëm nw https://www.sats.edu.za/write-book-review-2/, qasur së fundi me 07.10.2018.**)

Në kundërshtim me këtë parim, si dhe në kundërshtim me çdo parim njerëzor, shkencor, profesional dhe etik, autori i kritikës jo shkencore, ka nxjerrë një prodhim, kritik jo shkencor, larg të pa krahasueshëm me kontributet e mirëfillta dhe recensionet shkencore, të autorëve serioz. Edhe pse autori i kritikës jo shkencore me këtë produkt mëton të ketë bërë një "studim kritik", madje në mënyrë qesharake e quan udhëzues për lexuesin.

Edhe pse autori i kritikës jo shkencore me këtë prodhim të tij jo shkencor, mendon se ka dhënë një "kontribut të madh", në të cilin janë përdorur argumente dhe gjuhë shkencore, ajo çfarë shihet në gjithë këtë kritikë jo shkencore të tij, vërteton se autori i saj ka ndërtuar një dokument me qëllim të kundërt që duhet të ketë një recension i mirëfilltë shkencor. E ritheksojmë, jashtë çdo rregulli fetar, njerëzor, shkencor, profesional dhe etik.

Nxjerrja e fjalive jashtë kontekstit dhe shtrembërimi i tyre nga mënyra

se si janë thënë në libër duke krijuar shpifje; cilësimet subjektive për librin dhe autorët e tij; mashtrimi i lexuesit përmes të dhënave të pa vërteta, nga ajo që realisht përmban libri; keqpërdorimi i mënyrës së citimit të autorëve dhe literaturës së përdorur; ndërtimi i një libri mbi libër me një diskurs dhe qëllim keqbërës; gjuha jo etike dhe vullgare e përdorur ndaj librit dhe autorëve të tij si dhe karakteristikat e tjera të përmendura më lart etj. janë disa prej atyre gabimeve që, kanë bërë që kjo kritikë mos të ketë karakterin e një kontributi të mirëfilltë shkencor, për të cilin ka nevojë imediate shkenca juridike e Kosovës dhe më gjerë.

Pavarësisht atyre që u thanë më sipër, ajo që shkel çdo rregull dhe që e bënë kritikën jo shkencore, që vetëm titullin ta ketë "studim kritik", është gjuha e përdorur nga ana e autorit të kësaj kritike jo shkencore. I gjithë ky "kontribut shkencore", siç u tha disa herë, ndërtohet në një gjuhë mjaft të egër, fyese dhe denigruese në raport me autorët dhe librin, si dhe vetë pozitën e një profesori universitar, çfarë mëton se është autori i këtij kritike jo shkencore. "*Me trajtime kaotike", "fusnota fiktive", "konstatime pompoze dhe arbitrare", "pretendojnë ta kenë lexuar", "tezat e tyre fiktive", "manipulim brutal i literaturës", "autorët fare nuk e kuptojnë", "thonë e çfarë nuk thonë", "mos pyet"* etj. janë disa nga shprehjet dhe cilësimet subjektive, të pamatura (***që do të parmendën edhe në vijim më poshtë***) dhe të paargumentuara që autori i kritikës jo shkencore i përdor vazhdimisht në këtë "kontribut të madh të tij shkencor". Por, cilat janë shprehjet që autorët serioz përdorin në rastin e ndërtimit të një recensioni të mirëfilltë shkencorë, kur ndaj një teksti të caktuar kanë një kritikë të caktuar. "*Është gabim serioz" "përkundër virtyteve të tij, libri është i hapur për disa kritika"* këto janë disa fjalë që përdoren në një recension serioz.(**Shih: *John Ohnesorge, Book Review, CURTIS MILHAUPT & KATHARINA PISTOR, LAW & CAPITALISM: WHAT CORPORATE CRISES REVEAL ABOUT LEGAL SYSTEMS AND ECONOMIC DEVELOPMENT AROUND THE WORLD (The University of Chicago Press, 2008), THE AMERICAN JOURNAL OF COMPARATIVE LAW [Vol. 57 2009], fq.944-945***). *"Por ai (autori) kishte gabuar për këtë", "ku ai është i gabuar, mendoj, është në bindjen e tij për shkak se"* po ashtu janë disa të tjera, (***Shih: Jeremy Waldron, Book Review, ON CONSTITUTIONAL DISOBEDIENCE. By Louis Michael Seidman. New York, N.Y.: Oxford University Press. 2012. Pp. 162, HARVARD LAW REVIEW, [Vol. 127:1147 2014],*** **fq.1164 dhe 1172**), *"por problemi shkon shumë më thellë"* etj. (**Shih: Adam Shinar, Book Reviews, THE END OF CONSTITUTIO-**

NAL LAW? ON CONSTITUTIONAL DISOBEDIENCE. By Louis Michael Seidman.1 New York, N.Y.: Oxford University Press. 2013. Pp. xii + 162, CONSTITUTIONAL COMMENTARY [Vol. 29:181 2014], f.185), *"ata nuk ofrojnë arsye për të menduar se"* (***Shih: John Ferejohn, Book Review, THE LURE OF LARGE NUMBERS A CONSTITUTION OF MANY MINDS. By Cass R. Sunstein. Princeton, N.J.: Princeton Univ. Press. 2009. Pp. ix, 225. and LAW AND THE LIMITS OF REASON. By Adrian Vermeule. New York: Oxford Univ. Press. 2009. Pp. 1, 211, HARVARD LAW REVIEW [Vol. 123:1969 2010], fq.1970***), janë disa prej shprehjeve që përdoren nëpër recensione të mirëfillta shkencore në rastet kur një autorë i caktuar jep një kritikë shkencore ndaj një libri të caktuar, të një autori të caktuar.

Pra, kjo është gjuha që përdoret në recensione të mirëfillta shkencore, dhe ky është dallimi me këtë "kritikë jo shkencore". Këtë fakt lexuesi domosdoshmërisht se do ta vërejë dhe i njëjti do të ndërtojë bindjen e tij edhe për gabimet profesionale të autorit të kritikës jo shkencore, por edhe për qasjen jo etike dhe jo profesionale me rastin e përpilimit të këtij "kontributi të madh shkencor", i cili me këtë gjuhë dhe qasje të autorit, vetëm kontribut shkencor nuk mund të jetë. Autorët serioz me rastin e përpilimit të recensioneve nuk fillojnë as me konstatime, as me konkludime të përgjithshme mbi një tekst të caktuar, e assesi me ofendime dhe shprehje tjera subjektive siç edhe bën autori i kritikës jo shkencore. Autorët serioz (**jo autori i kësaj kritike jo shkencore**) në hyrje të çdo pjese ndërtojnë fillimisht argumentin që ata (autorët serioz) e mendojnë se është i drejtë. Pasi e shtjerrojnë atë argument, autorët serioz përmendin edhe pjesët e tekstit ndaj të cilit po ndërtohet ajo kritikë dhe të njëjtat i krahasojnë. Kjo metodologji dhe qasje e kundërt që ka përdorur autori i kritikës jo shkencore, i cili përveç tjerash, qartë shihet që prodhimin e tij e ka hartuar me qëllim tendencioz dhe keqdashës, ndaj librit dhe autorëve të tij, dhe jo për të dhënë një kontribut shkencor. Kjo është edhe ndër arsyet kryesore, përse autorët e librit dhe të kësaj përgjigje, mendojnë që kjo kritikë është jo shkencore, krahasuar me kritikat e tjera serioze dhe të mirëfillta.

Secili që lexon një recension të mirëfilltë shkencor, në fund të leximit të tij, pavarësisht nëse pajtohet apo jo, do të jap vlerësim pozitiv për autorin e atij recensioni, për mundin e tij që ai të zhvilloj debatin shkencor për një temë të caktuar.

Por, fatkeqësisht, kjo nuk do të ndodh me rastin e leximit të kësaj kritike jo shkencore. Në këtë rast, lexuesi mund nuk mund të nxjerr asgjë

më shumë, sesa një autor, i cili subjektivisht, ndërton "argumentet" e tij shkencore, duke pasur në sfond gjithnjë qëllimin e tij të ulët dhe aspak parimor, si ndaj librit ashtu edhe autorëve të tij.

8. Pse kjo kritikë është tendencioze dhe jo shkencore?

Ashtu siç reflektohet edhe në titull, kritika për autorët e librit, por besojmë edhe për publikun e gjerë dhe studentët, nuk përbën një debat shkencor të mirëfilltë, arsyeja kryesore për këtë është karakteri subjektiv dhe cilësimet subjektive, fyese dhe shpifëse që bën autori i kritikës në adresë të librit dhe të autorëve të saj. Subjektivizmi i shfaqur, nxjerr në mënyrë të qartë karakterin tendencioz, jo profesional, lajthitës dhe qëllim keq që ka shprehur autori në kuadër të këtij prodhimi të tij jo shkencor, si ndaj autorëve ashtu edhe ndaj librit.

Të shoqëruar me cilësime subjektive, të pa argumentuara, nga autori i kritikës jo shkencore, për autorët e librit janë disa çështje të cilat e bëjnë këtë kritikë të kualifikohet si tendencioze dhe jo shkencore. Këtu është fjala për çështjet si në vijim:

1. Qëllimet tendencioze, që çdo gjë të shkruar në libër ta analizojë në kontekstin negativ, për të krijuar një imazh për librin dhe autorët e tij;

2. Shpifjet dhe fyerjet ndaj autorëve të librit, që përmenden në masë të konsiderueshme në kritikën jo shkencore;

3. Mos pranimi i idesë ndryshe nga autori i kritikës jo shkencore dhe cilësimi i mendimit ndryshe si gabim, ani pse e drejta kushtetuese dhe shkencat juridike janë shkenca sociale;

4. Keqpërdorimi i literaturës së përdorur nga autorët në libër, duke e nxjerrë jashtë kontekstit literaturën atë, me qëllim që autori i kritikës jo shkencore të mbrojë kryefjalën e tij të përdorur "manipulim", të cilën e përdor mbi 130 herë në përmbajtjen e prodhimit të tij jo shkencor;

5. M 'veshja dhe atribuomi i gjërave që nuk i kanë thënë autorët e librit, deri në nivelin e shpifjes si dhe rrjedhimisht mashtrimi i lexuesit parmës këtyre cilësimeve;

6. Ngatërrimi i literaturës së përdorur nga autorët e librit, me literaturë tjetër çfarë nuk e kanë cituar ata. Autori i kritikës jo shkencore, i referohet një burimi tjetër në raste të caktuara, kurse autorët e librit në fakt kanë përdorur në atë rast një burim literature krejt tjetër. Këtë autori i kritikës jo shkencore e bën me qëllim që gjërat që janë thënë në libër dhe literaturën ta paraqes si "manipulim", duke vërtetuar "teorinë e tij të madhe". Një

gjë të tillë autori i kritikës jo shkencore e bën edhe me autorët, në raste të caktuar ngatërron autorët e tjerë, me autorët që janë cituar në libër;

7. Shkëputja e paragrafëve të librit dhe nxjerrja jashtë kontekstit, krahas asaj që me të vërtetë kanë thënë autorët e librit duke e pasuruar kritikën e tij jo shkencore me elemente shpifëse, që do të shihen në përgjigjen e zgjeruar më poshtë;

8. Tendenca negative e autorit të kritikës jo shkencore, që rreshtat e librit ti krahasojë me libra të tjerë të autorëve shqiptar, me qëllim që të tërhiqen paralele se gjoja këtë faqe janë një riprodhim, ani pse bëhet fjalë për gjëra shkencore në të drejtën kushtetuese, që autorët shqiptarë por edhe të huaj i thonë njëjtë, pasiqë janë fakte notore dhe të njëjta pothuajse që 200 vite dhe të cilat autori i parë i librit i ligjëron që 37 vite. (Këtu hyjnë për shembull: kuptimi i të drejtës kushtetuese, kuptimi i kushtetutës, ndarja e kushtetutave; struktura dhe përmbajtja e kushtetutës; miratimi i kushtetutave etj.);

9. Përpjekja e vazhdueshme e autorit të kritikës jo shkencore që të lajthitë dhe mashtroj lexuesin, me qëllim që të krijojë imazhin dhe përshtypjen negative për librin;

10. Qasja dhe cilësimet subjektive të autorit të kritikës jo shkencore, të përsëritura shumë shpesh në kritikën jo shkencore, siç i kemi potencuar më sipër;

11. Gabimet profesionale themelore të autorit të kritikës jo shkencore, në të kuptuarit e mënyrës së citimit duke e lidhur këtë me "teorinë e madhe të manipulimit";

12. Nxjerrja e kuptimeve të reja nga autori i kritikës jo shkencore, duke tentuar ti ndryshoj nocionet themelore të së drejtës kushtetuese;

13. Trajtimi i temave, jashtë kontekstit tematik të librit vetëm sa për të rritur vëllimin, duke harruar që ky tekst i përshtatet një plan programi zyrtar (syllabusi) për nivelin themelor; 14. Shfaqja e vazhdueshme e autorit të kritikës jo shkencore, me një dozë të lartë subjektivizmi për të treguar dijen e tij me qasje monopolistike, jashtë kontekstit të asaj që thonë autorët në libër;

15. Shtrembërimi i qëllimshëm i gjërave që kanë thënë autorët në libër, me synim që të krijojë tek lexuesi një bindje negative për librin;

16. Pakuptimësia, jo lidhshmëria e temave dhe përsëritja e tyre në mase të madhe, jashtë çdo konteksti tematik si dhe;

17. Tentimi i autorit të kritikës jo shkencore, që ti imponojë lexuesit dhe autorëve të librit, se çfarë literature duhet të konsultojnë dhe lexojnë,

duke e luajtur kështu rolin e "gardianit të literaturës" juridike.

Këto karakteristika tendencioze të kësaj kritike jo shkencore, lexuesi do t'i vërej gjatë kësaj përgjigje, rast pas rasti, ku qartë shihen pretendimet dhe synimet e karakterit krejt sulmues dhe subjektiv të autorit të kritikës jo shkencore ndaj librit si dhe autorëve të tij.

9. Subjektivizmi si veçori tjetër themelore e kësaj kritike jo shkencore

Siç u tha edhe në hyrje dhe në disa pjesë më lart, përderisa fjala më e përdorur nga ana e autorit të kritikës jo shkencore është "manipulim" dhe fjalë të tjera fyese. Duke marrë parasysh këtë fakt, autorët e librit por me plot të drejtë e cilësojnë këtë kritikë si subjektive, për arsyet që do të përmendet në rreshtat vijues.

Sipas fjalorit të Kembrixhit, shprehja "**subjektiv**" nënkupton **"...të influencuarit ose të bazuarit në besime apo përjetime personale, duke mos u bazuar në fakte..."** (**Cambridge Advanced Learner's Dictionart, Third Edition, Cambridge, United Kingdom, 2008, f.1451**). Në bazë të këtij fjalori, shprehja "subjektiv" përcakton të kundërtën e kuptimit të shprehjes "objektiv" (**Fjalori i cituar, f. 977**).

Në gjithë këtë kritikë jo shkencore, qasja subjektiviste e autorit të saj ka qenë e theksuar në çdo rresht, ku autori ka ardhur në përfundime, duke mos u bazuar në fakte, që me të drejtë mund t'i quajmë përjetime personale, duke shtrembëruar faktet, për nevoja të tij dhe të "argumenteve" që ndërton për të realizuar qëllimet keqdashëse.

Autori i kritikës jo shkencore nuk e ka ndërtuar këtë prodhim të tij mbi bazën e argumenteve dhe rregullave të zhvillimit të debatit akademik, por i njëjti vetëm ka shprehur subjektivizmin e tij duke shkuar deri në ofendime të ndryshme, siç u tha edhe më sipër, çfarë më së paku i përkasin një debati të mirëfilltë juridik. Këto ofendime, janë të shoqëruara me shpifje, fyerje ndaj autorëve, si dhe lajthitje të lexuesit dhe studentit. Këtu assesi nuk përjashtohen as gabimet profesionale, të autorit të kritikës jo shkencore.

Janë disa nga shprehjet subjektive, jo etike, fyese etj, që autori i kritikës jo shkencore i përdor vazhdimisht kur flet për librin. Shprehjet subjektive janë: *"...veçohet ai i mosdijes së tyre...", "...Me qëllim manipulimi...", "...libri dëmton rëndë çdokënd..."; "...Me trajtime kaotike...", "...fusnota fiktive...", "...konstatime pompoze dhe arbitrare...", "...pretendojnë ta kenë lexuar"..., "...tezat e tyre fiktive"..., "...manipulim brutal i literaturës"..., "...autorët fa-*

re nuk e kuptojnë"..., "...të pa lexuar nga autorët..."; "...përmasat tragjike të gabimeve profesionale..."; "....nga kjo libër studentët marrin padije të thellë..."; "...po të kishin dashur autorët tanë, kanë pasur mundësi të mësojnë, "Këtë nuk e kanë bërë edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre primare..."; "...autorët tanë e kanë shumë gabim..."; "...periodizimi më i shfytyruar që mund të hasë njeriu..."; "...absurdi i autorëve tanë është edhe më skandaloz..."; "...Autorin X, të cilin autorët tanë si duket nuk e kanë kuptuar si duhet..."; "...Autorët tanë, as idenë më të vogël nuk e kanë se çfarë paraqet Kushtetuta e Spanjës 1812.."; "...gabim skandaloz..."; "...gabim trashanik..."; "...manipulim i literaturës dhe mashtrim i lexuesit..."; "...gabime themelore profesionale..."; "...reflekton mosnjohjen e autorëve të koncepteve siç janë erga omnes dhe inter partes..."; "...konstatim "epokal"..."; "...autorët tanë po ta kishin lexuar do ta kuptonin.."; "...konstatime të çoroditura..." etj etj. Këto shprehje, më së paku i takojnë një debati shkencor dhe një gjuhe të mirëfilltë të këtij karakteri, çfarë mëton se e ka profilin autori i kritikës jo shkencore. Andaj bazuar në këto cilësime subjektive, të influencuara dhe krejt personale të autorit të kësaj kritike, me të vërtetë ky prodhim i tij, nuk ka të bëjë me një debat shkencor dhe për këtë do të bindet edhe lexuesi e aq më shumë një student, që kërkon dijen themelore, e që në këtë kritikë do të sheh dhe vlerësoj profesorin e tij, që sulmon në mënyrë krejt personale kolegët e tij të fakultetit. Kjo qasje edukuese nuk është ajo çfarë autori i kritikës jo shkencore duhet të ju japë gjeneratave të reja, aq më pak studentëve të tij, për të cilët thotë se sakrifikon, ani pse në kritikën e tij jo shkencore, i ofron atyre (studenteve) një produkt që nuk do të duhej të ishte pjesë e edukimit të studenteve dhe aspak nuk hyn në misionin e një profesori, i "kalibrit" çfarë mëton të jetë autori i kritikës jo shkencore.

Për të gjitha shprehjet e sipërpërmendura, autori i kritikës jo shkencore nuk ka dhënë një argumentim se pse një çështje e caktuar e përmendur në libër mund të kualifikohet me termat e sipërpërmendura, por konstatimi i tij në këtë mënyrë ka qenë "argumenti" i vetëm dhe këtë e ka bërë sipas qejfit dhe gjykimit subjektiv.

Në anën tjetër, për shumë çështje në të cilat ka teori të ndryshme të interpretimit dhe në të cilat autorët e ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar janë të ndarë, autori i kritikës jo shkencore përmes qasjes së tij subjektive i referohet vetëm atij mendimi që ai vet e përkrahë, duke mos pranuar fare një mendim ndryshe të përmendur në teorinë e së drejtës kushtetuese, çka është parim bazë në këtë shkencë dhe shkencat e tjera.

Tutje, autori i kritikës jo shkencore, siç e përmendëm edhe më sipër,

në disa raste edhe "hatrohet" se në një temë të caktuar nuk i është cituar punimi i tij, duke menduar se gjithë ajo çfarë ai ka shkruar dhe ka thënë, është pikë reference bazike për ato tema. Autori i koritës jo shkencore në shumë pjesë flet gjëra tejet jo relevante, me qëllimin e vetëm që në fund të asaj pjese të përmend një punim të caktuar të tij, duke i dhënë të njëjtit epitetet më të larta, sikurse i jep edhe vetës me tendencën për të krijuar një të vërtetë absolute, me qasje monopolisitike. Përderisa autori i kritikës jo shkencore vetëm ka dhënë përfundime të pamatura me rastin e shkrimit të kësaj kritike, duke mos shpjeguar se pse një term i përshtatet "argumentimit" që bënë ky autor, autorët e librit në këtë përgjigje shpjeguan në mënyrë të detajuar se pse ky prodhim jo shkencor, cilësohet edhe si subjektive.

Natyrën e subjektivizmit të kësaj kritike jo shkencore që po e trajtojmë në këta rreshta, do ta shtjellojmë edhe në të gjithë rreshtat pasues si dhe në përgjigjen e zgjeruar, për të cilët edhe lexuesi do të bindet se janë të tillë.

10. Mbi teorinë e përdorimit dhe rishikimit të literaturës

Siç do ta shohim më poshtë, autori i kritikës jo shkencore më së shumti hedhë kritika mbi përdorimin e literaturës, duke "argumentuar" se të njëjtat nuk janë përdorur si duhet dhe duke e lidhur këtë me "teorinë e tij të madhe të manipulimit".

Autori i kritikës jo shkencore duke u munduar të shpërfaq paqartësi në këtë drejtim, në shumë vende cilëson se literatura e përdorur në libër nuk është në rregull. Madje, autori i kritikës jo shkencore, me apo pa dashje, keqkupton teorinë e përdorimit të literaturës dhe citimit. Për shkak të kësaj, në gjithë produktit të tij ai i referohet përdorimit të literaturës si "manipulim", nocion të cilin do ta definojmë më poshtë.

Autorë të shumtë kanë përcaktuar metoda dhe kanë dhënë shpjegime rreth asaj se çka dhe si mund të përdoret literatura në një tekst.

Në këtë drejtim, para se të kalojmë tek elementet e tjera të definimit të kësaj çështje, janë dy lloj burimesh që përdoret në tekste, me rastin e përdorimit të një literature. Është fjala për burimet primare dhe sekondare, përkatësisht burimet kryesore dhe dytësore. Me burim kryesor nënkuptojmë përdorimin e një të dhëne apo raporti origjinal nga studiuesi i një studimi. Me burim sekondar nënkuptojmë burimin që përmban përshkrimin ose përmbledhjen nga dikush tjetër, dhe jo nga studiuesi origjinal i

një të dhëne apo raporti (**Shih: Abdullah Ramdhani, Muhammad Ali Ramdhani, Abdusy Syakur Amin, Writing a Literature Review Research Paper: A step-by-step approach, International Journal of Basics and Applied Sciences, Vol. 03, No.01, July 2014, fq.47-56**). Pra, kemi të bëjmë me burime të cilat cilësohen si të dorës së dytë (**Lidhur me kuptimin e literaturës primare dhe sekondare, shih: https://laverne. lib guides.com/c.php?g=34942&p=222059, qasur së fundi me 05.10.2018**). Në këtë drejtim, ka edhe kategorizime të tjera të llojeve të burimeve, mirëpo këto janë ndër më kryesoret.

Po ashtu, një mënyrë tjetër për citimin e literaturës është edhe nxjerra e konkluzioneve nga literatura e përdorur, që nuk do të thotë se literatura e futur në tekst të jetë fjalë për fjalë siç është thënë edhe në tekstin e një autori të caktuar që citohet. Pra në këto raste, citohet teksti, i cili është një mbështetje e interpretimit që bëhet në temën e caktuar. Këto pra quhen burime sekondare, ose citime sekondare të burimeve. (**Shih: Umberto Eco *"Si bëhet një punim diplome"*, botime përpjekja, Tiranë 1997, përktheu nga origjinali Kristina Jorgaqi, fq.206**). Kjo pra nënkupton që citimet mund të bëhen edhe në mënyrë indirekte, duke mbështetur interpretimet që bën autori i caktuar.

Një rregull tjetër e citimit, të cilin autori i kritikës jo shkencore, nuk e ka pasur parasysh është edhe fakti, se jo gjithmonë në kuadër të citimit, duhet të jesh me një mendje me autorin që citon, kjo pra përbën një përjashtim. Duke mos e kuptuar këtë, autori i kritikës jo shkencore, siç do të shohim edhe më poshtë, bën cilësime subjektive, duke e përdorur fjalën "manipulim" si dhe mendon se autorët e librit "nuk e kanë kuptuar" një burim të caktuar, duke mos e kuptuar mënyrën e përdorimit të literaturës dhe citimit. (**Shih: Umberto Eco "Si bëhet një punim diplome", botime përpjekja, Tiranë 1997, përktheu nga origjinali Kristina Jorgaqi, fq.208**). Një aspekt tjetër, të cilën autori i kritikës jo shkencore, e ka keqkuptuar dhe e ka quajtur "manipulim" është edhe citimi nga burimet e tërthorta, një standard ky i lejuar, kur citon nga një burim, por që ajo që citon nuk është thënie e burimit por e një autori tjetër. (**Shih po ashtu: Umberto Eco "Si bëhet një punim diplome", botime përpjekja, Tiranë 1997, përktheu nga origjinali Kristina Jorgaqi, fq.237**). Pra edhe në këtë çështje, do të shihet qartë tendenca keqdashëse e autorit të kritikës jo shkencore ndaj librit, respektivisht autorëve të saj, në kuadër të përgjigjes më poshtë.

Gjithnjë në kontekstin e përdorimit të literaturës, jepet edhe një defi-

nicion lidhur me analizimin dhe sintetizimin e literaturës së përdorur si në vijim: "*Pasi të keni grumbulluar artikujt që synoni të përdorni, duhet të analizoni secilën prej tyre dhe të ndani informacionin e rëndësishëm në të. Pastaj duhet të sintetizoni mbledhjen e artikujve, ti integroni ato dhe të identifikoni konkluzionet që mund të nxirren nga artikujt në grup*" (**Shih: Abdullah Ramdhani, Muhammad Ali Ramdhani, Abdusy Syakur Amin, vepra e cituar fq.51**).

Në këtë formë është vepruar edhe në libër, ku në shumë raste është nxjerrë një konkluzion pasi është analizuar një pjesë e madhe e literaturës dhe autorëve, dhe pas këtij konkluzioni janë cituar të njëjtit. Por, nëse autori i kritikës jo shkencore mendon se atë konkluzion do ta gjejë në të gjitha burimet e cituara në formulimin fjalë për fjalë si në libër, atëherë për shkak të kësaj natyre të pranuar dhe të avancuar të citimit të përdorur në libër, nuk do të ketë mundësi. Është pikërisht ky keqkuptim nga ana e autorit të kritikës jo shkencore që ka bërë që të hedhë dyshim mbi shumë burime të përdorura në libër, dhe me lehtësinë më të madhe të njëjtat ti quaj "manipulim", pa argumentuar fare se përse e bën ketë. Ani pse kjo lidhet me mënyrën e citimit, ashtu siç e kuptojnë autorët e ndryshëm, sepse natyrshëm jo të gjithë citimet dhe burimet e literaturës, i përdorin dhe i kuptojnë njëjtë.

Është shumë normale që nga rishikimi i literaturës së përdorur të nxjerrën konkluzione të caktuara, të ristrukturohen dhe përpunohen këto të gjetura, pasi citimi i fjalë për fjalë të secilit burim do ta kthente shkrimin e një teksti akademik, në një shkrim të natyrës mediale. Metodë tjetër që autorët kanë përdorur në libër, është edhe ajo që për tema të caktuara të ipet edhe literaturë shtesë. Kjo për arsye se libri përpos që do të shërbej si material primar për mësimin e temave kyçe të drejtësisë kushtetuese, i njëjti do të jetë edhe si një udhërrëfyes për studentin dhe lexuesin, nëse ata kanë vullnet që të thellohet në këto tema. Për këtë arsye, literatura e përdorur në libër është vënë në depoziton që, përpos të mbështetet argumenti ku janë bazuar autorët e librit, e njëjta të jetë edhe e arritshme për studentin dhe lexuesin. Këto lloje të burimeve, përdoren zakonisht përmes referencave udhëzuese, ku lexuesit udhëzohen edhe në pjesë të tjera të burimit të njëjtë, përveç faqes specifike, një mënyrë kjo e përdorur edhe në shumë pjesë të librit nga autorët. (**Shih më shumë: Mid'hat Shamiq "Si shkruhet vepra shkencore", përktheu Nexhat Ibrahimi, botoj Logos A, fq.157-158**). Me lehtësinë më të madhe dhe qasje krejt subjektive, sipas gjykimit të tij, autori i kritikës jo shkencore thotë se përdorimi i burimeve

në këtë formë është tërësisht "jo relevante" dhe i përbuz ato, duke krijuar "teorinë e tij të madhe të manipulimit".

Në fakt, **Mid'hat Shamiq** në librin e tij, "**Si shkruhet vepra shkencore**", pranon se referencat (fusnotat), mund të jenë objekt **edhe i sulmeve dhe i përbuzjeve (siç është rasti i sulmit që ka bërë autori i kritikës jo shkencore ndaj librit)**. Këtu e ka fjalën për referencat dokumentuese, që përdoren për të dokumentar diçka si dhe referencat udhëzuese, që udhëzojnë lexuesin, në zgjerimin e njohurisë së tij/saj. Në fakt autorët në libër, kanë përdorur këto lloje citimesh përfshirë edhe fusnotat eksplikative (sqaruese). Lidhur me ketë çështje **Mid'hat Shamiq** pohon: "***...derisa sipas rregullit, pranohen vlera dhe dobia e shënimeve eksplikative, në anën tjetër, të dy llojet e tjera të shënimeve (fusnotat ose citimet) dokumentuese dhe fusnotat (citimet) udhëzuese), shpesh herë janë objekt i sulmeve dhe përbuzjeve: i konsiderojnë shenjë e shkrimtarit pedant, të privuar nga elani dhe imagjinata dhe në esencë të shkrimtarit të bezdisshëm. Këto sulme dhe përçmime janë, ndërkaq, në bazë të pa arsyeshme dhe të padrejta, duke marrë parasysh që edhe ky lloj i shënimeve ka në punën shkencore qëllimin e vet të caktuar e të arsyeshëm***". (**Shih më shumë: Mid'hat Shamiq "Si shkruhet vepra shkencore", përktheu Nexhat Ibrahimi, botoj Logos A, fq.158**).

Ky konstatim i **Shamiqit**, siç e thamë, vërtetohet katërcipërisht në rastin e kritikës jo shkencore, ku autori i tij, në çdo rresht të librit, sulmon citimet, në mënyrë krejtësisht tendencioze dhe keqbërëse, duke thurur cilësime subjektive dhe duke aluduar në manipulim, pa e kuptuar as ai vetë se çka do të thotë kjo realisht, si dhe me mungesë elementare të rregullave të citimit. Po ashtu, në teorinë e rishikimit dhe përdorimit të literaturës, nuk ka ndonjë kufizim rreth asaj se çka lejohet të përdoret si burim. Në këtë drejtim, mund të nënvizojmë se është e lejuar që të përdoren libra, monografi, punime shkencore, artikuj, lajme nëpër portale të ndryshme, video në internet, linqe të internetit etj. Kjo vërtetohet edhe në bazë të **"Bluebook"**, në të cilin theksohet se në një tekst mund të citohen: libra, punime, revista, artikuj të gazetave, raste dhe dokumente gjyqësore, kushtetuta, statute, rregulla dhe rregullore, burime dhe të dhëna nga interneti etj. (**Shih: The BLUEBOOK – A Uniform System of Citation, Compiled by the editors of the Columbia Law Review, the Harvard Law Review, the University of Pennsylvania Law Review, and The Yale Law Journal, nineteenth Edition, USA, 2010 f.7-28**).

Megjithatë, në teori përmendet se ka kufizime në citimin e fakteve

notore (botërisht të ditura dhe që njihen nga të gjithë), por që zakonisht në raste të tilla, autorët në libër kanë përdorur citime udhëzuese. (**Shih: Umberto Eco "Si bëhet një punim diplome", botime përpjekja, Tiranë 1997, përktheu nga origjinali Kristina Jorgaqi, fq.235**). Megjithatë, edhe këto koncepte për autorin e kritikës jo shkencore, janë të papranueshme dhe këtë do ta shohim, në vijim të përgjigjes ndaj kësaj kritike jo shkencore.

Gabim tjetër që bënë autori i kritikës jo shkencore, është se i njëjti e kupton teknikën e citimit vetëm si pamje e jashtme, duke mos qenë i informuar se ato elemente janë futur në këto forma të citimit për të shërbyer për diçka përmbajtjesore.

Në të gjitha stilet e citimeve, përball asaj se kemi ndryshime në stil, ato përcaktojnë se krahas autorit dhe titullit të një burimi të caktuar, është e domosdoshme që të përmenden edhe të dhënë të tjera, siç janë botuesi, vendi i botimit, viti i botimit etj. Kjo nuk është e rastësishme dhe tërësisht e panevojshme për materien e citimit, pra nuk është gjithçka teknike. Kjo për arsye se një tekst i caktuar botohet nga botues të ndryshëm, në vende të ndryshme, ribotohet në edicione të ndryshme dhe në vite të ndryshme. Të gjitha këto elemente, ndikojnë që teksti të pësojë një dozë të ndryshimit, sa i përket karakteristikave teknike të tij. Në këtë drejtim, nëse në një tekst të caktuar të një botimi të caktuar, një e dhënë gjendet në një faqe të caktuar, në botimin tjetër ajo e dhënë gjendet në atë tekst, por jo domosdoshmërisht edhe në atë faqe. Për shkak se autori i kritikës jo shkencore, me apo pa dashje, e ka keqkuptuar këtë element jetik të përdorimit të fusnotës, ai në shumë raste vie deri te konkludimi se autorët e kanë "manipuluar" një tekst të caktuar. Kjo për arsye se kur autori i kritikës jo shkencore ka bërë krahasimin e tekstit në libër me literaturën e përdorur, nuk e ka përdorur botimin e njëjtë, por një botim tjetër, dhe rrjedhimisht, tekstin e cituar në libër nuk e ka gjetur në atë faqe që përmendet në fusnotë. Një gjë e tillë do të shihet në pjesën e plotë të përgjigjes. Ndoshta kjo është një çështje shumë elementare, por fatkeqësisht, për shkak të keqkuptimit të kësaj çështje elementare nga ana e autorit të kritikës jo shkencore, ai ndërton "argumente" në rolin e "gardianit të literaturës dhe shkencës juridike". Shembuj konkret të kësaj që thamë do të përmendim më poshtë, me rastin e përgjigjes ndaj "argumenteve" të autorit të kritikës jo shkencore për "manipulim të literaturës". Pra autori i kritikës jo shkencore ka keqpërdorur në tërësi mënyrën e citimit të autorëve të librit, duke i shfrytëzuar në një tjetër mënyrë literaturën e përdorur në libër, me qëllim që të

nxjerr jashtë kontekstit atë që kanë thënë autorët dhe vetë librin. Edhe këtë, siç do të shihet më poshtë, gjatë përgjigjes, ai e bën duke e shprehur në mënyrë ekstreme qasjen e tij subjektive. E ritheksojmë, që në rastin e kësaj kritike jo shkencore, është vërtetuar thënia e mësipërme e M.Shamiqit, që "**...fusnotat (citimet) shpesh herë janë objekt i sulmeve dhe i përbuzjeve...**". Këtë pra e ka bërë autori i kritikës jo shkencore, por në një mënyrë krejt jo etike dhe jo shkencore, si dhe në mënyrë tendencioze, keqbërëse dhe subjektive, duke aluduar në gjëra të pa qena, që ai vet shihet qartë se nuk i kupton.

11. Manipulimi me literaturë, kuptimi i saj dhe ndërtimi i "teorisë së madhe" nga autori i kritikës jo shkencore

Ndonëse sa i përket përdorimit të literaturës dhamë shpjegime më lartë, në këtë pjesë do të trajtojmë edhe fjalën më të përmendur në këtë kritikë jo shkencore: "manipulim". Për dallim nga kjo përgjigje, autori i kritikës jo shkencore, nuk ka dhënë ndonjë definicion lidhur me "manipulimin me literaturë", por vetëm ka dhënë përfundime ta pa argumentuara, se një apo tjetër burim literature është e "manipuluar". Autori i kritikës jo shkencore në këtë drejtim mjaftohet vetëm me këtë "konkluzion", duke mos përmendur në asnjë rast se pse përdorimi i literaturës në një formë të caktuar cilësohet si "manipulim". E gjithë kjo "zhurmë" e autorit të kritikës jo shkencore lidhur me përdorimin e fusnotave, lidhet me mungesën e njohurive të tij ose faktin që dëshiron të ja imponojë të tjerëve formën dhe mënyrën se si ai vetë i përdor burimet e literaturës dhe se si i citon ato. Përkitazi me teknikat e përdorimit të literaturës, folëm në rreshtat paraprak. Krejt çka bën autori i kritikës jo shkencore në këtë drejtim, në kuadër të produktit të tij, është të bindë të tjerët, që literatura përdoret vetëm siç ai e përdor.

Fillimisht, duhet të potencojmë se ky term nuk është termi kryesor mbi keqpërdorimin e literaturës dhe formave të caktuara të plagjiatit. Madje madje, ky term në definimet shkencore përmendet vetëm si një ndër elementet të cilat nuk duhet përdorur, me rastin e përdorimit dhe rishikimit të literaturës. Nga kjo vijmë në konkludim se autori i kritikës jo shkencore, me rastin e përdorimit të kësaj shprehje, nuk ka përdorur assesi një qasje profesionale, por është mbështetur vetëm në një thënie që ngrit më shumë pompozitet, bazuar në qasjen e tij subjektive, të cilën do ta sqarojmë, po ashtu edhe më poshtë.

Në punimin e **ALLEA (All European Academie)** me titull **"Kodi Europian i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor"** termi "manipulim" përmendet në dy kuptime, si i veçante dhe si i ndërlidhur me një term tjetër.

Në këtë botim, si shkelje e drejtpërdrejtë e praktikave të kërkimit përmendet edhe manipulimi, ku definohet si ***"Manipulimi i autorësisë apo denigrimi i rolit të kërkuesve të tjerë në botime"***. Ndërsa, si i ndërlidhur me një term tjetër, përmendet me rastin e shpjegimit të ***"falsifikimit"***, ku thuhet se ***"Falsifikimi është manipulimi i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshimi, heqja apo shmangia e të dhënave apo rezultateve pa justifikim"***. Kjo më së shumti transmetohet gjatë përkthimit të teksteve, nga një gjuhë në tjetrën. Asnjëherë autorët e kësaj përgjigje nuk gjejnë të dhëna se si definohet manipulimi me fusnota, që shpërfaq "teorinë e madhe" të autorit të kritikës jo shkencore. Pra ky nuk është rasti, që ngrit autori i kritikës jo shkencore ndaj librit, i njëjti thjesht ka probleme me mënyrën e citimit.

Si shkelje e praktikave të kërkimit përmendet edhe terma të tjerë, siç janë fabrikimi (sajimi i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta), plagjiatura (është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit origjinal, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale), ribotimi i pjesëve thelbësore të botimeve të veta më të hershme, pa cituar origjinalin ('vetëplagjiarizëm'), citimi në mënyrë përzgjedhëse për të zmadhuar gjetjet e veta ose për të kënaqur redaktorët apo kolegët, fshehja e rezultateve të kërkimit, lejimi i financuesve / sponsorizuesve të rrezikojnë pavarësinë gjatë procesit të kërkimit ose në raportimin e rezultateve, me qëllim krijimin e konteksteve të njëanshme, zgjerimi në mënyrë të panevojshme i bibliografisë së një studimi etj.

Edhe sikur autori i kritikës jo shkencore, si fjalë përmbledhëse të të gjitha këtyre mënyrave të shkeljes së praktikave të kërkimit të ketë zgjedhur fjalën "manipulim", i njëjti nuk ka dhënë në asnjë rast arsyetim se pse burimet e përdorura në libër përbëjnë "manipulim", dhe nëse përdorimi i tillë përbën ndonjërën nga elementet e definuara më lartë mbi shkeljet e praktikave të kërkimit. Autori i kritikës jo shkencore, për fat të keq, gjithë "teorinë e madhe të manipulimit" e ndërton mbi keqkuptimin që ai i bën mënyrës së përdorimit dhe rishikimit të literaturës, respektivisht të citimit në libër, të cilën as shihet se nuk e ka të qartë.

Autori i kritikës jo shkencore nuk ka pasur mundësi që këto "shkelje"

ti argumentojë në mënyrë profesionale, pasi autorët e librit me rastin e hartimit të tij i kanë pasur parasysh të gjitha këto nocione dhe të njëjtave u janë përmbajtur. Por, autori i kritikës jo shkencore ka keqkuptuar ose nuk i ka kuptuar, me apo pa dashje këto nocione, dhe në pamundësi të argumentimit të tyre, ka vazhduar me qasjen e tij subjektive, duke e bërë fjalë kyçe të kritikës jo shkencore, fjalën "manipulim".

Tutje, si formë e shkeljes së praktikave të kërkimit përmendet edhe **"Akuzimi i një studiuesi për sjellje të papranueshme apo shkelje të tjera në mënyrë keqdashëse"**. Në këtë drejtim, është pikërisht autori i kritikës jo shkencore, ai i cili bënë këtë shkelje me rastin e publikimit të produktit të tij. Mënyra jo profesionale, keqdashëse dhe subjektive se si është ndërtuar kjo kritikë, përbën shkelje të kësaj praktike dhe këtij parimi. Pra, autori i kritikës jo shkencore shkelë pikërisht këto parime bazike të etikës së kërkimit profesional, me rastin e ushtrimit të "rolit të tij" si "gardian i literaturës dhe shkencës juridike". Këtë e dëshmojnë edhe shprehjet subjektive që ka përdorur autori i kritikës jo shkencore, të theksuara më sipër. (**Shih: "Kodi Europian i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor" ALLEA – All European Academies, Berlin 2018, fq.9-10**) Sa i përket termit të manipulimit, duhet të ritheksohet edhe njëherë një fakt. Ky term pra, në shumicën e rasteve në kontekst të kërkimit shkencor ka të bëjë me mënyrën e përkthimit të një burimi. Kjo teori fillon me definicionin se ***"parimisht çdo tekst i përkthyer ka në vetvete një dozë të manipulimit"***. Pas kësaj, ndërtohen edhe parime dhe rregulla të përkthimit të një literature, duke përmendur kufijtë në të cilët ka fleksibilitet me rastin e përkthimit, në mënyrë që teksti mos të jetë i manipuluar (**Shih: Theo Hermans, The Manipulation of Literature – Studies in Literary Translation, Routledge, New York, 1985**).

Në këtë drejtim, autori i kritikës jo shkencore nuk e definon "manipulimin e argumentuar" në këtë prizëm, por siç e thamë edhe më lartë, vetëm në prizmin e qasjes së tij jo profesionale dhe subjektive, duke thënë çka të dojë vetë.

Përderisa autorët e librit i janë shmangur edhe kësaj forme të "manipulimit", autori i kritikës jo shkencore, ka bërë pikërisht këtë manipulim me rastin e draftmit të këtij produkti të tij jo shkencor. Për shembull kjo ka ndodhur në rastin kur është përkthyer vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, siç do të shohim më poshtë. Mbi bazën e këtij manipulimi, autori i kritikës jo shkencore, akuzon vetë autorët e librit për manipulim (shih: Kritikën jo shkencore, fq.162). Ky rast, si dhe rastet e tjera se

si autori i kritikës jo shkencore, duke tentuar të "argumentojë" "manipulimin", vetë keqpërdor dhe manipulon, do të vihen në dispozicion të lexuesit, në pjesën e mëposhtme si dhe në përgjigjen e zgjeruar, sipas metodës rast për rast. Keqpërdorimi i literaturës së përdorur në libër, nga autori i kritikës jo shkencore, është i theksuar edhe në mënyra të tjera krejt subjektive, në këtë kritikë si: m ʻveshja e gjërave të pa thëna të autorëve të librit, shtrembërimi i fakteve që kanë thënë autorët e librit, shtrembërimi i kontekstit dhe mënyrës se si autorët e librit kanë përdorur literaturën, shtrembërimi i mënyrës së citimit dhe kualifikimi si "manipulim" në mënyrë tendencioze, ngatërrimi i literaturës së përdorur nga autorët me literaturën që përdor autori i kritikës jo shkencore etj. Është e vërtetë se në këtë pjesë edhe autorët e kësaj përgjigje po i referohen termit manipulim, mirëpo për dallim nga autori i kritikës jo shkencore që këtë term e përdor në mënyrë jo profesionale dhe subjektive, autorët e librit dhe të kësaj përgjigje argumentojnë profesionalisht se pse kjo qasje e autorit të kritikës jo shkencore është jo profesionale dhe manipuluese.

Fatkeqësisht, siç do të shohim më poshtë, kjo frymë e "argumentimit" e përcjell gjithë këtë kritikë jo shkencore "voluminoze".

12. Përfundimi i fillimit të një përgjigje, ndaj një kritike jo shkencore

12.1.Autori i kritikës jo shkencore nuk ju përmbajt rregullave të debatit shkencor në kritikën e tij të botuar në portalin Koha Net

Autori i kësaj kritike jo shkencore, pikërisht në mënyrën se si e kishte ndërtuar gjithë këtë prodhim të tij jo shkencor, po në mënyrën e njëjtë kishte zgjedhur ta bëjë edhe publikimin dhe promovimin e këtij "zbulimi të madh".

"Kontributi shkencor" në stilin "Enver Hasançe" nga autori i kësaj kritike jo shkencore, ishte përcaktuar që mos të promovohet dhe diskutohet në hapësira serioze dhe akademike, por me anë të promovimit të saj në media dhe facebook. Strategjikisht, në ditën kur po fillonte viti i ri akademik dhe studentëve po i prezantohej libri.

Me publikimin e kësaj kritike në portalin Koha.Net, autori i kritikës jo shkencore në vend të zhvillimit të debatit të mirëfilltë shkencor dhe akademik kishte zgjedhur debatin medial. Këtu vazhdimisht përmendej "vëllimi" i kësaj kritike jo shkencore, pasi sipas autorit saj, "vëllimi" i kritikës përbënte "lajmin e madh medial".

I njëjti për hyrje kishte zgjedhur "5 gabimet themelore" dhe "3 cilësitë themelore të gabimeve" të autorëve të librit. E gjithë kjo që ai të bënte lajm, dhe që nga kjo shihet se ai nuk e kishte dert studentin dhe lexuesin të cilin e përmend vazhdimisht në këtë kritikë jo shkencore. A ishin pretendimet e autorit të kritikës jo shkencore me të vërtetë "gabime themelore", nuk ishte me rëndësi, ai kërkonte "lajmin e madh medial" dhe goditjen pa hak ndaj kolegëve të tij të Fakultetit Juridik.

E ritheksojmë, autori i kritikës jo shkencore kishte zgjedhur pikërisht fillimin e vitit të ri akademik për publikimin e kësaj kritike jo shkencore. E gjitha kjo me qëllim që ta dezinformojë dhe mashtrojë publikun e lexuesin, lidhur me "vlerat" e larta profesionale dhe shkencore që përmbante prodhimi i tij.

Theksojmë dhe besojnë fuqishëm se çdo debat dhe kritikë e mirëfilltë akademike është e mirëpritur për autorët e librit, ashtu siç është thënë edhe në parathënie të këtij libri, por kritika dhe debati duhet të jenë shkencore. Për debatet mediale në kërkim të "lajmit të madh" këtu nuk është bërë fjalë.

Mënyra se si autori i kësaj kritike jo shkencore e ka ndërtuar dhe promovuar këtë prodhim të tij kritik tendencioz, shërben shembullin më të keq të zhvillimit të një debati shkencorë dhe akademik. Një debat i mirëfilltë shkencor dhe akademik i mungon shkencës juridike kosovare, dhe zhvillimi i tij është shumë i rëndësishëm. Pritjen e publikut dhe studenteve, për një debat shkencor në ketë rast dhe më tutje, e ka lënduar dhe njollosur ekstremisht, autori i kritikës jo shkencore, me prodhimin e tij, të botuar në portale, duke promovuar kështu, "shkencën" e portaleve, për herë të parë e njohur në Kosovë dhe më gjerë, për nga karakteri dhe mënyra e zhvillimit. Nga kjo asgjë nuk mbetur debatit të mirëfilltë shkencor.

Krejt në fund, përpos kësaj përgjigje, për arsyet e sipërpërmendura, autorët e librit do ta publikojnë përgjigjen e plotë lidhur me secilin pretendim të autorit të kritikës jo shkencore dhe qëllim keqe. Nga sa i kemi analizuar dhe vlerësuar gabimet, pretendimet qëllim këqija dhe subjektive, të autorit në kritikën jo shkencore, përgjigjja jonë ndaj kësaj kritike jo shkencore do të përmbajë mbi 250 faqe, jo domosdoshmërist me ndjenjën e krenarisë dhe të fiksimit, ndaj vëllimit të saj, siç e bën autori i kritikës jo shkencore, ndaj vëllimit të prodhimit të tij jo shkencor. Kjo pjesë hyrëse, do t'i bashkëngjitet botimit të përgjigjes së plotë, dhe si e tillë mund të plotësohet, për dallim nga ky version.

Pas debatit të njëanshëm shkencor dhe akademik, me arsye mbrojtëse

të dinjitetit personal dhe profesional, përballë një kritike jo shkencore dhe qëllim keqe, autorët e librit do të vlerësojnë të gjitha mundësitë dhe mjetet ligjore përkitazi me fyerjet dhe shpifjet që janë bërë nga autori i kritikës jo shkencore në raport me autorët e librit.

Për fund, dhe pas publikimit dhe botimit të përgjigjes së plotë, ndaj kritikës jo shkencore, autorët e librit, e konsiderojnë të mbyllur debatin me autorin e kritikës jo shkencore, në çdo kusht dhe rrethanë, madje edhe nëse autori i kritikës jo shkencore, do të vazhdojë te merret me nivele të tilla të debatit jo shkencor, subjektiv dhe në suaza të personales.

Autorët e librit, urojnë që kolegët e Fakultetit Juridik, lexuesi dhe studenti në veçanti, më asnjëherë të mos përjetoj nivel të tillë të debatit "shkencor", me përmasa kaq të larta të nivelit subjektiv-personal, tendencioz, fyes dhe shpifës.

Arsim Bajrami
Florent Muçaj

Shtojca 2

Përgjigjja e autorit të kritikës ndaj reagimit të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj

Kritika ime nuk është personale, por shkencore: Përgjigje ndaj reagimit të autorëve Arsim Bajrami dhe Florent Muçaj

Prishtinë, 9 tetor 2018

Me vëmendje lexova përgjigjen e autorëve Arsim Bajrami dhe Florent Muçaj, të cilëve njëjtë si në kritiken ndaj librit, do të ju referohemi si "autorët tanë". U gëzova shumë që e kishin lexuar kritikën time shkencore. Më shumë se kaq, u gëzova që në përgjigjen e tyre kishin bërë vende-vende riinterpretime të sakta të instituteve dhe kategorive moderne kushtetuese, ashtu siç kam thënë unë në kritikën shkencore të librit të autorëve tanë. Po ashtu, gjë e mirë u duk edhe fakti se autorët tanë kishin përdorur larushi literature dhe me një saktësi të rrallë, gjë që nuk është rasti me veprën që ka qenë objekti i kritikës shkencore. Këtë duhet përgëzuar, megjithatë, sepse përbën një shenjë të mirë. Duhet gjithashtu të konstatojmë se na mban gëzimi i sotëm dhe një shpresë që në një të ardhme jo fort të largët autorët tanë do ta rilexojnë me shumë kujdes kritikën tonë shkencore dhe do ta përdorin atë për prodhimin e teksteve të tjera të tyre që lidhen me institutet dhe kategoritë themelore të së drejtës kushtetuese, jo vetëm si shkencë por mbi të gjitha si degë pozitive. Kjo sepse autorët tanë vërtetë kanë defekte serioze në të kuptuarit e esencës së sistemit politik dhe kushtetues kosovar dhe bashkëkohor.

E keqja e përgjigjes së autorëve tanë, ndërkaq, ka të bëjë me dy gjëra:

- e para, në librin që ka qenë objekt kritike akoma qëndrojnë gabimet që janë evidentuar nga autori i këtyre rreshtave; dhe
- e dyta, nga faqja 16 e përgjigjes së autorëve tanë bëhet fjalë për fyerje dhe ofendime krejtësisht personale, me të cilat nuk duhet të merre-

mi sepse nuk kanë asnjë relevancë për librin e autorëve tanë që ka qenë dhe është objekt kritike.

Shkrimtari, dramaturgu dhe poeti më i njohur irlandez i shekullit XIX, **Oscar Wilde**, ka një thënie jashtëzakonisht ilustruese. "Përvoja është emri që iu japim gabimeve tona". Këtu shkrimtari i njohur, autor i kryeveprës *Portreti i Dorian Greit*, ka parasysh që njerëzimi e quan përvojë atë që ka nxjerrë prej gabimeve. Në qoftë se autorët tanë do të ishin të interesuar të mësonin prej gabimeve të tyre, këtë do t'ua quanim përvojë. Por, duke mbetur kryeneç në pozicionet e tyre të para, ata mbeten brenda kornizës së gabimit dhe nuk kalojnë dot në përvojë.

Në fakt, gabimet e tyre në disa pjesë të përgjigjes, duke filluar nga krijimi i turbullirës në opinion, citimet paushalle dhe sulmet ***ad hominem*** (sulme drejtuar ndaj personit kritikues, jo ndaj kritikës si të tillë), shkojnë deri aty sa vështirë se mund të konsiderohen të denja, qoftë edhe për t'u quajtur gabime. Kjo, megjithatë, nuk është arsyeja që mos të konstatojmë disa gjëra lidhur me dy të këqijat si më sipër të autorëve tanë, për hir të studentit dhe lexuesit tonë.

Lidhur me të keqen e parë, në vijim si më sipër, shënojmë se pjesa dërmuese e përgjigjes së autorëve tanë mbron gabimet e evidentuara nga ne: ata akoma nuk e kanë të qartë se autori prind i së drejtës kushtetuese bashkëkohore, francezi **Adhémar Esmein**, i pari e ka thënë se "Instrumenti i Qeverisjes" (1653) është kushtetuta e parë e shkruar. Ky fakt gjendet i shkruar në të gjitha librat mbi të drejtën kushtetuese, pjesën që flet për historinë e kësaj fushe, në dy anët e Atlantikut. Keq është që autorët tanë akoma nuk besojnë një gjë të tillë, rreth së cilës pajtohen krejt autorët me renome dhe që është thënë që në vitin e largët 1896 (në veprën e **Adhémar Esmein**-it, e cituar në kritikën tonë shkencore). Këtë duhet ta përmirësojnë autorët tanë dhe nuk duhet të insistojnë në mbrojtjen e gabimeve profesionale, shkencore dhe didaktike që janë evidentuar gjerësisht dhe me shumë kujdes në kritikën tonë shkencore. Kjo mund të bëhet vetëm duke lexuar dhe studiuar me kujdes literaturën tonë të dhënë në brendi të tekstit, përfshirë këtu veprat e juristëve **Carl Schmitt** e **Hans Kelsen.**

Sa i përket manipulimit të fusnotave dhe literaturës për prodhimin e tekstit, gjendja nuk ndryshon, dhe ne i kemi dhënë një nga një faqet ku ka ndodhur një gjë e tillë: lexuesi ynë mund ta konstatojë fare lehtë se për çfarë bëhet fjalë sepse shumica e literaturës së manipuluar nga autorët tanë në librin objekt kritike gjendet në internet. Pjesën që nuk gjendet në internet, në çdo kohë mbetemi në dispozicion t'ia ofrojmë lexuesit tonë.

Me padurim presim që lexuesit tanë dhe Këshillin e Fakultetit që të thonë fjalën e tyre lidhur me kritikën tonë dhe librin që është objekt i saj. Ndryshe nuk mund të ecim përpara në rrugëtimin tonë kah dija bashkëkohore e kontinentit ku jetojmë.

Këtu, me këtë rast, ne do të flasim dhe polemizojmë vetëm për librin që ka qenë objekt i kritikës sonë shkencore dhe literaturën e përdorur në mënyrë manipulative për prodhimin e tij. Asnjë sqarim dhe asnjë literaturë tjetër nuk mund të përdoret në përgjigje të kritikës sonë sepse kjo do të përbënte shtrembërim të debatit. Ky shtrembërim bëhet me qëllim personalizimin e debatit thellësisht profesional dhe shkencor, si dhe për qëllime krejtësisht jodidaktike. Këtë do ta shohim në rreshtat në vijim.

Sërish ritheksojmë se nga faqja 16 e tutje, përgjigja e autorëve tanë ka natyrë goditjeje personale dhe nuk mbartë asnjë relevancë për reagimin tonë të mëtejshëm. Ky reagim yni kufizohet në librin e autorëve tanë dhe në përgjigjen e tyre deri në faqen 16. Deri në këtë faqe, përgjigja e autorëve tanë ka po ato cilësi që ka edhe libri i tyre e të cilat i kemi vëne në pah në kritikën tonë: manipulojnë literaturën dhe faktet e tjera profesionale dhe shkencore duke ndërtuar një narracion krejtësisht kaotik. Të shohim si duket kjo konkretisht.

Për të sqaruar kuptimin e së drejtës kushtetuese në fusnotën nr. 1 të librit të tyre, autorët tanë në fq. 10 të përgjigjes së tyre kanë cituar **Constitutional Theory in a Nutshell,** të autorit **Thomas E. Baker** (*William & Mary Bill of Rights Journal*, vol. 13, issue 1). Kjo, megjithatë, nuk është aspak e vërtetë sepse në fusnotën nr. 1 të librit të tyre, autorët tanë citojnë autorin shqiptar **Kurtesh Saliu**.

Për të argumentuar se në librin e tyre kanë përkufizuar mirë termin "kushtetutë", në faqen 11 autorët tanë në përgjigjen e tyre citojnë një pjesë nga ***Ustavno Pravo*** *(vtoro dopolnitelno i izmeneto izdanie)*, të autorëve **Svetomir Škarić** (Shkariq) & **Gordana Siljanovska-Davkova** (Kultura, 2009), të cilin në librin e tyre nuk e kanë cituar fare. A nuk është ky manipulim? Dhe a nuk duhet quajtur ky fenomen manipulim me literaturë, siç e kemi quajtur ne dhe siç e quan metodologjia e shkrimit nëpër katedrat universitare në vendet perëndimore ku prodhohet shkenca dhe dija tjetër profesionale? Kjo është përgjigja ime për autorët tanë që në faqen 7 të përgjigjes së tyre kanë kërkuar sqarim nga ky autor lidhur me këtë term. Nuk ka tjetër shprehje: manipulimi me literaturë paraqet njërën nga tri kategoritë e shkrimit abuziv. Krahas tij ekzistojnë edhe citimi fiktiv dhe plagjiatura. Të tria këto i kemi konstatuar në kritikën tonë shkencore, duke kur-

syer librin që ka qenë objekt kritike sa i përket kategorisë së plagjiatit. Këtë fenomen, pra plagjiatin, do ta shohim në kohën që vjen: në kritikën tonë shkencore. Tani për tani për plagjiat kemi folur shumë pak dhe atë vetëm në disa vende.

Fare në fund, sa i përket konstatimit të autorëve maqedon si më sipër, të cilët i citojnë autorët tanë, sipas të cilëve kushtetuta dhe definimi i saj në kuptimin formal dhe material paska pas ekzistuar këtu e 200 vjet, e ndiejmë për detyrim t'i tregojmë lexuesit dhe autorëve tanë se ky informacion është tërësisht i pasaktë. Nuk ka pasur definim të kushtetutës në dy kuptimet e sipërcekura asnjëherë para se të botoheshin librat e para mbi të drejtën kushtetuese në Francë mes dy luftërave botërore, për t'u bërë standard në kontinentin e vjetër pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Shtjellimet e para teorike mbi kushtetutën të autorit **Albert Venn Dicey** (1885) po ashtu nuk përmbajnë asnjë definim të tillë të kushtetutës, siç nuk përmban as libri i parë mbi të drejtën kushtetuese kontinentale i autorit prind **Adhémar Esmein** (1896). Nga kjo shihet se autorët vazhdojnë me avazin e vjetër nga libri që ka qenë objekt i kritikës sonë – prodhimin e informacionit tërësisht të gabuar duke u mbështetur në citime fiktive të autorëve të parëndësishëm për të drejtën kushtetuese. Edhe autorët tanë, njëjtë si ata maqedon, kanë perceptime të gabuara lidhur me definimet teorike të kushtetutës, duke e ngatërruar lindjen e termit kushtetutë me definimet e saj themelore teorike në kuptimin formal dhe material. Keq! Vërtet keq dhe dëm i madh për krejt ata që detyrohen të mësojnë nga autorët tanë!

Në faqet 12 dhe 13 të përgjigjes së tyre autorët tanë tentojnë të sqarojnë se në librin objekt kritike nuk e paskan trajtuar **Perandorinë Romake** para **Greqisë**, në ndërkohë që të njëjtën gjë e bëjnë sërish në përgjigjen e tyre. Kjo vërtet përbën një qasje të çuditshme të autorëve tanë, të cilët me kryeneçësi të pashoq mbrojnë gabimet e veta themelore profesionale e shkencore. Një qasje e tillë nuk i shërben qëllimeve e synimeve didaktike të librit dhe të vetë lëndës që mëtojnë ta diskutojnë me studentët dhe lexuesit. Të njëjtën gjë e bëjnë në faqen 13 të përgjigjes kur flasin për Kushtetutën e Medinës si për kushtetutën e parë në botë. Tani shkojnë edhe më larg, duke thënë se "**kjo është një fakt notor i cili mësohet për shumë vite në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe që i njëjti asnjëherë nuk është kontestuar**".

Nëse nuk ka debat të mirëfilltë shkencor e profesional, studentët tanë, gjykuar sipas asaj që autorët thonë në faqen 15 të përgjigjes së tyre, sërish

insistojnë dhe thonë se Kushtetuta e Kosovës është akt që ka themeluar shtetin e Kosovës. Nuk ka asnjë dyshim që, në një rast të tillë, Kosova do të ngelet i vetmi vend në universin e shteteve sovrane dhe të pavarura ku kushtetuta përbën aktin e themelimit të shtetësisë së saj, kurse deklarata e pavarësisë një dokument që rri në orbitën e historisë kushtetuese të Kosovës dhe që asnjëherë nuk e prek tokën e konstitucionalizmit liberal bashkëkohor. Thënë me fjalë të tjera, Kosova do të ngelet, sipas autorëve tanë, i vetmi vend ku kushtetuta ka lindur pa një *grundnorm*. U mor vesh, kjo përbën një gabim trashanik dhe krejt themelor, të cilin asnjëherë dhe askush në rruzullin tokësor nuk do ta pranojë si të tillë.

Në një pjesë të përgjigjes së tyre, autorët tanë përdorin një term interesant duke e quajtur kritikën e autorit të këtyre rreshtave si kritikë "Enver Hasançe". Kjo ka nevojë të shpjegohet në dy nivele: kuptimin që bart dhe nivelin gjuhësor që prezanton.

Kuptimi që bart është që kritika jonë qenka shkruar me një stil të veçantë që i takon një individi. Konstatimet, "sulmet" e qëllimet qenkan si të Enver Hasanit. Në parim, ky do të ishte kompliment për individualitetin e theksuar të stilit e identitetin e qartë të ideve. Por kjo përmbajtje merr konotacion pezhorativ kur e shpjegojmë nivelin gjuhësor që përfaqëson kjo shprehje. Enver Hasançe, me shtesën *çe* në fund, që të gjithë ata që kanë njohuri bazë të gjuhës e dinë që në të shumtën e rasteve shënjon një ngarkesë negative, fyese e përçmuese. Ajo që ky emërtim thotë nën vete është "aq keq, sa veç Enver Hasani do të dinte". Me këtë s'kam asnjë problem. Fyerjet në llogarinë time do t'i pranoja me kënaqësi, për të mos prishur një debat mirëfilli shkencor. Problemi është që, sado që lexuesi të presë se pas këtyre sulmeve ***ad hominem*** do të vijë më në fund argumenti kundër kritikës, ai nuk vjen. Pra, termi pezhorativ i përdorur prej tyre, nuk përdoret që t'i paraprijë shpjegimit pse unë e kam gabim, por që ta zëvendësojë këtë shpjegim. Dhe lexuesi, me shumë të drejtë, mund të kujtojë që një shpjegim të tillë ata nuk e kanë.

Këtë herë me kaq, duke shpresuar se debati do të kthehet në binarët civilizues dhe shkencor, profesional dhe për qëllime didaktike në rënd të parë, por edhe për hir të përndritjes së lexuesit laik që dëshiron të dijë më shumë për çështjet fundamentale të kushtetutshmërisë dhe të rendit kushtetues në Kosovë dhe më gjerë.

Enver Hasani

Literatura

A. Libra

A.V. Dicey, *The Law of the Constitution (1885)*, edited by J.W.F. Allison (Oxford University Press: Oxford, 2013).

Aalt Willem Heringa & Philip Kiiver, *Constitutions Compared* (Intersentia: Antwerp–Oxford–Portland, 2009).

Adhémar Esmein, *Eléments de droit constitutionnel français et comparé* (Recueil Sirey: Paris, 1896).

Afrim Hoti & Igor Kosir, *European Perspectives of the Western Balkan Countries (I)* (AAB College: Prishtinë, 2015).

Alexander M. Bickel, *The Least Dangerous Branch: The Supreme Court at the Bar of Politics*, Second Edition (Yale University Press: Yale, 1986).

Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011).

Andrew Arato, *Civil Society, Constitution and Legitimacy* (Rowman & Littlefield Publishers: Maryland, 2000).

Andrew Beale, *Essential Constitutional Law*, Second Edition (Cavendish Publishing Limited: London & Sidney, 1997).

Aristotle, *The Politics*, edited and translated by Ernest Barker (Oxford University Press: Oxford, 1962).

Arne Mavčič, *The Constitutional Review* (Vandeplas Publishing, LLC: U.S.A., 2013).

Aurela Anastasi, *Historia e Institucioneve* (Pegi: Tiranë , 2006).

Benedict Anderson, *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism* (Verso: New York and London, 2006)

Benjamin Constant, *Principles of Politics Applicable to All Governments* (Liberty Fund: Indianapolis, 2003).

_____, *Réflexions sur les constitutions, la distribution des pouvoirs, et les garanties, dans une monarchie constitutionnelle* (H. Nicolle: Paris, 1814).

Brigitte Basdevant-Gaudemet, Jean Gaudemet, *Introduction historique au droit : XIIIème-XXème siècles*, 3ème edition (LGDJ: Paris, 2010).

Carl Schmitt, *Constitutional Theory* (Duke University Press: USA 2008).

Daniel Prémont, Christian Stenersen, Isabelle Oseredczuk (eds.), *Droits intangibles et états d'exception / Non-Derogable Rights and States of Emergency* (Bruy-

lant: Brussels, 1996).
Dimitrije Kulić, *Ustavno sudstvo u svetu* (Naša reć: Leskovac, 1972).
Dominique Chagnollaud, *Droit constitutionnel contemporain 1 : Théorie générale – Les régimes étrangers*, 7e éd. (Dalloz: Paris, 2013).
Dominique Rousseau, *Droit du contentieux constitutionnel*, 10ème édition (LGDJ: Paris, 2013).
Donald P Kommers, Gary J. Jacobsohn, John E. Finn, *American Constitutional Law: Essays, Cases, and Comparative Notes* (Rowman & Littlefield Publishers: USA 2009).
Elliot Bullmer, *What is a Constitution: Principles and Concepts* (IDEA: Stockholm, 2017).
Enver Hasani, *Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare* (Univ. Prishtinës/Jalifat: Prishtinë/Hjuston, 2016).
_____, *Tema të zgjedhura nga e drejta kushtetuese* (Univ. Prishtinës/Jalifat: Prishtinë/Hjuston, 2016).
F.W. Bussell, *The Roman Empire: Essays on the Constitutional History from the Accession of Domitian (81 A. D.) to the Retirement of Nicephorus III (1081 A. D.)*, Vols. I & II (London and New York: Longmans, Green, and Company, 1910).
Fisnik Korenica & Dren Doli, *Constitutional Law in Kosovo* (Kluwer Law International: The Netherlands, 2012).
Francis Hamon & Michel Trope, *Droit constitutionnel*, 37e edition (LGDJ: Paris, 2016).
Georg Jellinek, *The Declaration of the Rights of Men and Citizens* (Henry Holt and Company: New York, 1901).
Georghios M. Pikis, *Constitutionalism – Human Rights – Separation of Powers* (Marinus Nijhoff Publishers: Leiden/London, 2006).
Giuseppe de Vergottini, *Diritto costituzionale comparato* (CEDAM: Padova, 2004).
Hans Kelsen, *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange, Ltd.: Clark, New Jersey: 2002, 2009).
Helmut Steinberger, *Models of Constitutional Jurisdiction* (Council of Europe Publishing: Strasbourg, 1993)
Herbert Hausmaninger, *The Austrian Legal System*, Fourth Edition (Manzsche Verlags und Universitätsbuchhandlung: Wien, 2011).
Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago, 2000).
Hilmi Ismaili & Fatmir Sejdiu, *Historia e shtetit dhe së drejtës (I)* (Fakulteti Juridik i Univ. Prishtinës: Prishtinë, 2005).
_____, *Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore* (Fakulteti Juridik i Univ. Prishtinës: Prishtinë, 2009).
Horst Dippel, *Modern Constitutionalism: An Introduction to a History in the*

Need of Writting (Horst Dippel: University of Kassel, 2002).
Jovan Gjorgjeviq, *E drejta kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972).
Kirsti Samuels & Vanessa Hawkins Wyeth, *State-building and Constitutional Design after Conflict* (International Peace Academy: New York, 2006).
Kristaq Traja, *Drejtësia Kushtetuese* (Luarasi: Tiranë, 2000).
Kurtesh Saliu, *E drejta kushtetuese* (Fakulteti Juridik i Univ. Prishtinës: Prishtinë, 2004).
_____, *E drejta kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1984).
Levent Gönenç, *Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries* (Martinus Nijhoff Publishers: The Netherland, 2002).
Louis Favoreu et. al, *Droit constitutionnel* (Dalloz: Paris, 2017).
Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian, et al., *Droit constitutionnel*, 19e éd. (Dalloz: Paris, 2017).
Luan Omari & Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese* (ABC: Tiranë, 2010).
Luan Omari, *Kushtetuta e Kosovës në një vështrim krahasues* (Dudaj: Tiranë, 2009).
_____, *Sistemi Parlamentar*, botim i katërt (Elena Gjika: Tiranë, 2006).
Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di giustizia costituzionale* (CEDAM: Padova, 2009).
Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*, Tomo II (CEDAM: Padova , 2011).
Lucio Pegoraro, *Giustizia costituttionale comparata: Dai modelli ai sistemi* (G. Giappichelli Editore: Torino 2015).
M.J.C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers* (Liberty Fund: Indianapolis, 1998).
Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe A Comparative Analysis* (Hart Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2015).
Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (KOHA: Prishtinë, 2011).
Mark Rayan & Steve Foster, *Unlocking Constitutional and Administrative Law*, 3d Edition (Routledge: London, 2013).
Mark Tushnet, Thomas Fleiner & Cheryl Saunders, *The Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London and New York, 2013).
Martin Loughlin & Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism. Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford University Press: Oxford, 2008).
Meir Ydit, *Internationalised Territories from the "Free City of Cracow" to the "Free City of Berlin": A Study in the Historical Development of a Modern Notion in International Law and International Relations (1815-1960)* (Leyden: A.W. Sythoff, 1961).

Michael C. Dorf & Trevor W. Morrison, *The Oxford Introductions to U.S. Law: Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2010).
Michael Rosenfled & Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012).
Natahan J. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional World* (State University of New York Press: New York, 2002).
Neil Parpworth, *Constitutional and Administrative Law* (Oxford University Pres: Oxford, 2012).
Nick Howard, *Beginning Constitutional Law* (Routledge and New York, 2013).
Nigel Foster & Satosh Sule, *German Legal System*, Fourth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2010).
Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History* (Macmilllian: London, 1998).
Norman Dorsen, Michel Rosenfled, Andras Sajo & Suzsanne Baer (eds.), *Comparative Constitutionalism. Cases and Materials* (WEST: USA, 2010).
Olivier Duhamel & Guillaume Tusseau, *Droit constitutionnel et institutions politiques* (Seuil: Paris , 2013.).
Oliver Duhamel, *Droit constitutionnel* (Seuil: Paris, 1993).
Oliver Gohin, *Droit constitutionnel* (Lexis Nexis: Paris, 2013).
Otis H. Stephen, Jr., John M. Scheb II & Colin Glennon, *American Constitutional Law*, Vol. I. (Cengage Learning: USA, 2015, 2012 & 2008).
P. Carrozza, A. Di Giovine & G.F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (Editori Laterza: Roma–Bari, 2009).
P. Dann and Z. Al-Ali, *The Internationalized Pouvoir Constituant*: *Constitution-Making under External Influence in Iraq, Sudan and East Timor* (Max Planck Yearbook of United Nations Law, 2006).
Pasquale Pasquino, *Sieyès et l'invention de la constitution en France* (Odile Jacob: Paris, 1998).
Paul Laband, *Public Law of the German Empire* (Cotta: Stuttgart, 1888).
Philippe Ardant & Bertrand Mathieu, *Droit constitutionnel et institutions politiques* (LGDJ: Paris, 2016).
Radomir Lukić, *Uvod u Pravo* (shumë herë e ribotuar në Beograd).
Ran Hirschl, *Constitutional Theocracy* (Harvard University Press: Harvard, 2010).
Richard H. Fallon, *The Dynamic Constitution: An Introduction to American Constitutional Law* (Cambridge University Press: Cambridge, MA, 2004).
Robert Elgie, *Semi-Presidentialism in Europe* (Oxford Unioversity Press: Oxford, 1999).
Simon Chesterman, *You, the People: The United Nations, Transitional Administration, and State-Building* (Oxford University Press: Oxford, 2004).
Sir Basil Markensinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law. A New Source of Inspiration*? (Routledge: London and New York, 2006).
Smiljko Sokol, *Ustavno pravo* (Narodne novine: Zagreb, 2009).

Sokol Sadushi, *Drejtësia kushtetuese në zhvillim* (Toena: Tiranë, 2012).
Tania Groppi, Marie-Claire Pontthoreau (eds.), *The Use of Foreign Precedents by Constitutional Judges* (HART Publishin, Oxford and Portland, Oregon, 2014).
Temistocle Martines, *E drejta kushtetuese* (UET Press: Tiranë, 2011).
Tom Ginsburg & Rosalind Dixon, *Comparative Constitutional Law* (University of Chicago Law School: Chicago, 2011).
Vicki C. Jackson, *Constitutional Engagement in a Transinational Era* (Oxford University Press: Oxford, 2010).
Vikram David Amar & Mark V. Tushnet, *Global Perspectives on Constitutional Law* (Ocxford University Press: Oxford, 2009).
Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective.* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).
Xhezair Zaganjori, *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare* (ABC: Tiranë, 2011).
Ylli Bufi, *Tempulli i demokracisë* (Ombra GMG: Tiranë, 2010).
Zejnullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike* (Fakulteti Juridik i Univ. Prishtinës: Prishtinë, 2007).

B. Artikuj

Ahron Barak, "Unconstitutional Constitutional Amendment", *Israel Law Review*, vol. 44, issue 3. 2011
András Sajó and Renata Uitz, "Freedom of Religion", në Michel Rosenfeld & András Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012).
Andrew Blicka, "Emergency powers and the withering of the Royal Prerogative", *The International Journal of Human Rights*, vol. 18, no. 2, 2014.
Anne Peters, "Supremacy Lost: International Law Meets Domestic Constitutional Law", botuar në *Vienna Journal of International Constitutional Law*, vol. 3, issue 3 (2009).
Antonio Cassese, "Modern Constitutions and International Law", në *Collected Courses of the Hague Academy of International Law*, vol. 192 (Brill Nijhoff, Leiden/Boston, 1985).
Arnaud Le Pillouer, "Pouvoir constituant originaire et pouvoir constituant dérivé: à propos de l'émergence d'une distinction conceptuelle", *Revue d'histoire des facultés de droit et de la science juridique*, no. 25-6 (2005-6).
Arthur Braun, A. Chopplet, "Adhémar Esmein et le droit constitutionnel de la liberté", *Civitas Europa*, 2016/2, N° 37.

Colin Warbrick, "Kosovo: The Declaration of Independence", *International and Comparative Law Quarterly*, vol. 57, issue 03 (July 2008).

Dahlia Scheindlin, "Phantom Referendums in Phantom States: Meaningless Farce or a Bridge to Reality?", *Nationalism and Ethnic Politics*, vol. 18, no. 1 (2012).

Dan Meagher, "The Common Law Principle of Legality in the Age of Right", *Melbourne University Law Review,* vol. 35, no. 2 (2011).

_____, "The Common Law Principle of Legality", *Alternative Law Journal*, vol. 38, no. 4 (2013).

_____, "The Principle of Legality as Clear Statement Rule: Significance and Problems", *Sydney Law Review*, vol. 36, no. 3 (September 2014).

David A. Strauss, "What is Constitutional Theory", *California Law Review,* vol. 87, issue 3 (1999).

Dimitrije Kulić, "Constitutionality and Constitutional Justice", 22 *Collection Papers Faculty of Law Nis* 45 (1982).

_____, "Kontrola ustavnosti zakona u funkciji nadleznosti jugoslovenskih Ustavnih sudova", Collection Papers Faculty of Law Nis 23 (1983).

Diter Grim, "Types of Constitutions", në Michel Rosenfled & Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012).

Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", *German Law Journal,* vol. 11, no. 8 (2010).

_____, "What about Kosovo's Constitution: Is there anything special? Discussing the grundnorm, the sovereignty, and the consociational model of democracy", *Vienna Journal on International Constitutional Law*, vol. 5, no.1 (2011).

Emily Hay, "International(ized) Constitutions and Peacebuilding. *Leiden Journal of International Law*, vol. 27, issue 01 (March 2014).

Enver Hasani, "Rasti i asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës", *E Drejta/Law*, nr. 1-4/2015.

_____, "Specifikat e trashëgimit të ish Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të", *E Drejta/Law*, nr. 1/ 2012.

_____, "Vendimet kryesore që bënë historinë e Kosovës", në *Ndarja dhe balansimi i pushteteve dhe roli i kontrollit kushtetues* (Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë: Tiranë, 2012).

Fabrizio Gilardi, "Policy credibility and delegation to independent regulatory agencies: a comparative empirical analysis", *Journal of European Public Policy*, vol. 9, no. 6 (2002).

Fisnik Korenica, Argjend Zhubi & Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: HoW 'special' is it?", *European Constitutional Law Review,* vol. 12, issue 3 (December, 2016).

Gabriela Goudenhooft, "The Romanian Constitutional Discourse between Modernization and Europeanization", *Europolity,* vol. 9, no. 1 (2015).
Gary Jeffrey Jacobsohn, "Constitutional Identity", *The Review of Politics*, vol. 68, no. 3, (2006).
Gerrit Ferreira and Werner Scholtz, "Has the Constitutional Court found the lost ball in the high Weeds? The interpretation of section 231 of the South African Constitution", *The Comparative and International Law Journal of Southern Africa*, vol. 42, no. 2 (July 2009).
Giancarlo Rolla and Tania Groppi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).
Hans Kelsen, "Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution", *The Journal of Politics,* vol. 4, no. 2 (May, 1942).
_____, "La garantie juridictionnelle de la Constitution (La Justice constitutionnelle)", *Revue* du *droit public* et de la science politique en *France et à l'étranger (Avril-Juin* 1928).
Horst Dippel, "Modern constitutionalism, An introduction to a history in need of writing", botuar në *The Legal History Review* Volume 73, issue 1-2 (2005).
Jan Wouters, Bart De Meester & Cedric Ryngaert, "Demoracy and International Law", në *Netherlands Yearbook of International Law,* vol. 34 (December, 2003).
Jermey Waldron, "The Rule of International Law", *Harvard Journal of Law & Public Policy,* vol. 30, no. 1 (Fall 2006).
John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution", *Minnesota Journal of International Law,* vol. 18, issue 2 (2009).
John W. Burgess, "Laband's Public Law of the German Empire", (*Political Science Quarterly*, vol. 3, no. 1 (March, 1888).
Joseph Marko, "The New Kosovo Constitution in a Regional Comparative Perspective", *Review of Central and East European* Law, vol. 33, no. 4 (2008).
Jürgen Habermas, "Struggles for Recognition in the Democratic Constitutional State", në Charles Taylor (ed.), *Multiculturalism, Examining the Politics of* Recognition (Princeton University Press: New Jersey, 1994)
Katalin Kelemen, "Appointment of Constitutional Judges in a Comparative Perspective – with a Proposal for a New Model for Hungary", *Acta Juridica Hungarica,* vol. 54, no. 1 (2013).
Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)", *PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security*, vol. XXIII (2008).
Luca Mezzetti, "Introduzione", në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di gius-*

tizia costituzionale, Tomo II (CEDAM: Padova, 2011).
Luca Mezzetti, "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", në *Luca Mezzetti (ed.), Sistemi e modelli di giustizia costituzionale* (CEDAM: Padova, 2009).
Luigi Lacchè, "Granted Constitutions: The Theory of *octroi* and Constitutional Experiments in Europe in the Aftermath of the French Revolution", *European Constitutional Law Review*, vol. 9, issue 02 (September 2013).
Marie-Hélène Caitucoli-Wirth, "La vertu des institutions: l'héritage méconnu de Sieyès et de Constant", *Histoire Politique,* vol. 1, no. 16 (2012).
Mark Thatcher, "Regulation after delegation: independent regulatory agencies in Europe", *Journal of European Public Policy*, vol. 9, no. 6 (2002).
Marta Cartabia, "The Italian Constitutional Court and the Relationship between the Italian Legal System and the European Community", *Michigan Journal of International Law*, vol. 12, issue 1 (1990).
Matt Qvortrup, "The History of Ethno-National Referendums 1791–2011", *Nationalism and Ethnic Politics*, vol. 18, no. 1 (2012).
Michael Kirby, "International Law: The Impact on National Constitutions", *American University International Law Review*, vol. 21, issue 3 (2006).
Michel Rosenfeld, "Constitutional Identity", në Michel Rosenfeld & Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012).
Mijat Suković, "Tri različita ustavna uređenja Crne Gore. Od razbijanja šestočlane jugoslovenske federacije (1992.) do sada (2009.)", *Revus: Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava*, nr. 11/2009 (Lublanë).
Miroslav Novák, "Is There One Best 'Model of Democracy?", *Czech Sociological Review*, vol. 5, no. 2 (Fall 1997).
Patrice Rolland, "Comment préserver les institutions politiques? La théorie du pouvoir neutre chez Benjamin Constant", *Revue Française d'Histoire des Idées Politiques*, vol. 1, no. 27 (2008).
Patricia Sanchez Abri & Jacqueline D. Lipton, "The Right to be Forgotten: Who Decides What the World Forgets?", *Kentucky Law Journal*, vol. 103, issue 3, (2014-2015).
Peter Radan, "Secessionist Referenda in International and Domestic Law", *Nationalism and Ethnic Politics*, vol. 18, no. 1 (2012).
Ran Hirschl, "Comparative Constitutional Law and Religion", në *Tom Ginsburg and Rosalind Dixon (eds.), Comparative Constitutional Law* (Edward Elgar: UK & USA, 2011).
Raoul Berger, "Doctor Bonham's Case: Statutory Construction or Constitutional Theory?" *University of Pennsylvania Law Review,* vol. 117, no. 4 (February 1969).
Richard H. Fallon, "How to Choose a Constitutional Theory", *California Law Review,* vol. 87, issue 3 (1999).
Robert C. Post, "Foreword: Fashioning the Legal Constitution: Culture, Courts

and Law", *Yale Law School Faculty Scholarship Series.* Paper 179 (2003).
Samuel Ethan Meller, "The Kosovo Case: An Argument for A Remedial Declaration of Independence", *Georgia Journal of International and Comparative Law,* vol. 40, no. 3 (2012).
Sandrine Baume, "De l'usage des pouvoirs neutres", *Revue Française d'Histoire des Idées Politiques*, vol. 4, no. 143 (2012).
Shen Yu-chung, "The Anomaly of the Weimar Republic's Semi-Presidential Constitution", *Journal of Politics and Law*, vol. 2, no. 3 (September, 2009).
Teemu Heikkinen, "Challenging the Royal Prerogative: The Decision on War against Iraq in Parliamentary Debates in 2002–3", *Parliamentary History,* vol. 35, pt. 1 (2016).
Thomas E. Baker, "Constitutional Theory in a Nutshell", *William & Mary Bill of Rights Journal,* vol. 13, no.1 (2004).
Thomas Poole, "United Kingdom: The royal prerogative", *International Journal of Constitutional Law*, vol. 8, no. 1 (2010).
Vincent Robert Johnson, "The French Declaration of the Rights of Man and of Citizens of 1789, the Reign of Terror, and the Revolutionary Tribunal of Paris", *Boston College of International and Comparative Law*, vol. 13, no. 1 (1990).
Zaid Al-Ali, "Constitutional drafting and external influence", në Tom Ginsburg and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Constitutional Law*. (Edward Elgar Pub: UK & USA, 2011).
Zdenk Kühn and Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic", *European Constitutional Law Review*, vol. 2, issue 02 (June 2006).

C. AKTE JURIDIKE DHE DOKUMENTE TË TJERA

[Abbé] Emmanuel Joseph Sieyès, *Qu'est-ce que le tiers-état?* (1789).
Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, *Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo*, Report, Doc. 12462, 7 January 2011.
Bill of Rights (SHBA 1791).
Bridgette Martin, *Secession and Statehood: The International Legal Status of Kosovo* (A dissertation submitted in partial fulfillment of the degree of Bachelor of Laws (Honors) at the University of Otego: Dunedin, 2008).
Daniel Hefflebower, *The* Präsidialregierung*, 1930–1933: The Executive Branch of the Weimar Government and the Dismantling of the Republic* (Bachelor of Arts with Honors: University of Michigan, April 20, 2010).
Deklarata e Shtetit Virxhinia mbi të Drejtat e Njeriut (SHBA, 1776).

Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit (Francë, 1787).
European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on the Draft Amendments to the Constitution of Montenegro, as well as on the Draft Amendments to the Law on Courts , the Law on the State Prosecutor's Office and the Law on the Judicial Council of Montenegro*, Adopted by the Venice Commission at its 115 th Plenary Session (Venice, 22-23 June 2018).
_____, *Turkey: Opinion on the Provisions of the Emergency Decree Law No. 674 of 1 September 2016 Which Concern the Exercise of Local Democracy in Turkey*, Opinion No. 888/2017, CDL-AD(2017)021, Adopted by the Venice Commission at its 112th Plenary Session (Venice, 6-7 October 2017; Strasbourg, 9 October 2017).
_____, *Rule of Law Checklist* (Study No. 711 /2013: Strasbourg, 18 March 2016).
_____, *The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with International Treaties: New Trends in Constitutional Justice*, CDL-JU(2009)036. English only (Strasbourg, 17 November 2009).
_____, *Comments on the Draft Law on the Constitutional Court of the Republic of Serbia*, Opinion no. 445/2007, CDL-AD (2007) 039, English only (Strasbourg, 7 November 2007).
_____, "The Composition of Constitutional Courts", *Science and Technique of Democracy*, no. 20, CDL-STD (1997) 020 (Strasbourg, December 1997).
_____, *Judicial Appointments*, Opinion No. 403/2006, CDL-AD(2007)028 (Venice, 22 June 2007).
_____, "Constitutional Justice and Democracy by Referendum", CDL-STD(1995)014, or. Engl.,: *Science and technique of democracy*, no. 14 (Strasbourg, 23-24 June 1995).
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi në rastin KO 97/10.
_____, Aktgjykimi në rastin KO 80/10.
_____, Aktgjykimi në rastin KO 98/11.
_____, Aktgjykimi në rastin KI 47/10 dhe rastin KO 103/14.
_____, Aktgjykimi në rastin KI 25/10.
_____, Aktgjykimi në rastin KO 047/16.
_____, Aktgjykimi në rastin KO 29/11.
_____, Aktgjykimi në rastin KO 119/14.
_____, Aktgjykimi në rastin KO 95/13.
_____, Aktgjykimi në rastin KO 98/11.
Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, "Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo", Advisory Opinion, 2010 I.C.J. 404 (July 22, 2010).
Instrumenti i Qeverisjes (Angli, 1653).
Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin ndaj Pronës, Arkivave dhe Borxhit të

Jashtëm (1983).
Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve (1969).
Korniza Kushtuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Kosovë, 2001).
Kushtetuta e Austrisë (1920).
Kushtetuta e Bullgarisë (1991).
Kushtetuta e Federatës Ruse (1993).
Kushtetuta e Irlandës (1937).
Kushtetuta e Japonisë (1946).
Kushtetuta e Kosta Rikës (1949).
Kushtetuta e Mbretërisë së Jugosllavisë (1931)
Kushtetuta e Qipros (1960).
Kushtetuta e Spanjës (1978).
Kushtetuta e SHBA-së (1787)
Kushtetuta e Shqipërisë (1998).
Kushtetuta e Turqisë (2017).
Kushtetuta e Vajmarit (Gjermania, 1919).
Kushtetuta e Vidovdanit (Mbretëria Serbo-Kroate-Sllovene, 1921).
Kushtetuta e Zvicrës (1874).
Kushtetuta e Zvicrës (1893).
Kushtetuta Malit të Zi (2007)
Kushtetuta Serbisë (2006).
Kushtetutat e Sllovenisë (1991).
Kushtetutën e Bosnjë-Hercegovinës (1995).
Kushtetutën e Greqisë (1978).
Letrat e Federalistit (SHBA, 1787-1788).
Ligji mbi Federatën e Malajas (Malajzi, 1957).
Ligji nr. 03/L-094 për Presidentin (Kosovë, 2009).
Ligji nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (2009).
Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Kosovë, 2015).
Ligji Themelor i Gjermanisë (1949).
Ligjin nr. 03/L-199 për Gjykatat (Kosovë, 2010).
Marrëveshja e Dejtonit (1995).
Marrëveshjet e Londrës e Cyrihut (1959).
Mr. Igor Spirovski, *The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with the International Treaties: New Trends in Constitutional Justice*, botuar nga European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) in co-operation with The Constitutional Court of Montenegro and the OSCE, Report, CDL-JU(2009)-036, English only (Strasbourg, 17 November 2009).
Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (2007).
Rezoluta 1244 e KS të OKB-së (1999).

Statuti Albertino (Itali, 1848).
Traktati i Lisbonës (2007).
William C. Kimberling, "The Electoral College", *Essays in Election* (Federal Election Commission: Washington D.C., 1992).

Treguesi

Abhazia, 184
ad hoc, 120, 121, 264
ad hominem, 344, 347
ad literam, 25, 71, 99, 110, 115, 203, 221, 261, 278, 282, 301
Afganistani, 70
Afrika, 92, 132, 209
Afrika e Jugut, 69, 70, 75, 92, 94, 113, 206
  Kushtetuta, 206
Agamben, Giorgio, 273
Ahtisaari. *Shih* Plani Ahtisaari
Ahtisaari, Martti, 173
AKI, 288
AKP, 200
aktivizmi gjyqësor, 265, 266
Albert, Richard, 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117
Al-Qaeda, 94
Althuser, Johannes, 200
Amar, Akhil Reed, 112
Amar, Vikram David, 10
  Global Perspectives on Constitutional Law, 10
amendamentet kushtetuese jokushtetuese, 47, 64
Amerika Latine, 92, 117, 223
Amerika Veriore, 132
Ananian-Welsh, Rebecca, 189
Anastasi, Aurela, 7, 10, 12, 16, 18, 19, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 46, 49, 54, 57, 58, 73, 78, 86, 88, 101, 148
  E drejta kushtetuese, 7, 18, 34, 46, 54
Andeson, Benedict, 64
Anglia, xiii, 8, 14, 23, 69, 96, 131, 307, 309
  Instrumenti i Qeverisjes, xiii, xx, 23, 307, 309
  Magna Carta, 22, 23, 281
  Rasti Dr. Bonham, 131, 132, 133, 134, 135, 140
  Revolucioni i Lavdishëm, 14, 24, 132
  Tudor, 134
Arabia Saudite, 70
Ardant, Philippe, 45
Aristoteli, 11, 18, 65, 242, 309
  Politika, 18
Asociacioni Serb, 141
Aucoin, Louis, 82, 93, 172, 199, 202, 203
Australia, 126, 127
Austria, 30, 32, 47, 114, 115, 116, 198, 254, 262, 263
Austro-Hungaria, 19
Avokati i Popullit, 249, 251
Azia, 132, 209, 283
Azia Qendrore, 92, 195
Bajrami, Arsim, xi, xix, xxvii, 40, 295, 296, 297, 298, 341, 343
Baker, Thomas, 1, 2, 306, 345
Baldvin, Clive, 188
Ballkani, 29, 146, 202

Barak, Ahron, 47, 48
Barnett, Hilaire, 56, 77, 79
Bashkimi Sovjetik, xiii, 104, 153, 163, 164, 165, 166
Baume, Sandrine, 224, 225, 226, 237
BE, 205, 248, 258
Beale, Andrew, 54
Belgjika, 104, 108
  Kushtetuta, 108
Beugnot, 85
Bickel, Alexander, 231
Bizanti, 17
Blicka, Andrew, 238
bloc de constitutionalité, 193, 234
Bocvana, 132
Bodin, Jean, 200
bona fide, 73, 96, 154, 258
borxhi
  lokal, 166
  lokalizuar, 166
  nacional, 166
  odioz, 166
Bosnjë-Hercegovina, 40, 41, 42, 75, 76, 84, 91, 92, 93, 160, 168, 193, 194, 226
  Dejtoni, 42
Botsford, George Willis, 17
Bourbon, xvi, xxiii, 84, 108, 221, 225, 227
Brazili, 233
Brewer-Carias, Allan, 269
Britania, 42, 49, 54, 56, 65, 78, 87, 126, 127, 133, 135, 138, 192, 197, 237
  para shek. XIX. *Shih* Anglia
Brown, Nathan, 61
Bufi, Ylli, 212
Bullgaria, 25, 27, 32, 102, 187, 263, 268, 318
  Kushtetuta, 102, 187
Bullmer, Elliot, 60, 61, 77
Burbank, Stephen, 243
Burgess, John, 21
Burke, Edmund, 65
Bussell, F.W., 17, 145
Bush, George W., 240
Caitucoli-Wirth, Marie-Hélène, 231
caktimi i gjyqtarëve
  modeli i bashkëpunimit, 263, 264
  modeli i caktimit të drejtpërdrejtë, 263
  modeli i zgjedhjes, 263, 264
Carré de Malberg, Raymond, 20
case and controversy, 137
Cassese, Antonio, 72
Chagnollaud, Dominique, 13
  Droit constitutionnel contemporain, 13
charters, 133, 134
Chesterman, Simon, 155
clear-statement rule, 127, 128
Coke, Sir Edward, 132, 134, 135
common law, 2, 16, 95, 127, 128, 132, 133, 134, 135, 137, 281
Constant, Benjamin, xv, xvi, xxiii, xxiv, 215, 223, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 236
  Fragments d'un ouvrage abandonné..., 226
  Principles of Politics Applicable to All Governments, 226
  Réflexions sur les constitutions..., 226
constitutio, 18, 19
constitutional interpretation. Shih

interpretimi kushtetues
Cromwell, Oliver, 23
Cuza, Alexander, 26
Çekia, 263
Gjykata Kushtetuese, 120, 121
Kushtetuta, 120
Çekosllovakia, xiii, 32, 163, 164, 165, 166
Danimarka, 69
Danish Institute for Human Rights, 283
Danzingu, 155
De Gaulle, Charles, 66, 233, 234, 240
De Meester, Bart, 95
De Vergottini, Giuseppe, 129
Diritto costituzionale comparato, 129
De Visser, Maartje, 51, 119
Deklarata e 2 korrikut 1990, 145
Deklarata e Pavarësisë, xii, xiii, xix, xxi, 80, 81, 83, 106, 152, 161, 162, 169, 171, 172, 174, 176, 177, 178, 180, 184, 203, 247, 256, 310
autorët, 180, 183, 185
demokracia konsociacionale, 193, 194, 207, 216, 285
Dialogu me Serbinë, 295
Dicey, A.V., 78, 346
The Law of the Constitution, 78
Dippel, Horst, 4, 89
Dixon, Rosalind, 11, 28, 70, 92
Dixon, Rosaline, 28
doctrine of necessity, 125
doktrina e çështjes politike, 266
Doli, Dren, 80, 194, 249, 258
Domiciani, 17
Dorf, Michael, 67
Droit constitutionnel, 36
Duguit, Léon, 20
Duhamel, Olivier, 45, 63, 109
Duverger, Maurice, 213, 241, 242
e drejta e përgjithshme. *Shih common law*
e drejta kushtetuese, xi, xix, xxvii, 2, 4, 12, 13, 14, 19, 31, 34, 38, 49, 62, 86, 101, 103, 109, 122, 154, 198, 297, 305, 374
e drejta ndërkombëtare dhe e drejta e brendshme, 74
e drejta shtetërore, 14
Egjipti, 68, 70
Eisenmann, Charles, 130
Elgie, Robert, 241, 352
Elizabeta II, 42
emergjencat
kushtet procedurale, 275
kushtet substanciale, 275
entrenching clause, 113
Erdoğan, Recep Tayyip, 69, 111, 276
erga omnes, 47, 48, 80, 81, 174, 203, 216, 330
Ervin Jr., Sam J., 242
Esmein, Adhémar, 19, 20, 344, 346
Estonia, 173
etërit themelues, 106
EULEX, 217, 248
Task-Forca, 248
Evropa, xiii, xiv, xvi, xxix, 4, 7, 15, 17, 20, 27, 29, 30, 32, 51, 53, 66, 75, 76, 80, 84, 85, 89, 108, 132, 213, 223, 237, 241, 247, 259, 263, 283, 285, 310
ex officio, 139
Fallon, Richard, 3, 90
Favoreu, Louis, 35, 37, 38, 45, 123,

126, 130
Ferreira, Gerrit, 206
Finlanda, 138
Finn, John, 24, 25
Fleiner, Thomas, 19
Foster, Nigel, 222, 352
Foster, Steve, 77, 78, 79
Franca, 14, 19, 20, 24, 36, 44, 45, 54, 63, 66, 68, 69, 79, 85, 88, 90, 104, 108, 109, 111, 113, 123, 139, 177, 192, 205, 223, 227, 229, 233, 237, 240, 242, 263, 346
Charte constitutionnelle e 1814-ës, 84, 85
Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, 22, 107, 193, 234, 281, 282
États généraux, 107
Këshilli Kushtetues, 193, 234
Kushtetuta e 1958-ës, 44
Perandoria, 227
Perandoria e Dytë, 229
Presidenti, 233
Republika e Dytë, 44
Republika e Katërt, 44
Republika e Tretë, 19, 20
Revolucioni Francez, xv, xxiii, 4, 7, 14, 22, 85, 106, 107, 109, 200, 221, 223, 238, 281
Senati Konservator, 227
Tribunati, 227
Frye, Timothy, 212
FSK, 271, 272
führer, 71
Gambia, 132
Genn, Hazel, 95
Giddens, Anthony, 189
Gilardi, Fabrizio, 237
Ginsburg, Tom, 11, 28, 70, 92
Gohin, Oliver, 45
Gönenç, Levent, 25, 26, 27, 28, 29, 30
Google, 9, 31
Goudenhooft, Gabriela, 26, 27
Greqia, xiii, xx, xxi, 6, 16, 18, 21, 36, 68, 69, 105, 173, 185, 208, 226, 260, 307, 308, 315, 346
Grimm, Diter, 56, 58
Groppi, Tania, 220, 268
grosso modo, 14, 138, 276
Grotius, Hugo, 200
Gruda, Zejnullah, 72, 158, 201
E drejta ndërkombëtare publike, 72
grundnorm, 79, 80, 81, 82, 103, 105, 152, 161, 172, 174, 175, 176, 300, 311, 347
GJED, 9, 213
GJEDNJ, 210, 263, 271, 273, 277, 285
Rasti *Lawless v. Ireland*, 277
Gjermania, 3, 19, 31, 39, 73, 91, 111, 123, 205, 222, 224, 236, 240, 262, 263
Bavaria, 255
Gjykata Kushtetuese, 235
Kushtetuta e 1871-ës, 212
Kushtetuta e Frankfurtit, 24
Kushtetuta e Rajhut, 108
Kushtetuta e Vajmarit, 11, 24, 30, 31, 32, 75, 108, 111, 112, 213, 222, 224, 225, 229, 235, 236
Ligji Themelor, 39, 40, 75, 100, 212, 222, 235
Perandoria, 222
Presidenti, 229, 235, 240

Rajhstagu, 229
Rajhu, 222
GJND, xiii, xxi, 80, 81, 83, 104, 107, 148, 153, 162, 173, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 200, 202, 210, 254, 311
Mendimi për Kosovën, xiii, xxi, 104, 162, 180, 182
Gjorgjeviq, Jovan, 2, 31, 32, 49, 56, 59, 122, 124
Gjykata Kushtetuese e Kosovës, xiv, xxi, 67, 217, 252, 259, 261, 278, 314
KI 48/12 & KO 48/12, 120, 287
KI 25/10, 200
KI 47/10, 49
KO 103/14, 49, 203, 204, 245
KO 119/14, 194, 212
KO 130/15, 141
KO 29/11, 208, 268
KO 29/12, 120, 287
KO 47/10, 50
KO 47/16, 208
KO 80/10, 269
KO 95/13, 255
KO 98/11, 49, 50, 207, 217, 218
Ligji për Gjykatën, 252, 259, 264, 278
Gjykata Speciale, 247, 250, 251, 252, 257, 284
Dhoma e Specializuar Kushtetuese, 249, 252, 257
Ombudspersoni, 251
Gjykata Supreme e Kosovës, 200
Habermas, Jürgen, 65
Haga, 247, 251, 257
Halili, Zenun, 283
Halimi, Arijeta, 208
Hamilton, Alexander, 89, 136, 242
Hamon, Francis, 15
Hamurabi, 23, 214
Hasani, Enver, 149, 151, 152, 153, 167, 181, 295, 296, 297, 298, 317, 347, 374
Hasebe, Yasuo, 19
Hauriou, Maurice, 20
Hausmaninger, Herbert, 254
Hefflebower, Daniel, 31
Hegel, Friedrich, 17, 65
Heikkinen, Teemu, 238
Henriku VIII, 214
Heringa, Aalt Willem, 71
Hitler, Adolf, 100, 205, 235
Hobbes, Thomas, 55, 175, 200
Holanda, 49, 74, 75
Hondurasi, 113, 114
Hoti, Afrim, 282
Howard, Nick, 60
Hungaria, 263
Gjykata Kushtetuese, 259
iluminizmi, xiii, 307
impeachement, 130, 242
imuniteti i funksionarëve të lartë, 118, 207, 217
in flagrantia, 218
in statu nascendi, 83
India, 64, 69, 132, 239, 240
inter partes, 47, 330
interpretimi kushtetues, 51, 52, 119
Iraku, 70, 226
Irani, 70
Irlanda, 69, 92, 132
Kushtetuta, 102
Irlanda Veriore, 93
Islanda, 69
Ismaili, Hilmi, 22, 23, 85, 148, 309

Ismajli, Osman, 12
Italia, 49, 51, 61, 62, 69, 85, 91, 103, 113, 123, 263, 268
  Asambleja Kushtetuese, 62, 102, 103
  Gjykata Kushtetuese, 258
  Kushtetuta, 62, 103
  referendumi institucional, 62
  Republika Italiane, 103
  Statuti Albertino, 49, 63
Izraeli, 69, 131, 176, 203
  Deklarata Hariri, 203
Jacobsohn, Gary, 24, 25, 63, 64, 65, 66, 350
Jahjaga, Atifete, 49, 120, 121, 141, 253
Japonia, 84, 102, 114, 132, 244
  Kushtetuta, 102, 114
  Kushtetuta e 1899-ës, 84
Jellinek, Georg, 282
Jemeni, 70
Jerusalemi, 155
Johnson, Vincent Robert, 281
judicial review. *Shih* kontrolli gjyqësor
Jugosllavia, xiii, 39, 66, 84, 104, 144, 145, 148, 150, 151, 152, 153, 162, 163, 165, 166, 167, 168, 169, 170, 209, 226, 283
  Kushtetuta e Mbretërisë e 1931-ës, 84
  Kushtetuta e Vidovdanit, 30, 206
  trashëgimi, 162, 163
jurie constitutionnaire, 227
jus cogens, 73, 75, 76, 96, 105, 182
jus naturale, 132
jus positivum, 132
Justiniani, 23
Kanadaja, 69, 70, 126, 127, 132, 183
  Kebeku, 183
Kant, Immanuel, 82, 95
Kastrati, Diana, 253
Katari, 70
Kaufmann, Eric, 213, 310
KEDNJ, 243, 275, 285
Kelsen, Hans, 10, 11, 79, 80, 81, 82, 83, 103, 116, 120, 130, 140, 171, 172, 175, 213, 219, 224, 234, 235, 236, 300, 310, 311, 344
kelsenian, 81, 82, 131, 140, 151, *Shih* kontrolli i kushtetutshmërisë: modeli evropian
Kenia, 69
Këshilli i Evropës: Asambleja Parlamentare, 247, 248
Kiiver, Philip, 71
Kili, 28
Kina, 69
king-in-parliament, 135
Kirby, Michael, 94
KNDCP, 274, 275
Kolumbia, 28
Komisioni Badinter, 165
Komisioni i Venecias, 39, 92, 93, 102, 188, 243, 253, 258, 276
Kommers, Donald, 24, 25
Konferenca e Bunjajt, 145, 149, 150, 151, 152, 181
konflikti i interesit, 265
kontesti kushtetues, 254
kontrolli dhe balancimi, 242
kontrolli gjyqësor, 23, 51, 52, 119, 122, 138, 141, 188, 195, 196, 197, 220
kontrolli i konvencionalitetit, xiv, 255, 257

kontrolli i kushtetutshmërisë
amendamentet, 256
contrôle préliminaire de constitutionalité, 234
marrëveshjet ndërkombëtare, 260, 315
modeli evropian, 50, 51, 52, 119, 138, 256, 257, 259
modeli i decentralizuar, 136, 138, 139
modeli i përzier, 138
shtetet pa kontroll, 138
Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin e Pronës, Arkivave dhe Borxhit të Jashtëm, 164, 165, 166, 167
Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, 45, 73, 74, 201, 205, 258, 260
Konventat e Gjenevës, 94
Koreja e Jugut, 240
Korenica, Fisnik, 80, 194, 249, 258
Korniza Kushtetuese e Kosovës, 40, 158, 159
Kosir, Igor, 282
Kosova, xi, xii, xiii, xiv, xv, xvii, 10, 12, 16, 39, 40, 41, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 56, 57, 61, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 79, 80, 81, 83, 84, 88, 91, 92, 93, 96, 97, 98, 99, 105, 106, 107, 111, 112, 113, 117, 118, 119, 120, 121, 123, 125, 140, 141, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 196, 198, 199, 200, 202, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 214, 215, 216, 217, 219, 220, 221, 223, 226, 232, 236, 237, 238, 239, 241, 244, 245, 246, 247, 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 262, 263, 264, 265, 266, 267, 268, 269, 270, 271, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 280, 284, 285, 286, 287, 288, 291, 295, 296, 307, 310, 311, 312, 313, 314, 315, 316, 317, 318, 319, 325, 340, 347, 374
Vilajeti. *Shih* Vilajeti i Kosovës
Kostarika, 114, 115, 116
Krasniqi, Jakup, 269
kreu i shtetit, xvii, 62, 103, 220, 221, 222, 230, 233, 235, 236, 237, 242, 317, 318, 319, *Shih* shefi i shtetit
Kroacia, 44, 45, 160, 164, 165, 168, 173
Gjykata Kushtetuese, 43
Krstić, Ivana, 188
Kulić, Dimitrije, 122
Kushtetuta e Kosovës, xiii, xiv, xx, xxi, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 66, 67, 74, 75, 76, 79, 81, 93, 96, 104, 118, 119, 125, 140, 141, 160, 161, 162, 171, 172, 173, 174, 176, 186, 190, 191, 196, 199, 202, 203, 204, 215, 218, 219, 220, 221, 224, 238, 246, 255, 256, 257, 258, 265, 266, 271, 272, 273, 274, 280, 283, 286, 310, 314, 315, 316, 347
Amend. 24, 248, 251, 257
Kushtetuta e Medinës, xiii, xx, 22,

307, 309, 346
kushtetutë, termi, 13
La Torre, Massimo, 212
Laband, P., 20, 21
Lacchè, Luigi, 85
laiciteti, 69, 70
LDK, 50
Le Pillouer, Arnaud, 83
least dangerous branch, 136
Letonia, 173
Letrat e Federalistit, xv, 25, 38, 89, 90, 135, 231
lex, 18
LGBT, 3
Libani, 193
Lidhja e Dytë e Prizrenit, 150, *Shih* Kosova
ligjet organike, 42, 43, 44
ligjshmëria socialiste, 129
ligjvënësi negativ, 51, 52, 117, 119, 120, 236
ligjvënësi pozitiv, 52, 119
Lijphart, Arend, 285
Lipton, Jacqueline, 9
Lituania, 173
Locke, John, xii, xx, 8, 22, 24, 25, 89, 135, 200, 242, 307, 310
Traktati i dytë mbi qeverisjen, 8
Loewenstein, Karl, 56, 58
Lufta e Dytë Botërore, 29, 91, 95, 108, 147, 157, 159, 160, 223, 235, 242, 346
Lufta e Ftohtë, 72, 144, 259
Lufta e Parë Botërore, 29, 95, 148, 222
Luftërat Ballkanike, 149
Luigji XIV, 230
Luigji XVI, 107
Llukiq, Radomir, 5
Machiavelli, 11, 24, 310
Madison, James, xv, 89
Magrebi, 92
Malajzia, 40, 41, 42
Kushtetuta, 42
Kushtetuta e Federatës së Malajas, 42
Ligji mbi Federatën e Malajas, 42
Marrëveshja për Federatën e Malajas, 42
Urdhri për Kushtetutën Federale, 42
Malcolm, Noel, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 157
Kosovo: A Short History, 145, 157
Mali i Zi, xiii, xxi, 39, 61, 74, 80, 123, 124, 158, 163, 164, 168, 169, 170, 173, 185, 256
Kushtetuta, 39, 79
Maqedonia, 44, 61, 75, 84, 163, 168, 169, 170, 243
Marquand, John, 189
Marquis de Lafayette, 282
Marshall, John, 136, 137
Martin, Bridgette, 184
Martines, Temistocle, 34, 38, 49, 62, 103, 353
Martinez, Jenny, 240
Martti Ahtisaari. *Shih dhe* Plani Ahtisaari
Marty, Dick, 247, 248
Marrëveshja e Bukureshtit (1913), 148
Marrëveshja e Kumanovës, 155, 156, 157, 158, *Shih* Kosova
Marrëveshja e Londrës (1913), 148
Marrëveshja e Stambollit (1914),

148
Marrëveshja me Serbinë për Asociacionin, 141
Marrëveshja për Kufirin me Malin e Zi, 74
Mathieu, Bertrand, 45
Mavčič, Arne, 132
Meagher, Dan, 127, 128
Meksika, 27, 240
Kushtetuta e 1824-ës, 27
Meller, Samuel Ethan, 182, 183, 184
Merriam Jr., C.E., 200
Mesić, Stipe, 283
Mill, John Stuart, 11, 24, 310
Millosheviq, Sllobodan, 155
Mithat Pasha, 146
monarkia kushtetuese, xii, xvi, 17, 26, 49, 108, 145, 225, 229, 307, 308
Montesquieu, xii, xv, xx, xxiii, 8, 11, 24, 195, 215, 224, 225, 227, 231, 242, 310
Fryma e ligjeve, 8
Morina, Visar, 48, 314
Morrison, Trevor, 67
Muçaj, Florent, xi, xix, xxvii, 297, 298, 341, 343
Muhamedi, 22, 309
Mussolini, Benito, 62
mutatis mutandis, 80, 252, 253
Napoleoni, xvi, 20, 108, 221, 227, 233
Ne, Populli..., 135, 137
Nicefori III, 17
Nikolla II, 28
nomos, 18
normë mbi normat. *Shih grundnorm*
Norvegjia, 69
Kushtetuta, 27
Novák, Miroslav, 68
nulla poena sine lege, 274
nullum crimen sine lege, 274
O'Neil, P.H., 241
OKB, 40, 153, 155, 158, 159, 163, 170, 173, 178, 180, 182, 183, 185, 254, 275
Këshilli i Sigurimit, 154, 163, 170
oktruar, 83, 85, 91, 150, 175
Omari, Luan, 7, 10, 12, 16, 18, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 46, 49, 54, 57, 58, 60, 73, 78, 86, 88, 101, 190, 211, 212
E drejta kushtetuese, 7, 18, 34, 46, 54
Sistemi parlamentar, 60, 211
Osetia e Jugut, 184
Pacolli, Behgjet, 118, 119, 208, 267
pacta sunt servanda, 96
padia kushtetuese, 253
Pakistani, 70
Paqja e Vestfalisë. *Shih* Vestfalia
parimi i proporcionalitetit, 125, 277, 285
Parpworth, Neil, 55, 56
Constitutional and Administrative Law, 55
Pasquino, Pasquale, 110
Paulson, Stanley, 213
PCN, 263
Pegoraro, Lucio, 130, 138
per definitionem, 254
Perandoria Otomane, 97, 145, 146, 147
Marrëveshja e Parisit, 146
Tanzimati, 146, 147

Traktati i Berlinit, 147
Perandoria Romake, xii, xvi, 16, 17, 18, 21, 23, 145, 307, 308, 346
Pereira Coutinho, Louis, 212
Peruja, 28
Peters, Anne, 76
petitum, 262
Pierandrei, Franco, 62
Scritti di Diritto Costituzionale, 62
Pikis, Georghios, 41
Pinelli, Cesare, 19
Plani Ahtisaari, 41, 80, 81, 82, 91, 105, 160, 161, 162, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 192, 199, 202, 203, 216, 286, 288
politeia, 18
political question doctrine. *Shih* doktrina e çështjes politike
Polonia, 10, 25, 26, 30, 32, 69, 155, 263
Kushtetuta e 1791-ës, 25, 26
Kushtetuta e 1923-ës, 30
Poole, Thomas, 188, 189, 238
Portugalia, 27, 69, 138, 213, 233
Kushtetuta e 1822-ës, 27
pouvoir constituant, 83, 90, 91, 92, 104, 115, 145, 149, 176, 184, 199, 226, 272
pouvoir constituant dérivé, 83, 104, 115, 248
pouvoir constituant originaire, 80, 81, 104, 145, 149, 176, 181, 182, 184, 185, 199, 200, 272
pouvoir constitué, 109
pouvoir neutre et intermédiaire, 225, 226
Presidenti i Kosovës, xii, xiv, xxv, 50, 119, 190, 205, 210, 214, 219, 220, 265, 268, 269, 276, 287
Preuss, Hugo, 222, 235
prima facie, xxviii, 53, 76, 86, 101, 321
pushtet neutral dhe i ndërmjetëm. *Shih pouvoir neutre et intermédiare*
pushteti aktiv, xvi, 229, 230
pushteti kushtetutëbërës. *Shih pouvoir constituant*
pushteti pasiv, xv, 229, 230, 236, 253
Qerimi, Qerim, 200, 201, 209
Qeveria e Kosovës, 207, 241, 245, 266, 271, 272
Qiproja, 40, 41, 69, 75, 76, 160, 178, 191, 193
Kushtetuta, 41
Marrëveshja mbi Garancitë, 41
Marrëveshjet e Londrës e Cyrihut, 41
Qvortrup, Matt, 153
Radan, Peter, 153
Ranjith, H., 213
Rayan, Mark, 77, 78, 79
recta ratio, 77, 102
referimet kushtetuese, 266
Reformacioni, xiii, 307
remedial secession, 183
Renesanca, xii, 307
Rezoluta 1244, 40, 155, 157, 158, 159, 163, 178, 359
Robespierre, Maximilien, xv, xxiii
Rolla, Giancarlo, 268
Rolland, Patrice, 225, 226
Rosenfeld, Michel, 18, 56, 70, 191, 314

Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law, 56, 70
Rousseau, Jean-Jacques, xv, xxiii, 22, 24, 54, 55, 193, 200, 215, 223, 226, 227, 231, 282
RSFJ. *Shih* Jugosllavia
Rumania, xiii, xxi, 25, 26, 32, 192, 263
Kushtetuta e 1866-ës, 25
Rusia, 25, 28, 29, 84, 184, 246, 263
Cari, 28
Kushtetuta, 102
Kushtetuta e 1906-ës, 25, 84
Revolucioni i Tetorit, 29
Ryngaert, Cedric, 95
Sadurski, Wojciech, 268, 314
Sadushi, Sokol, 129, 131
Drejtësia kushtetuese në zhvillim, 129
Sajó, András, 18, 56, 70, 110, 177, 191, 314
Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law, 56, 70
Saliu, Kurtesh, 4, 7, 9, 10, 12, 16, 34, 38, 49, 55, 56, 57, 58, 59, 71, 78, 86, 88, 98, 101, 102, 103, 116, 117, 122, 124, 198, 345
E drejta kushtetuese, 34, 55, 86
Samuels, Kirsti, 92
Sanchez Abri, Patricia, 9
Sartori, G., 241
Saunders, Cheryl, 19
Savoja, 62, 103
Scheindlin, Dahlia, 153
Schmitt, Carl, 10, 11, 54, 55, 56, 58, 59, 71, 79, 80, 81, 82, 83, 111, 112, 115, 116, 117, 171, 172, 175, 213, 219, 224, 225, 234, 235, 273, 300, 311, 344
Constitutional Theory, 10, 54
Scholtz, Werner, 206
Schwartz, 314
Schwartz, Herman, 268
Schwarzenegger, Arnold, 214
Sejdiu, Fatmir, 22, 23, 50, 85, 118, 119, 148, 269, 309
Serbia, xiii, xxi, 123, 124, 141, 148, 149, 153, 155, 157, 158, 162, 163, 164, 167, 168, 169, 170, 173, 179, 180, 181, 182, 185, 188, 258, 260, 295
Sieyès, Abbé, xv, xxiii, xxiv, 106, 107, 110, 215, 223, 227, 231
Qu'est-ce que le Tiers-État?, 106
Siljanovska-Davkova, Gordana, 345
Singapori, 42
Singh, Nidhi, 239
Škarić, Svetomir, 345
Skocia, 243
Slavov, Atanas, 187
Sllovakia, 263
Sllovenia, 3, 124, 164, 165, 169, 173, 263
Smith, Steven, 212
Sokol, Smiljko, 43
Somarthana, A.G.T., 213
Spanja, 25, 27, 30, 44, 45, 61, 69, 91, 114, 115, 116, 263, 318, 330
Kushtetuta, 115
Kushtetuta e Kadizit, 25, 27, 28
Spirovski, Igor, 256
Steinberger, Helmut, 260, 314
Strauss, David, 3
Street, Amy, 188

Sudani, 70
Suedia, 138
sui generis, 87, 149, 162, 178
Suković, Mijat, 39
Sule, Satosh, 222, 352
Sweet, A.S., 314
Shapiro, M., 314
SHBA, 2, 7, 22, 24, 25, 31, 38, 44, 61, 67, 68, 69, 77, 79, 88, 89, 90, 94, 104, 106, 114, 117, 125, 131, 133, 135, 136, 138, 163, 177, 189, 205, 223, 231, 237, 240, 242, 266
  Artikujt e Konfederatës, 90
  Asambleja e Filadelfias, 90
  Bill of Rights, 1, 282, 306, 345, 357
  Deklarata e Shtetit Virxhinia, 4, 282
  Gjykata Supreme, 134, 243, 281, 282
  Kushtetuta, 22, 24, 25, 89, 131, 133, 134, 138, 282
  Marbury v. Madison, 131, 133, 135, 136, 137, 140, 231
  Revolucioni Amerikan, 14, 22, 89, 109, 200
shefi i shtetit, xvi, 221, 238, 317, 318
Sheive, S.W., 314
Shirvani, Foroud, 212
Shqipëria, 10, 12, 32, 44, 46, 60, 68, 75, 79, 84, 91, 122, 170, 181, 260, 262, 263, 280, 291, 296, 315, 316
  Gjykata Kushtetuese, 261
  Kushtetuta, 124, 318
  Marrëveshja për kufirin detar me Greqinë, 260
  Protokolli i Firences, 170
Shrilanka, 213
Shugart, Matthew Søberg, 213
Timori Lindor, 226
Tocqueville, Alexis, 189
Traja, Kristaq, 129, 130, 314
traktatet kontrata, 201
traktatet ligje, 201
Traktati i Lisbonës, 38, 39, 105
Triestja, 155
Trope, Michel, 15
Tunheim, John, 93, 172, 199, 203
Turqia, 68, 69, 262
  Kushtetuta (2017), 206
Tusseau, Guillaume, 45, 63
Tushnet, Mark, 10, 19
  Global Perspectives on Constitutional Law, 10
Thatcher, Mark, 237
Thiers, Adolphe, 229
Ukraina, 243, 263
Umberto II, 62
UNMIK, 39, 153, 158, 161, 173, 178, 208, 254
Uruguaji, 28
uti possidetis, 169
Vedel, Georges, 242
vendime interpretative, 268
Venezuela, 28
Vestfalia, 30, 150, 152, 238
vetëpërmbajtja gjyqësore, 265
Vidmar, Jure, 148, 149
Vijay, Anurag, 239
Vilajeti i Kosovës, 146, 147, 148
Vilajeti i Nishit, 147
Vilajeti i Prizrenit, 147
Vile, M.J.C., 8
Vinx, L., 314
Virgjili, 18
  Eneida, 18

volonté générale, 215, 226, 231
Von Jhering, Rudolf, 43
Von Moltke, Johannes, 31
Waldron, Jeremy, 94, 95, 325
Warbrick, Colin, 152, 202
Weller, Marc, 84, 93, 160, 171, 172, 174, 199, 203
Wilde, Oscar, 344
Williams, George, 189
Wouters, Jan, 95
Wyeth, Vanessa Hawkins, 92
Ydit, Meir, 155
Yu-chung, Shen, 222, 357
Zaganjori, Xhezair, 181, 260
Zelanda e Re, 126, 127
Zvicra, 36, 102, 114, 115, 116
  Kushtetuta, 115
  Kushtetuta e 1874-ës, 102
  Kushtetuta e 1893-ës, 36

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

342

Hasani, Enver
E drejta kushtetuese : Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese" të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj / Enver Hasani. – Hjuston : Jalifat Publishing, 2018. – 404 f. ; 24 cm. – (Biblioteka Besa)

Literatura : f. 349-360. – Treguesi : f. 361–373. – Summary in English : xix–xxvi.

ISBN 978-0-9970186-6-0